

# ENVER HOXHA

VEPRA

21



**PROLETARË TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

**BOTOHET ME VENDIM TE KOMITETIT  
QENDROR TE PARTISE SE PUNES TE  
SHQIPERISE**



**ENVER HOXHA**



**INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE - LENINISTE  
PRANE KQ TE PPSH**

# **ENVER HOXHA**

**V E L L I M I**

**21**

**MAJ 1961 - SHTATOR 1961**

**SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1976**



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 21-TË

Vëllimi i 21-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përfshin dokumente të periudhës maj-shtator 1961, shumica e të cilave botohen për herë të parë.

Ky vëllim përmban kryesisht fjalime e biseda në takime, në mbledhje dhe në aktive të gjera me komunistë, punonjës, kuadro e me ushtarakë në qendër e rrethe, të cilat janë shkruar fill pas Kongresit IV të PPSH dhe përbëjnë një program konkret lufte e pune me rëndësi të madhe për edukimin dhe për mobilizimin revolucionar të komunistëve e të punonjësve. Veprat e këtij vëllimi zbërthejnë vendimet historike të Kongresit IV dhe orientojnë komunistët dhe punonjësit për zbatimin sa më mirë të detyrave që përcaktoi Kongresi.

Ndër problemet më të rëndësishme të kësaj periudhe janë ato që kanë të bëjnë me mobilizimin e përgjithshëm për realizimin ritmik të detyrave të planit të tretë pesëvjeçar. Në këtë kohë udhëheqja sovjetike me Hrushovin në krye, e tërbuar nga qëndrimet e prera parimore, marksiste-leniniste të PPSH, e dendësoi më tej veprimtarinë e saj antimarksiste e antishqiptare, duke pezulluar të gjitha marrëveshjet e arritura dhe duke përgatitur bllokadën ekonomike, politike dhe ushtarake kundër Shqipërisë socialiste. Në rrethana të tilla plotë-

simi me sukses i pesëvjeçarit të tretë merrte një rëndësi politike edhe më të madhe se në pesëvjeçarët e mëparshëm. Për këtë Komiteti Qendror i Partisë porosiste se, vetëm duke kuptuar thellë anën politike e ideologjike të problemeve ekonomike, masat punonjëse do të bëheshin plotësisht të ndërgjegjshme për të vënë në shërbim të revolucionit e të socializmit të gjitha aftësitë e tyre mendore e fizike duke i bërë të pafektshme presionet e shumta të revizionistëve sovjetikë dhe bllokadën e egër imperialisto-revizioniste.

Materialet e këtij vëllimi japin një pasqyrë të gjallë të punës së gjithanshme politike e ideologjike që iu desh të bënte në këtë periudhë Komitetit Qendror të Partisë. Bisedat e shokut Enver Hoxha me punëtorë, kooperativistë, specialistë e kuadro, diskutimet e tij në mbledhjet e Byrosë Politike e të Sekretariatit të KQ të Partisë, fjala e mbajtur në Plenumin II të KQ etj. përgatitnin ideologjikisht e politikisht komunistët dhe mbarë masat punonjëse për të përballuar me sukses vështirësitë e pengesat e shumta që ishin krijuar e do të krijoheshin për zbatimin e detyrave të planit të tretë pesëvjeçar si dhe të detyrave të tjera që kishin të bënin me forcimin e mëtejshëm të diktaturës së proletariatit, të mbrojtjes së atdheut etj. Këto materiale ndihmonin gjithashtu që të kuptohej sa më mirë e më thellë parimi marksist-leninist i mbështetjes në forcat e veta, parim që Partia jonë vazhdimisht e kishte pasur në bazë të veprimtarisë së saj udhëheqëse, por që merrte një kuptim edhe më konkret e më të mprehtë pas vendosjes së bllokadës dhe prerjes së ndihmës ekonomike nga ana e revizionistëve hrushovianë.

Trajtimin e këtyre problemeve të rëndësishme, që kishin të bënin me zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të rendit tonë socialist, PPSH dhe shoku Enver e shihnin të lidhur ngushtë me luftën konsekuente e pa kompromis që u duhej bërë qëndrimeve dhe veprimeve antimarksiste, tradhtare e antishqiptare të revizionistëve modernë. Të vendosur për të ecur më tej në kursin e tyre tradhtar, revizionistët hrushovianë çdo ditë e më tepër po e shoqëronin bllokadën ndaj vendit tonë me një veprimtari të gjithanshme armiqësore të fshehur e të hapur. PPSH dhe shoku Enver e shihnin qartë se mosmarrëveshjet dhe kontradiktat e mëdha politike e ideologjike që ekzistonin midis PPSH dhe PK të BS ishin acaruar në kulm, se nuk qe e largët dita kur lufta do të bëhej e hapur. Dokumentet e këtij vëllimi, si fjala në Plenumin III të KQ mbi disa probleme të gjendjes ndërkombëtare dhe fjalime e biseda të tjera, u bëjnë një analizë të thellë marksiste-leniniste qëndrimeve gjithnjë e më të shëmtuara të revizionistëve hrushovianë, zbulojnë thelbin e tyre antimarksist, demaskojnë veprimet e tyre kundërrevolucionare, që synonin ta detyronin Partinë e Punës dhe popullin shqiptar të gjunjëzoheshin dhe shprehnin vendosmërinë e patundur të PPSH dhe të RPSH për të mos iu nënshtruar asnjë diktati, për të ecur kurdoherë pa lëkundje në rrugën marksiste-leniniste. Në këtë mënyrë dokumentet që botohen në këtë vëllim janë vazhdim i përgatitjes së komunistëve e masave për të kuptuar më thellë tradhtinë e udhëheqjes së revizionistëve sovjetikë. Kjo luftë bëhej për probleme të mëdha parimore, që kishin të bënin me

bazat e doktrinës marksiste-leniniste, me fatet e lëvizjes komuniste e punëtores ndërkombëtare.

Shkrimet e këtij vëllimi janë vazhdim i mëtejshëm i luftës konsekuente të PPSH për mbrojtjen e parimeve të marksizëm-leninizmit në shkallë ndërkombëtare. Ato karakterizohen nga parimësia e lartë marksiste-leniniste dhe nga konsekuenca e vijës së palëkundur marksiste-leniniste që ka ndjekur në çdo periudhë të revolucionit e të ndërtimit socialist Partia jonë e Punës dhe Komiteti Qendror i saj me shokun Enver Hoxha në krye. Veprat që përmban ky vëllim, i përshkon si një fill i kuq besnikëria e thellë ndaj çështjes së marksizëm-leninizmit, popullit, atdheut e socializmit, vendosmëria për të mos u përkulur para asnjë armiku e shtate, para asnjë presioni, bllokade e shantazhi, por për të çarë kurdoherë përpara me trimëri e guxim marksist-leninist.

Dokumentet që botohen në këtë vëllim kanë një vlerë të madhe aktuale. Ato janë armë e fuqishme në duart e komunistëve, të klasës punëtores, të mbarë masave tona punonjëse, për të qenë kurdoherë vigjilente e në pozita sulmi, të gatshme e të palëkundura për mbrojtjen e fitoreve të arritura, për zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të atdheut tonë socialist.

## TE MESOJME PERDITE DHE DIJEN TA VEME NE SHERBIM TE POPULLIT

*Fjala para nxënësve dhe mësuesve të shkollës  
pedagogjike «Luigj Gurakuqi» të Elbasanit*

**3 maj 1961**

Të dashur nxënës dhe mësues,

Ju falemi nderit për këtë pritje kaq të ngrohtë dhe entuziaste që dëshmon për dashurinë e pafund që ju keni për Partinë e Punës. Ta doni kurdoherë me gjithë shpirt këtë Parti, e cila organizoi, mobilizoi dhe udhëhoqi popullin në luftë për çlirimin e atdheut nga armiqtë e jashtëm dhe tradhtarët e vendit. Edhe sot, nën udhëheqjen e Partisë, po ndryshon faqja e Shqipërisë, e bashkë me të ndryshojnë edhe njerëzit, sidomos ju, të rinjtë dhe të rejat.

Shumë prej jush nuk i kanë parë tmerret e luftës dhe vuajtjet e mëdha që ka hequr populli ynë. Ju të rinjtë nuk e keni jetuar periudhën para Çlirimit, kur populli vuante nën sundimin e regjimit feudoborgjez dhe nën zgjedhën e pushtuesve të huaj. Ju keni lexuar dhe keni dëgjuar për heroizmat e popullit tonë, si u ngrit

ai i tëri në këmbë gjatë Luftës Nacionalçlirimtare për çlirimin e atdheut, sepse atë e edukoi, e organizoi dhe e udhëhoqi Partia jonë e lavdishme. Po të mos kishte qenë Partia, do të ishte shumë e vështirë që Shqipëria të fitonte lirinë e vërtetë dhe sot të ndërtonte me sukses socializmin.

Çlirimi i atdheut u arrit, sepse Partia jonë ka ndjekur që në fillim një vijë të drejtë e të palëkundur marksiste-leniniste, atë vijë që shprehte dëshirat, ndjenjat dhe qëllimet fisnike të popullit tonë. Ka pasur parti marksiste edhe në vende të tjera që kanë qenë në kushtet tona, por që, duke mos zbatuar si duhet një vijë të drejtë marksiste-leniniste, gjatë luftës nacionalçlirimtare, ato nuk kanë qenë në gjendje ta çonin popullin e tyre drejt çlirimit e më vonë në rrugën e ndërtimit të socializmit, ashtu si e çoi Partia popullin tonë.

Ka shumë nga ata njerëz që nuk ndihmuan luftën për çlirimin e atdheut, por pas Çlirimit i vriste ndër-gjegjja dhe qortonin veten përse nuk dhanë edhe ata kontributin e tyre në Luftën Nacionalçlirimtare. Sigurisht kjo luftë ishte mjaft e vështirë. Por edhe pas Çlirimit para popullit shtroheshin detyra akoma më të mëdha e më të vështira se Lufta Nacionalçlirimtare, që kishin të bënin me ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Për të realizuar këto detyra të rënda, Partisë sonë i duhej të ndiqte përsëri një rrugë të drejtë marksiste-leniniste si gjatë luftës, ndryshe viheshin në rrezik të gjitha fitoret që i siguroi Partia popullit. Por Partia jonë, e kalitur dhe e edukuar me mësimet e V.I. Leninit dhe të J.V. Stalinit, edhe pas Çlirimit diti të zbatojë

me nder detyra të mëdha që e sollën popullin në ditët e sotme.

Ditët e bukura që gëzojmë, i detyrohen patriotizmit të zjarrtë dhe besnikërisë së madhe të popullit tonë ndaj Partisë, i detyrohen Partisë dhe vijës së saj të drejtë. Dhe për zbatimin e kësaj vije të drejtë u mobilizuan, dhe sot janë mobilizuar, si asnjëherë në historinë e popullit tonë, energjitë e tij të pashtershme, e bashkë me të edhe ata njerëz të ndershëm, të cilët, për një arsye ose për një arsye tjetër, nuk morën dot pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare.

Shihni si është ndryshuar Shqipëria! Nuk ka shumë vjet që te ne kolektivizimi mori përpjesëtime të gjera, u zbukuruan fushat e kodrat e atdheut tonë, janë hapur kudo toka të reja, u zhdukën gjerdhet e ferrat, u çelën kanale ujitëse dhe u thanë kënetat e moçale, u shtuan e u përmirësuan bagëtitë, u rrit prodhimi bujqësor etj., etj. Të gjitha këto u arritën vetëm në këto pak vite; po ç'do të bëhet te ne në vitet e ardhshme? Vendi ynë do të bëhet me të vërtetë një kopësht i bukur! Shikoni si punojnë sot me zell dhe të bashkuar si vëllezër kooperativistët tanë. Disa vjet më parë anëtarët e Partisë hasnin vështirësi për t'i bindur fshatarët që të futeshin në kooperativë. Tani fshatari shqiptar nuk ndahet nga kooperativa, se aty sheh të ardhshmen e tij të lumtur.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë shteti do t'i japë një ndihmë të madhe bujqësisë, në radhë të parë me traktorë, në bazë të detyrave që vendosi Kongresi IV i Partisë. Do të ndërtohen uzinat e plehrave kimike, do të zgjerohet rrjeti i ujitjes, kështu që nga fundi i këtij

pesëvjeçari, sidomos me përfundimin e pesëvjeçarit të katërt, jeta e popullit tonë do të bëhet më e mirë, sepse me rendimentet që do të sigurohen, do të shtohet prodhimi bujqësor në të gjitha kulturat.

Një hov më të madh do të marrë në rrethin tuaj industria. Rëndësi të veçantë ka për zhvillimin e forcave prodhuese të vendit tonë metalurgjia e zezë. Kombinati metalurgjik që do të ngrihet në qytetin tuaj, do të jetë qendra e parë e madhe e metalurgjisë në vendin tonë. Do të ndërtohet, gjithashtu, një fabrikë e madhe për prodhimin e çimentos si dhe një sërë veprash të tjera.

Punimet që do të bëhen gjatë këtij pesëvjeçari, pra, kanë një rëndësi shumë të madhe për zhvillimin e mëtejshëm ekonomik e kulturor të vendit tonë, por s'duhet harruar se detyrat që kemi përpara janë shumë të rënda, por plotësisht të realizueshme. Them plotësisht të realizueshme se ne kemi një popull të mrekullueshëm, me komunistët në ballë të frontit të luftës së ndërtimit të socializmit, kemi një rini heroike të vendosur dhe të aftë për të kapërcyer çdo vështirësi.

Edhe ju nxënësit keni një detyrë të madhe për të kryer: të mësoni sa më shumë dhe të bëheni njerëz të denjë për popullin, për Partinë dhe për atdheun tonë.

Partia punon që veçanërisht ju, të rinjtë dhe të rejtat, të rroni të gëzuar, për ju po ndërtohet jeta e lumtur. Detyra juaj në këtë fazë është të mësoni, sepse vendi ka nevojë për kuadro, sidomos për arsimtarë. Ju keni dëgjuar për vendimet e Kongresit IV të Partisë. Me mijëra arsimtarë do të duhen deri në fund të këtij pesëvjeçari. Deri atëherë ne duhet të kemi afërsisht 17



mijë veta. Pa arsim nuk mund të ndërtohet Shqipëria e re. Që të ecë ajo në rrugën e Partisë, duhen kuadro, duhen mësues që të edukojnë brezin e ri me shkencë, me dituri. Këtë do ta bëni ju, mësuesit e ardhshëm në radhë të parë. Kur ju, mësuesit e ardhshëm të shkollave fillore, ta bëni mirë punën, po ta kryeni detyrën në lartësinë e duhur, nxënësit do ta përvetësojnë lëndën më mirë, kështu, kur ata të shkojnë në shkolla të mesme e të larta, do të jenë më të përgatitur, do të dalin kuadro, të zotë për t'i dhënë popullit më shumë të mira.

Ju, nxënës të Shkollës Pedagogjike të Elbasanit, që keni ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, ta keni për nder që mësoni në këtë shkollë. Kjo shkollë i ka dhënë vendit tonë mësuesit e parë, të cilët kanë përgatitur një numër të madh arsimtarësh, që, të edukuar këtu, me një frymë të lartë patriotike, kanë shpërndarë kudo arsimin dhe kulturën në popull. Edhe ju që keni ardhur tani në Shkollën Pedagogjike të Elbasanit, të jeni kryelartë për shkollën tuaj, me të cilën krenohet i gjithë populli shqiptar, prandaj të mësoni si duhet për ta mbajtur kurdoherë lart nderin e kësaj shkolle.

Gjithashtu, të keni parasysh se nuk është e mjaftueshme puna që do të bëni këtu në shkollë. Ju shikoni si zhvillohet shkenca dhe e dini që thesarët e diturisë nuk mësohen vetëm gjatë kohës që je brenda mureve të shkollës. Prandaj, pasi të kryeni shkollën e mesme, të vazhdoni edhe më tej studimet, qoftë duke ndjekur universitetin, ose edhe duke studjuar vetë. Me këtë dua të them që, kur të bëheni mësues, të mos harroni se nuk është e mjaftueshme aq sa keni mësuar, mendoni se duhet të kualifikoheni vazhdimisht.

Jeta e njeriut është shumë e shkurtër, kurse dituritë, shkencat janë shumë të gjera. Prandaj kurrë nuk duhet lënë pas dore detyra që çdo ditë të mësojmë dhe atë që përvetësojmë, ta vëmë në shërbim të popullit. Po të mendojmë dhe të punojmë të gjithë kështu, atëherë çdo rrezik që kërcënon Shqipërinë do të zhduket, çdo pengesë që na del përpara do të kapërcehet, vendi ynë do të forcohet dita-ditës dhe armiqtë nuk do të gjejnë dot as të çarën më të vogël, për të na penguar në rrugën tonë.

Ju e dini se armiku kryesor i vendit tonë është imperializmi e në radhë të parë imperializmi amerikan, më i egri, luftënxitës dhe gjakatar. Kush nuk e paraqit ashtu siç është në realitet imperializmin amerikan, ai është në shërbim të tij dhe shërbëtorët kryesorë të imperializmit amerikan janë revizionistët jugosllavë, si dhe të gjithë revizionistët e tjerë modernë, që përpigjen të paraqiten të maskuar përpara popujve. Por jeta, përpjekjet dhe lufta që bëjnë këta popuj i demaskon ata, dhe vërtetojnë çdo ditë e një mirë vijën tonë të drejtë marksiste-leniniste.

Marksizëm-leninizmi na mëson ta demaskojmë pa mëshirë imperializmin, dhe sidomos tani imperializmin amerikan, të demaskojmë revizionizmin dhe të luftojmë kundër tyre, të mos u bëjmë atyre asnjë lëshim, ashtu sikurse ka vepruar Lenini, ndryshe ata të mbytin.

Ju keni dëgjuar ç'kanë bërë dhe ç'po bëjnë edhe tani imperialistët dhe revizionistët kundër vendit tonë, komplete të vazhdueshme, duke filluar që nga Lufta Nacionalçlirimtare dhe deri sot. Por ata kurdoherë kanë dështuar dhe do të dështojnë. Të gjitha komplo-

tet dhe intrigat e tyre, si ato të organizuara nga jashtë, ashtu edhe ato të organizuara me anën e tradhtarëve të vendit, janë zbuluar dhe janë shtypur. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhshmen. Ata mendojnë se e kanë izoluar popullin tonë, por ne kurrë nuk do të gjendemi të izoluar. Ne do të fitojmë kundër kujtdo qoftë dhe sado i fuqishëm qoftë, sepse i pamposhtur është marksizëm-leninizmi, që ne kemi përqafuar dhe e mbrojmë.

Kush mund të mohojë se politika e drejtë e Partisë sonë nuk është vërtetuar në jetë? Ne jemi një popull dhe një Parti që luftojmë me të gjitha forcat për paqen. Por ka njerëz që thonë se ne nuk jemi për paqen dhe se ne duam gjoja të hidhet bota në zjarr. Po paqja nuk mbrohet vetëm me fjalë, siç bëjnë disa, ajo mbrohet duke punuar e duke luftuar për të, duke qenë vigjilentë ndaj çdo manovre të armiqve të paqes dhe duke i demaskuar deri në fund veprimet e tyre. Të bësh zhurmë për paqen vetëm me fjalë, kjo nuk ka asnjë vlerë. Paqja mbrohet me aksione konkrete kundër imperializmit e sidomos kundër imperializmit amerikan, duke e demaskuar atë pa mëshirë, e bile, po të jetë nevoja, duke derdhur edhe gjak.

Ç'rezultate ka dhënë politika e revizionistëve modernë? Ka vite me radhë që ata thonë të çarmatosemi, po asgjë s'është bërë. Partia jonë është dakord që të gjitha shtetet të çarmatosen dhe të ecim drejt paqes. Po ç'ndodh? Imperialistët, e në radhë të parë imperialistët amerikanë, po armatosen vazhdimisht, ata po e bëjnë Gjermaninë Perëndimore qendrën e revanshit. Kështu veprojnë në Japoni e gjetkë. Imperialistët po ndërtojnë kudo baza të reja ushtarake, rrotull vendeve

socialiste, po aktivizojnë organizatat agresive ushtarake, po përkrahin kudo klikat antipopullore, po organizojnë ushtri mercenare dhe po ndezin vatra lufte për të shtypur popujt.

Partia dhe Qeveria jonë janë dakord të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë. Por ç'bëhet në këtë drejtim? Vazhdimisht po bëhen lëshime. Në vend që të nënshkruhet të paktën traktati i paqes me Republikën Demokratike Gjermane, po i bëhen lëshime të reja imperializmit.

Partia jonë e ka thënë në Mbledhjen e Moskës se sa më vonë të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë, aq më e vështirë bëhet gjendja, sepse Republika Federale Gjermane armatoset, forcohet, bëhet më e rrezikshme. Kur ishte Stalini, një fjalë thoshte dhe dridheshin imperialistët, kurse tani Gjermania po armatoset deri në dhëmbë. Kuba u sulmua nga mercenarët amerikanë, po bëhen luftëra në Laos, në Kongo, në Algjeri, të shkaktuara nga imperialistët. Ndërsa ne, pse i demaskojmë këto veprime të armiqve të paqes, na quajnë «dogmatikë».

Por ne jemi për paqen. Askush nuk mund të mendojë që një popull i vogël si yni, i rrethuar nga armiq, të mos dojë paqen. Po për paqen duhet luftuar, t'i thuhet popullit kush është armiku i paqes që vë në rrezik jetën e tij, në mënyrë që populli të jetë i armatosur dhe i gatshëm kurdoherë, domethënë të mbajë në një-rën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, dhe kështu, të pregatitur, të ecim përpara. Duke vepruar kështu, armiku e di se ku e ka vendin.

Imperialistët përpiqen të përfitojnë nga vështirë-

sitë tona të përkohshme, po ata i tmerron marksizëm-leninizmi. Marksizëm-leninizmit ia kanë frikën shumë edhe ata që luftojnë të maskuar kundër tij. Prandaj ata kanë kthyer bateritë kundër Shqipërisë. Por Shqipëria, megjithëse e vogël, nuk përkulet as para imperialistëve, as para fashistëve të rinj italianë, monarko-fashistëve grekë, revizionistëve jugosllavë apo kujtdo tjetër, sepse populli ynë jo vetëm është patriot i zjarrtë e i vendosur dhe në gjendje të mbrojë veten, por ai nuk është as i vetëm kundër armiqve të paqes dhe të marksizëm-leninizmit. Me popullin dhe me Partinë tonë janë të gjitha ato parti marksiste-leniniste që luftojnë me vendosmëri kundër imperializmit dhe revizionizmit.

Populli ynë, që është i lidhur si mishi me thoin me Partinë, aprovon të gjithë veprimtarinë politike, ideologjike dhe ekonomike të saj. Kjo nuk është propagandë, po realitet i gjallë. Kur ne kapim prej zverku tradhtarët e popullit dhe të Partisë, që hyjnë në shërbim të imperialistëve e të revizionistëve, dhe i çojmë përpara gjyqit, populli thotë: të shfaroset kjo farë! Kështu ndodh te ne, sepse rruga e Partisë është e drejtë. Ajo nuk u pëlqen vetëm imperialistëve, revizionistëve dhe tradhtarëve, të cilët kërkojnë të hedhin në erë pushtetin popullor dhe të vendosin regjimin e urryer të kapitalizmit, siç po ndodh në Jugosllavi.

Populli ynë me të drejtë ushqen një dashuri jashtë-zakonisht të madhe për Partinë, sepse nën udhëheqjen e saj ai çliroi atdheun e robëruar nga imperialistët dhe nga klasat sunduese dhe sot ndërton jetën e tij të lumtur. Prandaj t'i përvishemi punës me atë gëzim, entuziazëm e guxim revolucionar që karakterizon popu-

llin dhe rininë tonë. Ju nxënësit të mësoni sa më shumë dhe të punoni që vendimet dhe vijën e Partisë t'i zbatoni me sukses në jetë.

Viti i parë i pesëvjeçarit të tretë ka filluar mbarë, jo vetëm se këtë vit na ndihmoi edhe klima me shirat që ranë, por edhe për faktin se kemi një klasë punëtore heroike, një fshatarësi revolucionare dhe një inteligjencë patriotike, që, si asnjëherë tjetër, janë mobilizuar në punë për të zbatuar në jetë vendimet historike të Kongresit IV të Partisë. Kurrë nuk ka ndodhur si këtë vit që të gjitha ndërmarrjet industriale të vendit jo vetëm ta realizojnë, por shumica e tyre edhe ta tejkalojnë planin e tremujorit të parë. Plani është realizuar edhe në bujqësi e në të gjithë sektorët e tjerë. Kjo frymë optimizmi dhe entuziazmi po vazhdon dhe do të vazhdojë të ndihet edhe më mirë.

Ju uroj nga zemra, të dashur nxënës dhe mësues, të gjithë juve, që tregoni një dashuri kaq të madhe për Partinë, suksese sa më të mëdha në punë! Të jeni të bindur se Partia do të qëndrojë kurdoherë pranë jush, ajo do t'ju japë ndihmën e saj të pakursyer në kohë të mira dhe të vështira për të kapërcyer çdo vështirësi që do t'ju dalë përpara.

Rrofshin nxënësit dhe arsimtarët e Shkollës Pedagogjike të Elbasanit!

Të rrojë Partia e Punës e Shqipërisë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PËRSE RANKOVIÇI SHKON NË ATHINË?

2 maj 1961

Diplomatët jugosllavë vërtiten në kryeqytete të ndryshme të botës duke fshehur nën gunë plane kompletesh kundër paqes, kundër lirisë së popujve, kundër kampit të socializmit. Të gjitha këto veprime të tyre në shërbim të imperializmit botëror dhe të borgjezisë reaksionare ata i maskojnë me fjalë të mëdha, me demagogji. Në fund të çdo ndërmarrjeje dhe sipas shkallës së suksesit të arritur, diplomatët jugosllavë marrin nga padroni i tyre amerikan edhe ryshfetin, me një fjalë likuidohen faturat me anën e çeqeve me dollarë.

Këtë herë është Rankoviçi që shkon në Athinë. Ai shkon edhe si diplomat, edhe si ideolog, edhe si polic. Me fjalë të tjera, shkon «energji atomike jugosllave» në Athinë.

Vajtja e Rankoviçit në Athinë diktohet nga interesat e të dyja palëve. Të dyja palët do të nxjerrin konkluzionet dhe do të koordinojnë veprimet e hapura dhe të fshehta.

Mareshali jugosllav, kur u kthye në Beograd, «i nxirë në fytyrë nga dielli i Afrikës», siç thoshte TAN-

JUG-u, ishte bërë më afrikan se afrikani. Titoja me pak fjalë u tha qytetarëve nga ballkoni se atë e «kanë pritur», kudo ku shkoi, si Mesinë, dhe kjo do të mbetet si një datë historike për këta popuj. S'është çudi që paskëtaj popujt e Afrikës të numërojnë vitet dhe epokat duke filluar nga vajtja e Titos në ato vende. Por reklamat dhe blufet u duhen imperialistëve dhe çirakëve të tyre për të gënjyer popujt, pavarësisht se sa gënjehen ata dhe sa u zënë besë këtyre manovrave.

Por njerëzit e falimentuar në politikë, për të shpëtuar nga katastrofa dhe mbytja, kapen ku munden. Dhe nga kjo gjendje kërkojnë të përfitojnë imperializmi dhe Titoja, për të gënjyer dhe për të fituar koncesione për interesat e tyre djallëzore.

Në këtë labirint intrigash vete edhe Rankoviçi në Athinë. Qëllimet tanimë janë të qarta. Sigurisht, nuk janë as ato që deklaroi shtypi jugosllav, as ato deklarata publike që mund të bëjë Rankoviçi në Athinë, por intrigat, marrëveshjet sekrete dhe komplotet prapa mureve të ftohta të kancelerive dhe ambasadave. Fundi i fundit, këto janë në kompetencën e vet, sepse, sikurse dihet, aftësitë e tij janë dukur vetëm e vetëm në punën e shërbimeve sekrete, të intrigave dhe të kompleteve.

Rankoviçi shkon në Athinë për të koordinuar planet e «Paktit të Ballkanit» — ku bëjnë pjesë të dy vendet, dhe nëpërmjet tij lidhen me NATO-n, për të forcuar dhe për të aktivizuar sidomos anën ushtarake të tij.

Revizionistët jugosllavë, për demagogji dhe për të gënjyer popujt, përpiqen ta zvogëlojnë anën ushtarake



të «Paktit të Ballkanit». Por faktet tregojnë të kundërtën. Oficerë të lartë të ushtrisë jugosllave marrin pjesë në manovrat e ushtrisë greke, të cilat nuk bëhen rastësisht drejt kufijve të Shqipërisë. Delegacione të shumta ushtarake shkëmbehen çdo vit midis të dy vendeve, shkëmbehen informata dhe eksperiencë e gjithanshme. Ushtria jugosllave pajiset me armatime amerikane nëpërmjet Greqisë. Agjencia franceze e lajmeve AFP njoftonte nga Athina më 16 dhjetor të vitit që shkoi: «U mësua nga një burim i autorizuar se qeveria greke i shiti kohët e fundit qeverisë së Beogradit 50 aeroplanë ushtarakë amerikanë të tipit F-84, bashkë me pjesët e këmbimit. Furnizimi i këtyre aeroplanëve do ta ndihmojë Jugosllavinë, e cila nuk merr më ndihmë ushtarake amerikane (sic), të mbajë nivelin e potencialit të saj ushtarak. Marrëveshja e përfunduar me pëlqimin e Shteteve të Bashkuara, parashikon një shumë prej afro një milion dollarësh. NATO-ja u vu në dijeni mbi këtë marrëveshje. Kjo është një provë tjetër, thuhet në Athinë, se marrëdhëniet greko-jugosllave janë shumë të mira. Misionet ushtarake shkëmbehen rregullisht midis të dy vendeve».

Më qartë se kaq s'ka ku të vejë. Qarqet e Athinës dhe agjencia franceze e lajmeve zbulojnë qartë atë që revizionistët jugosllavë mundohen të mbulojnë me zor, domethënë bashkëpunimin e ngushtë ushtarak greko-jugosllav nëpërmjet «Paktit të Ballkanit» me NATO-n, nën drejtimin e drejtëpërdrejtë të Shteteve të Bashkuara.

Pra, mund të kuptohet lehtë vendi që do të zënë bisedimet me karakter ushtarak në bisedimet e Athinës.

Nuk është e rastit edhe koha e zgjedhur për udhëtimin e Rankoviçit në Athinë. Bisedimet në rrugën diplomatike për këtë vizitë, vetë vajtja e Rankoviçit, si dhe «shëtitja turistike» e nënadmiralet amerikan Xhorxh Anderson në Jugosllavi, bëhen vetëm pak javë pasi në Kongresin IV të PPSH u denoncua botërisht komploti që kishin përgatitur kundër lirisë dhe pavarësisë së Shqipërisë Jugosllavia dhe Greqia së bashku me Flotën VI Amerikane dhe me disa tradhtarë shqiptarë.

Rankoviçi do të qajë hallet, pra, me miqtë e tij të Athinës në lidhje me falimentimin e planit të tyre kriminal kundër RP të Shqipërisë dhe do të këshillohet për kurdisjen e planeve e të kompleteve të tjera për të ardhshmen. Puna e kompleteve jugosllave dhe greke për copëtimin e Shqipërisë ka rrënjë të vjetra. Ato e kanë bërë të dërsijë shumë diplomacinë e monarkive të të dy vendeve përpara dhe pas Luftës së Parë Botërore, dhe kanë zënë gjithashtu një vend shumë të madh në diplomacinë e revizionistëve jugosllavë dhe të monarko-fashistëve grekë pas Luftës së Dytë Botërore, duke filluar nga niveli i diplomatëve gjer në nivelin më të lartë të personaliteteve me përgjegjësi shtetërore, siç janë pazarllëku Piade - Caldaris në korridoret e Konferencës së Paqes në Paris më 1946, ose bisedimi Tito - Pavël në Korfuz më 1956 për ta ndarë Shqipërinë midis Jugosllavisë e Greqisë. Komplotet dhe pazarllëqet në kurriz të Shqipërisë kanë lidhje edhe me zgjidhjen e disa mosmarrëveshjeve të vjetra midis Greqisë dhe Jugosllavisë, të cilat, me gjithë aleancën e ngushtë midis të dy vendeve, nuk mungojnë

të dalin herë pas here në sipërfaqe. Kështu, në gushtin dhe në dhjetorin e vitit që shkoi, disa gazeta greke dhe jugosllave nisën një fushatë të ashpër për punën e Maqedonisë. Shtypi jugosllav e akuzonte Greqinë për synime territoriale ndaj Maqedonisë, ndërsa shtypi grek e akuzonte Jugosllavinë se zhvillon fushatë mbi temën e «Maqedonisë së Egjeut». Në Beograd, në Athinë dhe në disa kryeqytete të vendeve të NATO-s flitet përherë e më shumë se janë të gjitha mundësitë që të dyja palët të mbeten të kënaqura duke e zgjidhur këtë çështje në kurriz të Shqipërisë. Edhe një fakt tjetër: Kohët e fundit në shtypin grek flitet përherë e më shumë për «autonominë e Vorio Epirit», duke e lidhur këtë çështje me kuptimin që i jep bashkekzistencës paqësore Sofokli Venizellosi, që, nën maskën e «autonomisë të Vorio Epirit», fsheh planct agresive të shovinistëve grekë kundër RP të Shqipërisë dhe nën maskën e «bashkekzistencës paqësore» fsheh politikën agresive të reaksionit grek. Rankoviçi, me rastin e vajtjes së tij në Athinë, do të japë patjetër eksperiencën jugosllave mbi «autonominë e Kosovës» dhe mbi «bashkekzistencën paqësore», siç e kuptojnë atë revizionistët jugosllavë.

Qëllimet politike dhe ushtarake të vizitës së Rankoviçit në Athinë plotësohen edhe me një aspekt tjetër, me atë të diversionit ideologjik, megjithëse nënkryetari i Këshillit Ekzekutiv Federal të Jugosllavisë, specialist në çështjet policore, nuk është dalluar në fushën e ideologjisë. Por duhet thënë se njerëzit, të cilëve ai mund t'u japë ndihmë në këtë rast dhe që merren me çështje «ideologjike», nuk janë gjë tjetër veçse agjentë të policisë. Është fjala për elementët trockistë grekë.

Kohët e fundit këta kanë filluar të shtojnë aktivitetin për të formuar një organizatë të pavarur trockiste. Në janar të këtij viti ata nisën të botojnë edhe një gazetë, me të cilën kanë filluar një fushatë të gjerë kundër Partisë Komuniste Greke dhe EDA-s dhe kërkojnë të përhapin «komunizmin jugosllav». Me sa duket, qarqet zyrtare greke dhe veçanërisht ato policore, kanë ndër mend të formojnë me ta ndonjë organizatë politike të ngritur mbi parimet e Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, për ta paraqitur më vonë si «parti marksiste». S'ka asnjë dyshim se Rankoviçi është njeriu më i përshtatshëm, plotësisht në gjendje t'u japë eksperiencë dhe këshilla si këtyre elementëve trockistë ashtu edhe policisë greke. Është çështje zanati. Pastaj kush më shumë se ai është i interesuar të sigurojë pasues të «komunizmit jugosllav» edhe në vende të tjera. Nga ana tjetër, kush mund t'u japë këshilla më të mira qarqeve drejtuese të Athinës për propagandën e tyre kundër vendeve socialiste sesa revizionistët jugosllavë dhe në mënyrë të veçantë shefi i policisë jugosllave, që mban në dorë rrjetat e agjenturave të qendrave revizioniste kudo ku ka mundur t'i krijojë ato në vendet socialiste ose në vende të tjera?

Qëllimet e vizitës së Rankoviçit në Athinë janë, pra, të qarta, qoftë për anën politike, qoftë për atë ushtarake ose ideologjike, ku një vend me rëndësi zënë koordinimi i planeve dhe organizimi i kompleteve të reja kundër vendit tonë. Por s'ka asnjë dyshim se planet e komplotet e tyre do të dështojnë edhe në të ardhshmen, ashtu si kanë dështuar deri tani. Populli shqiptar ruan me vigjilencë dhe është gati t'u japë për-

gjigje shkatërruese atyre që ngrenë dorën kundër lirisë dhe pavarësisë së tij. RP e Shqipërisë nuk është e izoluar, megjithëse gjeografikisht është e rrethuar nga shtete që ndjekin një politikë armiqësore kundër saj, nuk është vetëm, por ka miq në të gjithë botën.

*Botuar për herë të parë si artikull redaksional në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 106 (3949), 2 maj 1961*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## KOMUNISTËT SHQIPTARË I PËRULEN VETËM MËRKSIZËM-LENINIZMIT DIJE POPULLIT TONË

*Nga biseda me kuadrot e Partisë të qytetit të Elbasanit*

4 maj 1961

Përshtypjet e mia për rrethin e Elbasanit, gjatë këtyre dy ditëve që ndodhem këtu, janë shumë të mira. Sa herë që na bie puna për të vizituar rrethin tuaj vërejmë ndryshime të mëdha, si në qytet ashtu edhe në fshat.

Te populli i mrekullueshëm i Elbasanit, te të gjithë punonjësit, shihet një aktivitet dhe entuziazëm i madh dhe i papërshkruar. Është fakt se, kudo që shkova, konstatova me kënaqësi se njerëzit janë të shëndetshëm, të gëzuar, punojnë, mësojnë dhe përparojnë vazhdimisht. Kjo duket qartë në qendrat e punës, në kooperativat bujqësore, në shkollat, në institucionet e ndryshme. Këto përparime janë një inkurajim i madh, në të njëjtën kohë janë edhe një barometër i drejtësisë së vijës së Partisë. Ja sepse sytë e punonjësve tanë shkëlqejnë nga gëzimi dhe besimi që kanë te Partia. Partia jonë punon me të gjitha forcat për të ndërtuar

sa më shpejt socializmin. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse socializmi siguron mirëqenien e popullit dhe, njëkohësisht, forcon më tej unitetin e Partisë me popullin, pa të cilin Partia nuk mund ta kryejë misionin e saj historik, ashtu siç e ka kryer me sukses deri tani.

Uniteti Parti-popull është një realitet, i krijuar jo me fjalë, por me luftë, me punë, me sakrifica dhe me zotësinë e njerëzve tanë, të komunistëve në radhë të parë, si edhe të punonjësve. Ne tani mund të themi pa frikë se njerëzit tanë, kuadrot tanë janë kalitur dhe kanë fituar një eksperiencë të pasur.

Le të marrim punën e bërë gjatë këtij viti. Rezultatet që kemi arritur këto kohët e fundit janë më të larta se çdo herë tjetër. Në historinë e Republikës sonë Popullore nuk është parë një mobilizim kaq i gjerë e intensiv në punë sa tani. Janë ngritur në këmbë klasa punëtore, fshatarësia punonjëse, inteligjenca popullore, burra e gra, të rinj e të reja. Ky mobilizim dhe entuziazëm i madh kanë sjellë si rezultat që planet e tremujorit të parë të realizohen e të tejkalohen në të gjithë sektorët e jetës së vendit tonë. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse tregon që jo vetëm vija e Partisë sonë është e drejtë, por edhe anëtarët e Partisë e kanë të qartë se momentet që po kalojmë janë të vështira, se rruga që ecim nuk është e shtruar me lule. Por Partia jonë na ka mësuar e na mëson që të mos thyhemi nga vështirësitë, përkundrazi të luftojmë e t'i kapërcejmë ato. Marksisti nuk ka frikë, ai nuk mund të gëlltitë qorrazi vijën, pikëpamjet dhe mendimet arbitrare që nuk janë në rrugën marksiste-leniniste. Ne, komunistët

shqiptarë, i përulemi vetëm marksizëm-leninizmit dhe popullit tonë. Të tjerëve që nuk ecin drejt, qofshin këta të fortë ose më pak të fortë, të vërtetën ne ua themi në sy. Kështu veproi Partia jonë në Mbledhjen e Moskës të 81 partive komuniste dhe punëtoje, që shtroi me guxim një radhë çështjesh të mëdha parimore, shkelja e të cilave rrezikon kauzën e madhe të socializmit dhe të komunizmit.

N.S. Hrushovi përdor shumë formula duke thënë: «ne jemi marksistë», «jemi të barabartë», «duhet të bëjmë kritikë» etj., po kur vjen puna që të tjerët të flasin haptazi për veprimet e tij të gabuara, kjo atij i djeg. Por një marksist i vërtetë, kur gabon dhe të tjerët e kritikojnë, ai kritikën i mirëpret. Ndryshe, ai që nuk është marksist, jo vetëm s'pranon kritikën, por hakmerret ndaj atyre që e kritikojnë, siç po bën Hrushovi me ne që pas Mbledhjes së Bukureshtit, duke manifestuar kështu pikëpamje të theksuara revizioniste e shoviniste. Por Partia jonë ka bërë detyrën e vet internacionaliste me qëndrimet e drejta marksiste-leniniste që ka mbajtur dhe këto qëndrime heroike të saj do t'i përmendë në shekuj historia. Neve nuk na rritet mendja, por është e drejtë të thuhet se qëndrimi i Partisë sonë është përkrahur nga miliona komunistë në të gjithë botën dhe do të vijë koha që edhe zyrtarisht të njihet sa të drejta ishin qëndrimet e Partisë sonë, përballë situatave shumë të rënda të krijuara nga N. Hrushovi dhe grupi që e pason.

Ju e dini se udhëheqja e Partisë sonë nuk ka mbajtur asgjë të fshehur nga anëtarët e Partisë. Qëndrimet armiqësore të udhëheqjes së PK të BS me Hrushovin



në krye ndaj Partisë sonë filluan qysh pas Mbledhjes së Bukureshtit, kur Partia jonë i tha ndal veprimtarisë antimarksiste të N. S. Hrushovit kundër PK të Kinës, nuk u pajtua me Hrushovin dhe grupin e tij për të dënuar padrejtësisht PK të Kinës.

Më kot përqipen të flasin kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe kundër Partisë së Punës të Shqipërisë Hrushovi me grupin e tij. Ne jemi në rrugë të drejtë, dhe pse jemi pikërisht në një rrugë të tillë nuk jemi të vetmit kundër kësaj rryme revizioniste shumë të rrezikshme. Me ne janë edhe parti të tjera komuniste e punëtore dhe shumë komunistë të vetë partive revizioniste, si në Bashkimin Sovjetik etj.

Udhëheqjet e disa partive mendojnë shtrembër dhe ecin në rrugë të rrezikshme revizioniste. Ato u përpoqën të na quajnë luftënxitës, gjë që s'është aspak e vërtetë. Partia jonë nuk ka qenë, nuk është dhe kurrë nuk do të jetë për luftën. Por ne, në asnjë mënyrë, nuk mund të ushqejmë iluzionin se luftë nuk do të ketë dhe të ngopemi me fjalë për çarmatimin. Neve nuk na lejohet të mos jemi vigjilentë në këtë çështje dhe të na hipin armiqtë mbi shpinë e të na likuidojnë. Këtë as e kemi lejuar dhe as do ta lejojmë. Për këtë qëndrim ata na akuzojnë si luftënxitës!

Imperializmi vazhdon të armatoset, ai kërkon për këtë qëllim të fitojë kohë pastaj të shpërthejë luftën. Prandaj duhet t'i demaskojmë veprimet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të vendeve të tjera kapitaliste, të mos kemi besim te ata, se janë të pabesë, të mos na shkojë kurrë në mendje se ata u bënë paqësorë, ose, siç pretendon Hrushovi, do të vijnë aty ku duam

ne! Kështu krijohen iluzione në popujt e botës se «Kenedi ndryshe nga Ajzenhaueri, është për paqen», siç shkruan shtypi sovjetik. Ministria e Jashtme e Bashkimit Sovjetik thotë se në Shtëpinë e Bardhë kanë ardhur udhëheqës të rinj, të arsyeshëm, paqedashës etj. Kurse Partia jonë është e mendimit se në qeverinë e re amerikane kanë ardhur vërtet njerëz të rinj, por koha po vërteton se këta janë gjithashtu luftënxitës, që shtojnë buxhetin ushtarak amerikan, që kërcënojnë popujt, që vringëllojnë armët. Le të deklarojë sa të dojë Kenedi se është për paqen, se do t'u japë «lirinë popujve të robëruar» (në fakt e ka fjalën për popujt e vendeve socialiste), kurse në të vërtetë ai po shton llojet e armëve, kërcënon me luftë Laosin, Republikën Demokratike të Vietnamit etj. Kjo vërteton edhe një herë se sa të drejtë ka Partia jonë kur thotë se natyra e imperializmit nuk ka ndryshuar, se imperializmi nuk bëhet paqedashës, duke ndërruar krerët e tij, por vetëm duke e përmbysur atë nga themelet me anë të revolucionit proletar.

Ne jemi për të ndërmarrë aksione të vërteta me rëndësi të madhe ndërkombëtare për frenimin e imperialistëve. Mirëpo asgjë nuk po bëhet në këtë drejtim. Paqja nuk mbrohet me fjalë. Edhe propagandë duhet bërë në favor të paqes, por kjo nuk është e mjaftueshme. Ajo duhet të shoqërohet edhe me qëndrime e veprime konkrete revolucionare. Historia ka shembuj që tregojnë se paqja nuk dhurohet, por fitohet me vepra. Ne nuk jemi për luftë, por kur imperialistët dhe reaksionarët na bien në qafë, jemi të detyruar të luftojmë për të mbrojtur atdheun tonë dhe paqen në botë.

Në këtë mënyrë kanë vepruar mjaft popuj duke i sjellë një shërbim të madh paqes.

Kështu veproi populli kuban, i cili me luftën e tij kundër SHBA-së mbrojti lirinë e vet. Në këtë mënyrë u vërtetua edhe teza e drejtë e Leninit të madh, që mbron me konsekuencë Partia jonë, se pushteti i klasës punëtore nuk merret në asnjë mënyrë pa dhunë. Ky pushtet në disa kushte të caktuara mund të merret edhe në rrugë paqësore, por kjo është një mundësi e rrallë. Fakti është se deri tani një gjë e tillë nuk ka ndodhur në histori; borgjezisë duhet t'ia rrëmbesh me violencë pushtetin, ajo kurrë nuk e lëshon këtë vullnetarisht, bile borgjezia, edhe kur pushtetin e ka fituar proletariati, lufton t'ia rrëmbejë këtij me forcë e jo më t'i lejojë, për shembull, komunistët francezë ose italianë ta marrin pushtetin, siç pretendojnë revizionistët, me rrugë paqësore. Jeta provon të kundërtën. Borgjezia reaksionare franceze, edhe Dë Golit, që është përfaqësuesi i borgjezisë së madhe franceze, deshi t'ia merrte pushtetin nga duart kohët e fundit, e jo më të lejojë Partinë Komuniste të Francës të marrë pushtetin me rrugën parlamentare.

Për këto çështje ne folëm edhe në Mbledhjen e Moskës, prandaj kundër pikëpamjeve tona të drejta hodhi gurë edhe udhëheqja e PK të Francës, jo aq fort sa Hrushovi dhe Gomulka, por, s'mbeti pas edhe ajo. Kur reaksionarët deshën të vendosin fashizmin në Francë para dy javësh, KQ i Partisë sonë i dërgoi një telegram përsëritës KQ të PK të Francës për orientimin që dha për t'u ngritur në luftë kundër reaksionit.

Kur ishim në Mbledhjen e Moskës më takoi Zha-

netë Vermeshi e më tha se nuk e kuptonte situatën e krijuar. Unë iu përgjigja se qëndrimin tonë ua shpjeguam me orë të tëra kur ishte ajo me M. Torezin në Shqipëri, prandaj, nëse nuk e kuptoni sot, do ta kuptoni nesër. Me këtë dua të them se jeta vërteton vijën e drejtë ideologjike të Partisë sonë.

Mjaft shokë të ndershëm e të thjeshtë sovjetikë na janë shprehur me nderimet për marrëdhëniet e ngushta, vëllazërore dhe në rrugë të drejtë që ka pasur PPSH me PK të BS. Si vëllezër, si shokë dhe bile më mirë se shokë kemi shkuar me ta. Po udhëheqja e sotme sovjetike e shkeli këtë miqësi.

Kur shkuam në nëntor në Moskë, në shtëpinë që ishte caktuar për ne, kishin vënë aparate përgjimi. Kjo na detyroi të largoheshim nga ajo shtëpi dhe të shkonim për të banuar në ambasadën tonë. Por u zbulua se edhe atje ishin vendosur prej kohësh aparate përgjimi. Kështu veprohet me armiqtë e jo me miqtë! Siç shihet, udhëheqja aktuale sovjetike po kryen veprime të poshttra ndaj nesh. Ne u thamë hapur udhëheqësve sovjetikë se si është e mundur që të vendosni aparate përgjimi në ambasadën e një vendi mik. Ky është një turp i madh. Përveç këtyre, udhëheqësit sovjetikë kanë organizuar sabotazhe dhe komplete kundër Partisë sonë, për të na krijuar vështirësi dhe për të rrëzuar udhëheqjen e Partisë dhe të shtetit tonë. Të tilla veprime ne nuk mund t'i pranojmë në asnjë mënyrë nga kushdo që të organizohen.

*Pastaj, shoku Enver Hoxha, pasi përmendi një sërë faktesh të punës armiqësore që ka zhvilluar ambasada sovjetike në Tiranë kundër vendit tonë, vazhdoi:*

Ne i pyesim udhëheqësit sovjetikë dhe ata duhet të na shpjegojnë përse i ka bërë këto «gabime» ambasadori sovjetik në Shqipëri, po kështu mareshali Greçko, ministri i Mbrojtjes Malinovski etj., dhe u theksojmë se këto nuk janë gabime të disa njerëzve, por rezultat i qëndrimeve armiqësore të udhëheqjes sovjetike ndaj udhëheqjes sonë, këtu reflektohet një vijë e caktuar antimarksiste. Për qëndrimet tona kritike ndaj vijës së tyre, natyrisht, udhëheqjes sovjetike nuk i ka ardhur mirë. Po kjo nuk na prish punë. Rëndësi ka që ne jemi në rrugë të drejtë.

Gabimet e udhëheqjes sovjetike ndaj Shqipërisë janë të rënda. Të marrim edhe një fakt. Udhëheqësit sovjetikë na premtuan se do të na ndihmonin për ndërtime të Pallatit të madh të Kulturës. Po ka tre muaj që punëtorët rrinë kot pa punë për mungesë të projektit. Ne ua kemi kërkuar projektin me dy letra që u dërguam njëra pas tjetrës, por nuk na janë përgjigjur. Jo vetëm kaq, po Hrushovi tërhoqi edhe specialistët që ishin dërguar për këtë punë, me qëllim që kjo ndërtesë që është në ngritje, të mbetet e pandërtuar, të dukej si një gërmadhë në mes të qytetit dhe populli të mendojë se fajin e ka udhëheqja jonë. Por ne u vumë detyrën njerëzve tanë, që me forcat e veta të përgatitin projektin dhe ta ndërtojmë akoma më të mirë Pallatin e madh të Kulturës. Kështu, këto ditë do të rifillojë puna me forca të shumëfishuara. Njerëzit tanë do të revoltohen kur të mësojnë historinë e kësaj vepre dhe do të thonë se turpi bie mbi Hrushovin.

Gjendja e krijuar tani në BS, me ardhjen e N. Hrushovit në krye të partisë dhe të shtetit sovjetik, është

një fatkeqësi e madhe për Bashkimin Sovjetik, për kampin e socializmit dhe për komunizmin ndërkom-bëtar. Neve na vjen shumë keq që në BS merren masa të padrejta, sidomos kundër kuadrove të vjetër. Hrushovi shkarkon nga detyra shumë kuadro, duke i akuzuar për falsifikime. Po a është e mundur që të gjithë këta të kenë falsifikuar shifrat? Kjo është e pabesueshme dhe tregon se të gjithë këta kuadro nuk janë dakord me vijën e Hrushovit, sepse dështoi puna e tij në bujqësi, për të cilën ai e hiqte veten si specialisti më i madh. Tani fajin për këtë dështim kërkon t'ua hedhë të tjerëve. Gabime sekretarët e komiteteve të partisë mund të bëjnë kudo, por ata duhet të thërriten në udhëheqje të kritikohen e të ndihmohen. Shkarkimet e shumë kuadrove nuk janë masa të marra thjesht për gabime të bëra në bujqësi. Ato janë marrë për qëllime të caktuara politike, «ik ti se do të vijë ky tjetri». Ç'fatkeqësi!

Çfarë demokracie dhe çfarë kritike mund të zhvillohet në parti kur Hrushovi bën plenumë të KQ ku marrin pjesë deri në 5 000 veta dhe aty fol po të duash. Aty flet vetëm Hrushovi, i cili herë godet një kuadër e herë një tjetër. Ky është qëndrim antimarksist ndaj kuadrove të vjetër bolshevikë. Ai me paramendim i njofton kuadrot se «kush nuk realizon planin, më mirë të japë dorëheqjen qysh tani»!

Ne nuk mund të jemi dakord me udhëheqësit bullgarë që thonë se edhe gabime të bëjnë udhëheqësit sovjetikë ne duhet të jemi kurdoherë me ta. Ky nuk është qëndrim marksist. Ne duhet t'u themi udhëheqësve sovjetikë, kur gabojnë, shokë këtu e keni gabim.

Tjetër është dashuria dhe respekti për Bashkimin Sovjetik dhe tjetër është kritika ndaj atyre që gabojnë. Gabime mund të bëjnë si partitë e vogla ashtu dhe partitë e mëdha, të cilat nuk janë të garantuara nga gabimet dhe deviacionet. Partia Komuniste e BS ka qenë dhe është një parti e madhe, nga e cila ne kemi mësuar. Por eksperiencia historike tregon se edhe në Partinë Komuniste të BS ka pasur fraksionistë të çdo kallëpi, si trockistë, revizionistë e të tjerë, kundër të cilëve Lenini dhe Stalini kanë luftuar pa mëshirë. Kështu këto sëmundje të rrezikshme duhet të luftohen atje edhe tani.

Partia jonë ka mbajtur qëndrim të drejtë e parimor ndaj çështjes e veprës së Stalinit. Ajo ka thënë se Stalini është një nga klasikët e marksizëm-leninizmit, një nga udhëheqësit më të lavdishëm të lëvizjes komuniste ndërkombëtare pas Leninit. Këtë pikëpamje të drejtë të Partisë sonë për çështjen e Stalinit udhëheqësit e sotëm sovjetikë e kanë pikë të dobët, sepse, siç dihet, Stalini ishte armik i tmerrshëm i revizionizmit. Puna është se me ç'sy e sheh personin dhe veprën e Stalinit, me syrin e marksistit apo me syrin e revizionistit.

Mund t'ju tregoj për një ngjarje që ka ndodhur kohët e fundit në Bullgari, ku kishin shkuar në një konferencë shtypi korrespondentët e agjencive të lajmeve të vendeve socialiste. Ata i çuan për të vizituar një kooperativë bujqësore. Atje u pritën nga kryetari i kësaj kooperative dhe sekretari i organizatës-bazë të partisë. Në pritje ishin dhe disa kooperativistë, midis të cilëve edhe një komunist veteran. Ky iu drejtua korrespondentit sovjetik dhe i thotë: «Ç'bëni ju, sovje-

tikët, pse e shani Stalinin, ai është çlirimtari ynë, me emrin e tij ne kemi luftuar, nën udhëheqjen e tij Bashkimi Sovjetik na ka çliruar? Ç'i bëtë Molotovin dhe shokët e tjerë të ngushtë të Stalinin? Ku po shkoni me këtë rrugë që keni nisur?». Korrespondenti sovjetik iu përgjigj: «Këto janë punët tona të brendshme dhe na përkasin vetëm neve». «Jo, iu përgjigj komunisti veteran, ato na përkasin të gjithëve, se Stalini s'ka qenë vetëm i Bashkimit Sovjetik». «Pusho, xhaxho, i thanë shokët bullgarë, sepse këtu ndodhet edhe një korrespondent jugosllav dhe na dëgjon». «Ama edhe ai qenka midis nesh, iu përgjigj veterani, atëherë e keqja na qenka futur brenda». Problemi që ngre Partia jonë, se Stalini nuk mund të dënohej pa u konsultuar edhe me partitë e tjera, është plotësisht i drejtë.

Hrushovi e Gomulka me shokë, në mbledhjen e fundit të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, që u mbajt në Moskë më 28-29 mars të këtij viti, patën paturpësinë të deklaronin se nuk është i vërtetë lajmi i dhënë nga ATSH-ja mbi komplotin e kurdisur nga ana e revizionistëve jugosllavë, e monarko-fashistëve grekë dhe e Flotës VI Amerikane<sup>1</sup> kundër RPSH, prandaj propozuan të krijohej një komision për të verifikuar saktësinë e këtij lajmi. Kjo është poshtërsia më e madhe, sepse nuk besohet një vend socialist, që tregon me fakte se ç'kërkonin të bënë spiunët e imperialistët kundër tij. Të vërtetën ata do ta mësojnë shpejt nga gjyqi që do të zhvillohet në Tiranë.

Pas kësaj patën paturpësinë të thoshin se nuk

---

<sup>1</sup> Shih Enver Hoxha. Vepra, vëll. 20, f. 115.



është e vërtetë që Shqipëria është sulmuar. Ne i pyetëm se kush ju tha se Shqipëria është sulmuar. Kjo është vetëm një shpifje! Në raportin mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror mbajtur në Kongresin IV të Partisë thuhet se u zbulua një komplot që përgatitej për të sulmuar Shqipërinë. Atëherë përse të besojmë udhëheqjen aktuale sovjetike, me Hrushovin në krye, përsa thotë për Stalinin?

Dihet se udhëheqësit sovjetikë u diskredituan me ato që bënë kundër RP të Kinës, duke hequr specialistët sovjetikë. Këtë janë duke e bërë edhe me ne. Ata përdorin lloj-lloj dredhish, një nga të cilat është kërkesa e tyre për të rritur pagën e specialistëve sovjetikë. Kur Bashkimi Sovjetik do të na dërgonte specialistë gjatë zbatimit të planit tonë të parë pesëvjeçar, Stalini na tha që ata të mos paguhen më shumë se specialistët shqiptarë të së njëjtës kategori. Kështu në këtë frymë të lartë internacionaliste vazhdoi ky trajtim derisa ishte Stalini. Ndërsa pas vdekjes së tij udhëheqja sovjetike kërkoi që çdo specialisti t'i shtohet rroga deri në 250 mijë lekë në muaj!

Do të vijë koha që këta njerëz të japin llogari për një veprimtari të tillë armiqësore kundër vendit tonë, sepse asgjë nuk mund t'i kalojë marksizëm-leninizmit. Ata kanë arritur deri aty sa kanë tërhequr specialistët për tërë natën, shumë prej të cilëve janë larguar me keqardhje nga vendi ynë, sepse janë njerëz të ndershëm. Të gjitha këto veprime, pra, tregojnë se udhëheqja sovjetike është në rrugë revizioniste.

Veprimtaria e revizionistëve jugosllavë, për të na përçarë e për të dëmtuar socializmin, është e qartë.

Kurse udhëheqësit sovjetikë bërtasin dhe hedhin parullën e afrimit me jugosllavët. Por revizionistët jugosllavë edhe Nehruit i kanë folur keq për ne, saqë ky, kur është takuar me ambasadorin tonë, i ka thënë të mos jemi të rrëmbyer me jugosllavët. Me politikën dhe me taktikën e tyre ndaj revizionistëve jugosllavë udhëheqësit sovjetikë duan të na futin ujkun në vathë. Por këtë nuk mund të na e hedhin dot.

Tani gazetatat sovjetike dhe bullgare nuk po flasin fare kundër revizionistëve jugosllavë. Puna ka arritur deri atje sa zëdhënësi kryesor i gazetës «Pravda» është bërë TANJUG-u. Pas disa ditësh Popoviçi, ministri i Jashtëm jugosllav, do të shkojë në Moskë dhe pas këtij, sigurisht, i vjen radha Titos me shokë të bëjnë vizitën gjoja për rregullimin e marrëdhënieve shtetërore.

Udhëheqja sovjetike duhet t'i rishikojë këto gabime, dhe këtë nuk e thotë vetëm Partia jonë, por e thonë edhe mjaft parti të tjera, bile edhe komunistë në vende socialiste të Evropës, si në Bullgari, në Çekoslovaki etj. Udhëheqja e partive në këto vende na ka sharë, po anëtarë të thjeshtë të partive të tyre nuk e aprovojnë qëndrimin që mbahet ndaj Partisë sonë, dhe jo vetëm kaq, po mjaft nga ata e manifestojnë haptazi simpatinë që ushqejnë për vijën e drejtë të Partisë sonë.

Në Bashkimin Sovjetik e në vendet socialiste të Evropës puna tani ka arritur deri atje sa të mos lejojnë as shpërndarjen e raporteve të Kongresit IV të Partisë sonë. «Nuk është nevoja ta bëni ju këtë gjë, i thanë ambasadorit tonë në Moskë, raportet që doni t'i shpërndani ju, dërgojani zyrtarisht ministrisë së jashtë-

me dhe dimë ne se kujt t'ia japim!»! Me një fjalë t'i djegin.

Është e qartë se revizionistët përpiqen të na krijojnë pengesa në rrugën tonë. Ata kanë shpresa që ne të falimentojmë ekonomikisht, që të krijohet pakënaqësi në popull ndaj Partisë, që, sipas tyre, Partia të thotë: «Fajin e ka udhëheqja që u prish me Bashkimin Sovjetik, prandaj ta rrëzoni këtë udhëheqje», pra në fuqi të vijnë revizionistët. Është e qartë se ata nuk do t'i lidhin duart këtej e tutje, përkundrazi do të veprojnë kundër nesh, por edhe ne do t'u përgjigjemi siç e meritojnë.

Tani dëshiroj të ndalem në disa probleme të tjera.

Partia jonë, me kujdesin që tregoi qysh pas Çlirimit e deri tani, i ka përgatitur kuadrot e vet, të cilët kanë marrë në dorë punën, zotërojnë teknikën e prodhimit, duke zëvendësuar kështu me sukses specialistët sovjetikë që i tërhoqi N. Hrushovi në mënyrë arbitrare.

Sot isha për vizitë në Cërrik. Është për t'u lavdëruar puna që kanë bërë punëtorët dhe mjeshtrat teknikë të mesëm duke ngritur një oxhak metalik të lartë 40 metra brenda një kohe rekord, për disa orë. Specialistët sovjetikë që në atë kohë ishin aty, i ndaluan punëtorët tanë të merreshin me këtë punë pa ardhur 8 specialistë nga Bashkimi Sovjetik, sepse nuk kishin besim që njerëzit tanë do ta bënë këtë vepër kaq të rëndësishme dhe shumë të vështirë. Prandaj punëtorët e Cërrikut kanë të drejtë të krenohen me punën kolosale dhe heroike që kanë bërë.

Me njerëzit tanë janë zëvendësuar edhe specialistët

sovjetikë që punojnë në ekipet gjeologjike e kudo gjetkë dhe punën janë duke e kryer shumë mirë. Por ne, kur të na duhen, dhe me siguri do të na duhen specialistë të huaj, kemi besim se do t'i gjejmë dhe Hrushovi me shokë të jenë të qetë se nuk do t'u zgjatim dorën imperialistëve. Ne kemi Kinën e madhe që do të na ndihmojë edhe me specialistë. Shokët kinezë na thanë që specialistëve të tyre ne t'u sigurojmë vetëm ngrënien e fjetjen dhe asnjë lek më shumë, dhe kjo të mos e kalonte në asnjë mënyrë rrogën e një specialisti shqiptar. Më pak le të kushtojë, po më shumë jo. Ky është një qëndrim vërtet marksist, vëllazëror, internacionalist. Të kemi parasysh edhe faktin se RP e Kinës ka për vete nevoja dhe vështirësi të mëdha, sidomos këta dy vjetët e fundit, të shkaktuara nga fatkeqësitë e natyrës. Dhe megjithëkëtë qeveria dhe PK e Kinës na i plotësuan të gjitha nevojat e planit të tretë pesëvjeçar, si dhe nevojat e tjera për bukë dhe për ushqime. Kjo është një ndihmë bujare dhe me frymë thellësisht internacionaliste në një kohë kur Kina ka nevojë për vete të sigurojë miliona tonë drithë në vit. Republika Popullore e Kinës na akordoi aq kredi sa duhet për të ngritur të gjitha objektet e pesëvjeçarit të tretë që shtetet socialiste të Evropës na i kanë pezulluar. RP e Kinës do të na ndihmojë për të ndërtuar 25 ndërmarrje të mëdha që do të ngrihen përpara afateve të parashikuara në planin pesëvjeçar.

Pra, plani i tretë pesëvjeçar nga pikëpamja e kredive është i siguruar. Tani çdo gjë varet nga forcat tona. Ne do t'i ndërtojmë patjetër të gjitha objektet, sepse populli dhe Partia jonë kanë forca. Një entuzia-

zëm i madh ka shpërthyer kudo, ka mobilizim dhe vrull në punë. Prandaj objektet e parashikuara që kanë një rëndësi të madhe ekonomike, ne patjetër do t'i realizojmë dhe forcat prodhuese në vendin tonë do të zhvillohen më shumë.

Rëndësi, si edhe më parë, do t'i kushtohet zhvillimit të industrisë së rëndë, e cila edhe në këtë pesëvjeçar do të bëjë hapa të mëdhenj përpara. Neve na çelen perspektiva të mrekullueshme me zbulimin e mineraleve shumë të vlefshme e të kushtueshme. Për këtë kemi të dhëna. Komiteti Qendror ka udhëzuar që brenda dy vjetëve të ardhshëm të përcaktohen rezervat dhe të paraqitet plani i zhvillimit të mëtejshëm të industrisë sonë minerare, duke përpunuar lëndën e parë në vend. Ne tani do të krijojmë laboratorët tanë, të cilët do të na japin mundësi që analizën e mineraleve ta bëjmë në vend.

Për realizimin e pesëvjeçarit të tretë të jemi të ndërgjegjshëm se do të kërkohet një kujdes më i madh i punonjësve për të bërë kursime, për shfrytëzimin e rezervave të brendshme etj. Deri dje sikur ishin në gjumë këto rezerva të mëdha, kurse tani secili vret mendjen të kursejë, të bëjë diçka më tej detyrës që i takon. Nga të dhënat që kemi nga ekipet e dërguara për problemin e kursimeve, shifrat arrijnë mbi dy miliard lekë. Preokupacioni i punonjësve vazhdon të jetë në këtë drejtim dhe do të ketë akoma kursime. Të tërë përpiqen të bëjnë racionalizime, të shkurtojnë materialet e importit etj. Prandaj të ecin të gjithë në këtë rrugë.

Edhe në bujqësi, përpjekjet që janë bërë deri tani

mund të themi kanë dhënë rezultate shumë të kënaqshme. Sidomos në këta dy-tre vjetët e fundit puna në bujqësi ka marrë hov të madh. Ju e shihni vetë se kudo janë hapur toka të reja e janë punuar kodra, po shtohen kudo sipërfaqe nën kulturë, po mbillen pemë e vreshta. Sivjet edhe koha e mirë ka favorizuar për prodhime të bollshme, por mbi të gjitha puna dhe mobilizimi i fshatarësisë janë faktorë bazë që do të krijojnë mundësitë që planet të realizohen edhe në bujqësi.

Mjetet për ujitjen dhe mekanizimin e bujqësisë, të parashikuara në pesëvjeçar, janë siguruar. Traktorët që nevojiten do të na vijnë nga Kina. Edhe ujitjen do ta realizojmë sipas parashikimit deri në 42 për qind të sipërfaqeve të mbjella. Gjatë kësaj kohe ne do të sistemojmë fushat, dhe nga viti i fundit i pesëvjeçarit, më 1965, do të kemi ngritur uzinat e plehrave kimike, që do të jenë një burim i madh begatie për bujqësinë tonë. Atëherë mund të themi me plot gojën se ajo do të dalë një herë e përgjithmonë nga prapambetja. Kjo është shumë inkurajuese.

Një hov i madh në punë dhe optimizëm në plotësimin e detyrave vërehet në të gjithë punonjësit. Por këto nuk duhet të na dehin. Duhet të jemi kurdoherë realistë, të mos kënaqemi me ato që kemi arritur, po, duke u mbështetur në to, të luftojmë për suksese të reja, sepse nevojat tona janë të mëdha, edhe vështirësitë i kemi të mëdha por të kapërcyeshme. Ne duhet të bëjmë akoma më shumë që të plotësojmë nevojat e popullit, të ngremë standardin e jetesës së tij dhe jemi të bindur se me masat e shumanshme që po merr Par-

tia, ai do të ngrihet. Ne do t'i realizojmë patjetër planet, bile kemi shpresë që t'i tejkalojmë ato, në të gjithë sektorët, për lumturinë e popullit dhe të atdheut tonë socialist.

Partia duhet të jetë në ballë të luftës për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse të atdheut në këto situata të vështira që po kalon vendi ynë në rrethimin e dyfishtë imperialisto-revizionist. Komunistët tanë duhet të shohin kudo interesat e mëdha të atdheut dhe të popullit, prandaj edhe ndonjë mosmarrëveshje të vogël që ata mund të kenë midis tyre ta zgjidhin sa më shpejt e drejt në rrugën marksiste-leniniste, në mënyrë që çdo organizatë-bazë partie të jetë si një trup i vetëm, të kërkojë llogari deri më një nga çdo komunist e njëkohësisht të drejtojë mirë punën në atë sektor ku ajo vepron.

Rëndësi vendimtare kanë forcimi i unitetit të Partisë dhe rritja e vigjilencës revolucionare. Armiqtë do të përpiqen me të gjitha mënyrat ta dobësojnë unitetin tonë, po ata kurrë nuk do të kenë sukses. Megjithëkëtë ne nuk duhet të dehemë nga sukseset, por ta shikojmë çdo gjë me syrin kritik marksist-leninist. Të jemi të dashur me popullin dhe me shokët. Kundër atij që gabon ose bën keq, kushdo qoftë ai, të mos hezitojmë ta kritikojmë, të përpiqemi ta sjellim në rrugë të drejtë, duke përdorur të gjitha format, me takt, me durim e me drejtësinë e Partisë dhe të jemi të sigurt se për çdo njeri të ndrequr nga gabimet kemi fituar një betejë në luftën kundër armiqve të klasës.

Vija e Partisë ka mobilizuar rreth vetes, jo vetëm

masat e popullit, por edhe nga ata që më parë na shikonin me sy të shtrembër. Situatat e krijuara kanë afruar edhe njerëz që nuk janë dakord me ne, por, kur shohin konkretisht ato që ka bërë e bën Partia për të drejtat e popullit, për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë, janë të detyruar të thonë të vërtetën. Çështja është që, me vijën e drejtë të Partisë, të mendojmë që çdo ditë të bëjmë punë për të kalitur patriotizmin popullor te njerëzit, për t'i hedhur në aksione për realizimin e detyrave të planit. Kjo është një detyrë aktuale për çdo anëtar partie.

Në organizatën tuaj, sikurse në çdo organizatë tjetër, ka anë të mira, po ka edhe dobësi e të meta, të cilat do të eliminohen me luftë dhe me përpjekje. Por mendimi i Komitetit Qendror është se organizata juaj është rritur, është forcuar e është kalitur dhe këtë e tregojnë rezultatet. Rrethi juaj ka bërë hapa përpara edhe në bujqësi. Kur nuk kishte përfunduar kolektivizimi, kishit vështirësi se gjenit rezistencë në fshatarësinë, por tani që kolektivizimi ka mbaruar, bujqësia në rrethin tuaj ka shkuar përpara, është zbukuruar vendi.

Sot vizitova vreshtat në jug të qytetit. Atje kemi njerëz xhevahirë, që kanë bërë një punë të mirë. Edhe në kooperativat bujqësore vura re se bëhen shumë përpjekje që planet të realizohen. Kjo tregon se organizata juaj e Partisë është në krye të detyrave. Prandaj është detyra jonë ta forcojmë akoma më shumë këtë organizatë, me luftë, me punë dhe me dituri. Ju të gjithë që jeni këtu jeni shokë me stazh në Parti dhe në punë, po duhet akoma më me kurajë të mësoni më shumë dhe të lidhni praktikën tuaj të madhe me



teorinë që keni mësuar në shkolla të mesme ose të larta, në shkolla e në kurse partie.

Ne jemi të bindur se ecim në rrugë të drejtë dhe drejtësia do të fitojë. Vështirësitë, shokë, do t'i kapërcejmë. Marksizëm-leninizmi do të fitojë.

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## KUADËR I MIRË ESIËTË AI QË DËGJON ZERIN E MASËS

*Nga biseda me kuadrot e kooperativës bujqësore  
të bashkuar të Zervaskës në rrethin e Pogradecit*

**6 maj 1961**

Ju faleminderit shumë për informacionin që më dhatë. Nga sa dëgjova duket se kooperativa juaj po ecën përpara dhe ka perspektiva zhvillimi shumë të mira, prandaj më lejoni të përgëzoj nga zemra gjithë kooperativistët dhe drejtuesit e kësaj ekonomie për punën e mirë që kanë bërë. Këtu dëgjova edhe për mjaft inisiativa që i sjellin fitime ekonomisë së përbashkët. Kjo është një gjë shumë e mirë. Askush nuk duhet të kënaqet vetëm me zhvillimin e kulturave tradicionale, prandaj punoni të krijoni edhe mundësi të tjera për rritjen e të ardhurave që do t'ju sigurohen nga ngritja e disa sektorëve të rinj, sikurse janë rritja e peshkut, e bletëve, e krimbit të mëndafshit etj.

Sigurisht, rëndësinë më të madhe duhet t'ua kush-toni kulturave të tilla sikurse janë gruri, misri, duhani dhe vreshtat, të cilat i keni vënë në rrugë të mirë, i

kultivoni prej vitesh dhe keni eksperiencë të mirë, prandaj merrni edhe rendimente të kënaqshme. Por mos lini pas dore edhe sektorët e rinj si ato që përmenda më lart, rëndësinë e të cilave e ka theksuar vazhdimisht Partia. Kryesia i ka parasysh këto orientime dhe kam besim se do t'i zbatojë, gjë që do të shtojë të ardhurat e kooperativës dhe do të përmirësojë jetën e anëtarëve.

*Pasi u foli të pranishmëve për përparimet që ka bërë bujqësia e vendit tonë, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Me entuziazmin e madh që kanë krijuar vendimet historike të Kongresit IV të PPSH planet tona edhe në sektorin e bujqësisë do të realizohen si në të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë. Rëndësi në këtë drejtim kanë edhe inisiativat e kooperativistëve, si ajo që keni marrë ju, për hapjen e rezervuarëve për ujitje, sepse ato sjellin fitime të konsiderueshme. Zbatimi i inisiativave kërkon organizim të mirë. Atje ku organizata-bazë e Partisë është e shëndoshë, atje ku komunistët janë në ballë të luftës, atje punët shkojnë mirë. Në radhë të parë organizata e Partisë dhe udhëheqja e kooperativës, që nga kryetari e të tjerët, duhet të jenë njerëz të mirë. Kryetar i mirë është ai që dëgjon dhe zbaton vendimet e asamblesë së kooperativës, sikurse ka theksuar kurdoherë Partia. Kjo do të thotë që kryetari, nën udhëheqjen e organizatës së Partisë, të punojë në mënyrë të atillë që t'u fitojë zemrën kooperativistëve. Atje ku nuk pyetet asambleja, punët nuk shkojnë mirë. Nga sa duket, këtu te ju dëgjohej me respekt zëri i masës, prandaj kooperativa ecën përpara.

Punët në vendin tonë shkojnë shumë mirë, sepse

flamuri i Partisë është i pastër dhe komunistët ecin përpara në rrugën marksiste-leniniste.

Partinë ne e kemi të fortë, sepse ajo ka një vijë të drejtë, sepse organizatat-bazë dhe anëtarët e tyre janë të lidhur ngushtë me masat. Lidhjet e popullit me Partinë kanë rëndësi vendimtare. Komunistët duhet të jenë kurdoherë në mes të popullit. Kur rrënjët janë shtrirë thellë në tokë, bima lulëzon dhe jep fruta. Dhe pikërisht, Partinë e kemi të fortë sepse ajo kurdoherë u ka qëndruar pranë masave, ka dëgjuar zërin e tyre dhe i ka udhëhequr me guxim e mençuri drejt jetës së re e të lumtur.

Qëllimi dhe detyra e Partisë sonë është të ndërtojë socializmin dhe komunizmin në Shqipëri. Por ajo si Parti marksiste-leniniste e ka për detyrë që me punën e me vijën e saj të marrë pjesë e të kontribuojë në triumfin e socializmit dhe të komunizmit në të gjithë botën. Partia jonë është një Parti marksiste. Si e tillë, kur ajo e shikon që shokë të partive të tjera nuk ecin në rrugë të drejtë, nuk druhet t'ua thotë në sy gabimet e t'i kritikojë dhe me këtë ajo zbaton në jetë marksizëm-leninizmin, kryen një detyrë internacionaliste. Marksizëm-leninizmi na mëson se, i madh ose i vogël qofsh, pikëpamjen tënde si komunist duhet ta thuash hapët. Në qoftë se je në rrugë të gabuar dhe të bindin të tjerët për këtë, detyra jote është të bësh autokritikë. Por, në qoftë se ti je në rrugë të drejtë, është detyra e të tjerëve ta pohojnë këtë gjë, ndryshe ata gabojnë rëndë. E drejta nuk mund të fshihet dhe marksizëm-leninizmi nuk mposhtet. Ky është ligj. Marksizëm-leninizmi është si fara e mbjellë, që, pasi ngrohet, me gjithë peshën e

rëndë që ka përsipër, çan tokën dhe del në ajër të lirë e zhvillohet me shpejtësi.

E gjithë historia njëzetvjeçare e Partisë sonë vërteton rrugën e saj të drejtë marksiste-leniniste. Po të mos ishte Partia në rrugë të drejtë, Shqipëria nuk do të ishte çliruar dhe transformuar, njerëzit nuk do të ishin të gëzuar dhe të lumtur.

Çështja e përcaktimit dhe e zbatimit drejt të vijës së Partisë ka rëndësi të madhe, sepse, po të shtrembërosh rrugën marksiste-leniniste, të qepen nga prapa të tëra të këqijat dhe të dalin njëra pas tjetrës, si zinxhir. Shtrembërimet në fillim mund të jenë të vogla, mund të duken si gjëra pa rëndësi, por dalngadalë ato trashen dhe rrezikojnë të gjitha fitoret e popullit. Prandaj Partia dhe populli duhet të jenë vigjilentë, të mos lejojnë që vija të shtrembërohet, po kurdoherë të qëndrojnë e drejtë, në mënyrë që t'u bëjë ballë çdo dallge dhe furtune.

Ne jemi të sigurt se marksizëm-leninizmi do të fitojë. Imperializmi dhe revizionizmi do të dështojnë plotësisht. Komunistët ishin fare të paktë kur i udhëhiqte Karl Marksi, por çështja e tyre ishte e drejtë, pra e pavdekshme. Ata përballuan sulmet e egra dhe terrorin e kapitalistëve dhe s'shkoj shumë kohë kur u krijua nga Lenini i madh Bashkimi Sovjetik dhe më vonë në kohën e Stalinit kampi i madh i socializmit. Tani forcat e komunizmit ndërkombëtar janë kolosale, të pathyeshme, ekzistojnë vende e shtete të fuqishme, kurse forcat e kapitalizmit janë të pakta dhe vazhdimisht vijnë duke u dobësuar. Por ata përdorin çdo gjë kundër nesh për të na goditur, për të na dobësuar dhe për të shpërthyer luftën.

Një nga mjetet efikase që përdor kundër nesh imperializmi, janë tradhtarët e marksizëm-leninizmit, revizionistët modernë, të cilët, si agjentë të imperialistëve, janë shumë të rrezikshëm. Por revizionistët e sotëm, ashtu sikurse ndodhi me ata jugosllavë, për shumë kohë maskohen. Ata, si tradhtarë, synojnë t'i bëjnë varrin popullit të tyre, si dhe të gjithë popujve të tjerë të vendeve socialiste. Prandaj, Partia jonë ka mbajtur, mban dhe do të mbajë kundër revizionistëve një qëndrim të drejtë dhe të papërkulur marksist-leninist dhe sepse ndjek këtë rrugë të drejtë, duke mbajtur qëndrime konsekuente parimore, ajo ka fituar simpatinë e gjithë komunistëve të botës.

Në botë ka parti të mëdha nga numri i anëtarëve dhe më të vjetra nga mosha, por nuk e kanë pjekurinë dhe guximin e Partisë sonë. Udhëheqësit e partive të tilla habiten nga qëndrimet e drejta, të guximshme e të prera që ka mbajtur e mban Partia jonë në vlerësimin e problemeve të ndryshme. Si është e mundur, pyesin ata, që komunistët dhe populli shqiptar, duke qenë të rrethuar nga armiq, t'u bëjnë ballë kompleteve, të qëndrojnë në këmbë dhe të përparojnë, të bëjnë të ecin përpara industria, bujqësia, arsimit, kultura, mirëqenia e popullit, të ndërtojnë socializmin?!

Por këta njerëz nuk kanë pse të habiten. Ne qëndrojmë, jetojmë dhe përparojmë, sepse jemi në rrugë të drejtë, jemi parimorë dhe kur je i drejtë e parimor nuk ke frikë nga askush. Komunizmi kërkon të mos kesh frikë, të jesh trim dhe i guximshëm, të jesh parimor dhe i papërkulur.

E vërteta është se disa udhëheqësve u ka mbetur

qejfi nga qëndrimet e drejta të Partisë sonë dhe në radhë të parë kjo ndodh me Nikita Hrushovin, që kundrejt Shqipërisë bën veprime antimarksiste. Por neve nuk na prishet puna nga këto dhe jemi të sigurt se populli sovjetik është me ne, me ne janë komunistët e vërtetë të Bashkimit Sovjetik.

Po përse Hrushovi është thartuar dhe mban qëndrim antimarksiste ndaj Partisë sonë?

Sepse Partia jonë, në bazë të rregullave leniniste, në vendin dhe në kohën e duhur, kritikoi ashpër pikëpamjet e revizionistëve modernë për një varg problemesh të rëndësishme të lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Partia jonë thotë të demaskohet imperializmi, se ai është i egër e luftënxitës, se ai kërkon t'i bëjë varrin komunizmit. «Ju shqiptarët jeni gjaknxeh të dhe nuk dini të bëni politikë», na thotë Hrushovi. E vërteta është se ne në vlerësimin e gjërave gjithmonë kemi qenë dhe jemi gjakftohtë dhe këto që themi për imperializmin, i themi duke u mbështetur në ideologjinë marksiste-leniniste dhe në eksperiencën tonë, sepse jemi një popull që kemi vuajtur shumë dhe një vend që gjithmonë është kërcënuar nga synimet agresive të imperialistëve. Prandaj ne pikëpamjet e revizionistëve as i kemi pranuar e as do t'i pranojmë kurrë, sepse është krimi më i madh të humbasësh busullën e ta futësh popullin në greminë.

Qëndrimet e Hrushovit ndaj imperializmit janë të paprincipita. Mbledhja e nivelit të lartë që u bë vjet në Paris dështoi. Atëherë qeveria sovjetike mbajti një qëndrim që e aprovaam të gjithë. Mirëpo nuk vonoi shumë dhe Hrushovi filloi përsëri të fërkohej me krerët

e imperializmit, të flasë ndryshe nga sa foli pas dëshimit të mbledhjes së nivelit të lartë. Këto nuk janë qëndrime marksiste, por lëkundje të një politikani shumë të dobët që justifikohet se gjoja këto veprime i bën për hir të paqes. Po edhe ne për paqen punojmë dhe luftojmë, sepse e duam atë.

Kur themi të luftojmë për paqen, kjo nuk do të thotë t'u bëjmë lëshime imperialistëve amerikanë, përkundrazi t'u qëndrojmë ballë për ballë veprimeve të tyre kundër paqes, t'ua vëmë këmbët në një këpucë kur është puna për të mbrojtur interesat e popujve. I duhet vënë fre Amerikës që pengon Kinën e madhe të marrë pjesë në mbledhjet ndërkombëtare, atë Kinë që udhëhiqet nga një Parti e lavdishme marksiste-leniniste, që ka udhëhequr një popull kolos në luftë për shumë vjet me radhë. Shumë ia ka frikën Kinës imperializmi. Prandaj ajo duhet të futet patjetër në OKB se ka një peshë të madhe në botë. Po Hrushovi e injoron këtë, sepse do të bëjë si do vetë, të takohet me kë të dojë. Ne jemi marksistë-leninistë dhe interesat e marksizëm-leninizmit kërkojnë që RP e Kinës të futet në organizatat ndërkombëtare. Duhet ditur se pa pjesëmarrjen e RP të Kinës nuk mund të zgjidhet asnjë problem i rëndësishëm me karakter ndërkombëtar.

Sekretin e armës atomike e kanë edhe Franca e Gjermania Perëndimore, kurse Kinën duan ta mënjanojnë dhe megjithëkëtë nga ana e qeverisë sovjetike nuk po luftohet që ajo të zërë vendin që i përket në arenën ndërkombëtare. Qëndrime të tilla nuk janë aspak të drejta. Megjithatë RP e Kinës nuk mbetet prapa. Ajo ndërton me ritme të shpejta socializmin. Nuk do të jetë



larg koha kur ajo do të zbulojë vetë sekretin e armëve atomike e do të ketë bomba e raketa dhe këto do të jenë një garanci e madhe për ruajtjen e paqes. Sepse, kur t'i ketë këto mjete të fuqishme edhe Kina Popullore, atëherë imperialistëve do t'u dridhen leqet e këmbëve.

Forca e imperializmit amerikan as duhet nënvlef-tësuar, as duhet mbivlerësuar. Dihet se kapitali monopolist amerikan është futur në të gjitha shtetet e Amerikës Latine, sepse në krye të këtyre shteteve sundojnë qeveri borgjeze, të cilat ekonominë e vendeve të tyre e kanë lënë në duart e kapitalit amerikan. Në këto vende po zhvillohet një lëvizje e fuqishme revolucionare. Bile ka edhe kapitalistë vendës që duan të këputin zinxhirët e kapitalit amerikan. Kështu në këto vende po rritet dita-ditës lëvizja nacionalçlirimtare e popujve, po rritet edhe pakënaqësia e kapitalistëve vendës kundër sundimit të monopoleve amerikane. Këtë pakënaqësi po e shfrytëzojnë partitë komuniste për të demaskuar imperializmin amerikan. Kështu SHBA si kudo edhe në kontinentin amerikan e kanë keq punën. Prandaj ata i kanë vënë vetes për detyrë të shtypin revolucionin kuban, por kjo është shumë e vështirë për ta.

*Në fund të bisedës shoku Enver Hoxha, duke vënë theksin në mosmarrëveshjet me udhëheqjen revizioniste të Bashkimit Sovjetik, tha:*

Në rast se revizionistët duan të veprojnë edhe më tej kundër Shqipërisë nuk do të kenë sukses. Partia dhe populli ynë nuk janë vetëm. Ata, po të duan, le t'i shkelin marrëveshjet, Partia ka siguruar dhe ka parashikuar të gjitha masat e nevojshme në lidhje me rea-

lizimin e planit të tretë pesëvjeçar. Për ndërtimin e objekteve kryesore do të na ndihmojnë populli dhe Partia Komuniste e Kinës. Këtu duket edhe ndjenja e lartë internacionaliste e PK të Kinës, e cila na u gjend pranë në këto ditë të vështira që krijoi udhëheqja sovjetike. Ata që nuk ua duan të mirën popullit dhe Partisë sonë dhe parashikojnë që ne të falimentojmë me planin e tretë pesëvjeçar, le të mos shpresojnë asgjë. Populli shqiptar, me Partinë e tij në krye, do ta realizojë planin, do të kapërcejë çdo pengesë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **RRËNJËT E PARTISË SONË JANË NË ZEMRËN E POPULLIT SHQIPTAR**

*Nga fjala në mitingun para popullit të Pogradecit*

**6 maj 1961**

Të dashur shokë, motra, vëllezër, të rinj dhe pionierë të Pogradecit,

Jam shumë i lumtur dhe i gëzuar që gjendem sot këtu midis jush dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në këtë miting të organizuar për të shprehur dashurinë dhe besnikërinë e madhe që ju ushqeni për Partinë heroike të Punës të Shqipërisë!

Entuziazmi dhe gëzimi juaj i madh tregojnë qartë se sa të thella janë rrënjët e Partisë sonë në zemrën e popullit shqiptar, sa e madhe dhe e sigurtë është dashuria e popullit të rrethit të Pogradecit për Partinë tonë legjendare, të krijuar nga klasa punëtore dhe fshatarësia heroike, nga gjithë populli ynë punonjës, në momentet më të vështira nëpër të cilat kalonte atëherë atdheu ynë i shtrenjtë.

Partia e Punës e Shqipërisë nuk lindi nga ndonjë kombinacion i rastit, ajo lindi nga gjiri i popullit tonë

liridashës. Qysh në fillim, në kohët më të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, ajo u mbrujt me gjakun e heronjve tanë që marshuan kurdoherë përpara me flamurin e Partisë, kundër armiqve të shumtë, barbarë e të armatosur deri në dhëmbë.

Partia jonë është Partia e mijëra dëshmorëve të rënë në luftën e lavdishme për lirinë e popullit dhe për pavarësinë e atdheut, e atyre dëshmorëve që ne i përkujtuam dje edhe këtu te ju dhe që do t'i përkujtojmë çdo vit, në shekuj e brez pas brezi me respekt të thellë.

E mbrujtur me gjakun e bijve të saj më të mirë dhe duke pasur në themelin e vet parimet e pavdekshme të marksizëm-leninizmit, Partia jonë diti ta udhëheqë drejt popullin në çdo situatë, të lidhej ngushtë me të dhe të përballonte çdo rrezik.

Motra dhe vëllezër të dashur, populli shqiptar korri fitoren e madhe të Çlirimit të atdheut dhe të vendosjes së pushtetit të tij në situata jashtëzakonisht të rënda, sepse kishte në udhëheqje këtë Parti heroike. Në ato kushte të vështira, duke ndjekur traditat heroike të të parëve tanë, traditat revolucionare të fshatarësisë sonë, frymën heroike të klasës sonë punëtore të vogël nga numri, por të fortë si çeliku, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, u bashkua si kurrë ndonjëherë, rrëmbeu pushkën, doli maleve për liri dhe i dërrmoi të gjithë armiqtë, okupatorë e tradhtarë. Gjaku i dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare u bë flamuri me të cilin marshuam në atë kohë drejt fitores dhe sot po marshojmë me sukses në rrugën e ndërtimit të socializmit e më vonë të komunizmit, për të mirën dhe për lumturinë e popullit tonë që është qëllimi më i lartë i Partisë.

Fitoret e mëdha të Luftës Nacionalçlirimtare sollën edhe fitoret e reja historike të ndërtimit të socializmit. Ne, shokë, fituam në Luftën Nacionalçlirimtare, sepse nuk ishim vetëm, ne kishim përkrah Bashkimin e lavdishëm Sovjetik, Ushtrinë e tij legjendare të Kuqe me J.V. Stalinin në krye, që i ndihmuan popullin tonë dhe të gjithë popujt e tjerë të robëruar për t'u çliruar nga skllavëria fashiste.

Flamuri i Partisë sonë marksiste-leniniste, flamuri i klasës sonë punëtore, flamuri i vegjëlisë, kurrë nuk u përkul dhe kurrë nuk do të përkulet përpara çdo furtune dhe çdo armiku që do të orvatet të cenojë sado pak truallin e shtrenjtë që na lanë stërgjyshët tanë, këtë tokë të mrekullueshme të vaditur me gjak në luftërat shekullore për liri dhe për pavarësi. Kushdo që do të përpiqet ta cenojë këtë truall, me siguri do të gjejë vdekjen.

Një popull i tillë i mrekullueshëm si ky yni, me një Parti të fortë si çeliku dhe besnike deri në fund e marksizëm-leninizmit, nuk ka mortje kurrë dhe kurdoherë e në çdo situatë do të korrë fitore.

Vështirësi të panumërta kaluan populli dhe Partia jonë pas Çlirimit, por ato ne i kapërcyem dhe korrëm gjithë këto fitore të mëdha që gëzojmë sot. Ne realizuam me sukses planet tona ekonomike. Partia, me politikën e saj të drejtë, siguroi mobilizimin e plotë të masave punonjëse dhe bëri t'i ndryshohet faqja atdheut. Ajo, sidomos, krijoi njerëzit e Shqipërisë së re, të cilët i bëri të ndërgjegjshëm dhe patriotë të flaktë për lulëzimin e vendit të vet.

Partia, duke edukuar popullin me një patriotizëm

të lartë, rrënjosi njëkohësisht te ai ndjenjat e internacionalizmit proletar, dashurinë e madhe për Bashkimin Sovjetik, për Partinë e lavdishme të Leninit, për popujt e tjerë vëllezër të vendeve socialiste dhe të gjithë popujt përparimtarë e lirishtashës të botës.

Partia jonë, që nxori popullin shqiptar nga errësira në dritë, e edukoi dhe e udhëhoqi atë me një vendosmëri të tillë që të kryejë me nder në një kohë sa më të shkurtër vepra madhështore. Për ngritjen e këtyre veprave populli ynë, i udhëhequr me zotësi e largpamësi nga Partia, ka pasur edhe ndihmën internacionaliste të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të tjera të demokracisë popullore.

Por ndihma e dhënë nga miqtë, jo vetëm s'ka përbërë dhe s'përbën faktorin kryesor për ndërtimin e socializmit, por ajo nuk mund t'i sjellë shërbimet e duhura popullit, në rast se nuk bie në duar të sigurta dhe kur nuk përdoret si duhet për të mirën e popullit. Me këtë dua të them se të gjitha të mirat që gëzon sot populli ynë dhe që do të gëzojë edhe më shumë në të ardhshmen, u detyrohen kryesisht dhe në radhë të parë punës vetëmohuese dhe talentit të njerëzve të Shqipërisë së re, u detyrohen komunistëve shqiptarë, që, si në kohën e Luftës Nacionalçlirimtare edhe pas saj, qëndruan në ballë të luftës së re, të lavdishme dhe heroike për ndërtimin e socializmit, iu përveshën punës me të gjitha forcat e tyre mendore dhe fizike për të realizuar planet ekonomike për të mirën dhe për lumturinë e popullit shqiptar.

Si shembull mund të marrim rrethin tuaj, i cili, nga mendja dhe nga duart e arta të punëtorëve dhe të

fshatarëve të kësaj krahine, të udhëhequr nga organizata e Partisë e rrethit, është transformuar në një kopësht të bukur. Kudo në qendrat e punës po realizohen detyrat që ka vënë para jush Partia, po lulëzojnë çdo vit e më shumë kodrat nga vreshtat dhe pemët frutore, fushat kudo po gjelbërojnë, po ndërtohen çdo vit qindra e qindra shtëpi të reja.

Kështu si te ju ndodh në të katër anët e vendit tonë. Ju e dini se industria jonë, që më parë pothuajse nuk ekzistonte, tani jo vetëm është zhvilluar shumë, por nga viti në vit ajo po forcohet dhe po ecën përpara. Ju, shokë dhe shoqe, jeni në dijeni të vendimeve historike të Kongresit IV të Partisë dhe të planit të tretë pesëvjeçar që ai aprovoi, plan madhështor që do të jetë një hap i madh përpara në zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë dhe të kulturës së vendit tonë.

Plani i tretë pesëvjeçar do të bëjë që në vendin tonë të ndërtohen hidrocentrale, fabrika, uzina e kombinat me rëndësi të madhe ekonomike. Tani ka ardhur ajo kohë, kur edhe Shqipëria, dikur e varfër, e lënë me shekuj pas dore nga armiqtë e vendit dhe të popullit tonë, të lulëzojë dhe të përparojë në të gjitha drejtimet.

Malet tona që më parë ishin kështjella për mbrojtjen e atdheut e që të tilla janë dhe do të jenë në çdo rast rreziku, tani i japin popullit edhe minerale të çmueshme. Kështu, nga gjiri i tyre ne nxjerrim sot hekur, krom, naftë dhe shumë pasuri të tjera të vlefshme. Duke u bazuar në perspektivat e mira që ka nxjerrja e mineralit të hekurit, në vendin tonë krijohen kushtet edhe për ngritjen e industrisë së metalurgjisë së zezë. Ka ardhur koha që edhe në Shqipëri, klasa

punëtore të nxjerrë metalurgët e saj. Kështu, me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës, gjatë pesëvjeçarit të tretë do të fillojë të ngrihet në vendin tonë e para uzinë për petëzimin e hekurit që do të zgjerohet pastaj edhe më shumë gjatë pesëvjeçarëve të ardhshëm. Do të ngrihen edhe një sërë objektesh të tjera shumë të rëndësishme, sidomos uzinat për prodhimin e plehrave kimike. Fushat tona tani janë sistemuar, janë pastruar nga gjerdhet e nga ferrat dhe po sistemohen e po zbukurohen çdo vit e më shumë. Në saje të rrugës së lavdishme të kolektivizimit, të përcaktuar nga i madhi Lenin, e që në vendin tonë u realizua me sukses të plotë, në saje të bonifikimeve, të kanalizimeve, të mekanizimit dhe të ngritjes së nivelit agroteknik të fshatarësisë kooperativiste, duke përdorur në arat tona edhe plehrat kimike, ne do të prodhojmë shumë më tepër se tani, sepse përdorimi i plehrave kimike në një masë shumë më të madhe se sot do t'i rritë shumë rendimentet e kulturave bujqësore, do të shtojë begatinë në fshatin tonë të ri.

Shokë dhe shoqe, socializmi, bollëku, nuk vijnë vetvetiu. Ne e dimë se fitoret e deritanishme janë siguruar vetëm me luftë dhe me përpjekje. Askush dhe për asnjë çast nuk duhet ta flejë mendjen e të bjerë në vetëkënaqësi, prandaj, nga më i madhi e deri te më i vogli, të mobilizohemi me të gjitha forcat, të punojmë me këtë entuziazëm të madh që ka ngjallur Kongresi IV historik i Partisë sonë, për të realizuar planet që ka vendosur Partia për popullin.

Shumë gjëra të gëzueshme e kuptimplote kanë ndodhur pas Kongresit IV të Partisë. Për të parën herë



të gjitha ndërmarrjet ekonomike të vendit tonë, jo vetëm i kanë realizuar, por edhe i kanë tejkaluar planet e tremujorit të parë. Edhe në sektorin e bujqësisë, fshatarësia jonë kooperativiste i ka realizuar planet. Kjo tregon se populli ynë, trim dhe punëtor, aprovon me të gjitha forcat e tij vijën e Partisë, sepse shikon që ajo është një vijë e drejtë marksiste-leniniste dhe e palëkundshme.

Në këtë mobilizim të madh si asnjëherë populli ynë u tregon të gjithë atyre që nuk ia duan të mirën, që komplotojnë kundër tij, të largojnë duart nga Shqipëria, ndryshe do t'u priten jo vetëm duart, por edhe koka. Prandaj, të dashur shokë, vëllezër dhe motra, të rinj dhe të reja, të gjithë e kemi për detyrë të luftojmë dhe të vëmë të tëra forcat në shërbim të popullit për të konsoliduar dhe për të çelikosur fitoret e arritura, për të realizuar planin e tretë pesëvjeçar, për t'u siguruar masave tona punonjëse më shumë bukë, mish, gjalpë, fruta, veshmbathje, banesa etj.

Ne me siguri do ta realizojmë planin e tretë pesëvjeçar, sepse vendosmëria dhe forca e popullit tonë, të udhëhequr nga Partia, janë të mëdha dhe faktorë vendimtarë. Ne kemi edhe ndihmën e miqve tanë, të vendeve socialiste. Këto forca ne do të dimë t'i kombinojmë si duhet dhe si kurdoherë do të dalim me sukses.

Shokë dhe shoqe,

Gjendja ndërkombëtare po zhvillohet në favorin tonë, në favor të socializmit dhe të paqes. Forcat e socializmit e të paqes çdo ditë e më shumë po shtohen

e po bëhen një fuqi e madhe dhe pengesë e pakapërcyeshme për imperializmin amerikan dhe për shërbëtorët e tij. Vendet socialiste qëndrojnë si shkëmb graniti për të përballuar me sukses çdo plan dhe për të shkatërruar intrigat e imperialistëve dhe në radhë të parë të imperializmit amerikan dhe të revizionistëve modernë, si revizionistët jugosllavë e të tjerë.

Partia dhe Qeveria jonë, shokë dhe shoqe, kanë luftuar, luftojnë dhe do të luftojnë për mbrojtjen e paqes botërore. Populli ynë, nën udhëheqjen e Partisë së tij të Punës, është mobilizuar i tëri për ndërtimin e atdheut dhe për përmirësimin e jetës së tij të lirë dhe të lumtur. Prandaj le të lehin ata që na quajnë gjaknxehëtë. Jo, ne e kemi kokën shumë të ftohtë, kurrë nuk kemi dashur dhe nuk e duam luftën, se kemi vuajtur nga lufta dhe nuk duam kurrë që ajo të shpërthejë. Por paqen, bashkekzistencën paqësore, për të cilat luftojmë, nuk mund t'i kuptojmë që në emër të tyre të lejojmë të bëhen krime në kurriz të popullit shqiptar dhe të Republikës Popullore të Shqipërisë. Këtë nuk e lejon kurrë Partia jonë, e cila ka pasur, ka dhe do të ketë një vijë politike dhe ideologjike të palëkundshme, këtë nuk e lejon kurrë populli ynë. Ne duam të jetojmë në paqe me të gjitha shtetet, pavarësisht nga regjimi që ato kanë, por bashkekzistencë për bashkekzistencë dhe shuarje të vigjilencës së popujve, mbi bazën e të cilave imperialistët, revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë komplotojnë për të robëruar atdheun tonë, ne nuk do t'i pranojmë kurrë. Për një kuptim të tillë të bashkekzistencës ne nuk kemi qenë dhe nuk do të jemi asnjëherë.

*Pastaj shoku Enver Hoxha, pasi foli për kuptimin leninist të bashkekzistencës paqësore, për natyrën agresive të imperializmit, me atë amerikan në krye, për iluzionet që ushqejnë Hrushovi dhe grupi i tij ndaj njerëzve «të rinj» që kanë ardhur në fuqi në SHBA, sikur këta qenkan «paqësorë», «elastikë» në politikë etj., tha:*

Të gjitha këto tregojnë qartë se imperializmi, dhe veçanërisht imperializmi amerikan, është agresiv dhe përgatitet për luftë. Prandaj popujt duhet të jenë vigjilentë dhe paqen t'ua imponojnë imperialistëve jo me fjalë, por me punë, me vepra. Këto thotë Partia jonë. Kjo nuk do të thotë t'u shpallësh luftë imperialistëve, por t'i demaskosh ata në sy të popujve. Është ndryshe t'u fërkosh krahët agresorëve dhe krejt ndryshe t'u tregosh grushtin; po t'i japësh gishtin armikut, ai të rrëmben dorën.

Partia jonë ka ndjekur dhe do të ndjekë me besnikërinë më të madhe mësimet e Leninit dhe të Stalinit edhe përsa i përket luftës që duhet bërë kundër revizionistëve. Mësuesit tanë të mëdhenj, V.I. Lenini dhe J.V. Stalini, na kanë mësuar dhe na kanë edukuar që t'i luftojmë pa mëshirë revizionistët, sepse ata janë armiq të betuar të klasës punëtore dhe agjentë të ndyrë të imperializmit dhe të borgjezisë ndërkombëtare. Mirëpo ka njerëz që, duke i harruar këto mësimet të pavdekshme, na akuzojnë se jemi gjaknxehtë në qëndrimet tona ndaj revizionistëve, sidomos ndaj revizionistëve jugosllavë. Jo, ne nuk jemi gjaknxehtë në luftën kundër revizionizmit, por parimorë. Në këtë drejtim, ne kemi një eksperiencë jashtëzakonisht të madhe, të fituar në luftën tonë të drejtë kundër komplotëve dhe

intrigave që revizionistët jugosllavë kanë bërë dhe vazhdojnë të bëjnë kundër vendeve të kampit të socializmit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare, e veçanërisht kundër Partisë dhe atdheut tonë. Ne i kemi provuar në kurrizin tonë komplotet e revizionistëve jugosllavë. Prandaj një marksist i vërtetë nuk mund të ngopet me përralla duke dëgjuar ata që predikojnë dhe që na këshillojnë të zbutet lufta kundër revizionistëve jugosllavë se «mos u rritet mendja». Një pikëpamje e tillë është e huaj për marksizmin, ajo do të thotë të mos e demaskosh kusarin, do të thotë t'ia lehtësosh atij punën kriminale. Partia jonë nuk ka ecur dhe nuk mund të ecë në këtë rrugë, pavarësisht që disa na akuzojnë se qenkemi dogmatikë. Po të ishim të tillë, populli shqiptar nuk do të kishte një dashuri kaq të madhe dhe kaq të thellë për Partinë e tij heroike, nuk do të ekzistonin ky entuziazëm dhe ky optimizëm realist në masat e gjera të popullit për politikën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, nuk mund të realizoheshin të tilla suksese kolosale si ato që ka arritur populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë gjatë këtyre 16-17 vjet çlirim.

Partia jonë thotë atë që ka provuar dhe e provon çdo ditë jeta, se revizionistët jugosllavë janë armiq të tërbuar të marksizëm-leninizmit, dhe armiq të tillë të rrezikshëm janë edhe të gjithë ata revizionistë që e kanë akoma maskën në fytyrë, por që me punën e tyre janë vënë në shërbim të imperializmit dhe të borgjezisë. Dihet nga të gjithë se deri tani Jugosllavia titiste ka marrë rreth 3 miliard dollarë nga SHBA-ja, për të ndër-tuar «socializmin specifik». Por çdo njeri e kupton se imperializmi nuk mund të japë kurrë të holla për for-

cimin e pozitive të klasës punëtore, për ndërtimin e socializmit. Pohime të tilla janë vetëm gënjeshtër. Këtë nuk e themi vetëm ne, po të gjithë marksistë-leninistët e botës, me përjashtim të disa grupeve që kanë humbur vigjilencën ndaj revizionistëve.

Marksizmi, qysh nga lindja e tij dhe deri sot që është bërë një forcë kolosale dhe e pamposhtur, ka kaluar vështirësi dhe pengesa të panumërta. Në situata shumë të vështira ka luftuar i madhi Karl Marks kundër kapitalit. Ai atëherë kishte me vete një pakicë; në atë kohë lufta e ndërgjegjshme dhe revolucionare e proletariatit ishte në hapat e parë, por Marks kishte ide të qarta dhe të fuqishme, kishte besim të pakufishëm dhe mbështetej në klasën punëtore të Gjermanisë, të Francës, të Anglisë. Ai kurrë nuk i tremb vështirësive, po i kapërcente ato me vendosmëri të madhe. Në saje të mësimëve të tij dhe të V. I. Leninit në Rusi fitoi Revolucionin i madh Socialist i Tetorit dhe më vonë revolucionet popullorë triumfuan edhe në një varg vendesh të tjera.

Jeta dhe mësimet e mëdha të klasikëve të marksizëm-leninizmit na mësojnë dhe na bindin se klasa punëtore kurrë nuk mund të mposhtet. Ashtu si dielli pastron qiellin dhe kthjellon hapësirën nga rretë, ashtu edhe marksizëm-leninizmi pastron lëvizjen komuniste ndërkombëtare nga pikëpamjet e revizionistëve modernë, duke i demaskuar ata pa mëshirë. Klasa punëtore dhe aleatja e saj fshatarësia, përkohësisht mund të dëmtohen, revizionistët përkohësisht mund të arrijnë të gënjejnë popullin, por atyre shpejt do t'u dalë kallaji.

Partia jonë ecën kurdoherë me sukses përpara, se udhëhiqet nga një vijë e drejtë marksiste-leniniste dhe

ka mbështetjen e fuqishme të të gjithë popullit tonë. Ajo ka mbështetjen e popullit sovjetik, të Partisë Komuniste të Leninit dhe të Partisë Komuniste të Mao Ce Dunit, të komunistëve dhe të punëtorëve të vendeve socialiste dhe të lëvizjes komuniste dhe punëtoresh ndërkombëtare.

Të dashur shokë, si kurdoherë edhe në këto situata Partia jonë na porosit që në njërin dorë të mbajmë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Revizionistëve modernë nuk u pëlqen kjo parullë e Partisë sonë. Por s'ke ç'i bën! Ne nga zbatimi në jetë i kësaj parulle vetëm të mira kemi pasur. Armët, po t'i hedhin të gjithë, do t'i hedhim edhe ne. Përderisa imperialistët dhe veglat e tyre armatosen dhe bëjnë komplete kundër nesh, barutin ne do ta mbajmë kurdoherë të thatë.

Partia na mëson të punojmë me zell dhe sa më shumë për forcimin e ekonomisë së vendit tonë, sepse sa më të fortë të jemi ekonomikisht, aq më të paprekshëm bëhemi, aq më i paprekshëm bëhet atdheu ynë.

Shokë dhe shoqe, le të mprehim gjithnjë e më shumë vigjilencën revolucionare. Ujët mund të flejë, por armiku nuk fle, prandaj derisa të zhduket rrethimi kapitalist, ne duhet të jemi kurdoherë vigjilentë dhe të bëjmë që Shqipëria e re socialiste të mos preket nga kushdo që do të guxonte ta bënte këtë, sepse cilido qoftë ai do të gjente vdekjen.

Të dashur shokë, mëma dhe motra, me besim të patundur te Partia, te vija e saj e drejtë marksiste-leniniste, le të hidhemi në punë e aksion dhe të kryejmë plotësisht çdo orë dhe çdo ditë detyrat tona, të realizojmë e të tejkalojmë planet tona.

Dëshiroj t'ju falënderoj, veçanërisht ju, punonjës

të Pogradecit, klasën punëtore, fshatarësinë dhe gjithë inteligjencën e rrethit tuaj, për punën e lavdërueshme që po bëni në realizimin e detyrave. Sot vizitova kooperativën e kombinuar të artizanatit të qytetit tuaj dhe vura re se atje ka punëtorë të mrekullueshëm, burra, gra dhe vajza që punojnë me zell, entuziazëm, patriotizëm dhe me mendjen e duart e tyre të arta prodhojnë sa më shumë të mira materiale për popullin. Ashtu si kooperativa e kombinuar, i kanë realizuar planet edhe ndërmarrjet e tjera ekonomike të rrethit tuaj, prandaj me plot të drejtë keni merituar flamurin tranzitor të 20-vjetorit të lavdishëm të Partisë sonë. Edhe në bujqësi, fshatarësia kooperativiste e rrethit tuaj ka realizuar planet pothuajse në të gjithë zërat.

Pra, shokë dhe shoqe, ju uroj me gjithë zemër suksese të reja dhe më të mëdha në punën tuaj! Komiteti Qendror i Partisë më ka ngarkuar t'ju dorëzoj këtë flamur që ju e merituat në saje të punës suaj të palodhur. Ky është një nder që më bëhet dhe për mua kjo do të mbetet një ditë e paharruar. E mbajtshi me nder dhe deri në fund këtë flamur! Në përvjetorin e lavdishëm të 20-vjetorit të themelimit të Partisë sonë, më 8 Nëntor, unë do të jem i lumtur të dëgjoj që ky flamur t'u mbetet përgjithnjë punonjësve të rrethit tuaj!

Rroftë Partia jonë heroike!

Rroftë populli ynë i mrekullueshëm!

Rrofshin punonjësit e rrethit të Pogradecit!

*Botuar për herë të parë me shkurtime, në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 112 (3955);*

*9 maj 1961*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## USHTRIA JONË ESHTË NJË GARANCI PËR TË MBROJTUR FITORET E ARRITURA

*Fjala në një repart ushtarak të qytetit të Korçës*

8 maj 1961

Të dashur shokë ushtarë dhe oficerë,

Jam shumë i gëzuar që gjendem sot në mes jush, në mes ushtarakëve të njërit prej reparteve nga më të rëndësishmit dhe më të përparuarit e ushtrisë sonë heroike. Më lejoni t'ju sjell përshëndetjet më të nxhta të Komitetit Qendror të Partisë. Duke u ndodhur këtu, për të marrë takim me masat punonjëse të Korçës, kisha dëshirë të takohesha gjithashtu edhe me ju.

Sikurse jeni në dijeni, në të gjithë Shqipërinë vlon puna ndërtimore me një entuziazëm të madh. Ky entuziazëm dhe ky patriotizëm i lartë janë karakteristika të punonjësve të Shqipërisë së re dhe tregojnë besimin e madh të të gjithë punonjësve të vendit tonë dhe të ushtrisë sonë të lavdishme për Partinë tonë heroike e Komitetin e saj Qendror, për pushtetin tonë popullor, tregojnë besnikërinë e tyre të pafund për vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë.



Pas Çlirimit ne kemi ngritur një industri të fuqishme moderne, e cila gjatë pesëvjeçarit të tretë do të forcohet edhe më shumë. Ju i keni lexuar direktivat e pesëvjeçarit të tretë që aprovoi Kongresi IV i Partisë. Ky pesëvjeçar parashikon objekte të shumta dhe të rëndësishme që do ta bëjnë më shpejt Shqipërinë tonë një vend industrialo-agrar. Do të ndërtohen objekte të rëndësishme për përpunimin e mineraleve, që do të kontribuojnë në zhvillimin edhe më të shpejtë të forcave prodhuese. Do të ngrihen, gjithashtu, një sërë veprash, si kombinati i ri i tekstileve, uzinat e plehrave kimike dhe uzina e fabrika të tjera si dhe objekte me rëndësi të madhe ekonomike.

Perspektiva e përparimit të vendit tonë është e mirë edhe në bujqësi. Atdheu ynë, e bashkë me të edhe fshati, çdo vit ndërtohet e zbukurohet më shumë. Një transformim i madh është bërë në fshatin tonë, sidomos vitet e fundit. Kolektivizimi, që, siç na ka mësuar V.I. Lenini, është rruga e shpëtimit të fshatarësisë nga mjerimi dhe nga varfëria, ka sjellë ndryshime rrënjësore në fshat. Kudo janë hapur toka të reja, po bëhet sistemimi i tyre, janë prishur gjerdheth dhe janë krijuar parcela të mëdha, në fusha punon traktori; është ngritur niveli kulturor i fshatarëve. Fshatarësia jonë kooperative me zell përqafton të renë. Veçanërisht sivjet janë punuar mjaft mirë tokat dhe të gjitha kulturat janë mbjellë në kushte shumë më të mira se çdo herë tjetër. Këto tregojnë për përparimet që po bëhen në fshatin tonë me kolektivizimin. Këtë vit po na ndihmon edhe koha dhe kemi shpresa që ky të jetë një vit i mbarë bujqësor.

Gjatë këtij pesëvjeçari ne do të luftojmë më mirë e më shumë për të kapërcyer vështirësitë që na dalin në bujqësi, veçanërisht kundër fatkeqësive të natyrës. Me përpjekjet tona dhe duke përfunduar uzinat e plehrave kimike nga fundi i pesëvjeçarit bujqësia jonë do të hyjë në një rrugë me të vërtetë të përparuar dhe atëherë do të pretendojmë jo këto rendimente që marrim sot në grurë apo në misër, po rendimente shumë më të larta. Po kështu dot'i rritim rendimentet edhe në kulturat e tjera. E ardhshmja e bujqësisë sonë, pra, është e bukur. Kjo ka rëndësi shumë të madhe, sepse do të krijohen mundësitë që t'i japim popullit më shumë prodhime bujqësore e blegtorale dhe do të sigurojmë edhe lëndën e parë të nevojshme për industrinë.

Planet e Partisë janë të tilla që industria jonë, e cila rritet e zgjerohet çdo vit, të sigurohet me lëndë të parë minerale ose bujqësore-blegtorale të vendit. Dhe në këtë drejtim toka jonë ka rezerva dhe pasuri të mëdha.

Ju keni dëgjuar për pasuritë e mëdha që fshch nëntoka jonë. Rezervat e njohura deri tani do të zgjerohen edhe më shumë gjatë këtij pesëvjeçari. Perspektiva të mëdha të ne ka industria e naftës. Gjatë pesëvjeçarit të tretë sasia e naftës dhe e gazit të prodhuar do të shtohen dhe me to ne do të furnizojmë uzinën e plehrave azotike që do ta ndërtojmë gjatë këtij pesëvjeçari. Më vonë, në pesëvjeçarët e ardhshëm, do ta zgjerojmë industrinë kimike për të prodhuar në vendin tonë edhe materiale sintetike, duke përdorur naftën si lëndë të parë. Kështu këtë prodhim të çmueshëm nuk do ta eksportojmë bruto, po do ta përpunojmë në vend, do ta

bëjmë edhe më të vlefshëm se tani. Por vendi ynë ka edhe hekur-nikel me përmbajtje të lartë industriale, po zbulojmë shtresa të tjera kromi, kemi një perspektivë të mirë për bakrin etj.

E gjithë Shqipëria fsheh nën tokë minerale të çmueshme. Kërkimet që po bëhen do të sjellin që në të ardhshmen të kemi më shumë minerale. Kjo është një siguri dhe pasuri e madhe për planet tona ekonomike, për përmirësimin e jetës së popullit.

Populli ynë, duke parë perspektivën e shkëlqyer të përparimit të atdheut, duke parë në jetë se këto nuk janë fjalë, po një realitet i gjallë, ka besim të madh në rrugën e Partisë, në udhëheqjen dhe në vijën e saj të drejtë. Prandaj ai është lidhur kaq ngushtë, e do me gjithë shpirt dhe i qëndron besnik deri në fund Partisë sonë të lavdishme marksiste-leniniste.

Ushtria jonë nuk është një ushtri e kazermës, por një ushtri që ka dalë nga populli, rron bashkë me popullin, e njeh, e do dhe e ndihmon atë, i njeh sukseset e mëdha që ne kemi korrur gjatë kohës së shkurtër pas Çlirimit dhe që e ka për detyrë të ruajë atdheun, popullin dhe fitoret e tij. Rruga e drejtë e Partisë sonë ka dhënë rezultate kolosale si në zbulimin e në forcimin e atdheut, ashtu edhe në formimin dhe në edukimin e njerëzve të Shqipërisë së re.

I gjithë populli ju do me gjithë shpirt ju, ushtarë dhe oficerë, sepse ju ecni me vendosmëri në traditat revolucionare të popullit tonë trim dhe të luftës së partizanëve tanë heroikë, në saje të së cilës populli ynë u çlirua përgjithmonë nga robëria. Me thirrjen e Partisë, pa marrë parasysh as vdekjen, populli rroku armët dhe

u bëri ballë armiqve të egër, të shumtë, të djallëzuar e të armatosur deri në dhëmbë. Frymëzimi i Partisë ishte i tillë që çdo partizan i thjeshtë u bë një trim, një hero, ndryshe fashistët nuk do të ishin mundur.

Shokë ushtarë dhe oficerë, populli ynë është i lumtur që vija e Partisë në ushtri ka qenë dhe është e drejtë. Partia jonë pas Çlirimit tregoi kujdes të veçantë për ushtrinë, prandaj partizanët trima të Luftës Nacionalçlirimtare ajo i çoi në shkolla. Tani ushtria jonë ka me mijëra kuadro oficerë, bij të dashur të Partisë dhe të popullit, besnikë të çështjes së madhe të komunizmit. Këtyre njerëzve të mrekullueshëm Partia u dha mundësinë të pajisen me artin më të përparuar ushtarak, me artin stalinian. Partia jonë ruajti dhe zhvilloi me oficerët tanë eksperiencën e pakufishme të Luftës Nacionalçlirimtare. Kështu, pra, u krijuan kuadrot e ushtrisë sonë. Në saje të këtij kujdesi, ne sot kemi një ushtri të fortë, të stërvitur si duhet, të disiplinuar, me ndërgjegje të lartë socialiste dhe të gatshme të mbrojnë interesat e larta të atdheut dhe të socializmit, në çdo moment dhe kundër kujt do armiku qoftë.

Ushtarët dhe oficerët tanë dinë të përdorin armët më moderne në rast se do t'i imponohej luftë atdheut tonë.

Populli dhe komunistët shqiptarë janë kundër luftës, se në luftë derdhet gjaku i njerëzve, shtypen popuj, shkatërrohen vende. Por ne dimë njëkohësisht se derisa ekzistojnë imperialistët, ekziston edhe rreziku i luftës. Imperialistët, revizionistët dhe fashistët përpiqen të na bëjnë varrin, të djegin dhe të robërojnë atdheun tonë, të shkatërrojnë kampin e socializmit dhe lëvizjen ko-

muniste ndërkombëtare. Për këto arsye ne i mbajmë armët ngrehur dhe barutin e thatë. Por kurrë nuk do të provokojmë luftë, veçse do të jemi kurdoherë të gatshëm për të mbrojtur tokën e shenjtë të atdheut, fëmijët, jetën paqësore të popullit tonë. Ja përse i duam ne armët, të cilat do t'i ruajmë si sytë e ballit. Kjo është vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë sonë në ushtri. Këtë rrugë na kanë mësuar të ndjekim Lenini dhe Stalini dhe eksperiencia e madhe e popullit tonë.

Revizionistët modernë përpiqen të dobësojnë vigjilencën tonë kundër imperializmit, të dobësojnë unitetin e radhëve tona. Prandaj, Partia jonë dhe të gjitha partitë e tjera marksiste-leniniste i demaskojnë pa mëshirë revizionistët modernë, si revizionistët jugosllavë e të tjerë, sepse ata janë armiq të tërbuar të marksizëm-leninizmit, agjentë të imperializmit dhe të borgjezisë reaksionare. Prandaj, kushdo që nuk i demaskon revizionistët me të gjitha forcat, ashtu siç i kanë demaskuar Marksi dhe Lenini, kush nuk i godet ashtu siç i goditi dhe i shtypi Stalini, ai është një pacifist, ai është vetë një revizionist.

Disa njerëz, ne shqiptarët na quajnë kokëfortë e gjaknxhtë, por ne mendjen e kemi të qartë, sytë të hapët dhe zemrën të zjarrtë. Për fat të keq, disa udhëheqës të partive komuniste thonë se ç'është gjithë kjo zhurmë që bëjnë komunistët shqiptarë kundër revizionizmit jugosllav? Duke folur shumë kundër tyre, thonë ata, atyre u rritet mendja. Kjo, shokë, është një parullë revizioniste. Marksizëm-leninizmi na mëson se armiku duhet demaskuar. Titoja dhe klika e tij revizioniste atë duan, të mos flitet për ta që ta bëjnë më lehtë punën

e tyre minuese kundër kampit të socializmit. Të gjithë ata që përhapin të tilla parulla në fakt ndihmojnë revizionistët.

Marksistët e vërtetë e vlerësojnë drejt rrezikun e revizionistëve dhe helmin që kërkojnë të përhapin ata në lëvizjen komuniste ndërkombëtare dhe në vendet socialiste. Veçanërisht komunistët shqiptarë i njohin mirë revizionistët jugosllavë se ç'punë armiqësore bëjnë kundër komunizmit ndërkombëtar, e sidomos kundër vendit tonë. Kemi 18 vjet që luftojmë kundër tyre. Në fillim jemi sjellë ndaj tyre si miq, sepse nuk i kemi njohur, kurse ata qysh në atë kohë ishin armiq të tanë dhe si të tillë i kanë sjellë dëme të mëdha vendit tonë. Duke njohur mirë qëllimet, taktikat dhe dredhitë e revizionistëve jugosllavë, ne i demaskojmë pa mëshirë ata, pavarësisht se ka njerëz që përpiqen të na denigrojnë, por me Partinë dhe me popullin tonë janë shumë parti marksiste-leniniste, të gjithë popujt që luftojnë për liri, për pavarësi dhe për paqe.

Jeta po tregon sa e drejtë është vija e Partisë sonë. Revizionistët modernë përpiqen të gënjejnë njerëzit duke thënë se imperializmi amerikan tani nuk është agresiv, prandaj mund të bisedohet me të e të arrihet në disa marrëveshje. Partia dhe Qeveria jonë nuk janë kundër bisedimeve, vetëm se ne jemi për bisedime të frytshme, në interes të paqes, që i shërbejnë forcimit të pozitave të socializmit, interesave të popujve, të veçjelisë, dhe në asnjë mënyrë interesave të imperializmit, të kapitalistëve. Këtu qëndron ndryshimi ynë me revizionistët modernë.

Ne themi se imperialistët amerikanë nuk kanë

ndryshuar, se ata vazhdojnë të armatosen, se ata kërkojnë të fitojnë kohë. Prandaj atyre u duhen shtrënguar dhëmbët dhe të mos nanurisen me fjalë.

Revizionistët modernë e quajnë «dogmatik» J.V. Stalinin. Ai fjalët i kishte të pakta, por fjalët e tij kalonin gojë më gojë në të gjitha kontinentet, ngrohnin zemrat e punonjësve e të popujve paqedashës, kurse armiqtë e socializmit dridheshin. Ndërsa tani, me gjithë fjalët e shumta bombastike që janë thënë për çarmatimin, imperialistët e sidomos imperialistët amerikanë as që duan t'ia dinë. Të çarmatoset imperializmi amerikan do të thotë që ai të pranojë të hedhë poshtë armët. Kjo gjë nuk mund të arrihet kurrë, sepse armatimi qëndron në natyrën agresive e luftënxitëse të tij.

Kur populli kuban i hodhi në det mercenarët e dërguar nga imperializmi amerikan, u vërtetua se paqja mbrohet jo me fjalë, por me luftë revolucionare kundër veprimeve agresive të imperializmit amerikan. Dështimi i intervencionit amerikan kundër Kubës ka qenë një fitore jo vetëm për popullin kuban dhe për paqen në përgjithësi, por edhe një tregues i mirë i vijës së drejtë të Partisë sonë, të PK të Kinës dhe të atyre partive marksiste-leniniste që vazhdimisht ngrenë nevojën e vigjilencës së popujve dhe u thonë të jenë të kujdesshëm se imperializmi që po armatoset dhe po përgatitet për luftë, po të gjeti në gjumë, të fut thikën pas shpine.

Partia jonë ka ndjekur kurdoherë mësimet e V.I. Leninit për marrjen e pushtetit. Ndër të tjera ai thotë se proletariati, po të jetë e mundur, le ta marrë pushtetin pa luftë të armatosur, por në qoftë se borgje-

zia përdor dhunën, atëherë duhet të përdoret dhuna edhe nga ana e proletariatit. Komunistët francezë mund të na kritikojnë, duke pretenduar se ata pushtetin do ta marrin në mënyrë paqësore. Ne i urojmë ata, në rast se ia dalin, se nuk duam të derdhet gjaku i vëllezërve tanë proletarë francezë. Por duhet të jemi realistë. Jeta ka vërtetuar se deri sot në asnjë vend revolucionit socialist nuk ka fituar në rrugë paqësore. Rruga e vërtetë për marrjen e pushtetit nga proletariati po shtrembërohet me qëllim nga revizionistët modernë, për të dobësuar vigjilencën dhe për të ulur frymën revolucionare të partive komuniste në luftën e tyre për përmbysjen e pushtetit të borgjezisë.

Ka njerëz që thonë se Kina dhe Shqipëria janë për luftë. Kjo është vetëm gënjeshtër dhe shpifje. As Kina, as Shqipëria, as ndonjë vend tjetër me të vërtetë socialist nuk mund të pranojnë që t'u hyjë armiku brenda, t'u rrëmbejë fitoret. Shpifjet dhe gënjeshttrat e këtyre njerëzve kundër partive tona po pësojnë çdo ditë disfatë, ndërsa marksizëm-leninizmi kurdoherë do të triumfojë.

Ne jemi marksistë dhe kemi të drejtë të themi pikëpamjen tonë në mbledhjet e marksistëve. Pikëpamjet që shpreh një parti nuk duhen vlerësuar duke u nisur nga pozitat e të madhit ose e të voglit, ndryshe largohemi nga marksizëm-leninizmi. Pikëpamjet e çdo partie duhen parë vetëm në frymën marksiste-leniniste dhe kështu duhen vlerësuar edhe pikëpamjet e Partisë sonë.

Disa udhëheqësve sovjetikë nuk u pëlqejnë qëndrimet parimore të Partisë sonë. Në komplotin e Bukureshtit vetëm Partia e Punës e Shqipërisë doli në



mbrojtje të PK të Kinës dhe u shpreh me vendosmëri se nuk mund të dënohet padrejtësisht Partia heroike Komuniste e Kinës.

N. S. Hrushovit nuk i pëlqeu ky qëndrim i Partisë sonë, prandaj qysh atëherë filluan t'i bëhen presione Partisë së Punës të Shqipërisë. Por sharra hasi në gozhdë, Partia jonë e ka koskën të fortë. Në Mbledhjen e Moskës të nëntorit 1960 Partia jonë e tha përsëri fjalën e vet. Dhe atje ne dhe PK e Kinës nuk ishim vetëm. Me ne ishin edhe parti të tjera që mbajtën qëndrim marksist-leninist.

Por udhëheqjet e disa partive ua kanë fshehur popullit dhe partisë së vet qëndrimet e padrejta që kanë mbajtur në Bukuresht dhe në Moskë, prandaj komunistët e këtyre partive i rrethojnë njerëzit tanë që punojnë ose mësojnë në ato vende, dhe u kërkojnë materiale për të mësuar si është e vërteta mbi qëndrimin e Partisë sonë. Studentët dhe oficerët tanë që mësojnë në Bashkimin Sovjetik dhe në vendet e tjera të demokracisë popullore të Evropës, qëndrojnë të papërkulur në mbrojtje të vijës së Partisë së tyre marksiste-leniniste dhe me këtë qëndrim ata ndihmojnë njëkohësisht dhe Bashkimin Sovjetik.

Popujt e Bashkimit Sovjetik Partia jonë do t'i mbrojnë nga kushdo qoftë që i kërcënon. Ne e duam me gjithë zemër atdheun tonë, por jemi edhe internacionalistë, sepse duam dhe respektojmë edhe popujt e tjerë e, në radhë të parë, popujt e vendeve socialiste. Ne jemi komunistë shqiptarë, por njëkohësisht duam dhe respektojmë edhe partitë e tjera që ndjekin një vijë të drejtë marksiste-leniniste. Uniteti ynë duhet të

jetë i çeliktë, por në rrugën marksiste-leniniste. Për këtë rrugë ne do të luftojmë deri në fund.

Ka grupe njerëzish që përpiqen t'u krijojnë vështirësi Partisë dhe vendit tonë, por nuk do t'ia arrijnë dot qëllimit, ata do të dështojnë. Ata që i bëjnë presione dhe i krijojnë vështirësi Shqipërisë, ka ardhur koha të demaskohen.

Duke pasur kurdoherë në zemër Partinë dhe interesat e mëdha jetike të popullit tonë, për të cilat ka derdhur kaq gjak, veçanërisht ushtria jonë e lavdishme, ju, shokë ushtarë dhe oficerë, duhet të mësoni e të edukoheni vazhdimisht, të forconi ushtrinë me armët që disponon dhe ashtu si i gjithë populli ynë të bëni edhe ju kursime në çdo drejtim.

Ne duhet të forcojmë vigjilencën, ta kemi Partinë të pastër, ta kalitim vazhdimisht, ta mbrojmë me vigjilencë marksizëm-leninizmin, të forcojmë dhe të çelikosim mbrojtjen e atdheut socialist, fitoret e mëdha që kemi arritur në të gjitha fushat. Këto porosi të Partisë sonë të mos i harrojmë kurrë.

Ju e kuptoni se koha ecën në favorin tonë, por aktualisht po kalojmë situata të vështira, sepse kundër nesh bëhen komplete nga armiqtë e popullit e të Partisë. Prandaj kurrë të mos dobësojmë vigjilencën, se ajo na ka nxjerrë kurdoherë faqebardhë, veç të mirave asgjë të keqe nuk na ka sjellë. Duke ruajtur e duke forcuar vigjilencën as ngritja ekonomike e vendit nuk është penguar, përkundrazi, industria, bujqësia, arsimi dhe kultura vazhdimisht kanë ecur përpara, liria dhe pavarësia e atdheut janë mbrojtur. Prandaj ushtria jonë të jetë kurdoherë në gatishmëri të plotë, sepse

kjo do t'i bëjë armiq të t'i vënë gishtin kokës, përpara se të fillojnë ndonjë aventurë, duke menduar se Shqipëria është e rrethuar gjeografikisht dhe ka vështirësi.

Shqipëria është e izoluar gjeografikisht, por ajo nuk është vetëm. Ajo ka miq të fuqishëm, siç janë popujt e vendeve të demokracisë popullore e popujt liridashës në botë. Kështu Shqipëria nuk është dhe kurrë nuk do të jetë e izoluar.

Ju uroj nga zemra shëndet dhe punë të mbarë, shokë ushtarë dhe oficerë! Veçanërisht ju, shokë oficerë, kini kujdes për ushtarët, i edukoni ata si duhet politikisht dhe ushtarakisht. Partia dhe Komiteti i saj Qendror e dinë sa kujdes të madh tregoni ju për ushtarët, prandaj vazhdoni në këtë rrugë, ta shtoni edhe më shumë këtë kujdes. Ju keni në duart tuaja njerëz të mrekullueshëm që vijnë në ushtri nga të katër anët e Shqipërisë dhe këta nuk ju vijnë analfabetë si më parë, prandaj mësimet ushtarake, teorike dhe dijenitë e përgjithshme që u jepni ushtarëve gjatë orëve të mësimt bëni që ata t'i përvetësojnë si duhet, sepse, pasi të kryejnë shërbimin ushtarak, do të përhapen në të katër anët e atdheut, ku do të punojnë për ta bërë atë më të bukur, më të lulëzuar. Pra, ashtu si bëjnë mësuesit në shkolla edukimin ideologjik dhe kulturor të brezit të ri, edhe ju, shokë oficerë, keni një detyrë shumë të madhe, që ju ka ngarkuar Partia dhe populli, ta bëni ushtrinë tonë të zonjën, vigjilente, patriote të flaktë, të disiplinuar dhe të gatshme për çështjen e madhe të atdheut dhe të socializmit.

Komiteti Qendror i Partisë është i bindur se bijtë

e Partisë sonë të lavdishme, siç jeni ju, do ta kryejnë me nder këtë detyrë të madhe.

Të rrojë ushtria jonë heroike!

Të rrojë atdheu ynë i dashur!

Të rrojë Partia jonë e lavdishme!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## UNITETI PARTI-POPULL E BËN RPSH NJË KËSHTJELLË TË PAMPOSHTUR

*Fjala me kuadrot e repartit ushtarak të kufirit dhe  
të Sigurimit të Shtetit të rrethit të Korçës*

9 maj 1961

*Në mes të entuziazmit të jashtëzakonshëm, të duar-  
trokitjeve të stuhishme dhe të ovacioneve për Partinë e  
Punës dhe Komitetin e saj Qendror fjalën e mori shoku  
Enver Hoxha:*

Ju falënderoj nxehtësisht për këtë pritje kaq të përzemërt, e cila i takon Partisë sonë të lavdishme të Punës! Partia dhe populli ynë krenohen me ju, ushtarë dhe oficerë të kufirit, të ndjekjes dhe të organeve të Sigurimit të Shtetit, armë të fuqishme e të lavdishme që mbrojnë interesat e popullit e të atdheut. Ushtarët dhe oficerët e kufirit ruajnë kufijtë e shtrenjtë të atdheut, lirinë dhe pavarësinë e popullit, fitoret e tij të mëdha nga intrigat dhe sulmet e armiqve të jashtëm, si dhe nga spiunët e diversantët, të cilët luftojnë me të gjitha forcat dhe mjetet e tyre për të dobësuar regjimin tonë të demokracisë popullore.

Prandaj për të gjithë ju, shokë të reparteve të kufirit, të ndjekjes dhe të Sigurimit të Shtetit, përgjërohen Partia dhe populli, sepse ju jeni nga bijtë e tyre më të mirë, jeni ajo pjesë e forcave tona të armatosura që ndodheni vazhdimisht në kontakt me veprimet e armiqve.

Shokë të dashur, duhet të jeni kurdoherë vigjilentë, sepse, siç e shihni, gjatë luftës suaj të përditshme heroike, agjenturat e huaja veprojnë dhe luftojnë kundër vendit tonë, po ata që dërgojnë bien si miu në çark, sepse nuk gjejnë terren të përshtatshëm për punën e tyre armiqësore në vendin tonë, nuk bëjnë dot si të duan. Ata kanë ngrënë dhe kurdoherë do të hanë grushte nga arma e lavdishme e sigurimit, nga rojet tona heroike të kufirit, nga populli ynë trim e vigjilent.

Është gëzim i madh për popullin tonë që Partia ka edukuar dhe ka kalitur njerëz të tillë si ju që, me njohuritë dhe me eksperiencën tuaj, dini t'i zbuloni e t'i bëni pluhur e hi taktikat djallëzore të armikut, i cili i ndryshon ato sipas rrethanave dhe situatave. Kjo ka rëndësi të madhe. Më kot përpiqen armiqtë ta dëmtojnë Republikën tonë Popullore. Shqipëria është një kështjellë e pamposhtur, sepse Partia dhe populli janë në unitet të çeliktë. Ky unitet përbën, në radhë të parë, forcën tonë të pamposhtur. Po të mos qe ky unitet në mes Partisë dhe popullit atëherë armiqtë do ta kishin më lehtë të vepronin kundër atdheut tonë. Kjo ndodh se në Partinë e Punës të Shqipërisë, që është pjella e popullit, bëjnë pjesë njerëzit më të mirë, elementë të ardhur nga radhët e klasës punëtore, të fshatarësisë revolucionare dhe të inteligjencës popullore.

Ne jemi të pamposhtur se vija e Partisë sonë është

një vijë e drejtë, që shpreh interesat dhe ndjenjat e larta të popullit. Për këtë arsye uniteti i Partisë dhe i popullit është i çeliktë. Populli e do Partinë e tij me të gjitha forcat sepse sheh në jetë sa e drejtë është vija e saj marksiste-leniniste, se kjo vijë e drejtë gjen shprehjen e vet në realizimin e planeve që përfaqësojnë të tashmen e bukur të popullit tonë dhe të ardhshmen e lumtur të tij. Populli ynë sheh se Partia nuk thotë vetëm fjalë, nuk i bën fantazira popullit, po i tregon realitetin, i tregon rrugën si të mobilizohet dhe e udhëheq me guxim e largpamësi në punën për të realizuar kudo, në çdo sektor, vepra të mrekullueshme. Për këto arsye populli është i lidhur ngushtë dhe e do si shpirtin e tij Partinë, për këto arsye ç'thotë Partia populli përpiqet me të gjitha forcat t'i zbatojë, për këto arsye edhe rojet tona të kufirit janë bërë heronj dhe punonjësit e Sigurimit të Shtetit, të cilët janë nga njerëzit më të mirë, vigjilojnë ditë e natë dhe janë të gatshëm të sakrifikojnë edhe jetën e tyre që popullit të mos i cenohet asnjë fije floku.

Gjendja aktuale, të dashur shokë, zhvillohet në favor të forcave të socializmit e të paqes. Këto forca rriten çdo ditë, çdo vit, kurse forcat e imperializmit e të luftës po dobësohen e i humbasin pozitat e tyre vazhdimisht. Por me gjithë dobësinë e tyre, armiqtë e socializmit nuk i kanë hedhur armët, ata përpiqen të armatosen edhe më shumë dhe të na dëmtojnë me anë të diversionit dhe të shantazhit. Në këto rrethana interesat e larta të atdheut kërkojnë që barutin ta mbajmë kurdoherë të thatë dhe vigjilencën revolucionare në lartësinë e duhur.

Ju jeni në dijëni të komplotit të poshtër që revizionistët jugosllavë e monarko-fashistët grekë, në bashkëpunim me Flotën VI Amerikane, kishin organizuar kundër vendit tonë. Janë pikërisht punonjësit e armës së sigurimit që i zbuluan komplotistët, jeni ju, shokë të kufirit, që keni kapur shumë diversantë, të vënë në shërbim të këtij komploti. Ata përpara hetuesisë pohuan fijet e komplotit të poshtër që po përgatitej kundër RP të Shqipërisë, gjë që bëri të mundshme të kapen tradhtarët e atdheut, të cilët së shpejti do të japin llogari përpara gjyqit të popullit dhe do të marrin dënimin e merituar.

Me gjithë fitoret që kemi korrur, Partia na mëson se duhet të jemi vigjilentë, sepse imperialistët dhe shërbëtorët e tyre janë dhe mbeten agresorë. Ne jemi për paqen, kurse ata janë kundër paqes. Por paqen ne nuk e lypim nga Kenedi. Atë ne do t'ua imponojmë imperialistëve amerikanë dhe shërbëtorëve të tyre.

Ne jemi për bashkekzistencë, po nuk lejojmë që për hir të saj të likuidohet liria, pavarësia dhe sovraniteti i popullit shqiptar. Kush e kupton ndryshe bashkekzistencën ai nuk është marksist, po revizionist. Le të na akuzojnë sikur gjoja ne nuk jemi për bashkekzistencën paqësore. Jo, ne nuk jemi për një bashkekzistencë të tillë që rrezikon lirinë dhe pavarësinë e popullit tonë. Ne nuk jemi as për atë lloj bashkekzistence që pretendojnë revizionistët modernë, domethënë që t'u bëjmë lëshime atyre dhe imperialistëve, që t'u hapim kufijtë revizionistëve jugosllavë, sikurse kanë vepruar disa nga vendet socialiste evropiane, ku është arritur sa t'u vjedhin brenda në selinë e Komitetit Qendror dokumente



shumë sekrete, ose t'u bëjnë komplete. Këto ne nuk i lejojmë në vendin tonë.

Duke përfituar nga këto lëshime, revizionisti i urryer Rankoviç gjen rast të akuzojë vendin tonë se gjoja është një skëterrë ku sundon çizmja e kufitarit. Jo, vendi ynë nuk është një skëterrë, por një shtet socialist që çdo vit bëhet më i bukur, pavarësisht se disa, për shkak të vijës së drejtë të Partisë sonë, e shtrembërojnë të vërtetën dhe na bëjnë presione. Por ata ta dinë mirë se populli shqiptar kurrë nuk e ka ulur kurrizin përpara kujt do goftë.

Populli shqiptar ka qenë kurdoherë i drejtë. Kush ka mik popullin tonë, ka një mik për kokë. Populli ynë nuk e ndërron rrugën e tij të drejtë dhe ai do të fitojë, se nuk është i vetëm në këtë rrugë, se Partia jonë marksiste-leniniste nuk është e vetme.

Në këtë luftë revolucionare për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar, ne nuk jemi vetëm. Me ne janë Partia Komuniste e Kinës, të gjithë komunistët e vërtetë të botës dhe të vetë Partisë së lavdishme Komuniste të Leninit, që aprovojnë vijën dhe qëndrimet e drejta të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët modernë, jugosllavë e të tjerë, si edhe të gjithë ata që nuk na e duan të mirën, shpejt do ta kuptojnë se as presionet ekonomike dhe as ato ushtarake, as shpifjet dhe as diversionet nuk do ta ndalin popullin shqiptar të ecë gjithmonë përpara në rrugën e socializmit.

Plani ynë i tretë pesëvjeçar që aprovoi Kongresi IV i Partisë sonë, megjithëse i ngjeshur, është një plan real,

i përgatitur me shumë kujdes dhe të gjitha mundësitë janë që ai jo vetëm të realizohet plotësisht, po edhe të tejkalohet, sepse ne kemi një popull heroik, punëtor dhe patriot të flaktë. Populli ynë i ka treguar kurdoherë këto cilësi, po veçanërisht po i tregon në këtë periudhë të shkurtër pas Kongresit IV historik të Partisë.

Si për çdo pesëvjeçar, edhe për pesëvjeçarin e tretë janë nënshkruar marrëveshje për ndihma e kredi nga vendet socialiste. Në rast se disa udhëheqës të vendeve socialiste ia presin ndihmat e kreditë Shqipërisë, domethënë në rast se shkelin marrëveshjet që kanë firmuar, do të jetë një turp i madh për ta dhe do të demaskohen, sepse plani ynë përse u përket ndihmave e kredive është i siguruar nga Republika Popullore e Kinës.

Por një situatë e tillë, kundër Partisë dhe vendit tonë, nuk mund të vazhdojë për shumë kohë, sepse të tilla janë sot rrethanat, të tilla janë forcat e marksizëm-leninizmit. Demagogjia mund të gënjejë për një farë kohe vetëm disa njerëz, po marksizmin ajo nuk mund ta errësojë dot. Ja, jeta po tregon veprimet armiqësore të imperialistëve amerikanë kundër paqes, po vërteton gjithashtu se sa false janë predikimet e revizionistëve modernë se imperializmi amerikan gjoja ka ndryshuar natyrën e tij agresive ngaqë kanë ndryshuar qeveritarët në Uashington. E vërteta është se imperialistët amerikanë janë po ata që kanë qenë, dhe ata që kanë ardhur tani në fuqi në SHBA janë po aq të egër e luftënxitës si gjithë të tjerët, janë njerëz që e kanë në shpirt luftën dhe agresionin. Kjo që po them u provua në Kubë, në Laos, në Afrikë etj. Kjo veprimtari e agre-

sorëve imperialistë, vërteton pikëpamjet e drejta që ka Partia jonë mbi natyrën e imperializmit, pikëpamje që janë shprehur edhe në Deklaratën e Moskës të vitit 1960, për hartimin e së cilës edhe Partia jonë ka dhënë kontributin e saj.

Parimet marksiste-leniniste duhet të zbatohen me përpikëri nga kushdo që e quan veten komunist dhe nga çdo parti që e quan veten marksiste-leniniste. Nga ana jonë, këto parime i kemi zbatuar me përpikëri dhe i kemi mbrojtur me konsekuencë.

Ne shohim dhe jeta ka treguar se cilët janë revizionistët jugosllavë. Ne i njohim mirë veprimet, taktikat dhe sulmet e tyre, sepse i kemi vuajtur në kurriz. Këto i dinë mirë i gjithë populli, Partia dhe në radhë të parë ju, që mbron kufijtë, ju kuadrot e Sigurimit të Shtetit, që jeni në luftë të përditshme me revizionistët jugosllavë. Prandaj ta rritim vazhdimisht vigjilencën kundrejt tyre.

Por disa të ashtuquajtur shokë të disa partive komuniste, me qëndrimet oportuniste që mbajnë ndaj revizionistëve jugosllavë, bëjnë që të ulet vigjilenca revolucionare e komunistëve. Të tilla qëndrime ne i hedhim poshtë dhe i shkelmojmë. Të zbutësh ose të pushosh luftën kundër revizionistëve jugosllavë, në një kohë që klika tradhtare e Titos vepron në shërbim të imperializmit dhe merr prej tij çeqe sa herë që kurdis ndonjë komplot kundër vendeve tona, do të thotë të shuash vigjilencën revolucionare, të mos mbash një qëndrim marksist, por revizionist, prandaj «këshillat» për të mos luftuar kundër revizionistëve jugosllavë nuk bëjnë për ne, le t'i mbajnë për vete ata që i thonë.

Rruga jonë, shokë, është e drejtë. Shikoni si e aprovon dhe si mobilizohet i gjithë populli rreth vijës së Partisë. Ky është pulsi i drejtësisë së kësaj vije. Po e aprovoi dhe po e zbatoi populli vijën e Partisë, kjo do të thotë se ajo është e drejtë, është në interesin e tij. Partia jonë u bindet vetëm popullit dhe marksizëm-leninizmit dhe jo atyre që shkelin marksizëm-leninizmin dhe interesat e popujve.

Prandaj, shokë, të lidhemi me popullin si mishi me thoin, të punojmë me të gjitha forcat për të kryer detyrat që na ka ngarkuar Partia, të gjithë, i madh apo i vogël në përgjegjësi dhe në çdo sektor ku punojmë.

Ju, të dashur shokë të sigurimit dhe të kufirit, keni detyra jashtëzakonisht të rënda dhe delikate. Të jeni të bindur se te ju Partia dhe populli kanë besim të madh se do t'i kryeni me nder detyrat e mëdha që ju janë ngarkuar. Sigurimi i qetësisë dhe i lumturisë së popullit duhet të na udhëheqë të gjithëve në çdo veprim. Kështu na mëson Partia.

Ju që ruani kufijtë e atdheut mendoni kurdoherë punën paqësore të baballarëve, të mëmave dhe të motrave tuaja, jetën e grave dhe të fëmijëve tuaj. Çdo neglizhencë nga ana juaj sjell dëm për familjen e madhe të vendit tonë. Kështu duhet të mendojë edhe punëtori në fabrikë për mosrealizimin e planit, për prishjen e një vegle, për të metat në realizimin e detyrës dhe për çdo pakujdesi që sjell uljen e rendimentit ose ngritjen e kostos së prodhimit.

Sa më mirë të punojnë të gjithë, sa më me përpikëri ta kryejë secili detyrën e vet, aq më shpejt do të sigurohen zhvillimi ekonomik dhe zbukurimi i at-

dheut, mbarëvajtja e punëve dhe mirëqenia e popullit. Le të marrim si shembull edhe punën e arsimitarëve në shkolla. Në rast se një arsimtar nuk e kryen si duhet detyrën, në rast se ai nuk u fiton zemrën fëmijës, nxënësit, studentit, dhe me mjeshtërinë e tij prej pedagogu nuk u fut në kokë atyre dituritë që zotëron, edhe ai i sjell një dëm jo të vogël familjes sonë të madhe, pengon planet tona në fushën e arsimit, përgatitjen e kuadrove të ardhshëm.

Të gjitha këto probleme, shokë të dashur, janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën dhe zgjidhja e tyre shpejt dhe drejt përbën një forcë të madhe për ne. Vigjilenca revolucionare dhe zbatimi si duhet i saj në detyrë përbën atë forcë të madhe që e çon vendin tonë drejt begatisë, gjë që ne do ta arrijmë patjetër, sepse kemi Partinë që na udhëheq, të kalitur në rrugën marksiste-leniniste.

Liria dhe pavarësia e atdheut tonë, begatia dhe mirëqenia e popullit janë të siguruar, sepse kufijtë e shtrenjtë të Shqipërisë i ruajnë sokola të tillë që nuk lejojnë të kalojnë armiqtë e popullit shqiptar.

Shokë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, Partia e di se ju nuk i keni ato lehtësi dhe komoditete që gëzojnë punonjësit e qyteteve. Ju rroni në kufi, në male e kodra, në pyje e gryka, ku nuk ka banesa si në qytet; ku nuk ka kinema, teatro e të tjera zbavitje. Por Partia përpiket me çdo mjet e mundësi që t'ua bëjë jetën më të këndshme atje ku ju shërbeni. Kujdesi i Partisë për ju ka qenë i vazhdueshëm dhe akoma më shumë do të shtohet.

Ju, shokë oficerë, keni një detyrë shumë të madhe.

Duke marrë parasysh kushtet e vështira të jetës së kufirit, të jeni sa më afër ushtarëve, të organizoni mirë shërbimin, ushtrimet dhe mësimet, por pa harruar edhe ato që përmenda më lart, me qëllim që jeta e kufitarëve tanë, brenda mundësive dhe kushteve të vendit, të bëhet sa më e gëzuar. Kjo ka rëndësi të madhe. Ju e dini detyrën tuaj dhe e kuptoni se ushtari gjatë kohës së qëndrimit në shërbim nuk duhet të ndiejë mërzitje, prandaj të jeni sa më afër tyre.

Ju gjithashtu duhet të lidheni sa më ngushtë, jo vetëm me popullin përreth kufirit, po edhe me familjet e tyre, të bëni që të gjithë shokët e kufirit të jenë në dijeni të situatës, si edhe të shëndetit e të mirëqenies së familjeve të tyre.

Përveç këtyre, shokët oficerë të kufirit që merren me punën e Partisë, me propagandën dhe agjitacionin, duhet t'u bëjnë të njohur vazhdimisht kufitarëve sukseset e popullit tonë në të gjitha fushat. Të mos bëhen leksione të thata e të vjetruara, por këto të jenë konkrete dhe të përmbajnë probleme aktuale. Qendra duhet t'ju mbajë në dijeni mbi këto probleme, dhe ju vetë duhet të shfrytëzoni çdo ditë shtypin, në mënyrë që informacionet t'i hartoni me material të freskët dhe t'i zhvilloni në mënyrë të gjallë dhe tërheqëse për ushtarët e kufirit. Kjo është e domosdoshme të bëhet.

Në kohën e lirë, jashtë shërbimit dhe mësimet, detyra juaj është të organizoni dëfrimin me kufitarët, brenda mundësive që keni. Atje ku punoni dhe jetoni ju, mund të mos ketë kushte për një fushë futbollit, megjithatë një top futbollit ju duhet ta keni, ashtu sikurse duhet të keni edhe vegla muzikore, libra, gazeta

etj., dhe në rast se ju mungojnë këto mjete, duhet t'i kërkon.

Edhe një herë ju falemi nderit shumë për pritjen e ngrohtë dhe për dashurinë që shprehni për Partinë! Unë do t'u raportoj shokëve të Komitetit Qendror se vizitova këtë repart të kufirit dhe konstatova entuziazmin e madh të ushtarëve, të nënoficerëve e të oficerëve, dashurinë e besnikërinë e tyre të madhe për Partinë tonë të lavdishme, për Komitetin e saj Qendror, për Qeverinë dhe për popullin tonë heroik.

Prandaj ju uroj shëndet dhe punë të mbarë në realizimin e detyrave që ju ka ngarkuar Partia dhe populli, për të mirën e atdheut tonë të dashur!

Rroftë Partia jonë e lavdishme e Punës!

Rroftë populli shqiptar!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## NË ÇDO PUNË TË NA KARAKTERIZOJË FRYMA E LARTË REVOLUCIONARE DHE MPREHTËSIA POLITIKE

*Nga biseda në kryesinë e kooperativës bujqësore  
të bashkuar të Pojanit në rrethin e Korçës*

9 maj 1961

*Pasi i uroi të pranishmit për sukseset e arritura në ekonominë e tyre si dhe për sukseset e gjithë fshatarësisë kooperativiste të rrethit të Korçës, shoku Enver Hoxha, duke e përqëndruar fjalën e tij rreth veprimtarisë së armiqve të jashtëm të vendit tonë dhe të kampit të socializmit, tha:*

Imperialistët përpiqen t'u shkaktojnë vështirësi vendeve tona. Por përballë politikës luftënxitëse agresive të imperialistëve dhe të revizionistëve, të gjitha vendet socialiste e së bashku me to edhe Republika jonë Popullore duhet të luftojë me vendosmëri për të mbajtur në gatishmëri të plotë forcat e armatosura, për të mprehur më tej e në lartësinë e duhur vigjilencën revolucionare, për të asgjësuar çdo orvatje të armiqve tanë e për të realizuar planet ekonomike.



Por vështirësitë nuk na krijojnë vetëm nga imperialistët. Presione ekonomike po na bëhen edhe nga udhëheqësit e disa vendeve mike, të cilat ndjekin një rrugë të gabuar, në kundërshtim me parimet e marksizëm-leninizmit. Dihet se me të gjitha vendet socialiste, e veçanërisht me Bashkimin Sovjetik, me Çekoslovakinë etj., ne kemi nënshkruar marrëveshje për ndihma e kredi gjatë këtij pesëvjeçari. Por në qoftë se udhëheqësit e këtyre vendeve, duke mos u pëlqyer vija e drejtë e Partisë sonë, nuk do t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura, ata, vërtet do të na krijojnë vështirësi të shumta, por ta dinë mirë se, në fund të fundit, nuk kanë për ta penguar realizimin e planit të tretë pesëvjeçar.

Kredi dhe ndihma ekonomike neve na ka dhënë Bashkimi Sovjetik, sidomos sa që gjallë Stalini, dhe ato i kanë shërbyer vendit tonë për të mëkëmbur ekonominë dhe për të ndërtuar socializmin. Por këto kredi e ndihma asnjëherë nuk kanë qenë e s'do të jenë faktori kryesor i ndërtimit të socializmit te ne. Jo, faktori kryesor ka qenë dhe është puna e palodhur e njerëzve tanë trimë e punëtorë, mobilizimi dhe entuziazmi i përgjithshëm i popullit tonë, udhëheqja e ndritur, largpamëse dhe konsekuente e Partisë sonë të Punës. Prandaj në qoftë se udhëheqësit e disa vendeve socialiste mendojnë se miqësia vëllazërore, që lidh popullin tonë me popujt e tjerë vëllazër, varet nga kreditë që na japin, ata gabojnë rëndë dhe mendojnë në rrugë antimarksiste.

Ne jemi të bindur se, duke vepruar kështu, ata jo vetëm do të dështojnë në veprimtarinë e tyre kundër

nesh, por do të demaskohet edhe politika e tyre e padrejtë e antimarksiste që ndjekin.

Partia jonë mendon se ndihmat që i japin njëri-tjetrit vendet socialiste duhet të jenë vëllazërore, pa interes. Ne nuk u kemi dhënë ndihmë ekonomike vendeve socialiste, se s'kemi pasur mundësi, por, kur ka qenë rasti, aq sa ka qenë fuqia jonë ekonomike edhe kemi dhënë. Por e vërteta është se Partia jonë e Punës u ka dhënë dhe u jep një ndihmë shumë të madhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare në tërësi dhe vendeve socialiste në veçanti me politikën e saj të drejtë e konsekuente, me luftën që ka bërë e bën për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, me qëndrimet e saj parimore e të guximshme.

*Pastaj shoku Enver Hoxha, pasi foli për qëllimet armiqësore të N. Hrushovit dhe pasuesve të tij në Mbledhjen e Bukureshtit e në atë të Moskës, si dhe për qëndrimin revolucionar të Partisë sonë në këto mbledhje, tha:*

Marksizëm-leninizmi nuk do t'i lejojë të qëndrojnë për shumë kohë me maska në fytyrë ata që tradhtojnë parimet e tij të pavdekshme. Këtë e provon jeta. Edhe Titoja për një farë kohe mundi të maskohej si marksist, por pastaj iu gris maska dhe i doli në shesh fytyra e vërtetë, tradhtar i marksizëm-leninizmit, dhe grupi i tij agjenturë e imperializmit e kryesisht e imperializmit amerikan.

Revizionistët jugosllavë janë shumë të djallëzuar dhe bëjnë shumë manovra të holla për të fshehur vepërimtarinë e tyre antimarksiste. Megjithatë marksizëm-leninizmi i zbuloi dhe i quajti ashtu siç janë: armiq të socializmit dhe të popujve. Prandaj çdo revizionist,

sado maska që të përdorë për të mbuluar fytyrën e vet, shpejt ose vonë, maskat do t'i grisen dhe do të dalë në shesh tradhtia e tij.

Shqipëria, shokë, nuk ka qenë dhe kurrë nuk do të jetë e izoluar, ajo ka miq të fortë dhe të fuqishëm. Sa për mbështetjen ekonomike që ka të bëjë me realizimin e planit tonë të tretë pesëvjeçar, kjo është siguruar plotësisht. Sipas sinjalizimeve që kishim nga qëndrimet që mbanin ndaj Partisë dhe vendit tonë disa udhëheqës të vendeve socialiste, Partia jonë parashikoi vështirësitë që ata do të na nxirrnin dhe mori masa që realizimi i planit të sigurohej.

Masat që janë marrë e do të merren duhen vënë në jetë, duhet luftuar me vetëmohim kundër vështirësive dhe me besim të plotë në forcat tona. Ne do të fitojmë, se jemi në rrugë të drejtë. Realizimi i planit të tretë pesëvjeçar ka një rëndësi të madhe jo vetëm nga pikëpamja ekonomike, sepse do të ngrejë më tej mirëqenien materiale të popullit tonë, por ka rëndësi të madhe edhe nga ana politike për t'u dhënë një grusht të gjithë atyre që nuk na e duan të mirën dhe për t'u treguar se edhe pa ju planin ne e realizuam, jetën e popullit e përmirësuam, në qytete i dyfishuam shtëpitë e banimit, te ne asgjë nuk ka ndryshuar në politikë dhe në ideologji, vetëm ju keni ndryshuar. Të gjitha fitoret tona demaskojnë vijën tuaj antimarksiste.

Prandaj ta forcojmë vigjilencën revolucionare. Në radhë të parë të forcojmë jetën e brendshme të organizatave-bazë të Partisë, ku të punohet me ngulm që të zhduken edhe grindjet më të vogla që mund të ketë midis disa komunistëve dhe punonjësve, veçanërisht në

këto kohëra, sepse armiku përpiqet të kapet edhe pas fërkimeve më të vogla dhe më të zakonshme që mund të ndodhin në radhët tona, t'i fryjë ato për të krijuar përçarje dhe për të penguar rrugën e drejtë të Partisë sonë.

Prandaj të pastrohen sa të jetë e mundur me mirëkuptim meritë dhe grindjet e vogla personale në organizatën-bazë të Partisë dhe jashtë saj, secili t'i shohë e t'i gjykojë çështjet në kuadrin e përgjithshëm, në interes të Partisë dhe të popullit. Pra ta ruajmë të pastër Partinë. Të mbahet kurdoherë lart hovi revolucionar në punë, askush të mos ketë frikë për të kritikuar cilindo qoftë që gabon. Ata që kritikojnë ta gjykojnë kritikën e tyre nën prizmin e interesit të madh të atdheut dhe të mos i mendojnë çështjet gabim duke u nisur nga mbeturinat mikroborgjeze. Kush gabon sado pak, të mendojë se gabimi i tij vërtet mund të jetë i vogël, po ai dëmton interesat e mëdha të atdheut dhe të popullit, prandaj të dalë para Partisë me auto-kritikë dhe të zhduket gabimi.

Të gjithë e njohin dhe e kanë të qartë vijën e drejtë të Partisë sonë. Momentet na diktojnë nevojën që të jemi të kujdesshëm si asnjëherë. Prandaj të kihet kujdes që një fjalë që bie trosh, që nuk është në vijën e Partisë dhe në interes të popullit, jo vetëm që nuk duhet ushqyer, por duhet reflektuar rreth saj, përse e tha ai këtë fjalë, ç'e shtyri që e tha etj. Me një fjalë duhet vrarë mendja. Po të jetë njeri i ndershëm, patriot dhe njihet në jetë për qëndrimet dhe për punën e tij të mirë, duhet t'i thuhet: «Vëlla, mos e thuaj më këtë fjalë se nuk tingëllon mirë dhe nuk i shërben

çështjes sonë». Këtë ia themi se ai nuk është armik, ka folur pa të keq, se ashtu e ka dëgjuar. Por në rast se është vagabond, llafazan, intrigant dhe nga ata që sillen rrugëve, kjo fjalë e shprehur prej tij duhet të ketë bishta nga pas. Me një njeri të tillë, ju nuk duhet të mbani atë qëndrim që duhet mbajtur ndaj një njeriu të ndershëm dhe patriot. Një njeri të lig nuk duhet ta trajtoni njëlloj si një patriot. Prandaj kur flet trosh një njeri jo i mirë, të reflektoni, domethënë duhet vigjëlues, se atje diku fle «lepuri», prandaj t'i kapim këta «lepuj» për veshi e t'i vëmë në vendin që meritojnë.

Ju, shokë, që jetoni e punoni në një zonë kufitare, siç është rrethi i Korçës, duhet t'i keni parasysh këto mësimë. Monarko-fashistët grekë punojnë intensivisht kundër vendit tonë dhe vazhdimisht organizojnë komplete. Përpara se të bëjnë sulmin që mendojnë kundër vendit tonë ata dërgojnë nga përtej kufirit diversantë dhe aktivizojnë në veprimtarinë e tyre elementë armiq. Prandaj të forcohet vigjilenca revolucionare e komunistëve dhe e popullit dhe të mobilizohen të gjitha forcat tona kundër çdo veprimtarie armiqësore, në mënyrë që armiqtë të jashtëm e të brendshëm t'u bëhet e pamundur veprimtaria kundër popullit dhe atdheut tonë.

Gjithë popullsia e krahinës suaj është karakterizuar kurdoherë nga një patriotizëm i madh, jo vetëm tani që na ka edukuar Partia, por gjatë gjithë historisë populli i rrethit të Korçës ka qenë një popull patriot, ka luftuar për Shqipërinë dhe në çdo moment ka ditur të godasë dhe të shpartallojë orvatjet e shumta të sho-

vinistëve grekë, të cilët nuk kanë ndërruar asnjë fije nga programi i tyre për aneksimin e rrethit të Korçës dhe të Gjirokastrës, bile kanë pretenduar edhe Vlorën e të arrijnë deri në Elbasan. Për një politikë të tillë të copëtimit të Shqipërisë ka qenë Elefter Venizellosi, për këtë politikë ndaj vendit tonë është edhe i biri i tij Sofokli Venizellosi, pra, ndodh ashtu si thotë proverbi: «Si i ati dhe i biri, kungull e bostan çairi».

Prandaj edhe ne të ndjekim rrugën e stërgjyshëve tanë, por me një ndjenjë patriotizmi e përgjegjësie akoma më të lartë, me një zgjuarsiri më të madhe, sepse rrojmë në një kohë kur Shqipëria nuk është më ajo që ka qenë dikur, por ka ecur shumë përpara, është bërë më e fortë dhe më e lulëzuar se kurrë, masat e popullit janë më të zhvilluara nga çdo pikëpamje dhe kanë në krye Partinë e Punës, e cila i mëson, i edukon dhe i udhëheq me urtësi drejt ndërtimit të jetës së re socialiste, drejt shtimit dhe konsolidimit të fitoreve të arritura.

Puna juaj, pra, duhet të karakterizohet nga një frymë revolucionare dhe mprehtësi e fortë politike, nga një dashuri e madhe për shoqi-shoqin. Komunistët e organizatës-bazë të kooperativës suaj duhet të forcojnë kompaktësinë e tyre dhe çdo gjë të zgjidhet në prizmin e interesit të përgjithshëm.

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

# KOHA E REGJIMIT TË SKLLAVËRISË, E SHTYPJES SË POPULLIT DHE E URISË S'KA PËR T'U KTHYER KURRË NË SHQIPËRI

*Nga biseda me fshatarët e kooperativës bujqësore  
të bashkuar të Lumalasit në rrethin e Korçës*

9 maj 1961

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë,

Është e dyta herë që vizitoj kooperativën tuaj, por punën tuaj e kam parë më shpesh, se duke ardhur shumë herë në Korçë, kam vënë re përparimet që keni bërë. Kjo pasqyrohet edhe në punën e kujdesshme që duket në fushat tuaja dhe që është për t'u lavdëruar.

Ju jeni kooperativistë të zotë, të zgjuar dhe të palodhur në punë. Në krye keni një organizatë partie të shëndoshë dhe një kryesi të fortë, me kryetar të mirë, shokun Zenun Shahollari, që dinë ta organizojnë punën, si duhet, të mobilizojnë si duhet forcat duke bërë që kooperativa juaj të kthehet kështu në një kopësht të bukur. Të ardhurat që ju vijnë nga puna në koopera-

tivë, janë shtuar nga viti në vit dhe si pasojë është përmirësuar jeta e anëtarëve.

Ne, çdo ditë, shohim ndryshimet që pëson fshati ynë socialist. Një nga provat që e vërteton këtë është edhe Lumalasi juaj, i cili ka ecur shumë përpara në krahasim me kohën kur e kam vizituar për herë të parë. Që atëherë ka ndryshuar pamja e arave, keni bërë plot shtëpi të reja që i kanë zbukuruar fshatrat e kooperativës suaj dhe të tjera jeni duke bërë e do të bëni. Por ajo që ka më shumë rëndësi është fakti se ka ndryshuar shumë njeriu në kooperativën tuaj. Ai është bërë më i përparuar, jeton më i lumtur dhe i gëzuar, pa frikë dhe pa halle për të ardhshmen, përkundrazi me një besim të madh në jetë.

Këtu mësova se vitin e kaluar, që, për shkak të kohës së keqe, ka qenë një vit i vështirë për gjithë fshatarësinë, kooperativa juaj, në saje të punës së palodhur të kooperativistëve dhe të organizimit e të drejtimit të mirë, jo vetëm mori prodhime të mjaftueshme, por, duke administruar mirë pasurinë e përbashkët, sidomos në problemin e drithit, ju nuk iu bëtë barrë shtetit dhe as në treg nuk bletë bukë. Kjo është një ndihmë e madhe si për shtetin ashtu dhe për veten tuaj.

Vitin e kaluar kemi pasur thatësi të shumë të madhe. Por Partia dhe Qeveria, që janë të lidhura me popullin si mishi me koskën, morën masa të shpejta për të mos e lënë popullin pa bukë. Veç kësaj, nga Republika Popullore e Kinës na erdhën me dhjetëra mijë tonë drithë. Kështu populli ynë asnjë gjysmë dite nuk vuajti për bukë.



Për këtë vit, shokë, në saje të punës së palodhur të kooperativistëve dhe të kohës së mirë, do të kemi një vit të mbarë bujqësor, pra do të prodhojmë më shumë drithëra buke. Kjo do të thotë që do të përmirësohet më shumë jeta juaj, sepse do të merrni grurë, panxhar etj., më tepër se vjet, do të siguronit të ardhura më shumë. E njëjta gjendje është kudo në Shqipëri.

Veç nuk duhet të harroni se kjo mbarësi ka ardhur në radhë të parë në saje të kolektivizimit, të kësaj rruge të drejtë që i tregoi fshatarësisë Partia jonë. Tani fshati është në rrugën e përparimit, ai ndodhet në kohën e përmirësimit dhe të sistemimit të tokave, në periudhën e ndërtimit të kanaleve ujitëse dhe kulluese. Kudo në Shqipëri, në pjesën dërrmuese fushat janë bërë po kaq të bukura sa edhe në kooperativën tuaj dhe të fshatrave fqinje me ju. Këtë, pra, e bëri kolektivizimi, bashkimi vullnetar i forcave të fshatarësisë sonë, rruga e lavdishme që treguan Lenini dhe Stalini.

Ne e përfunduam në përgjithësi kolektivizimin dhe me këtë korrëm një fitore të madhe që do të na lehtësojë jashtëzakonisht shumë në vitet e ardhshme, kur do të prodhojmë në vend edhe plehra kimike. Me ndërtimin e uzinave të plehrave, në bujqësinë tonë do të ketë ndryshime të mëdha përsa u përket rendimenteve. Në fund të këtij pesëvjeçari sipas masave të marra do të përfundojmë së ndërtuari të dyja uzinat e plehrave kimike dhe kur t'i vëmë në shfrytëzim, kooperativat do të furnizohen me sasi të mjaftueshme plehrash. Kjo do të na ndihmojë që t'i rritim shumë rendimentet, domethënë të sigurojmë prodhime të bollshme. Kësaj

ne do t'ia arrijmë patjetër, ky është qëllimi i Partisë dhe për këtë luftojmë në planet tona.

Plani i tretë pesëvjeçar parashikon zhvillimin e mëtejshëm e të vrullshëm të industrisë. Përveç uzinave të plehrave kimike, do të ndërtohen objekte të tjera të rëndësishme, si uzina për prodhimin e bakrit, një kombinat tjetër tekstili, më i madh nga ai që kemi, si dhe dhjetëra vepra të tjera.

Natyrisht këto të mira nuk bien nga qielli, ne ato do t'i ngremë me duart e arta të punonjësve tanë dhe me ndihmën e miqve tanë, të Kinës së madhe etj. Por ashtu si gjer tani, kryesorja e kryesoreve do të jetë puna, mundi, zgjuarsia dhe aftësitë e punëtorëve, të specialistëve dhe të kuadrove tanë, prandaj për ngritjen e këtyre veprave të rëndësishme duhet të punojmë më shumë.

Për kuadro ne tani nuk jemi si në vitet e para, kur veterinerët, agronomët, inxhinierët etj., numëroheshin me gisht, tani ata janë shtuar. Planet tona për përgatitjen e kuadrove janë shumë të mëdha, prandaj duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i sigurojmë, disa duke i përgatitur me kurse pa i shkëputur nga puna, disa duke i dërguar vetë kooperativa në shkolla me shpenzimet e saj etj., në mënyrë që, në fund të pesëvjeçarit, të kemi një numër të konsiderueshëm kuadrosh të lartë e të mesëm për bujqësinë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Ju fshatarët keni një eksperiencë shumë të madhe në punët e bujqësisë, prandaj agronomët e mesëm e të lartë dhe specialistët e tjerë të bujqësisë duhet të përfitojnë nga eksperiencia juaj. Po duhet pasur parasysh

se dituria është shumë e gjerë, sa të rrojë njeriu, aq më shumë mëson. Sot pa mësim, pa shkollë asgjë nuk bëhet. Pra në rradhë të parë t'i mësojmë të rinjtë dhe të rejat, sepse kështu do të bëjmë që të lulëzojnë fshatrat dhe qytetet tona. Prandaj ju të moshuarit mos harroni detyrën për të dërguar djemtë dhe vajzat në shkolla. Sigurisht kjo nuk arrihet menjëherë; ata do t'i dërgoni gradualisht të mësojnë dhe pastaj të kthehen në fshat dhe ta bëjnë atë aq të bukur, sa askujt të mos i shkojë në mendje të lërë kooperativën dhe të vejë në qytet, në Korçë për shembull. E përse të largohet nga kooperative, kur këtu ai të ketë kinemanë, fushën sportive, orkestrën, korin, estradën etj.?

Me punën tonë ne do ta bëjmë fshatin si qytetin. Do të vijë një ditë që djemtë dhe vajzat nuk do të kërkojnë të largohen nga fshati, sepse jo vetëm që këtu do të ngrihen ato që përmenda, por këtu të tërheqin fort edhe ajri i pastër e bukuritë e rralla të natyrës sonë. Veç këtyre, kolektivizimi krijon kushte për një të ardhshme gjithnjë më të lumtur e të begatshme. Në rrethin tuaj, ku lëvizja kooperativiste është më përpara, kjo do të realizohet më shpejt. Ju keni qenë shembull, keni qenë pionierët e kësaj lëvizjeje në vendin tonë. Shumë nga fshatarët tuaj pararojë kanë shkuar në rrethet e tjera si në Durrës, në Kavajë, në Tiranë dhe atje janë bërë drejtues kooperativash e kanë punuar aq mirë, saqë populli nuk i lë më të largohen andej, sepse i do si njerëzit më të afërt të tij.

*Në vazhdim të bisedës së tij, shoku Enver Hoxha, pasi foli mbi disa probleme të gjendjes ndërkombëtare, tha:*

Ju e dini se rreth e rrotull vendi ynë ka armiq, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë që dërgojnë vazhdimisht diversantë dhe komplotojnë kundër pushtetit tonë. Ata kanë ngrënë dhe kurdoherë do të hanë grushte të rënda nga populli, pushteti popullor, Partia jonë e Punës. Por armiqtë nuk heqin dorë nga synimet e tyre, prandaj edhe ne t'i kemi sytë kurdoherë hapur dhe, kurdoherë që armiku të ngrejë veshët, ne t'i bicom me grusht kokës, se ata kanë për qëllim të kthejnë regjimin e skllavërisë, t'i rrëmbejnë popullit lirinë dhe tokën. Por koha e tyre mbaroi, nuk kthehet më, tani është koha e sundimit të popullit, e triumfit të socializmit.

Prandaj, në këtë kohë të favorshme për ne dhe kur armiqtë, të dëshpëruar, mobilizohen të na dëmtojnë, të shtojmë dashurinë dhe unitetin me njëri-tjetrin, të jemi të lidhur ngushtë rreth Partisë, në mënyrë që armiku të mos gjejë dot asnjë të çarë në radhët tona. Secili të mendojë interesin e madh të Shqipërisë, të popullit, të kalamanëve dhe të gjithë brezit tonë të ri, që ata të mos shohin ato halle, mjerime e vuajtje që kemi hequr ne. Për këtë lufton Partia dhe çdo vit ne ecim përpara. Pra, e përsëris, të jemi të bashkuar rreth Partisë, sepse pa Partinë e vijën e saj marksiste-leniniste asnjë fitore nuk arrihet.

Shikoni sa shumë e do populli Partinë e tij, si përgjërohet ai për të. Partia i ka këmbët në tokë, rrënjët i ka të thella në zemrën e njerëzve, sepse ato që tha Partia u realizuan dhe po realizohen. Dhe Partia nuk ia bëri popullit gjendjen shesh me lule, nuk i tha se të gjitha

këto që u realizuan do të bëheshin me një të rënë të borisë. Gjatë luftës Partia i tha popullit se do të vuajmë, do të bëjmë sakrifica, ndërsa pas Çlirimit i tha se, që të sigurojmë një jetë më të lumtur, duhet të punojmë e të derdhim djersë, duhet të jemi të gatshëm e të ndër-gjegjshëm që të japim edhe jetën, po të jetë nevoja. Dhe populli e përqafoi me gjithë zemër rrugën e Partisë, se kishte besim të madh te ajo dhe ky besim u vërtetua në jetë, në luftë e në punën ndërtimtare. Populli ynë me të drejtë thotë, nuk ka si Partia jonë, sepse vazhdimisht si tha Partia, ashtu u bë. Realitetin e ndritur të Shqipërisë së re e shohin edhe ata që nuk ia kanë dashur të mirën Partisë dhe vetë jeta i detyron të pranojnë se këto që i ka sjellë Partia popullit dhe atdheut në këta 16-17 vjet çlirim, ata, kur ishin në fuqi, jo vetëm s'mund t'i bënin dot kurrë, por as mund t'i ëndërronin dot. Ata asgjë nuk bënë për këtë vend, por vetëm hanin e pinin duke zhvatur mundin e popullit fukara dhe mbushnin qypet me flori, duke nxjerrë në ankand vetë lirinë dhe pavarësinë e atdheut. Pra asgjë e mirë dhe e vlefshme nuk i ka mbetur sot Shqipërisë nga koha e tyre e perënduar një herë e përgjithmonë. Çdo gjë të re, të fuqishme e të bukur, që e shohim tani kudo, populli i udhëhequr nga Partia e ndërtoi në vitet e çlirimit.

Pikërisht ky realitet i gjallë i detyron ata që më parë i pinin gjakun popullit, të kuptojnë se forca e kësaj Partie është e pamposhtur, prandaj të vënë mend e të thonë: «Të ulim kokën e t'i shtrohemi punës se rrënjët kësaj Partie nuk kemi forcë t'ia shkulim dot».

Ju uroj me gjithë zemër të realizoni me sukses planin që keni përpara dhe i mbushçi hambarët plot!

Të rrojë Partia jonë e Punës!

Rrofshin kooperativistët e kooperativës së bashkuar të Lumalasit!

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtlime, sipas origjinalit  
që gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## **KUSH PËRPIQET T'I BEJË VARRIN SHQIPËRISË, DO TË BJERË VETË BRENDA**

*Fjala para kuadrove të Partisë, të pushtetit  
dhe të ushtrisë në rrethin e Korçës*

**9 maj 1961**

Me rastin e vizitës sime në rrethin tuaj për t'u takuar me punëtorët dhe me fshatarët e Korçës, për të njohur kërkesat dhe dëshirat e tyre dhe për t'u informuar si shkojnë punët këtu, mendova që, para se të largohesha, të merrja edhe një takim me kuadrot e Korçës.

Gjithë Partia është në dijeni të problemeve më të rëndësishme politike, ideologjike dhe ekonomike të vendit tonë. Komiteti Qendror i Partisë e ka pasur dhe e ka për detyrë që ta mbajë kurdoherë në korent Partinë për problemet dhe për ngjarjet më me rëndësi. Ajo duhet të jetë e informuar për çdo gjë, sepse vetëm kështu do të mund të luftojë dhe të kryejë detyrat e saj të mëdha në çdo drejtim, për ta udhëhequr popullin me sukses në rrugën e ndërtimit të socializmit.

Natyrisht, ju jeni në dijeni për çështjet kryesore të

planit të tretë pesëvjeçar, që u vendos nga Kongresi IV i Partisë. Gjatë kësaj kohe ju kanë rënë në dorë edhe materialet e këtij Kongresi, të cilat i keni lexuar dhe i keni studjuar: Jam i sigurt se ju do t'i shfrytëzoni këto materiale për të mobilizuar dhe për të organizuar masat punonjëse, duke qëndruar ju vetë në radhët e para të luftës për realizimin e detyrave të pesëvjeçarit.

Një nga qëllimet e realizimit të planit të tretë pesëvjeçar është rritja e fuqisë ekonomike të vendit, që popullit t'i japim më shumë ushqime, banesa, veshmbathje etj. Nëpërmjet luftës për realizimin e planit të kalitimit Partinë, kuadrot dhe të gjitha masat punonjëse, të ngremë aftësinë e tyre në drejtim të organizimit dhe të shtimit të prodhimit. Çështje tjetër me rëndësi është që Partia ta mbajë popullin kurdoherë në dijeni për problemet e mëdha politike, të dijë ta orientojë drejtë atë dhe ta armatosë për të qenë i aftë t'i bëjë ballë çdo situatë aktuale apo në perspektivë.

Ne konstatojmë me kënaqësi të jashtëzakonshme që Partia jonë heroike, duke ndjekur një vijë të drejtë, është kalitur, është bërë një Parti e fortë, e çeliktë, e zonja ta udhëheqë popullin në rrugën e ndritur të socializmit. Është fakt se pas Kongresit IV të Partisë është ngjallur në masat punonjëse një entuziazëm i paparë. Kjo shprehet në punën për realizimin me sukses të planit të vitit 1961. Sikundër e keni mësuar nga shtypi, plani i tremujorit të parë të këtij viti është realizuar në të gjithë zërat, ai është tejkaluar gati në të gjitha ndërmarrjet. Ky është një sukses shumë i madh që zakonisht nuk e arrinim që në tremujorin e parë.



Përsa u përket vështirësive, sidomos mungesave materiale, ne kemi pasur edhe më përpara, por veçanërisht këtë vit këto vështirësi kanë qenë më të mëdha. Megjithatë punonjësit tanë, të udhëhequr nga Partia, janë mobilizuar në mënyrë të pashembullt dhe, si rezultat, boshllëqet që lindnin i kanë plotësuar me përpjekjet e tyre të mëdha. Unë mund t'ju informoj për shifrat parraprake të studimit mbi problemin e kursimeve, megjithëse akoma nuk është arritur në konkluzione përfundimtare. Nga llogaritë që kanë bërë ekipet e dërguara në rrethe për çështjen e kursimeve, del se është arritur të ekonomizohen mbi dy miliard lekë. Kjo është një shumë e konsiderueshme. Megjithatë punonjësit po i vazhdojnë përpjekjet për t'i shtuar kursimet, për të bërë sa më shumë ekonomi, pa cenuar planin. Një punë e lavdërueshme është bërë sidomos për të shtuar kursimet nga importi. Kjo tregon se Partia e ka kuptuar drejt situatën e vështirë të importimeve.

Të gjithë punonjësit jo vetëm kanë realizuar kursime, po kanë zhvilluar në një shkallë të lartë përpjekjet e tyre edhe për racionalizime dhe kanë bërë që t'u pritët hovi prirjeve të disave për sa më shumë përfitime personale në lekë. Në këtë çështje, kanë pasur faj bashkimet profesionale që nuk kanë ditur t'i mobilizojnë si duhet punonjësit dhe të mos lejonin që të binte vrulli i tyre për shpikje dhe për racionalizime. Por Partia e kapi menjëherë këtë problem dhe tani kjo punë ka marrë një hov të madh. Sot nuk ka ndër marrje ekonomike, ofiçinë, park automobilistik, kantier ndërtimi etj., ku punonjësit të mos mendojnë e të mos punojnë për kursime. Në shumë ofiçina me të njëjtat

mjete tani bëhen shumë më tepër pjesë këmbimi, të cilat deri dje kërkoheshin me forcë të vinin nga jashtë.

Ne shohim ndërmarrje si ajo e qymyrgurit në Mborje-Drenovë që përpiqet të prodhojë në oficinën e vet pjesë këmbimi që i nevojiten, bile të prodhojë edhe për ndërmarrje të tjera. Kjo tregon se shumë ndërmarrje ekonomike të vendit tonë e kanë kuptuar drejt frymën e Kongresit IV të Partisë dhe janë mobilizuar për ta vënë atë në jetë. Tani na bie detyra që këtë vrull, që shihet kudo, ta mbajmë gjallë, ta ngremë edhe më lart.

Partia jonë është e fortë, sepse ajo gëzon besimin e plotë të masave punonjëse. Ajo nuk ua fsheh atyre realitetin, përkundrazi u ka treguar dhe u tregon kurdoherë qartë vijën politike të saj.

Për arsye të qëndrimeve të padrejta revizioniste të disa udhëheqjeve të vendeve socialiste, gjatë këtyre kohëve të fundit janë krijuar situata të vështira në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Në këto situata të vështira Partia jonë ka mbajtur qëndrim të drejtë, ajo ka kritikuar me forcë, në rrugën marksiste-leniniste, në radhë të parë udhëheqjen sovjetike dhe të gjithë ata që e pasojnë.

*Pasi foli për Mbledhjen e Bukureshtit dhe atë të Moskës të vitit 1960 dhe mbi disa çështje ndërkombëtare, siç janë iluzionet e shtypit sovjetik që shkruajnë se Kenedi di të bëjë politikë elastike, jo ashtu si Ajzenhaueri, mbi nënshkrimin e traktatit të paqes me RD Gjermane, shtimin e armatimit nga RF Gjermane, manovrat e imperializmit amerikan për të mbuluar veprimet e tij agresive, shkeljet e Deklaratës së Moskës nga*

*ana e revizionistëve sovjetikë etj., shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Jeta po provon vazhdimisht drejtësinë e vijës së Partisë sonë e të PK të Kinës si përsa i përket qëndrimet që duhet mbajtur ndaj imperializmit, ashtu edhe kundrejt revizionistëve jugosllavë dhe revizionistëve modernë.

Për qëndrimet tona ndaj revizionistëve jugosllavë udhëheqësit sovjetikë na kritikojnë se flasim shumë kundër tyre dhe se jemi gjoja gjaknxehëtë. Jo, ne nuk jemi aspak gjaknxehëtë. E vërteta është se revizionistët jugosllavë si agjentë besnikë të imperialistëve amerikanë duhet të luftohen dhe të demaskohen me të gjitha forcat. Kurse udhëheqësit sovjetikë na «këshillojnë» të mos flasim, por të heshtim. Sipas tyre, ata që nuk luftojnë kundër revizionistëve jugosllavë, na qenkan marksistë, kurse ne qenkemi dogmatikë. Revizionistët jugosllavë le të flasin, le të bëjnë propagandë në favor të imperializmit dhe kundër socializmit, kurse ne të mos flasim kundër vijës së tyre revizioniste, predikojnë udhëheqësit e vendeve socialiste të Evropës. Të bukur «këshillë»!

Ne nuk jemi dakord me udhëheqësit e PK të Bullgarisë, që jo vetëm nuk luftojnë kundër revizionistëve jugosllavë, por kanë hapur edhe kufijtë shtetërorë bullgaro-jugosllavë, ku me mijëra njerëz në javë hyjnë e dalin nga të dyja vendet. Vetë Zhivkovi me gojën e tij ka thënë se jugosllavët dërgojnë në Bullgari agjentë dhe spiunë nga kufiri e kanë arritur sa t'u rrëmbejnë edhe dy emigrantë politikë jugosllavë. Mirë, «shoku» Zhivkov le të bëjë si të dojë në vendin e tij, por të

paktën të mos na kritikojnë pse jemi vigjilentë ndaj revizionistëve jugosllavë. Na kritikojnë se duan që edhe ne të veprojmë ashtu si bëjnë ata, por ne nuk do ta bëjmë kurrë një gjë të tillë.

«Pse keni frikë nga jugosllavët, na thonë udhëheqësit sovjetikë, ju mbrojmë ne, në rast se sulmoheni». Ne e dimë mirë se në një rast të tillë popujt e Bashkimit Sovjetik e popujt e tjerë do të na mbështetin, por ne nuk do t'ia lejojmë vetes në asnjë mënyrë që Shqipëria të bëhet një Hungari e dytë, ku shumë komunistë i varën në shtyllat e elektrikut. Detyra e marksistëve është të jenë kurdoherë vigjilentë dhe të luftojnë pa mëshirë kundër çdo armiku, edhe kundër revizionizmit modern. Kështu e kuptojmë ne këtë çështje.

Pra, rruga jonë është e qartë, vija jonë është e drejtë. Prandaj gjithë Partia është mobilizuar për zbatimin e kësaj vije.

Të themi realitetin, jo të mburremi, po qëndrimi heroik i Shqipërisë ka fituar admirimin e të gjithë komunistëve dhe të patriotëve kudo në botë, sepse populli ynë është ndeshur ballë për ballë me imperialistët, italianë, gjermanë, amerikanë, anglezë, francezë, me revizionistët jugosllavë dhe me monarko-fashistët grekë. Edhe reaksionarët e dinë tanimë qëndrimin e udhëheqësve sovjetikë e të disa vendeve të tjera socialiste dhe çuditën se si mban një qëndrim të guximshëm Shqipëria e vogël. Natyrisht, ata ashtu gjukojnë, prandaj çuditën, ata nuk mund ta kuptojnë forcën e madhe të marksizëm-leninizmit, forcën e pathyeshme edhe të një populli të vogël, kur ai është në unitet të plotë me Partinë e tij, me vijën e saj të drejtë marksiste-leniniste.

Shembulli i Kubës këto kohët e fundit ka rëndësi, jo vetëm për faktin që ajo nuk u mposht, por u vërtetua edhe një herë ajo që ka thënë Partia jonë se imperia- lizmi amerikan është agresiv dhe përgatitet për luftë, prandaj duhet të jemi vigjilentë dhe ta mbajmë barutin të thatë kundër imperializmit dhe veglave të tij.

Kjo vërtetoi edhe një gjë tjetër, se imperializmi dhe borgjezia ndërkombëtare nuk e dorëzojnë vullnetarisht pushtetin me rrugë paqësore, pa ua marrë me forcë. Përkundrazi, edhe atje ku proletariati e ka marrë pushtetin, ajo organizon luftë civile për ta kthyer përsëri atë, dhe jo t'i thotë Palmiro Toliati: «Ç'prisni ju, komunistët, ejani merreni pushtetin se ju dini të drejtoni dhe të mbronin interesat e Italisë».

Por në Itali po bëhet me tërë kuptimin e fjalës një punë fund e krye revizioniste. Udhëheqësit e Partisë Komuniste të Italisë shpallën se janë me Mbledhjen e Moskës, por në organizatat e partisë, atje, Deklarata e Moskës e 81 partive nuk ka shkuar fare. Akoma nuk ishte tharë boja e firmës që kishte vënë Toliati në këtë Deklaratë dhe ky i dërgoi Titos një telegram urimi e miqësor dhe as që ngurroi fare në një fjalim të tij të bënte një provokacion si ai i Ulbrihtit<sup>1</sup> kundër Partisë sonë. Këto akte tregojnë qëndrimin mospërfillës ndaj Deklaratës së Moskës.

Këto provokacione u bënë me qëllime të caktuara, por Partia jonë nuk ra në kurthin e tyre. Qëllimi ishte që edhe ne t'u përgjigjeshim haptazi dhe publikisht sulmeve të tyre, ta fillonim ne të parët polemikën, që

<sup>1</sup> Shih Enver Hoxha. Vepra, vëll. 20, f. 11.

kështu ata të gjenin shkak për të hapur luftë kundër Partisë sonë, duke e cilësuar si dogmatike. Pastaj të dilte Hrushovi që gjoja lufton si marksist me vendosmëri edhe revizionizmin, edhe dogmatizmin. Komiteti Qendror i Partisë sonë nuk ra në këtë provokacion, po i drejtoi një letër KQ të PSB të Gjermanisë dhe u mjaftua me kaq për këtë çështje. Kur provokacioni me Ulbrihtin nuk u ndezi, atëherë menduan ta bëjnë këtë nëpërmjet udhëheqjes së një partie të një vendi që nuk ishte në kampin socialist dhe gjetën PK të Italisë. Po provokacionit të Toliatit ne nuk iu përgjigjëm fare që të mos ta ketë Hrushovi si «një argument» kundër nesh në kongresin XXII që është duke përgatitur. Do të vijë koha që ne t'u japim përgjigjen, se të gjitha këto janë të shënuara në defter.

Përsa i përket realizimit të planit të tretë pesëvjeçar ai është i siguruar plotësisht. Republika Popullore e Kinës na akordoi kredinë për të cilën ju keni dijeni. Ne do të mobilizohemi me të gjitha forcat që ky plan të realizohet dhe të tejkalohet duke u mbështetur kryesisht në mundësitë dhe në rezervat tona të brendshme, në patriotizmin dhe në hovin revolucionar të masave tona punonjëse.

Hrushovi me shokë po ndjekin rrugën e presioneve ekonomike që ne e dimë mirë se ku synojnë. Por do të vijë koha që akti i tyre ndaj nesh të dënohet dhe qëllimit ata nuk do t'ia arrijnë kurrë, sepse Shqipëria, si kurdoherë, nën udhëheqjen e Partisë ecën në rrugën e marksizëm-leninizmit. Populli ynë me siguri do ta realizojë planin e tretë pesëvjeçar, do ta përmirësojë nivelin e jetesës së punonjësve dhe vendi ynë do të

bëhet një shembull i shkëlqyer për të gjitha ato vende që duan të ecin në rrugën marksiste-leniniste.

Detyra jonë është që të marrim të gjitha masat për organizimin e mirë të punës, për sigurimin e punëtorëve, të mjeshtrove dhe të teknikëve, me qëllim që objektet që parashikon pesëvjeçari ynë të realizohen në kohën e duhur. Dhe ne ato do t'i realizojmë patjetër, se kemi forca dhe prova të shumta e bindëse, si dhe aftësitë dhe vendosmërinë e punonjësve tanë.

Prandaj ne kemi baza të shëndosha për t'i kryer veprat e pesëvjeçarit të tretë. Ndërtimi i të gjitha objekteve ka rëndësi të madhe për ekonominë tonë, po rëndësinë më të madhe e ka ngritja e metalurgjisë së zezë. Krijimi i kësaj dege të industrisë së rëndë ka rëndësi të madhe për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë. Hekuri në ekonomi është si buka që hamë, ai hyn kudo. Në një të ardhshme jo të largët ne do të kemi uzinat për përpunimin e tij.

Metalurgjia dhe uzinat e plehrave kimike kanë rëndësi të madhe për zhvillimin e forcave prodhuese të vendit tonë, prandaj bashkë me të gjitha objektet e tjera të pesëvjeçarit, ne do të vëmë të gjitha forcat që t'i ngremë. Ja, në Berat do të ngremë një tjetër kombinat tekstili, si dhe shumë vepra të tjera. Shokët kinezë na kanë premtuar të na ndihmojnë për të ngritur 25 objekte. Ata janë treguar të gatshëm, si internacionalistë të vërtetë. Krejt ndryshe është qëndrimi i udhëheqjes revizioniste sovjetike ndaj vendit tonë. Për shembull, shumë skandaloz ishte vendimi i Hrushovit për të mos na ndihmuar me bukë. Ai ishte një shantazh i hapur i tij. Aq poshtë ra udhëheqja hrushoviane në

këtë çështje, sa na kërkuan që një sasi drithi t'ua blenim me flori. Për këtë, shokë, ne disponojmë dokument zyrtar. Ky dokument që ra në dorën tonë, atyre u dogji aq shumë sa na e kërkuan t'ua kthenim, po ai ruhet në arkivat tona dhe është një akuzë shumë e rëndë kundër udhëheqjes sovjetike me Hrushovin në krye. Ose kur ishte fjala që uzinën e plehrave fosfatike të na e bënin çekët, Mikoiani na nxirrte një mijë pengesa për sigurimin e lëndës së parë të fosforiteve. Shokët kinezë na thanë të mos kemi merak për lëndë të parë se na e sigurojnë ata.

Partia duhet ta dijë se plani ynë i tretë pesëvjeçar është i mbështetur plotësisht në mundësitë tona të brendshme, përse u përket ndihmave nga jashtë ato mbeten gjithnjë ndihma. Tani varet çdo gjë nga ne, prandaj duhet të mobilizohemi dhe Partia e populli është fakt që janë mobilizuar tërësisht.

Edhe këtu në rrethin tuaj vura re se mobilizimi i punonjësve është i mirë. Gjatë 4 muajve të parë të këtij viti ju keni realizuar planin gati kudo, me përjashtim të ndërmarreve të tregtisë shtetërore dhe të asaj kooperativiste. Edhe në këtë sektor xhiroja është realizuar si total, por ka boshllëqe në mjaft zëra. Prandaj punonjësit e tregtisë shtetërore dhe ata të kooperativave të konsumit duhet të bëjnë më shumë përpjekje në këtë drejtim.

Përse u përket kursimeve rrethi juaj ka dalë me një shifër të kënaqshme. Sigurisht kjo shifër nuk është përfundimtare, se punonjësit do të gërmojnë akoma dhe do të nxjerrin burime të reja kursimesh.

Bujqësia e rrethit tuaj dihet që është e përparuar.



Fushat tuaja, duke u punuar mirë, po lulëzojnë. Unë vizitova kooperativat bujqësore të Pojanit dhe të Lumalasit dhe vura re me kënaqësi ndryshime të mëdha si në fushat, por sidomos te njerëzit që janë plot entuziazëm dhe përgjërohen për Partinë. Fushat atje lulëzojnë dhe këtë vit rendimentet e kulturave të ndryshme jo vetëm do të realizohen, por edhe do të tejkalohen. Në Lumalas kryetar është një djalë shumë i mirë dhe sekretari i organizatës së Partisë një djalë energjik. Po kështu edhe në Pojan entuziazmi i masave kooperative ishte i madh, arat i kishin punuar për bukuri, kulturat qenë në gjendje shumë të mirë. Atje tokat i kishin sistemuar mirë dhe të rregulluara edhe me kanale kulluese e ujitëse. Kjo do të thotë se kooperativat tuaja tani janë duke hyrë në rrugën e një bujqësie me të vërtetë të përparuar.

Sukseset në rrethin tuaj tregojnë se organizata e Partisë e rrethit është e fortë, si në qytet ashtu edhe në fshat, se vija e Partisë është e drejtë, këtë e vërteton jeta dhe puna e saj. Drejtësia e vijës së Partisë duket edhe në lidhjet e Partisë me popullin tonë. Prandaj t'i forcojmë akoma më shumë këto lidhje, se armiqtë nuk flenë. Armiqtë brenda vendit nuk kanë forca të mëdha, por vëzhgojnë me kujdes ku të gjejnë ndonjë të çarç, mosmarrëveshje ose pakënaqësi, të kapen pas tyre për t'i shfrytëzuar e për t'i zmadhuar ato, po të ketë mundësi. Por armiqtë, që do të orvaten të na dëmtojnë, ne do t'u biem kokës kurdoherë.

Por rruga më e drejtë është që para këtyre situatave që zhvillohen në favorin tonë, pavarësisht nga vështirësitë që hasim dhe që do të hasim edhe në të

ardhshmen, ne duhet t'i forcojmë sukseset tona dhe të luftojmë çdo dobësi dhe sëmundje që shfaqet. Është shumë e rrezikshme kur një sëmundje nuk njihet, por, kur e dikton atë, puna qëndron ndryshe. Sigurisht për mjekun ka vështirësi, por ai e kuron me durim dhe e zhduk sëmundjen. Çështja është, pra, që në këto situata jo vetëm anëtarët e Partisë duhet të jenë shembull, por këta duhet të frymëzojnë edhe masat, që gjërat e vogla, grindjet e mosmarrëveshjet me njëri-tjetrin të zhduken dhe të mos bëhen. në asnjë mënyrë pengesë për ecjen tonë përpara, të mos u jepet shkak armiqve të maskuar të spekulojnë, të mos u lihet asnjë mundësi njerëzve të pandërgjegjshëm të livadhisin dhe të pengojnë përpërimin tonë, t'u krijojnë vështirësi Partisë dhe pushtetit tonë popullor.

Prandaj, në organizatat-bazë të Partisë të shumëfishohet kjo frymë revolucionare që konstatohet kudo për zgjidhjen sa më mirë dhe sa më shpejt të të gjitha problemeve. Edhe grindjet e vogla që mund të lindin midis njëri-tjetrit e që e kanë burimin në mbeturinat mikroborgjeze në Parti, duhet të luftohen e të pastrohen me frymë revolucionare, ashtu si është vepruar kurdoherë, por ca më tepër tani ata që bëjnë gabime duhet t'i kuptojnë ato shpejt e drejt dhe t'i ndreqin.

Duhet të kihet kujdes që gjërat e vogla të mos futen në kallëpe politike ose ideologjike, se veprime të tilla e dëmtojnë Partinë. Anëtari i Partisë e mbron Partinë e vet, se ajo është jeta e tij, po mund të ndodhë që një njeri, për një gjë të vogël, të kundërshtojë në organizatën-bazë edhe një propozim të lavdërueshëm të një shoku me të cilin ai grindet, ose që ka ndonjë

mëri të vogël. Mirëpo sado i mirë që mund të jetë propozimi, mëria e shtyn atë që të thotë se ai nuk është i drejtë, por është i gabuar, i perealizueshëm etj. Kështu krijohet një farë konfuzioni në organizatën-bazë, e cila në vend që t'i gjykojë problemet në një frymë partie të shëndoshë e luftarake, humbet kohën kot, problemet nuk zgjidhen, grindjet thellohen.

Prandaj të kemi kujdes në këto gjëra, sepse armiku tenton të na godasë në të gjitha drejtimet, ai përpiqet të shfrytëzojë çdo dobësi tonën, po i doli, mirë për të, po s'i doli, ai tërhiqet. Ne kurdoherë kemi qenë gjeografikisht të rrethuar, po tani ka ardhur koha që të jemi më shumë vigjilentë.

Anëtarët e Partisë duhet të jenë të zgjuar dhe të bëjnë dallime midis njerëzve. Nuk përjashtohet rasti që një person, me një të kaluar të pastër, për një moment të thotë edhe ndonjë fjalë që nuk tingëllon si duhet. Ky njeri duhet të korrigjohet duke u këshilluar, sepse ai nuk e thotë atë me ndonjë qëllim të keq dhe këtë e vërteton e gjithë e kaluara e tij si njeri i mirë, por se nuk e ka kuptuar drejt atë që tha. Por, në qoftë se një pikëpamje e shtrembër del nga goja e një vagabondi, e një njeriu me qëndrim të keq, ose e një dembeli, që kurdoherë i shmanget punës, këtë rast mos e lini të kalojë, sepse shfaqja e një pikëpamjeje të tillë ka një qëllim të caktuar. Këtyre shfaqjeve t'u kush-toni kujdes, sepse nga një gjë e vogël mund të dalë një punë e rrezikshme. Shumë veprime armiqësore janë zbuluar nga gjërat e vogla. Ato, pra, i ka zbuluar vigjilenca e Partisë, ajo ka kapur fillin e çështjes dhe ka hedhur dorën mbi armiqtë.

Ju do të mësoni mbi zhvillimin e gjyqit që do të hapet së shpejti në Tiranë për tradhtarin Teme Sejko me shokë. Veprimtaria e këtyre tradhtarëve ka qenë një punë shumë e rrezikshme; ata organizonin një komplot të rrezikshëm të kurdisur nga monarko-fashistët grekë, revizionistët jugosllavë dhe Flota VI Amerikane, së bashku me tradhtarët shqiptarë që janë në Jugosllavi. Po Sigurimi i Shtetit ishte në dijeni të kësaj veprimtarie, kishte sinjalizime qysh më parë, por Partia, e cila drejton organet e Sigurimit, këshillonte që të ecej me kujdes të madh. Sigurimin e Shtetit Partia e ka edukuar në rrugën marksiste-leniniste. Pra, pas sinjalizimeve të para çështjet duheshin verifikuar dhe u verifikuan. Kështu, nga gjërat e vogla u zbulua ky komplot i rrezikshëm dhe u neutralizua puna e armiqve të jashtëm. Armiqtë kujtonin se ne flinim, po kur panë se po zbuloheshin, u përpëlitën dhe u orvatën të arratiseshin, por ishin të rrethuar.

Prandaj, shokë, vigjilenca është detyrë e dorës së parë. Vigjilenca dhe goditjet nuk u pëlqejnë armiqve. Hrushovi me shokë thonë se «nuk është e vërtetë që ishte komplot, siç thonë shqiptarët, kjo është vetëm një bombë që hodhi Enver Hoxha në Kongresin IV të PPSH, sepse asnjë sulm nuk është bërë kundër Shqipërisë». Ne u thamë udhëheqësve sovjetikë: «Lexojeni me kujdes raportin tonë, ne nuk kemi thënë se u sulmua Shqipëria, por po organizohej komploti për një sulm kundër Shqipërisë».

Por udhëheqësit sovjetikë le të mos bëhen merak, së shpejti do të bëhet gjyqi dhe do të provohen sa të vërteta janë këto që thamë ne. Ata arritën deri atje sa

në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës që u bë në Moskë në mars të vitit 1961, të na thonë: «Përse atëherë nuk na lajmëruat për këtë komplot? Ju e kishit për detyrë t'i njoftonit pjesëmarrësit e Traktatit të Varshavës». Përfaqësuesi i Partisë dhe i Qeverisë sonë në këtë mbledhje deklaroi se ne, si anëtarë të Traktatit të Varshavës, si aleatë që jemi, do t'ju njoftonim për këtë çështje, por, kur ne e vumë mirë në dorë këtë komplot, kur kishim kapur agjentët e armiqve tanë të jashtëm dhe ishim duke bërë hetime mbi ta, për ne rreziku ishte evituar. Megjithëkëtë, në kohën e duhur, ne e vumë në dijeni ambasadorin sovjetik. Mirëpo Nikita Hrushovit nuk i pëlqeu kjo gjë.

Sulmi kundër Shqipërisë nuk arriti të bëhej siç ndodhi me Kubën. Komploti kundër nesh ishte pothuajse i njëjlojtë si ai që u realizua me sulm kundër Kubës, organizim brenda, organizim jashtë. Nga jashtë do të futeshin në Shqipëri forca diversantësh të organizuara nga tradhtarët shqiptarë, me qëllim që të kapnin disa pika mbështetjeje në territorin tonë, të flitnin me radio, të shkaktonin trubullira në vend, pastaj të futej edhe ushtria greke dhe ajo jugosllave dhe çështja të përfundonte në OKB. Zbulimi i këtij komploti demaskon mirë imperializmin amerikan, klikën revizioniste jugosllave, Venizellosin me shokë e të tjerë.

Por le të mos i vijë mirë Hrushovit, faktet janë fakte, prandaj u thamë udhëheqësve sovjetikë se «armiqtë duhen demaskuar jo vetëm nga ne, po edhe nga ju dhe në qoftë se këtë nuk e bëni, aq më keq për ju». Kur i dëgjojnë miqtë e Shqipërisë këto gjëra, pyesin: «Përse nuk shkruajnë gazetatat e disa vendeve socialiste

për to?». Pyesin se shohin që ato po heshtin. Po faktet zbulohen, dëgjohen. Nesër, kur të bëhet gjyqi, ne këto gjëra do t'i publikojmë dhe populli sovjetik e gjithë popujt vëllezër të vendeve socialiste do t'i mësojnë dhe do t'i gjykojnë taktikat dhe presionet që bëhen kundër një populli të vogël, të cilit duan t'i bëjnë varrin. Po Shqipëria do të rrojë dhe do të lulëzojë, sepse ajo ka një Parti të çeliktë, ka një popull të mrekullueshëm, se vendi ynë është në miqësi me popujt e Bashkimit Sovjetik dhe të të gjitha vendeve të tjera socialiste, se Republika jonë Popullore nuk është e izoluar. Le të bëjnë kundër saj presione dhe padrejtësi, ato janë të përkohshme. Kush përpiqet t'i bëjë varrin Shqipërisë, do të bjerë vetë brenda.

Në këto situata rëndësi të madhe ka çështja që të mos e humbasim fillin, sepse armiqtë atë duan.

Për këto kontradikta me udhëheqjen sovjetike ne nuk do të flasim hapur. Një gabim të tillë ne nuk do ta bëjmë, nuk do t'u japim armë armiqve tanë, që të flasin kundër nesh dhe kundër Bashkimit Sovjetik për këto veprime të padrejta dhe oportuniste të Hrushovit. Por Partia duhet t'i dijë mosmarrëveshjet që të jetë e mobilizuar dhe e gatshme kundër çdo provokacioni. Në qoftë se udhëheqja sovjetike, me Hrushovin në krye, nuk do të ndërrojë qëndrimin e saj ose do të flasë publikisht kundër nesh, atëherë dhe ne do të flasim hapur e do t'ua themi të gjitha.

Në mbledhjet e komunizmit ndërkombëtar ne, si kurdoherë, do ta themi fjalën tonë, por në situatën që është krijuar tani, Hrushovi e ka vështirë të marrë pjesë në mbledhje si ajo e nëntorit të vitit 1960 që u bë

në Moskë, sepse ai u dogj nga kjo mbledhje. Ai mund të organizojë përsëri mbledhje ndërkombëtare të partive, por me pasuesit e tij.

Prandaj, shokë, t'i përvishemi punës me të gjitha forcat dhe në të gjitha drejtimet. Organizata e Partisë e rrethit të Korçës është një nga më të mirat, më të vjetrat, dhe me shokë që kanë një eksperiencë të gjatë partie. Ju, shokë, kuadro të Partisë, të përpiqeni të jeni në ballë të punës e të luftoni me vendosmëri për realizimin e detyrave që ju ka ngarkuar Partia.

*Botohet për herë të parë me shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE PËRBALLOJMË SITUATAT E VËSHITIRA QË NA IMPONOHEN

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 maj 1961

Situatat janë të vështira, përse i përket realizimit të marrëveshjeve me vende të tjera, por ne duhet të bëjmë të gjitha përpjekjet që t'i ndërtojmë edhe hidrocentralet. Siç dihet, për linjat e tensionit të lartë ne kemi kontraktuar me Bashkimin Sovjetik, por kreditë nuk na jepen. Prandaj të bisedojmë edhe një herë me sovjetikët për këto çështje dhe t'u themi nëse do të na i japin apo jo materialet për linjat e tensionit, përndryshe na dëmtojnë ekonominë, na mbeten pa u ndërtuar hidrocentralet. Në rast se thonë «nuk ua japim kreditë», atëherë t'i pyesim nëse do t'i respektojnë kon-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbi gjendjen e punimeve të ndërtimit dhe të montimit të hidrocentralit të Shkopetit dhe të Bistricës», paraqitur nga Drejtoria e Industri-Ndërtimit pranë aparatit të KQ të PPSH.



tratat që kemi vendosur bashkërisht. Materialet ne do t'i blejmë me klering. Në rast se na përgjigjen që as me klering nuk do të na i japin, atëherë këto materiale ne duhet t'i sigurojmë nga Kina ose nga ndonjë vend tjetër. Por, në radhë të parë, meqenëse kemi kontraktuar, të bisedojmë përsëri me sovjetikët, sepse kontratat ekzistojnë, ato janë firmosur, pastaj të bëjmë përpjekje për t'i siguruar nga vende të tjera.

Lidhur me montimin e hidrocentraleve të veprojmë siç u tha këtu: të pranojmë montatorët çekë me 250 mijë lekë në muaj, në të njëjtën kohë t'i themi udhëheqjes çekoslllovakë se ky qëndrim s'është i drejtë, pse montatorët na kushtojnë 70 milion lekë. Ky është një turp i madh për ta, që duan të na hedhin litarin në grykë, po s'kemi ç'bëjmë, këto janë situatat që kalojmë. Në rast se për montimet do të duhen 20 specialistë çekë, ne të kërkojmë 15, sepse na kushtojnë shtrenjtë dhe punët e tjera suplementare t'i bëjmë me njerëzit tanë. Në rast se edhe çekët nuk do ta mbajnë fjalën, me gjithë pagën 250 mijë lekë në muaj për çdo specialist, dhe nuk do të na dërgojnë edhe turbinat, më vonë këto çështje, në situatat që mund të krijohen, i shqyrtojmë përsëri. Presionet ekonomike të çekëve do t'i përballojmë.

Kleringu ynë është i lidhur me importet, që janë shumë të nevojshme për ne. Vërtet që eksportojmë hekur, krom etj., po marrim shumë gjëra për të cilat kemi nevojë, prandaj duhen realizuar kontratat që kemi nënshkruar. Në rast se sovjetikët, çekët e të tjerë refuzojnë edhe kleringun, edhe tregtinë, atëherë do të drejtohem i gjetkë. Tregtinë me sovjetikët, me çekët, me

bullgarët, e me çdo vend tjetër, duhet ta bëjmë mbi baza të reciprocitetit. Po të mos na i japë materialet Bashkimi Sovjetik, atëherë ta përdorim kleringun me Italinë, me Austrinë etj. Kleringun me Bashkimin Sovjetik do ta shkurtojmë, sepse sovjetikët s'na japin importin sipas marrëveshjes që kemi bërë. Kleringu ynë është i vogël dhe ne nuk jemi në gjendje të bëjmë presione në rrugën e këmbimeve tregtare.

Natyrisht, në marrëdhëniet tregtare njerëzit tanë të kujdesen që të bisedojnë në platformë ekonomike, por të kihet parasysh se politika hyn kudo. Sovjetikët po i acarojnë vazhdimisht qëndrimet e veta ndaj vendit tonë, sidoqoftë, besojmë se disa norma do t'i ruajnë. Normat e marrëdhënieve shtetërore midis vendeve ekzistojnë dhe ne mund t'u themi atyre: ju bëni tregti edhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përse nuk bëni me Shqipërinë? Nga ana tjetër, nuk duhet hedhur poshtë interesi që kanë çekët ose të tjerë për shkëmbime me klering. Sigurisht ata s'kanë ndonjë interes të madh për marrëdhënie me ne, se janë shtet më i fuqishëm ekonomik, dhe mund të mos kenë nevojë për mallrat tona, po nga ana tregtare mund t'u leverdisë, dhe kjo nuk duhet harruar.

Në çështje të tjera të ndërtimeve tona, t'u qëndrojmë rreptësisht grafikëve përkatës. Do të ishte gabim që në këto situata të mos mbajmë në ndërtime një farë rezerve, sepse mjaft gjëra nuk do të bëhen në kohën që mendojmë ne, sepse do të na vonohen nga sovjetikët dhe pasuesit e tyre. Kjo ka lidhje me energjinë elektrike. Prandaj studimit për ekonomizimin e energjisë t'i dalim përpara që të përballojmë situatën sikur

edhe gjysmë viti të na vonohet ndërtimi i hidrocentra-  
lit nga afati i parashikuar. Këtë ta kemi parasysh që  
tani, prandaj të marrim të gjitha masat e nevojshme.

Partia dhe ju, shokë përgjegjës të dikasterëve, të  
keni parasysh edhe ato probleme që u shtruan këtu  
për ngritjen e rendimentit, për shfrytëzimin e gurëve  
dhe për harxhimin e çimentos me ekonomi, për shfry-  
tëzimin e mekanizmave etj. Të gjitha këto dhe ato që  
thanë shokët e tjerë, të vihen sa më parë në jetë, kështu  
do t'i kapërcejmë me sukses këto situata të vështira.

Problemet e organizatave të Partisë në këto ndër-  
marrje nuk janë më të vogla, prandaj të frymëzohen  
dhe të mobilizohen komunistët për zgjidhjen e tyre.  
Përsa u përket motopompave që u janë marrë koope-  
rativave bujqësore ose ekskavatorët e bonifikimit,  
mund t'u kthehen në rast se del nevoja për ujitje. Në  
rast se tani për tani këto nuk nevojiten, përse të largoh-  
hen nga Bistrica? Sidoqoftë duhet forcuar solidariteti  
me ndërmarrjet e tjera dhe me kooperativat bujqësore.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# POPULLI KËRKON QË SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TË KRIJOJNË SA MË SHUMË VEPRA ME VLERË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

22 maj 1961

Ne, si shtet i demokracisë popullore, në këto momente politike duhet t'i zhvillojmë më tej sektorët e letërsisë, teatrit, muzikës, pikturës, skulpturës etj. Këtu u shtruan mjaft çështje, për të cilat dëshiroj edhe unë të jap ndonjë mendim.

Siç doli edhe nga diskutimet e shokëve, Byroja Politike konstaton me kënaqësi se puna e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve në përgjithësi është e mirë. Drejtuesit e këtij sektori të rëndësishëm kanë bërë përpjekje të mëdha për të zbatuar direktivat e Partisë.

Arti dhe kultura te ne i shërbejnë popullit. Po bë-

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve «Mbi gjendjen në letërsi dhe në arte».

het çdo ditë e më qartë se nuk mund të bëjmë dot pa to, pa letërsi, pa art dhe pa muzikë, të cilat sot janë bërë të masës. Gjatë kësaj periudhe në vendin tonë është krijuar një bazë e shëndoshë në fushën e artit e të letërsisë, por këtij sektori duhet t'i japim një ndihmë më të madhe, të tregojmë më tepër kujdes për të, të bëjmë më shumë hapa përpara. Popullit duhet t'i japim vazhdimisht sa më shumë vepra të bukura.

Vendi ynë është i rrethuar nga armiq të egër. Detyra jonë është që edhe në art e në letërsi të paraqitet realiteti konkret i vendit tonë. Edhe nga vende të tjera mund të marrim gjëra pozitive, nga krijimtaria përparimtare e tyre, por të mbështetemi fort në kulturën kombëtare. Është pozitiv fakti që vigjilenca e shoqëve të Lidhjes qëndron në lartësinë e duhur. Janë kapur në kohë disa shfaqje negative të huaja dhe janë geditur ato. Kjo tregon se njerëzit e artit dhe të letërsisë në vendin tonë janë edukuar me mësimet marksiste-leniniste. Ideologjia borgjeze e revizioniste përpiqet të depërtojë në këta sektorë, sepse e di që kanë një rëndësi të madhe për edukimin e popullit. Deri tani armiqtë s'kanë gjetur terren, me siguri kjo do të ndodhë edhe në të ardhshmen, por vigjilencën të mos e harrojmë.

Të kemi kujdes të veçantë për studentët tanë që mësojnë në shkolla jashtë shtetit, pse ka rrezik që, duke u ndodhur nën presionin e ndikimeve të huaja, disa prej tyre të infektohen. Edhe kjo nuk ka ndodhur e me siguri nuk do të ndodhë, pse njerëzit tanë janë të lidhur ngushtë me Partinë e të pajisur me moralin komunist, por, megjithatë, ne duhet të jemi të vëmend-

shëm dhe t'i hedhim hapat me kujdes. Trajtimi që ju, shokë komunistë dhe drejtues të Lidhjes, u keni bërë shfaqjeve të vogla që janë manifestuar deri më sot, është i drejtë.

Duhet treguar kujdes për ata kuadro, të cilët gjatë Luftës Nacionalçlirimtare nuk kanë qenë të lidhur me ne, por sot punojnë ndershmërisht. Kur ata gabojnë, mos i ofendoni duke u përmendur të kaluarën, por u vini në dukje ku i kanë gabimet dhe me anë të bindjes dhe të arsytimit i ndihmoni të korrigjohen. Ju këta i njihni mirë, njihni dhe të metat e tyre, prandaj duhet të punoni me ngulm dhe me durim që të zhduken të metat dhe shfaqjet e huaja që mund të manifestohen në praktikën e tyre. Ne shohim se mjaft prej tyre kanë bërë kthesë të madhe dhe këtë nuk e kanë bërë për t'u dukur. Është gabim të hedhësh poshtë punën e kuadrove nën pretekstin se «kanë mbaruar shkollat në vendet kapitaliste». Ne sot kemi inxhinierë të vjetër, që punojnë pa u lodhur për Partinë, duke vënë në jetë mësimet e saj.

Ju, shokë kryesorë të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve, do të keni vështirësi edhe në të ardhshmen, por ato duhet t'i kapërceni, duke u mbështetur fort në ideologjinë e Partisë. Mos lejoni të hyjnë në artet tona shfaqje të huaja për ideologjinë tonë revolucionare. Të keni kujdes për të mbrojtur çdo njeri të artit e të letërsisë, sepse ekziston rreziku i depërtimit të ideologjisë borgjeze në radhët e tyre. Të zhvillohet me ta një punë e madhe edukative, për brumosjen e tyre me ideologjinë marksiste-leniniste.

Shfaqjet e huaja, që mund të duken, t'i luftoni në

rrugë të drejtë, ashtu siç ju ka mësuar Partia. Nga literatura ose nga muzika e huaj të marrim atë që është përparimtare, revolucionare, që është e popullit. Ne do të mësojmë edhe nga trashëgimia botërore përparimtare, por jo ta imitojmë atë. Kryesorja është që, edhe kur lexojmë ndonjë kryevepër të ndonjë autori të madh të huaj, çdo gjë ta lidhim mirë me jetën e vendit dhe çdo gjë që krijojmë, ta lidhim me realitetin shqiptar. Me të vërtetë Hygoi është një poet i madh, por dhe vjershat e poetëve tanë janë mjaft të bukura. Pse ndonjëri të kopjojë ose të adaptojë vargje të autorëve të huaj? Por që njerëzit tanë të shkruajnë për realitetin e Shqipërisë, duhet ta njohin këtë realitet, të njohin jetën.

Populli kërkon që shkrimtarët dhe artistët të krijojnë vepra jo vetëm për Tiranën, sepse Tirana nuk është e gjithë Shqipëria. Prandaj shokët shkrimtarë të venë më shpesh poshtë, të marrin kontakt me bazën dhe kjo punë të mos bëhet kalimthi. Në këtë drejtim, ju, si kuadro kryesorë, duhet të keni kujdes, që romani ynë të jetë me nivel të lartë dhe të trajtojë konflikte që ekzistojnë në shoqërinë tonë, me qëllim që lexuesit të frymëzohen e të ndihmohen në punën e tyre.

Edhe anën financiare nuk duhet ta shohim ngushtë, sepse situatat e vështira që kalojmë, kërkojnë që ne të ngremë kurdoherë më lart nivelin e propagandës së Partisë. Të marrim çështjen e profesionalizmit. Kjo çështje është e drejtë në parim, por duhet parë në kushtet e sotme të vendit tonë. Te ne ka akoma një tirazh të vogël të botimeve të literaturës artistike dhe nuk shtrohet aq shumë çështja e profesionalizmit. Ne mund ta

lejojmë daljen në profesion të lirë të disa shkrimtarëve ose të disa artistëve, që këta të shkëputen nga punët e tjera kryesore për të nxjerrë vepra të rëndësishme, natyrisht me afate. Edhe ne, kur na ngarkon Partia për të përgatitur një raport, në fillim mendojmë dhe vijmë rrotull, por, kur dimë se na është caktuar një afat, i përvishemi punës seriozisht dhe e përfundojmë në kohën e duhur. Prandaj edhe shokët që do të dalin në profesion të lirë, të punojnë e të krijojnë. Për shkrimtarët profesionistë mund të caktohet një rrogë bazë e përshtatshme, ose për ta mund të rritet përqindja e së drejtës të autorit. Por në qoftë se shkrimtari nuk prodhon, atëherë si profesionist ai do të shpërblehet më pak. Për disa të tjerë të vazhdohet të jepen leje krijuese. Përsa i përket orarit të reduktuar, këtë mund ta caktojë Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës.

Natyrisht, shkrimtari ose artisti që del në profesion të lirë, duke pasur kohë të mjaftueshme në dispozicion, duhet të prodhojë vepra që do të frymëzojnë masat me frymën e lartë të patriotizmit, të nxitin njerëzit në punë për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e atdheut. Por që shkrimtarët e afirmuar t'i kushtohen kryesisht krijimtarisë duhet të ndihmojnë për përgatitjen e kuadrove të tjerë që të merren me punë shoqërore, pedagogjike etj. Kjo nuk do të thotë që shokë si Dhimitër Shuteriqi, Shevqet Musaraj etj., të mos merren në të ardhshmen me punë shoqërore. Për shkrimtarë si këta ne kemi interes jo vetëm të krijojnë, por të japin mësim edhe në shkolla, të përgatitin tekste, të drejtojnë revista etj., sepse janë njerëz të kualifikuar.



Çështja e studiove dhe e kërkesave të tjera materiale të nevojshme për shkrimtarë, artistë, piktorë, skulptorë etj., duket si gjë e vogël, po ka rëndësi për krijimtarinë letraro-artistike. Piktori nuk mund të bëjë dot një tablo në dhomën ku banojnë edhe disa pjesëtarë të tjerë të familjes. Prandaj kjo çështje duhet zgjidhur sa më parë.

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe të Kulturës, në bashkëpunim me Lidhjen e Shkrimtarëve dhe të Artistëve dhe me komitetet ekzekutive përkatëse, të vendoset që, në një kohë sa më të shkurtër, të krijohen mundësitë për të plotësuar nevojat e shkrimtarëve dhe të artistëve me shtëpi dhe me studio. Nga ana tjetër, shteti duhet t'i blejë veprat e piktorëve. Nuk më duket e drejtë të shtrohet çështja që veprat e artistëve t'i blejnë individë, sepse këto vepra nuk janë vetëm për të zbukuruar muret, por pasqyrojnë zhvillimin e kulturës sonë dhe kanë vlera edukuese. Më vonë mund të kemi interes që shumë nga këto vepra t'i shesim edhe jashtë vendit, gjë që do ta bëjë shteti. Prandaj shteti të organizojë më mirë porositë dhe blerjen e veprave të piktorëve dhe të skulptorëve. Për këtë të krijojmë galerinë tonë të arteve, e cila të shërbejë edhe si vend për ekspozimin e veprave.

Ne duhet të vazhdojmë duke dërguar njerëz për studime edhe jashtë shtetit, natyrisht aq sa na lejojnë mundësitë tona dhe situatat politike që po kalojmë. Por, në radhë të parë, ne të mbështetemi në shkollat tona. Atyre t'u vëmë rëndësi të madhe, me qëllim që ato t'i plotësojmë me vegla dhe me sende të nevojshme për të nxjerrë kuadro dhe t'i kthejmë në një «oficinë»

nga ku mund të nxjerrim njerëz të aftë për sektorin që kanë mësuar. Po që nevoja, ne mund të sjellim edhe profesorë nga jashtë dhe të evitojmë dërgimin e studentëve tanë në vende të tjera, se nuk i kemi mundësitë që të plotësojmë të gjitha nevojat që kemi. Edhe piktorëve t'u sjellim bojëra, penela e të tjera sende që u nevojiten. Këto e të tjera probleme e detyra në fushën e artit e të kulturës, mendoj se duhen mbajtur parasysh, jo vetëm nga organet qendrore, por edhe nga rrethet. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të ketë më shumë inisiativë, t'i presë më ngrohtë shkrimtarët dhe artistët, të dëgjojë kërkesat dhe propozimet e tyre. Ç'mund të jetë për shtetin tonë një milion lekë që duhen për të plotësuar kërkesat e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe të Artistëve? Ne vetëm me ekipet për fushatën e kursimeve ekonomizuam një miliard e 700 milion lekë.

Kërkesat e ndryshme duhen zgjidhur më mirë në rrugë shtetërore, sepse ndryshe njerëzit detyrohen të vijnë në Komitetin Qendror me mendimin se vetëm këtu mund të zgjidhen çështjet e tyre. Komiteti Qendror jep orientime, por janë organet shtetërore përkatëse ato që merren me zgjidhjen praktike të problemeve. Dhe kërkesat e njerëzve të artit e të kulturës nuk janë të mëdha, që të na kostojnë nga pikëpamja financiare, por ato kanë rëndësinë e tyre për zhvillimin e krijimtarisë letraro-artistike. Ja, për shembull, zhvillim po merr gjinia e estradës. Nexhmija kishte parë estradën e kooperativës bujqësore të Dushnikut në Berat dhe më tha se ishte mjaft e mirë, me një kor rreth 100 veta; përmbajtja e pjesëve ishte në nivel të lartë ideologjik

e artistik. Estrada nuk vinte në shenjë vetëm anët negative, por evidentonte edhe anët pozitive të fshatit, ngrinte lart heronjtë e ditëve tona. Kjo shfaqje e estradës së Dushnikut ishte e bukur dhe në krye të saj ka vetëm një mësues. Mirëpo që të zhvillohen e të përparojnë estradat duhet të ushqehen me lëndë të parë. Këtë lëndë të parë do ta prodhojnë shkrimtarët, kompozitorët etj., të cilët duhet t'i ndihmojmë në punën e tyre fisnike.

Më shumë kujdes duhet të tregojmë edhe për popullarizimin e veprave tona letrare e artistike. Kështu, për shembull, mund t'u dërgojmë disa shtëpive botuese jashtë shtetit material, të cilin ata, si tregtarë që janë, do ta botojnë për të fituar. Kjo neve na intereson, si për romanin, ashtu dhe për tablonë. Ne dërgojmë në ekspozita vepra nga tonat, por në qoftë se japim edhe ndonjë vepër si dhuratë, i huaji do të nxitet të blejë nga ne dhe të shesë në vendin e tij. Këto vepra do të shërbejnë për popullarizimin e vendit tonë dhe të suksesëve të mëdha që ka arritur ai edhe në fushën e kulturës. Por nuk do të vijmë këtu, për shembull, shtëpitë botuese të Parisit apo të Brukselit që ta bëjnë këtë punë, të blejnë veprat e artit tonë, këtë duhet ta bëjmë ne, me njerëzit tanë, që merren me këto punë.

Ne jemi që ju të ndihmoheni seriozisht. Deri më sot jeni ndihmuar, por, duke marrë parasysh rëndësinë që ka arti e letërsia duhet që shteti t'ju ndihmojë akoma më shumë. Muzikën dhe pikturën ta ndihmojmë më shumë se këto janë sektorë të vështirë. Ne kemi besim se kompozitorët do të na japin muzikë të bukur që ta dojë masa.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës duhet të interesohet për botimin e romaneve, të tregimeve etj., të shkrimtarëve, meqenëse, deri më sot, koha më e madhe është zënë me botimin e librave shkollorë. Kjo çështje të shikohet me kujdes, në mënyrë që të botohen më parë ata libra që janë më të rëndësishëm, më urgjentë dhe më të domosdoshëm.

Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të interesohet gjithashtu për përkthimin e shitjen jashtë shtetit të romaneve, të tregimeve etj., të shkrimtarëve tanë.

E gjithë lëvizja kulturore dhe artistike në vendin tonë ka marrë një hov të madh. Kjo i detyrohet kujdesit që ka treguar Partia, populli dhe vetë shkrimtarët e artistët. Por në të ardhshmen ne duhet ta vlerësojmë akoma më tepër rëndësinë e këtyre sektorëve, detyrat që na dalin për zhvillimin e mëtejshëm të tyre. Ne kemi bindjen se edhe shokët që drejtojnë Lidhjen do të punojnë më mirë për ta çuar më përpara krijimtarinë letraro-artistike të vendit tonë.

Ju, shokë komunistë, shkrimtarë e artistë, luftoni për mbrojtjen e interesave të atdheut, por Partia jonë lufton edhe për mbrojtjen e interesave të të gjithë lëvizjes komuniste e punëtore të botës. Ne jemi internacionalistë. Ka klika dhe grupe deviatorësh që na shajnë e që shpifin kundër nesh, por në të ardhshmen popujt do ta kuptojnë se sa ka dhënë Partia dhe populli ynë në luftë kundër revizionistëve dhe oportunistëve të të gjitha ngjyrave. Ne do të qëndrojmë të patundur dhe këta tradhtarë të marksizëm-leninizmit nuk na mposhtin dot. Ne jemi për fitoren e marksizëm-leninizmit, pallavrat dhe shpifjet e revizionistëve nuk do ta errë-

sojnë aspak rrugën tonë revolucionare, për të cilën ne jemi të vendosur.

Shokët e Lidhjes, siç i premtuan Byrosë Politike edhe në këtë mbledhje, jemi të bindur se do të mobilizohen me të gjitha forcat e tyre për të realizuar detyrat që kanë në fushën e krijimtarisë e për të qënë luftëtarë të vendosur edhe në mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit në letërsi dhe në artin tonë të bukur. Ju urojmë suksese të reja!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verball i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **SITUATA KËRKON SQARIM POLITIK, UNITET TË FORTË DHE MOBILIZIM TË MADH TË MASAVE**

*Fjala me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë  
të rretheve dhe me disa kuadro kryesorë  
të aparatit të KQ të PPSH*

**30 maj 1961**

Dëshiroj t'ju vë në dijeni mbi ngjarjet e kohëve të fundit. Nuk po filloj që nga Mbledhja e Moskës e 81 partive komuniste e punëtore, sepse për këtë ju jeni të informuar, bile shumë prej jush kanë dijeni edhe për mbledhjen e fundit të përfaqësuesve të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, që u zhvillua në Moskë më 28-29 mars të këtij viti.

Qëllimi kryesor i mbledhjes së fundit të Traktatit të Varshavës ishte të sulmoheshin Komiteti Qendror i Partisë dhe Qeveria jonë. Këtë qëllim kishin Nikita Hrushovi dhe shokët e tij, kurse rendi i ditës i kësaj mbledhjeje parashikonte të mbahej një raport mbi gjendjen moralo-politike të forcave të armatosura të shteteve që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës dhe armatimi i tyre. Por në fakt nuk u biseduan këto çësh-

tje. Problemi i armatimit të ushtrive të vendeve anëtare të Traktatit të Varshavës ishte diskutuar më parë në mbledhje të ndryshme me përfaqësuesit ushtarakë të këtyre vendeve, bile ishin përgatitur edhe listat për nevojat që kishte çdo ushtri, si dhe burimet e vendet se ku do të merreshin këto armatime. Kështu në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës çështja e armatimit të ushtrive ishte vetëm formalisht dhe në fakt kjo as që u diskutua fare.

Në këtë mbledhje diskutoi edhe përfaqësuesi i Partisë dhe i Qeverisë sonë. Në diskutimin e tij ai trajtonte situatën ndërkombëtare, gjendjen moralo-politike, armatimin e ushtrisë sonë, parashtronte pikëpamjet e Partisë dhe të Qeverisë sonë në lidhje me masat që duheshin marrë, dhe bënte propozime për forcimin e mëtejshëm të kampit socialist dhe të ushtrive tona.

Përveç fjalimit të përfaqësuesit tonë, të gjitha fjalimet e tjera ishin vetëm sulme kundër nesh dhe asnjëri prej udhëheqësve të vendeve të tjera socialiste që diskutuan nuk trajtoi problemet që kishin të bënin me rendin e ditës. Ata u hodhën në sulm dhe pyetën përse nuk foli përfaqësuesi i Shqipërisë në lidhje me letërnë që na kishte dërguar komandanti i forcave të bashkuara të Traktatit të Varshavës, mareshali A. A. Greçko.

Duhet të dini se kjo ishte një letër e dorëzuar në orën e fundit, ashtu siç e praktikon udhëheqja sovjetike në të gjitha mbledhjet ndërkombëtare; ata kanë për qëllim ta vënë tjetrin në pozita të vështira, që të mos ketë kohë ta shqyrtojë me kujdes materialin. Por ne i kuptuam menjëherë qëllimet e ulëta të Hrushovit me

shokë dhe arritëm t'i jepnim në kohë përgjigjen e merituar mareshalit Greçko, me gojë dhe me shkrim.

Letra e Greçkos kërkonte që ne të pranonim të lanim duart nga baza e Vlorës dhe, sipas tij, nga i gjithë hinterlandi<sup>1</sup> i saj, i cili të vihej nën drejtimin e sovjetikëve; që forcat e armatosura të marinës shqiptare të tërhiqeshin nga ky territor dhe të gjitha anijet luftarako-detare, ndihmëse etj. të merreshin në dorëzim nga ekipazhet sovjetike.

Ne iu përgjigjëm në rregull kësaj letre, duke ruajtur kurdoherë gjakftohtësinë, sepse kjo është karakteristika e drejtësisë marksiste-leniniste. Pra, letra jonë ishte shkruar me ton të qetë, në frymë miqësore, bazohej në parimet marksiste-leniniste, në internacionalizmin proletar dhe në marrëveshjet e firmosura në mes të dy qeverive tona. Prandaj iu përgjigjëm se ky propozim është i papranueshëm për ne, sepse në radhë të parë nuk ishte as miqësor, as internacionalist, as vëllazëror dhe as i bazuar në marrëveshjet që kishim. Ne iu përgjigjëm se forcat tona ushtarako-detare, në çdo kohë dhe nga çdo pikëpamje, janë treguar të zonjat të drejtojnë çdo mjet luftarak detar. Në fund, nënvizonim se propozimi i Greçkos nuk kishte asnjë bazë dhe theksonim se arsytet që parashtronte ai për të marrë këto masa ishin të gjitha shpifje dhe trillime. E vetmja «arsye» që paraqiste Greçkoja në letrën e tij për masat që propozonte ishte se gjoja jelesa e marinarëve sovje-

<sup>1</sup> Hinterland (nga gjermanishtja) hinter — pas, land — vend. Në politikën kolonialiste do të thotë vend që përfshihet në territorin kolonial të pushtuar, mbl të cilin shteti imperialist ka pretendimet e veta.



tikë në bazën detare të Vlorës ishte bërë e pamundur. Sipas tij, sovjetikëve u ishin krijuar në bazë kushte aq të këqija, sa ata nuk shihnin tjetër rrugëzgjidhje veç asaj që ne shqiptarët të largoheshim nga baza jonë dhe atë ta merrnin në dorë sovjetikët, sepse vetëm në këtë mënyrë, sipas tyre, do të evitohej çdo incident! Një «incident», sipas tyre, ishte se një polic në lumin Izvor, duke kontrolluar një autobus, me të cilin udhëtonin edhe tri gra sovjetike, u tha atyre që, pasi shkollin për në Vlorë, duhet të kishin me vete letërnjoftimet, sepse në qytet, duke mos i njohur, mund t'u sillnin pengesa. Nga kjo ndërhyrje e policit na qenkan acaruar marrëdhëniet dhe është prekur «krenaria» sovjetike. Ky «incident» na paskësh qenë një nga arsyet vendimtare për të marrë në dorëzim të gjitha anijet nga ana sovjetike. Përveç kësaj, në letër bëheshin një sërë shpifjesh të tjera për gjëra fare të vogla dhe pa asnjë bazë, sepse as që kanë ndodhur, por janë trilluar me qëllim prej tyre.

Për ne është e qartë se këto qëndrime të udhëheqjes sovjetike, që po mbahen pas Mbledhjes së Bukureshtit, kanë bazën e vet politike dhe ideologjike. Përpara Bukureshtit, veçanërisht në bazë, nuk kishte ndodhur as mosmarrëveshja më e vogël midis të dyja palëve, atje kishte harmoni të plotë. Ndërsa pas Bukureshtit u kurdisën të gjitha këto trillime nga ana e udhëheqjes sovjetike, e ambasadës sovjetike në Tiranë, veçanërisht nga ana e oficerëve sovjetikë që kanë ardhur në bazën e Vlorës apostafat për qëllime armiqësore.

Pas fjalimit tonë në mbledhjen e Traktatit të Var-

shavës, filluan të gjithë sulme kundër nesh. Kur u ngrit Hrushovi dhe e pyeti përfaqësuesin shqiptar përse nuk foli për këtë letër, ne iu përgjigjëm se nuk ishte këtu vendi të flitej, sepse në këtë mbledhje ne kemi ardhur për probleme të tjera dhe jo për t'iu përgjigjur korrespondencës midis ministrive të mbrojtjes. Mirëpo ata ishin pregatitur për këtë punë, prandaj çfarë nuk thanë kundër nesh: «Ju e keni vënë veten jashtë Traktatit të Varshavës», «ju jeni antisovjetikë», «ju shqiptarët jeni kundër unitetit» e të tjera. Janë aq të shumta këto sulme sa nuk thuhet dot. Po ama edhe përgjigjja që morën ishte sa e drejtë aq edhe e rreptë, saqë N. Hrushovi u detyrua të ngrihej njëzet herë të fliste, sepse të gjitha faktet dhe argumentet e tyre ishin pa bazë, dhe këto qëndrime tregonin qartë pozitën e tyre false, antimarksiste, antishqiptare, jomiqësore dhe aspak internacionaliste.

Më në fund, pasi folën e folën të gjithë kundër nesh, por edhe ne nuk mbajtëm asgjë përsipër, ata dolën me një vendim që baza e Vlorës t'u dorëzohet sovjetikëve dhe të lidhet direkt me komandantin sovjetik të forcave të bashkuara të Traktatit të Varshavës, dhe këtë çështje e hodhën në votë. Të gjithë e aprovuan këtë vendim, vetëm ne votuam kundër dhe e cilësuam si një vendim që s'ka asnjë bazë dhe që nuk përshkohet aspak nga fryma internacionaliste.

Përveç kësaj, në mbledhjen e marsit të Traktatit të Varshavës u bënë edhe sulme e ndërhyrje të tjera kundër nesh, sidomos për gjiqin që do të zhvillohej kundër tradhtarit Teme Sejko me shokë, të cilët organizonin një komplot kundërrevolucionar dhe një ndërhyrje të

armatosur të bashkërenduar me Flotën VI Amerikane, me monarko-fashistët grekë e me revizionistët jugosllavë, sepse, me sa duket, ky gjyq u digjte shumë. Në këtë mbledhje, gjyqi kundër këtyre tradhtarëve u bë problem i ditës. Sipas tyre, ky ishte një gjyq i trilluar, fals, sepse Shqipëria nuk është sulmuar prej askujt. Prandaj, sipas tyre, duhej të formohej një komision për të kontrolluar dokumentet e hetuesisë sonë nëse janë të vërteta apo jo. Në këtë frymë folën Hrushovi, Gomulka, Zhivkovi e të tjerë. Ata u kapën nga «fakti» që «përse nuk na keni vënë në dijeni për këtë problem». Natyrisht, ne e hodhëm poshtë edhe këtë pikëpamje dhe u përgjigjëm ashtu si e meritonin.

Karakteristike është fakti se udhëheqësit e vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës në këtë mbledhje kishin ardhur me plane shantazhesh dhe kërcënimesh ndaj nesh për të mos i dënuar spiunët dhe tradhtarët që kishim kapur dhe që kishim deklaruar se do t'i nxirrnim në gjyq. Për t'ia arritur këtij qëllimi ata na frikësonin edhe me likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës. Duke na bërë presion me heqjen e bazës së Vlorës, në rast se këta tradhtarë do t'i nxirrnim në gjyq, ata mbronin haptazi tradhtarët e Partisë dhe të atdheut tonë. Kështu mund të kuptohen këto presione dhe kërcënime. Pse i mbrojtën këta tradhtarë dhe spiunë e dinë vetëm ata. Por ne e kemi shumë të qartë çështjen. Ne kemi shumë të qartë faktin që N. S. Hrushovi ka mbrojtur Panajot Plakun. Ky tradhtar i ka dërguar një letër Hrushovit, me të cilën kërkonte likuidimin e udhëheqjes së Partisë sonë. N. S. Hrushovi ka mbrojtur gjithashtu tradhtarët, Dali Ndrëu, Liri

Gega, Tuk Jakova e të tjerë, me një fjalë të gjithë tradhtarët e Partisë sonë. Ne dimë gjithashtu se Hrushovi ka biseduar me Sofokli Venizellosin dhe ka pranuar që të na komunikonte neve pikëpamjet e tij mbi të ashtuquajturën çështje të autonomisë së «Vorio Epirit».

Këto gjëra dimë ne, prandaj për këto qëndrime e kemi kritikuar Nikita Hrushovin haptazi, në rrugë marksiste. Mund të lindë pyetja: Përse u dogji atyre dalja e spiunëve dhe e tradhtarëve të Partisë dhe të atdheut tonë në gjyqin e fundit? Këtë e dinë ata. Përse donin të ndërhynin dhe të shikonin dosjet e tradhtarëve tanë? Edhe këtë e dinë ata. Ne dimë një gjë që të jemi kurdoherë vigjilentë. Koha dhe historia janë të pamëshirshme, ato do t'i nxjerrin në shesh këto gjëra dhe do të sqarojnë përse i ka marrë nën sqetull udhëheqja sovjetike tradhtarët e Partisë dhe të shtetit tonë.

Ata nuk na trembin dot me presionet që na bëjnë për bazën e Vlorës, sepse ne jemi në rrugë të drejtë në çdo drejtim. Qenia e bazës së Vlorës i shërben jo vetëm mbrojtjes së Shqipërisë, por të gjithë kampit të socializmit. Për këtë qëllim është krijuar baza ushtarako-detare e Vlorës, gjë që pasqyrohet edhe në dokumentet historike të nënshkuara nga të dyja palët. Faktet kanë treguar se njerëzit tanë që kanë punuar në bazë, drejtonin më së miri mjetet luftarako-detare dhe ata që punojnë sot në bazë janë bërë shumë të zotë në punën e tyre, bile në tepër të zotë nga shumë sovjetikë që kishin ardhur këtu gjoja për të instruktuar njerëzit tanë. Edhe përsa i përket trimërisë, populli, komunistët, oficerët dhe ushtarët shqiptarë e kanë treguar kur ka ardhur rasti.

Prandaj vendimi që mori mbledhja e fundit e Traktatit të Varshavës ishte një akt që shkelte të gjitha normat e pranuar për marrëveshjet midis shteteve, që shkelte interesat e kampit të socializmit, që dëmtonte dhe rrezikonte mbrojtjen e Shqipërisë dhe të kampit në tërësi. Këtë pikëpamje ua kemi thënë troç udhëheqësve sovjetikë dhe gjithë udhëheqësve të vendeve të tjera socialiste të Evropës, prandaj ata mbajnë një përgjegjësi të rëndë historike mbi kurrizin e tyre, në radhë të parë Nikita Hrushovi, por edhe të tjerët kanë po aq përgjegjësi sa edhe ai.

Koha do ta tregojë dhe po tregon se ç'krime të poshtra po bëhen. Ajo në të ardhshmen do t'i tregojë edhe më shumë, edhe më qartë poshtërsitë e revizionistëve. Pa marrë parasysh asgjë, ata vazhdojnë në rrugën e tyre antimarksiste që si e si t'i komplikojnë çështjet. Vetëm gjakftohtësia e Partisë sonë ka bërë që deri tani të evitohen veprime të papëlqyera.

Udhëheqja sovjetike, pas një mbledhjeje që ka bërë, i ka drejtuar një letër Komitetit Qendror të Partisë sonë të firmosur nga Kosigini. Në gjysmën e kësaj letre flitet për ndihmat që i ka dhënë Bashkimi Sovjetik Shqipërisë. E gjithë kjo pjesë nuk përshkohet nga një frymë miqësore, vëllazërore, internacionaliste, por nga qëllime antishqiptare të grupit revizionist të kryesuar nga Hrushovi. Nga kjo pjesë e letrës gjithashtu del konkluzioni se këto ndihma që ka marrë vendi ynë, nuk i kanë shërbyer udhëheqjes shqiptare për të ulur kurrizin kundrejt pikëpamjeve dhe vendimeve të këtij grupi revizionist. Me një fjalë, ndihmat që na kanë dhënë populli sovjetik dhe PK e BS, sipas grupit të

Hrushovit, duhet të kuptohen si një faktor për të qenë të bindur, për t'iu nënshtruar pikëpamjeve trockiste re-vizioniste të tij.

Në letër ka edhe plot shpifje të fabrikuara kundër bazës së Vlorës duke përfshirë edhe «incidentin» që polici ynë u paskësh kërkuar tri grave sovjetike që udhëtonin në autobus, të mbanin me vete letërnjoftimet dhe kjo për ta paskësh qenë një «tragjedi e madhe», prandaj me këtë letër kërkohet që Qeveria Shqiptare, e cila ngarkohet me përgjegjësi të plotë, të zbatonte vendimin e mbledhjes së Traktatit të Varshavës.

Me anën e një letre, ne i dhamë përgjigje qeverisë sovjetike, veçanërisht për çështjen e vendimit. Përsëritëm edhe një herë pikëpamjet tona me gjakftohtësi, duke i vërtetuar të gjitha faktet dhe u thamë se vendimi i mbledhjes së Traktatit të Varshavës është i papranueshëm për ne dhe ka vetëm një zgjidhje, që baza ushtarako-detare e Vlorës të qëndrojë në duart e ushtrisë shqiptare. Tjetër zgjidhje nuk ka. Kjo do të thotë, theksonim në letër, të zbatohet marrëveshja e firmosur nga të dyja palët.

Si po zbatohet marrëveshja? Në bazë të marrëveshjes ne kishim në dorëzim të plotë anije luftarako-detare, të cilat i drejtonin oficerët tanë, kurse anijet e tjera, qysh në gushtin e vitit të kaluar, duhet të merreshin në dorëzim nga ekipazhet tona, pasi ato tashmë ishin të mësuara, të stërvitura dhe plotësisht të gatshme për t'i marrë në dorëzim.

Mirëpo, pas Mbledhjes së Bukureshtit, pala sovjetike, me pretekste të ndryshme, se gjoja nuk ka ardhur akoma koha etj., nuk po i dorëzonte anijet në bazë të

marrëveshjes. Ne u vumë në dukje sovjetikëve se marinarët tanë janë plotësisht në gjendje t'i marrin anijet në dorëzim dhe t'i drejtojnë, sepse kanë disa vjet që po mësojnë dhe janë stërvitur më mirë nga ata që na keni dërguar ju dhe që vetëm një vit kanë që janë futur në marinë. Kuptohet se qëllimi i tyre ishte të mos na i dorëzonin anijet, sepse, po të ecej sipas grafikut të caktuar me marrëveshje, ata do të na i kishin dorëzuar me kohë.

Pas vendimit të Traktatit të Varshavës ne kërkuam të mbahej statukuoja. Këtë ua thamë në mënyrë kategorike. U thamë gjithashtu se po të doni të zbatohet marrëveshja e arritur qysh më parë, sipas së cilës anijet do t'u dorëzohen ekipazheve tona mbasi të jenë përgatitur, jeni të lirë të largoheni. Edhe vetë shteti sovjetik, një vit e ca më parë ka thënë se «ekipazhet shqiptare janë të përgatitura».

Shumë kohë pas përgjigjes sonë, për të qenë solidarë me vendimin e Traktatit të Varshavës, na u dërgua një letër nga qeveria hungareze, në të cilën me terma të forta e të palejueshme, na këshillohet të zbatojmë vendimin e Traktatit të Varshavës. Por më e poshtër nga të gjitha është letra e gjermanëve, e firmosur nga një farë Vili Shtof, nënkryeministër dhe ministër i mbrojtjes, që nuk është veçse një fashist, bile edhe një fashist nuk do ta shkruante një letër të tillë. Vili Shtof me këtë letër merr haptazi në mbrojtje revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë dhe na akuzon ne si provokatorë ndaj jugosllavëve dhe grekëve. Këtij dokumenti që ne kemi në dorë, do t'i japim përgjigjen e merituar. Një letër të tillë na kanë drejtuar

dhe bullgarët. Të tjerët nuk na kanë dërguar gjë deri tani.

Në përgjigjen tonë dërguar qeverisë sovjetike ne propozonim që në rast se nuk pranohet statukuojja, që ne duam të mbahet, të vinte një komision nga Bashkimi Sovjetik për të diskutuar mbi masat dhe mënyrën për likuidimin e bazës së Vlorës, që ata dëshironin. Ata e pranuan propozimin tonë dhe komisioni erdhi. Por edhe njerëzit që e përbënin këtë komision, filluan të bënin plot provokacione. Duhej gjakftohtësia e Partisë sonë për t'u bërë ballë provokacioneve të tyre.

Ne parashtruam përsëri miqësisht tezat tona në komision, ndërsa ata qëndruan në tezat e tyre. Ata na thanë: «ose pranoni zbatimin e vendimit ose ne do të largohemi nga baza» dhe na kërkuan që t'u dorëzonim të gjitha mjetet, bile deri te bulonat dhe dërrasat që kanë përdorur për një barakë. Përfaqësuesit tanë, në frymën e letrës që u drejtuam, u përgjigjën që në rast se ju nuk pranoni pikëpamjen e drejtë të Qeverisë sonë, atëherë merrni të 8 nëndetëset dhe një bazë lundruese që shërbehen nga ekipazhet sovjetike, ndërsa të tjerat që shërbehen nga njerëzit tanë, do të qëndrojnë këtu sepse janë pronë e popullit shqiptar. Pronë e shtetit tonë, u vumë në dukje atyre, janë edhe 8 nëndetëset dhe baza lundruese që ne u thamë t'i merrnin, dhe në fakt ashtu është, ato janë bërë prona jonë me marrëveshje, qofshin që u dhanë falas, qoftë sikur edhe me para të na ishin dhënë. Kjo nga ana juridike. Por edhe nga ana morale e drejta është me ne, sepse Shqipëria është shtet socialist, anëtare e Traktatit të Varshavës, pjesëtare e kampit të socializmit. Në këtë kuptim ne



kemi një qëllim të përbashkët. Ndonjë mund të hidhet e të thotë, mirë, po ato ju janë dhënë pa para juve, shqiptarëve. Ne u përgjigjemi se ato nuk janë sheqerka ose lodra, por mjete për mbrojtjen e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të kampit të socializmit. Parulla jonë është një për të gjithë dhe të gjithë për një. Kjo parullë për Partinë tonë ka një kuptim të lartë internacionalist dhe kësaj ne i përmbahemi.

Kështu si arsyetojnë Hrushovi dhe ata që e pasojnë, mund të kërkojnë të na marrin edhe fabrikat e kombinatet që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik. Por gjëra të tilla mund t'i bëjnë vetëm njerëz të poshtër në tërë kuptimin e fjalës. Të tillë janë udhëheqësit e sotëm sovjetikë me Hrushovin në krye, prandaj demaskimi i këtyre revizionistëve do të thotë mbrojtje e Bashkimit Sovjetik.

Ne i kemi mbrojtur dhe i mbrojmë popujt e Bashkimit Sovjetik, sidomos në këto situata që ata kalojnë, sepse Hrushovi dhe grupi i tij janë armiq jo vetëm të popullit shqiptar, por edhe të popujve sovjetikë. Ne dimë e do ta dallojmë kurdoherë Bashkimin Sovjetik të kohës së Leninit dhe të Stalinit nga këta renegatë të marksizëm-leninizmit.

Revizionistët sovjetikë e dinë mirë se kundër kujt flasim ne, por, për të mbuluar veprimet e tyre antimarksishte, thonë se udhëheqësit shqiptarë sulmojnë Bashkimin Sovjetik, i hedhin baltë PK të BS etj. Ata duan që rrugën dhe kritikën tona të drejta, por të ashpra, që drejtohen kundër këtij grupi armiqësor revizionist, t'i shpjegojnë sikur drejtohen kundër popullit vëlla sovjetik, kundër PK të BS. Ne e dimë gjithashtu se

veprimtaria antimarksiste e këtij grupi drejtohet jo vetëm kundër Shqipërisë socialiste, por edhe kundër gjithë komunizmit ndërkombëtar.

Ata e kanë të qartë rrugën që ndjekim ne, po e shtrembërojnë me qëllime armiqësore dhe shpifin kundër nesh. Dje, për shembull, një shofer sovjetik i marinës shtypi një marinar tonin, i cili është në gjendje shumë të rëndë. Procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes e kanë firmosur komandantët e anijeve sovjetike, njerëz të tjerë sovjetikë dhe vetë shoferi që bëri këtë krim, ndërsa ambasada sovjetike në notën e saj, në përgjigje të notës sonë, thotë se kjo gjë nuk është e vërtetë. Plot nota me gjëra të tilla u kemi dërguar dhe kështu përgjigjen. Q'illum i fëlliqur ka dalë përsipër!

Në lidhje me bazën e Vlorës, ne i njoftuam, pra, se cilat anije mund të largohen, kurse të tjerat nuk lëvizin nga vendi. Ata bënë gjithë atë zhurmë dhe presione. Po a lëkundet mali i Tomorit nga shirat, erërat dhe furtunat? Jo, nuk lëkundet, por qëndron i palëvizur, si shkëmb graniti në këmbë. Kështu, pra, udhëheqja e Partisë e Qeveria jonë nuk u lëkundën nga vendimet e tyre. Kur e panë se nuk shkonin dot më tej, ata u larguan me nëndetëset e tyre, që nuk i kishin dorëzuar, dhe me bazën lundruese. Mirëpo na lanë këtu rreth 150 marinarë të tyre, sigurisht për mollë sherri. Ne u thamë se edhe këta duhet të largohen sa më parë nga Shqipëria, nuk kanë pse të qëndrojnë më te ne, sepse po rrinë kot dhe ky nuk është veçse një qëndrim me qëllime të këqija. Dhe në fakt veprime të tilla si ajo që kreu shoferi i tyre mund të bëjnë akoma.

Ne e dimë se fajin nuk e kanë marinarët për ato që

bëhen në bazën e Vlorës, por udhëheqja. Si është e mundur të arrijnë deri atje sa të instruktojnë marinarët të vjedhin çdo gjë që të gjejnë? Kështu nuk po lënë perde pa hequr natën, pa marrë ventilatorë, llampa elektrike, artikuj porcelani etj. Aq është e vërtetë kjo sa që vetë komandanti i tyre ka njoftuar komandën tonë se s'ka çfarë t'u bëjë njerëzve të tij, u ka folur njëqind herë që të mos veprojnë kështu, por ata janë shturur. Komandanti i prapavijës së tyre, me gradën kolonel, ka arritur të marrë, me qëllim përvetësimi, plaçka që i takojnë shtetit tonë. Kur pyetet çfarë është duke bërë kështu, se ai është komunist, përgjigjet pa pikë turpi se do t'i marrë për vete këto gjëra, sepse të tërë kështu po bëjnë.

Po përse i bëjnë gjithë këto veprime të poshtra? Sigurisht, i kurdisin për të na akuzuar ne, për të pasur gjoja sa më shumë «fakte» kundër nesh. Por me gjithë këto provokacione të ulëta kuadrot tanë kanë urdhër të mbajnë gjakftohtësinë, duke filluar që nga oficeri më i lartë e deri te marinarit i thjeshtë. Të gjithë janë treguar në nivelin e duhur, njerëz partie. Ata i shohin se këto qëndrime janë të padenja dhe u bëjnë përshtypje shumë të keqe. Dhe ne e kuptojmë se këto i bëjnë për të na dërguar vazhdimisht nota. Ja, përfaqësuesi i tyre ushtarak, më i madhi që kanë tani te ne, vjen e i ankohet komandës sonë sikur një marinar shqiptar i paska «kontrolluar» xhepat një marinar sovjetik, një tjetër marinar shqiptar «nuk ka lejuar» një marinar sovjetik të dilte në breg të detit, ose se paska «kontrolluar» pakon që ishte duke nxjerrë një marinar sovjetik etj. Me sa duket, ata po mbledhin plaç-

kat për të ikur. Në këtë situatë kjo është zgjidhja më e mirë, që ne nuk e deshëm, por që e krijuan vetë revizionistët sovjetikë.

Veprimet armiqësore sovjetike në bazën e Vlorës kryhen me urdhrin e udhëheqjes revizioniste hrushoviane, por, megjithatë, në bazë ka njerëz të mirë që u japin marinarëve tanë edhe çelësat e aparateve më delikate të nëndetëseve, i këshillojnë ku të kenë kujdes e si t'i ruajnë e t'i mirëmbajnë ato, u thonë se ne kemi qenë dhe jemi miq etj.

Partia jonë e ka thënë edhe e thotë se Vlora do të qëndrojë kurdoherë një bazë e fortë për mbrojtjen e atdheut tonë, RP të Shqipërisë, dhe të interesave të përbashkëta të popujve të kësaj zone. Kjo ka qenë, është dhe do të mbetet parimi i palëvizshëm i Partisë sonë. Ne asgjë nuk na tund nga rruga jonë. Udhëheqësit sovjetikë, po të duan, le të shkojnë më tutje. Dhe ata kanë shkuar më tutje në qëndrimet e tyre kundër nesh. Meqenëse udhëheqja sovjetike do t'i tërhiqte anijet e flotës luftarako-detare të bazës së Vlorës, nuk kishte asnjë kuptim për ne të linim të vazhdonin studimet kursantët dhe oficerët e marinës sonë që kishim dërguar në Bashkimin Sovjetik. Prandaj Qeveria jonë i dha urdhër atasheut tonë ushtarak në Moskë t'i kthente kursantët dhe oficerët tanë të marinës që studjonin në shkollat sovjetike të marinës. Atasheu ynë ushtarak u paraqit në komandën sovjetike dhe i njoftoi asaj vendimin e Qeverisë sonë. E vetmja fjalë që i thanë atasheut tonë në komandën sovjetike ishte, pse nxitoheni, por ai u përgjigj menjëherë se këtë urdhër kam nga Qeveria ime, dhe unë zbatoj urdhrin e saj.

Kështu atasheu ynë ushtarak shkoi menjëherë në Leningrad, ku, pasi njoftoi komandën e akademisë së marinës, mblodhi gjithë kursantët dhe u shpjegoi çështjen. Të gjithë njëzëri thanë se janë nën urdhrin e Partisë. Kur atasheu ushtarak shqiptar shkoi në akademinë tjetër të marinës, nuk e lejuan t'i takonte dhe të gjithë kursantët i burgosën nëpër dhoma, duke vendosur rreth tyre edhe roje. Po kursantët shpërthyen pengesat dhe morën takim me përfaqësuesin e shtetit tonë, i cili i mblodhi dhe u parashtroi si qëndronte puna. Ai u tha se urdhri i Partisë është që të ktheheni në Shqipëri. Të gjithë iu përgjigjën thirrjes si një trup i vetëm dhe me këtë rast buçitën fjalime dhe parulla për rrugën e drejtë të Partisë sonë. Kjo bëri përshtypje të madhe në gjithë kursantët dhe oficerët sovjetikë, të cilët donin të dinin përse bëheshin këto veprime të padrejta ndaj shqiptarëve, përse të burgosen shqiptarët që silleshin, qëndronin dhe mësonin aq mirë. Kështu u bë një rrëmujë e madhe që e mori vesh i madh e i vogël. Për të mposhtur njerëzit tanë komanda sovjetike dyfishoi rojet, po shumica e këtyre thanë hapur se nuk pranojnë t'i burgosin shokët shqiptarë. Atëherë këto roje i zëvendësuan me roje të tjera, po edhe ato kundërshtuan. Drejtori i njërës prej akademive të marinës refuzoi të trajtoheshin në këtë mënyrë kursantët dhe oficerët tanë që studjonin atje, ai përkundrazi i vuri në rresht dhe i shoqëroi vetë në kinema. Në një akademi tjetër, oficerëve tanë u thanë se ju do të ktheheni përsëri te ne. Kështu që arritën deri atje sa deshën t'i mbanin me forcë kursantët tanë duke i gënjyer se në Shqipëri ka shpërthyer kundërrevolucioni si në Hungari

etj. Kur atasheu ynë ushtarak po zbatonte urdhrin e Qeverisë sonë në Leningrad, dhe shefi i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Sovjetike i telefonoi dhe e njoftoi të kthehej në Moskë, ai i tha se unë zbatoj urdhrin e Qeverisë sime dhe jo tuajin. Ata e dëbuan atasheun tonë ushtarak dhe si kundërmasë ne dëbuam atasheun e tyre.

Natyrisht, ne protestuam menjëherë. Ato ditë mbli-dheshin komisionet e të dyja palëve në Tiranë për çështjen e bazës së Vlorës, por ne pezulluam punimet e komisionit tonë dhe e njoftuam palën sovjetike që në rast se nuk hiqet dorë nga masat arbitrare dhe armiqësore kundër kursantëve dhe oficerëve shqiptarë që studjonin në shkollat e marinës të Bashkimit Sovjetik, mbledhja nuk mund të zhvillohej. Kështu ata u detyruan t'i anulonin masat kundër njerëzve tanë dhe veç kësaj gënjyen duke bërë deklaratë se nuk kishin ndër mend t'i mbanin në Bashkimin Sovjetik kursantët dhe oficerët tanë të marinës dhe se do të merrnin masa për t'i kthyer në Shqipëri. Vetëm pas kësaj vazhduan bisedimet e të dy komisioneve shqiptare e sovjetike për bazën e Vlorës. Udhëheqja sovjetike u detyrua të ndryshonte qëndrimin e saj nga qëndrimi i vendosur i Partisë dhe i Qeverisë sonë, si edhe nga patriotizmi i lartë, vendosmëria e madhe dhe syri i patrembur i komunistëve, i oficerëve e i kursantëve tanë.

Njerëzit tanë që studjonin në shkollat e marinës në Bashkimin Sovjetik, mbajtën qëndrim shembullor. Porsa morën udhëzimet e Partisë, ata ishin gati për çdo sakrificë, veçse të zbatohej porosia e Partisë pa as më të voglën lëkundje. Qëndrimi i njerëzve tanë i tregoi

vendin klikës hrushoviane që organizon veprime armiqësore të pashembullta kundër vendit tonë, që ka prishur marrëdhëniet miqësore dhe vëllazërore në mes të dy vendeve tona. Po ata duhet të kuptojnë se me shqiptarët, me kuadrot e Partisë, nuk i zënë dot lopët në këtë mënyrë, sepse do të gjejnë përpara grushtin që do t'u thyejë kokën. Dhe me të vërtetë me aktin që bënë kundër kursantëve dhe oficerëve tanë të marinës, ata demaskuan veten e tyre, pasi ky akt ka bërë bujë edhe në Bashkimin Sovjetik, veçanërisht në ato qytete ku mësonin njerëzit tanë dhe që ishin të dashur e të sjellshëm me profesorët dhe me shokët e tyre sovjetikë, si edhe me popullin.

Siç e shihni, gjendja e krijuar në marrëdhëniet me Bashkimin Sovjetik është e vështirë, jemi duke kaluar situata të tilla, në të cilat duhet mbajtur gjakftohtësi. Tani për ne është e qartë me ç'njerëz kemi të bëjmë. Midis dy vendeve tona kanë ndodhur gjithë ato ngjarje që po precipitohen gjithnjë e më tepër. Ato na bindin akoma më shumë që udhëheqësit e sotëm sovjetikë, me Hrushovin në krye, jo vetëm që janë në rrugë të gabuar, por ata janë futur thellë në një rrugë armiqësore kundër kampit të socializmit dhe veçanërisht kundër RP të Shqipërisë. Ata kanë bërë çdo gjë kundër nesh dhe janë përsëri të gatshëm të bëjnë ç't'u vijë për dore, por do të thyhen. Ata kanë humbur dhe do të humbasin edhe sikur më tej të shkojnë në qëndrimet e tyre. Ata mund të marrin ndonjë vendim që të na përjashtojnë nga Traktati i Varshavës, por le ta marrin edhe këtë vendim, përgjegjësia e tyre do të jetë e rëndë, por nga zemra e popullit sovjetik dhe e popujve

të vendeve të tjera socialiste nuk mund të na nxjerrin dot. Këtë ata nuk do ta arrijnë kurrë, sado propagandë të shfrenuar që të bëjnë kundër nesh. Propaganda e tyre kundër Shqipërisë nuk do të zërë vend në masat e komunistëve dhe të popujve të tyre. Këtë e them jo vetëm në parim, por kështu është edhe në realitetin konkret.

Ne kemi qindra studentë e specialistë të tjerë që kanë lidhje me njerëz të thjeshtë sovjetikë, me komunistë sovjetikë. Ata ua kanë shpjeguar këtyre qëndrimet e Partisë sonë dhe të Hrushovit e të grupit të tij revizionist. Ata kanë qenë dhe janë në gjendje të gjykojnë këto qëndrime dhe shumica dërrmuese e tyre aprovon plotësisht vijën e drejtë të Partisë sonë. Po të mos e aprovonin, udhëheqja sovjetike do t'i linte raportet e Kongresit tonë IV të qarkullonin lirisht nëpër Bashkimin Sovjetik. Por fakti është se kundër këtyre raporteve atje është vendosur censura. Kudo është mobilizuar sigurimi sovjetik për të grumbulluar raportet, të cilat qarkullojnë dorë më dorë. Në rast se këto raporte do të ishin me përmbajtje antimarksiste, siç shpifin udhëheqësit sovjetikë, atëherë përse të mos i lënë, se të tilla punonjësit sovjetikë nuk do t'i kapin me dorë. Por raporti i Kongresit IV të Partisë sonë është marksist-leninist dhe demaskon vijën, qëndrimet dhe qëllimet e grupit të N. Hrushovit. Ata që e kanë lexuar, e kanë aprovuar atë plotësisht. Tani që po zhvillohen ngjarjet ndërkombëtare të kohëve të fundit, ata që e kanë lexuar një herë raportin, e kërkojnë përsëri t'i kthehen, se, siç thonë ata, «është një analizë reale e situatës ndërkombëtare».



Në një artikull të gazetës «Izvestia», botuar kohët e fundit, thuhet: «Deri kur do të lejohen të armatosen gjeneralët e Hitlerit?». Ky është një tym që lëshojnë këta njerëz për t'u mbuluar, sepse është lëvizja komuniste e punëtore ndërkombëtare që ngre çështjen se deri kur do të armatosen Gjermania Perëndimore. Dihet se Kenedi bën deklaratat pas deklaratash për të organizuar spiunazh dhe diversion kundër vendeve socialiste. Po ç'kanë thënë Partia Komuniste e Kinës dhe Partia e Punës e Shqipërisë? Ato kanë theksuar vazhdimisht që t'u qëndrohet dhëmb për dhëmb e t'u shtrëngohen rripat imperialistëve, sidomos imperializmit amerikan, të detyrohen ata që të vijnë në rrugën e paqes dhe të bashkekzistencës, se me pallavrat e Hrushovit me shokë ata nuk vijnë.

Ne jemi të sigurt se edhe nga takimi që do të bëjë Hrushovi me Kenedin asgjë nuk do të dalë, se jemi të qartë për qëllimet e Kenedit dhe planet e tij të hapura dhe se i njohim pikëpamjet prej pacifisti e likuidatori të Nikita Hrushovit. Diplomatët sovjetikë, kudo që janë, thonë se me këtë takim do të zgjidhen të gjitha çështjet ndërkombëtare. Ky është një falsitet i madh, një blufë tmerreshme. Si mund të shpallet që Hrushovi shkon në këtë takim për të vendosur për problemet e rëndësishme ndërkombëtare, kur në të vërtetë shkon për të biseduar me Kenedin për çështje që u takojnë vetëm Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës? Ne dimë se edhe nga kjo mbledhje do të dalë vetëm tym. Kjo nuk do të thotë se ne nuk jemi për paqen. Ne jemi të vendosur për paqen, por jo në rrugën që ecin Hrushovi dhe të gjithë ata që i mbajnë

ison. Paqja nuk zgjidhet në atë rrugë. Por Hrushovi kërkon të krijojë një situatë të favorshme derisa të kalojë Kongresi XXII i PK të BS që do të aprovojë edhe programin e partisë.

Kështu janë zhvilluar marrëdhëniet midis dy vendeve dhe partive tona, kurse nga ana ekonomike të gjitha ndihmat dhe kreditë janë pezulluar. Këtë e deklaroi Hrushovi në mbledhjen e fundit të Traktatit të Varshavës, e përsëritën edhe gjithë të tjerët. Çështjen e ndihmave dhe të kredive ata e kanë ngritur në një mënyrë të urryer antimarksiste, domethënë sikur ata me Ulbrihtin janë duke na mbajtur shpirtin gjallë. Ata thonë do ta merrni këtë ndihmë në rast se na nënshtroheni neve. Por një gjë e tillë kurrë nuk do të ngjasë. Këtë lloj ndihme ne nuk e duam, se populli shqiptar dhe Partia e tij janë nga ata që rrojnë edhe me një kothere bukë.

Edhe udhëheqësit çekoslovakë ecin në rrugën e Hrushovit. Po sido që të bëjnë edhe këta do të humbasin. Ne jemi në rrugë të drejtë, ne vërtet e kemi pësuar nga këto veprime, por kemi mësuar shumë. Gjyqin tonë të fundit revizionistët sovjetikë dhe ata që i pasojnë nuk e besuan, asgjë nuk shkruan në shtypin e tyre. Mirë, le të mos shkruajnë, nesër do të shohin çfarë do të dalë; popujt sovjetikë, bullgarë e të tjerë do të vijë koha të mësojnë se ç'ishin këta armiq dhe tradhtarë. Për ne rëndësi ka fakti që në këto situata populli ynë është i bashkuar si grushti rreth Partisë, që uniteti i Partisë sonë është i çeliktë, që populli dhe Partia janë të ngritur politikisht, ideologjikisht dhe moralisht dhe të lidhur si një trup i vetëm rreth KQ të Partisë dhe

Qeverisë. Kjo përbën forcën e pamposhtur të atdheut tonë.

Asnjë intrigë, asnjë punë armiqësore e Hrushovit dhe e shokëve të tij nuk mund të ketë sukses dhe aq më tepër të mposhtin Partinë tonë. Vështirësi do të kemi, po ne do të fitojmë, kurse ata do të humbasin. Rëndësi ka pasur dhe ka çështja që njerëzit duhet t'i vëmë në dijeni. Qartësia e njerëzve në këto situata dhe për këto çështje ka bërë që të forcohet uniteti ynë, të mos lejojmë që shpifjet e armiqve kundër nesh të zënë vend dhe të krijojnë gjëra të paqarta te njerëzit tanë për të krijuar pastaj situata të ndera në Parti dhe në popull.

Ne Partinë e kemi mbajtur kurdoherë në dijeni, i kemi thënë si qëndron e vërteta. Kjo i ka kalitur njerëzit tanë dhe ka bërë që edhe të lëkundshmit, ose ata që nuk janë të ngritur politikisht, t'i kuptojnë drejt këto çështje dhe të luftojnë kundër kësaj veprimtarie të madhe antimarksiste që po zhvillojnë armiqtë, imperialistët, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë, si edhe grupi revizionist i Nikita Hrushovit.

Veprimtaria e këtij grupi nuk ka marrë fund, por ne të ruajmë si kurdoherë gjakftohtësinë. Kjo nuk është një çështje e thjeshtë. Vetëm një parti marksiste-leniniste, e kalitur në luftëra dhe në vështirësi, mund të ruajë gjakftohtësinë, një parti që është në rrugë të drejtë nuk tronditet. Një parti e tillë është Partia jonë, e cila në këto situata ka vepruar kurdoherë drejt, në mënyrë marksiste-leniniste, prandaj edhe është kalitur.

Situata e sotme, në radhë të parë, kërkon të ruajmë

unitetin. Kjo ka rëndësi vendimtare. Armiqtë e Partisë sulmojnë udhëheqjen e saj se ajo gjoja na qenka antisovjetike. Kjo është parulla e tyre. Ata, duke përfutuar nga dashuria e madhe që ka Partia jonë për Bashkimin Sovjetik, përpiqen të krijojnë dyshime te njerëzit dhe ta shtrojnë çështjen si Koço Tashkoja se ai që e do Bashkimin Sovjetik duhet të mbrojë edhe Hrushovin. Por duke demaskuar Hrushovin nuk do të thotë aspak se ne jemi kundër Bashkimit Sovjetik. Ne themi se një udhëheqje që është kundër socializmit, që vepron kundër interesave të kampit dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare duhet demaskuar pa mëshirë. Populli e do udhëheqjen kur ajo ecën në rrugë të drejtë, por kur e shtrembëron rrugën askush nuk e ndjek.

Po të ishte se udhëheqja jonë do të qe kundër marksizëm-leninizmit, kundër socializmit, kundër lirisë dhe pavarësisë së atdheut, atëherë përse do ta donte kaq shumë Partinë populli ynë? Populli e do Partinë pikërisht se ajo ecën e papërkulur në rrugën marksiste-leniniste, se ajo ndërton me sukses socializmin, mbron interesat e atdheut dhe të popujve. Njerëzit e grupit të Hrushovit me propagandën e tyre mundohen të krijojnë dyshime te njerëzit e dobët.

Ne e duam Bashkimin Sovjetik, po veprimet armiqësore që bën grupi i Hrushovit kundër Shqipërisë ne nuk do të rrimë pa ua përplasur në fytyrë, sigurisht pa shkelur normat dhe rregullat që ekzistojnë në marrëdhëniet tona. Mendojmë se nuk ka ardhur koha të shkruajmë në gazeta për këto çështje, por në mbledhjet ndërkombëtare të partive ne do të mbajmë qëndrim

të bazuar në vijën e drejtë të Partisë sonë, do të shprehim, pra, pikëpamjet e Partisë sonë. Në qoftë se këto pikëpamje bien në kundërshtim me ato të grupit të Nikita Hrushovit, aq na bën.

Ne do t'ua themi këto pikëpamje të drejta njerëzve të Partisë sonë, sepse edhe kundërshtarët tanë nuk rrinë pa ua thënë shpifjet kundër nesh njerëzve të tyre. Ata u dërgojnë organizatave të partisë letra pas letrash, po argumentet e tyre janë pa kripë dhe s'i beson njeri. Në këto letra u shkruajnë: «Enver Hoxha i hodhi baltë Bashkimit Sovjetik», «Enver Hoxha është kundër Bashkimit Sovjetik», «Partia e Punës e Shqipërisë ka dalë në rrugë antimarksiste».

Ne, pra, duhet t'i armatosim mirë njerëzit tanë, t'i informojmë mirë dhe drejt që të dinë ç'bëjnë ata. Jo vetëm ne anëtarët e Partisë duhet të dimë të bëjmë diferencimin midis Bashkimit Sovjetik e Partisë së lavdishme të Leninit dhe këtij grupi armik me Hrushovin në krye, që kanë ngritur dorën kundër një vendi socialist, por edhe populli duhet të edukohet që të dijë ta bëjë këtë diferencim. Ne jemi me popujt e Bashkimit Sovjetik edhe në këto situata të vështira për ta.

Të kemi parasysh se kudo bëhen pyetje, por të mos merret se ato bëhen me qëllim të keq. Njerëzit tanë janë dhe duam të jenë politikë. Por, që të jenë të tillë, ata duhet të sqarohen, të mos hezitohet t'u jepen argumentet ashtu siç janë. Kurdoherë që të paraqitet rasti t'i sqarojmë si ata me parti, ashtu edhe ata pa parti. Ne do t'ua themi popullit e gjithë atyre që pyesin se ç'qëllime ka Hrushovi për bazën e Vlorës dhe në radhë të parë do t'i themi Partisë që ajo të jetë mirë në

dijeni. Në qoftë se dikush në rrugë, në aktiv, apo në konferencë, të bën një pyetje, duhet dhënë përgjigje, natyrisht e matur, objektive, me gjakftohtësi, në rrugë marksiste-leniniste.

Njerëzit vetvetiu bëjnë pyetjen: si qëndron çështja me Bashkimin Sovjetik? Ne duhet t'u përgjigjemi se në krye të shtetit dhe të partisë atje është një grup revizionist dhe popujt e BS tani po kalojnë situata të vështira. Sigurisht grupi i Hrushovit ka mjete të mëdha propagande, por nuk është aq e lehtë për ta të mbytin drejtësinë dhe zërin e së vërtetës, të Partisë së Punës të Shqipërisë, të Partisë Komuniste të Kinës etj.

Prandaj, në këto situata, Partia jonë të jetë në këmbë për të mbrojtur interesat e Partisë e të popullit, për të ruajtur dhe për të mbrojtur njerëzit. Kini kujdes me njerëzit, shokë, se në këto situata presioni i armikut është i madh, i madh është presioni që na bën imperia-lizmi me gjithë fuqinë e propagandës së tij, e madhe është propaganda dhe presioni i revizionistëve jugosllavë, i monarko-fashistëve grekë, të shumta e të pandërprera janë sulmet e tyre. I gjithë ky presion mund të shkaktojë trubullira te njerëzit me nerva të dobët, shumë nga ata mund të thyhen. Prandaj duhen mbajtur afër, të këshillohen, të korigjohen, të ndihmohen, të shërohen dhe të inkurajohen të ecin përpara.

Armiqtë duan që të hidhen poshtë njerëzit që nuk i përmbajnë nervat në këtë situatë. Kundër elementëve armiq Partia di si të veprojë, por të tërë në një thes nuk duhen futur, sidomos njerëzit e mirë të popullit dhe anëtarët e Partisë. Ka prej tyre që nuk i kuptojnë si duhet këto momente të vështira, që u errësohet gjykimi.

Me këta njerëz, ose me komunistë të tillë duhet të sillemi si mjeku me të sëmurët nga gripi, tifoja ose tuberkulozi, i cili përpiqet deri në fund t'i shërojë.

Por ne asgjë nuk na tremb se Partinë e kemi të fortë. Ju, shokë, jeni drejtues partie në rrethe, jetoni ditë e natë me masat dhe vetë e konstatooni se nuk është parë kurrë një mobilizim dhe entuziazëm kaq i madh në popull dhe në komunistët, një patriotizëm kaq i lartë, josentimental, po konkret, në punë dhe në luftë për realizimin e detyrave dhe për kapërcimin e vështirësive. Kjo tregon forcën e madhe të Partisë dhe të popullit tonë. Këtu njihen njerëzit, në momentet e vështira dhe te njerëzit tanë patriotizmi është ngritur në një nivel shumë të lartë, gjë që tregon sa e zonja dhe e kalitur është Partia jonë. Prandaj të punojmë akoma më mirë që ta kalitim edhe më shumë Partinë, ta forcojmë edhe më tej unitetin e saj, ta mbajmë të qartë masën e Partisë, t'ia themi si po zhvillohen situatat, mos t'ia fshehim, por t'ia tregojmë në mënyrë objektive, ashtu siç kanë ndodhur, pa i shtuar ose pakësuar gjë, dhe bashkë me Partinë të bëjmë që edhe populli të jetë i qartë.

Për t'i përballuar me sukses sulmet që na bëhen, kuptohet rëndësia vendimtare që ka realizimi i planeve tona në të gjitha drejtimit, jo vetëm në ekonomi, por edhe në sektorët e arsimit, të kulturës etj. Të vëmë të gjitha forcat tona, të punojmë me mish e me shpirt e në të gjitha drejtimit që t'i realizojmë dhe bile t'i tejkalojmë planet si përgjigje të sulmeve që na bëhen nga të katër anët. Populli ynë është i mrekullueshëm, përkrahës aktiv i vijës së drejtë të Partisë së tij, i gatshëm

për të bërë çdo sakrificë, prandaj të dimë ta mobilizojmë drejt atë për realizimin e planeve. Atëherë ne do ta meritojmë plotësisht besimin e madh që ka populli ndaj Partisë.

Përveç punës vetëmohuese, hovit revolucionar dhe gatishmërisë së masave të gjera punonjëse për realizimin e planeve ekonomike, ne do të kemi të gjitha ndihmat e nevojshme edhe nga Republika Popullore e Kinës. Nga Kina kanë filluar të vijnë grupet e para të specialistëve, të cilët së bashku me specialistët tanë do të studjojnë vendet ku do të ndërtohen uzinat dhe fabrikat që parashtron plani i tretë pesëvjeçar.

Është interesant dhe shumë inkurajues fakti se kudo ku kanë qenë specialistët sovjetikë, porsa u larguan këta, njerëzit tanë kanë marrë punën në dorë dhe kur u bënë disa korigjime në plan, nga kolektivët dhe specialistët tanë i janë drejtuar letra Komitetit Qendror me kërkesën që planet të mos shkurtohen, duke shprehur kështu besimin se ata janë në gjendje të sigurojnë realizimin e plotë të planeve të caktuara. Pra në të gjitha drejtimet planin e pesëvjeçarit të tretë e kemi të siguruar.

Marrëdhëniet me Republikën Popullore të Kinës i kemi shumë miqësore, jo vetëm në fushën ideologjike, por edhe në çështjet politike dhe ekonomike. Të gjitha problemet tona politike kanë gjetur aprovimin e plotë edhe nga shumë parti të tjera. Ne kemi përkrahjen dhe mbështetjen e të gjithë popujve revolucionarë në botë.

Ne do të përpiqemi, si kurdoherë, që kjo situatë e nderë me disa parti të eliminohet, por vetëm në rrugën marksiste-leniniste. Ne asnjë koncesion nuk do të bëj-



më përse u përket parimeve. Ne kërkojmë që Hrushovi dhe ata që e pasojnë të heqin dorë nga veprimet anti-marksiste dhe armiqësore që bëjnë, veçanërisht kundër Shqipërisë. Ne kemi qenë dhe jemi për miqësinë me Bashkimin Sovjetik e me të gjitha vendet e demokracisë popullore. Ne, nga ana jonë, nuk do të bëjmë asgjë për të acaruar marrëdhëniet me këto vende, por kjo nuk varet nga ne. Kjo varet nga ata. Deri tani nuk shohim ndonjë shenjë në këtë drejtim, përkundrazi ata çdo ditë na dërgojnë nga një notë me qëllime tendencioze e shpifje, por ne notave të tyre u përgjigjemi dhe i vëmë në vend gjërat.

Tani, shokë, ju do të shkoni në bazë dhe njerëzit mund t'ju pyesin. Kini parasysh që çështjet të sqarohen drejt, ashtu siç janë në të vërtetë. Të kuptohet mirë se marrëdhëniet tona me udhëheqjen sovjetike nuk janë më si përpara dhe për këtë shkaktarë janë ata vetë. Sot udhëheqja sovjetike zhvillon një veprimtari të gjerë agjenturale kundër vendit tonë. Nuk është më ajo situatë kur çdo gjë ishte kudo e hapur për njerëzit sovjetikë. Prandaj, kur këta vijnë poshtë, shokët tanë të jenë të kujdesshëm dhe vigjilentë. Atyre që janë diplomatë, që bëjnë vizita në vendin tonë, tani nuk mund t'u japim çfarëdo gjë që kërkojnë. Ata përpara kanë ditur shumë gjëra tona të brendshme, ne asgjë s'u kemi mbajtur fshehur, natyrisht si miq. Tani ne nuk jemi aspak të detyruar t'u japim informata dhe t'u themi si shkon industria, si jemi me bukën etj. Mund t'u themi, fundi i fundit, si punon dega e shoqërisë së miqësisë me BRSS, po edhe këtu t'u lihet të kuptojnë se nuk pranojmë kontroll mbi aktivitetin e saj, për arsye se kur vete ambasadori ynë

në një mbledhje të shoqërisë së miqësisë BRSS-Shqipëri, që bëhet një herë në vit në Moskë, nuk i japin as fjalën të përshëndesë, sa ai detyrohet të kërkojë me insistim t'i jepet fjala. Kur të ndërrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet ndaj Partisë dhe vendit tonë, pastaj shohim e bëjmë.

Natyrisht, njerëzit sovjetikë të priten në mënyrë korrekte dhe, kur bëjnë pyetje provokuese, t'u përplasen fytyrës përgjigjja e duhur. Kur pyetjet e tyre kanë qëllim vëzhgimi ose informacioni, domethënë karakter thjesht spiunazhi, atëherë u thoni haptazi se të tilla informata nuk u jepen. Gjer këtu është kufiri juaj, u thoni. Kur të shihni se bëjnë gjëra të turpshme ndaj njerëzve tanë, si presione, shantazhe, kërcënime etj., i demaskoni.

I mësoni njerëzit tanë të luftojnë dhe të mbajnë qëndrime të drejta ndaj të gjitha veprimeve armiqësore, në të njëjtën kohë të luftojnë që ta forcojnë miqësinë me Bashkimin Sovjetik dhe këto qëndrime ndaj këtyre njerëzve nuk e dobësojnë aspak miqësinë tonë me popujt e Bashkimit Sovjetik. Duke vepruar kështu, ne jemi në rrugë të drejtë.

Ndonjë gjë tjetër për të thënë nuk kisha. Këto ishin çështjet që unë dëshiroja t'ju theksoja.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM URIMI ME RASTIN E 60-VJETORIT  
TË DITËLINDJES**

**31 maj 1961**

**SHOKUT MIHAL LAKO**

**Korçë**

I dashur shoku Miha,

Ju dërgoj përshëndetjet më të nxehta shoqërore me rastin e 60-vjetorit të ditëlindjes suaj dhe ju uroj shëndet e jetë të gjatë për të mirën e Partisë sonë të dashur, të familjes dhe tuajën personalisht!

Partia ka te ju, shoku Miha, një bir besnik që, prej një kohe të gjatë, keni punuar dhe keni luftuar pa ndërprerje për përhapjen e ideve komuniste në vendin tonë e për formimin e Partisë dhe, pas themelimit të saj, keni luftuar me konsekuencë për zbatimin me besnikëri të vijës marksiste-leniniste të Partisë për të mirën e saj, të popullit, të atdheut tonë të shtrenjtë dhe të çështjes së madhe të socializmit.

Shoku dhe miku im i dashur, të rroni për shumë vjet akoma, i lumtur, i gëzuar dhe plot shëndet, për të luftuar si kërdoherë me vendosmëri për kauzën e madhe dhe të drejtë të Partisë sonë marksiste-leniniste!

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **MBROJTJA E KUFIJVE ËSHTË DETYRA MË E LARTË PATRIOTIKE**

*Fjala në aktivin e Partisë të forcave të kufirit*

**2 qershor 1961**

Jam shumë i gëzuar që po bisedoj me ju, shokë ushtarë dhe oficerë të kufirit. Me këtë rast, në emër të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Qeverisë së RPSH ju uroj për punën tuaj të madhe patriotike që po kryeni ditë e natë, në ruajtje të kufijve të shtrenjtë të atdheut tonë.

Kjo detyrë që kryeni ju si komunistë dhe si patriotë është detyra më e lartë që u ka ngarkuar Partia dhe populli bijve të tij, sepse mbrojtja e kufijve do të thotë mbrojtja e lirisë dhe e pavarësisë së atdheut, mbrojtja e fitoreve të socializmit dhe e jetës së lumtur të popullit tonë. Këto çështje jetike me asgjë tjetër nuk mund të barazohen, asgjë tjetër nuk mund të vihet mbi to, sepse për realizimin e tyre, populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, ka bërë sakrifica të mëdha, ka derdhur shumë gjak. Por të tilla sakrifica nuk i janë

dashur të bëjë vetëm brezit tonë. Sakrifika si këto janë bërë edhe nga brezat paraardhës, të cilët kanë luftuar me heroizëm për të realizuar ëndrrat dhe dëshirat e popullit tonë heroik.

Na bie neve detyra e madhe që fitoret e tanishme, të arritura nga populli shqiptar me përpjekje dhe heroizma, me luftëra dhe me gjak, t'i ruajmë, t'i mbrojmë dhe t'i zhvillojmë për brezat që do të vijnë në vendin tonë gjatë shekujve.

Armiqtë përpiqen të cenojnë kufijtë e atdheut tonë, prandaj kufijtë tanë duhet të mbrohen me vigjilencën më të madhe, ashtu sikurse i mbroni ju. Ju dhe populli, duke qenë vigjilentë, do të zbuloni dhe do të mbytni çdo përpjekje, çdo organizim të fshehtë dhe çdo komplot që do të orvaten të bëjnë armiqtë e popullit tonë dhe të socializmit, qofshin këta të brendshëm ose të jashtëm. Kështu ka ndodhur gjatë gjithë periudhës pas Çlirimit të vendit. Kështu do të ngjasë edhe në të ardhshmen.

Ne flasim me plot siguri për një gjë të tillë, sepse në krye kemi Partinë tonë të lavdishme marksiste-leniniste, e cila ka dalë nga gjiri i një populli heroik, sepse ajo, gjatë gjithë jetës së saj, ka mbrojtur me çdo kusht marksizëm-leninizmin. Një parti e tillë, pra, që qëndron fort në pozitë e marksizëm-leninizmit, kuptohet se i zhvillon në të gjitha drejtimet virtytet më të mira dhe më të larta të popullit, ajo zhvillon në interesin e popullit ekonominë e vendit dhe këtë ekonomi, që lulëzon dita-ditës, e vë në shërbim të të gjithë popullit. Prandaj ne jemi të sigurt kur themi se Shqipëria e re, e ndërtuar nga duart e arta të popullit të vet që udhëhiqet nga një Parti e kalitur marksiste-leniniste, do të ecë kurdoherë

përpara në rrugën e socializmit dhe të komunizmit dhe do të mposhtë çdo orvatje të imperialistëve, të revizionistëve e të çdo armiku tjetër, të hapur ose të fshehtë, të popullit tonë dhe të marksizëm-leninizmit.

Partia jonë është e lidhur ngushtë me popullin e vet. Këto që themi nuk janë formula, shokë, por realitet i gjallë, janë zbatim i jetë i parimeve marksiste-leniniste. Është vërtetuar dhe po vërtetohet nga vetë jeta se në momentet më të vështira dhe më të rrezikshme Partia me popullin dhe populli me Partinë janë të lidhur shumë ngushtë. Që të kuptosh këtë të vërtetë, nuk është nevoja të jesh filozof. Kjo ndodh, sepse populli shqiptar sheh se në saje të Partisë, në saje të udhëheqjes së saj të drejtë, ai gëzon gjithë këto të mira sot, ai sheh qartë dhe perspektivat që i janë hapur për të ardhshmen. Populli sheh se Partia punon, ndërton, vigjilon dhe sakrifikon për të mirën e tij, se Partia nuk i mban asgjë të fshehtë popullit, se çdo të mirë e të keqe, çdo vështirësi e hall ajo e ndan me popullin e vet. Dhe nuk ka si të jetë ndryshe.

Partia jonë kurdoherë i ka pasur kartërat të hapura me popullin. Prandaj ekziston një unitet i çeliktë në mes të Partisë dhe të popullit në çaste gëzimi dhe vështirësish, në ditë të mira dhe të këqija.

Dy plane pesëvjeçare janë realizuar në vendin tonë dhe shikoni si ka ndryshuar faqja e Shqipërisë e mbi të gjitha si kanë ndryshuar njerëzit. Janë rritur ndërgjegjja patriotike, mirëqenia dhe kultura e popullit, është krijuar besimi në forcat e veta dhe këto kanë bërë që të realizohen planet, të ndryshojë e të zbukurohet atdheu, të lulëzojë industria, e cila në të kaluarën gati

nuk ekzistonte, dhe të arrijë në një shkallë të tillë zhvillimi që s'është parë. Gjithashtu edhe në bujqësi, me gjithë vështirësitë e natyrës në tre vjetët e fundit, planet janë realizuar me sukses të madh.

Plani i tretë pesëvjeçar që u shtrua dhe u aprovua në Kongresin IV të Partisë do ta forcojë akoma më shumë ekonominë tonë. Tani ky plan është duke u realizuar me sukses. Që nga fillimi i vitit e deri tani gati të gjitha ndërmarrjet ekonomike, që janë me qindra, jo vetëm e kanë realizuar, por edhe e kanë tejkaluar planin. Realizimi i pesëvjeçarit të tretë do të forcojë më tej ekonominë tonë, do të bëjë të përparojnë industria, bujqësia, mirëqenia e kultura e popullit. Kjo do të arrihet kryesisht me forcat e popullit tonë. Garanci për këtë janë vija e drejtë marksiste-leniniste e Partisë në të gjitha fushat, si dhe ndihma internacionaliste e vendeve socialiste. Secili nga këta faktorë ka vendin dhe rëndësinë e vet, ata pleksen me njëri-tjetrin dhe janë të nevojshëm për ndërtimin e socializmit.

Partia jonë e ka vlerësuar drejt ndihmën vëllazërore dhe internacionaliste si dhe bashkëpunimin e ngushtë dhe të sinqertë, në rrugën marksiste-leniniste me vendet socialiste. Ky parim ka qenë dhe mbetet i drejtë. Por nuk është aspak e drejtë pikëpamja e udhëheqjeve të disa vendeve socialiste, të cilat me qëllime të caktuara dhe për arsyt që do t'i shpjegoj, mendojnë se, duke ia pezulluar, ose duke mos i dhënë ndihmën vëllazërore dhe internacionaliste Shqipërisë socialiste, kjo do të izolohet dhe do të detyrohet të shkojë në rrugë qorre, antimarksiste. Ato gabohen rëndë. Në realizimin e pesëvjeçarit të tretë Partia jonë do të qëndrojë si kurdoherë.



në rrugën e saj marksiste-leniniste edhe përsa i përket bashkëpunimit vëllazëror me vendet socialiste. Si në parim ashtu dhe në praktikë janë nënshkruar marrëveshje me vende socialiste, por në fakt ndihmë të madhe vëllazërore ne kemi nga Republika Popullore e Kinës.

Ju jeni në dijeni që, para se të aprovohej plani i tretë pesëvjeçar nga Kongresi IV, Bashkimi Sovjetik dhe të gjitha vendet e demokracisë popullore të Evropës, kush më shumë e kush më pak, i kishin premtuar vendit tonë ndihma materiale, për të cilat u nënshkruan edhe marrëveshjet përkatëse dhe u bë detajimi sipas sektorëve të ndryshëm. Mirëpo, pas Mbledhjes së Bukureshtit, pas qëndrimit të palëkundur marksist-leninist të Partisë sonë, udhëheqjet e vendeve socialiste të Evropës, me udhëheqjen e Bashkimit Sovjetik në krye, i kanë pezulluar këto ndihma, kanë folur nëpër mbledhjet e ndryshme ndërkombëtare se nuk do të na i japin ato, ashtu siç e kanë zakon të veprojnë njerëzit që nuk bazohen në parimet dhe shkelin pa kurrfarë skrupuli marrëveshjet e firmosura. Në letrat që ata i kanë drejtuar Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeverisë sonë nuk e kanë guximin ta thonë haptazi këtë, ndërsa në fakt ia kanë prerë ndihmat dhe kreditë Republikës Popullore të Shqipërisë. Këto qëndrime të tyre kundër vendit tonë le t'i gjykojë historia dhe patjetër do të vijë me siguri koha që këto do të gjykohen si akte të turpshme në marrëdhëniet midis shteteve. Ne tani ia shtrojmë dhe ia bëjmë të qarta këto gjëra popullit tonë, sepse pa popullin Partia nuk ka jetë.

Partia dhe Qeveria jonë i kuptuan dredhitë dhe pikësynimet e këtyre udhëheqjeve antimarksiste, prandaj

morën masa që plani i tretë pesëvjeçar të realizohej dhe RPSH të mos izolohej. Përkrah nesh u gjendën parti dhe vende të tjera socialiste, të gatshme si kurdoherë për ta ndihmuar Shqipërinë. Kështu, Partia Komuniste e Kinës dhe Qeveria e RP të Kinës nuk u pajtuan aspak me këtë qëndrim fare të padrejtë që po mbahej ndaj Shqipërisë dhe i dhanë asaj një ndihmë të madhe, e cila kompensonte ndihmën që Bashkimi Sovjetik dhe vendet e tjera socialiste të Evropës i kishin akorduar Republikës Popullore të Shqipërisë. Kështu mbështetja e planit tonë të tretë pesëvjeçar nga jashtë është e mjaftueshme.

Shokë, një entuziazëm i madh që nuk është parë kurrë, ka shpërthyer në të gjithë vendin, një mobilizim total i të gjitha masave punonjëse për të realizuar dhe për të tejkaluar me sukses planin e ri pesëvjeçar. Kjo është një siguri e madhe dhe në këtë vrull të fuqishëm patriotik bën pjesë edhe puna juaj e palodhur për të ruajtur me vigjilencë kufijtë e shtrenjtë të atdheut, bëjnë pjesë përpjekjet, sakrificat dhe mundimet tuaja. Partia e di se ju bëni shumë sakrifica, sepse jeta juaj e përditshme nuk është si jeta paqësore e punonjësve të qytetit ose të fshatit, sepse ju e kryeni detyrën në male, në gërxhe dhe në pyje. Kur të tjerët flenë, ju rrini zgjuar ditë dhe natë, jeni vazhdimisht në rrezik, sepse armiku përpiqet të gjejë shteg të kalojë kufirin e të futet në tokën tonë, për të dëmtuar ndërtimin e socializmit të ne. Prandaj puna juaj është fisnike, e lavdishme dhe bën pjesë në këtë hov të madh patriotik që ka pushtuar gjithë popullin tonë.

Ne kufijtë tanë do t'i ruajmë me vigjilencën më të

madhe derisa të ekzistojnë armiqtë imperialistë dhe shërbëtorët e agjentët e tyre besnikë, revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, neofashistët italianë, derisa ekziston kërcënimi i ndërhyrjeve ushtarake brutale kundër atdheut tonë që kërkojnë të na rrëmbejnë lirinë, fitoret e arritura dhe të na shtypin. Derisa rrezikohen liria dhe pavarësia e atdheut ne barutin do ta mbajmë kurdoherë të thatë, kufijtë do t'i ruajmë si sytë e ballit dhe njëkohësisht do të forcojmë dashurinë dhe miqësinë ndaj popujve vëllezër. Kjo dashuri dhe miqësi, ndjenjat tona të internacionalizmit proletar për këta popuj nuk varen nga hapja e kufijve, siç bëjnë bullgarët, të cilët ua kanë hapur kufijtë revizionistëve jugosllavë gjoja për vëllazërimin e popujve bullgar e jugosllavë. Përkundrazi, interesat e forcimit të miqësisë dhe të pozitave të socializmit kërkojnë që të demaskohet pa mëshirë përpara syve të të gjithë botës dhe përpara popujve të Jugosllavisë klika revizioniste e Beogradit, sepse ajo është një rrezik për socializmin dhe për vetë popujt e Jugosllavisë. Kjo nuk u pëlqen Nikita Hrushovit dhe atyre që e pasojnë. Por Partia jonë zbaton vijën e saj ideologjike dhe për këtë ajo mban përgjegjësi para popullit të vet si dhe komunizmit ndërkombëtar. Popullin, Partia e Punës e Shqipërisë e informon çdo ditë për veprimtarinë e saj, ndërsa nëpërmjet sukseseve të arritura në ndërtimin e socializmit në Shqipëri, qëndrimeve të saj politike për problemet ndërkombëtare dhe në mbledhjet ndërkombëtare të partive komuniste e punëtore, ajo jep kontributin e saj për fitoren e komunizmit ndërkombëtar. Kurdoherë, kur ka qenë rasti, Partia jonë ka mbajtur qëndrime të drejta e të vendosura

dhe një nga këto raste ka qenë edhe Mbledhja e Bukureshtit.

Në Bukuresht, Hrushovi dhe shokët e tij kurdisën një komplot shumë të rrezikshëm për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ishte çështja për të flakur jashtë kësaj lëvizjeje Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës, si një parti gjoja antimarksiste, dogmatike dhe puna arriti deri atje sa Hrushovi me gojën e tij t'u thoshte shokëve kinezë para mbledhjes që ju, po të doni, shkëputuni nga kampi. Vetëm Partia e Punës e Shqipërisë nuk ishte dakord me këtë qëndrim dhe u tha ndal komplotistëve.

Mosmarrëveshjet me udhëheqjen sovjetike, kundërshtimet tona me të kishin filluar para Mbledhjes së Bukureshtit, bile para vizitës së Hrushovit në Shqipëri, të cilin ne e pritëm si përfaqësues të BS, duke manifestuar kështu dashurinë dhe miqësinë që ushqen populli ynë për popujt sovjetikë. Ne si marksistë dhe në rrugë marksiste, disa herë me radhë, i kishim vënë në dukje N. Hrushovit pikëpamjet tona për revizionistët jugosllavë, për mbrojtjen dhe për marrjen nën sjetull që ai u bënte tradhtarëve, për disa qëndrime të gabuara politike në çështjet e mëdha ndërkombëtare etj. Ne nuk i kemi gëlltitur ç'na kanë servitur ata, por si marksistë ua kemi vënë në dukje pikëpamjet tona.

Ne e dinim se vendimi që mori Partia jonë, për të kundërshtuar Hrushovin në Mbledhjen e Bukureshtit, do të ishte me pasoja për ne, por ishte vendim i drejtë. Ky vendim u vu përballë veprimeve dhe qëndrimeve antimarksiste qoftë të udhëheqjes sovjetike, qoftë të udhëheqjes bullgare, polake, rumune etj. Partia jonë ishte plotësisht e bindur se kështu mbrohej marksizëm-

-leninizmi, komunizmi ndërkombëtar, internacionalizmi proletar.

N. Hrushovit, udhëheqjes së sotme sovjetike dhe të gjithë atyre që i pasojnë nuk u pëlqeu qëndrimi i drejtë i Partisë sonë në Bukuresht dhe prandaj qysh atëherë filluan haptazi goditjet dhe sulmet kundër Partisë dhe vendit tonë. Kështu, për shembull, u dukën ndërhyrjet e njerëzve sovjetikë me mënyra agjenturale kundër udhëheqjes sonë me anë të Liri Belishovës e të Koço Tashkos, provokuan e nxitën ushtarakët kundër udhëheqjes së Partisë, filluan kërcënimet e presionet në fushën e ekonomisë, na u drejtuan letra nga KQ i PK të BS me qëllim që ta fusnin udhëheqjen tonë në rrugën e prapaskenave antimarksiste për të biseduar për mosmarrëveshjet me Partinë Komuniste të Kinës, pa përfaqësuesit e kësaj partie, me qëllim që të përgatitnin terrenin e favorshëm për ta në Mbledhjen e Moskës, që u mbajt më vonë.

Partia jonë ka qenë një nga inisiatorët që parashtrori dhe kërkoi që çështjet, të cilat u shtruan në Bukuresht në mënyrë të shpejtuar e antimarksiste, të shtroheshin në një mbledhje të gjerë të komunizmit ndërkombëtar të përgatitur mirë. Prandaj u kërkua që këto çështje të diskutoheshin në Mbledhjen e Moskës dhe Partia jonë insistoi deri në fund për këtë.

Udhëheqja sovjetike përdori të tilla dredhi që ne nuk mund t'i imagjinonim kurrë, por që tani pasurojnë dita-ditës eksperiencën tonë në luftën kundër armiqve të marksizëm-leninizmit. Ata kërkonin nga ne t'i rregullonim punët ashtu si donin ata dhe të shkonim në Mbledhjen e Moskës me një zile, të shuhej kështu zëri i PPSH

që kumboi fuqishëm në Bukuresht, por nuk ia arritën dot qëllimit. Para Mbledhjes së nëntorit të vitit 1960, në Moskë, ata u përpoqën me të gjitha mënyrat dhe përdorën mbi ne të gjitha mjetet «për të na bindur», me të butë e me kërcënime, por asgjë nuk u piu ujë. Të gjitha taktikat e tyre u përngjasin atyre të revizionistëve jugosllavë, por akoma më të stërholluara.

Partia jonë ka një eksperiencë të gjatë në luftën kundër revizionistëve, gjë që e ka ndihmuar atë të parashikojë saktë rrugët nga do të kalonte sot dhe nesër udhëheqja sovjetike me kursin antimarksist që kishte nisur.

Udhëheqësit sovjetikë kishin kohë, që tre vjet më parë, që ambasadën tonë në Moskë e konsideronin si ambasadën e një vendi armik. Këtë e vërteton fakti se atje kishin organizuar përgjimin agjentural me mjete teknike moderne. Dhe në shtëpinë e pritjes që ishte caktuar për ne, prej kohësh kishin vendosur përgjimin agjentural. Kjo nuk mund të na shkonte kurrë në mendje. Ky akt ne na indinjoi dhe në një takim që patëm në Kremlin me udhëheqës sovjetikë ia përplasëm në fytyrë Hrushovit. Ai nuk kishte ç'përgjigje të jepte, por vuri duart në kokë, pastaj filloi të na kërcënonte me likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës me qëllim që të na trembte. Dhe ne iu përgjigjëm Hrushovit e shokëve të tij me tonin që meritonin. Asgjë nuk na trembte, se ishim në rrugë të drejtë, qëndrimet tona ishin marksiste, kurse qëndrimet e tyre ishin antimarksiste. Prandaj Hrushovi as që kishte guximin të na shikonte drejt në sy. Këto ne ua thamë udhëheqësve sovjetikë edhe nëpër korridore, ku ata u orvatën «të na bind-

nin», edhe në Mbledhjen e Moskës, para gjithë pjesëmarrësve.

Në Mbledhjen e Moskës Partia jonë, PK e Kinës dhe një numër partish të tjera mbajtën qëndrim të paturdur për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, në radhë të parë, për problemet e politikës së përgjithshme ndërkombëtare, në çështjet e luftës dhe të paqes, të çarmatimit, të bashkekzistencës paqësore e të tjera, dhe shfaqën pikëpamjet si duheshin kuptuar këto çështje.

Ju, shokë, e dini vijën e Partisë sonë për këto probleme të mëdha të kohës. Ne kemi qenë, jemi dhe do të jemi kundër luftës, por kurrë nuk jemi dhe nuk do të jemi që të çarmatosemi përpara imperializmit botëror me atë amerikan në krye, përpara revanshistëve gjermanë që po armatosen deri në dhëmbë me mjetet më moderne, me të vetmin qëllim që të zhdukin socializmin dhe të robërojnë popujt.

Ne duam të rrojmë në miqësi me të gjithë popujt, pavarësisht nga regjimi shtetëror që ekziston në çdo vend. Që këtej lind edhe politika e bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme. Por jo për hir të bashkekzistencës paqësore të shuajmë luftën politike dhe ideologjike, të mos demaskojmë imperializmin, të gjendemi duarlidhur duke çarmatosur ushtritë tona, duke prishur aeroplanët dhe anijet e luftës, sepse për t'u mbrojtur paskemi raketa, të llomitim e të themi fjalë të mira për Ajzenhauerin ose për Kenedin, t'i buzëqeshim Adenauerit për të na bërë lëshime që nuk i bëjnë kurrë. Për çështje të tilla kaq të rëndësishme duhen shtrënguar dhëmbët para imperializmit, duhen vënë mirë pikat mbi i-të. Prandaj me të

tilla qëndrime oportuniste, antimarksiste, ne nuk mund të jemi dakord me Hrushovin.

Shumë po flet Hrushovi që kur ka ardhur në fuqi për problemin e çarmatimit. Çfarë nuk tha e nuk shpifi kundër Stalinit duke e quajtur edhe «kalë të ngordhur», po ç'bëri Hrushovi që kur ka ardhur në fuqi, ç'fitore ka korrur njerëzimi në lidhje me çarmatimin? Asgjë! Përkundrazi, Hrushovi dhe ata që e pasojnë u kanë dhënë kohë imperializmit amerikan dhe revanshizmit gjerman të armatosen, që edhe shtete të tjera kapitaliste të shtojnë buxhetet ushtarake për të prodhuar armët e shfarosjes në masë dhe për të rritur forcat e armatosura, duke u përgatitur në këtë mënyrë për luftë. Po pse veprojnë kështu këto shtete kapitaliste?

Natyrisht, ne nuk do t'u hapim luftë shteteve imperialiste, por në rast se imperialistëve u qëndrohet si duhet dhëmb për dhëmb, ashtu siç na mëson marksizëm-leninizmi, ata do të pengoheshin seriozisht në rrugën e tyre të armatimeve dhe të luftës dhe shumë nga popujt kolonialë ose gjysmëkolonialë që kanë luftuar dhe luftojnë për lirinë dhe pavarësinë e tyre në Azi, në Afrikë ose në Amerikën Latine, brenda kësaj periudhe do të ishin ngritur në revolucion dhe do të kishin fituar. Në një kohë kur populli algjerian lufton për të fituar lirinë e pavarësinë e vet, kur shtypet me zjarr rezistenca e popullit francez pro luftës nacionalçlirimtare të popullit patriot të Algjerisë, Hrushovi shkoi për vizitë në Francë, e quajti Dë Golin «krenaria e Francës» dhe deshi të bënte një vizitë në Algjeri, domethënë të shkonte si në një departament francez. Këtë ma ka thënë Moris Torezi, i cili kishte protestuar dy



herë për një gjë të tillë. Me këtë nuk dua të them se Moris Torezi nuk është vetë oportunist, por dua të theksoj se njerëzve si ky, kur u dhemb drejtpërdrejt, atëherë ngrihen dhe flasin gjoja për të mbrojtur parimet, ndërsa në Mbledhjen e Moskës të vitit 1960 Torezi u ngrit kundër qëndrimit të drejtë të Partisë sonë, kundër parimeve marksiste-leniniste që ajo mbronte.

Me të tilla qëndrime, pra, i lihet dorë e lirë imperializmit me atë amerikan në krye, frenohet lëvizja nacionalçlirimtare e popujve, minohen fitoret e arritura në vendet socialiste. Bota nuk ha bar, njerëzit arsyejnë dhe nuk jemi ne vetëm që i gjykojmë kështu këto çështje. Kështu duhet thënë edhe për Partinë e madhe të Leninit dhe të Stalinit që ka një eksperiencë të pasur në luftën kundër oportunistëve dhe në luftë për shkatërrimin e fashizmit e për çlirimin e popujve. Këto arsyetime i bëjnë, pra, edhe komunistët e vërtetë të kësaj partie.

Prandaj ne themi se duhet mbajtur qëndrim për këto çështje të mëdha politike. Në Mbledhjen e Moskës Partia Komuniste e Kinës, Partia jonë dhe parti të tjera që përkrahën qëndrimet tona, i kritikuan qëndrimet e buta ndaj imperializmit. Ky qëndrim i drejtë nga ana jonë nuk u pëlqente udhëheqjes sovjetike e pasuesve të saj.

Hrushovi dhe ata që e pasojnë janë në pozita krejt oportuniste e revizioniste. Ata kanë nevojë për situata të qeta, nuk u interesojnë situatat e vërteta revolucionare marksiste-leniniste. Ata nuk duan të flitet kundër revizionistëve jugosllavë, sepse demaskimi i këtyre do të ndihmonte me siguri edhe për demaskimin e atyre që mbajnë akoma maska. Nikita Hrushovit, Teodor

Zhivkovit, Valter Ulbrihtit dhe të tjerëve si këta nuk u pëlqejnë komunistët shqiptarë që demaskojnë me të drejtë, me fakte dhe në rrugë marksiste-leniniste klikën revizioniste të Beogradit. Hrushovi me shokë na thonë: «Ç'frikë keni nga Jugosllavia», «ju mbrojmë ne», «mos çani kokën për jugosllavët», «ata duhen kritikuar për disa çështje dhe jo gjithmonë».

Të gjitha përpjekjet e këtyre njerëzve synojnë që të mos flitet për revizionistët jugosllavë, se kështu, sipas tyre, do të dalë në shesh «gabimi» i Stalinit që i demaskoi ata dhe «merita» e Hrushovit që e «korigjoi» atë «gabim»! Por Stalini i ka kritikuar revizionistët jugosllavë shumë drejt, në rrugë marksiste-leniniste dhe me metoda marksiste shoqërore. Kjo vërteton drejtësinë e rrugës që ka ndjekur kurdoherë Stalini në mbrojtje të marksizëm-leninizmit, kurse Hrushovi e cilësoi Stalinin «vrasës», «kriminel» se gjoja «ka bërë gabime ndaj Jugosllavisë», «e hodhi atë jashtë kampit» etj.

Mirëpo me të qeshurat e përçafimet, me lulet e kreditë që u dha Hrushovi klikës së Titos dhe të Rankoviçit, ai i futi në thes, i komprometoi udhëheqjet e të gjitha vendeve socialiste të Evropës, përveç Shqipërisë. Kështu, të gjithë këta, Zhivkovi, Dezhi, Gomulka, Gerua e djalli me të birin, shkuan dhe u puthën dorën Titos dhe Rankoviçit, rehabilituan tradhtarët e popujve të tyre si Trajçe Kostovin, Laslo Rajkun e të tjerë. U përpoqën shumë që edhe ne të rehabilitonim Koçi Xoxen, por nuk u cci.

Titoja dhe grupi i tij, të inkurajuar nga këto konsiderata, vazhduan rrugën e tyre përçarëse kundër vendeve socialiste dhe nuk vonuan të nxirrnin «programin» e tyre antimarksist të Kongresit VII të LKJ. Hrushovi

me ata që e pasonin, në këtë situatë që u krijoi miku i tyre i Beogradit, dashur padashur e me gjysmëzëri, e cilësuan këtë klikë si «kalë i Trojës» etj., vetëm sepse i detyroi lëvizja komuniste ndërkombëtare, marksizëm-leninizmi kurdoherë fitimtar, që Hrushovi me shokë nuk i mposhtin dot. Këtë ata e bënë edhe për arsye taktike, që nesër, kur t'ua donte puna, të thoshin: «Ja, edhe ne kemi thënë se Titoja është si «kali i Trojës»».

Në fakt marrëdhëniet me grupin e Titos u shtuan dhe u bënë të përzemërta. Ato arritën deri atje sa KQ i PK të Bullgarisë ka lëshuar një udhëzim ku thuhet se nuk do të flasin kundër Jugosllavisë për hir të miqësisë, të bashkekzistencës dhe të vëllazërimit që duhet të krijohet midis popujve bullgar e jugosllavë. Me fjalë të tjera, kjo do të thotë le të bërtasin kot shqiptarët. Kështu, është krijuar një situatë e tillë e favorshme për revizionistët jugosllavë në Bullgari, saqë agjentët e Titos arritën të vjedhin në aparatit e KQ të PK të Bullgarisë të gjitha dokumentet e Mbledhjes së Moskës të vitit 1960 dhe fajtorët nuk i dënuan me gjyq, por u mjaftuan vetëm me përjashtimin e tyre nga Partia. Fajtorët që komplotonin për rrëzimin e pushtetit popullor në Bullgari kohët e fundit ishin në bashkëpunim të ngushtë me ambasadën jugosllave në Sofje.

Këto, pra, janë rezultatet e kësaj vije «tejpamëse» të Nikita Hrushovit dhe të Teodor Zhivkovit. Ne jemi të sigurt se atyre që nuk janë në pozita marksiste-leniniste me siguri shumë gjëra kanë për t'u ndodhur. Por ne kemi bindje se e drejta do të fitojë, pse Partia jonë është në rrugë të drejtë, prandaj ajo kurdoherë do të fitojë.

Le të flasim pak edhe për gjyqin që u zhvillua tani

së fundi në vendin tonë kundër një grupi tradhtarësh që donin të rrëzonin me forcë pushtetin popullor dhe të copëtonin atdheun tonë. U vërtetua plotësisht se ky grup bashkëpunonte me revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe me Flotën VI Amerikane. Imperialistët dhe revizionistët jugosllavë na sulmojnë me egërsi çdo ditë, po shtypi sovjetik dhe ai i vendeve të demokracisë popullore heshtin. Kjo do të thotë se ata janë dakord me imperialistët dhe revizionistët jugosllavë. Ky është konkluzioni.

Ne me gjqyin tonë akuzojmë vetëm ata që kanë kryer krime kundër vendit tonë. Me qëndrimin që mbajnë Hrushovi me shokë tregojnë se nuk janë dakord me gjqyin dhe dënimin që u dhamë tradhtarëve. Po Shqipëria nuk mund të mbyllë sytë para komplotit të imperialistëve dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve jugosllavë, ne nuk mund të mos i hidhnim në gjqy dhe të mos i dënonim agjentët e tyre. Në qoftë se kjo i dhemb N. Hrushovit, aq na bën. Hrushovi ka marrë edhe një letër nga Panajot Plaku, dërguar nga Beogradi, në të cilën ky i thoshte se vetëm ju mund ta rrëzoni udhëheqjen shqiptare. Për këtë gjë tradhtari Panajot Plaku ka bërë edhe një deklaratë në Beograd, në të cilën thotë se pikëpamjet e tij ia ka bërë të ditura Hrushovit me një letër që i ka drejtuar. Kopjen e kësaj letre ai ia ka dhënë edhe udhëheqjes jugosllave. Dihet se ç'na ka thënë Hrushovi për Panajot Plakun, ose të kthehet në Shqipëri ose do t'i japim ne strehim politik në BS. Po ashtu dihet ç'përgjigje i kemi dhënë ne<sup>1</sup>.

---

<sup>1</sup> Shih Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 52-53.

N. Hrushovi ka mbrojtur edhe tradhtarët Liri Gega e Dali Ndreu që komplotonin kundër Shqipërisë, të cilët ishin agjentë të jugosllavëve. Ata në fund tentuan të arratiseshin në Jugosllavi, por ju, shokë kufitarë, i kapët në kufi tek po iknin. Ai ka mbrojtur gjithashtu Tuk Jakovën, i cili i ka drejtuar letër Hrushovit. Por ne për të gjitha këto i kemi dhënë përgjigje në kohën e duhur dhe në rrugën marksiste-leniniste.

Ne i kemi thënë N. Hrushovit pikëpamjen tonë për çdo gjë si marksistë-leninistë që nuk kemi qenë dakord me të. Po të ishte marksist ai do të thoshte se kështu ka ndodhur, po nuk do të ndodhë më. Atëherë do të ishte ndryshe puna. Ndërsa ai ka vazhduar në rrugën e tij kundër Partisë dhe vendit tonë dhe për këtë ne flasim me fakte.

Mbledhja e fundit e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në rendin e ditës kishte studimin e gjendjes së ushtrive të vendeve të kampit socialist nga pikëpamja morale, politike dhe ushtarake. Duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të kësaj mbledhjeje, ne shkuam atje për të shfaqur mendimin tonë. Mirëpo nuk u bë ashtu siç u tha. Ndërsa ne shtruam atje situatën politike, gjendjen aktuale të ushtrisë sonë, si edhe nevojat e saj, revizionistët sovjetikë dhe pasuesit e tyre me paturpësinë më të madhe filluan sulmet kundër nesh dhe mbledhja u kthye në një tribunë sulmi dhe kërcënimesh kundër Partisë dhe vendit tonë, në vend që të diskutonte problemet që ishin në rendin e ditës. Por ata morën përgjigjen e merituar nga ana jonë.

Ata thanë se Enver Hoxha shpifi kur tha në Kon-

gresin IV të PPSH se Shqipëria u sulmua nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe Flota VI Amerikane. Pas përgjigjes që dhamë ne, në mbledhje u kërkuar nga Gomulka që të krijohet një komision për të kontrolluar vërtetësinë e dosjeve të hetuesisë sonë. Përgjigjja jonë ishte se «deri këtu ne nuk lejojmë njeri, se e dimë që askush nuk ka kërkuar të bëhet një veprim i tillë për gjyqet që zhvilloi ju kundër armiqve, tradhtarëve dhe spiunëve të popujve tuaj. Juve nuk ju shkoi aspak në mendje të pyesnit partitë e tjera për Josif Stalinin që ishte njeri aq i madh dhe na takonte të gjithëve, por morët kundër tij gjithë ato masa çnjerrëzore. Tani ç'keni ndër mend të bëni që i merrni nën sjetull tradhtarët e popullit tonë?»

Revizionistët sovjetikë e kishin mizën nën kësulë, prandaj vepruan siç dihet, por faktet janë fakte dhe këto nuk mund të errësojnë të vërtetën.

Revizionistët sovjetikë, të prirur për komplete ndajnesh, nxorën versionin se Qeveria Shqiptare nuk është solidare me Traktatin e Varshavës dhe se në bazën ushtarako-detare të Vlorës është krijuar gjoja një gjendje e paduruar për marinarët sovjetikë që shërbejnë atje, prandaj, sipas tyre, duhet të merret vendimi<sup>1</sup> që shqiptarët të largohen krejt nga baza e Vlorës dhe kjo të vihet nën drejtimin e sovjetikëve.

Më lejoni t'ju flas pak për historikun e bazës ushtarako-detare të Vlorës.

Partia jonë, duke parë interesat e kampit socialist

---

<sup>1</sup> Shih «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 46. Tiranë, 1970.

dhe të mbrojtjes së atdheut tonë, mori iniciativën për krijimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës. Komiteti Qendror i Partisë sonë, me sinqeritetin më të madh dhe në frymën marksiste-leniniste, ka përsëritur shumë herë se RPSH ka qenë, është dhe do të jetë mburoja e çeliktë e socializmit në brigjet e Adriatikut, prandaj duhej baza e Vlorës. Pra me iniciativën e Partisë sonë u ngrit baza e Vlorës dhe u nënshkruan marrëveshje, sipas të cilave të gjitha anijet luftarake pas një periudhe, kur ne gradualisht të përgatitnim kuadrot tanë, do të vihehin në duart e Ushtrisë Shqiptare, do të lundronin duke pasur flamurin shqiptar dhe oficerët sovjetikë do të shërbenin në flotë si instruktorë derisa të zëvendësoheshin nga koha në kohë me njerëzit tanë që po përgatiteshin për këtë qëllim.

Kështu ishin marrëveshjet e pranuar nga të dyja palët dhe kjo ishte e drejtë. Jeta ka treguar jo vetëm heroizmin, por edhe zotësinë e kuadrove tanë që brenda një kohe të shkurtër arritën të përvetësonin teknikën më moderne. Kështu, ne morëm menjëherë në dorëzim anije luftarake, të cilat së bashku me anijet ndihmëse u vunë në duart e oficerëve tanë.

Në janarin e vitit të kaluar ne kishim përgatitur njerëzit tanë për të marrë në dorëzim edhe anije të tjera bashkë me mjetet detare ndihmëse, por pala sovjetike na u përgjigj që dorëzimi të bëhej më vonë, sepse në atë kohë deti paskësh dallgë etj. Ne qëmë dakord me propozimin e tyre, megjithëse argumentet nuk ishin bindëse.

Para Mbledhjes së Bukureshtit në bazën ushtarako-detare të Vlorës ekzistonin marrëdhënie vëllazë-

rore midis njerëzve tanë dhe marinarëve sovjetikë, nga ana jonë as incidenti më i vogël nuk kishte ndodhur. Edhe nja dy herë kur kanë ngjarë incidentet këto janë shkaktuar nga ata vetë.

Pas Mbledhjes së Bukureshtit ata filluan të ndryshojnë qëndrim, ndërsa urdhri i komandës sonë ishte i prerë: asgjë të mos ndryshonte ndaj ushtarakëve sovjetikë në bazën e Vlorës. Por atje u bënë me qëllim një mijë e një gjëra nga ana e tyre deri në mbledhjen e Traktatit të Varshavës ku u muar vendimi që thamë më sipër. Ne u përgjigjëm se vendimi ynë është ai që kemi firmosur bashkërisht<sup>1</sup> — të ruajmë atje statuskuonë në bazë të marrëveshjeve, sepse e drejta në vështrimin marksist, nga pikëpamja politike, morale, juridike është me ne, sepse ju vetëm keni shpifur dhe të gjitha ato që po kurdisni tani janë pa bazë, prandaj, po ta hetoni mirë çështjen, do të shikoni se punët janë kështu si ju themi ne dhe se ato që kanë ndodhur janë provokuar prej jush me qëllime të caktuara. Ky vendim i Qeverisë Shqiptare është i drejtë, prandaj për masën që merrni ju mbani një përgjegjësi të madhe përpara popullit tuaj, popullit shqiptar dhe kampit të socializmit. Prandaj mendohuni dhe thellohuni për këto që po bëni.

Ata nuk e pranuan mendimin tonë dhe vendosën heqjen e bazës. Atëherë ne kërkuan të formohej një komision, por njerëzit e tyre në komision pretendonin

---

<sup>1</sup> Është fjala për marrëveshjet e 12 shtatorit 1957 dhe e 3 marsit 1959 të nënshkruara nga të dyja palët mbi ndërtimin, qëllimet dhe parimet mbl të cilat do të ngrihej baza ushtarako-detare e Vlorës.



që të merrnin të gjitha mjetet detare, deri te dërrasat e barakave dhe vidat e hedhura mënjanë. Sigurisht po t'i marrë vesh këto gjëra populli sovjetik, dhe do të vijë koha që t'i marrë, ai do të revoltohet. Por njerëzit tanë kanë mbajtur gjakftohtësinë më të madhe. Ne u thamë sovjetikëve, po të doni shkoni vetëm me ato mjete që drejtohen nga ekipazhet tuaja, megjithëse edhe këto i përkasin popullit shqiptar, të aprovuara me marrëveshje të firmosura nga të dyja palët. Këtë e bëmë për hir të miqësisë, ndërsa për të tjerat u thamë se nuk lejojmë të bëhet asnjë hap përpara, se janë pronë e popullit shqiptar.

Ata vazhduan me dredhi, me presione e me shantazhe për t'i tërhequr të gjitha mjetet. Ne nuk lëvizëm nga qëndrimi ynë dhe u thamë se këto mjete nuk janë lodra, por armë që na duhen për të mbrojtur atdheun tonë dhe kampin e socializmit, prandaj ju mbani përgjegjësi të madhe për ato që bëni.

Lidhur me veprimet antishqiptare të grupit të N. Hrushovit dua t'ju tregoj edhe për qëndrimin që është mbajtur ndaj marinarëve tanë që studjonin në Bashkimin Sovjetik. Çdo vit që këta mbaronin shkollat ktheheshin në Shqipëri dhe merrnin në dorëzim mjetet luftarako-detare që ishin në bazën e Vlorës. Sipas marrëveshjes parashikohej që brenda vitit 1962 të gjitha mjetet do të merreshin në dorëzim nga kuadrot tanë. Në mjetet detare ku ekipazhet ishin të përbashkëta, njerëzit tanë kishin nga 4-5 vjet në shërbim, kurse të tyret, që gjoja mësonin tanët, ishin rekrutë të rinj. Kështu që në të vërtetë ndodhte e kundërta, njerëzit tanë i mësonin sovjetikët.

Kur sovjetikët vendosën të tërhiqnin mjetet detare nga baza e Vlorës, u thamë se në këto kushte edhe ne detyrohemi t'i heqim kursantët që studjojnë në shkollat e marinës në BS. Për këtë, sipas rregullave, atasheu ynë ushtarak në Moskë, në bazë të vendimit të Qeverisë, u paraqit në komandën sovjetike dhe kërkoi ndihmën për kthimin e kursantëve tanë të marinës që studjonin atje. Por kur ai shkoi për t'i marrë, ndeshi në akte të ulëta që nuk mund të imagjinohen. Kursantët tanë i kishin mbyllur nëpër dhomat e shkollës gati në formë arresti. Duhet ta dini, shokë, se të 200 e ca kursantët kanë qëndruar të papërkulur dhe kanë treguar një patriotizëm e internacionalizëm të pashoq. Të brumosur me ideologjinë e Partisë sonë ata kanë protestuar në mënyrë energjike, revolucionare, në rrugën marksiste-leniniste kundër qëndrimeve të poshtra që mbante komanda sovjetike ndaj tyre dhe kërkuan me këmbëngulje të anuloheshin këto masa të turpshme. Puna arriti deri atje sa i rrethuan edhe me roje, por rojet sovjetike refuzuan të zbatonin urdhrat e komandës sovjetike kundër shokëve të tyre shqiptarë. Rojet sovjetike që nuk zbatuan urdhrin, i futën në burg, por edhe të tjerët që i zëvendësuan nuk pranuan të mbanin të izoluar shokët e tyre shqiptarë.

Drejtorët dhe profesorët e akademive të marinës shprehnin keqardhjen e tyre për një trajtim të tillë. Një drejtor akademie u shpreh se nuk mund të zbatonte një urdhër të tillë. «Unë nuk mund t'i mbaj të mbyllur kursantët shqiptarë, tha ai, se janë djem të sjellshëm, të edukuar, që shkojnë mirë me mësim».

Çështja e kursantëve tanë të marinës bëri bujë në

Leningrad dhe në Baku, morali i tyre qëndronte lart, ata nuk u përvulën përpara izolimit dhe presioneve që u bëheshin. Sa kohë që këta ishin të izoluar, u detyruan të bënin edhe greva urie, sepse nuk i linin të shkonin të pashoqëruar në mensë. Populli jashtë në rrugë brohoriste për kursantët tanë, shante haptas udhëheqjen sovjetike dhe protestonte përse mbaheshin mbyllur shqiptarët.

Udhëheqja sovjetike, duke qenë nën presionin e protestave të Qeverisë sonë dhe të rezistencës heroike të marinarëve shqiptarë, u detyrua të vendoste kthimin e kursantëve. Kur kursantët hipën nëpër autobuze dhe ngritën flamurin shqiptar e brohoritnin, populli nëpër rrugë e në stacione i përshëndeste. Duke parë simpatinë që tregonin masat për njerëzit tanë, ndërhyri policia dhe i shpërndau. U bënë gjëra që më parë as nuk të shkonin në mendje, ndërsa tani këto janë ngjarje reale, por shumë prekëse dhe revoltuese.

Me kursantët tanë u treguan solidarë kursantët kinezë, rumunë dhe vietnamezë, të cilët i ndihmuan gjatë kohës që ata u mbajtën në arrest. Njerëzit tanë fituan, fitoi e drejta.

Pas gjithë këtyre veprimeve aspak shoqërore dhe të ulëta, qeveria sovjetike ka paturpësinë të thotë, në notat që i ka dërguar Qeverisë sonë, se nuk është e vërtetë që ka arrestuar kursantët dhe oficerët tanë të marinës dhe se atyre do t'u jepen lehtësitë e duhura për t'u kthyer në Shqipëri. Kështu u janë përgjigjur ata të gjitha protestave të drejta të Qeverisë sonë.

Duhet të jesh në marrëdhënie me ta në punët e përditshme për të kuptuar rrugën antimarksiste, në të

cilën po ecën grupi udhëheqës i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik me Hrushovin në krye.

Kështu qëndrojnë punët për këto çështje. Nga çdo anë që ta marrësh ne jemi në rrugë të drejtë marksiste-leniniste. Partia jonë ecën me një kujdes të jashtëzakonshëm në këto çështje, sepse kështu duhet ecur. Kjo nuk do të thotë që ne të bëjmë lëshime. Ne as lëshimin më të vogël nuk do t'u bëjmë revizionistëve, por duhet urtësi. Ata përpiqen me të gjitha forcat që të mposhtin vullnetin e çeliktë të Partisë dhe të popullit shqiptar. Por e kanë kot. Ata gabohen rëndë në këtë drejtim, sepse nuk mposhtet vullneti i popullit dhe i Partisë sonë.

Për të gënjyer popullin dhe Partinë udhëheqësit e tanishëm sovjetikë ndjekin taktikën e shpifjeve dhe thonë se udhëheqësit shqiptarë po i hedhin baltë Bashkimit Sovjetik, po sulmojnë Bashkimin Sovjetik dhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Por faktet qëndrojnë ndryshe.

Miqësia midis dy vendeve tona ka qenë e madhe dhe e sinqertë. Kudo që të shkoje në Shqipëri dhe të dëgjoje fjalën sovjetik ishte njësoj sikur të thoshe mik, vëlla dhe kjo ishte plotësisht e drejtë. Ndihamat që na ka dhënë Bashkimi Sovjetik në kohën e J. V. Stalinit kanë qenë internacionaliste, vëllazërore. Kurrë nuk i kemi mohuar dhe nuk do t'i mohojmë këto ndihma. Por grupi i Hrushovit trillon akuza gjoja sikur ne e mohojmë ndihmën e Bashkimit Sovjetik. Kjo është një poshtërsi e madhe. Këto ndihma ne i kuptojmë drejt, si internacionalistë dhe jo për të ulur kurrizin përpara rrugës së gabuar të Nikita Hrushovit. Këtë ne nuk e

bëjmë dhe në Kremlin i thamë Hrushovit se shqiptarët kanë luftuar edhe pa bukë e të zbathur po asnjëherë nuk i janë përkulur askujt.

Ne kemi kritikuar dhe kritikojmë me të madhe, brenda normave marksiste-leniniste, shkaktarët e vërtetë të prishjes së marrëdhënieve dhe të miqësisë, dhe fajtorët për këtë janë Nikita Hrushovi dhe shokët e tij. Ne kritikojmë gjithashtu edhe të gjithë ata udhëheqës të vendeve të tjera, të cilët, duke ndjekur rrugën e N. Hrushovit, gabojnë rëndë në qëndrimet që mbajnë ndaj vendit tonë. Këto kritika ne i kemi thënë në mbledhje të rregullta, duke u qëndruar besnikë normave leniniste, të cilat ata i shkelin si pa të keq.

Vija e Partisë sonë në këto çështje kaq të rëndësishme është e drejtë, marksiste, e urtë. Aktet e ulëta dhe veprimet armiqësore që thuren ndaj Partisë dhe popullit nga revizionistët e sotëm duhet t'i dijë Partia jonë, sepse kështu i shtohet eksperiencia e luftës me armiqtë, vigjilenca dhe mprehtësia, i forcohen njohuritë marksiste-leniniste dhe di të mbrohet.

Si Partia edhe populli duhet të mbrohen nga çdo rrezik. Ju e keni vënë re gjatë gjithë këtyre viteve se me ç'zell të madh kanë luftuar dhe luftojnë imperialistët dhe revizionistët jugosllavë për të shkatërruar Partinë dhe socializmin në vendin tonë. Por ata asnjë sukses nuk kanë pasur, sepse vigjilenca e Partisë ka qenë kurdoherë e mprehtë. Prandaj Partia duhet të jetë e qartë edhe për veprimtarinë e gjithë këtyre grupeve revizioniste dhe nëpërmjet Partisë duhet të sqarohet edhe populli. Këto nuk do t'i bëjmë muhabete pazari, por, kur pyesin njerëzit, do t'i sqarojmë. Në

qoftë se ata do të vazhdojnë veprimtarinë e tyre armiqësore edhe në forma të tjera, dëm vetes do t'i bëjnë. Ne do të mbrohemi brenda normave leniniste. Veç armë atyre nuk do t'u japim të na luftojnë, por në rast se do të orvaten, edhe ne «dyfekët» i kemi gati.

Politika jonë e jashtme do të mbetet ajo që ka qenë, një politikë e drejtë, marksiste-leniniste. Nikita Hrushovi mund të shkojë nesër në Vjenë<sup>1</sup>, në bisedime të nivelit të lartë, por ne nuk mund të mos themi edhe pikëpamjen tonë se ç'është imperializmi, sidomos ai amerikan, ç'është Kenedi, cilat janë qëllimet e tij etj. Ne qëndrojmë fort në pikëpamjen tonë dhe do të shohim cila politikë është më e drejtë, politika jonë marksiste-leniniste apo politika oportuniste e revizionistëve.

Ne jemi të bindur se do të fitojë politika marksiste-leniniste, pavarësisht se ka vështirësi dhe pengesa të mëdha. Ne qëndrojmë me vendosmëri në këtë rrugë dhe kemi bindjen se të gjitha këto do t'i kapërcejmë. Këtë gjë ne e kemi deklaruar edhe në Kongresin IV të Partisë. Qeveria sovjetike, ajo e Polonisë, e RD Gjermane etj., kanë vënë censurë të rreptë që materialet e këtij Kongresi të mos u bien në dorë njerëzve në vendet e tyre, të cilët i vlerësojnë me objektivitet problemet e rëndësishme ndërkombëtare, siç i shtroi drejt dhe qartë Kongresi ynë IV.

---

<sup>1</sup> Në datën 3-4 qershor u bë takimi midis N. Hrushovit dhe Xh. Kenedit për të diskutuar çështje që kishin të bënin me marrëdhëniet midis BRSS dhe SHBA-së. U diskutua edhe rreth çështjeve të ndalimit të provave bërthamore, të çarmatimit dhe çështjes gjermane, por pa asnjë rezultat.

Vështirësi në marrëdhëniet tona ka, por në BS, si rrjedhim i kursit revizionist që ndjek udhëheqja sovjetike, ka vështirësi edhe më të mëdha, si në lëmin ideologjik, ashtu edhe në fushën ekonomike. Ato që po ndodhin atje do të kenë pasoja serioze për të ardhshmen e socializmit e të komunizmit në BS dhe në ato vende që ndjekin këtë kurs. Jo vetëm politika e jashtme e Hrushovit nuk pati sukses, por edhe planet e tij «të mëdha» mbi zhvillimin ekonomik të vendit, dështuan.

Që të mbulojë dështimet e tij në politikë dhe në ekonomi Hrushovi i ka shkarkuar të gjithë sekretarët e parë të komiteteve qendrore të republikave sovjetike, sepse gjoja kanë bërë spekulime, se paskan gënjyer qeverinë me shifra të rreme etj. Mendja nuk ta pret që të gjithë sekretarët e parë të kenë gënjyer qeverinë, sepse këta njerëz ai i ka pasur mbështetje në rrugën e tij revizioniste. Gjithë këta kuadro Hrushovi i ka pasur shumë afër, bile shumë prej tyre i ka marrë me vete nëpër shëtitjet që ka bërë në një numër vendesh jashtë Bashkimit Sovjetik, sepse ata e kanë përkrahur në çështjet e politikës së brendshme e të jashtme. Këta kuadro, Hrushovi jo vetëm i hoqi nga postet me përgjegjësi, por i përjashtoi edhe nga partia. Vetëm budallenjtë mund ta hanë këtë gënjeshtëri. Fajin nuk e merr njeri përsipër edhe kur bëhet qyrk, e ca më pak Hrushovi.

Dihet se njerëzit mund të gabojnë, mund të bëjnë edhe faje. Por marksizëm-leninizmi na ka mësuar se si duhen trajtuar ata që gabojnë ose që bëjnë faje. Këta duhen trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe në rru-

gën marksiste-leniniste dhe jo si vepron Hrushovi. Ai ka akuzuar Stalinin për trajtim jo të mirë të kuadrove, ka arritur të thotë se Tukaçevski me shokë nuk kanë tradhtuar dhe Buharinin, Kamenievin, Zinovievin e të tjerë po i rehabiliton, kurse kuadrove të vjetër dhe të besuar të partisë po u vë fshesën. Ku janë fjalët bombastike, që i ka theksuar në fjalimet e tij «të mëdha», se tani në Bashkimin Sovjetik po zhduken burgjet, ndërsa nga ana tjetër nxjerr ligje për internime dhe dërgon njerëz me shumicë në Siberi?

Këto janë situata të vështira të krijuara nga një vijë oportuniste-revizioniste, nga një shturje e Nikita Hrushovit në vijë, e cila po pasqyrohet edhe në kulturë e në art. Të gjithë ne kemi parë filma sovjetikë dhe na kanë pëlqyer. Por tani zor se mund të gjendet ndonjë film i përshtatshëm për popullin tonë, ku mund të shprehet ajo frymë e shëndoshë me të cilën ne duam të edukojmë masat tona punonjëse. Kemi pasur rastin të shohim disa filma sovjetikë që të ngjethet mishtë. Me anë të këtyre filmave, që janë krejtësisht të padenjë për kinematografinë socialiste, revizionistët sovjetikë kanë për qëllim të bindin amerikanët se gjoja në Bashkimin Sovjetik janë zhdukur burgjet dhe kampet, prandaj le të njihen miqtë me «mrekullitë» që janë arritur në erën e N. Hrushovit. Kështu thotë edhe Sairus Itoni, një nga miliarderët më të mëdhenj amerikanë, që mban në kraharor edhe medaljen e paqes të Leninit. Me të vërtetë gjëra të çuditshme na duken këto, por ky është realiteti. Ne si marksistë i kritikojmë haptazi këto devijime.

Partia jonë është e kalitur dhe qëndron në ballë



të luftës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, të interesave jetike të popullit tonë, për ndërtimin e socializmit me ritme të shpejta në Shqipëri. Ju po shikoni se ç'dashuri të madhe ka populli ynë për Partinë dhe si mobilizohet ai për zbatimin e vijës së saj të drejtë. Kjo është shprehje e unitetit të çeliktë që ekziston midis Partisë dhe popullit, prandaj këtë dashuri dhe unitet ta ruajmë si sytë e ballit. Ruajtja e unitetit midis Partisë dhe popullit ka rëndësi shumë të madhe, sepse imperialistët dhe revizionistët luftojnë për të na përçarë, që të realizojnë qëllimet e tyre në Shqipëri. Shumë vjet kanë ata që po përpiqen për këtë dhe nuk ia kanë arritur dot, por kanë dështuar në orvatjet e tyre; të gjithë përçarësit kanë çarë vetëm kokën e tyre, por asnjëherë murin e çeliktë të Partisë.

Prandaj për këtë qëllim duhet të sqarohen e të zhduken qoftë edhe grindjet më të vogla që mund të ekzistojnë midis njerëzve. Këtë e kërkojnë interesat e larta të atdheut, të Partisë dhe të komunizmit ndërkombëtar. Në rast se ti ke ndonjë pakënaqësi thuaje në rrugë partie, se Partia do të ta sqarojë. U grinde me një shok, sillu me të si komunist, në rast se ai ka faj, përpiqu ta bindësh që ta kuptojë fajin e tij, mos i mbaj mëri, sepse kjo gjendje, me dashje ose pa dashje, do të reflektohet edhe në radhët e Partisë. Nëse shoku gabon, përpiqu ta sqarosh jashtë ose edhe brenda në Parti. Qëndrimet marksiste-leniniste mund të mbahen edhe pa qenë shumë i ngritur nga pikëpamja teorike, por duke kuptuar si duhet vijën e drejtë të Partisë. Komunistët me qëndrimet e tyre të drejta duhet t'u fitojnë zemrën njerëzve dhe t'i sjellin këta në rrugë të drejtë.

Theksova më parë rëndësinë e unitetit, por uniteti i Partisë përmban shumë gjëra që shfaqen me forcë në mënyrë të menjëhershme, ose edhe në mënyrë të ngadalshme në jetë. Të gjitha këto raste duhet të kanalizohen në vijën e Partisë për ta forcuar Partinë dhe shfaqjet e këqija të luftohen që të zhduken. Po të veprohet në këtë mënyrë uniteti kurrë nuk do të dëmtohet. Ne, komunistët, jemi pararoja e popullit, prandaj detyra jonë është që popullin ta mbajmë kurdoherë të shtrënguar fort rreth Partisë. Kjo kërkon që në çdo rast dhe për çdo gjë të jemi shembull për popullin, sepse në këtë mënyrë do të kalojmë, me siguri, çfarëdo pengese dhe vështirësie, do të përballojmë dhe do të luftojmë çdo presion të mbeturinave mikroborgjeze që i ndeshim jo vetëm te njerëzit pa parti, por edhe te anëtarët e Partisë.

Puna edukative dhe politike me masat është e domosdoshme të forcohet. Është e domosdoshme të kalitim, në radhë të parë, Partinë për të përballuar këto situata. Prandaj, shokë, të jeni kurdoherë të matur e me takt në marrëdhëniet me njerëzit, ashtu si ju mëson Partia. Kini parasysh se presioni i armikut është i madh dhe i shumanshëm, sidomos në këto momente. Ka njerëz që nervat i kanë të çeliktë, ka që i kanë më pak të fortë, ka të tjerë që nuk i durojnë dot këto presione dhe thyhen. Detyra dhe zotësia e komunistëve është që të jenë afër këtyre njerëzve, domethënë afër atyre që nervat nuk i kanë të shëndoshë dhe të punojnë që edhe atyre t'ua kalitin, të mos i lënë t'u dobësohen dhe të humbasin toruan, të mos i hedhim në anën e armikut. Sidomos ju që e shihni çdo ditë nga afër

veprimtarinë e armikut, kini për detyrë të punoni me njerëzit, këtë ta keni preokupacion të madh. Kur te ndonjë shoku juaj duket një dobësi, përpiquni ta ndreqni, mos e hidhni menjëherë tej, duke e cilësuar se nuk është në rrugë të drejtë, ose se është në rrugë armiqësore etj. Asnjë njeri të mos i japim armikut.

Në këto situata, shokë, patriotizmi i popullit tonë është i pashembullt. Ne kemi një popull të mrekullueshëm, pa dyshim që shembulli i tij frymëzon edhe Partinë. Prandaj organizatat-bazë të Partisë, sidomos ato të zonave kufitare, duhet të bëhen të gjalla, luftarake, revolucionare. Njerëzit të vihen në dijeni të situatës dhe të rreziqeve që ajo mund të sjellë. Juve, oficerëve, ju bie detyra që të tregoni kujdes për ushtarët, se për ta në repart ju jeni nëna, babai, vëllai ose motra, ju jeni këshilltarët më të afërt të tyre për çdo brengë që kanë në zemër. Pra t'u qëndroni sa më afër kufitarëve se ata janë kurdoherë ballë për ballë armikut.

Ju e keni shumë të qartë se në këto situata monarko-fashistët grekë, nga njëra anë, dhe revizionistët jugosllavë, nga ana tjetër, do të përpiqen të aktivizohen më shumë se deri tani. Prandaj edhe vigjilenca juaj duhet të jetë e madhe. Instruksionet duhet të zbatohen me përpikëri dhe të përdorni në punë metoda të reja që ju diktojnë rrethanat.

Për veprimet në male, në pyje e kudo në radhë të parë zbatoni dhe përhapni eksperiencën tuaj më të mirë. Prandaj pasurojeni sa më shumë këtë eksperiencë në luftën e përditshme kundër armiqve, diversantëve, spiunëve dhe agjentëve që do të përpiqen të kalojnë

kufirin. Këtë luftë ju ta bëni duke përvetësuar edhe metodat e luftës së armikut. Këto metoda nëpërmjet jush duhet t'i përvetësojnë të gjithë ushtarët. Pra të vini në zbatim në punën tuaj të gjitha mjetet që keni, të studjoni me hollësi dhe kujdes të madh metodat e armikut, sepse edhe ato janë një mësim shumë i mirë në luftën tonë kundër tyre, prandaj mos i neglizhoni.

Të luftohet liberalizmi që është shfaqur te ndonjë oficer i kufirit dhe mos bëni asnjë lëshim në ruajtjen e kufijve. Të jeni shumë vigjilentë në detyrë. Kjo nuk do të thotë të mos keni besim te njerëzit. Besimin te njerëzit ta keni të plotë, jo vetëm te shokët me të cilët punoni dhe luftoni përditë, por edhe te populli, sepse pa mobilizimin e të gjitha forcave të popullit është e pamundur të mbrohen kufijtë e atdheut.

Ne kemi njerëz të mrekullueshëm në kufijtë tanë. Populli ynë është patriot i flaktë, por duhet të dimë të lidhemi ngushtë me të, t'i bëjmë sa më të gjalla këto lidhje, të komunikojmë e të informojmë njëri-tjetrin, sepse vetëm duke pasur lidhje të forta, kufiri ynë do të bëhet i pakapërcyeshëm. Këtë kërkon Partia nga ju dhe ajo ka besim të patundur; ky besim bazohet në patriotizmin dhe në vendosmërinë tuaj, si edhe në dashurinë e madhe që keni për Partinë. Ju, këtu, jeni kuadro të vjetër e të rinj, njerëz të kalitur në luftën e madhe për çlirimin e atdheut, si dhe të tjerë që janë kalitur gjatë përpjekjeve për mbrojtjen e fitoreve historike të popullit tonë, fitoreve të ndërtimit të socializmit në Shqipëri.

Prandaj, shokë, me besim të plotë te Partia dhe te populli, kryeni plotësisht e me ndërgjegje detyrën tuaj,

e cila, e përsëris edhe një herë, ka qenë, është dhe do të jetë detyra më e lartë. Byroja Politike, sa herë që merr në studim çështjet që kanë të bëjnë me këtë dikaster, rekomandon që të tregohet kujdes më i madh për forcat e kufirit.

Të jeni të sigurt se Partia dhe populli, klasa punëtoare dhe fshatarësia kooperativiste, do t'ua shpërblejnë sakrificat dhe detyrën tuaj fisnike që kryeni për mbrojtjen e kufijve të atdheut, me realizimin dhe tejkalimin e planeve ekonomike.

Të rrojë Partia jonë heroike e Punës!

Të rrojë populli ynë i mrekullueshëm!

Të rrojnë kufitarët tanë trima, arma e Sigurimit të Shtetit dhe e Policisë Popullore!

Të rrojë ushtria jonë e lavdishme, që mbron me nder dhe heroizëm fitoret e mëdha historike të popullit tonë!

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim, sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

## TA BËJMË LUGINËN E BUKUR TË PEZËS QË TË LULEZOJË KURDOHERË

*Fjala në mitingun me kooperativistët e lokalitetit  
të Ndroqit në rrethin e Tiranës*

**14 qershor 1961**

Të dashur shokë dhe shoqe kooperativistë të Ndroqit, të Pezës heroike dhe të të gjitha fshatrave të tjera të këtij lokaliteti,

Jam shumë i lumtur dhe i gëzuar që kam rastin të takohem sot me ju dhe t'ju transmetoj përshëndetjet më të nxehta dhe më të përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë e të Qeverisë, si edhe të shokut tonë të dashur Myslim Pezës dhe t'ju uroj me gjithë zemër suksese akoma më të mëdha në punën tuaj për lulëzimin e këtyre kooperativave dhe për përmirësimin e jetës suaj!

Shokë dhe shoqe, kur vijmë në këto anë e takohemi me ju, kurdoherë, si në momente të gëzuara ashtu edhe në momente të vështira, na kujtohen vitet heroike të Luftës së lavdishme Nacionalçlirimtare që zhvilloi populli ynë nën udhëheqjen e Partisë kundër

armiqve të egër. Duke u takuar me popullin heroik të Pezës, të Ndroqit dhe të të gjitha kooperativave të tjera të kësaj zone ne marrim forca të reja, sepse këtu në Pezën heroike, nën udhëheqjen e Partisë sonë, në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare, luftoi me trimëri populli i kësaj krahine rreth shokut tonë, «Babë» Myslim Pezës. Në këtë krahinë u grumbulluan partizanët e parë të Luftës Nacionalçlirimtare të rrethit të Tiranës. Në krye të çetës që udhëhiqte Partia, ishte babë Myslimi, një shok heroik, i vendosur, i ndershëm dhe i drejtë, që e donte me gjithë shpirt popullin, lirinë e tij dhe prandaj u lidh shpejt me Partinë tonë Komuniste, që udhëhiqte këtë luftë çlirimtare.

Çeta partizane e Myslim Pezës u zmadhua me bijtë dhe bijat trime të kësaj krahine, që nuk kursyen as jetën e tyre për çlirimin e atdheut. Në mes jush, të dashur shokë dhe vëllezër, ka shumë nga ata me të cilët ne kemi luftuar krah për krah kundër okupatorëve e tradhtarëve, kemi ndenjmur në mes të maleve ditë dhe net pa ngrënë, kemi fjetur jashtë në shi, në dëborë e në baltë. Por qëllimi ynë ishte të mposhtnim armiqtë dhe të arrinim që populli shqiptar të fitonte lirinë, që Shqipëria jonë e dashur të ishte e pavarur. Partizanët e Pezës dhe të kësaj krahine, të udhëhequr nga Partia, nuk u trembën as nga fashistët italianë, as nga nazistët gjermanë, as nga ballistët e bejlerët; ata nuk i trembi as të ftohtit, as uria, sepse bazën e shëndoshë e kishin në këtë popull që s'u tremb as nga djegiet, as nga rreprezaljet e armiqve barbarë. Në këtë zonë ne kishim mbështetje kasollet tuaja, që ishin qendra dhe foleja e

partizanëve. Çdo familje në këto anë kishte nga një luftëtar.

Këto ne duhet t'i përmendim çdo ditë, vëllezër dhe motra, ato nuk duhet t'i harrojmë sepse në saje të Luftës Nacionalçlirimtare që bëri populli ynë, klasa punëtore dhe fshatarësia jonë patriote, të udhëhequr nga Partia, sot jetojmë të lirë dhe të lumtur ne dhe fëmijët tanë, të cilëve mësuesit u tregojnë për luftën heroike të prindërve, të vëllezërve dhe të motrave të tyre, që sakrifikuan edhe jetën që ata të rrojnë të lumtur, të rriten të gëzuar dhe pa brenga, të mësojnë dhe të fitojnë dituri. Këto duhet t'ua mësojmë edhe brezave të ardhshëm.

Punën që kanë bërë prindërit tuaj, ju duhet ta çoni më tej, ta zgjeroni akoma më shumë me diturinë tuaj, që ta ktheni këtë vend të bukur në një vend të begatshëm, që vuajtjet dhe mjerimi t'i mbeten përgjithmonë së kaluarës. Për këtë arsye ju duhet t'i doni me gjithë shpirt prindërit tuaj.

Prandaj, kur kalojmë këtyre anëve, na rreh zemra fort kur shohim se në këto vende betejash sot ndërtojmë jetën e re ashtu si na mëson Partia. Ju po shihni se si Shqipëria po ndryshon çdo ditë. Kudo vendi është mbushur me fabrika, kombinatë, hidrocentrale, që përpara nuk i kishim, kudo fushat dhe kodrat janë zbukuruar dhe prodhojnë për popullin. Më parë ishte e pamundur të bëheshin këto ndryshime, sepse në regjimet antipopullore të atëhershme askush nuk mendonte për popullin, përkundrazi shfrytëzuesit i pinin popullit djersën dhe gjakun çdo ditë dhe çdo orë.

Ju jeni afër kryeqytetit, dhe e dini se si ka qenë



përpara Tirana dhe si është sot. Në Tiranën e dikurshme sundonte çizmja e fashistëve italianë dhe gjermanë, të cilët me ballistët dhe zogistët kishin vendosur qendrën e tyre dhe kërcënonin çdo ditë dhe çdo orë repartet e Ushtrisë sonë Nacionalçlirimtare, çetat që ndodheshin rreth Pezës heroike.

Shumë prej jush kanë pasur rastin të vizitojnë atdheun tonë dhe kanë parë se ndërtime të mëdha nuk bëhen vetëm në Tiranë, por në të gjithë Shqipërinë.

Të gjitha këto të mira që po ndërtohen në atdheun tonë të bukur, janë bërë nga duart e arta të popullit tonë, për të mirën e tij. Këto ndërtime, vëllezër dhe motra, u realizuan brenda një kohe shumë të shkurtër, sepse populli nën udhëheqjen e Partisë mori në duar pushtetin. Këto suksese u arritën se udhëzimet dhe direktivat e Partisë kanë qenë kurdoherë të drejta, kanë shprehur dëshirat dhe interesat e popullit, sepse Partia dhe popull ishin dhe janë një e të pandarë, sepse Partia e dinte çfarë kërkonte e përse luftonte populli, se Partia vetë është pjellë e popullit.

Udhëzimet dhe direktivat që dha Partia, në të gjitha drejtimet, përputheshin me dëshirat tuaja dhe ato nuk mbetën vetëm fjalë ose parulla të shkruara në letër, por u realizuan dhe po realizohen dita-ditës në jetë, sepse populli shqiptar, duke ecur sipas mësimëve të Partisë, iu vu punës me mish e me shpirt dhe i zbatoi këto udhëzime e direktiva. Pra ajo që është realizuar në vendin tonë është meritë e Partisë dhe e popullit. Prandaj populli e do kaq shumë Partinë dhe është i lidhur ngushtë me të. Këto lidhje u krijuan dhe u forcuan në luftë për të njëjtat qëllime dhe ideale.

Ne kemi pasur dhe kemi armiq që nuk na e kanë dashur dhe nuk na e duan të mirën. Ata jo vetëm nuk janë në gjendje ta dëmtojnë atdheun tonë, por as nuk do të jenë në gjendje të prekin sado pak popullin shqiptar. Kjo ndodh se popull e Parti si një grusht i vetëm i bëjnë ballë çdo rreziku, kapërcejnë çdo vështirësi dhe i shtypin armiqtë pa mëshirë.

Kujtoni, shokë dhe vëllezër, 17 vjetët që kanë kaluar që nga çlirimi i atdheut. Kanë qenë kohë të vështira nga shumë pikëpamje. Në vitet e Luftës Nacionalçlirimtare rreth Partisë duhej të grumbulloheshin edhe një kategori njerëzish që nuk e kishin akoma të qartë rrugën e saj. Ishin me mijëra njerëz të cilët në fillim jo vetëm nuk na donin, por edhe na shanin. Por ne kishim besim se do të vinte ajo kohë që këta njerëz do të bindeshin për drejtësinë e vijës së Partisë. Dhe kështu ndodhi. Partia bëri që edhe këta njerëz t'i kuptonin drejt vijën dhe qëllimet e saj. Ajo punoi me takt e me durim me këta njerëz për t'i bindur dhe shumicën dërrmuese të tyre e bindi jo vetëm me fjalë, me politikën e saj të drejtë, por edhe me vepra. Ata panë ç'bënë Partia dhe populli dhe ç'kishin bërë ata në kohën e tyre, në ç'mjerim e lanë Shqipërinë bejlerët, agallarët dhe kapitalistët, me të cilët ishin lidhur. Mendimi i këtyre njerëzve filloi të ndryshonte dalngadalë dhe tani shumë prej tyre janë bërë qytetarë të denjë të RPSH dhe punojnë ndershmërisht për popullin. Njerëz të tillë, Partia nuk i ka përzier kurrë me armiqtë. Ata që e vazhduan rrugën kundër popullit morën dënimin e merituar, sepse Partia nuk mund të lejonte të cenoheshin interesat e larta të popullit, nuk mund të

lejonte që të merreshin nëpër këmbë gjaku i derdhur, sakrificat e panumërta të popullit tonë heroik për hatrin e disa spiunëve dhe tradhtarëve të shitur. Partia, nga një anë, punoi për t'i bindur njerëzit dhe tërhoqi në rrugën e drejtë të popullit shumicën dërrmuese të tyre, ndërsa, nga ana tjetër, atyre që ishin të vendosur për rrugën armiqësore u tregoi vendin. Kjo është rruga e drejtë revolucionare që na mëson Partia. Kështu ka vepruar dhe kështu do të veprojë ajo kurdoherë me ata që do të marrin nëpër këmbë interesin e përgjithshëm dhe që do të ndjekin rrugën kundër popullit, e cila i çon në greminë.

Vëllezër dhe motra, armiqtë e jashtëm kërkojnë që këtë vend të bukur, Shqipërinë, ta copëtojnë në mes tyre. Këtë kanë synuar monarko-fashistët grekë, revizionistët jugosllavë, fashistët italianë me imperialistët amerikanë në krye. Shumë komplete kanë bërë ata kundër vendit tonë, por Partia dhe i gjithë populli kanë qenë kurdoherë vigjilentë, prandaj të gjitha veprimet e armiqve të tërbuar të vendit tonë dhe të agjentëve të tyre kanë dështuar. Kështu dështoi edhe komploti i fundit.

Shtypi i vendeve imperialiste, si dhe fletushkat që botojnë ballistët e zogistët në vendet ku kanë gjetur strehim politik, janë shumë të dëshpëruar nga ky dështim dhe janë të detyruar të pohojnë se është vështirë të vihet në dorë Shqipëria, sepse ajo është një koskë e fortë që të ngec në fyt. Prandaj armiqtë e vendit tonë kanë filluar tani një fushatë të egër kundër Shqipërisë. Por qentë le të lehin, karvani ecën përpara. Ata presin ashtu si presin qentë që të bien mishra nga

qielli, por ato nuk do të bien kurrë, prandaj edhe këta do të mbeten kurdoherë të uritur dhe Shqipërinë nuk do të jenë kurrë në gjendje ta prekin. Populli që udhëhiqet nga Partia, ka krijuar organet e veta, në radhë të parë ushtrinë tonë të lavdishme, pjellë e Luftës Nacionalçlirimtare, të përbërë nga bijtë tuaj e që drejtohen dhe edukohen nga oficerët trima që kanë luftuar në të katër anët e Shqipërisë, nëpër male dhe në fusha, që i ka mësuar dhe i ka edukuar Partia se si të drejtojnë një ushtri të fuqishme, të pajisur me armët më moderne. Kemi krijuar një ushtri që ka në shpirt vetëm interesat e Partisë dhe të popullit, që punon dhe udhëhiqet vetëm nga një qëllim, të mbrojë popullin nga çdo rrezik, të mbrojë fitoret e tij. Tani ushtria jonë është në këmbë, ajo është vigjilente, e mësuar dhe e edukuar më së miri, e armatosur me të gjitha mjetet e nevojshme për mbrojtjen e atdheut, prandaj as miza nuk do të kalojë dot në këto anë.

Ne kemi gjithashtu një pushtet të fortë popullor në udhëheqje të të cilit populli vetë ka zgjedhur njerëzit e tij. Këta njerëz janë të lidhur me masat dhe zbatojnë me besnikëri udhëzimet e Partisë e të Qeverisë, të cilat përfaqësojnë dëshirat dhe interesat e popullit. Po të mos ishte i tillë pushteti, Shqipëria nuk do të ecte përpara, nuk do të zhvillohej dhe nuk do të arrinte nivelin që ka arritur sot dhe ku të gjitha të ardhurat që sigurohen nga puna e përbashkët e gjithë popullit shpërndahen në mënyrë të tillë që begatia dhe lumturia të vijë për të gjithë. Sot nuk është përmirësuar vetëm jeta e fshatarëve të Myzeqesë ose të Korçës që kanë fushat më të bukura dhe më pjellore të

vendit tonë. Mirëqenia sot ka arritur deri në skajet më të largëta të atdheut. Partia mendon dhe kujdeset për të gjitha krahinat e vendit. Ajo mendon që i gjithë vendi të zbukurohet. Është punuar dhe punohet që të thahen kënetat, të bëhen kanalizime, të sistemohen toka, të krijohen mundësi që të ketë bollëk. Por këto punë, vëllezër dhe motra, nuk mund të bëhen menjëherë. Bujqësia është një sektor i tillë ku sa më shumë dhe sa më mirë të punosh, sa më tepër vegla dhe plehra të ketë aq më shumë prodhime do të marrësh. Prandaj Partia ka bërë shumë deri tani për këtë sektor, por duhet të bëjë akoma më tepër në të ardhshmen.

Ju e dini se plani ynë pesëvjeçar do ta bëjë bujqësinë shumë më të përparuar se ç'është. Ju gëzoheni që shikoni rreth fshatrave tuaja mjaft traktorë e kombajna. Sot në gjithë Shqipërinë ka me mijëra të tillë dhe gjatë pesëvjeçarit të tretë do të vijnë edhe mjaft të tjerë, sepse dihet që me traktorë toka punohet më mirë dhe jep rendimente më të larta.

Ju, shokë fshatarë, ndodheni në një luginë të bukur, e cila duhet me të vërtetë të lulëzojë ashtu sikurse e meriton krahina juaj që ka luftuar dhe ka derdhur gjak për Shqipërinë tonë të re, ashtu si e meriton kryeqyteti i atdheut tonë. Lugina e Pezës heroike dhe e fshatrave të tjera të lokalitetit të Ndroqit jo vetëm duhet të punohet shumë mirë për të mbjellë grurë dhe misër, fruta dhe perime, por ju duhet të shfrytëzoni dhe të gjitha mundësitë për të shtuar sipërfaqet e ujëtshme. Mos u kënaqni me një elektropompë që keni tani. Kjo është shumë pak. Ju duhet të mendoni dhe të përpiqeni që të shfrytëzoni të gjitha ujërat që rrje-

dhin në përrrenjtë e krahinës suaj, duke i grumbulluar nëpër hauze për t'i pasur si rezervë në kohën e verës, gjë që do të shtojë shumë rendimentet e kulturave bujqësore. Organizatat-bazë të Partisë, kryesitë e kooperativave dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Tiranës duhet t'i studjojnë një nga një dhe sa më parë këto probleme, se ku mund të ndërtohen rezervuarë të tillë me forcat tuaja. Në këtë drejtim edhe Qeveria ka vendosur ta ndihmojë fshatarësinë deri në 30 për qind të shpenzimeve. Prandaj mobilizohuni që ta kryeni mirë edhe këtë detyrë.

Kush ka vizituar rrethin e Korçës ka vënë re se fushat janë të punuara shumë mirë, prandaj fshatarësia kooperativiste atje siguron rendimente të larta, pra edhe të ardhura të mira. Mirëpo kooperativistët e atij rrethi shikojnë edhe më tutje, prandaj kanë filluar të ndërtojnë rezervuarë të vegjël. Vizitova një të tillë në kooperativën bujqësore të bashkuar të Lumalasit. Ai ishte bërë me punën e palodhur të kooperativistëve. Kur e pyeta kryetarin se sa kohë do të duhej për t'i nxjerrë shpenzimet e kësaj pune, ai u përgjigj se vetëm nga zarzavatet që do të prodhojmë gjatë këtij viti, do të nxirren shpenzimet e bëra për këtë punë. Ju, vëllezër dhe motra, nuk jeni më pak punëtorë se kooperativistët e Korçës. Prandaj duhet t'i futeni me zell punës në këtë drejtim, sepse kështu do t'i bëni më të begatshme kooperativat.

Shumë e rëndësishme për ju dhe për krahinën tuaj është kultura e ullirit. Edhe prindërit tanë ishin patriotë si ne, edhe ata kujdeseshin për të na ushqyer dhe për të na rritur ashtu sikurse kujdesemi ne për fëmijët

tanë, prandaj ata i kanë mbjellë gjithë këta ullinj. Por vallë ne që dimë më shumë nga ata, që kemi mjete më shumë nga ata, nuk mundemi t'i dyfishojmë e t'i trefishojmë ullinjtë e sotëm? Sigurisht që mundemi. Ndonjë plak mund të thotë se gjyshërit tanë nuk i kanë mbjellë ato në një ose dy vjet, po gjatë dhjetëra dhe ndoshta qindra vjetëve. Dhe kështu është. Edhe ne nuk pretendojmë që t'i shtojmë ullinjtë brenda një ose dy vjetëve, por as nuk do presim me dhjetëra e njëqind vjet. Duhet të fillojmë të mbjellim shumë më tepër nga sa kemi mbjellë deri tani. Të gjitha këto vepra që ka bërë populli shqiptar nën udhëheqjen e Partisë, gjatë këtyre 17 vjetëve, prindërit tanë nuk i bënë dot as për njëqind vjet dhe jo se nuk donin, por sepse nuk i linte i huaji, se ata i pengonte beu dhe agai, kurse ne sot kemi forca dhe kushte të tilla që mund t'i kryejmë shumë më shpejt.

Ja, këtu në Ndroq pushteti popullor ndërtoi një vepër të re e të bukur, fabrikën për prodhimin e vajit, e cila s'ka të krahasuar me atë që kishin ngritur, po në fshatin tuaj, bejlerët e vendit dhe që tani s'e krahason dot as me një haur lopësh. Fabrikën e re e drejton një bir i kësaj krahine, dje pjesëmarrës në luftën për çlirimin e vendit. Detyra juaj është që t'i siguronit kësaj fabrike lëndën e parë, ullirin.

Prandaj, vëllezër dhe motra të Ndroqit, mos u kënaqni me planin që keni për të mbjellë vetëm 2000 rrënjë ullinj gjatë pesëvjeçarit, por ta rishikoni këtë plan dhe të mbillni shumë më tepër. Veç kësaj, t'i pas-troni dhe t'u shërbeni mirë ullinjve që na kanë lënë gjyshërit tanë, t'u bëni atyre krasitjen e rëndë, t'i plehë-

roni që të prodhojnë më shumë. Sikur këto shërbime t'i siguroni për të gjithë ullinj të patjetër do të merrni jo 10-15 kg, por 50-100 e më shumë kg për çdo rrënjë, sikurse marrin mjaft kooperativa në Mallakastër dhe në bregdetin e Vlorës. Mund të shfrytëzoni kodrat që janë të mbushura me maré. Në vend të tyre mbillni ullinj se kështu do të siguroni dhe të ardhura më të mëdha. Mbjellja e ullinjve dhe shërbimi që duhet t'u bëni atyre duhet të jetë një nga preokupacionet tuaja më të mëdha. Mbillni për vete dhe për brezat e ardhshëm!

Ju keni shumë mundësi për të mbjellë vreshta. Këtu rritet shumë mirë rrushi, për tryezë ose për të bërë verë. Duke shtuar vreshtat, ju do të keni mundësi të shitni shumë rrush dhe me ato të holla të bleni më shumë ushqime, veshmbathje, lëndë druri për ndërtime. Kështu Ndroqi e Peza do të zbukurohen, do të bëhen qendra tërheqëse për qytetarët.

Këtu afër ju keni katundin Shesh që prodhon një rrush me famë, të bukur dhe të ëmbël, që kërkohet kudo. Këtë varietet rrushi ju duhet ta përhapni në të gjithë lokalitetin tuaj, në të gjitha kooperativat bujqësore, sepse, po të shtohet prodhimi, atëherë shteti do të ndërtojë edhe fabrikë për përpunimin e tij.

Ju keni arritur rezultate të mira në prodhimin e drithit jo vetëm këtë vit, por edhe vitin e kaluar. Me gjithë thatësirën e madhe të vitit që shkoi, ju e siguruat bukën. Kjo është një punë e mirë patriotike. Këtë vit ju do të merrni rendimente më të larta. Kjo është një gjë e mirë, por do të vijë shpejt koha që shteti do t'ju ndihmojë edhe me plehra dhe kur të keni ndërtuar edhe rezervuaret për ujë që thashë më lart, atëherë



nga këto fusha nuk do të merren më 12 e 13 kv grurë për hektar, por 20 dhe 25 kv. Prandaj përvishjuni punës, filloni sa më parë nga korrja e grurit dhe mos lejonit të humbasë asnjë kokërr, të mos kemi firo. Një kalli më pak është një humbje për çdo familje. Dhe pasi të korrni grurin e ta futni në hambar, menjëherë arat i mbillni me misër hamullor, në mënyrë që të merrni dy prodhime në vit nga e njëjta sipërfaqe.

Gjatë këtij pesëvjeçari Partia do të ngrejë uzinat e plehrave kimike. Më parë kishte nga ju që nuk e kuptonin rëndësinë e plehut. Por ajo kohë ka kaluar dhe tani plehu kimik kërkohet kudo. Tani Partia po e bën realitet dëshirën e fshatarësisë dhe me ngritjen e uzinave të plehrave kimike do të plotësojmë më mirë nevojat e bujqësisë.

Një punë e madhe do të bëhet për ndërtimin e veprave të tjera të mëdha, siç janë kombinati i ri i tekstileve në Berat që do të prodhojë stofa akoma më të bukura dhe më të lira, fabrikat e mëdha të çimentos, që do të krijojnë mundësi për të shtuar akoma më shumë ritmet e ndërtimeve në të ardhshmen etj.

Kudo ka kërkesa të mëdha për lëndë druri, çimento dhe material ndërtimi për të ndërtuar shtëpi. Unë ju këshilloj, shokë, të keni kujdes që shtëpitë të mos i ndërtoni si më përpara, larg njëra-tjetrës, por sa më afër, sepse ndërtimi në këtë mënyrë ka të mirat e tij, krijohen mundësitë për të sjellë më shpejt dritën elektrike, ujin e për të qenë më afër njëri-tjetrit. Mos lakmoni t'i ngrini ato brenda një viti. I ndërtoni një herë karabiná, pastaj ndërtoni një dhomë e kështu me radhë derisa t'i përfundoni të gjitha. E rregulloni shtë-

pinë mirë dhe pastër, sepse njeriu që punon ka nevojë edhe për t'u çlodhur në një ambient të këndshëm. Këto janë kërkesa të kohës dhe koha e tanishme kërkon që të zhduket çdo gjurmë e keqe e së kaluarës.

Më parë, po të shikonin një grua në mbledhje, njerëzit e fesë dhe anadollakët do ta përgojnin. Tani që Partia u hapi sytë e u dha të drejtën grave, këto edhe punojnë, shkojnë edhe në mbledhje, shkojnë edhe në shfaqje, sepse ato kanë po aq të drejta, janë po aq të zonjat sa edhe burrat dhe kanë zënë vendin e merituar në shoqëri e në familje, nderohen e respektohen nga të gjithë. Gratë janë të afta për punë sa dhe burrat, bile ato punojnë edhe më shumë. Vajzat tona mësojnë në shkolla njëlloj si dhe djemtë. Ato sot punojnë në të katër anët e vendit, si mjeke, mami, infermiere, inxhinierë, agronome, mësuese e të tjera, e të tjera. Ato nuk kanë frikë as nga përgjegjësitë, as nga vështirësitë. Shikoni, pra, ç'ndryshime ka bërë gruaja në vendin tonë. Tani na duket marrëzi që gruaja në të kaluarën mbahej mbyllur ose që vajza nuk dërgohej në shkollë. Në një familje ku të gjithë punojnë ka më shumë të ardhura, atje mirëqenia është më e ngritur.

Prandaj në këtë problem të rëndësishëm të keni parasysh mësimet e Partisë. Gjithashtu Partia na mëson që të rinjtë të sillen mirë me prindërit e me pleqtë, t'i duan ata me gjithë shpirt dhe t'i respektojnë. Të rinjtë t'i dëgjojnë me kujdes më të moshuarit. Këta mund të mos kenë shkollë, por kanë eksperiencën e madhe të jetës, janë njerëz të vuajtur, kanë parë shumë halle në jetë dhe kanë kapërcyer shumë vështirësi, prandaj duhen dëgjuar dhe respektuar. Por edhe më të

mëdhenjtë të mos e heqin veten se dinë gjithçka, se edhe të rinjtë e shkollave mësojnë shumë gjëra që nuk i dimë ne, prandaj, kur na thonë diçka, të mos u themi largohuni që këtej, por t'i dëgjojmë me kujdes, të mësojmë edhe ne prej tyre. Prandaj respekti duhet të jetë i dyanshëm, sepse rrojmë e punojmë në kohë të tjera, në kohë të reja, kur shkenca ka ecur përpara. Partia jonë është një Parti marksiste, ajo lufton kurdoherë për drejtësinë dhe na mëson që të themi kurdoherë të vërtetën. Atij që punon mirë, t'i thuhet të lumtë, dhe atij që është i aftë t'i hapet rruga të ecë përpara, kurse ata që nuk ecin dot më tej, por janë njerëz të mirë, ne duhet t'i nderojmë, t'i çmojmë për ato që kanë bërë, por dhe t'i bëjmë të kuptojnë që të mos zënë vendin e djemve ose të vajzave të reja që ecin përpara. Ky është ligji ynë. Kur plaket njeriu i ikën edhe fuqia, kurse të riut i zien gjaku, prandaj nuk është e drejtë t'ia zësh vendin atij që ka mundësi të ecë përpara e që i jep më shumë shoqërisë.

Kush bën gabim duhet ta pranojë atë dhe të luftojë që të ndreqet, se ndryshe dëmton Partinë, çështjen tonë të madhe, socializmin dhe komunizmin. E tillë është Partia jonë. Ajo dhe udhëheqja e saj shkojnë në popull, dëgjojnë vërejtjet e popullit dhe pranojnë këshillat e tij. Në rast se populli ka diçka për të thënë, ta thotë hapur dhe ai që i thotë hapur e në sy kritikën që janë në interesin e punës, është trim. Ka njerëz të shtyrë nga qëllime të këqija, që të futin thikën pas shpine. Partia i kupton ata dhe u tregon vendin, por kur një fshatar, për shembull, mund të pyesë «ne nuk kemi ujë për të ujitur arat dhe pemët, përse të mos na dër-

gohet një elektropompë?», këtij ne nuk mund t'i themi se është njeri i keq, sepse ai ato fjalë i tha në interes të popullit. Ose një tjetër mund t'i drejtohet kryetarit dhe t'i thotë, ti nuk punon mirë; kryetari nuk ka të drejtë t'i thotë pse më kritikon. Populli ka plotësisht të drejtë të kritikojë kur puna nuk ecën mirë, ndryshe ndonjë drejtues bëhet kapadai, nuk dëgjon njeri, dhe ecën me hundën përperjetë dhe të gjithë pastaj i duken si miza. Po të lejohet një gjë e tillë, atëherë puna dëmtohet. Por Partia nuk lejon të dëmtohet puna, njerëzve të tillë ajo u thotë «pa zbritni njëçikë nga fiku». Këtë Partia e ka bërë dhe e bën vazhdimisht kur duhet. Kështu vepron ajo edhe në lëmin ndërkombëtar.

Kur Partia jonë sheh se ndonjë udhëheqës partie, i çfarëdo partie qoftë, edhe i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, gabon, ajo pa u trembur dhe pa frikë ia thotë në sy, që të ndërrojë rrugë, të kthehet në rrugën e drejtë marksiste-leniniste. Këtë Partia jonë e ka bërë, prandaj ajo ka mbështetjen e të gjithë komunistëve të vërtetë në botë. Ja një shembull: Nikita Hrushovi nuk la gjë pa thënë për J. V. Stalinin, i cili ka qenë një luftëtar i shquar për përhapjen dhe për mbrojtjen e ideve të marksizëm-leninizmit. Ai ndoqi me besnikëri të madhe rrugën e Leninit, nën udhëheqjen e tij Bashkimi Sovjetik ka kapërcyer momente shumë të vështira. Kur Bashkimi Sovjetik sulmohej nga të katër anët, Stalini bashkë me Leninin dhe nën udhëheqjen e tij shpartalluan intervencionin imperialist dhe kundërvolucionarët rusë, kur ai ishte në udhëheqje të partisë dhe të shtetit Bashkimi Sovjetik realizoi industrializimin, ngriti bujqësinë kolkoziane, zhvilloi kulturën dhe luf-

toi pa mëshirë armiqtë e betuar të Bashkimit Sovjetik, të socializmit dhe të komunizmit. Me gjithë këto merita të mëdha të Stalinit, N.S. Hrushovi i hodhi baltë atij. Këtë rrugë ndoqën dhe shumë udhëheqje të partive të tjera, të cilat pranuan ato që tha Hrushovi për Stalinin. Por udhëheqja e Partisë sonë nuk pranoi të njollosej emri i Stalinit dhe i tha Hrushovit, para mbledhjes së 81 partive, se Partia dhe populli ynë nuk janë dakord me këto akuza e sharje në adresë të J.V. Stalinit.

Ne nuk kundërshtojmë rastet që si Stalini ashtu edhe çdo udhëheqës tjetër apo individ kanë bërë dhe bëjnë gabime në punë. Njeri pa gabime nuk ka. Por këto akuza që i bëhen Stalinit, nuk janë të drejta. Atyre që i bënë kritika Stalinit nuk u erdhi mirë nga qëndrimi parimor i Partisë sonë, por u erdhi mirë komunistëve të vërtetë të të gjithë botës dhe të gjithë atyre luftëtarëve sovjetikë e antifashistë që me emrin e Stalinit në gojë hidheshin në sulm mbi ushtrinë hitleriane, u erdhi mirë të gjithë marksistë-leninistëve të vërtetë në botë, për të cilët vepra e Stalinit do të mbetet kurdoherë e pavdekshme.

Partia jonë dhe Partia Komuniste e Kinës kanë mbrojtur me heroizëm marksizëm-leninizmin. Prandaj disa udhëheqës të disa partive komuniste të vendeve socialiste organizuan një komplot për ta nxjerrë jashtë kampit të socializmit Republikën Popullore të Kinës, për ta nxjerrë jashtë gjirit të lëvizjes komuniste ndërkombëtare Partinë Komuniste të Kinës. Por Partia jonë që kurdoherë është karakterizuar për vigjilencë të lartë, në Mbledhjen e Bukureshtit i tha ndal këtij komploti. Ne, tha Partia jonë atje, nuk pranojmë të komploti.

tohet kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe do të ishte një gabim shumë i rëndë që Kina e lavdishme të hidhej jashtë kampit socialist. Kështu Partia jonë ua prishi planet komplotistëve.

Nuk ka komunist dhe njeri të ndershëm në botë që të thotë se nuk është i drejtë një qëndrim i tillë si ky i Partisë sonë. Popujt dhe partitë komuniste të vërteta në të gjithë botën i përkrahin këto qëndrime, se janë të drejta, pavarësisht se udhëheqësve të disa vendeve socialiste nuk u pëlqeu qëndrimi i drejtë i Partisë sonë. Shqipëria vazhdon të ecë përpara, të ndërtojë socializmin, të mbrojë paqen, të mbajë në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën.

Neve nuk na është rritur dhe nuk na rritet mendja nga qëndrimet e drejta që mbajmë, që po i vërteton vetë jeta, pavarësisht se jemi një popull dhe një Parti e vogël. Por rëndësi të madhe dhe vendimtare ka se ne qëndrojmë fort në binarët e marksizëm-leninizmit dhe jemi të bindur se ai do të triumfojë. Partitë që i qëndrojnë besnike marksizëm-leninizmit, të mëdha ose të vogla qofshin, do të fitojnë, kurse ata që kërkojnë t'i vënë pengesa rrotës së marksizëm-leninizmit për ta frenuar që të shkojë përpara, do të bien vetë. Ky është ligj, do apo nuk do dikush, historia do të ecë përpara. Idetë e mëdha që Karl Marksi dhe Frederik Engelsi shkruan në Manifestin e tyre të famshëm, që u bë fener për proletariatin ndërkombëtar dhe për popujt e shtypur, sot po vërtetohen në jetë. Ashtu si kanë thënë Marksi dhe Engelsi, ashtu si pohuan më vonë Lenini dhe Stalini, ashtu po ndodh.

Këto që po ju them janë fjalët e Partisë, të popullit. Forca jonë qëndron në forcën e tyre.

Prandaj, me besim të patundur në vijën e drejtë të Partisë t'i përvishemi punës në mënyrë të organizuar, të bëjmë që të lulëzojnë kooperativat bujqësore të lokalitetit tuaj. Unë ju uroj shëndet, punë të mbarë, prodhime të shumta, jetë të lumtur në familje, në shoqëri dhe të jeni të bindur se ne nuk do të ndalemi kurrë në rrugën tonë dhe të kemi besim se kurdoherë do të korrim suksese të mëdha, nën udhëheqjen e Partisë sonë të lavdishme!

Rroftë Partia jonë e lavdishme!

Rrofshin kooperativistët e Pezës heroike, të Ndroqit e të fshatrave të tjera të lokalitetit tuaj dhe qofshin kurdoherë të nderuar dhe të respektuar!

Rroftë rinia e lokalitetit tuaj dhe mësuesit e mësueset që e mësojnë atë në rrugën e Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**DUKE PRODHUAR SA MË SHUME,  
DO TË RROJMË EDHE MË MIRË**

*Fjala me kooperativistët e Petrelës në rrethin e Tiranës*

**14 qershor 1961**

Të dashur shokë dhe shoqe të Petrelës,

Unë dhe shokët e tjerë që marrim pjesë në këtë takim, jemi shumë të gëzuar që kemi ardhur këtu në gjirin tuaj të takohemi dhe të bisedojmë bashkë. Është një gëzim i madh për ne që erdhëm këtu në Petrelë, në këtë lokalitet, ku kemi luftuar së toku për këto ditë të lumtura që gëzon sot i gjithë populli shqiptar.

Në shtëpitë dhe në kasollet tuaja, partizanët, djemtë dhe vëllezërit tuaj, në kohët më të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare, kanë gjetur strehim dhe ju atë krodhë bukë që kishit e ndatë me luftëtarët trima. Partizanët nëpër familjet tuaja kanë gjetur zemra të ngrohta ashtu si në gjirin e gjithë popullit shqiptar, i cili, me thirrjen e Partisë, u ngrit i tëri në luftë për të shkatërruar sundimin e egër të bejlerëve dhe të agallarëve, që jo vetëm i pinë gjakun popullit gjatë gjithë kohës,



por sollën në vendin tonë edhe pushtuesit italianë dhe gjermanë.

Partia e cila doli nga gjiri i vuajtur i popullit tonë, e udhëhoqi atë në luftën e madhe për liri. U dëbuan një herë e përgjithmonë fashistët italianë e gjermanë dhe u përmbys pushteti feudoborgjez, që sundonte me shekuj në vendin tonë.

Ju mbani mend se këtu në Petrelë Ahmet Zogu kishte ngritur një përmendore për gjeneral Gjilardin<sup>1</sup>, një barbar i huaj që rronte me rrogën që i jepte Ahmet Zogu, të cilën e thithte nga djersa dhe gjaku i popullit tonë. Ahmet Zogu këtë njeri e kishte sjellë për të shtypur popullin, por populli ynë i vuri shkelmin, e shkatërroi atë përmendore dhe ngriti përmendore të reja për djemtë dhe vajzat e tij që luftuan dhe u vranë për lirinë e atdheut, që ju si i gjithë populli të rroni të lirë dhe të punoni e të prodhoni sa më shumë për familjet tuaja, për shoqërinë tonë socialiste.

Ky ishte ideali i madh i Luftës Nacionalçlirimtare, që filloi si në shumë krahina edhe këtu në Petrelë. Po, duhej derdhur gjak, se pa gjak ishte e pamundur të çlirohej Shqipëria dhe të bëhej një shtet i demokracisë popullore ku ndërtohet me sukses socializmi. Disa njerëz që e heqin veten si komunistë, po që s'janë tjetër veçse antimarksistë, pretendojnë se tani që socializmi është bërë një forcë e madhe në botë, kapitalizmi mund t'ia japë pushtetin klasës punëtore pa luftë, me vullnetin e dëshirën e tij. Por jeta ka treguar se klasat shfry-

---

<sup>1</sup> Gjeneral Gjilardi — me origjinë hungareze, adjutant i Zogut dhe inspektor i përgjithshëm.

tëzuese nuk të falin gjë, përkundrazi të marrin shpirtin dhe këtë populli ynë e ka provuar shekuj me radhë në kurrizin e tij. Prandaj ai, me klasën punëtore në ballë, nën udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste, përmbysi nga themelet pushtetin e shfrytëzuesve, mbi gërmadhat e të cilit ngriti pushtetin e vet. Një gjë e tillë nuk arrihet pa luftë, pa gjak. Këtë e ka vërtetuar historia. Por kush e merr pushtetin me luftë kundër kapitalistëve, fashistëve, bejlerëve dhe agallarëve, duhet ta mbrojë atë me vendosmëri. Edhe pushteti ynë popullor që u vendos në të gjithë vendin pas Luftës Nacionalçlirimtare, u fitua me luftën e popullit të udhëhequr nga Partia, me gjakun e dëshmorëve dhe sot mbrohet me vigjilencë.

Kur themi pushteti popullor kuptojmë se në fuqi janë klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse që përbëjnë shumicën dërrmuese të popullsisë dhe që udhëhiqen nga Partia. Prandaj ky pushtet është i pamposhtur. Përpyekjet që kanë bërë e bëjnë armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm për ta rrëzuar pushtetin tonë popullor, kanë dështuar e do të dështojnë, sepse grushti i hekurt i diktaturës së proletariatit do të dërrmojë si kurdoherë çdo armik që do të tentojë të dëmtojë ndërtimin e socializmit te ne. Ju e dini se armiqtë e brendshëm çdo përpjekje për të rrëzuar pushtetin tonë popullor e kanë mbështetur kurdoherë te armiqtë e jashtëm. Gjyqi i fundit që u zhvillua në vendin tonë, siç e ndoqët edhe në shtyp, provoi se tradhtari Teme Sejko me shokë ishin të lidhur me të huajt, me revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe me Flotën VI Amerikane.

Por Shqipërinë nuk është aq lehtë jo vetëm ta sulmojnë e ta copëtojnë, por edhe kufijtë e saj nuk janë në gjendje t'i prekin sado pak, se u pritet dora. Kanë bërë dhe bëjnë orvatje revizionistët jugosllavë ose monarko-fashistët grekë, të shtyrë nga imperialistët amerikanë, po ata kurrë nuk do të kenë sukses në orvatjet e tyre, sepse nuk do të gjejnë kurrë të çara në popullin shqiptar, në Partinë e tij të lavdishme e në pushtetin e tij popullor, sepse Partia, Qeveria dhe populli ynë janë si një grusht i vetëm. Partia është ajo që e udhëhoqi popullin për çlirim, që e mësoi si të përparojë, se Partia përbëhet nga djemtë dhe vajzat e popullit dhe ata nuk kanë tjetër qëllim veçse të punojnë e të luftojnë derisa të kenë jetën për të mirën e popullit dhe të atdheut. Veprat që vërtetojnë qëllimet e larta të Partisë janë të shumta dhe populli ynë i njeh mirë.

Bijtë dhe bijat e Partisë nga më të mirat derdhën gjakun rrëke për popullin e vet. Vetëm tradhtarët e atdheut mund ta mohojnë një gjë të tillë, por populli kurrë. Nën udhëheqjen e Partisë u ndërtua një industri krejt e re në vendin tonë, ku më parë nuk kishte asgjë, veçse kudhra të ndonjë farkëtari. Fabrikat, kombinatet, hidrocentralet që janë ndërtuar dhe po ndërtohen nga të katër anët e Shqipërisë, dëshmojnë për veprën e madhe të Partisë.

Në kohën e Zogut e vetmja fabrikë e cigareve që u ngrit nuk i përkiste popullit, por pronarit Xhelo Dibra me shokë, kurse të gjitha veprat që ndërtohen tani në Shqipëri janë pronë e përbashkët e gjithë popullit dhe të ardhurat që vijnë prej tyre, përdoren për të forcuar më tej ekonominë socialiste, për të shtuar

prodhimin, me qëllim që populli çdo vit të ketë më shumë e nga çdo gjë, që mirëqenia e tij të ngrihet vazhdimisht.

Vepra të pavdekshme të Partisë janë punimet e mëdha që janë bërë e po bëhen në fushat e ndryshme të Shqipërisë, të cilat këto dy-tre vjetët e fundit janë zbukuruar nga kolektivizimi. «E bukur është puna e kolektivizimit, tha patrioti Asllan Kërçiku<sup>1</sup>, por akoma më i bukur na duket bashkimi i kooperativave, sepse kështu na u shtua edhe më shumë fuqia». Kjo është e drejtë dhe tregon largpamësinë e Partisë.

Mos mendoni se fshatari ynë u bind me një të thënë. Jo. Këtë rrugë në fillim edhe fshatari në Rusi nuk e kishte kuptuar, edhe atje Partia Bolshevike i këshillonte antarët e saj të mos nxitoheshin me fshatarësinë, të kishin durim dhe të punonin së pari për ta bindur. Fshatari, para se ta vërë në jetë një gjë të re, interesohet ta shikojë dhe ta provojë dhe kur të bindet pastaj e përqafton. Kështu ndodhi në fakt edhe te ne.

Shumë njerëz nuk i kuptonin këto gjëra në fillim, por Partia ua shpjegonte me durim, i porosiste gjithnjë antarët e vet të mos shpejtonin në çështjen e kolektivizimit, por të punonin për ta bindur fshatarësinë për epërsitë e kësaj rruge të treguar nga Marksi dhe Lenini e të zbatuar në jetë nga Stalini. Kolektivizimi është rruga e begatisë për fshatarësinë. Këtë e vërtetoi edhe praktika jonë e triumfit të kolektivizimit në fshat; tani, shikoni, në lokalitetin tuaj 97 për qind e fshatrave janë kolektivizuar.

---

<sup>1</sup> Nga fshati Fikas i rrethit të Tiranës (1878-1970). Pjesëmarrës aktiv në Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Agjikator dhe luftëtar i zjarrtë i vijës së Partisë për transformimin socialist të fshatit.

Ky është një sukses i madh, sepse kolektivizimi ka bërë që fushat e vendit tonë nga Veriu në Jug të marrin një pamje tjetër, ato janë zbukuruar, janë zhdukur gjerdhet, janë tharë kënetat e moçale, janë bërë sisteme dhe kanalizime. Këto vepra duhej të bëheshin patjetër. Që të punoheshin si duhet të gjitha këto toka duhej të futej në to mekanizimi, të ujiteshin e të kulloheshin tokat, të plehëroheshin ato, të siguroheshin për bujqësinë kuadro të arsimuar.

Punë kaq të mëdha nuk mund të bëheshin në një bujqësi të coptuar në toka të vogla, të ndara. Prandaj fshatarësia jonë e kuptoi atë që i thoshte Partia, se duheshin bashkuar këto copa në një ekonomi të madhe, që të futej traktori e shumë mekanizma të tjera.

Këtëj e tutje, vëllezër dhe motra, bujqësia jonë do të përparojë me hapa akoma më të mëdhenj se deri tani. Gjatë pesëvjeçarit të tretë ne do të sjellim shumë mekanizma të tjera bujqësore dhe do të ndërtojmë uzina për prodhimin e plehrave kimike.

Kështu nga fundi i këtij pesëvjeçari fushat tona do të japin më shumë prodhime, sepse, përveç mekanizimit, do të kemi më shumë plehra kimike, do të shtohet sipërfaqja e ujitshme që do të arrijë mbi 40 për qind të tokës së punueshme, do të shtohet dhe do të grumbullohet akoma më mirë plehu organik dhe atëherë ju nuk do të luftoni për 8 ose 10 kv grurë për hektar, por për 20 dhe 25 kv.

Fshatarësia jonë heroike, nën udhëheqjen e Partisë, brenda një kohe të shkurtër prej 16-17 vjet jete të lirë, ka bërë gjithë këto mrekullira. Këto përparime u bënë se ju i keni besuar me gjithë zemër Partisë, sepse keni kriju-

ar bindjen që Partia punon vetëm për të mirën e popullit.

Kur Partia jep ndonjë direktivë, zbatimimi i saj gjen mbështetje të fortë nga fshatarësia. Edhe për të ardhshmen fshatarësia është e bindur se bujqësia jonë do të bëhet një bujqësi e përparuar, prandaj i është përveshur punës me të gjitha forcat.

Në lokalitetin tuaj bujqësia ka përparuar, edhe te ju ka kooperativa të mira bujqësore. Në radhë të parë, duhet kuptuar drejt çështja e drejtimit kryesor, cilave kultura ju duhet t'u vini më shumë rëndësi. Sigurisht prodhimi i drithërave të bukës duhet të zërë vendin kryesor. Kjo kërkon që tokat që janë të vlefshme për drithëra, të mos zihen në asnjë mënyrë me kultura drunore. Krahas kësaj, rëndësi kanë për ekonominë tonë popullore edhe bimët industriale, nga të cilat ju kultivoni vetëm duhanin. Kooperativat tuaja prodhojnë edhe zarzavate. Kështu, pra, tokat e bukës duhet të rezervohen për drithëra dhe të përpiqeni sa të jetë e mundur që këto toka të ujiten me motopompa ose me elektropompa, me çikrikë ose me hauze.

Partia në rreth dhe në lokalitet si dhe vetë kooperativat bujqësore të mendojnë seriozisht për këtë problem, domethënë për të vënë sa më shumë toka nën ujë, sepse kështu do t'i shtojmë shumë prodhimet. Shteti do t'ju ndihmojë në drejtim të kanalizimeve dhe të ndërtimit të rezervuarëve. Prandaj nga ju kërkohet të shikoni se ku janë vendet që mund të ndërtoni prita për rezervuarë, ç'punë mund të bëni vetë dhe sa duhet t'ju ndihmojë shteti.

Një detyrë tjetër me rëndësi për ju është shtimi i ullinjve, i vreshtave dhe i pemëve frutore. Ullinj të kanë

një rëndësi të madhe për ekonominë e vendit tonë dhe për familjet tuaja, prandaj i shtoni ato, mos u kënaqni me ato që na kanë lënë gjyshërit dhe prindërit, por duhet të mendojmë që ashtu si i kujtojmë dhe u jemi mirënjohës të parëve tanë për ato që na kanë lënë, kështu do të na kujtojnë brezat e ardhshëm për ato që do t'u lëmë ne. Te asnjëri nuk duhet të ekzistojë mendimi i ngushtë se ulla jep pas 10-15 ose 30 vjetësh. Ne duhet të mbjellim ulla për vete dhe për kalamanët tanë, ashtu siç hamë ne, nipërit dhe fëmijët e gjyshërve dhe të prindërve tanë, të cilët i kanë mbjellë ato për ne, në kohën e tyre me vështirësi dhe me vuajtje të mëdha. Ne sot i kemi të gjitha mundësitë, kemi forca dhe mjete që të mbjellim shumë më tepër nga sa kanë mbjellë ata. Gjëni për këtë qëllim specialistët më të mirë. Në vendet e pjerrëta ndërtoni mure, në mënyrë që ujërat e dimrit të mos rrjedhin poshtë, por të futen thellë në rrënjët e ullinjve që të ngopen me ujë. Duke bërë shërbime të tilla do të shikoni se do të keni fitime të mëdha. Shqipëria është një vend që ka kushte të favorshme për mbjelljen e ullinjve, të agrumeve dhe të shumë pemëve të tjera.

Krahas me ullinjtë kujdesuni për shtimin e vresh-tave dhe sidomos të pjergullave që ju i zhvillonin shumë. Mos mbillni më nga rrushi me erë, bile i zëvendësoni pjergullat e këtij lloji me pjergulla që prodhojnë rrush të mirë dhe të ëmbël për të ngrënë dhe për të bërë verë. Mbillni pjergulla dhe fruta në ato toka ku nuk bëhet drithi, i ktheni kooperativat tuaja në kopshte të lulëzuara për të mirën tuaj dhe të popullit tonë.

Populli thotë «më mirë të dish se të kesh», sepse,

kur di, je në gjendje të ndërtosh, të prodhosh, të rritësh mirëqenien, kurse po të mos dish, mund të kesh pasuri, por ato pa punë nuk të sjellin gjë. Partia së pari e çliroi popullin dhe pastaj e mësoi atë si të punojë dhe të ndërtojë jetën e tij të lumtur. Partia, mbi të gjitha, mësoi dhe edukoi njeriun e ri.

Një tjetër revolucion i madh, që është bërë në vendin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, është edhe çlirimi e zhvillimi i gruas. Kjo është një çështje me rëndësi të madhe. Gruaja është gjysma e shoqërisë, ajo është e zgjuar si dhe burri, ajo është po aq e guximshme dhe e zellshme për të mësuar sa edhe burri, ajo është e zonja për punë ashtu sikurse edhe babai dhe vëllezërit e saj. Prandaj Partia e mësoi dhe e edukoi atë si të bëhet e vlefshme për vete, për familjen dhe për shoqërinë, ngriti lart personalitetin e saj.

Kudo sot në vendin tonë janë mbushur shkollat plot me gra e me vajza dhe nga puna që ka bërë Partia në këtë drejtim vendi ynë ka parë shumë të mira. Te ne tani ka shumë mjekë dhe infermiere. Do të vijë koha kur në vendin tonë shumica e mjekëve do të jenë gra, sepse gruaja është shumë më e dhemshur dhe më e kujdesshme se burri për të sëmurët. Po kështu është e do të jetë edhe në shumë sektorë të tjerë.

Partia e dinte se paragjykimet e vjetra ndaj gruas nuk mund të zhdukeshin menjëherë, se për t'i luftuar ato duhej bërë një punë e madhe edukative. Si rezultat i kësaj pune shohim se prindërit tanë, megjithëse të kaluar nga mosha dhe që më parë nuk e kuptonin mirë rëndësinë e kësaj çështjeje, tani i ndihmojnë gratë dhe vajzat e tyre, i këshillojnë ato që të shkojnë në shkollë



dhe të mësojnë, duke menduar se ata vetë kanë qenë pa dituri e pa kulturë. Pleq dhe burra të tillë me të vërtetë duhet të respektohen, sepse nuk ka qenë e lehtë të ndryshonte pikëpamja e vjetër që ata kishin mbi gruan.

Politika e drejtë e Partisë, pra, krijoi njerëz të rinj. Tani në vendin tonë është formuar një ushtri e tërë me njerëz të mësuar, me inxhinierë, agronomë, gjeologë, pedagogë, mjekë, mësues dhe njerëz të tjerë të profesioneve të ndryshme. Deri në fund të pesëvjeçarit të tretë vendi ynë do të ketë me qindra dhe me mijëra kadro të lartë dhe të mesëm që do të futen në prodhim, në industri e bujqësi, në ndërtim e transport, për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë së re. Shumë prej tyre do të jenë gra dhe vajza.

Të gjithë kuadrot që do t'i duhen zhvillimit të mëtejshëm të vendit tonë, do të dalin nga gjiri i popullit, nga qytetet dhe nga fshatrat tona. Prandaj, të dashur vëllezër dhe motra, djemtë dhe vajzat tuaja t'i dërgoni patjetër në shkolla. Mos u zemëroni në qoftë se ju kritikojnë, kur nuk dërgoni rregullisht në shkollë fëmijët tuaj. Kohët kanë ndryshuar dhe vazhdimisht po ndryshojnë, vendi përparon me shpejtësi. Gjatë pesëvjeçarit të tretë do të ndërtohen shumë objekte të reja për zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë. Te ne do të ndërtohet një kombinat i madh për përpunimin e hekurit dhe të nikelit, ku do të punojnë me mijëra punëtorë dhe do t'i sigurohen vendit të ardhura të mëdha. Por atje duhet të punojnë njerëz të mësuar, inxhinierë, specialistë dhe teknikë të aftë që ne duhet t'i përgatitim qysh tani nëpër shkolla. Vepra të tjera të shumta dhe të rëndësishme do të ndërtohen gjatë pesëvjeçarit. Përveç kësaj,

ne duhet të arrijmë që çdo kooperativë bujqësore të ketë jo më një agronom dhe një zooveteriner, por më shumë. Njerëz të tillë me arsim ne akoma i kemi të paktë, prandaj duhet t'i përgatitim.

Sigurisht këmbët ne do t'i shtrijmë sa kemi jorganin, por ato që thotë Partia janë të mundshme dhe reale, prandaj do të bëhen patjetër. Veçse, për t'u realizuar, duhet të mobilizohemi që të gjithë duke i kryer si duhet detyrat që na ngarkohen. Të punojmë të organizuar mirë dhe me vullnet, në mënyrë revolucionare, sepse kështu jo vetëm do t'i realizojmë, por edhe do t'i tejkalojmë planet tona.

Populli ynë është paqedashës, ai nuk e do luftën dhe nën udhëheqjen e Partisë lufton kundër saj. Por ne duhet të kuptojmë se sa më të fortë të jemi ushtarakisht, sa më vigjilentë të tregohemi, sa më shpejt ta zhvillojmë ekonominë dhe sa më tepër të rritet mirëqenia aq më të pathyeshëm bëhemi. Duke realizuar planet tona, ne bëhemi më të fortë, prandaj armiqtë që kanë ndër mend të bëjnë luftë, na e kanë frikën, por, po të na gjejnë të dobët, ata na sulmojnë. Pra, çështja e ndërtimit të socializmit është e lidhur me luftën për mbrojtjen e paqes. Të luftosh për paqen nuk do të thotë të mbyllësh sytë dhe të çarmatosesh ndaj imperialistëve, fashistëve e revizionistëve. Të hedhësh armët derisa armiku ekziston dhe përgatitet për luftë, kjo do të thotë të mbarosh me gjithçka. Por populli shqiptar, i udhëhequr nga Partia, i cili ka vuajtur shumë në të kaluarën, nuk do ta bëjë kurrë një gjë të tillë. Ai i ka sytë hapur. Marksizëm-leninizmi na ka mësuar, dhe këtë e ka vërtetuar eksperiencia jonë, se derisa ekzistojnë armiqtë

rreth nesh, ne do të mbajmë në një rën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Partia, pra, e mëson popullin edhe të punojë, edhe të vigjëlojë. Për të mbrojtur lirinë dhe pavarësinë e atdheut, si dhe fitoret e mëdha të ndërtimit të socializmit, Partia ka krijuar një ushtri të lavdishme dhe të fuqishme të përbërë nga djemtë e popullit dhe nga oficerët tanë trima, bijtë tuaj, që kryen me nder Luftën Nacionalçlirimtare dhe që Partia i përgatit pas Çlirimit në shkollat ushtarake. Kështu, ushtarët, marinarët dhe oficerët tanë tani janë në gjendje të përdorin çdo lloj arme. Nuk është më ajo ushtri e pajisur me ato armë të pakta italiane që ua kishim rrëmbyer armiqve gjatë luftës, por ushtri e pajisur me armë nga më modernet. Prandaj nuk mund të përsëritet më koha kur Italia e Musolinit, duke grumbulluar rreth vetes tradhtarët e shitur si Qazim Mulletin me shokë, u fut në Durrës dhe në Vlorë me flotën e saj. Tani askush nuk e kalon dot kufirin tonë, sepse kemi një ushtri të fortë dhe të edukuar me një frymë të lartë luftarako-revolucionare që mbron me vigjilencë kufijtë e atdheut e njëkohësisht merr pjesë aktive për ndërtimin e socializmit. Ajo, e udhëhequr nga Partia, është një garanci për jetën e lirë dhe paqësore të popullit tonë.

Republika Popullore e Shqipërisë nuk është e vetme në luftën kundër armiqve. Partia jonë e bazuar në marksizëm-leninizmin ecën përpara dhe nuk ka forcë që ta ndalë, sepse ajo ka me vete popullin e mrekullueshëm shqiptar, ka një vijë politike të drejtë që vërte-tohet çdo ditë në jetë, ka miq besnikë si popujt e Kinës së madhe e të vendeve të tjera socialiste, ka popujt e komunistët e të gjithë botës.

Shokë, motra dhe vëllezër, në qoftë se tjetrit ia do të mirën, gabimet thuaja në sy. Ai që të do të heq veshin, kurse ai që nuk të do të fërkon krahët kur të shikon se je futur në rrugë të gabuar dhe përpiqet të të fusë thellë e më thellë derisa të të shpjerë në greminë. Partia na mëson se kur dikush bën një gabim, i madh ose i vogël qoftë, thuaja hapur, në qoftë se të kupton, mirë për të dhe për popullin, por në qoftë se nuk të kupton, sigurisht keq për të dhe për popullin. Partia gjithashtu na mëson që të bëjmë përpjekje për t'i ndrequr njerëzit që gabojnë, në qoftë se ka ndonjë që nuk ndreqet në qafë pastë veten, por nuk mund të lejojmë që interesat e popullit të cenohen.

Ndokush mund të thotë: kush mund të kritikojë drejtuesit kur gabojnë. Kritikuesi më i drejtë dhe më objektiv është populli. Populli ka shumë respekt për njerëzit e Partisë, prandaj këta nuk duhet ta shpërdorjnë këtë besim, por ta dëgjojnë popullin me vëmendje. Populli është i dashur, i ndershëm dhe i zgjuar. Nganjëherë ai nuk dëshiron të ta thotë haptazi kritikën, po ta sjell në një mënyrë që ti ta kuptosh. Prandaj është detyra e çdo komunisti që t'i dëgjojë me kujdes dhe me vëmendje fjalët e popullit dhe, kur gabon, të bëjë përpjekje që të ndreqet.

Kështu duhet vepruar edhe kur një parti tjetër gabon. Ta themi fjalën tonë atje ku duhet dhe në kohën e duhur dhe Partia jonë i ka treguar trimërinë dhe vendosmërinë e saj edhe në këtë drejtim në rrugën e drejtë marksiste-leniniste, në rrugën e popullit.

Para një viti, në Bukuresht u kurdis një komplot nga ana e N. Hrushovit dhe e udhëheqësve të tjerë të

disa partive komuniste të vendeve socialiste. Partia jonë e nuhati komplotin e rrezikshëm dhe nuk u radhit në anën e tyre për përjashtimin e Kinës Popullore nga kampi socialist. Partia Komuniste e Kinës për 40 vjet me radhë udhëhoqi popullin e madh kinez në luftë për fitoren e revolucionit, për ndërtimin e socializmit në një të katërtën e botës dhe sot mbron me vendosmëri marksizëm-leninizmin. Sigurisht, autorëve të këtij komploti me N. Hrushovin në krye nuk u pëlqeu ky qëndrim, kjo drejtësi e Partisë sonë. Kjo pak punë prish, e rëndësishme është se qëndrimi i Partisë sonë është aprovuar nga të gjithë komunistët e vërtetë në botë, nga të gjithë popujt, të cilët i duan dhe i respektojnë Partinë dhe popullin tonë të vogël.

Karl Marksi i vetëm ka luftuar kundër borgjezisë ndërkombëtare që kishte arritur kulmin e fuqisë së saj. Me një grusht internacionalistësh, por me besim të madh te klasa punëtore dhe te populli, ai çau përpara. Shumë kohë kanë luftuar V. I. Lenini e J. V. Stalini kundër trockistëve e oportunistëve dhe i kanë dërrmuar. Në saje të mësimëve të tyre të pavdekshme sot në vendet socialiste njerëzit janë të lirë e ndërtojnë socializmin. Por duhet pranuar kjo e vërtetë se derisa ekziston imperializmi dhe kapitalizmi, këta kurdoherë do të përdorin agjentët e tyre, siç janë revizionistët e sotëm, për të përçarë unitetin e lëvizjes komuniste e punëtore në botë, për të dëmtuar çështjen e madhe të socializmit. Por revizionistët nuk mund të kenë jetë të gjatë në kohën e sotme. Ata dështuan në kohën e Karl Marksit, kur ai ishte pothuajse i vetëm, ata u shpartalluan me sukses nga Lenini dhe Stalini, e jo tanimë që marksizëm-

-leninizmi është bërë ideologjia triumfuese e proletariatit botëror dhe forcat e socializmit janë shumëfishuar.

Prandaj, mëma, motra dhe vëllezër të Petrelës, me besim të patundur në vijën e drejtë të Partisë t'i përvishemi punës me entuziazëm, guxim e me vendosmëri që të krijojmë sa më shumë pasuri për atdheun e popullin tonë, të prodhojmë sa më shumë që të rrojmë më mirë. Kjo është në duart tona dhe medoemos këtë do ta bëjmë, sepse gjithçka që ka thënë Partia është realizuar. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhshmen.

Organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit popullor si kurdoherë do t'i keni afër. Ato janë tuajat, prandaj çdo hall, çdo nevojë dhe kërkesë ua thoni atyre. Të jeni të sigurt se çdo ndihmë e mundshme në kuartrin e Republikës do t'u jepet nga Qeveria dhe Komiteti Qendror i Partisë, sepse çdo gjë që është në vendin tonë është për popullin. Prandaj, me të tillë besim përvishjuni punës ashtu sikurse keni bërë deri tani, e më mirë në të ardhshmen, dhe ne jemi të bindur se kooperativat e lokalitetit tuaj do të bëhen të begatshme e të lulëzuara dhe populli do të jetojë i lumtur.

Të rrojë Partia e lavdishme e Punës e Shqipërisë!

Të rrojë populli heroik shqiptar!

Të rrojë populli patriot dhe punëtor i lokalitetit të Petrelës!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TE PËRHAPIM NË FSHAT TË GJITHA TË MIRAT E KLASËS PUNËTORE

*Nga biseda me kuadrot drejtues të kooperativës  
së bashkuar të Vaqarrit «Rruga e Leninit»  
të rrethit të Tiranës*

**14 qershor 1961**

*Pasi u informua për sukseset, vështirësitë, do-  
hësitë dhe për perspektivën e kësaj kooperative shoku  
Enver Hoxha foli për kalimin e vështirësive që i dolën  
vendit tonë në vitin e kaluar e pastaj vazhdoi:*

Klasa punëtore dhe gjithë fshatarësia punonjëse  
këtë vit janë mobilizuar si kurrë ndonjëherë tjetër për  
kryerjen e të gjitha detyrave. Këtë vit përveç mobilizimi-  
mit kemi pasur në favor edhe kohën, prandaj bujqësinë  
e kemi të mbarë. Ky është një inkurajim i madh për  
fshatarësinë tonë lidhur edhe me perspektivën.

Kudo shihet një frymë e lartë patriotike për të re-  
alizuar planin e tretë pesëvjeçar, me gjithë vështirësitë  
e mëdha që ka krijuar udhëheqja sovjetike, me Hru-  
shovin në krye, qëndrim ky që përkrahet edhe nga

udhëheqësit e disa vendeve të tjera socialiste. Realizimi i detyrave që na vë përpara plani, është plotësisht i mundshëm, për arsye të punës së madhe që bëjnë Partia, pushteti, kuadrot, si edhe të mobilizimit total të klasës punëtore dhe të fshatarësisë punonjëse.

Realizimi i detyrave të këtij plani ka rëndësi të madhe. Revizionistët në disa vende thonë se Shqipëria nuk ecën dot përpara pa ne. Por ata gabohen. Shqipëria ecën dhe do të përparojë, sepse politika e drejtë e Partisë së saj mbështetet në marksizëm-leninizmin. Po të jesh në rrugë të drejtë dhe t'i qëndrosh besnik marksizëm-leninizmit nuk humbet kurrë. E tillë është epoka jonë, prandaj disa njerëz, sado fuqi që të kenë, nuk kanë ç'i bëjnë një partië dhe një populli qofshin edhe të vegjël.

Për ne rëndësi të madhe ka mbrojtja e marksizëm-leninizmit, sepse ky na jep forca të realizojmë me sukses planet tona, të ecim përpara në ndërtimin e socializmit, të përmirësojmë çdo vit e më shumë jetën e popullit jo vetëm duke ngritur më lart nivelin e tij material, por duke ngritur edhe kulturën e tij e njëkohësisht duke qenë vigjilentë për mbrojtjen e atdheut dhe të vendeve socialiste. Populli ynë e do Partinë se e ka të qartë vijën e saj të drejtë, se ajo nuk mbetet vetëm te fjalët, por ato i kthen në vepra në dobi të atdheut e të socializmit.

Revizionistët modernë për ne thonë se jemi dogmatikë dhe sektarë, sepse qëndrimet e Partisë sonë atyre nuk u pëlqejnë. Partia jonë thotë ta luftojmë imperializmin me atë amerikan në krye dhe të luftojmë revizionizmin si agjenturën e tij në lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Udhëheqësit revizionistë sovjetikë



puthen me revizionistët jugosllavë. Në komisionin e redaktimit për hartimin e deklaratës së Moskës të vitit 1960 ne përsëri luftuam që këta armiq të demaskohen.

Ndërsa ne i zbatojmë vendimet e Mbledhjes së Moskës, ka të tjerë që heshtin, sepse ndjekin një vijë që i lejon revizionistët e sotëm të vazhdojnë punën e tyre përçarëse në radhët e komunizmit ndërkombëtar dhe në vendet socialiste.

Titoja nuk shkoi kot në Afrikë dhe në Azi. Amerika si kurdoherë e shpërbleu për punën që ai zhvilloi atje. Titoja e bëri këtë punë sepse në vjeshtë do të zhvillohet në Beograd konferenca e vendeve të paangazhuara. Revizionistët jugosllavë e të tjerë, duke spekuluar në vullnetin e popujve të Afrikës e të Azisë për të qenë të lirë, të pavarur, komplotojnë që të ndihmojnë imperializmin dhe të dobësojnë influencën e madhe që kanë në botë marksizëm-leninizmi dhe vendet socialiste.

Kur na kritikojnë, si «dogmatikë» ose «kokëfortë», revizionistët duan që ne të heshtim dhe të bëjmë punën e tyre, në mënyrë që një mëngjes ata të na futin në grackë. Këto parulla këta njerëz, pra, i hedhin për të gënjyer komunistët dhe popujt, me një fjalë ata i shërbejnë imperializmit.

Por ne nuk do të mashtrohemi kurrë. Kjo situatë që është krijuar, patjetër do të sqarohet. Komunistët e BS, që janë edukuar nga Lenini dhe Stalini, që kanë luftuar për më shumë se 40 vjet me radhë për të shtypur borgjezinë, për të ngritur pushtetin sovjetik, për të ndërtuar socializmin, nuk duhet ta lënë veten të gënjehen nga ky grup renegatësh që po çon ujë në mu-llirin e imperializmit.

N. Hrushovi po ndjek një rrugë pa krye, të dëmshme për socializmin. Me veprimet e tij ai i jep kohë imperializmit të armatoset. Me fjalë imperializmit mund t'i thuash sa të duash që të mos armatoset, ai nuk dëgjon, por ndjek rrugën e tij. Dhe ja konkretisht Gjermania Perëndimore, e përkrahur nga imperialistët amerikanë, është bërë si në kohën e Hitlerit. Të gjithë gjeneralët hitlerianë sot atje janë në fuqi, të gjithë fashistët janë të lirë dhe kanë pozita me rëndësi. Gjermania Perëndimore po armatoset deri në dhëmbë. Të gjithë e dinë këtë dhe janë kundër armatimit të saj, por nuk mjafton vetëm kaq. Po të qëndrohet fort në ato parime që janë vendosur në Mbledhjen e Moskës dhe të ndiqet një politikë konsekuente për mbrojtjen e paqes, armiqtë nuk lëvizin dot si të duan. Por tani ata shohin se rrugën e kanë të hapur, duke qenë të inkurajuar nga qëndrimi oportunist i N. Hrushovit me shokë.

Pra, vija e Partisë sonë frymëzon komunistët dhe popullin tonë të ecin përpara me guxim dhe besim të patundur, dhe jo vetëm njerëzit tanë, por edhe popujt e komunistët e vërtetë në botë. Në këtë rrugë marksiste-leniniste lufton edhe Partia Komuniste e Kinës dhe partitë e tjera komuniste e punëtore dhe s'ka si të jetë ndryshe. Pra marksizëm-leninizmi do të fitojë.

V. I. Lenini gjatë gjithë jetës së tij ka luftuar me vendosmëri dhe rreptësi të madhe kundër rrymave të ndryshme antimarksiste, kundër revizionistëve, oportunistëve, trockistëve etj., të cilët ai i ka cilësuar si armiqtë më të tërbuar të komunizmit. Në këtë rrugë ka ecur edhe J. V. Stalini. E tani na del Hrushovi me

shokë dhe thonë se mësimet e Leninit na qenkan vjetruar.

Titoja është armik i marksizëm-leninizmit sa edhe Kautski, të cilin V. I. Lenini e bëri paçavure derisa e shkatërroi. Kautski, në kohën e tij ishte vetëm një person që udhëhiqte një grup oportunistësh kundër marksistëve, kurse Titoja, të cilin e mbron N. Hrushovi, ka në dorë pushtetin, është revizionizëm në fuqi, prandaj ne luftojmë kundër revizionizmit jugosllav, ndërsa Hrushovi na këshillon të heshtim, se kështu e dashka politika.

Rruga që kanë zënë revizionistët, do t'i vërë disa në vështirësi jashtëzakonisht të mëdha, sepse tezat e tyre të rreme nuk do të vërtetohen kurrë.

Udhëheqësit bullgarë thonë se kanë një vijë të drejtë politike. Por në tregun e tyre nuk gjen shpesh as domate, megjithëse Bullgaria është një vend që prodhon e eksporton shumë domate. Në Çekosllovakia që është një vend me industri të zhvilluar, me bujqësi të mekanizuar, një vend që bën tregti të madhe, shpeshherë nuk gjen dot një kokërr limon as për të sëmuret. Dhe këtë na e thonë vetë, të gjithë ata që kanë ardhur nga këto vende te ne. Pra, ne kemi arritur suksese të mëdha, sigurisht duke kapërcyer vështirësi të shumta. Vështirësi do të kemi ndofta edhe më të mëdha, por ne kemi besim se vazhdimisht do të ecim përpara. Situatat e krijuara nuk janë aq të lehta, prandaj ato duhet t'i kuptojmë mirë, t'ia bëjmë të qarta popullit, në mënyrë që t'i përballojmë me sukses ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht.

Unë gëzohem që punën e keni filluar mbarë dhe

keni arritur suksese, por këto që keni arritur të mos ju dehin, prandaj merrni masa të shfrytëzoni si duhet ditët pa shi, shikoni me kujdes interesin e përgjithshëm të popullit, por edhe interesin e kooperativistëve. Të dyja këto mos i shkëputni nga njëra-tjetra, i kini parasysh dhe mobilizohuni më mirë se vitin e kaluar që të korrni suksese edhe më të mëdha.

Ju jeni afër Tiranës, afër kryeqytetit, prandaj ta bëni shembull kooperativën tuaj. Ju jeni shumë të favorizuar për të marrë ndihmë nga Tirana, sidomos në zhvillimin e jetës shoqërore dhe kulturore, në edukimin e njerëzve, në përmirësimin e mënyrës së jetesës. Të gjitha të mirat që ka klasa punëtore i merrni dhe i përhapni në fshat, në mënyrë që ta bëni fshatin të mbushur nga të katër anët me kopshte të bukura, plot pemë e ullishta, me klub, kinema, terren sportiv etj., ku të rinjtë dhe kooperativistët të luajnë, të dëfrenë e të çlodhen në mënyrë të kulturuar.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË LUFTOJMË E TË PUNOJMË DUKE VËNË KURDOHIERË IDEALIN E PARTISË MBI GJITHIÇKA, ATDIHEUN MBI ÇDO GJË**

*Nga biseda me kuadrot drejtues të kooperativës  
së bashkuar Bërzhitë-Dobresh të rrethit të Tiranës*

**14 qershor 1961**

*Në fillim, pasi u informua mbi gjendjen shumë të mirë të kulturave bujqësore të këtij viti, për numrin e ullinjve që ka kooperativa dhe për shërbimet që u bëhen atyre, për gjendjen e pemëve frutore, të vreshtave dhe të pjergullave etj., dhe pasi i vuri në dijeni të pranishmit mbi disa probleme aktuale ekonomike dhe politike të vendit, shoku Enver Hoxha tha:*

Punët tona shkojnë mirë. Vjet ne patëm vështirësi për shkak të thatësirës, por Partia dhe Qeveria morën masa dhe populli nuk vuajti asnjë ditë për bukë. Në sektorët e tjerë planet u realizuan me sukses, kështu që furnizimi i popullit me mallrat e nevojshme u zhvillua normalisht.

Këtë vit ne do të jemi edhe më mirë. Bujqësinë kudo e kemi të mbarë, grurë e misër do të prodhohet

më shumë, po ashtu pambuk e panxhar, dhe bagëtitë do t'i ushqejmë më mirë. Me ritme të shpejta po zhvillohet edhe industria.

Ky është viti i parë i planit të tretë pesëvjeçar dhe ne duhet të bëjmë një hap të madh përpara, i cili do të influencojë shumë edhe në realizimin e planeve të viteve të ardhshme. Partia dhe Qeveria kanë marrë të gjitha masat që çdo gjë e caktuar në këtë pesëvjeçar të realizohet me punën tonë, duke u mbështetur kryesisht në forcat tona.

Kudo në Shqipëri do të ngrihen fabrika e uzina të reja, një uzinë për pasurimin e kromit, një tjetër kombinat i madh tekstili, fabrikë çimentoje në Krujë dhe në Elbasan e shumë të tjera. Kështu prodhimet do të shtohen dhe do të bëhen më të lira për popullin tonë. Ky është edhe qëllimi që i ndërtojmë këto vepra.

Edhe në bujqësi do të kemi suksese të mëdha. Brenda këtyre 2-3 vjetëve të fundit kur në shumicën e fshatrave u krye kolektivizimi, po shohim ndryshime të mëdha, kooperativat bujqësore po forcohen dhe po pasurohen, po hapen kudo toka të reja, po shtohen frutat, agrumet, ullinjtë, po bëhen pyllëzime të reja etj.

Por gjatë pesëvjeçarit të tretë ne do të kemi përparime edhe më të mëdha. Do të kemi më shumë traktorë, do të shtohen sipërfaqet e ujitshme, do të bëhen punime të mëdha bonifikimi, do të ndërtohen rezervuarë të rinj, do të thahen moçale etj., dhe mbi të gjitha do të ndërtohen dy uzina të mëdha për prodhimin në vend të plehrave kimike, azotike dhe fosfatike që do të plotësojnë shumë më mirë nevojat tona. Kështu në pesëvjeçarin e ardhshëm ne do të kemi plehra në sasi

të mjaftueshme, jo vetëm për të plehëruar tokat e drithërave dhe bimëve industriale, po edhe për kulturat e tjera dhe tokat tona do të bëhen më pjellore.

Me ato që do të ndërtojmë në pesëvjeçarin e tretë do të bëjmë që në pesëvjeçarin e katërt të sigurojmë prodhime më të bollshme, shtetit do t'i sigurohen të ardhura më të mëdha dhe do të jetë në gjendje të plotësojë më mirë nevojat e popullit, në çdo drejtim. Jo vetëm që do të prodhohen më shumë mallra në vend, por me të ardhurat më të mëdha që do të sigurojmë, do të jemi në gjendje të sjellim nga jashtë ato sende të nevojshme për popullin që akoma nuk i prodhojmë vetë.

Ne kemi zbuluar vendburime të pasura hekur-nikeli dhe mineralesh të tjera. Atje po ngremë dhe do të ngremë miniera për t'i nxjerrë këto pasuri nga toka, në të ardhshmen jo të largët do të ngremë uzina e kombinatë për përpunimin e tyre dhe me to do të rritim eksportin. Me të ardhurat që do të sigurojmë do të blejmë gjithçka që na nevojitet, bile edhe traktorë të vegjël e makina të tjera bujqësore për toka të ngushta si këto tuajat. Tani nuk i kemi të gjitha, por sa më shumë të prodhojmë aq më shumë do të kemi. Ju në fshat, kur të keni ujë për ujitje, pleh edhe vegla të përparuara bujqësore, sigurisht do të prodhoni më shumë.

Partia tregon një kujdes të madh që njerëzit të mësojnë, me qëllim që të punojnë më mirë e të prodhojnë më shumë, për lumturinë dhe begatinë e popullit. Prandaj ajo hapi shkolla kudo, që të shkojnë djemtë dhe vajzat e popullit e të fitojnë dituri dhe këtë ta vënë në shërbim të socializmit.

Perspektiva e ndërtimit tonë socialist është e shkël-

qyer. Janë ndërtuar e do të ndërtohen vepra të mëdha dhe këto do t'i bëjnë djemtë dhe vajzat e popullit e në radhë të parë të punëtorëve dhe të fshatarëve, ata do të jenë si kurdoherë në krye të këtyre punëve. Bëmë sa bëmë ne, por jeta është jetë dhe njerëzit plaken. Por Partia nuk plaket dhe nuk vdes kurrë, ajo rron dhe përtërihet vazhdimisht sa dhe populli vetë. Ja, sot jemi ne, nesër vijnë të tjerët, të rinjtë që i ka mësuar dhe i ka edukuar Partia. Shumë nga këta hyjnë në Parti, kështu që ajo mbetet kurdoherë e re. I riu, pra, ka forca, energji, vrull, kurse i moshuari, megjithëse ka eksperiencën, vjen koha që s'punon dot. Ky është ligj i natyrës.

Partia ushqehet vazhdimisht me forca të reja, me zotësinë e me diturinë e të gjithë anëtarëve të saj, që bëjnë gjithçka për të mirën e popullit. Prandaj të rinjtë duhet të ndjekin shkollat, të fitojnë dituri, të përvetësojnë teknikën, e cila vazhdimisht përparon, lehtëson shumë punën e njeriut dhe shton rendimentin. Ju e dini se ç'kemi hequr ne, sa shumë forca materiale e sa mjete financiare kemi shpenzuar më parë për hapjen e një tuneli, sepse aq ishin dituria dhe mundësia jonë. Tani që shkenca dhe teknika kanë ecur përpara, një tunel, për hapjen e të cilit më parë duhej shumë kohë, tani mund të hapet në një kohë të shkurtër. Këto mundësi do të vijnë edhe te ne.

Në të ardhshmen do të bëhen shpikje të reja. Partia do t'ua mësojë ato të rinjve dhe ata do t'i vënë në shërbim të popullit. Kjo lumturi nuk do të vijë vetvetiu, por me luftë dhe me punë. Para luftës ne ishim të varfër, të pamësuar dhe të shtypur. Po, kur erdhi



koha, rrëmbyem pushkën, dolëm në mal dhe luftuam, fituam dhe çliruam vendin, të shkatërruar dhe të varfëruar akoma më shumë. Këtë populli ynë s'e harron, s'duhet ta harrojnë këtë as të rinjtë, por edhe sikur ndonjëri ta harrojë, do të ketë me mijëra njerëz që do t'ia kujtojnë dhe do t'i thonë se në të kaluarën fshatarit frytet e punës ia merrnin beu, agai, taksidari, fajdexhiu etj.

Punët na shkojnë mirë se Partia ecën në rrugë të drejtë. Prandaj ta forcojmë dashurinë për Partinë dhe në mes njëri-tjetrit. Të luftojmë e të punojmë duke vënë kurdoherë idealin e Partisë mbi gjithçka, atdheun mbi çdo gjë. Partinë dhe atdheun t'i ruajmë si sytë e ballit. Të gjithë, të mëdhenj e të vegjël, të punojmë pa u lodhur për ta bërë atdheun tonë sa më të fortë e të paprekshëm dhe jetën e popullit sa më të lumtur.

Në punë dhe në jetë ka edhe mosmarrëveshje, të cilat, natyrisht, nuk janë zhdukur, prandaj duhen zgjidhur me kujdes, nuk duhet të lihen të zmadhohen sa të arrijnë të dëmtojnë interesat e mëdha të Partisë, të popullit dhe të atdheut. Kur vjen puna që këto çështje të vogla rriten sa të dëmtojnë interesat e Partisë, të popullit dhe të atdheut, atëherë u duhet thënë ndal. Kjo nuk do të thotë që, kur bën një padrejtësi kryetari i kooperativës bujqësore, ti të mbyllësh gojën. Jo! Po të veprosh kështu përsëri ke dëmtuar interesat e popullit. Përkundrazi duhet vënë në dukje gabimi, të diskutohet e të kritikohet se nga një metodë pune e tillë kemi dobi, përkundrazi, kur e keqja mbulohet, atëherë puna kalbet.

Kur i futesh një pune, nuk do të thotë se këtë e

kryen pa gabime. Vetëm një njeri i pandërgjegjshëm mund të thotë se çdo gjë e ka bërë mirë. Kur një komunist nuk e kryen mirë një punë, Partia e kritikon. Anëtari i Partisë nuk duhet të zemërohet nga kjo vërejtje, por duhet të mendohet, të pyesë ndërgjegjen e tij: «Pse ma bënë këtë vërejtje shoku, apo organizata e Partisë, më duan të mirën apo të keqen?». Në qoftë se vërejtjen nuk e ka kuptuar, të bisedojë me atë që ia ka bërë dhe nëse është i bindur për kritikën, të kërkojë të falur për gabimin që ka bërë dhe të mos e përsëritë më. Këto gjëra ndodhin në jetë, por Partia ka forca që t'i sheshojë.

Komunistët duhet të vrasin mendjen më shumë për gabimet që bëjnë, se kanë përgjegjësi më të madhe nga ata që janë pa parti. Ata duhet të jenë të zgjuar e më të mësuar dhe kur nuk janë të tillë duhet të mësojnë nga ata që kanë shkollë eksperiencën e punës dhe të jetës.

Anëtari i Partisë duhet të jetë më i sjellshmi nga të gjithë. Edhe ai mund të ketë raste që «t'i vijë shpirti në majë të hundës», por nuk duhet ta bëjë veten përpara tjetrit edhe sikur të jetë i bindur se fajin e ka tjetri. Në këtë rast ai duhet të bëjë përpjekje që ta ndreqë. Ai mund të ketë të drejtë të nxehet për fajin që ka bërë tjetri, por duhet të jetë gjakftohtë dhe të luftojë që ta bindë fajtorin. Dhe kur fajtori e kupton gabimin, atëherë ai është i qetë.

Anëtari i Partisë duhet të jetë i durueshëm, gjakftohtë, i dashur me njerëzit. Edhe të të kritikojë kur ke bërë gabim, por edhe të të marrë nga dora, të të përgëzojë, të të përqafojë kur ke bërë një punë të mirë. Po të silltë kështu anëtari i Partisë, atëherë ai

pa parti do të thotë ky është komunist i mirë, që ta thotë në sy edhe gabimin edhe kritikën dhe, kur punon mirë, të ka mbi krye. Ky është njeri që çështjet i zgjidh në interes të popullit e që i dëgjon hallet e tij.

Anëtari i Partisë duhet të jetë më i ndershmi nga të gjithë e të mos mendojë se është në Parti e mund të bëjë ç'të dojë, të bëjë edhe matrapazllëqe e vjedhje. Njerëzve të tillë t'u vënë drunë jo vetëm Partia, por edhe populli. Populli kërkon që anëtarët e Partisë të jenë njerëzit më të drejtë dhe më të ndershëm se i ka në udhëheqje. Prandaj, kur gabon një anëtar partie, populli të mos ketë frikë, por t'ia thotë në sy gabimin që ka bërë. Por mund të ndodhë që një anëtar partie të hakmerret për një kritikë që i ka bërë një punonjës i thjeshtë pa parti, po ai duhet të ketë besim se një komunisti të tillë do t'i dalë boja patjetër, se ai mund të gënjejë për një farë kohe organizatën-bazë, mund të gënjejë edhe komitetin e Partisë, po i godituri do t'i drejtohet edhe Komitetit Qendror të Partisë, i cili do të dërgojë instruktorin e vet që ta verifikojë çështjen, do të pyesë njerëzit si qëndron puna dhe e drejta do të dalë në shesh.

Çështja e popullit është shumë e madhe. Po të mos punojnë komunistët kështu si thashë, populli dëmtohet, kështu na mësojnë Lenini dhe Stalini. Ne kemi një popull shumë të mirë, xhevahir, për çdo gjë që i thotë Partia ai është gati ta zbatojë. Atëherë ne, anëtarët e Partisë, duhet të jemi dhjetë herë më të gatshëm. Pse është populli i tillë, Partia ka suksese të mëdha, ajo kurdoherë fiton, kapërcen vështirësitë e panumërta dhe ecën përpara kurdoherë në rrugë të drejtë. Por ka edhe anëtarë partie që nuk sillen mirë. Këta janë 1-3-5, kurse

Partia është me dhjetëra mijë dhe ata që bëjnë gabime ajo i ndreq. Rëndësi ka si qëndron shumica.

Në fund kisha dhe diçka. Të ndërtoni për kooperativën bujqësore një furrë kolektive, ku të piqet buka për nevojat e të gjithë anëtarëve, sepse një punë e tillë ka shumë leverdi. Së pari, kursehen sasi të konsiderueshme drithi në favor të kooperativistëve dhe të shtetit, së dyti, ekonomizohen drutë dhe si pasojë pakësohen prerjet e tyre në pyje, së treti, lehtësohet gruaja nga një punë shumë e rëndë në shtëpi dhe i jepet mundësi asaj të bëjë më shumë ditë-punë në kooperativë, gjë që sjell si pasojë forcimin e kooperativës, shtimin e prodhimit dhe të të ardhurave të anëtarëve.

Unë ju uroj suksese të mëtjshme në punë juve, vëllezërve dhe motrave të kooperativës së Dobreshit dhe Bërzhitës dhe ju këshilloj që si organizata e Partisë ashtu edhe kryesia e kooperativës bujqësore të mbështeteni plotësisht te asambleja e kooperativës, në mënyrë që të gjithë kooperativistët të jenë të bindur se ajo që vendoset në asamble është e drejtë, prandaj duhet zbatuar. Po mori një vendim asambleja, kryesia ka të drejtë ta zbatojë atë pavarësisht se ndonjë nuk do.

Ju falënderoj shumë për pritjen tuaj të përzemërt. I përshëndetni nga unë të gjithë kooperativistët. Përpiquni që sa të korrni grurin të mbillni misrin, t'i bëni shërbimet kulturore, të shtoni ullinjtë, vreshtat dhe frutat e tjera që ta bëni kooperativën tuaj një kopësht me të vërtetë të bukur!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## KËTO DITË TË LUMTURA POPULLI YNË : I KA ENDËRRUAR ME SHIEKUJ

*Fjala në mitingun e organizuar me popullin  
e lokalitetit të Zall-Herrit të rrethit të Tiranës*

15 qershor 1961

Të dashur shokë dhe shoqe të lokalitetit të Zall-Herrit,

Jam shumë i lumtur dhe i gëzuar që kam ardhur sot midis jush t'ju sjell përshëndetjet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Qeverisë e t'ju uroj me gjithë zemër jetë të lumtur e të gëzuar të gjithë juve që merrni pjesë në këtë miting, familjeve, shokëve e shoqeve tuaja!

Shokë kooperativistë, ditë të lumtura kanë ardhur sot për popullin shqiptar. Këto ditë të lumtura ai i ka ëndërruar me shekuj, ai ka luftuar në shekuj për t'i arritur, por nuk ka mundur dot, sepse armiqtë e njerëzimit dhe të popullit tonë ishin të fortë në ato kohë, kurse populli nuk i kishte organizuar forcat e tij për t'i përmbysur ata, pasi kapitalistët, bejlerët dhe agallarët, bashkë me agjentët e tyre jo vetëm kishin push-

tetin dhe armët në dorë, por përdornin edhe influencën dhe mjetet e tyre për t'i përçarë forcat e popullit, për t'i vënë ato në luftë kundër njëra-tjetrës dhe për të sunduar vetë.

Këtë taktikë, «përça e sundo», bejlerët dhe agallarët e vendit tonë e kanë përdorur gjatë gjithë kohës së sundimit të tyre; ata gënjenin një pjesë të popullit, kryetarëve u jepnin para dhe i vinin në luftë me njëri-tjetrin dhe në këtë mënyrë popullin e mbanin nën zgjedhë. Këta armiq të popullit, kur e shikonin punën ngushtë, vendosnin diktaturën e egër mbi popullin. Kështu erdhi në fuqi Ahmet Zogolli, i cili me politikën e tij të poshtër antipopullore mundi ta mbante të përçarë popullin dhe të qeveriste vendin me hekur e me zjarr. Kur idetë përparimtare të komunizmit filluan të përhapen edhe në vendin tonë, në klasën punëtore dhe në fshatarësinë shqiptare, atëherë ai dhe bajraktarët e tij, duke e ndierë veten të pafuqishëm, u lidhën me Italinë fashiste. Ata bënë një marrëveshje me Italinë dhe i dhanë asaj të drejtën që të sillte në Shqipëri forca italiane për të shtypur çdo revoltë të popullit shqiptar, në rast se ngrihej kundër regjimit të urryer të Ahmet Zogut. Kjo ishte tradhtia më e poshtër ndaj popullit.

Në fakt, për shkak të lëvizjes së madhe popullore që udhëhiqnin në ilegalitet komunistët, situatat u bënë të vështira për regjimin e Zogut; atëherë Ahmet Zogu dhe bajraktarët e tij i hapën dyert Italisë dhe në Shqipëri u vendos fashizmi italian, armiku më i egër i popullit shqiptar, që kishte synuar prej shumë kohësh t'i shtinte në dorë tokat e bukura të stërgjyshëve tanë dhe t'i kolonizonte këto me italianë.

Mirëpo planet e tyre nuk u realizuan. Fashistët italianë erdhën në Shqipëri si pushtues dhe Ahmet Zogolli, mbreti kriminel, u largua si tradhtar dhe fshehurazi nga populli, sepse nuk ishte njeriu i popullit por xhelati i tij. Ai mori gjithë arin e shtetit që ia kishte grabitur dhe zhvatur popullit shqiptar dhe për 10-15 vjet e hëngri me njerëzit e tij dhe e shkoi jetën me kontrabanda e matrapazllëqe.

Më në fund Zogolli vdiq dhe as që i shkon në mendje njeriut për të, vetëm na ka mbetur në kujtesë si një sundimtar i egër dhe tradhtar nga më të këqijtë që i ka bërë dëme të mëdha popullit, që grabiti Shqipërinë dhe e la vendin në padituri, në varfëri dhe në prapambetje të madhe. Baltën e mëmëdheut ai e mori në thundrat e këpucëve.

Shqipëria mbeti atje ku ishte, por e pushtuar nga fashistët italianë; populli i përbuzur dhe i braktisur, që vuante nën zgjedhën e dyfishtë, edhe të pushtuesve edhe të klásave shfrytëzuese vendëse. Ai e ndiente mbi shpatulla këtë zgjedhë dhe si kurdoherë kërkonte rrugëshpëtimi që të fitonte lirinë, por nuk mund ta gjente dot vetë rrugën e vërtetë. Duhej një forcë e madhe, e dalë nga gjiri i popullit, për ta drejtuar dhe për ta frymëzuar popullin tonë në luftën për liri, për të përcaktuar mirë qëllimet dhe rrugën e fitores, për ta organizuar dhe për ta hedhur atë në luftë kundër okupatorëve, për t'u rrëmbyer kapitalistëve, bejlerëve dhe agallarëve pasuritë që i kishin vënë duke thithur brez pas brezi djersën dhe gjakun e popullit fukara. Pra, kur atdheu ishte në rrezik, nga gjiri i popullit dolën njerëzit më të mirë dhe më besnikë që nuk u

dhimbsej as jeta për fatet e popullit, ata formuan Partinë Komuniste të Shqipërisë dhe dolën malit për liri.

Vëllezër dhe motra, e vetmja rrugë për të shpëtuar atdheun dhe popullin ishte lufta kundër okupatorëve dhe të gjithë atyre që kishin tradhtuar çështjen e madhe të popullit. Ju i mbani mend kohët e vështira, por heroike të Luftës Nacionalçlirimtare. Nuk kishte forcë që ta mposhte vullnetin dhe dëshirën e popullit për liri; as intrigat e zogistëve e të tradhtarëve, as armët e italianëve, të gjermanëve e të ballistëve nuk e frikësuan dhe nuk e gënjyen dot këtë popull. Ai u ngrit i tëri në këmbë nën udhëheqjen e Partisë dhe i përplau armiqtë si një stuhi e pamëshirshme.

Ju e keni parë, të dashura nëna, motra dhe vëllezër, se vija e Partisë sonë ka qenë kurdoherë një vijë e drejtë. Partia i bëri thirrje popullit që të bashkohej pa dallim feje, krahine dhe ideje në luftën kundër armikut. Kjo ishte detyra kryesore në atë kohë. Dhe kjo ishte një politikë e drejtë e Partisë, të cilën ajo e zbatoi me vendosmëri.

Ju keni dëgjuar për Konferencën e Pezës që ka një rëndësi të madhe historike. Atje Partia ftoi edhe përfaqësues të nacionalistëve, në mes të të cilëve edhe Bazin e Canës. Në këtë mbledhje Partia shtroi platformën e vet politike, të cilën e pranoi me fjalë edhe Abaz Kupi. Po ai ishte një njeri tepër dinak dhe i poshtër. Në Pezë, të gjithë ne, vendosëm të luftohej okupatori dhe Bazi ishte dakord me këtë. Atëherë i dhamë dorën shoqi-shoqit dhe u betuam që të zbatohet kjo politikë e drejtë e Partisë.



Kur e thirrëm Abaz Kupin, ne e dinim se ai ishte zogist, por politika e Partisë synonte të bashkonte gjithë popullin në luftë kundër të huajve, pastaj si të çlirohej Shqipëria, çështjen e llojit të qeverimit do ta zgjidhte vetë populli siç e zgjidhi. Bazi me fjalë e pranoi politikën e Partisë në Pezë, por nga ana tjetër dredhonte.

Partia më ngarkoi mua dy-tri herë të takohesha me të. Unë u përpoqa ta bind duke i thënë se e vetmja rrugë e drejtë për shpëtimin e popullit dhe të atdheut tonë është lufta e pamëshirshme kundër okupatorëve, se për këtë qëllim duhet të ngremë popullin në këmbë, t'i themi atij përse duhet të luftojë dhe çfarë do të bëhet nesër në Shqipëri, ta ngremë fshatarësinë në luftë që toka t'u merret bejlerëve dhe agallarëve dhe t'i jepet atij që e punon. Por Bazi i Canës ishte i ndër-gjegjshëm në tradhtinë e tij. Kur isha një herë në Shëngjergj dëgjova se si nga dritarja e një shtëpie, ku qëndronte i rrethuar prej disa «trimave» të tij, bërtiste: «Vetëm ne zogistët do t'ua japim tokat fshatarëve». Por kjo ishte vetëm një gënjeshtër. A ishte e mundur që Selman Petrela t'ju thoshte juve: «O fshatarë, i merrni këta ullinj të e mi se nuk i dua më?». Këtë ai nuk do ta bënte kurrë, sepse ishte një tregtar, një fajdexhi dhe si i tillë ishte pasuruar nga gjaku dhe djersa juaj. Ai ishte njeri i Zogut, hiqej si i zoti dhe i zgjuar, por pasurohej nën bajonetat e Zogut dhe të Abaz Kupit, përkrahej nga Xhemal Herri, tjetër gjakpirës ky, që ju grabiste ullinj të dhe pasuritë tuaja.

Abaz Kupi, sigurisht, s'mund të qëndronte me ne. Ai, duke u mbështetur fuqimisht nga anglezët, u për-

poq të vinte përballë Frontit Nacionalçlirimtar të ashtuquajturën partinë e tij zogiste të «Legalitetit». Por «Legaliteti» shkriu si vesa e mëngjesit, sepse që të rrojë një parti dhe të bëhet një forcë e madhe, duhet të ketë rrënjë në popull. Ajo parti, që, pasi u formua, u zmadhua dhe u bë e fortë si çeliku, u armatos për vete, armatosi edhe popullin të cilin e udhëhoqi në luftën kundër fashistëve italianë e gjermanë, shpartalloi ballistët e zogistët, ishte Partia Komuniste e Shqipërisë, e cila lëshoi rrënjë të thella në zemrën e popullit dhe u lidh me të si mishi me thoin, sepse luftonte për interesat e popullit. Një «parti» si ajo e Abaz Kupit, që për fat të keq ai e krijoi në këtë fshat, nuk kishte asgjë të përbashkët me popullin. Abaz Kupi dhe Xhemal Herri mendonin se këtu në fshatin tuaj kishin një bazë të fortë të tyre, se ju ishit njerëzit e tyre. Po kjo nuk është aspak e vërtetë, Partia nuk e ka besuar kurrë këtë. Populli i fshatit tuaj nuk kishte asgjë të përbashkët me Bazin e Canës. Ju nuk e ndihmuat atë, prandaj ai u detyrua të strukej shpellave dhe pastaj t'ua mbahte këmbëve.

Abaz Kupi tani jeton larg Shqipërisë me disa lëmosha që i japin të huajt. Ai e di mirë ç'është Partia jonë dhe ç'forcë ka populli ynë nën udhëheqjen e saj. Ka njerëz që kanë ikur jashtë si Abaz Kupi dhe rrojnë akoma me ëndrra. Ata një ditë iu drejtuan Bazit dhe i thanë që të ktheheshin në Shqipëri për të marrë fuqinë në dorë. Bazi i Canës që na njeh mirë ne, i këshilloi miqtë e tij të mos merren me këto punë, «unë i njoh sa të vendosur janë komunistët dhe partizanët, prandaj rrini të hamë rehat këtë kafshatë buke që na

japin» u tha ai. Këto i ka thënë pikërisht kështu Abaz Kupi.

Populli i këtij lokaliteti ka qenë pjesë e pandarë e popullit tonë heroik, por në kushte shumë më të vështira se krahinat e tjera të Shqipërisë, sepse këtu te ju zhvillimi shoqëror ka qenë shumë prapa. Ju nuk ishit më pak të zgjuar se populli i krahinave të tjera të vendit tonë. Populli kudo është i njëjlojtë, por midis krahinave ka edhe ndryshime nga pikëpamja e zhvillimit.

Me thënë të drejtën, këtu te ju bejlerët dhe agallarët mundën ta gënjenin për një farë kohe popullin, por kjo nuk u ndezi gjatë, sepse, po t'u kishte ndezur, nuk do të ishte kjo gjendje dhe Luftës Nacionalçlirimtare do t'i kishin dalë vështirësi të mëdha. Po ju nuk i nxorët ndonjë vështirësi luftës së popullit, sepse shpejt e kuptuat se kush ishte Abaz Kupi me shokë. Juve, si i gjithë populli ynë, ju digjte zemra për Shqipërinë dhe donit që tokat dhe ullinjtë të ishin tuajat dhe jo të beut e të agait. Prandaj Partia ka besim të madh te ju. Edhe pas Çlirimit armiqtë e betuar të Partisë ju thoshin: «Kini mendjen se ju keni qenë me Zogun dhe me Abaz Kupin, prandaj Partia do t'ju shohë me tjetër sy». Po këto ishin parulla armiqësore që ata i lëshonin me qëllim që t'ju ndanin ju nga Partia. Partia i do njerëzit e mirë njëjloj. Ashtu si ka organizatë partie në Tiranë, në Korçë, në Vlorë, apo në fshatrat e Elbasanit ose të Durrësit, ashtu ka edhe këtu te ju. Partia nuk është diçka e shkëputur, ajo ka dalë nga gjiri i popullit, nga gjiri juaj, dhe kudo punon e lufton njëjloj për të mirën e tij, që të përmirësohet jeta e tij, e cila në fakt është përmirësuar dhe do të përmirësohet vazhdimisht, çdo vit.

Sikur unë t'ju numëroja këtu të gjitha veprat që janë ndërtuar në Shqipëri gjatë këtyre 17 vjetëve pas Çlirimit, do të zgjatesha shumë. Por le të marrim vetëm Tiranën. Ju të moshuarit e mbani mend Tiranën e vjetër që ishte si një fshat, me rrugët e ngushta e plot baltë, me shtëpi të vogla të ndërtuara me qerpiç. E çfarë ndërtoi atëherë Xhemal Herri? Sa vjet qëndruan klasat shfrytëzuese në fuqi dhe ç'bënë? Asgjë për popullin, çdo gjë për vete. Megjithatë, ç'janë ato që ndërtuan ata për vete përpara uzinave e fabrikave madhështore, pallateve shumëkatëshe dhe rrugëve të gjera e të asfaltuara, përpara kinemave, teatrove, shesheve e lulishteve që janë ngritur pas Çlirimit në Tiranën e popullit? Ato që regjimet e kaluara nuk i ndërtuan dot për qindra vjet, populli, nën udhëheqjen e Partisë, i ndërtoi vetëm brenda 16-17 vjetëve.

Këtë populli ynë e ka kuptuar fare mirë. Në saje të punës vetëmohuese të popullit, nën udhëheqjen e Partisë, po zhvillohet dita-ditës më shumë industria jonë socialiste. Këtë pesëvjeçar do të ngrihen shumë fabrika e kombinatë të reja më të mëdha e më moderne se ato që janë ndërtuar deri tani. Në Berat do të ndërtohet një kombinat tekstili më i madh se ai i Tiranës, që populli të ketë për të veshur rroba më të mira dhe më të lira. Një fabrikë çimentoje do të ngrihet gjithashtu këtu afër jush, në Krujë, dhe një tjetër në Elbasan.

Kudo në vendin tonë po ndërtohet, në qytete dhe në fshatra bëhen shtëpi të reja, shtëpi e vatra kulture, stalla, fabrika dhe uzina. Partia mendon që të tilla të ndërtohen sa më shumë dhe sa më shpejt, se kështu do

të përmirësohet gjendja ekonomike e popullit. Mirëpo të gjitha këto ndërtime duan lëndë druri, çimento, tulla, tjegulla etj. Ne kemi fabrika tullash e tjegullash, por do të ngrihen edhe të tjera. Do të ngrihen dy uzina për prodhimin e plehrave kimike për t'i ardhur në ndihmë fshatarësisë sonë, gjithashtu edhe një uzinë për përpunimin e mineralit të hekurit dhe të nikelit.

Në sektorin e bujqësisë, gjithashtu, janë bërë ndryshime të mëdha. Janë tharë kënetat, moçale, janë bërë e po bëhen rezervuarë të mëdhenj për ujitje, kanalizime, në fusha është bërë kolektivizimi që është një fitore shumë e madhe e ndërtimit të socializmit në vendin tonë. Shumë nga fshatarët tanë në fillim ndrydheshin, nuk e kuptonin mirë rëndësinë e kooperativave bujqësore. Por këtë e kishte të qartë Partia se kështu na mësonin Lenini dhe Stalini. Kini kujdes, u thoshin shokëve komunistë, përpiquni t'i bindni fshatarët se ata më së fundi do t'i kuptojnë të mirat që u sjell kooperativa. Kështu u veprua edhe te ne dhe kolektivizimi pothuajse ka përfunduar dhe tani po të punohet si duhet në fshat ka për të ardhur patjetër begatia.

Të marrim fshatin tuaj. Brenda një kohe të shkurtër ju hapët toka të reja, por, nga sa shohim, keni shumë të tjera për të hapur. Partia do t'ju ndihmojë në këtë drejtim që të hapni akoma më shumë që dhe këto vende rreth jush të bëhen medoemos kopshte të bukura dhe do të bëhen.

Shteti do t'ju ndihmojë me kredi për zhvillimin e frutikulturës. Veçanërisht do të ndihmohen me kredi me afat të gjatë kooperativat e zonave malore, si kooperativat e lokalitetit tuaj, në mënyrë që të gjitha

kodrat të mbillen me pemë frutore, me qëllim që të ardhurat të rriten e të përmirësohet mirëqenia si në kooperativat e zonës fushore. Ndiurma për ju do të jetë më e madhe se e kooperativave të Myzeqesë e të Vlorës, pasi këto i kanë fushat më pjellore e me sipërfaqe të mëdha. Megjithatë edhe te ju, po t'i bëni shërbimet e duhura tokës, kjo do të bëhet pjellore.

Kryesorja është që të mobilizoheni e të punoni të gjithë, pa ndiurma nuk do t'ju mungojë, ashtu si nuk ju ka munguar deri tani. Ju keni arritur disa suksese, por nuk duhet të kënaqeni me kaq, të punoni më shumë për të shtuar prodhimet. Duhet të zhvilloni sidomos ullinjtë që janë një pasuri e madhe jo vetëm për ju por për gjithë popullin tonë; t'ju bëni shërbimet e duhura që të prodhojnë më tepër dhe të punoni me këmbëngulje për shtimin e tyre, për t'i mbjellë të gjitha këto kodra me ullinj, me vreshta dhe me pemë të tjera frutore. Prandaj mos u mjaftoni vetëm me atë pjesë që keni hapur deri tani, por t'i hapni të gjitha kodrat përreth dhe t'i mbillni.

Prandaj, shokë dhe vëllezër, është në interesin tuaj dhe të gjithë atdheut, për të ardhshmen e fëmijëve tuaj, t'i përvisheni punës, tokave që keni hapur dhe që i keni bërë ara, t'u shërbeni si duhet që të merrni jo vetëm një po edhe dy prodhime në vit. Ato toka, që janë të veshura me bimë të egra, t'i ktheni në radhë të parë në toka buke dhe në pemishte, ullishta e vreshta. Në këtë drejtim mobilizohuni se nga Partia do të keni të gjithë përkrahjen e duhur.

Kudo në vendin tonë janë hapur shkolla. Partia çdo ditë na mëson dhe na thotë se nuk mund të ecet

përpara pa shkollë dhe pa dituri, sepse, po të keni këto, do të punoni më mirë, do të shtoni më tepër prodhimet. Në qoftë se në kooperativën tuaj do të vijnë agronomi, veterineri, zootekniku, mjeku, infermieri, mamia dhe mësuesi, atëherë do të keni më shumë bukë, qumësht, bagëti, nuk do të ketë sëmundje e padituri dhe fëmijët tuaj do të rriten si duhet me të gjitha të mirat. Më parë këtu nuk kishte shkolla, kurse tani ka çdo fshat. Ju keni shkollën 7-vjeçare dhe fare afër në Tiranë keni edhe shkolla të mesme, institute të larta dhe universitetin tonë. Të gjithë duhet të mësojmë, e në radhë të parë fshatarët, sepse ata kanë qenë më prapa. Por tani fshatarët janë zgjuar dhe duan të mësojnë me të gjitha forcat e tyre.

Ja, më bëhet zemra mal kur shoh që shumë gra kanë ardhur këtu në miting. Këto gra punojnë si edhe burrat. Më përpara të gjitha këto nëna dhe motra rrinin të mbyllura në shtëpi, nuk dilnin as në punë, as në rrugë, kur ishin të sëmura nuk mund të shkonin as te mjeku dhe për këtë shkak shumë nga fëmijët vdisnin. E gjithë kjo ndodhte nga prapambetja dhe zakonet e egra në regjimet e kaluara. Pse ky trajtim ndaj gruas, a nuk është ajo e zgjuar, e ndershme, e zonja, trime, punëtore njëlloj si burri, në mos më shumë? Atëherë si mund ta mbanim ne gruan në gjendjen e mëparshme? Këtë nuk na e lejonte vija e drejtë e Partisë sonë marksiste-leniniste. Partia që në fillim tha se gruaja duhet të çlirohet dhe populli e vuri në vend fjalën e Partisë. Ja tani përkrah jush, si dje në luftë, shikoni kudo nënat e motrat, gratë e vajzat që venë në shkollë dhe në punë. Kjo flet për atë revolucion të

madh që është bërë në vendin tonë në çështjen e tërheqjes së gruas në prodhim e në aktivitetet shoqërore.

Fanatizmi në këtë drejtim është mbeturinë e sundimit të vjetër otoman. Mund të mendojë ndokush se në Turqi janë bërë përparime. Ç'përparim i thonë atij kur gratë atje akoma dalin me perçe? Gratë e Shqipërisë, të edukuara me frymën e Partisë, brenda një kohe shumë të shkurtër e flakën tej perçen.

Fshatari ynë është përparimtar. Për këtë unë doja të falënderoja nga zemra të gjithë ata burra të moshuar që e kanë kuptuar drejt vijën e Partisë, i kanë futur gratë, motrat dhe vajzat e tyre në punë, i respektojnë ato, i dërgojnë të rejat në shkollë. Partia nuk do t'ua harrojë kurrë këtë qëndrim përparimtar. Ata e dëgjojnë dhe e mbajnë fjalën e Partisë dhe në këtë mënyrë i kanë sjellë një shërbim të madh vendit dhe familjeve të tyre.

Pjesëmarrja e gruas në punë është shenjë përparimi e begatie. Shikoni ç'ndodh te ne: në çdo sektor pune i gjen gratë që punojnë njëloj si edhe burrat e më me ndërgjegje. Gratë sot punojnë në çdo profesion, mësuese, mjeke, inxhinierë, shitëse, telefoniste etj. dhe për këtë ato falënderojnë Partinë. Është detyrë e të gjithëve që ta përkrahim e ta ndihmojmë atë për të mbrojtur e për të rritur dinjitetin dhe personalitetin e saj.

Shqipërinë tonë të re e ndërtoam me gjak dhe me djersë e nuk ka forcë që ta mposhtë dhe ta ndalojë të ecë përpara. Ne jemi të fortë se jemi në rrugë të drejtë, të cilën populli i udhëhequr nga Partia e mbron me vendosmëri. Por armiqtë na kanë halë në sy dhe ar-



matosen për të na goditur. Prandaj të jemi kurdoherë vigjilentë e të gatshëm dhe në njërën dorë të mbajmë kazmën e në tjetrën pushkën. Sa më të përparuar të jemi në bujqësi, në industri, aq më të fortë do të jemi, se kur armiku të shikon të dobët, të godet, kurse, kur të sheh të fortë, nuk guxon të të prekë. Prandaj, duke ndërtuar socializmin, duke punuar për të përmirësuar jetën e popullit tonë, ne forcohem gjithnjë e më shumë dhe armiqtë tanë duhet të mendohen shumë po të veprojnë kundër RPSH.

Edhe revizionistët e Beogradit, monarko-fashistët grekë dhe neofashistët italianë, që janë armiq të egër të popullit shqiptar, duhet t'i bëjnë mirë llogaritë me ne dhe të mos mendojnë se populli ynë nuk është i armatosur. Ata të mos harrojnë të kaluarën jo shumë të largët, kur partizanët dhe populli ynë thyen divizionet fashiste italiane e gjermane, ballistët e zogistët, atëherë kur nuk kishim armë dhe ato pak që kishim ua kishim marrë armiqtë. Tani kemi një popull që është i tëri i armatosur, kemi një industri të fuqishme që rritet nga viti në vit, një bujqësi që përparon vazhdimisht dhe një ushtri besnike të popullit dhe të Partisë që nuk e tund as topi, të fortë, të kalitur dhe të armatosur me armët më moderne.

Prandaj me besim të madh te Partia, te forca e saj dhe e popullit, t'i përvishemi punës me mish e me shpirt se tani punojmë për vete, për fëmijët tanë që jeta jonë të jetë e lumtur dhe e gëzuar. Nga ana tjetër, të hapim sytë se armiku nuk e pushon luftën kundër nesh. Ka akoma njerëz që mund të gënjejnë. Prandaj këta njerëz ne duhet t'i kemi kujdes. Jo të gjithë e

kuptojnë menjëherë rrugën e drejtë. Partia dhe patriotët e kanë për detyrë që të ndreqin çdo njeri që gabon. Këtë politikë ka ndjekur vazhdimisht Partia. Sa njerëz kanë bërë gabime gjatë kohës së luftës dhe po të mos punonte me mend Partia sa nga këta do të ishin dënuar. Por Partia dënoi vetëm fajtorët kryesorë, ata që kishin lyer duart me gjakun e popullit. Partia ecën dhe punon me mend si populli, se ajo është nxënëse e tij, ka mësuar prej tij dhe di t'i dallojë ata që gabojnë padashur. Populli të fal një herë, dy herë, tri herë, por kur me gabimet e tua dëmtohet çështja e tij, atëherë të jep dënimin e merituar, ashtu sikurse e morën të gjithë tradhtarët e atdheut dhe të popullit, qofshin këta njerëz të thjeshtë ose me përgjegjësi, si Koçi Xoxe, Teme Sejko etj. Partia nuk merr parasysh kush është ai që bën gabime dhe faje ndaj popullit. Kushdo qoftë ai duhet ta paguajë tradhtinë edhe me kokën e vet. Teme Sejko me shokë, agjentë të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë e të lidhur me imperialistët amerikanë komplotuan kundër popullit e Partisë. Veprimtaria e tyre përbënte një rrezik të madh për ekzistencën e diktaturës së proletariatit, prandaj gjyqi i popullit u dha dënimin e merituar.

Interesat e popullit dhe të atdheut janë mbi të gjitha. Kështu duhet të mendojnë të gjithë. Atdheu është gjëja më e shtrenjtë. Po humbe lirinë e atdheut ke humbur gjithçka.

Për popullin tonë interesat e Partisë janë mbi çdo gjë, sepse po u dëmtua dhe u rrezikua Partia, u rrezikua edhe jeta e popullit. Populli pa Partinë do të binte në robëri, por edhe Partia nuk mund të rrojë pa

popullin. Prandaj popull dhe Parti janë të lidhur përjetë. Për këtë arsye ne jemi të fortë. Vërtet ne kemi miq, por kemi edhe armiq, veçse planet e tyre të gjitha kanë dështuar dhe do të dështojnë kurdoherë, sepse populli është i lidhur me Partinë si mishi me koskën.

Shokë dhe vëllezër, nëna dhe motra, me besim të patundur te Partia, te ju, në forcën dhe zgjuarsinë tuaj, të ecim përpara, të prodhojmë dhe të punojmë sa më shumë! Në emër të Komitetit Qendror të Partisë, unë ju uroj nga zemra punë të mbarë e suksese të mëdha!

Këtë vit ju do të keni prodhime të mira dhe kjo gjë e gëzon shumë Partinë sepse djersa dhe puna juaj do të japë frytet e duhura. Vitin e kaluar ishim ca shtrënguar se na dëmtoi thatësira, por Partia mendoi për ta përballuar këtë gjendje dhe popullit nuk i mungoi buka. Këtë vit me furnizimin jemi shumë më mirë, do të kemi prodhime të bollshme, edhe për industrinë tonë do të kemi më shumë lëndë të parë. Prandaj është një gjë e gëzueshme që ky vit bujqësor është i mbarë. Partia është e lumtur kur në shtëpitë tuaja ka bollëk, gëzim dhe lumturi.

Të jeni të sigurt se, duke ndjekur këtë rrugë, çdo vit do të ketë më shumë gëzim, më shumë lumturi e begati për njerëzit tanë, prandaj

Të rrojë Partia jonë e Punës!

Të rrojë populli shqiptar!

Të rrojë populli i të gjithë lokalitetit të Zall-Herrit, besnik i Partisë!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**AVIATORËT QË RRTI, KALITI DHE EDUKOJ  
PARTIA JANË BIJ BESNIKË TË SAJ  
DHE TË POPULLIT**

*Fjala me oficerët e repartit të aviacionit të Rinast*

**15 qershor 1961**

Në radhë të parë ju përgëzoj dhe ju falënderoj për punën e lavdishme që bëni çdo ditë në shërbim të Partisë dhe të atdheut!

Këtë takim po e bëjmë si në të kaluar e sipër dhe më vjen keq që nuk kam kohë të qëndroj gjatë me ju, sepse në Prezë është mbledhur dhe na pret populli i gjithë lokalitetit. Por në këtë takim të shkurtër dua t'ju shpreh kënaqësinë që ndieva duke asistuar në fluturimin e mrekullueshëm të shokut tuaj. Specialist nuk jam, por them se ata që bëjnë të tilla fluturime janë heronj, njerëz të zotë nga çdo pikëpamje, sepse kanë arritur të zotërojnë makina kaq të fuqishme, të komplikuar dhe delikate, njerëz që kanë guxim, ashtu siç keni të gjithë ju, që Partia ju ka dhënë në dorë këto

mjete. Kjo tregon një anë shumë pozitive të njerëzve tanë, oficerëve të Ushtrisë sonë Popullore, dëshirën, vullnetin e madh dhe këmbënguljen për të mësuar. Partia jonë tani ka krijuar kuadro të aftë, të dalë nga gjiri i popullit, të cilët deri dje ishin analfabetë, disa nuk kishin as shkollë, le të mesme të plotë, por as 7-vjeçare, bile shumë kanë qenë vetëm me fillorë dhe shkollën e kanë bërë pas Çlirimit. Megjithatë, njerëzit tanë, kur kanë ndjekur shkollat ushtarake, kanë dalë të shkëlqyer si nga ana teorike, ashtu edhe në praktikë.

Jeta ka treguar se të gjithë ushtarakët tanë, të çfarëdolloj arme apo sektori të ushtrisë sonë, kur kanë vazhduar studimet në shkollat e larta ushtarake, kanë treguar zotësi të rrallë. Këtë nuk e them për t'ju bërë qejfin, sepse ju jeni komunistë, por kështu është e vërteta. Armët që ju kanë vënë në duar Partia e populli, që nga avionët e deri te nëndetëset, janë përvetësuar prej jush me një shpejtësi të jashtëzakonshme; ato drejtohen si duhet dhe janë në gatishmëri të plotë për arsye se i gjithë efektiv, oficerë dhe ushtarë, që shërbejnë në to, janë të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që u kanë ngarkuar Partia dhe populli. Prandaj, atje ku është caktuar, secili efektiv mëson dhe stërvitet mirë çdo ditë dhe çdo mjet është gati në çdo kohë, në shërbim të atdheut.

Duhet të jemi në gatishmëri shokë! Këtë e them se rreziku i luftës ekziston përderisa ekziston imperializmi. Ato fjalë të mëdha që ka thënë Stalini për paqen, jo një por as dhjetë Hrushovë të ngrihen nuk mund t'i tundin. Paqja është në duart e popujve dhe

nëse ata mobilizohen me të gjitha forcat kundër luftës, ajo do të sigurohet. Paqja do të rrezikohet në rast se çështja lihet vetëm në duart e disa personave, në shpresën e bisedimeve me krerët e imperializmit dhe në premtimet boshe për paqe. Bisedime mund të bëhen, por këto duhet të shoqërohen me një lëvizje të madhe të masave popullore, me aksione konkrete revolucionare, për t'ua bërë të pamundur jetën luftënxitësve, për të shkatërruar planet e imperialistëve amerikanë dhe aleatëve të tyre, imperialistëve anglezë, francezë, italianë dhe revizionistëve modernë, revizionistëve jugosllavë kryesisht dhe atyre të cilëve maska nuk u është çjerrë akoma si duhet. Ne, pra, jemi për këtë rrugë, se kjo është e drejtë dhe nuk ka kush e kundërshton.

Imperialistët amerikanë kanë leverdi të madhe në rast se në çështjen e paqes qëndrohet vetëm me llafë, diskutime dhe takime. Ata fitojnë kohë jo vetëm për vete, por armatosin dhe satelitët e tyre si Gjermaninë fashiste të Bonit. Ata çdo vit i shtojnë armatimet dhe këtë po e vërteton jeta. Paqja nuk mund të sigurohet në qoftë se nuk mbështetesh fuqimisht në popujt, nuk ndihmon lëvizjet nacionalçlirimtare dhe antikoloniale që bëjnë popujt e botës kundër kolonizatorëve të rinj, të cilët kryesisht janë imperialistët amerikanë, në qoftë se nuk frymëzohet që të ngrihet proletariati i të gjitha vendeve kapitaliste në luftë kundër borgjezisë imperialiste brenda në strofkën e saj dhe t'i nxjerrë asaj çdo orë dhe çdo ditë pengesa në përgatitjen e luftës. Atëherë, me të vërtetë, imperializmit amerikan i thuhet ndal, i pritët rruga për armatime. Ndryshe

ai armatoset e pregatitet për luftë dhe ti bjeri sa të duash daulles për paqe.

Pra, Partia jonë ka një vijë të drejtë, si për të gjitha çështjet e politikës së jashtme, edhe për paqen; këtë vijë ndjekin e zbatojnë edhe Partia Komuniste e Kinës, shumë parti të tjera, komunistët e botës, marksistë-leninistët e vërtetë që përbëjnë shumicën dërrmuese në lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Por nga disa vihen gurë në rrotat e marksizëm-leninizmit. Kjo nuk ndodh për herë të parë në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Borgjezia kapitaliste, për të penguar ecjen përpara, është përpjekur vazhdimisht t'i kundërvërë doktrinës sonë fitimtare teorinë e urryer oportuniste të revizionizmit. Por marksizëm-leninizmin, përhapjen e ideve të tij në botë, ecjen përpara të socializmit nuk i kanë penguar dot kurrë. Sigurisht, atij i kanë sjellë dëme revizionistët modernë e veçanërisht revizionistët jugosllavë, prandaj ata konsiderohen armiqtë tanë të rrezikshëm dhe kjo është pranuar në mbledhjet e komunizmit ndërkombëtar, vendimet e të cilave duhen zbatuar nga të gjithë.

Por ka udhëheqës që nuk i zbatojnë këto vendime, përkundrazi ata u bëjnë një luftë të tmerrshme atyre që i zbatojnë. Nuk dua të zgjatem për dëmet që i sjellin revizionistët modernë marksizëm-leninizmit, por do t'ju them se N. Hrushovi ka nxjerrë teorinë që sa më shumë të sulmohen revizionistët jugosllavë, aq më tepër lidhen me amerikanët. Kështu Hrushovi dhe ata që e pasojnë kërkojnë të heshtet kundër një sëmuni-

djeje të rrezikshme që kërkon të depërtojë në trupin e shëndoshë të komunizmit ndërkombëtar për ta brejtur këtë nga brenda. Ky është një krim i madh që i bëhet komunizmit dhe popujve. A mund të heshtet për shëtitjet që bën Titoja me vapor nga dy muaj nëpër Afrikë, kur dihet që këto nuk janë shëtitje thjesht turistike, por me qëllime të caktuara për t'i shërbyer imperializmit amerikan, i cili lufton që të dobësojë influencën e madhe të socializmit dhe të komunizmit në sytë e popujve që kanë hedhur tej zgjedhën koloniale dhe kanë fituar një farë pavarësie? Jo, ne nuk mund të heshtim para fakteve të tilla.

Për të penguar e për të dëmtuar lëvizjen antikoloniale që po zgjerohet, imperializmi amerikan përdor klikën titiste që t'i tërheqë në anën e vet këto forca. Ai e sheh se nuk mund t'i gënjejë dot popujt që po zgjohen ashtu siç bënte përpara, prandaj si mjet diversioni përdor revizionizmin modern, Titon me klikën e tij që shëtit nëpër Azi dhe Afrikë. Ju keni dëgjuar se në disa vende komunistët persekutohen, futen nëpër burgje, pushkatohen. Me këto metoda reaksionare qeveritë e këtyre vendeve synojnë të shuajnë lëvizjet revolucionare, të zgjatin jetën e borgjezisë dhe t'u hapin rrugë planeve të imperialistëve që i mbajnë në fuqi. Natyrisht për t'u maskuar Titoja përdor edhe ndonjë formulë kundër kolonializmit, shtiret se lufton për paqe, por këto nuk janë gjë tjetër veçse tym.

Pra, Nikita Hrushovi dhe ata që e pasojnë, me politikën që ndjekin, ndihmuan që Titoja, me gjithë kontradiktat që ekzistojnë midis këtyre vendeve, të arrijë në marrëveshje për të bërë një mbledhje në



Beograd në vjeshtën e ardhshme. Tani N. Hrushovit i janë vënë këmbët në një këpuce për qëndrimet revizioniste që mban dhe megjithëse bën një propagandë antimarksiste në radhët e partive të tjera kundër Partisë sonë, është i detyruar të pyesë se ç'mendon Partia jonë për këtë mbledhje që do të mbahet në Beograd, dhe në të njëjtën kohë deklaron se qeveria sovjetike «nuk është dakord»! Po përse ai e do tani mendimin tonë në mënyrë indirekte? Sepse Partia e Punës e Shqipërisë do t'ia përplasë fytyrës rezultatet e politikës së tij, rrjedhimet që sjell ajo, sepse këto çështje do të dalin në shtyp dhe atyre do t'u vijë hidhur. Ata do të heshtin për këtë mbledhje dhe ato që mendohen prej tyre se gjoja do të bëhen përçapje në rrugë diplomatike, domethënë me muhabete, për të influencuar që në këtë mbledhje në Beograd të mos harrohet të flitet kundër imperializmit dhe kolonializmit, janë vetëm fjalë. Këtë punë e ka merak vetë Titoja, ai do t'i lidhë mirë krerët e këtyre vendeve në vjeshtë dhe do të orvatet t'i hedhë kundër përhapjes së komunizmit, kundër çlirimit të popujve.

Sipas Hrushovit nuk duhet folur kundër Titos, ai duhet lënë rehat të livadhisë. As kjo, as ajo e udhëheqësve bullgarë, që kanë hapur kufijtë me Jugosllavinë, nuk është rruga marksiste që duhet ndjekur. Ju shqiptarët doni të merrni flamurin e luftës kundër revizionizmit, thonë udhëheqësit bullgarë, me Teodor Zhivkovin në krye. Ne duam vetëm të bëjmë detyrën tonë prej komunisti për të mbrojtur popullin dhe Partinë tonë, lirinë e atdheut, komunizmin. Prandaj kufijtë ne nuk i hapim, siç bëhet në Bullgari, ku hyjnë dhe dalin nga

Jugosllavia me mijëra. Dhe këtë qëndrim ata e justifikojnë me lidhjet që duhen mbajtur me popullin jugosllav.

Vigjilencë i thonë t'u hapësh kufijtë revizionistëve jugosllavë? Këtë që bënë vetë bullgarët na këshillonin ta bënim edhe ne, por ne nuk bëjmë si ata. Ne i njohim mirë revizionistët jugosllavë, i dimë taktikat e tyre sepse kemi rreth 20 vjet që po luftojmë kundër tyre dhe kjo nuk është një luftë e vogël. Metodat dhe taktikat e tyre i njohin edhe të tjerët, por heshtin.

Partia jonë i ka kritikuar me të drejtë N. Hrushovin dhe njerëzit e tij përsa kanë bërë kundër Partisë dhe atdheut tonë. Këto kritika ajo nuk i bëri prapa krahëve, as botërisht, po haptazi në mbledhje marksiste-leniniste partish. Atyre nuk u pëlqeu qëndrimi ynë dhe na shanë, por ata janë të sharë, kurse ne jemi të nderuar dhe koha do të tregojë sa të drejtë kemi.

Për komplotin që organizuan Teme Sejko me shokë me ndihmën e revizionistëve jugosllavë, monarko-fashistëve grekë dhe Flotës VI Amerikane, Hrushovi me shokë u përpoqën t'i mbyllnin grykën thesit, se me demaskimin e tij damkosen miqtë e tyre. Ata shkuan deri atje sa për gjyqin tonë të thonë se është diçka e trilluar, sepse nuk i vumë në dijeni etj. Qëllimi i këtyre përpjekjeve ishte të mos bëhej gjyqi, se revizionistëve u dilnin të palarat në shesh. Gjyqi u bë, atje u vërtetua tradhtia, tradhtarët morën dënimin e merituar, por «miqtë» heshtën për këtë komplot të madh, ndërsa reaksioni botëror dhe imperialistët flisnin çdo ditë kundër nesh.

Udhëheqësit e disa vendeve socialiste nisen nga

pikëpamja se Partia dhe populli ynë janë të vegjël, prandaj s'duhet të mbajnë të tilla qëndrime. Por populli ynë është heroik, ai, megjithëse i rrethuar, nën udhëheqjen e Partisë, po lufton dhe po u bën ballë me sukses kompleteve e diversioneve të armiqve të egër dhe triumfon vazhdimisht. Ne kemi besim se e drejta është me ne dhe prandaj do të fitojmë.

Ne jemi një Parti marksiste prandaj do t'i kritikojmë të gjithë ata që gabojnë, të mëdhenj apo të vegjël qofshin; Partia jonë ka mjaft eksperiencë për të parë si duhet pasojat e çdo veprimi. Për ne si marksistë, ka rëndësi të madhe kujdesi që duhet të tregojmë për të mbrojtur Bashkimin Sovjetik që në këto çaste kalon ditë të vështira. Ai që është marksist e internacionalist i vërtetë e do atdheun e vet si shpirtin, jep kokën për të, kurdoherë që e lyp nevoja, por njëkohësisht dhe duke luftuar me vendosmëri kundër grupit revizionist të Hrushovit, që po e çon atdheun e madh të Leninit e të Stalinit drejt humnerës.

Ta duam si shpirtin Partinë, ta duam si shpirtin popullin tonë. Momentet që kalojmë nuk janë të lehta, ju i kuptoni ato. Ne si kurdoherë i qëndrojmë besnikë marksizëm-leninizmit, sepse vetëm ky na ka nxjerrë nga çdo vështirësi. Në rrugën e vet Partia jonë ka përkrahjen, respektin dhe dashurinë e të gjithë popujve dhe komunistëve të botës. Imperialistët, revizionistët dhe reaksionarët janë një grusht njerëzish. Sido që forcën e tyre nuk duhet ta nënvleftësojmë, por çdo ditë që ka kaluar nga Mbledhja e Bukureshtit tregon se punët ecin në favorin tonë.

Prandaj, shokë, me besim të madh te Partia, si

kurdoherë, kryeni si duhet detyrën. Partia dhe populli ju janë mirënjohës për këtë, ata kanë te ju bij nga më të mirët dhe besnikë. Ju uroj nga zemra punë të mbarë dhe ju premtoj se do të vij edhe një herë tjetër për të biseduar më gjatë me ju!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **PARTIA NA KËSIHILLON TË QËNDROJME MË PAK NË ZYRË DHE MË SHUMË MIDIS POPULLIT**

*Fjala në mitingun e organizuar me kooperativistët  
e lokalitetit të Vorës e të Prezës*

**15 qershor 1961**

Të dashur shokë dhe shoqe,

Nuk mund të ketë forcë më të madhe në botë se forca e popullit. Forca e popullit tonë të lashtë, trim, heroik e paqedashës është vërtetuar gjatë gjithë historisë së tij, ajo nuk është lëkundur përpara asnjë vështirësie. Në forcën e madhe të popullit tonë, të cilën e ka treguar e po e tregon edhe populli heroik i Prezës, i Vorës dhe i fshatrave të tjera të lokalitetit tuaj, gjeti forcën e saj të madhe Partia Komuniste e Shqipërisë, sot Partia e Punës, e cila e udhëhoqi popullin tonë në luftën e tij më të lavdishme dhe bëri që të realizohen dëshirat e stërgjyshërve dhe të gjyshërve tanë, që gjithë jetën dërsitën, luftuan dhe u vranë, por nuk arritën dot të fitonin lirinë e vërtetë dhe pavarësinë.

Populli shqiptar, me Skënderbeun në krye, heroin tonë të lavdishëm që e njeh jo vetëm historia e Shqipë-

risë, por edhe ajo e Evropës, u rezistoi hordhive otomane dhe kurrë nuk u mposht. Kjo luftë heroike ka qenë një fitore e madhe jo vetëm për ne, po për gjithë qytetërimin evropian, që kërcënohej nga imperatoria e sulltanëve. Prandaj emri i Skënderbeut dhe i shqiptarëve është skalitur përjetë në historinë e Evropës. Populli shqiptar që luftoi kundër otomanëve, shtypjen e të cilëve e ka të freskët në kujtesën e tij, që vuajti shumë nën thundrën e bejlerëve, të feudalëve dhe të mbretit satrap, Ahmet Zogut, u ngrit i tëri si një trup i vetëm kundër fashistëve italianë e gjermanë me kushtimin e parë të Partisë. E kush e kujton tani katilin Ahmet Zogolli, që, pasi ropi popullin, rrëmbeu floririn dhe iku si hajdut e frikaman nëpër Evropë? Askush. Ai u katandis si mos më keq e mbaroi si një tradhtar i urryer i atdheut e i popullit.

Motra dhe vëllezër të dashur,

Populli shqiptar luftoi dhe fitoi në Luftën Nacionalçlirimtare se atë e udhëhiqte Partia. Po të mos ishte themeluar PKSH, rruga e popullit tonë do të ishte e errët. Populli ynë, siç thashë, ka luftuar shumë në të kaluarën, po asnjëherë nuk ka mundur të fitonte, se, kur vinte fundi, fitoret ia merrnin nga duart bejlerët dhe agallarët për t'u pasuruar edhe më tepër. Por nga gjiri i popullit, nga gjiri juaj, baballarë dhe mëma të dashura, doli Partia, radhët e së cilës u mbushën me bijtë tuaj, me djemtë dhe vajzat tuaja, nga ata më të vuajturit dhe më të mjeruarit, nga ata që nuk kishin bukë të hanin, që ripeshin rrugëve dhe bejlerët me Zogun në krye u grabitnin djersën. Natën e 8 Nëntorit

1941 në Tiranë u krijua Partia, që i tha popullit të ngrihej në luftë për të mposhtur armiqtë dhe kështu u bë. Nuk ka forcë që ta ndalë hovin e popullit për të ecur përpara, kur udhëhiqet me zotësi dhe konsekuencë nga një parti marksiste-leniniste, besnike deri në fund e interesave të tij.

Mbani mend, kur u formua Partia, ajo u bëri thirrje gjithë popullit, të krishterë e myslimanë, të pasur e të varfër, komunistë e patriotë, zogistë a ç'të ishin, të bashkoheshin se kishin një armik të përbashkët e të madh në vend, pushtuesit fashistë, prandaj duhej çliruar vendi. Lufta për çlirimin e atdheut ishte detyrë e të gjithëve. Më vonë, tha Partia, çështjet tona të brendshme do t'i zgjidhim vetë, atë pushtet që të dojë populli, atë do të vendosim. Kjo ishte rruga e drejtë e Partisë, e cila donte që të mos ndodhnin vëllavrasje. Por armiqtë, bejlerët dhe agallarët nuk e pranuan fjalën e Partisë.

Partia më kishte dërguar shumë herë të bisedoja me këta njerëz që nga Lumo Skëndoja dhe deri te Abaz Kupi. Unë jam përpjekur t'i bind, arritëm edhe në marrëveshje me ta për të luftuar kundër pushtuesve, por ata mbetën vetëm me fjalë; kur vinte puna për luftë nuk ia bënë asnjëherë bam. Por Partia dhe partizanët kishin baza të forta në popull, te ju, dhe kështu radhët tona çdo ditë forcoheshin, shumëzoheshin. Lufta u bë e madhe, e fuqishme, popullore dhe atdheu u çlirua.

Abaz Kupi s'ka qenë tjetër veçse një tradhtar i shitur te anglezët që u përpoq deri në fund bashkë me ta të dëmtonte luftën e popullit tonë. Por as ai, as shokët e tij nuk ia arritën dot qëllimit, se ishin të vetmuar, kurse Partia ishte me popullin dhe populli është i fuqi-

shëm. Populli e përqafoi programin e Partisë, që shprehte shumë qartë qëllimet e Luftës Nacionalçlirimtare dhe interesat e popullit. Partia i tha atij që në fillim se vetëm po të luftonte kundër pushtesve dhe tradhtarëve do ta merrte pushtetin dhe duke qenë në pushtet, ligjet do t'i bënte vetë, do t'ua merrte tokën beut dhe agait, fabrikat e pakta që ishin do t'ua merrte borgjezëve dhe do të ngrinte plot të reja me punën e tij nën udhëheqjen e Partisë.

Vitet pas Çlirimit janë dëshmitare për ndryshimet e mëdha që ka bërë Shqipëria. Në radhë të parë kanë ndryshuar njerëzit. Ata janë bërë e bëhen vazhdimisht më të kulturuar, më të shëndetshëm, më të gëzuar dhe më të lumtur. Kjo ka rëndësi të madhe sepse tregon që çdo gjë në Shqipërinë e re bëhet për njeriun, që ai të rrojë i shëndetshëm, i gëzuar, i lumtur dhe i mësuar. Dhe në fakt, populli shqiptar, i udhëhequr dhe i frymëzuar nga Partia, e ktheu vendin nga gërmadhë në kopësht me lule. Kudo në Shqipëri janë ngritur me dhjetëra e dhjetëra fabrika e kombinate, uzina e hidrocentrale. Tani populli pjesën më të madhe të sendeve që i duhen, i merr nga fabrikat e vendit, që janë të tijat dhe vihen në lëvizje nga duart e djemve dhe të vajzave të popullit, drejtohen prej tyre dhe të ardhurat shërbejnë për të rritur mirëqenien dhe lumturinë e popullit. Në kohën e mbretit Zog, kur një kapitalist ngrinte ndonjë fabrikë, fabrikë i thënçin, me të pasurohej ai, fitimet e saj shërbenin për të mbushur xhepat e tij, të mirat i gëzonte gruaja dhe fëmijët e tij, pa si ishte populli aq i bënte kapitalistit. Atëherë dhe bujqësia prodhonte vetëm për të pasuruar bejlerët dhe



agallarët, ndërsa masa e fshatarëve që punonte ditë e natë vdiste nga uria dhe të pasurve as që u prishej puna.

Rruga e Partisë ka qenë, është dhe do të mbetet e drejtë, prandaj populli e do si shpirtin Partinë, prandaj ju brohoritni me kaq zjarr për të.

Italia ishte një fuqi e madhe kapitaliste, por ç'bëri kur erdhi këtu? Ajo hapi vetëm disa puse për nxjerrjen e naftës, bëri dhe disa rrugë për qëllime ushtarake. Bëri ato që i shërbenin pasurimit të borgjezisë italiane dhe qeverisë fashiste të Duçes. Kurse ne që na quanin rrjepacakë dhe xhahilë, tani nxjerrim 10 dhe 12 herë më shumë naftë se italianët. Ne i kemi zgjeruar shumë fushat e naftës. Ajo te ne është një pasuri e madhe për popullin. Naftë ka dhe do të ketë akoma më shumë.

Por në vendin tonë nuk ka vetëm naftë. Inxhinierët dhe gjeologët tanë punojnë për të zgjeruar minierat e kromit dhe në të ardhshmen do të ngremë uzina që ta pasurojnë atë për ta bërë më të vlefshëm dhe të shtojmë kështu më tej të ardhurat tona. Ne kemi shumë bakër, kemi miniera të rëndësishme me këtë mineral, prandaj do të ngrihen uzina të tjera për të prodhuar akoma më shumë për popullin, si ajo për prodhimin e telave prej bakri, do të çohet drita elektrike kudo në fshatra që të zhduken kështu llambat me vajguri. Ne kemi zbuluar rezerva të mëdha hekuri. Hekuri ynë është me përmbajtje të mirë. Bashkë me të ndodhet dhe një metal tjetër i vlefshëm, nikeli. Edhe minierat e hekur-nikelit tonë janë me përmbajtje minerali të pasur. Këto miniera kemi filluar t'i hapim e t'i zgjerojmë. Ja pra, ç'po bën Partia për lulëzimin e vendit.

Ai popull, që beu, bajraktari dhe agai e poshtëronin, pasi i rrëzoi këta nga pushteti dhe mori në duart e veta fuqinë, po ndërton të gjitha këto vepra të mëdha për lumturinë e tij. Ju, vëllezër dhe motra, i keñi parë vetë me sy këto vepra dhe frytet e tyre i gëzoni çdo ditë. Kombinatin e tekstileve «Stalin», me stofat e të cilit visheni ju, nëna dhe motra, e ngriti populli ynë me ndihmën e popujve të Bashkimit Sovjetik. Atje punojnë e drejtojnë mijëra gra e vajza shqiptare.

Përpara thoshin se gruaja vendin e ka vetëm në shtëpi, të lindë e të rritë fëmijë e të bëjë punët e shtëpisë. Por Partia bëri një revolucion të madh në mendjen e njerëzve në lidhje me çështjen e gruas, sidomos e zgjoi gruan, i ngjalli besim në forcat e saj, e bindi popullin se pa gruan nuk mund të ketë Shqipëri të lirë e socialiste. Partia luftoi që të zhdukte mendimin e vjetër reaksionar për gruan dhe fshatari ynë e kuptoi drejt vijën e Partisë në këtë çështje të madhe, e ndihmoi gruan të dalë pa perçe, të mësojë dhe të çojë edhe vajzat në shkolla. Kjo është një çështje e madhe. Ne i respektojmë këta burra përparimtarë që nuk u sjellin asnjë pengesë grave dhe vajzave. Sot në vendin tonë është arritur që burrat dhe gratë të bashkuar, me Partinë në krye, po bëjnë të gjitha këto mrekulli, drejt lulëzimit të vendit. Gruaja, pra, siç e vërteton jeta jonë, është një forcë e madhe për ndërtimin e socializmit.

Brenda këtyre pesë vjetëve do të ngrihen kombine dhe fabrika të reja, ndër to një kombinat tekstili në Berat, më i madh nga ai i Tiranës, ku do të prodhohen copa më të bukura se ato që prodhohen deri tani. Do të ndërtojmë edhe një fabrikë për stofa. Do të ngrihen

edhe dy fabrika çimentoje, një në Krujë dhe një në Elbasan, që populli të ketë më shumë çimento për të ndërtuar shtëpi dhe çdo gjë që i duhet. Në lokalitetin tuaj janë ndërtuar mjaft shtëpi dhe vendi, sidomos këtu në Prezë, është i bukur. Mos e harroni këtë vend kaq të bukur në këtë kodër të lartë. Ndërtoni shtëpi edhe atje poshtë, por edhe në këtë kodër të bukur, sepse këtu kanë jetuar dhe kanë luftuar kundër armiqve stërgjyshët tanë. Partia do ta ndreqë dhe do ta zbukurojë këtë vend të bukur që të përjetësohet kujtimi i tyre.

Partia ka në program të zhvillojë industrinë e lëndëve të ndërtimit, për të ngritur të gjitha këto kombinete, fabrika e hidrocentrale, por do të ndërtohen me ritëm më të shpejtë se deri tani edhe shtëpi për punëtorët dhe për fshatarët. Ju keni dëgjuar, motra e vëllezër, dhe shumë prej jush kanë shkuar në Tiranë e gjetkë dhe kanë parë sa kanë ndryshuar kryeqyteti ynë dhe qytetet e tjera, si Durrësi, Vlora, Elbasani, Shkodra, Korça, Fieri etj. Kudo brenda një kohe të shkurtër janë zhdukur shtëpitë e vjetra dhe në vend të tyre janë ngritur pallate të reja. Këto i bëri socializmi, ai po sjell begati në qytet dhe në fshat. Fshati ynë po ndryshon çdo ditë, bujqësia tani është kolektivizuar, fshatarët janë bashkuar si në një familje të madhe. Një fshatar më tha se kolektivizimi është një gjë e bukur, por bashkimi i kooperativave është akoma më i mirë, sepse kështu fshatarësia e bujqësia do të zhvillohen më shumë.

Puna e madhe e Partisë e bindi fshatarin tonë që të futej në rrugën e kolektivizimit, e cila ishte rruga më e mirë për të. Po sa fitime kemi nga bashkimi i koopera-

tivave! Tani po hapen me shumicë toka të reja, kudo po sistemohen e po pastrohen ato nga hendeqet dhe gjer-dhet. Tani kudo fushat janë zbukuruar siç i shihni. Në to mund të punojnë pa pengesa traktorët, që tani i kemi me mijëra dhe akoma mijëra të tjerë do të sjellim gjatë pesëvjeçarit të tretë. Kemi bonifikuar e vazhdojmë të thajmë moçale dhe kënetë. Atje ku përpara kishin folenë mushkonjat e malarjes, tani rriten misri dhe pambuku. Kemi hapur kanale të mëdha për ujitjen e tokave dhe kudo vazhdojmë të hapim të tjera. Edhe këtu te ju kështu është punuar dhe po punohet. Në Shargë ju do të ndërtoni këtë pesëvjeçar një rezervuar të madh. Jua merrte mendja të kishit motopompa për ujitje, ose që fusha juaj, aq e rënduar nga ujët, të kanalizohet? Tani te ju janë zgjeruar parcelat dhe ju po mbillni jo vetëm misër po edhe grurë. Po çfarë do të bëhet pas pesë vjetësh në bujqësi? Një ndryshim i madh. Këto që shohim me sy janë bërë brenda tre vjetëve, sepse vetëm kohët e fundit mori hov kolektivizimi.

Gjatë pesëvjeçarit të tretë do të vazhdohet të punohet për bonifikimin e fushave, do të shtohen traktorët, do të arrijmë të ujitim 45 për qind të tokave arë, që të mos presim me duar nga qielli, se lutjet nuk të japin gjë, por puna dhe djersa të japin bukë. Këtë pesëvjeçar ne do të ndërtojmë edhe dy uzina për prodhimin e plehrave kimike. Më parë, shumë nga ju kishin frikë se plehu kimik ju digjte tokën, tani ia dini vlerën dhe e kërkon shumë atë. Plehrat kimike do t'i prodhojmë në vend me ndihmën e miqve dhe do t'i hedhim tokës plehun që i nevojitet.

Kur të bëjmë të gjitha këto atëherë nuk do të

kënaqemi me 14 dhe 15 kv grurë ose misër për hektar, por duhet të luftojmë për 20 dhe 25 kv. Kjo do të arrihet. Edhe tani ka vende në Shqipëri që marrin edhe 30, bile dhe 50 kv grurë ose misër për hektar, pa pleh, vetëm me ujë dhe punë të mirë, po kur të kemi pleh, atëherë kudo në bujqësi do të prodhohet më shumë drithë.

Vendi ynë është i begatshëm, njerëzit tanë janë të mrekullueshëm. Partia qëndron si kurdoherë në krye dhe punon për popullin. Bujqësisë do t'i jepet të gjitha ato mundësi që thashë, atëherë do të kemi më shumë prodhime për popullin, për mirëqenien e të cilit lufton Partia. Edhe tani nuk është se jemi keq, ndryshimet dhe përparimet që kemi bërë janë të mëdha, por nuk mund dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të kënaqemi me këto që kemi arritur. Prandaj të mobilizohemi me të gjitha forcat për realizimin e planeve. Edhe kooperativa juaj ka planin e vet pesëvjeçar si të gjitha të tjerat, prandaj luftoni dhe mobilizohuni jo vetëm ta realizoni, por edhe ta tejkaloni atë. Qysh sivjet luftoni për të marrë prodhime sa më të mëdha, prandaj shfrytëzoni çdo mundësi në këtë drejtim.

Unë do të thosha në radhë të parë t'i kushtoni kujdes bukës, kjo është kryesorja. Kudo, jo vetëm te ne, këtë kanë kryesoren, bukën. Për bukë nuk kemi vuajtur, megjithëse vjet patëm thatësi të madhe, por Partia mendoi me kohë për sigurimin e bukës së popullit. Duhet që bukën ta bëjmë vetë, të kemi edhe për të ngrënë edhe rezerva që të përballojmë çdo vështirësi.

Po nuk është vetëm buka, njeriut i duhen edhe prodhimet blegtorale, pemët etj. Ju këtu kenë një pasuri

të madhe me ulla. Ku ka vend më të bukur se këtu te ju, në mes të ulla? Veçse këta ulla duhen punuar si duhet. Ju i dini më mirë se unë punët e bujqësisë, por Partia më ka ngarkuar t'ju them se ulla u duhen bërë shërbime më të mëdha. Ju i punoni ulla mirë, por vlonjatët, elbasanasit, bregdetasit i punojnë akoma më mirë se ju.

Ulliri ka leverdi të madhe ekonomike e ushqimore, ai na jep vajin dhe bërsitë, me atë bëhet sapuni e mbi të gjitha ai është ushqim shumë i mirë. Të tregojmë shumë kujdes për ulla që kemi, por të mbjellim dhjetëfishin e tyre, sepse janë një pasuri e madhe për të gjithë popullin tonë.

Partia ka parashikuar një plan të madh me afat të gjatë për mbjelljen e ulla dhe janë të gjitha mundësitë për realizimin e tij. Pikë-pikë bëhet lumi, thotë populli, dhe me ujët e lumenjve mbushet deti. Prandaj mendoj që edhe ju ta rishikoni planin e ulla dhe të mbillni më tepër.

Gjithashtu të mbillni pemë frutore sa të jetë e mundur më shumë. Vlerën e tyre tani e njohin të gjithë, se po të hash fruta ke shëndet. Pastaj me to bën pije të ndryshme, reçel, marmelatë etj., që i kërkon populli dhe sjellin të ardhura të mira. Frutat dhe zarzavatet tona i kërkojnë shumë edhe jashtë, sidomos ato të hershmet. Tani jashtë domatet tona shiten nga 150 dhe 200 lekë kilogrami. Duhet të mbillni sa më shumë fruta dhe zarzavate edhe për popullin edhe për eksport.

Partia ka vendosur që fshatrave, sidomos kooperativave bujqësore të rrethit tuaj, t'u japë kredi me afat të gjatë për të mbjellë pemë frutore në blloqe. Kjo

kredi të shërbejë për të paguar ditët e punës që do të bëjë një kooperativë bujqësore për mbjelljen e pemëve derisa ato të fillojnë të japin prodhim. Një gjë e tillë u intereson shumë kooperativave, sidomos atyre të zonave malore e kodrinore. Prandaj e studjoni këtë çështje, dilni me propozime konkrete, shtoni ullinj të radhë të parë, studjoni ku ka mundësi për të krijuar rezervuarë të vegjël dhe mos u kënaqni vetëm me një motopompë që ujit qoftë edhe njëqind hektarë, sepse vetëm Preza ka mbi një mijë hektarë tokë. Punoni që të shtoni sa të jetë e mundur më shumë sipërfaqet e ujtitshme. Ky është vendimi i Komitetit Qendror. Në këtë drejtim shteti do t'ju ndihmojë deri në 30 për qind të shpenzimeve, të tjerat do t'i bëni vetë.

Shikoni detyrat që ka vënë Partia për bujqësinë. Ato ne do t'i bëjmë medoemos se populli i përqafton me bindje të plotë të gjitha udhëzimet e Partisë dhe i realizon me këmbëngulje në jetë. Pse themi ne që e ardhshmeja e popullit tonë është e lumtur? Sepse brenda 16-17 vjetëve, nën udhëheqjen e Partisë, populli ynë trim e punëtor ka bërë atë që në Shqipëri në regjimet antipopullore nuk është bërë dot as në disa qindra vjet.

Sa më shumë dhe më mirë të realizojmë planet tona, aq më të fortë bëhemi. Partia nuk thotë gjëra që nuk realizohen. Ajo nuk ka thënë, për shembull, të bëjmë diçka jashtë mundësive, por na këshillon të shtrijmë këmbët sa kemi jorganin. Pikërisht për këtë, ato që thotë Partia do të realizohen se s'bën. Planet e Partisë populli i sheh si realizohen në jetë. Kjo ndodh se Partia është si një nënë nikoqire që e di mirë gjendjen e familjes, që i bën mirë llogaritë në bazë të të ardhurave

që ka. Partia vepron kurdoherë në interes të popullit dhe me llogari. Prandaj u bënë të gjitha këto gjëra për popullin në një kohë fare të shkurtër, prandaj ju e doni me gjithë shpirt Partinë tonë heroike, Partinë e Punës të Shqipërisë. Jo më kot thuhet: «Ç'thotë Partia bën populli, çdo populli bën Partia».

Partia na mëson edhe një gjë tjetër. Të gjitha këto gjëra nuk bëhen me «frymën e shenjtë», por me punë e dituri. Për këtë janë hapur shkolla kudo në vendin tonë deri te Universiteti i Tiranës; nga këto shkolla kanë dalë mijëra kuadro, djem e vajza, burra e gra. Por këta kuadro që kemi nxjerrë deri tani nuk janë mjaft, vendit i duhen akoma më shumë. Pastaj të mësuarit s'ka fund. Sa më shumë të mësojë njeriu, aq më tepër kërkon. Gjë e çuditshme duket kjo, po kështu është, dituria është si një pus i thellë që nuk ka fund. Këtë e tregon edhe zhvillimi e përparimi i shkencës botërore.

Prandaj të mësojmë pareshtur e të gjithë që ta çojmë akoma më përpara socializmin në vendin tonë. Ju e patë gjysmë ore më parë si fluturoi me avion njëri nga pilotët tanë. Ai përpara ishte çoban, por mbaroi shkollën dhe tani është bërë një pilot i shquar i vendit tonë.

Shqipëria sot është e fortë si asnjëherë. Prandaj të gjitha komplotet e imperialistëve amerikanë, të revizionistëve jugosllavë, të monarko-fashistëve grekë, të neofashistëve italianë kanë dështuar me turp. Shqipëria qëndron si një kala e pamposhtur dhe flamuri i saj që e mban lart Partia, flamuri me shqiponjën dykrenare dhe yllin e artë, valon krenar se Republika jonë Popullore është e fortë. Kapitalizmit po i vjen fundi, shpejt a



vonë ai do të vdesë. Ky është një ligj objektiv që e kanë zbuluar Marksi dhe Lenini dhe nuk ka si të ndodhë ndryshe. Këtë e vërteton historia e popullit tonë.

Po sot ka akoma popuj të mëdhenj që vuajnë nën sundimin kapitalist. Atje klasa punëtore lufton që të përmbysë pushtetin e kapitalit dhe do të vijë koha që jo vetëm në këto vende, por edhe në të gjithë botën popujt të çlirohen nga sundimi kapitalist.

Ne jemi të fortë se kemi një popull heroik që di ku shkon, di çfarë mbron. Populli ka sot një Ushtri të fuqishme Popullore, e cila, e frymëzuar nga idealet e Partisë, është e përgatitur nga çdo pikëpamje dhe e gatshme në rast se do të preken kufijtë dhe interesat e atdheut e të popullit. Ushtria jonë mbron atdheun e vet socialist, ajo përbëhet nga djemtë tuaj dhe vigjëlon për ruajtjen e jetës paqësore të popullit tonë.

Në fillim në ushtrinë tonë kishte plot analfabetë, tani nga këta nuk ka fare. Sot të gjithë djemtë ushtarë kanë mbaruar shkollën fillore e 7-vjeçare, bile prej tyre edhe të mesmen. Në ushtri ne kemi mijëra oficerë të Luftës Nacionalçlirimtare që i mësoi dhe i edukoi Partia dhe tani u ka dhënë në dorë armë nga më modernet, të cilat dinë t'i përdorin më së miri, që nga aeroplanët e deri te nëndetëset. Le të guxojnë, po të duan, pasardhësit e Musolinëve ose të Hitlerëve të sulmojnë Shqipërinë, ata do të shfarosen si në det, në qiell edhe në tokë.

Partia me të drejtë na këshillon që të hapim sytë e t'i bëjmë katër se si thotë populli «uji fle, hasmi s'fle», të mbajmë fort në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën, se armiku, po të gjeti bosh, të fut thikën.

Është fakt se armiku kurrë nuk na ka gjetur në gjumë dhe sa herë që ka ngritur dorën, ia kemi bërë copë.

Kështu ndodhi edhe me komplotin që deshën të bënin kundër nesh disa tradhtarë shqiptarë të organizuar nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe të ndihmuar nga Flota VI Amerikane. Siç jeni në dijeni, ky komplot dështoi e bashkë me të edhe planet e armiqve të jashtëm.

Ne nuk duhet të dehemi nga sukseset, por të jemi vigjilentë dhe të shkatërrojmë planet dhe veprimtarinë armiqësore të imperialistëve, të revizionistëve e të gjithë reaksionarëve, të mos i lëmë ata të bëjnë si të duan. Për këtë ne duhet të jemi të fortë e të përgatitur më së miri. E kemi për detyrë që me shembullin e përkrahjen tonë internacionaliste të ndihmojmë edhe të tjerët, sidomos të gjithë ata popuj që vuajnë nën zgjedhën e kapitalit amerikan, anglez, francez etj., të bëjmë që klasa punëtore e popujt e këtyre vendeve të ngrihen në këmbë dhe të luftojnë kundër planeve të luftës të imperialistëve e sidomos të imperialistëve amerikanë. Sot, më shumë se kurrë, duhet të bashkohen në një front të vetëm forcat revolucionare e proletariati në vendet kapitaliste me luftën nacionalçlirimtare të vendeve koloniale e gjysmëkoloniale, me forcat përparimtare e paqedashëse të botës kundër luftës dhe reaksionit.

Më vjen me të vërtetë keq që erdhi koha të largohem prej jush, sepse, kur vijmë te ju, marrim forcë, se forca e Partisë është forca juaj. Partia na ka mësuar të jemi kurdoherë në mes të popullit, sepse prej tij ne mësojmë dhe ato që mësojmë nga populli i vëmë përsëri në shërbim të tij. Po tani u err, shumë nga ju janë edhe larg,

pra kanë për të bërë rrugë. Prandaj nuk dua t'ju mbaj më gjatë. Por ju them se nuk është as hera e parë, as e fundit që vij, ne e kemi për detyrë dhe duhet të vijmë më shpesh të takohemi me ju. Partia na këshillon të qëndrojmë më pak në zyrë dhe më shumë midis popullit, të dëgjojmë me vëmendje ç'thonë njerëzit e popullit e të këshillohemi me ta dhe pastaj të vendosim ç'do të bëjmë.

Të dashur shokë dhe shoqe, me besim të patundur te Partia jonë e lavdishme, punoni të qetë e me hov të madh revolucionar se luftojmë për një çështje të madhe, për ndërtimin e socializmit, për 'zbukurimin e jetës, begatinë dhe të ardhshmen tonë e të fëmijëve tanë. Të punojmë në të gjithë sektorët dhe të mësojmë që të prodhojmë sa më shumë për të mirën tonë dhe të familjeve tona, për të mirën e gjithë Shqipërisë. Interesi i Shqipërisë duhet të lidhet me interesin e çdo familjeje. Çdo shqiptar nuk mund të shkëputet kurrë nga interesi i atdheut, kush e shkëput veten nga shoqëria bën gabim të rëndë, dëmton atdheun dhe familjen e vet.

Me besim të patundur në drejtësinë e Partisë, në forcat, zotësinë dhe zgjuarsinë tuaj, t'i përvishemi punës dhe planin e tretë pesëvjeçar ta realizojmë kudo e në të gjitha drejtimet.

Duke ju uruar me gjithë shpirt jetë të lumtur dhe të gëzuar, vit të bollshëm dhe prodhime të shumta, gëzim në familje, le të brohorasim për atë që na çeli sytë, na mësoi, na çliroi, na mbron dhe na udhëheq me siguri në një rrugë të drejtë, për Partinë e lavdishme të Punës të Shqipërisë, Partinë e punëtorëve dhe të fshatareëve tanë!

Rroftë Partia heroike e Punës e Shqipërisë!

Rroftë populli heroik i lokaliteteve të Prezës dhe të Vorës, që ka qenë, është dhe do të jetë kurdoherë besnik i Partisë, i çështjes së madhe të popullit, të socializmit dhe të komunizmit!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **SPECIALISTËT E BUJQËSISË TË MERREN ME SHUMË ME PUNËN E GJALLË NË TERREN**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**19 qershor 1961**

Pavarësisht nga masat e tjera që do të merren, mendoj se duhet bërë një ndarje më e drejtë e kuadrit, në bazë të nevojave dhe të zhvillimit që marrin bujqësia dhe blegtoaria. Por ndryshime të mëdha në planin e përgatitjes së kuadrove me anë të shkollave në nuk mund të bëjmë, sepse nevoja kanë edhe sektorët e tjerë. Ndonjë ndryshim i vogël mund të bëhet, por planet që kemi aprovuar duhet të realizohen. Të kemi kujdes sidomos për edukimin e kuadrove, për lidhjen e tyre me jetën, me problemet e prodhimit. Këtu duhet

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit mbi kuadrin e sektorit të bujqësisë dhe të grumbullimit.

të përqëndrohet i gjithë kujdesi i Partisë dhe i ministrisë.

Kuadrot e ministrisë, të ndërmarrjeve bujqësore, të SMT-ve dhe të organeve lokale të pushtetit duhet të shikohen me kujdes se me ç'punë merren. Në qoftë se në Ministrinë e Bujqësisë një numër kuadrosh janë të tepërt, atëherë këta mund të shkurtohen, sepse po t'i lëmë aty, do të merren me letra. Mund edhe të mos i heqim, por të ndihmohen që të merren me punën e gjallë. Në rast se specialistët në ministri nuk merren vetëm me letra, por pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në ndërmarrjet bujqësore dhe në kooperativat bujqësore duke kontrolluar zbatimin e udhëzimeve dhe duke ndihmuar për zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë, atëherë këta s'ka pse t'ia heqim aparatit të ministrisë. Prandaj duhen marrë masa në dikaster, në komitetet e Partisë dhe në komitetet ekzekutive të kp të rretheve që specialistët të mos i angazhojmë shumë me punë zyre, me letra dhe mbledhje, sidomos gjatë fushatave të mëdha. Kur të mbarohen punët kryesore të bujqësisë, aty nga tetori, nëntori e dhjetori, atëherë të bëhen edhe analizat e punës e të merren masat përkatëse.

Edhe në NB-të e në SMT-të ka 180 kuadro të lartë, por, po të marrim parasysh zhvillimin e madh të këtyre sektorëve dhe shkurtimin e organikave që bëmë vjet, mendoj se tani për tani nuk duhet të bëjmë përsëri shkurtime. Disa kuadro nga këta sektorë edhe mund t'i heqim e t'ua japim kooperativave bujqësore, por këtë ta matim mirë, ndryshe të mos prishim thasë dhe të bëjmë torba. Situatën në kooperativat bujqësore nuk mund ta ndreqim menjëherë. Në kooperativat bujqësore

na duhen qindra kuadro të lartë dhe të mesëm, prandaj për të përmirësuar gjendjen e tyre nuk kanë ç'të na bëjnë 15-20 kuadro që mund të shkurtojmë nga dikasteret, nga NB-të apo nga SMT-të. Orientimin e kemi të qartë, prandaj kur shikohet se në një ndërmarrje bujqësore ka ndonjë specialist të tepërt, të hiqet dhe të vendoset atje ku ka më shumë nevojë.

Përsa u përket rretheve dhe lokaliteteve, unë hezitohet të heqim kuadro. Edhe lokalitetit, po t'i heqim specialistë, atëherë si do të ndihmohen teknikisht të 10-12 kooperativat që janë në territorin e tij? Rëndësi ka që këta kuadro t'i lehtësojmë nga letrat dhe t'i bëjmë që të ndihmojnë më shumë kooperativat. Në këtë drejtim ne duhet të japim një shembull më të mirë. Nuk është e drejtë që ne të kërkojmë informacion çdo ditë nga baza. Është e domosdoshme që teknikët e lartë në bazë t'i ngarkojmë të merren me prodhimin, kurse për punët e tjera të caktohen njerëz që kanë mbaruar teknikumet. Lushnja, për shembull, mund të ketë më shumë kuadro se ndonjë rreth tjetër, po atje ka një bujqësi të madhe. Në qoftë se teknikëve të lartë u kërkojmë të bëjnë çdo javë ose dy herë në javë mbledhje, atëherë ata nuk kanë si të lidhen me prodhimin e të ndihmojnë bazën. Këtë duhet ta mbajmë parasysh edhe ne si Sekretariat. Në rast se do të bëjmë çdo javë mbledhjen e Sekretariatit të KQ, jo vetëm s'kemi për të shkuar sa duhet në bazë, por do të pengohet edhe aparati, ose punët do t'i ndërpresim në mes. Është fakt se tani që mbledhemi më rrallë, nuk kemi humbur asgjë, përkundrazi kemi fituar shumë, sepse të gjithë shokët kanë vajtur në bazë, e kanë ndihmuar më mirë atë dhe kanë

mësuar më shumë prej saj. Prandaj ky shembull duhet ndjekur edhe nga kuadrot e tjerë.

Fakultetin e zooveterinarisë mendoj se nuk duhet ta ngremë tani. Të mbajmë edhe për disa vjet orientimin që kemi, sipas të cilit, ai që del veteriner, të dijë edhe nga zooteknika, të mos fillojmë që tani nga ndarja e specialistëve, sepse sot e tillë është situata jonë.

Në përgjithësi sektori i bujqësisë ka marrë një numër pak a shumë të madh kuadrosh. Në këtë sektor ne shohim mjaft përparime, njerëzit punojnë mirë. Sigurisht të meta të veçanta ka e do të ketë si kudo, por në përgjithësi njerëzit që punojnë në bujqësi, specialistët e lartë, teknikët e mesëm dhe të ulët, janë të lidhur me punën dhe e kanë ndihmuar mirë fshatarësinë në kryerjen e detyrave. Bujqësia këtë vit ka marrë një hov të ri zhvillimi. Në këtë drejtim ka ndihmuar vërtet koha, por ka influencuar shumë edukimi i kuadrove, që kanë zbatuar udhëzimet e Partisë dhe të Qeverisë. Kjo tregon një rritje të konsiderueshme të nivelit ideopolitik e profesional të kuadrit në sektorin e bujqësisë. Kjo është pozitive.

Një kujdes të posaçëm ne duhet të tregojmë për çështjen e shkollave bujqësore. Ministria e Bujqësisë duhet të interesohet për mbarëvajtjen e këtyre shkollave. Kontingjentet është mirë të plotësohen, në radhë të parë me elementë nga fshati. Por në përgjithësi fshatarët, porsa mbarojnë 7-vjeçaren, hyjnë në punë, prandaj duhet bërë çmos që të rinj fshatarë të ndjekin shkollat. Ka dhe do të ketë njerëz që nuk u pëlqen të shkojnë në fshat, por në masë njerëzit shkojnë kudo që ka nevojë atdheu dhe kjo është pozitive.



Ne nuk kemi evidenca se sa fshatarë, që kanë mbaruar shkolla e kurse bujqësore, janë larguar nga profili i tyre, prandaj ta krijojmë këtë evidencë jo vetëm me ata që kanë mbaruar 4-5 vjet më parë, por edhe me ata që kanë mbaruar tani. Numri i atyre që kanë mbaruar shkollën e kuadrove bujqësorë është i madh, sepse kjo shkollë ka 8 vjet që është ngritur. Ajo është hapur atëherë kur kolektivizimi ishte akoma në fillim, por tani gjendja ka ndryshuar, kooperativa bujqësore ka kudo dhe kryetarë janë zgjedhur shumë nga ata njerëz që kanë një eksperiencë të madhe praktike. Prandaj çështja e kryetarëve duhet parë posaçërisht dhe në shkollë të dërgohen nga ata që janë të aftë për kryetarë, në mënyrë që edhe kur të mbarojnë mësimet, asamblëtë t'i zgjedhin përsëri. Të mos dërgohet në shkollë ndonjë që masa nuk e zgjedh edhe pasi të mbarojë shkollën.

Mendoj të krijojmë një kurs, në të cilin të sjellim disa kryetarë të afirmuar. Në këtë kurs të ketë një program të tillë që këta kryetarë të ndihmohen për të rritur dituritë e tyre agroteknike dhe drejtuese. Të kihet parasysh që kryetarët të mos ngarkohen me gjëra që i dinë. Prandaj të rishikohet programi i kësaj shkolle, të krasiten lëndët e tepërta, të bëhet e mundur që njerëzit që do të dërgohen të mos qëndrojnë gjatë në këtë shkollë, po të mbarojnë shpejt mësimet dhe të kthehen në punë. Por edhe sikur të qëndrojnë dy vjet, kjo kohë të vlejë për të marrë njohuri të një cilësie të lartë.

Çështja e grumbullimit në këtë material ka hyrë si qimja në vezë, sa për të kaluar radhën. A nuk është më mirë ta merrnim në shqyrtim këtë problem në një mbledhje të veçantë, me qëllim që gjendja të përmirësohet?

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# PROBLEMET E ORGANIZATËS SË GRUAS NUK MUND TË ZGJIDHEN SI DUHET NË RAST SE NUK BËHEN PROBLEME TË PARTISË

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

23 qershor 1961

Problemi i gruas ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe shoqërore. Partia i ka kushtuar këtij problemi një vëmendje të veçantë. Si rezultat, në zhvillimin e gruas së vendit tonë janë bërë përparime të mëdha. Megjithëkëtë, jemi të ndërgjegjshëm se emancipimi i mëtejshëm i saj pengohet nga një radhë konceptesh të vjetra, që janë sidomos në kokën e burrave. Po nuk u kuptua kështu kjo çështje, atëherë nuk do të mund të luftojmë si duhet për ecjen e gruas gjithnjë e më përpara. Natyrisht, kjo është njëra anë e problemit, ana tjetër është që gruan ta edukojmë vazhdimisht, të bëjmë

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua puna e Partisë me gruan në fshat.

që t'i ngrihet më lart personaliteti, të rritet niveli arsimor dhe kulturor i saj.

Mendoj se duhen bërë më shumë konferenca me burrat për rëndësinë shoqërore të gruas, për emancipimin e saj të plotë, ashtu siç zhvillohen konferenca të tilla edhe me vetë gratë. Po ta zhvillojmë më mirë se deri tani këtë punë, jam i bindur se do të bëjmë një kërcim të madh përpara. Të marrim një shembull. Në rast se burri e kupton mirë barazinë e gruas me veten e tij, ai nuk duhet të lejojë ngarkesën e gruas, as veshjen e saj me çitjane e mbulesën me çarçaf. Siç u ngrit këtu nga shokët, është plotësisht e drejtë dhe e domosdoshme heqja e ngarkesës nga kurrizi i gruas. Edhe unë them që ta shohim mirë këtë çështje, po të duan burrat le të ngarkohen vetë, por gruaja në asnjë mënyrë të mos ngarkohet.

Ose të marrim një problem tjetër, atë të administrimit të të ardhurave në familje. Në qoftë se bëjmë që burri të kuptojë se edhe gruaja është e aftë të administrojë, kemi arritur një sukses. Pse e them këtë? Këtë e them sepse gruaja është një administratore dhe nikoqire e ndershme. Ajo nuk shkon në kafene dhe nuk e prish lekun kot. Kjo u duhet sqaruar burrave. Ta bëjmë burrin që kur merr rrogën, t'ia japë gruas, e cila ka mundësi t'i administrojë më mirë të ardhurat e familjes. Në këtë mënyrë ajo do të bëhet një forcë më e madhe.

Çështja e administrimit të të ardhurave në familje ka një rëndësi të madhe. Mentaliteti i vjetër borgjez dhe mikroborgjez ishte që kush kishte paratë në dorë, ai kishte pushtetin në familje, ai sundonte. Këtë mentalitet duhet ta zhdukim sidomos në burrat e atë më

tepër tani që gruaja punon e kontribuon njëlloj si burri. Po t'i hiqen burrit paratë nga xhepi, ai do ta dëgjojë gruan edhe më mirë. Natyrisht, të ardhurat e familjes në fillim mund të administrohen bashkërisht, nga burri dhe gruaja, por të synohet që gradualisht këto të kalojnë në duart e gruas. Kjo do të sjellë edhe ndryshime në mentalitetin e njerëzve, gruaja në shtëpi do të ketë votë të barabartë në diskutimet me burrin, midis tyre do të ketë një mirëkuptim më të madh etj.

Gruaja ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe edhe si nënë, edhe si edukatore e brezit të ri. Rinia, deri në një farë kohe sa të fitojë personalitetin e vet, do të kalojë nga duart e nënës dhe më pak nga duart e babait. Prandaj këtë çështje mendoj t'ia ngremë me forcë në një frymë të tillë Partisë dhe kjo ta shtrojë në popull.

Gruaja tani merr pjesë gjerësisht në punë, aq sa ne kemi vështirësi për t'i siguruar fronte pune, sidomos në qytet. Në fshat, të ndihmohet gruaja për të përvetësuar agroteknikën, e cila ka rëndësi të madhe për zhvillimin e bujqësisë. Por agroteknika nuk mësohet duke dërguar gra të moshuara në kurse e shkolla, por duke dërguar gra dhe vajza. Po të veprohet kështu, në bujqësi do të bëhet një përmbysje e madhe. Pjesëmarrja e gruas në punë është një sukses i madh dhe ka rëndësi për emancipimin e saj. Në të kaluarën, gruaja në përgjithësi ka punuar brenda mureve të shtëpisë, ndërsa tani sulmon në sektorë të ndryshëm jashtë shtëpisë. Kjo është një fitore e madhe, të cilën Partia duhet ta çmojë mirë.

Çlirimin ekonomik të gruas duhet ta kuptojë, në radhë të parë Partia, e cila është e domosdoshme të

influencojë edhe në masat e gjera të popullit, sidomos te burrat. Kjo është një nga hallkat kryesore në luftën për emancipimin e plotë të gruas. Fakti është se gruaja në fshat jo vetëm punon në bujqësi, por kryen edhe punët e shtëpisë, që janë një barrë e madhe për të, dhe që burrat duhet ta vlerësojnë si duhet. Mentaliteti në vendin tonë është që punët e shtëpisë duhet t'i bëjë vetëm gruaja. Natyrisht këtë mentalitet ne nuk e zhdukim dot menjëherë jo në fshat por as në qytet. Prandaj, për të lehtësuar gratë ka rëndësi çelja e çerdheve për fëmijët në kooperativat bujqësore. Kjo të mos kuptohet si një çështje luksi, por si një çështje që lehtëson gruan, po kështu edhe ngritja e furrave kolektive.

Në përgjithësi, njerëzit tanë që dikur ishin të shtypur dhe i çliroi revolucioni popullor, karakterizohen nga një entuziazëm i madh. Masa të tëra njerëzish që atëherë ishin të prapambetur dhe me nivel të ulët kulturor, tani kanë vërshuar nëpër shkolla, dyert e të cilave janë të hapura për ta. Këtë ndryshim e shohim edhe te gruaja, e cila në të kaluarën ka vuajtur shumë, ndërsa tani janë çelur për të perspektiva të ndritura, prandaj ajo është e gatshme të përqafojë me dashuri vijën e Partisë, të ecë në rrugën e gjerë të emancipimit të plotë të saj.

Unë jam shumë i kënaqur që në fshatra djemtë zënë 53 për qind të efektivit të nxënësve në shkollat 7-vjeçare dhe vajzat 47 për qind. Ky është një sukses i madh. Të insistojmë që të ndjekin sa më shumë vajza shkollën 7-vjeçare, sepse, kur të bëhen gra, nuk e kanë lehtë të vazhdojnë shkollën e mbrëmjes, se gratë lodhen edhe gjatë ditës në punë si edhe në punët e shtëpisë e

me fëmijët, pastaj ka dhe burra që i pengojnë. Në kushtet e sotme, e kanë vështirë të vazhdojnë shkollën e mbrëmjes jo vetëm gratë e martuara, por edhe vajzat, prandaj të luftojmë me forcë kundër mentalitetit që ekziston te ne për vajzën, sipas të cilit, po të vejë në shkollën e mbrëmjes, vajza nuk e ka të lehtë edhe të martohet. Ky është një problem shoqëror. Prandaj të ngulim këmbë që ato të vazhdojnë jo vetëm shkollat e mbrëmjes, por edhe shkollat profesionale.

Mendoj që edhe në përdorimin e formave të punës për problemet e gruas të mos jemi të shtrënguar. Edhe Partia që ka një strukturë tjetër organizative dhe një disiplinë më të fortë, përsëri gjen forma të përshtatshme pune, ca më tepër kjo mund të bëhet në organizatat e masave. Kështu, për shembull, ne duhet të insistojmë për edukimin e grave të reja, por të mos lëmë pa përfshirë në punën edukative edhe gratë e kaluara nga mosha, të cilave bashkë me punën, t'u japim njohuri edhe mbi mënyrën e jetesës etj., sipas kërkesave dhe nevojave që kanë.

Kam një sugjerim për shoqet drejtuese të BGSH-së: mendoj që ato të kenë lidhje më të rregullta me aparatit e Komitetit Qendror, dhe jo vetëm me drejtorinë e organizimit. Puna e organizatës së gruas nuk mund të kufizohet vetëm me lidhjet që mbahen nëpërmjet drejtorisë së organizimit, prandaj të shtohen e të forcohen këto lidhje me të gjitha drejtoritë e Komitetit Qendror. Problemet e përgjithshme që preokupojnë organizatën e gruas nuk mund të zgjidhen si duhet në rast se nuk bëhen probleme të Partisë. Nga ana tjetër, organizatës së gruas duhet t'i sinjalizohen probleme të veçanta, të

cilat ajo mund t'i zgjidhë duke mobilizuar të gjithë aktivin e vet. Por puna e gruas duhet të shoqërohet me punën e Partisë. Disa forma që përdor organizata e gruas janë të mira, po drejtoria e organizimit nuk duhet të mjaftohet me këtë. Në rast se punonjësit e drejtorisë së organizimit nuk i shikojnë dhe nuk i zbatojnë format e punës në jetë, nëpërmjet zhvillimit të luftës, atëherë ato do të mbeten të vdekura, të thata dhe nuk do të kenë efikasitetin e duhur. Prandaj gjërat duhen parë në jetë, në bazë. Për këtë drejtoria e organizimit nuk duhet të shkëputet nga aktiviteti i gjithë Partisë, nga jeta, nga lufta e anëtarëve të saj, vetëm kështu këto forma do të jenë të gjalla, do të kenë vlerë. Edhe vetë drejtoria e organizimit duhet të jetë më e gjerë dhe me më tepër inisiativë për organizatat e masave. Ne kemi në krye të këtyre organizatave shokë dhe shoqe që janë me inisiativë, të përgatitur, me pikëpamje të drejta. Ajo që kërkohet është të forcohet më shumë udhëheqja e Partisë dhe të zhvillohet aktiviteti sipas rrethanave dhe kushteve, sipas krahinës, lokalitetit ose fshatit. Kjo do të ngjallë një entuziazëm, mobilizim dhe patriotizëm më të madh të njerëzve për të kryer detyrat që kanë përpara.

Ka të drejtë shoqja Zina Franja<sup>1</sup> kur thotë se organizata e rinisë nuk tregohet aq aktive në lidhje me problemin e të rejave. Puna me të reja ka rëndësi të madhe, ato janë nënat e ardhshme, prandaj nuk duhet të qëndrojnë nën saçin e mentaliteteve të vjetra, por të

---

<sup>1</sup> Në atë kohë përgjegjëse e organizatës së gruas në rrethin e Shkodrës.



shpërthejnë e të luftojnë si duhet. Mirëpo kjo s'është e lehtë, sepse edhe të rejat janë në kontakt të përditshëm me nënën, me babanë dhe me shoqërinë ku kanë lindur dhe jetojnë. Megjithatë, ato janë një forcë e gjallë, plot dinamizëm, prandaj organizata e rinisë duhet të interesohej vazhdimisht për edukimin e tyre. Të arrijmë që organizata e rinisë të kuptojë rolin e së resë për gjallërimin e organizatës së gruas. Të rejat janë vërtet anëtare të organizatës së rinisë, po shumë prej tyre janë njëkohësisht edhe gra. Prandaj të gjenden forma të përshtatshme që të rejat të luajnë rolin e tyre edhe në organizatën e gruas. Nuk mundet që një e re të lërë një mbledhje shumë interesante që zhvillon organizata e gruas, sepse e thërret organizata e rinisë. Këtu duhen gjetur format më interesante, sepse nuk ka ndonjë mur që ndan organizatën e rinisë nga ajo e gruas. Ca më mirë kur organizata e rinisë punon për edukimin e të rejave dhe ato janë aktiviste të afta për organizatën e gruas. Mendoj që organizata e rinisë ta rishikojë punën e saj me të rejat si dhe forcimin e marrëdhënieve me organizatën e gruas.

Nuk është e drejtë pikëpamja që në krye të organizatës së gruas të ketë vetëm komuniste. Sigurisht komunistet janë më të zhvilluara dhe duhet të jenë në udhëheqje, por kjo nuk do të thotë që t'u mbyllen dyert grave pa parti. Prandaj rreth shoqeve komuniste në këshillat e grave të ketë edhe shumë gra pa parti. Të jemi të bindur se edhe gratë pa parti janë të flakta për Partinë dhe nuk kursehen të punojnë me organizatën e gruas.

Në përgjithësi mund të themi se në punën me gruan

ne kemi arritur suksese të mëdha. Këto suksese i detyrohen në radhë të parë Partisë, po edhe vetë punës së organizatës së gruas. Tani çështja shtrohet që këto suksese t'i forcojmë e t'i shpiem më përpara. Të metat që ekzistojnë, t'i korrigjojmë. Te gratë kemi një forcë të madhe që s'duhet ta lëmë pas dore. Partia ka besim të plotë në organizatën e gruas, në punën dhe në besnikërinë e shoqeve që janë në drejtim të saj, në qendër dhe në bazë. Ju shoqe që punoni me organizatën e gruas, ngulni më tepër këmbë përpara forumeve dhe shokëve të Partisë, insistoni dhe ua mblidhni pak atyre kur nuk e vlerësojnë si duhet organizatën e gruas, këtë levë të rëndësishme të Partisë, dhe të gjithë kemi për të parë se punët do të shkojnë më mirë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

# KURSIMI — METODË PUNE SOCIALISTE, DETYRË E MADHIE POLITIKE, EKONOMIKE, E PËRHERSHME PËR TË GJITHË

*Fjala në Plenumin II të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**1 korrik 1961**

Unë jam plotësisht dakord me raportin e paraqitur në këtë Plenum nga Byroja Politike, të mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror shoku Haki Toska, si edhe me diskutimet e shokëve që morën fjalën gjatë zhvillimit të punimeve të kësaj mbledhjeje të Komitetit Qendror për problemin e madh të kursimeve. Kjo është një gjë shumë e mirë. Partia jonë ka qenë vazhdimisht kompakte si në shqyrtimin e çështjeve ekonomike, ashtu edhe në çështjet ideologjike ose politike dhe këtu qëndron forca e pathyeshme e saj dhe e popullit, që ajo e udhëheq në rrugën e ndërtimit të socializmit.

---

<sup>1</sup> Ky Plenum i zhvilloi punimet e tij më 30 qershor dhe më 1 korrik. Dëgjoi dhe aprovoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbl masat që duhen marrë për forcimin e mëtejshëm të regjimit të kursimit».

Për problemin e kursimeve është bërë kudo një punë shumë e mirë. Ky nuk ishte një problem i ri për Partinë. Dihet se çështja e kursimeve është një detyrë e vazhdueshme dhe kështu duhet të jetë edhe në të ardhshmen. Inisiativat edhe më parë nga ana e Komitetit Qendror dhe e Qeverisë nuk kanë qenë të pakta në këtë çështje. Por megjithëse forma e punës nuk është origjinale, mund të themi se këtë radhë organizimi i punës për problemin e kursimeve ka qenë shumë i frytshëm, konkret dhe i shpejtë. Ky rezultat pozitiv, përqaqimi i shpejtë i kësaj çështjeje nga baza dhe nga masat e pullit ka arsytet e veta.

Në radhë të parë, është çështja e vijës së drejtë politike dhe organizative të Partisë sonë, e cila ka bërë që punonjësit, duke filluar nga më i thjeshti e deri te ata që janë në udhëheqje, të jenë të ndërgjegjshëm për detyrat e mëdha që u janë ngarkuar, të kuptojnë drejt dhe si duhet momentet aktuale politike, të jashtme dhe të brendshme, dhe të mobilizohen me një entuziazëm të madh për realizimin e detyrave dhe për tejkalimin e tyre, të tregohen të shkathët dhe me inisiativë në çdo sektor.

Një meritë të madhe në arritjen e sukseseve tona kanë klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjenca popullore, organizatat e masave, të gjithë kuadrot e Partisë, duke filluar që nga shokët e Plenumit të Komitetit Qendror, ministrat, drejtorët dhe shefat e seksioneve të aparateve qendrore e deri te drejtuesit në rrethe e në bazë. Edhe kjo është refleks i zbatimit të vijës së drejtë të Partisë.

Ne shohim një rritje, një hov të madh te njerëzit,

të eksperiencës dhe të zotësisë së kuadrove tanë. Çdo ditë dhe çdo vit konstatojmë me një kënaqësi legjitime që kuadrot tanë të bazës dhe të udhëheqjes kanë fituar një eksperiencë të madhe në praktikë, ata në shumicën dërrmuese janë pajisur edhe me shkencë. Nuk është e tepërt të themi se mburremi që kuadrot tanë tani dinë t'i kombinojnë këto gjëra, të japin prova, të kenë rezultate dhe të marrin inisiativa të lavdërueshme në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik të vendit.

Si kudo zhvillimi i ekonomisë ka rëndësi të jash-tëzakonshme, veçanërisht për vendin tonë, që ishte dhe akoma është më prapa në krahasim me disa vende socialiste, ai ka një rëndësi më të madhe për arsye se edhe mjetet që luajnë një rol të madh në zhvillimin e ekonomisë, te ne nuk janë aq të bollshme dhe të shumëllojta siç janë në disa vende të demokracisë popullore. Por mjete mund të kesh shumë dhe të mos dish t'i përdorësh si duhet, mund të kesh pak dhe të dish t'i shfrytëzosh si duhet e të kesh rezultate të mira. Mund të themi se ato që kemi, njerëzit tanë tani dinë t'i përdorin si duhet. Kjo ka rëndësi të madhe sidomos për këto momente që i kanë kuptuar kaq mirë njerëzit tanë, me parti dhe pa parti, në bazë dhe në qendër. Kjo i ka bërë ata, sidomos këto kohët e fundit, të bëjnë përpjekje kolosale, në të gjitha drejtimet, për shfrytëzimin racional të makinerisë, për t'i dhënë popullit më shumë prodhime.

Ne luftojmë për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, ky është ligji ynë. Por rritja e vazhdueshme e mirëqenies kërkon që problemin kryesor të kursimeve ta kemi kurdoherë parasysh. Mund të kesh shumë, por

kjo nuk do të thotë që pasurinë e përbashkët ta shfrytëzosh keq, të livadhisësh me këtë pasuri, sepse në këtë mënyrë do të përfitojnë vetëm disa njerëz të pandërgjegjshëm. Si pasojë, në vend që të krijojmë bollëkun që duhet për popullin, në vend që t'i japim atij prodhime më shumë, më të mira dhe më të lira, do të notohet në parulla e premtime dhe ritmet e zhvillimit ekonomik, megjithëse mjetet i kemi dhe jemi në gjendje t'i sigurojmë, nuk do të jenë ato që kërkojmë.

Në vendin tonë, të drejtuar nga Partia jonë e lavdishme, nuk mund të themi se nuk ka të meta, prishje dhe shpërdorime të pasurisë socialiste. Të mohosh këtë do të thotë të mbyllësh sytë. Por një pjesë e këtyre të metave për një kohë ka ardhur nga mungesa e ngritjes teknike të njerëzve, nga të metat e punës organizative etj. Por nuk duhet përjashtuar se mjaft prej tyre vijnë edhe nga moskokëçarja, nga mungesa e kontrollit, e organizimit, e përgjegjësisë, për shkak se nuk është punuar sa duhet për t'u ngritur ndërgjegjja socialiste e njerëzve. Disa nuk kuptojnë akoma si duhet se malli i shtetit, prona socialiste, është e paprekshme, se nga mbarëvajtja e pronës socialiste, nga mbrojtja e saj, nga përdorimi me nikoqirllëk i saj, varet interesi personal i secilit. Dhe njerëz të tillë ka edhe në radhët e Partisë.

Partia jonë i sheh dhe i lufton të metat. Është fakt se Partia është kurdoherë në lëvizje dhe në luftë kundër pikëpamjeve dhe qëndrimeve mikroborgjeze, kundër vjedhjeve, shpërdorimeve, neglizhencave, ajo i edukon njerëzit si ta organizojnë më mirë punën etj.

Ne shohim një rritje të madhe të forcave krijuese të popullit. Këtë e kemi parë kurdoherë si gjatë luftës

dhe gjatë periudhës pas Çlirimit, e po e shohim veçanërisht këto kohët e fundit. Pas Kongresit IV të Partisë duket kudo një rritje e papërshekruar e entuziazmit të masave të popullit, e dashurisë dhe e besnikërisë së tyre të madhe ndaj Partisë, e përpjekjeve për zbatimin me përpikëri dhe me të gjitha forcat e në mënyrë revolucionare të direktivave të Partisë. Këto cilësi nuk blihen; këtë besim, ndërgjegje e besnikëri ndaj popullit dhe atdheut, i ka edukuar te njerëzit Partia jonë. Këtij hovi të madh revolucionar, kësaj kompaktësie të madhe në mes popullit dhe Partisë nuk mund t'i vësh çmim. Jo vetëm kaq, por kjo është një forcë e tillë që çdo gjë që gjen përpara, çdo vështirësi e pengesë, çdo punë armiqësore e kapërcen, e shtyp dhe triumfon.

Këto nuk janë fjalë boshe, por realitet dhe ky realitet nuk fabrikohet. Është zor ta mobilizosh popullin për një çështje të gabuar, për një qëllim jo të drejtë, po të jesh në rrugë të gabuar, populli nuk të ndjek. Atëherë ky realitet vërteton se sa e drejtë është vija e Partisë sonë në të gjitha çështjet dhe se barometri më i sigurt i drejtësisë së vijës së Partisë sonë është populli. Pra ne mund të themi me bindje të plotë se vija e Partisë sonë është e drejtë, se populli është qind për qind dhe për çdo gjë me Partinë. Kjo është një forcë kolosale dhe në këtë forcë ne duhet të mbështetemi vazhdimisht.

Partia jonë kurdoherë ka vepruar dhe ka zbatuar vijën e saj duke u mbështetur te populli. Kështu ajo ka krijuar bindje të thella te njerëzit për vijën e saj të drejtë. Kur ia thua haptazi popullit si të mirën, ashtu edhe hallet, vështirësitë, gabimet ose të metat, ai të

kupton, të ndjek dhe të jep forca të reja. Forca e Partisë sonë qëndron në lidhjet e saj me popullin.

Një çështje e tillë mjaft e rëndësishme si kjo e kursimeve u përçafua menjëherë nga kuadrot e punonjësit tanë dhe u arritën shpejt rezultate. Kjo nuk erdhi si pasojë se ne tani kemi teknikë dhe njerëz të zotë, po kryesorja është te kuptimi i drejtë i situatës, te vija e drejtë e Partisë që në çdo çështje ajo mbështetet te masat dhe zgjidh çdo problem, qoftë ai edhe më i rëndë. Kjo ka qenë dhe është karakteristika e Partisë sonë e cila hedh poshtë akuzën e revizionistëve modernë, që e cilësojnë si sektare. Nuk them vetëm për revizionistët jugosllavë, por edhe për ata sovjetikë.

Revizionistët kanë lëshuar parullën se Partia jonë është «dogmatike», «sektare», gjë që s'është aspak e vërtetë. Le t'u bien sa të duan kambanave, karakteristika e Partisë sonë ka qenë, është dhe do të mbetet marksizmi i kulluar, që i jep asaj jetë. Një nga karakteristikat dalluese të Partisë sonë është lidhja e saj e ngushtë me masat. Këto lidhje janë konkrete, të mbrujtura me gjakun, me punën dhe me djersën e njerëzve të Partisë dhe të popullit tonë. Këto lidhje bënë të mundur edhe në këtë rast që mbi shifrat e planifikuara të kursehen edhe 1,7 miliard lekë, shumë kjo jo e vogël. Byroja Politike i ka rekomanduar Qeverisë që këto shifra të përfshihen në format përkatëse në planin e shtetit dhe të bëhen përpjekje që të realizohen, sepse ato do të na nxitin për kursime të tjera. Gjatë diskutimeve doli se kemi akoma mundësi të bëjmë kursime dhe kështu është. Gjatë çdo viti të pesëvjeçarit rezervat e brendshme që krijon zhvillimi i ekonomisë, të cilat



nuk duhet t'i lëmë të flenë në asnjë mënyrë ose të shpërdorohen, t'i zbulojmë, t'i shfrytëzojmë dhe të bëjmë që t'i jepet sa më shumë popullit. -

Ne duhet të bëjmë ekonomi edhe për gjërat e mëdha por edhe për gjërat e vogla. Të voglat nuk duhet t'i neglizhojmë. Të krijohet kjo edukatë në njerëzit duke filluar qysh në bankat e shkollës. Kjo çështje nuk duhet parë në kuptimin mikroborgjez, s'duhet menduar se tani ne po ndërtojmë socializmin prandaj nuk duhet të kursejmë. Nuk është kështu, ne duhet medoemos të kursejmë, sepse kursimi sjell bollëkun, krijon mirëqenien, rrit nivelin ekonomik e kulturor. Ne duhet t'i mësojmë njerëzit që vazhdimisht të bëjnë ekonomi, të kursejnë dhe këto kursime t'i venë përsëri popullit.

Unë nuk them se kemi qenë dorëlëshuar. Por situatat që janë krijuar na kanë bërë të jemi pak më të shtrënguar, natyrisht pa e penguar zhvillimin e ekonomisë. Byroja Politike shumë herë ka porositur të rikuperoheshin tubat e naftës, por ata nuk shfrytëzoheshin në masën e duhur nga punonjësit e naftës. Në të vërtetë kjo porosi është pranuar nga të gjithë, por nuk është vënë në jetë në mënyrë sistematike. Pasi të mbarohet punë me këta tuba, të hiqen atje ku janë dhe të vendosen për t'u përdorur përsëri gjetkë. Nga një punë e tillë dalin mijëra metra tuba. Këtë gjë nuk duhet ta bëjmë vetëm tani, por edhe kur të kemi industrinë tonë të përpunimit të hekurit. Nuk do të thotë se, duke prodhuar vetë hekurin në të ardhshmen, nuk do të ecim me kursim, ne do ta ruajmë atë, se do të kemi ku ta përdorim.

Prandaj në këtë drejtim duhet të mobilizohemi të

gjithë, të kemi kujdes që si në shtëpitë tona, si në buxhetin tonë familjar të veprojmë edhe për çështjet shtetërore, bile dhe ca më tepër. Në shtëpi secili është përgjegjës dhe bën ç'të dojë, rrogën kushdo mund ta hajë edhe brenda 10 ditëve dhe pastaj, po të dojë, «t'i bjerë daulles», por nuk mund të lejohet që pasuria e shtetit të shpërdorohet në mënyrë të paligjshme.

Edhe te ne ka shumë fakte që duhet të na bëjnë të mendojmë edhe për mirë, edhe për keq. Ka akoma raste të qëndrimeve jo të drejta, por më shumë kemi shembuj të mirë. Në këto situata karakteristike janë iniciativat e mëdha krijuese të masave në të gjitha ndërmarrjet, të cilat jo vetëm bëjnë të realizohen planet ekzistuese, por ato synojnë edhe në drejtimin që të prodhohen në vend edhe mjaft mallra që akoma i sjellim nga jashtë. Kjo është një iniciativë për t'u lavdëruar që duhet ta çojmë përpara. Nuk është çështja e ngritjes vetëm të një fabrike çimentoje si ajo që tha shoku Josif Pashko e që ka rëndësi të madhe, por duhet menduar edhe për gjëra të vogla, deri te krëhëri dhe maja e penës. Ne duhet të shtojmë prodhimet në vend në një gamë të madhe që nga mallrat e konsumit të gjerë deri te makineritë.

Ne nuk pretendojmë të bëjmë menjëherë makineri të mëdha në vend, por të vogla uzinat tona mund dhe duhet t'i bëjnë. Në këtë drejtim ka plot iniciativa, por ato duhen inkurajuar, ndihmuar dhe shoqëruar. Ndihma në këtë drejtim nuk duhet mjaftuar vetëm me fjalë, ajo duhet të jepet në mënyrë të organizuar. Për she-mbull, është një punë shumë e mirë që shokët e naftës kanë arritur të prodhojnë deri në 80 për qind të veglave

të ndërrimit, por duhet punuar edhe më tej dhe që të arrihet të shtohen akoma ato, duhet bërë grumbullimi, sistemimi dhe centralizimi i ofiçinave. Në industrinë tonë ka shumë rezerva. Në mjaft ofiçina do të shikosh deri dy-tri torno e më shumë. Tani ka ardhur koha që ato të përqëndrohen, si ato të industrisë ashtu edhe ato që janë në bujqësi e kudo ku ka makineri. Kjo do të na japë shumë dorë për shfrytëzimin në maksimum të tyre, do të na ndihmojë që të kemi një plan të qartë për zëvendësimin e veglave të ndërrimit dhe për fabrikimin e shumë mallrave që ose na mungojnë ose i kemi të pakta, apo nga ato që sjellim nga jashtë. Duke bërë sa më parë këtë punë do të arrijmë rezultate të rëndësishme për zhvillimin e ekonomisë. Si çështja e tornove ka edhe mjaft çështje të tjera.

Po ka edhe qëndrime negative. Të marrim për shembull Durrësin. Atje nuk është problem vetëm çështja e depove. Jam dakord me shokët që thanë se depo na duhen akoma dhe duhet të ngrihen të tjera të reja. Zhvillimi i ekonomisë, i importit dhe i eksportit kërkojnë që ne të ndërtojmë depo edhe më shumë në të ardhshmen. Por nuk ka qenë arsyeja e depove gjendja skandaloze në ndërmarrjen e farërave, ku janë shkatërruar dhe janë shpërdoruar gjithë ato mjete për shkak të qëndrimeve kriminale që janë mbajtur ndaj pasurisë së shtetit. Duhet thënë se në këtë ndërmarrje dhe në mjaft ndërmarrje të tjera të Durrësit nuk është në lartësinë që kërkohet vigjilenca revolucionare e Partisë dhe e pushtetit.

Komiteti Qendror ka theksuar dhe thekson preokupimin e jashtëzakonshëm dhe të vazhdueshëm që

duhet të kenë organet lokale të Partisë dhe të pushtetit për çdo gjë që ndodh në rrethin e tyre, pavarësisht se ndërmarrjet apo entet janë me karakter nacional apo lokal. Udhëheqja në rreth ta ketë të qartë se nuk mund të heqë përgjegjësinë që ka për realizimin e planeve në të gjitha ndërmarrjet që ekzistojnë në rreth. Prandaj ato duhet të marrin masa partie brenda kompetencave të tyre, ose të ndërhyjnë menjëherë në Qeveri apo në Komitetin Qendror për rregullimin e një situatë, që është jashtë kompetencave të komitetit të Partisë ose të komitetit ekzekutiv të kp të rrethit. Çrregullimet që vërtetohen nëpër ndërmarrjet nacionale nuk i shkarkojnë nga përgjegjësia komitetet e Partisë apo komitetet ekzekutive të kp të rretheve.

Çështja, shokë sekretarë të parë të komiteteve të Partisë të rretheve, nuk qëndron vetëm te kuadri. Dakord, çështja e kuadrit ka rëndësi të madhe. Por eksperiencia tregon se, po të mos qëndrojë Partia në krye të ndërmarrjeve industriale ose të atyre bujqësore, sado kuadro të mirë të ketë atje, mungesa e kontrollit dhe e ndihmës së Partisë dhe të pushtetit, mungesa e zbatimit të ligjeve në të, bëjnë që edhe kuadrot më të mirë të bien në gabime, ndoshta jo shumë të rënda në fillim, por kjo pozitë do t'i çojë njerëzit në rrëshqitje sa të detyrohemi pastaj të marrim masa të rënda kundër tyre. Në këtë drejtim duhet t'i mbajmë përgjegjësitë plotësisht.

Përgjegjësitë duhet të mbahen edhe për një arsye tjetër. Ekonomia jonë zhvillohet, pra zmadhohen, forcohen industria, bujqësia, etj. Këtë pesëvjeçar do ta shtojmë akoma më shumë fuqinë e industrisë sonë

edhe me ngritjen e një sërë ndërmarrjesh kryesore, përveç shumë të tjerave më të vogla. Për ndërtimin e tyre është parashikuar çdo gjë, edhe kuadrot. Kuadrot që do t'i drejtojnë të gjitha këto vepra nuk janë të përgatitur të tërë, një pjesë jemi duke i përgatitur tani.

Kuadrot e rinj, sigurisht, mund të mos jenë në atë nivel të lartë drejtimi sikundër janë ata që punojnë tani në naftë, në industrinë e tekstileve, në uzinat e në sektorë të tjerë. Për t'i ndihmuar kuadrot e rinj duhet që një pjesë e kuadrove, të cilët aktualisht punojnë në veprat që kemi ndërtuar, të shkojnë për të drejtuar objektet e tjera të reja që po ndërtojmë gjatë këtij pesëvjeçari.

Çështjen e kam te interesimi që duhet të tregojnë komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive në drejtim të objekteve me karakter nacional. Ky interesim është tani shumë i nevojshëm, sepse kjo do të ndihmojë që puna në këto objekte të ecë më mirë për realizimin e detyrave. Organeve lokale të Partisë dhe të pushtetit në rreth këtej e tutje u bie barra edhe në këtë drejtim, sepse është e pamundur që Ministria e Industrisë me zhvillimin e madh të industrisë në këtë pesëvjeçar të mund të drejtojë në mënyrë operative dhe si duhet edhe fabrikën e niseshtesë ose një fabrikë tjetër qoftë edhe më të madhe. Ndihma e organeve lokale të Partisë dhe të pushtetit do të lehtësojë, dhe duhet të lehtësohen, edhe ministritë. Komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të kp të rretheve duhet të drejtojnë një ekonomi më të fuqishme se sot dhe jo vetëm atë me karakter lokal. Natyrisht kjo punë do të bëhet

mirë në rast se shokët e rretheve do të interesohen akoma më shumë se deri tani.

Ne mund të themi pa u gabuar se drejtimi i ekonomisë në rrethe shkon përpara. Ne shohim tani një aftësi më të madhe drejtuese nga kuadrot që janë poshtë dhe një kuptim akoma më të drejtë të përgjegjësisë të shokëve të rrethit për ekonominë, për ndërmarrjet nacionale ose lokale. Ky kuptim dhe ky interesim duhet të shtohen tani që ekonomia do të forcohet akoma më tepër. Prandaj në këtë drejtim ju duhet të keni më shumë inisiativë.

Të marrim shembull punën e ekipeve që u dërguan nga Komiteti Qendror dhe nga Qeveria në rrethe për çështjen e kursimeve. Ju thatë vetë se ekipet ju kanë dhënë një ndihmë të madhe dhe kështu është. Çdo vit janë dërguar ekipe të tilla për probleme të ndryshme të ekonomisë, të industrisë, të bujqësisë etj. Edhe në të ardhshmen do të dërgohen përsëri ekipe. Por ju nuk duhet të mjaftoheni vetëm me punën e ekipeve që ju dërgohen nga lart. Kur shikoni se një ose dy ndërmarrje nacionale ose lokale nuk shkojnë mirë, të keni inisiativë, të mos prisni vetëm nga lart, por me mundësitë tuaja dhe në një moment të caktuar, krijoni ekipe për të shëruar një situatë të sëmurë që mund të jetë krijuar atje. Prandaj të mos ju mungojë inisiativa në këto çështje.

Rrethet janë duke u forcuar vazhdimisht me kuadro. Shokë drejtues të rretheve, kini kujdes të madh për kuadrot e çdo sektori qoftë. Ju jeni në udhëheqje dhe duhet të kuptoni se edhe te kuadrot me stazh ka momente ngritjeje, ka edhe momente rënieje. Udhëheqja

duhet të jetë në gjendje dhe në atë shkallë që t'i ketë në dorë kuadrot, t'i ndihmojë sa duhet kur ata kanë nevojë. Atje ku kuadri ecën përpara lëreni të ecë, mos ia prisni inisiativën. Kuadrot e vjetër drejtues dhe teknikë duhet t'i respektojmë dhe të tillë tani kemi plot, me parti dhe pa parti, që janë mobilizuar totalisht për realizimin e detyrave. Për këta duhet të kemi kujdesin më të madh se janë thesar i madh për Partinë, por duhet të keni kujdes të madh veçanërisht për kuadrot e rinj që dalin nga teknikumet dhe universiteti. Vetëm këtë vit ekonomia do të marrë rreth 600 kuadro universitarë, të ditës dhe të natës, domethënë dyfishin e numrit që ishin përgatitur gjatë 15 vjetëve të regjimit të Zogut.

Kuadrot e rinj të trajtohen si duhet, të mos i quajmë të rinjtë pa eksperiencë, sepse eksperiencën teorike ata e kanë, atyre u mungon vetëm praktika. Është e vërtetë se ata nuk mund të krahasohen me kuadrot e vjetër, por duke marrë parasysh prejardhjen e tyre dhe luftën që bën populli, edhe ata, pavarësisht se kanë qenë në teknike, në universitet apo në institute, janë mbrujtur me luftën teorike dhe praktike të popullit, janë njerëz të devotshëm të popullit, me hov revolucionar, me dashuri të madhe për Partinë. Kuadrot tanë të mbrujtur me të tilla virtyte ne nuk i krahasojmë kurrë me ata të disa vendeve socialiste, të cilët nuk bëjnë një jetë të lidhur me popullin, me vuajtjet dhe djersën e tij, përkundrazi janë mësuar e po mësohen me një jetë të shthurur shoqërore të krijuar në rrethanat aktuale të tyre. Këtë nuk e shohim në kuadrot tanë. Prandaj, kur thërriten kuadrot e rinj për t'i

pyetur dhe për t'u thënë se ku mendojnë t'i dërgojmë, ata përgjigjen: nuk ka pse të pyetemi që të shkojmë këtu ose atje, na dërgoni ku mendon Partia! Një gjë e tillë ndodh vetëm në ato vende si te ne, në Shqipëri, ku Partia është në pozita të shëndosha marksiste-leniniste, e lidhur ngushtë me popullin.

Prandaj, duke menduar ç'thesar kemi te kuadrot e rinj që dalin nga shkollat, njerëzit e Partisë dhe të pushtetit të kenë kujdes që t'i trajtojnë si duhet, të udhëhiqen në këtë çështje nga pikëpamje të drejta marksiste, se vërehen edhe neglizhenca në këtë drejtim, por, po të jetë Partia e zgjuar, puna do të shkojë mirë.

Sovjetikët na i hoqën specialistët, çekët po ashtu, bullgarët jo, megjithëse këta janë të paktë dhe nuk kanë ndonjë peshë të madhe. Këta specialistë, bile disa edhe nga ata që deri dje shanin hapur udhëheqjet e tyre dhe mbronin çështjen e drejtë të Partisë dhe të popullit tonë, të nxitur nga ambasadat e tyre, u detyruan të bëjnë kthesë, bile të manifestonin sjellje të tilla skandaloze që asnjë rrugaç nuk mund t'i bënte. Të instruktuar nga udhëheqjet revizioniste të vendeve nga kishin ardhur, ata filluan veprimtarinë sabotuese në vendin tonë.

Udhëheqja sovjetike me Hrushovin në krye dhe ata që e pasojnë, me tërheqjen e specialistëve të tyre, na krijuan situata të vështira duke menduar se ne do të thyheshim dhe çdo gjë do të binte në ujë, domethënë do ta nënshtronin Partinë tonë, por ata shpresuan kot. Kuadrot tanë, me eksperiencën që kishin, morën plotësisht në dorë drejtimin e punëve që lanë specialistët e huaj dhe mund të themi se punët po na ecin mirë.



Planet në vendin tonë nuk janë realizuar asnjëherë si këtë vit. Këtë e bëri i gjithë ky kompleks ngjarjesh që thashë dhe në këtë kompleks është për t'u vënë në dukje veprimtaria dhe zotësia e kuadrove dhe e teknikëve tanë.

Le të marrim sektorin e gjeologjisë ku ka punuar numri më i madh i specialistëve sovjetikë, të cilët kanë ardhur për të na ndihmuar, po nuk dihet disa mund edhe të na kenë sabotuar<sup>1</sup>. Ata i kanë dhënë raporte qeverisë së tyre për ato që kanë zbuluar dhe mendojmë se ata dinë shumë gjëra mbi pasuritë tona që neve nuk na i kanë bërë të ditura. E them këtë se derisa ishin specialistët sovjetikë të gjeologjisë për një lloj minerali ishin dhënë informata se kishim një milion tonë rezerva, kurse brenda tre-katër muajve pas largimit të tyre, gjeologët tanë, duke studjuar gjendjen, kanë thënë se kjo shifër do të arrijë në dy e gjysmë dhe gjer në tre milion tonë dhe se brenda këtij viti, gjer në 20-vjetorin e themelimit të Partisë sonë do të realizohet plani i pesëvjeçarit të tretë që është caktuar nga Kongresi vetëm për këtë sektor.

E kam çështjen këtu që tentativa për të na dëmtuar ekonomikisht janë bërë, por ato dështuan. Kuadrot tanë tani i janë futur punës me vetëmohim dhe nuk janë në nivel të ulët si mendonin disa njerëz jashtë. Kjo, shokë, duhet kuptuar drejt. Ne nuk mund të mjaftohemi me këtë gjendje, të jemi të kënaqur dhe të themi se çdo gjë te ne u arrit. Shkenca është një

---

<sup>1</sup> Koha e vërtetoi më së miri këtë. Në materialet e mëvonshme kjo do të argumentohet me fakte.

gjë e madhe dhe pa fund. Ajo ka bërë dhe bën hapa kolosalë përpara, dhe në krahasim me këto përparime ne jemi akoma shumë prapa. Prandaj do të kemi kur-dcherë nevojë për ndihmën e shkencës dhe të teknikës së përparuar. Ne do ta kërkojmë dhe do ta marrim edhe nga vendet e tjera këtë ndihmë, sepse nga ana teorike nuk mund të pengohemi, se fundi shkenca nuk mbyllet në dollap. Por situatat aktuale janë të tilla që kjo ndihmë dhe eksperiencë nga disa vende socialiste nuk na jepet.

Ne mendojmë se udhëheqjet e vendeve socialiste të Evropës janë në rrugë antimarksiste. Kjo situatë mund të vazhdojë për shumë vjet, por Partia dhe populli ynë nuk do të vdesin, populli dhe marksizëm-leninizmi nuk vdesin kurrë.

Ne do të pranojmë ndihmën e sinqertë, të pastër, marksiste-leniniste, kush nuk na e jep atë turp për të dhe me siguri këta njerëz do të vijë dita që të japin llogari patjetër.

Ne në rrugën tonë nuk jemi vetëm, nuk jemi të izoluar. Të gjithë specialistët, për të cilët kemi nevojë tani, na dërgohen nga RP e Kinës, e cila po i jep një ndihmë vëllazërore, internacionaliste vendit tonë. Ashtu si na ka ndihmuar Stalini, ashtu sot na ndihmon e kujdeset për Shqipërinë shoku Mao Ce Dun. Çekoslovakët kërkojnë t'u paguajmë 250 mijë lekë në muaj për një specialist të tyre. Të kërkojmë për një specialist 250 mijë lekë në muaj kjo është 10-11 herë më shumë se rroga e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror ose e Kryeministrit të Shqipërisë!

Çështjen e kam që kuadrot që po përgatit Partia

dhe pushteti, këtë thesar të madh, t'i përdorim si duhet, në interesin e madh të popullit, të dimë të sillemi me ta si duhet, në mënyrë komuniste, sidomos me kuadrot e rinj. T'u rrimë këtyre afër dhe t'i ndihmojmë nga ana praktike, nga ana e jetesës dhe në çdo drejtim. Kuadrit të vjetër që i është regjur lëkura, si shokut Todo Manço, i cili ka eksperiencë të madhe, kërkoi shumë, kurse një kuadër i ri duhet ndihmuar më tepër.

Nuk dua të zgjatem më shumë në këtë çështje se raporti ishte i qartë dhe diskutime u bënë mjaft dhe të mira, po detyrat që dalin nga ky Plenum t'i zbërthejmë në jetë dhe t'i realizojmë. Momentet nuk janë të lehta, ju e kuptoni dhe e keni kuptuar drejt se këto situata u krijuan jo për fajin tonë, po të të tjerëve.

Situata ndërkombëtare në përgjithësi duhet konsideruar në favorin tonë, në favorin e socializmit. Kjo nuk është vetëm një formulë për të bindur njerëzit se ne jemi më të fortë nga imperializmi. Jo. Ky është një realitet. Forcat e socializmit, pavarësisht se tani ekzistojnë disa vështirësi dhe bile serioze, janë më të mëdha.

Duhet ditur se në kampin e imperializmit janë të theksuara kontradiktat midis shteteve. Kontradikta ata nuk kanë vetëm në luftën kundër socializmit. Në këtë drejtim ata puqen gati në të gjitha taktikat e tyre. Por në mes tyre ekzistojnë kontradikta, të cilat natyrisht ne duhet t'i shfrytëzojmë. Po ka shfrytëzim e shfrytëzim të këtyre kontradiktave. Ka shfrytëzim në mënyrë marksiste dhe revolucionare, ka edhe shfrytëzim me taktika të maskuara që në realitet nuk janë gjë

tjetër veçse metoda revizioniste që çojnë ujë në mulirin e armikut.

Natyrisht Partia jonë është një parti relativisht e vogël, por lufta e drejtë e saj për paqen dhe për bashkekzistencën paqësore, sidomos për ruajtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, është një kontribut me rëndësi në çështjen e madhe të komunizmit dhe të paqes. Pikërisht pse ky kontribut është i madh, prandaj kundër Partisë sonë janë drejtuar shigjetat e udhëheqjes sovjetike dhe të udhëheqjeve të tjera revizioniste të vendeve socialiste të Evropës. Ndryshe, në rast se ata nuk do të shikonin ndonjë rrezik për politikën e tyre revizioniste dhe oportuniste, atëherë nuk kishin arsye përse të luftonin një parti dhe një popull të vogël, heroik dhe të palëkundur. Por qëndrimi i Partisë sonë u djeg shumë, sepse vija e drejtë e saj u zbulon lakrat.

Mos ka thënë ndonjë gjë të re Nikita Hrushovi që hiqet si kampion i paqes dhe i bashkekzistencës paqësore? Jo, asgjë të re s'ka thënë! Nuk mund të ketë parti komuniste marksiste-leniniste dhe shtet socialist që të mos dojë e të mos luftojë për çështjen e paqes, kundër luftës. Kjo çështje nuk është një kurorë me diademë<sup>1</sup> sikurse kërkon politika revizioniste e Hrushovit, politikë e cila ka infektuar një sërë partish të tjera.

Stalini, që N. Hrushovi po e lufton si «kalë të ngordhur», ka qenë një udhëheqës i lavdishëm i proletarietit ndërkombëtar, i Bashkimit Sovjetik, mik i madh i popujve, i lirisë dhe i demokracisë, i cili ka luftuar gjatë gjithë jetës së tij për paqen dhe bashkekzistencën

<sup>1</sup> Kurorë koke e zbukuruar me gurë të çmuar.

paqësore midis vendeve me sisteme të ndryshme shoqërore. Lexoni çdo shkrim të Stalinit, ndiqni me kujdes jetën dhe luftën e tij për mbrojtjen e Bashkimit Sovjetik dhe të paqes dhe do të shihni se çdo masë dhe përpjekje e tij kanë pasur për qëllim forcimin e paqes dhe të Bashkimit Sovjetik, që në kohën e tij u bë kështjella e pamposhtur e lirisë, e socializmit dhe e paqes. Në kohën e tij, Bashkimi Sovjetik luftonte për dobësimin e forcave të imperializmit, për shkatërrimin e fashizmit, të cilin me të vërtetë e shkatërroi, me qëllim që popujt të rronin të lirë dhe në paqe, sepse paqja dhe liria nuk mund të vendosen pa u shkatërruar imperia- lizmi dhe luftënxitësit. Nën udhëheqjen e Partisë Komuniste (b) me Stalinin në krye, popujt e Bashkimit Sovjetik, me luftën, gjakun dhe me djersën e tyre, korrën fitore të mëdha.

Po të lexosh shkrimet e fundit të Stalinit do të shikosh se në to theksohet me të madhe çështja e mbrojtjes së paqes. Të gjithë jemi dëshmitarë për këtë gjë. Stalinin ne e kishim dhe e kemi udhëheqësin tonë të madh dhe ecim në rrugën që na ka treguar ai në çështjen e luftës për paqe. Në momentet më të vështira që po kalonte bota, për interes të paqes, të socializmit, të Bashkimit Sovjetik, Stalini nënshkroi traktatin e mossulmimit me Gjermaninë fashiste, po tani na del një i pacipë mareshal i Bashkimit Sovjetik dhe u jep armë revizionistëve jugosllavë duke deklaruar se Stalini mbronte fashistët gjermanë, pikërisht atë që thoshin armiqtë e socializmit, Daladieri me Çembërlejnin.

Edhe parullën se «lufta mund të evitohet» Hrushovi e ka nxjerrë si një teori të tijën, dhe se me këtë ai na

paska «pasuruar» marksizmin. Në fakt Hrushovi s'ka thënë gjë të re, por veproi e tradhtoi duke u maskuar me parulla.

N. Hrushovi dhe të gjithë ata që e pasojnë kanë tradhtuar rrugën marksiste-leniniste, janë futur me të dyja këmbët në revizionizëm. Qëndrimet dhe veprimet e tyre nuk kanë ndryshim nga ato të revizionistëve jugosllavë, edhe qëllimet e tyre janë të njëjta me ato të jugosllavëve.

Revizionistët jugosllavë mbrojnë haptazi imperializmin amerikan dhe përpiqen të përçajnë kampin socialist, të mbjellin në radhët tona idetë revizioniste, të dobësojnë vrullin revolucionar të komunistëve e të popujve dhe të krijojnë mundësi që imperializmi amerikan të na godasë më lehtë. Në këto çështje taktike revizionistët jugosllavë veprojnë hapur. Nikita Hrushovi akoma nuk vepron aq hapur, po sidoqoftë edhe ky me shokë janë plotësisht në këtë rrugë.

Kush nuk është për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare në rrugën e bisedimeve? Në ka pasur ndonjë që ka bërë bisedime me imperialistët, duke filluar që nga Çerçilli e gjer te Ruzvelti, ose me përfaqësues të tjerë të borgjezisë ndërkombëtare, ka qenë J.V. Stalini. Por ai ka pasur një kuptim të drejtë leninist dhe ka ndjekur një politikë të lartë parimore në bisedimet e në kompromiset, pa u bërë asnjë lëshim të gjithë shëfave të kapitalizmit dhe të imperializmit ndërkombëtar.

Mos vallë çështjen e çarmatimit e shtroi për herë të parë Hrushovi? Kjo ka qenë ëndrra e komunistëve për të ardhshmen, por ta shtrosh sot këtë çështje, do të thotë të çarmatosesh në luftën për ta fituar këtë të

ardhshme, në emër të së cilës kanë luftuar e luftojnë komunistët e vërtetë. Kështu e kanë shtruar problemin e çarmatimit klasikët e marksizëm-leninizmit. Po si e shtron tani Hrushovi? Ai në bazë të politikës së tij për këtë çështje ka oportunizmin. Ai ka besim të plotë se mund të arrihet në përfundime të mira me anë bisedimesh dhe thekson se është gabim t'u përgjigjemi me kërcënime imperializmit amerikan dhe veprimeve të tij të hapëta të armatosura, si edhe luftës së vazhdueshme që bën ai për ringjalljen e revanshizmit gjerman dhe të militarizmit japonez. Pra, Hrushovi ndjek politikën antimarksiste të buzëqeshjeve dhe të përkëdheljeve ndaj imperializmit. Këtë ka bërë dhe po bën ai jo vetëm me fjalë po edhe me vepra.

Ne mund të themi se këto situata të vështira që janë krijuar në gjendjen ndërkombëtare janë rezultat i politikës revizioniste të N. Hrushovit. SHBA e shohin forcën e madhe të socializmit, por shohin njëkohësisht se në udhëheqjen e kampit socialist ka njerëz me të cilët mund të bëhen muhabete të pambaruara dhe ato të fitojnë kohë për ngritjen e potencialit të tyre ushtarak. Këtë mundësi imperializmit ia ka dhënë Hrushovi me të dyja duart, pavarësisht se në fjalimin e fundit me rastin e 20-vjetorit të sulmit të Gjermanisë mbi Bashkimin Sovjetik ai deklaroi se në çështjen e traktatit të paqes me Gjermaninë nuk duhet të zgjatemi më etj. Këto që lëshon nganjëherë Hrushovi janë slogane, parulla, dhe në fakt bisedimet me imperialistët vazhdojnë, ndërsa situata acarohet edhe më shumë. Por nuk janë vetëm këto.

Çështja është se imperializmi qëndron vazhdimisht

armik i socializmit e i popujve dhe natyrën e tij nuk e ka ndryshuar aspak. Kur i fut ndonjë shiringë Hrushovit, ai thotë se natyra e imperializmit nuk ka ndryshuar, por s'kalon shumë kohë dhe Hrushovi flet ndryshe. U bën lëshime të mëdha imperialistëve edhe në çështjen e mbrojtjes. Gjeneralë të shquar gjatë Luftës Patriotike në Bashkimin Sovjetik tani janë nxjerrë në pension, rreth 500 mijë oficerë janë nxjerrë në lirim. Hrushovi ka ndryshuar të gjitha pikëpamjet taktike dhe strategjike të luftës, të aviacionit, të këmbësorisë, të marinës. Këmbësorinë veçanërisht e ka lënë pas dore. Kurse masat që ka marrë jo vetëm nuk janë pasuar nga imperialistët, përkundrazi ata kanë ecur akoma më shumë në rrugën e armatimeve, për forcimin e potencialit të tyre ushtarak.

Përpara këtyre situatave dhe logjikës së fortë marksiste-leniniste të Partisë Komuniste të Kinës, të Partisë sonë dhe të mjaft partive të tjera, Hrushovi detyrohet dhe bën ndonjë skerco. Kështu në fjalimin e tij me rastin e 20-vjetorit të sulmit të Gjermanisë hitleriane mbi Bashkimin Sovjetik, sikurse e keni lexuar, hedh ndonjë fjalë si ajo që në rast se nuk do të arrihet ndonjë përfundim në çështjen e çarmatimit, atëherë ne do të rishikojmë çështjen e shtimit të efektivit të forcave ushtarake etj.

Vihet pyetja: përse shtrohet po në këtë mënyrë për 4-5 vjet me radhë kjo çështje? Ai ka' deklaruar se politika e tij do të triumfojë, se imperialistët do t'i sjellë në rrugë dhe shkoi u puth me Ajzenhauerin, tha gjithë ato fjalë të mira për të, pastaj në Paris lëshoi një bombë kundër tij. Më vonë e ndryshoi fletën, foli



fjalë të mira për Kenedin, po të gjithë e panë se ç'ishte ky njeri, prandaj Hrushovi u detyrua të flasë edhe kundër tij. Ne nuk u besojmë kurrë fjalëve që dalin nga goja e Hrushovit, ai dredhon vazhdimisht. Dhe kjo është një lojë e rrezikshme.

Pesë vjet me radhë Hrushovi u përpoq ta rregullonte me imperializmin. Më vonë u orvat të hidhte jashtë familjes së vendeve socialiste Kinën e madhe. Por është i njohur qëndrimi i drejtë që mbajti Partia jonë në Bukuresht dhe më vonë qëndrimi i saj i vendosur në Mbledhjen e Moskës për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar.

Pavarësisht ç'po bëjnë grupi i Hrushovit dhe ata që e pasojnë, komunizmi ndërkombëtar do ta kujtojë me mirënjohje veprën e Partisë së Punës të Shqipërisë, e cila, pa marrë parasysh asgjë, mbrojti me një principialitet të lartë jo vetëm Kinën e madhe, por ajo mbrojti njëkohësisht interesat e mëdha të kampit të socializmit, miqësinë midis popujve të Kinës e të Bashkimit Sovjetik.

Një rrymë revizioniste po përshkon një numër të madh partish në Evropë, deri edhe Partinë Komuniste të Francës, udhëheqësi i së cilës, Moris Torezi, u ka thënë njerëzve tanë: «Interesant, edhe ne e luftojmë revizionizmin, po e luftojmë në shkallë ndërkombëtare, kurse ju i jeni qepur Jugosllavisë në një kohë që dihet se Titon askush nuk e dëgjon». Mirëpo Titon e dëgjon imperializmi që e ka veglën e vet dhe e shtyn të veprojë me forcë kundër unitetit të kampit të socializmit. Imperializmi tani ia ka arritur këtij qëllimi pavarësisht se nuk do të fitojë kurrë në këtë rrugë.

Titoja, ky shërbëtor i imperializmit, po punon për të organizuar në vjeshtë një konferencë në Beograd me përfaqësuesit e vendeve të porsaçliruara, ish-koloniale. Udhëheqësit sovjetikë duan «të na bindin» se nuk janë dakord për këtë konferencë, sikur nuk qe N. Hrushovi ai që në OKB e mbështeti një «inisiativë» të tillë. Nga ana tjetër, udhëheqësit sovjetikë thonë se «në këtë konferencë ne do të influencojmë me anën e diplomatëve që të flitet edhe kundër imperializmit, edhe kundër revizionizmit», por në fakt nuk dalin dot hapur. Dihet se Hrushovi dhe Titoja kundër imperializmit amerikan konkretisht nuk thonë asnjë fjalë dhe nuk kanë për të folur kurrë. Dhe, megjithëkëtë ata dhe shokët e tyre e quajnë një «sukses» këtë konferencë.

Hrushovi me shokë po i varin ujkut mëlçinë në qafë dhe i thonë ruaje. Dhe ujku imperialist, duke nxitur këlyshët e tij, lufton që të krijojë me ta një peshë të madhe në politikën ndërkombëtare në favor të tij. Sigurisht në mes tyre do të ketë edhe kontradikta.

Vendet socialiste kanë një potencial të madh politik, ekonomik dhe ushtarak për të influencuar në rrugë dhe në forma të drejta në popujt e porsaçliruar ose që janë çliruar nga kolonializmi. Hrushovi me Titon puqen në pikëpamjet e tyre dhe forcat ekonomike e propagandistike i përdorin për të gënjyer njerëzit. Taktikat e grupit të Hrushovit dhe të revizionistëve jugosllavë nuk janë të ndryshme, bile ato janë të njëjlojta, por ndërsa ato të revizionistëve jugosllavë janë fare të hapëta, këta qëndrojnë akoma pas perdes.

Ne kemi besim se kjo gjendje që është krijuar do të ndryshohet. Marksizëm-leninizmi do t'i japë fund,

do të gjenden forca që do t'u thonë ndal këtyre situatave dhe jemi të bindur që në këtë luftë të drejtë kundër revizionizmit dhe përkrahësve të tij do të fitojmë ne, se ne përbëjmë shumicën dërrmuese në lëvizjen komuniste botërore. Do të vijë koha që këtyre njerëzve do t'u vihen këmbët në një këpuçë.

Në të gjitha kontaktet që kanë pasur njerëzit tanë me njerëz të bazës ose edhe me kuadro të mesëm e të lartë në vendet socialiste të Evropës, me ndonjë përjashtim, të gjithë thonë «i lumtë Partisë së Punës të Shqipërisë», «keni të drejtë», «qëndroni». Po këto momente janë, dhe me siguri do të kapërcehen, sepse rruga jonë është e drejtë.

Atë që tha Hrushovi se do ta nënshkruajmë aktin për çështjen e Berlinit dhe traktatin e paqes me Gjermaninë, nuk është hera e parë që e dëgjojmë. Për këtë çështje është marrë edhe vendim në Mbledhjen e 81 partive komuniste dhe punëtoare, ku u vërtetua edhe një herë pikëpamja e Partisë sonë, për të cilën na kishin sulmuar disa herë duke na thënë se nuk dini të bëni politikë, po doni t'i vini zjarrin botës. Në mbledhjen e Traktatit të Varshavës delegacioni ynë e ngriti përsëri këtë çështje, ai u shpreh se sa më vonë ta nënshkruajmë traktatin e paqes me Gjermaninë, aq më e rrezikshme bëhet kjo çështje për ne. Po Hrushovi na u drejtua me këto fjalë: «Të jeni të arsyeshëm, i duhet ardhur rrotull kësaj çështjeje si bën dentisti i mirë që kruan dhëmbin me kujdes dhe pastaj vjen një moment i favorshëm dhe e heq. Kur të vijë ky moment ne do ta përshëndesim. Sivjet ne duhet ta nënshkruajmë këtë traktat dhe do t'u tregojmë grushtin imperialistëve se Berlini

është bërë një qendër e tmerrshme e spiunazhit kundër vendeve të kampit tonë»!

Po këto fjalë, për nënshkrimin e traktatit të paqes me Gjermaninë, vetëm sa u thanë, tani Hrushovi me shokë thonë fjalë të tjera, ata janë për biseda dhe mbledhje, për pregatitjen e një konference të nivelit të lartë, për të cilën Hrushovi u dogj. Ai këtë do, me qëllim që të shtyhet kjo çështje pa mbarim. Për këtë janë edhe imperialistët, të cilët nuk duan të zgjidhet çështja gjermane.

Me një politikë të tillë si kjo që ndjek Hrushovi nuk mund të arrihet në zgjidhjen e problemeve. Dhe pse ne kemi pikëpamje të kundërta, na quajnë luftënxitës. Politika që ndjekim ne ka qenë dhe është e drejtë dhe vetëm kështu i mblidhen rripat imperializmit. Por një situatë e tillë është krijuar gati në të gjitha partitë komuniste dhe punëtoresh të Evropës, sipas të cilave duhet të bëhen vetëm bisedime që të sigurohet bashkekzistenca etj.

Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Francës asnjë fjalë nuk tha në kongresin e partisë së vet kundër revizionizmit, as në kohën kur diskutohej kundër grupit të Servenit dhe të Kazanovës që janë kokë e këmbë revizionistë. Edhe në rezolucionin e kongresit nuk e gjen në asnjë vend të paktën fjalën revizionizëm. Kjo do të thotë të tradhtosh haptazi marksizëm-leninizmin.

Pikërisht në një situatë të tillë del Moris Torezi dhe thotë se nuk ka asnjë rrezik, kurse Zhanetë Vermesh deklaroi: «E çuditshme është parulla juaj «në njërën dorë kazmën në tjetrën pushkën» në kohën e raketave. Kjo nuk është as realiste, thotë ajo, në pe-

riudhën e mjeteve kaq të fuqishme të shfarosjes në masë! Ç'ju duhen juve armët? Kush do t'ju sulmojë ju?».

Ata dhe disa të tjerë na thonë: «Si do të sulmoheni ju nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë dhe Flota VI Amerikane, ju jeni të siguruar nga Traktati i Varshavës?». Këto janë parulla revizioniste që Partia jonë as i ka ngrënë as do t'i hajë. E mbajmë mend fare mirë se si N. Hrushovi «mbrojti» Kubën me raketa! Ne e vlerësojmë drejt situatën e krijuar nga imperialistët dhe revizionistët, prandaj populli ynë është mobilizuar dhe i bashkuar rreth Partisë, ka besim të madh te vija e saj, te fitorja e marksizëm-leninizmit.

Me këtë besim t'i përvishemi punës ashtu sikurse i jemi përveshur, bile tani edhe më shumë, sepse realizimi i planeve tona do të jetë një grusht i rëndë për revizionistët. Këta kanë krijuar një bllokadë të vërtetë kundër vendit tonë, bllokadë ekonomike dhe politike, duke filluar qysh nga Bukureshti e gjer tani. Me përjashtim të shtypit të partive motra të vendeve socialiste të Azisë, që shkruajnë rregullisht për vendin tonë, shtypi i vendeve socialiste të Evropës a ka apo nuk ka dy-tri informacione që nga ajo kohë për vendin tonë.

Ç't'i thotë gazeta «Pravda» popullit sovjetik, që plani i tremujorit të parë apo i gjashtëmujorit të parë të këtij viti u realizua në Shqipëri, apo u ndërtuan këto dhe ato vepra? Këto nuk ka si ia thotë, se ndryshe i del boja për shpifjet që kanë bërë. Edhe për gjuqin nuk kanë ç'të flasin, se populli sovjetik me siguri do të thotë: shqiptarët bëjnë mirë që u bien në kokë tradhtarëve e agjentëve; pastaj do të thonë: Ç'janë këto puthje në formën e marrëdhënieve shtetërore që bën

Hrushovi ynë me revizionistët jugosllavë, me ata që bëjnë komplete kundër një populli të një vendi socialist si Shqipëria?

Çështja është se edhe në kushtet e bllokadës punët tona ecin dhe do të ecin kurdoherë përpara, këtë bllokadë ne do ta çajmë me siguri se kjo mbahet me kleçka. Kështu Hrushovi është detyruar të dërgojë Kozllovin dhe Ignatovin në Bullgari të asistojnë në mbledhje, se atje ka një numër komunistësh që nuk janë dakord me qëndrimin armiqësor të udhëheqjes bullgare ndaj vendit tonë.

Në këto situata, pra, të mobilizohemi më shumë dhe me besim të pakufishëm të përpiqemi të realizojmë planet, të bëjmë kursime dhe novacione, të luftojmë me vigjilencë kundër shigjetave të helmatisura që do të përpiqen të na lëshojnë armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm.

Të mos harrojmë, shokë, çështjen e vigjilencës, të jemi vigjilentë dhe të pamëshirshëm kundër armiqve. Mund të ketë kuadro që trubullohen në këto situata, ata duhet të ndreqen, të binden. Duhet pasur parasysh se punon edhe armiku për t'i çorientuar njerëzit, prandaj asnjë njeri të mos i lëshojmë armikut, të luftojmë gjer në fund për të shpëtuar njerëzit dhe në rast se ndonjë nuk heq dorë nga rruga armiqësore, pasi bëhen të gjitha përpjekjet, të demaskohet pa gurrim.

Në radhë të parë të mbajmë Partinë në korent, asgjë të mos i fshehim asaj, të sqarojmë edhe popullin. Partia të mbajë lidhje sa më të ngushta me popullin. Këto lidhje nuk ka asnjë forcë që t'i çajë. Të rritet kudo vigjilenca, të forcohet gatishmëria e Ushtrisë Po-

pullore dhe e Armës së Sigurimit të Shtetit, e cila si kurdoherë të tregohet e zgjuar dhe e pamëshirshme kundër të gjithë atyre që tentojnë të cenojnë interesat e vendit tonë.

Vendimet e Plenumit t'i çoni poshtë. Shumë shokë këtu bënë mjaft propozime të vlefshme. Të studjohen ato me kujdes dhe të zbatohen ato që janë të zbatueshme. Ne mendojmë që për materialet e këtij Plenumi të mos bëhen aktive të posaçme, sepse ekipet që u krijuan për problemin e kursimeve bënë plot mbledhje, prandaj nuk është nevoja të shtrohet edhe një herë në mbledhje ky problem. Prandaj mendojmë që vendimi të punohet në një mbledhje të përbashkët të komitetit të Partisë dhe të këshillit popullor të rrethit, pastaj të punohet në organizatat-bazë të Partisë.

Në rast se keni vërejtje parimore për projektvendimin i bëni, në rast se keni vetëm vërejtje gjuhësore ose stilistike apo për ndonjë shifër atëherë i dorëzoni në sekretari.

*Pas vërejtjeve dhe pasi Plenumi aprovoi tërësisht projektvendimin shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Mendojmë që këtë vendim ta shtypim në gazetë. Atëherë e mbyllim këtë seancë që ka të bëjë me pikën e parë të rendit të ditës. Të gjithë shokëve të ftuar u uroj sukses në luftën për mbrojtjen e vijës së Partisë, të popullit, të socializmit dhe të marksizëm-leninizmit!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE MBI  
MARRËDHËNIET E PPSH ME PK TË BS  
DHE PARTITË KOMUNISTE E PUNËTORE  
TË VENDEVE SOCIALISTE TË EVROPËS**

*Informacion në Plenumin II të KQ të PPSH*

**1 korrik 1961**

Për shkak të qëndrimeve antimarksiste të udhëheqjes sovjetike, si dhe të atyre që e pasojnë, ndaj Partisë dhe vendit tonë, marrëdhëniet tona me ta dhe me vendet e demokracisë popullore të Evropës janë keqësuar. Nuk do të flas qysh nga fillimi për këto çështje, sepse ju tashmë jeni në dijeni të tyre. Qëndrimet marksiste-leniniste të Partisë sonë ua prishën planet dhe taktikat Hrushovit dhe pasuesve të tij. Por nga punimet e Mbledhjes së Moskës dhe nga zhvillimi i të gjitha ngjarjeve të mëvonshme del se Hrushovi me suitën e vet mendonin se kishte ardhur koha që Partinë Komuniste të Kinës ta dënonin si dogmatike, ta eliminonin nga kampi socialist qysh në Bukuresht dhe të mos zgjatet kjo punë gjer në Mbledhjen e Moskës. Kjo tani për ne është e qartë.



Në Bukuresht Hrushovi i gjeti në befasi përfaqësuesit e një pjese të partive komuniste dhe punëtoresh, ndërsa një pjesë tjetër dhe veçanërisht udhëheqjet e partive komuniste dhe punëtoresh të vendeve socialiste të Evropës ishin në dijeni të asaj që do të bëhej në Bukuresht, por ndërhyrja e përfaqësuesit të Partisë sonë, shokut Hysni Kapo atje, ua prishi planet. Ky qëndrim i Partisë sonë bëri që të shtangeshin përfaqësuesit e partive që u gjetën në befasi të këtij komploti, zbulimi dhe dënimi i të cilit ishte një fitore e madhe për çështjen tonë. Ata nuk mundën t'ia arrinin dot qëllimit dhe këtë shpresuan ta realizonin në Mbledhjen e Moskës.

Sigurisht Mbledhja e Moskës i keqësoi më shumë situatat për revizionistët. Grupit të Nikita Hrushovit në këtë mbledhje i duhej të përballonte situata më të vështira, sepse shumë parti nuk gjendeshin më në befasi si në Bukuresht dhe përfaqësuesit e tyre shkonin atje më të përgatitur. Përveç asaj, gjatë mbledhjes, përfaqësuesit e partive komuniste dhe punëtoresh dëgjuan edhe fjalimet e debatet e përfaqësuesve të Partisë Komuniste të Kinës dhe të Partisë së Punës të Shqipërisë. Kështu në Mbledhjen e Moskës puna e grupit të Hrushovit nuk shkoi aq lehtë.

Natyrisht, ata zhvilluan qysh më parë një luftë të ashpër, u përgatitën me qëllim që në mbledhje të konsolidonin pozitat e tyre antimarksiste në lidhje me qëndrimin ndaj PK të Kinës e njëkohësisht edhe kundër Partisë sonë që nuk u pajtua me ta në Mbledhjen e Bukureshtit. Prandaj ata filluan t'i përpunonin ato parti që u shtangën në Bukuresht, ndërsa ndaj Partisë

sonë jo vetëm bënë orvatje për ta tërhequr në rrugën e tyre antimarksiste, por, kur e panë që kjo s'u doli, filluan edhe kërcënimet kundër nesh, për të cilat ju tani jeni mirë në dijeni.

Çështja është që kjo veprimtari revizioniste e grupit të Hrushovit i ka sjellë një dëm të madh komunizmit ndërkombëtar dhe kampit të socializmit, sepse tani në radhët tona nuk ekziston as uniteti ideologjik, as uniteti politik. Kjo është e qartë. Dihet se tani një sërë partish janë në kundërshtim të hapur me vijën revizioniste të grupit të Hrushovit dhe të udhëheqësve të vendeve të demokracisë popullore të Evropës dhe të disa partive komuniste të vendeve perëndimore. Kjo mungesë uniteti i intereson shumë imperializmit, ai për këtë ka punuar dhe punon pareshtur, për të dobësuar unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste e punëtoje ndërkombëtare.

Partitë marksiste-leniniste e konsiderojnë si një çështje jashtëzakonisht të madhe çështjen e unitetit. Por për mbrojtjen e unitetit ka dy rrugë diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën: e para, ta mbrosh atë me fjalë dhe nga ana tjetër me vepra ta sabotosh, kurse rruga tjetër është ta mbrosh unitetin me të gjitha forcat në rrugën marksiste-leniniste dhe, me gjithë kontradiktat e mëdha politike dhe ideologjike që ekzistojnë në mes partive tona, të mos i japësh asnjë armë imperializmit të na luftojë dhe ta thellojë akoma më shumë këtë mungesë uniteti, këtë përcarje. Për rrugën e parë, për prishjen e unitetit, punon me ndërgjegje të plotë dhe me të gjitha forcat grupi i Hrushovit.

Të marrim çështjen e RP të Kinës që ka një rëndësi

të jashtëzakonshme për kampin e socializmit. Kina ka një potencial kolosal, ushtarak, politik dhe ideologjik, por nga grupi i Hrushovit vazhdohet të injorohet ky potencial kolosal në lëmin ndërkombëtar. Jo vetëm kaq, por po bëhen të gjitha përpjekjet, haptazi ose fshehurazi, për ta diskredituar dhe për ta mënjanuar Kinën nga arena ndërkombëtare.

Po të lexoni me kujdes telegramin që i ka dërguar Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, me rastin e 40-vjetorit të themelimit të saj, do të vëreni se atje nuk përmenden fare roli i madh i Kinës dhe i Partisë Komuniste të Kinës në luftën për mbrojtjen e paqes e të socializmit, lufta konsekuente që bën Republika Popullore e Kinës kundër imperia-lizmit. Këto çështje në këtë dokument janë eliminuar. Kjo haptazi do të thotë se udhëheqësit sovjetikë nuk janë dakord me politikën konsekuente të Partisë Komuniste të Kinës dhe të shtetit kinez, me gjithë flluskën e sapunit që lëshoi Nikita Hrushovi në fjalën e tij me rastin e 20-vjetorit të sulmit të Gjermanisë fashiste mbi Bashkimin Sovjetik, duke thënë disa gjëra gjoja në mbështetje të RP të Kinës.

Një çështje tjetër që dua të vë në dukje është ajo e ndihmës që Bashkimi Sovjetik ia ka prerë plotësisht Republikës Popullore të Kinës, ashtu sikurse ka vepruar edhe me ne. Kundër vendit dhe Partisë sonë udhëheqja sovjetike bën një luftë pa princip, një luftë të egër antimarksiste. Dhe kjo ka arsytet e veta.

Këto arsye qëndrojnë në faktin se vija e Partisë sonë, taktikat e saj të drejta në rrethanat dhe në kush-

tet e vendit tonë (duke marrë parasysh rrethimin gjeografik, komplotet e vazhdueshme që na bëhen, potencialin mbrojtës të vendit tonë) atyre u djegin jashtëzakonisht shumë. Prandaj grupi i Nikita Hrushovit dhe udhëheqjet e vendeve të demokracisë popullore të Evropës e të Partisë Komuniste të Francës dhe të Italisë që e pasojnë, nga qëndrimet që mbajnë ndaj nesh, duket qartë se kanë organizuar një taktikë të përbashkët. Nga të dhënat dhe nga dokumentet që kemi shikohet e njëjta vijë, jo vetëm një vijë e përgjithshme, por edhe një vijë e organizuar gjer në detaje, edhe në taktikat e përbashkëta. Qëllimi është bllokimi i Shqipërisë dhe diskreditimi i udhëheqjes shqiptare. Por bllokada kundër vendit tonë nuk kufizohet vetëm me anën propagandistike, sepse përsa i përket kësaj ane në një përqindje të madhe atyre nuk u beson njeri. Parullat e tyre tashmë dihen: «Udhëheqja shqiptare është në pozita antisovjetike, sektare, dogmatike» etj.

Por nuk është vetëm kjo anë. Ata, duke parë rrezikun që përbën për ta politika e drejtë e Partisë dhe e shtetit tonë, kanë vendosur edhe bllokadën ushtarake kundër Shqipërisë. Për ta legalizuar këtë thirrën edhe mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, rezultatet e së cilës ju i dini. Kjo mbledhje, e organizuar nga grupi i Hrushovit, kishte për qëllim që t'u jepte një grusht Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, për të lëkundur masat e gjera të Partisë dhe të popullit tonë me kërcënimin e hcqjes së bazës ushtarako-detare të Vlorës dhe si rrjedhim të alarmoheshin Partia dhe opinioni shqiptar se tani po krijohet një rrezik i madh për Shqipërinë nga

imperializmi dhe për këtë fajtoje të nxirrej udhëheqja shqiptare.

Për t'ia arritur kësaj ata shkelën çdo normë, marrëveshje dhe traktat. Kësaj mbledhjeje ata u munduan t'i jepnin në dukje karakterin e një mbledhjeje normale, sepse rendi i ditës parashikonte rishqyrtimin e gjendjes ushtarake dhe të armatimeve të ushtrive tona. Për këtë përçapjet ishin bërë nëpërmjet shtatmadhorive të ushtrive të vendeve pjesëtare, natyrisht edhe të Shtatmadhorisë sonë. Të tilla tratativa nga ata bëhen në mënyrë të shkëputur, nuk bëhen përçapje të rregullta prej aleati, që kanë mbi supe detyra të përbashkëta kundër një armiku të përbashkët, por dërgojnë nga 5 oficerë gjoja për të dhënë përshtypjen sikur flitet për armatime dhe kur bëhen mbledhje Hrushovi thotë ne kemi sa të duash raketa që i nxjerrim sikur të jenë sallam.

Dihet potenciali ushtarak i Bashkimit Sovjetik, por procedurat dhe metodat e tyre të punës si pjesëtarë të Traktatit të Varshavës ne i kritikojmë. Dhe në fakt në mbledhjen plenare të Traktatit, në mars të këtij viti, asgjë nuk u tha ç'është bërë dhe ç'do të bëhet për forcimin e ushtrive tona, sikurse ishte njoftuar më parë, por qëllimi i mbledhjes ishte të goditej Shqipëria, me të njëjtat procedura sikurse u veprua në Bukuresht kundër Kinës.

Një natë, vonë, përpara se të bëhej mbledhja, delegacionit tonë mareshali Greçko i dërgoi një letër, në të cilën ai bënte po ato kërcënime dhe kërkesa që u parashtruan pastaj nga Hrushovi dhe miqtë e tij në mbledhje. Greçkoja me qëllim e dorëzoi shumë vonë

letrën, në mënyrë që ne të mos kishim kohë të përgjigjeshim. Po nuk doli si kishin menduar ata.

Që mbledhja të zhvillohej ashtu sikurse ishte bërë njoftimi, të gjithë pjesëmarrësit duhej të kishin vepruar si veproi delegacioni i vendit tonë, duke diskutuar mbi ato probleme, për të cilat vendet tona ishin vënë në dijeni, në bazë të rendit të ditës, dhe që janë aq të rëndësishme dhe preokupante për fatin e vendeve socialiste dhe të paqes botërore. Delegacionet e vendeve pjesëmarrëse në këtë mbledhje, duke filluar nga Hrushovi dhe të tjerët me radhë, bënë vetëm sulme kundër udhëheqjes dhe vendit tonë dhe për këto ju jeni në dijeni.

Ky ishte një kërcënim që u bëhej Partisë dhe vendit tonë dhe që u hodh poshtë se nuk ka asnjë bazë politike, ideologjike, morale, juridike, ushtarake etj., të gjitha të drejtat janë në anën tonë. Por ata asgjë nuk morën parasysh dhe këtu u tregua egërsia e tyre.

Natyrisht ne i mbrojtëm të drejtat tona dhe u treguam vendin atyre, por nuk duhet harruar edhe ana tjetër, dëmi i madh që i bënë grupi i Hrushovit dhe miqtë e tij mbrojtjes së përbashkët të kampit socialist. Është fakt se me heqjen e bazës së Vlorës dobësohet fuqia mbrojtëse e tij. Hrushovi në mënyrë demonstrative urdhëroi largimin e nëndetëseve dhe të anijeve shoqëruese që ishin në bazën e Vlorës. Këtë e mori vesh gjithë bota, Londra i pa të filmuara edhe në televizion anijet luftarake sovjetike që u kthyen nga Vlora në detin Balltik.

Me ndërgjegje të plotë, pra, grupi i Hrushovit ka dobësuar mbrojtjen e kampit socialist dhe të vendit tonë. Ju i dini se cilat ishin arsyet e këtij qëndrimi. Të gjitha

ato që kishin kurdisur kundër vendit tonë njerëzit e këtij grupi janë shpifje të poshtra që nuk i mban dheu.

«Faktet» që pretendonin ata, shoku Mehmet i përmbloodhi në një letër dhe pastaj thirri përfaqësuesin e Komandës së Bashkuar të Traktatit të Varshavës në vendin tonë, e pyeti atë ç'gjëra kishte dhe pasi foli ai, shoku Mehmet ia dha me shkrim përgjigjen tonë. Kjo u pasua edhe me vizitën që bëri pas disa ditësh shoku Mehmet në bazën ushtarako-detare të Vlorës, në mars 1961, ku foli para efektivit të saj dhe i bëri të qarta mjaft probleme.

Mosdërgimi i armatimeve në kohën e caktuar, si edhe moskompletimi i bazës, për ne ishin sinjale të masave dhe të qëndrimeve që do të mbaheshin kundër nesh nga udhëheqja sovjetike dhe që u kurorëzuan në mbledhjen e marsit të Traktatit të Varshavës.

Në mbledhjen e marsit ata ngritën edhe çështjen e komplotit, i cili për ta na qenkej një bluf i kurdisur dhe i përgatitur posaçërisht prej nesh, prandaj, sipas tyre, duhej të krijohej një komision për të parë vërtetësinë e fakteve.

Përse e paraqitën ata një pikëpamje të tillë? Këtu ka dy gjëra: ose ata janë bashkëpunëtorë me këtë komplot ose mbrojnë imperializmin, revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë. Për këtë ne nuk kemi dyshim, sepse nuk është hera e parë që këta njerëz mbrojnë armiqtë e Partisë dhe të popullit tonë. Këtë ata e ngritën në sistem; gjë që do të thotë të jesh shumë i komprometuar dhe ky komplot është me të vërtetë shumë demaskues për politikën e Hrushovit me shokë. Prandaj ata mbajnë një qëndrim të tillë.

Për gjyqin e tradhtarëve dhe të spiunëve shqiptarë që u bë në muajin maj në Tiranë, grupi i Hrushovit dhe pasuesit e tij kanë mbajtur heshtje të plotë. Të mbash heshtje të plotë ndaj një veprimtarie të tillë armiqësore që nuk është as hera e parë dhe as e fundit që kurdiset nga ana e imperialistëve, e revizionistëve jugosllavë dhe e monarko-fashistëve grekë kundër Shqipërisë dhe çështjes së socializmit, do të thotë të mbrosh ata, të marrësh anën e tyre. Ata kanë pasur frikë nga zhvillimi i këtij gjyqi.

Ju e keni lexuar letrën që shoku Mehmet i ka bërë gjatë kësaj kohe Kosiginit. Në përgjigje të kësaj letre, që iu bë e ditur të gjitha partive, na janë thënë fjalë të ulëta. Por le të qëndrojmë në çështjen e heqjes së bazës ushtarako-detare të Vlorës. Sa i drejtë ka qenë qëndrimi ynë politik, moral, ushtarak dhe juridik në këtë çështje dhe sa të ulëta dhe armiqësore kanë qenë qëndrimet dhe taktikat e palës sovjetike.

Qëndrimet e tyre kanë qenë të poshtra, revoltuese dhe të shumta sa që nuk mund të numërohen. Por në bazë grupi i oficerëve tanë, në këto momente delikate, ka mbrojtur me zotësi dhe me zgjuarsi Partinë kundër komplotistëve, provokatorëve dhe shovinistëve që bastarduan ndjenjat e marinarëve sovjetikë gjer në atë shkallë sa, po të shikoni një rulo kinematografike që është marrë atje, do të vëreni në ç'situatë të rëndë u lanë anijet, mjetet etj., dhe do të bëni menjëherë pyetjen, kush ka jetuar në atë vend, a është e mundur që njerëzit sovjetikë të kenë shpuar rezervuarët, të kenë thyer krevatet, xhamet e ndërtesave ku jetonin dhe punonin etj.? Ata bënë përpjekje që të merrnin andej



çdo gjë, gjer edhe bulonat e fundit, por nuk ia arritën dot qëllimit. Ne qëndruam rreptë, mbrojtëm si duhet të drejtat tona, iu përgjigjëm sulmeve dhe provokacioneve me gjakftohtësi, kurse ata e humbën toruan. Anijet mbetën në vend. Ne u dhamë atyre vetëm anijet ku shërbente personeli sovjetik, jo se ato që i morën janë të tyret. Ne ua lamë ato që morën sepse nuk donim të acaroheshim me tej situata, me që ata këtë donin.

Ata që shërbenin në bazë ishin të frymëzuar me armiqësi kundër vendit tonë, ishin njerëz të shthurur politikisht dhe ideologjikisht. Të katandiset oficeri maçhor sovjetik të heqë mënjanë për vete aparatin telefonik, motorin e automobilin, të futë në valixhen personale, për ta marrë në Bashkimin Sovjetik, ventilatorin e gjëra të tjera, kjo as që na shkante kurrë ndër mend!

Një pasqyrë krejt të kundërt paraqit qëndrimi i marinarëve dhe i oficerëve tanë që studjonin dhe studjojnë në Bashkimin Sovjetik. Ata së bashku me ambasadorin tonë kanë mbajtur qëndrim heroik në mbrojtje të vijës së Partisë dhe të drejtësisë së saj, u kanë rezistuar si komunistë shumë veprimeve antisocialiste që kanë bërë revizionistët sovjetikë qysh nga arrestimi i kursantëve dhe i oficerëve tanë të marinës deri në largimin e tyre nga Bashkimi Sovjetik.

Në këtë mënyrë po vazhdohet të qëndrohet edhe ndaj marinarëve tanë që ndodhen në Sevastopol. Atje janë dërguar dy gjuajtës për riparim, të cilët ata duan të na i mbajnë. Për to nuk do të bëjmë luftë, po është çështja e qëndrimi i tyre. Kur ishin marinarët sovjetikë këtu, ne kemi lejuar përfaqësuesit e komandës sovjetike, ambasadorin sovjetik e deri te Novikovi të

shkonin në bazën e Vlorës, ku ata prapa shpine na organizuan komplete e provokacione, ndërsa ata nuk lejojnë në BS përfaqësuesin e komandës sonë, pranë Komandës së Bashkuar të Traktatit të Varshavës, të shkojë dhe të tërheqë, e në mënyrë të organizuar, ekipazhet tona nga anijet.

Po pse sovjetikët mbajnë të tilla qëndrime? Duket qartë, se kanë frikë nga e vërteta. Këto gjëra udhëheqja sovjetike i ka bërë dhe i bën për të diskredituar Partinë dhe udhëheqjen tonë. Por në fakt ndodhi e kundërta.

Tani mund të themi se në bazën ushtarako-detare të Vlorës është vendosur rregulli e qetësia. Mjetet tona detare tani janë në gatishmëri të plotë. Atje do të ngremë edhe shkollën e marinës me pedagogë që kanë mbaruar akademitë. Pra ne do të vazhdojmë ta forcojmë më tej marinën dhe mbrojtjen tonë bregdetare dhe mund të themi se edhe nga ana materiale jemi më të sigurt se më parë.

Çështjen e bazës ushtarako-detare të Vlorës revizionistët hrushovianë e kanë marrë si një pretekst për masa eventuale të mëvonshme, për të na nxjerrë edhe nga Traktati i Varshavës. Në fakt, që nga Hrushovi e gjer te Zhivkovi, ata kanë hedhur parullën që «ju po e vini veten jashtë Traktatit të Varshavës», se «për prishjen e bazës së Vlorës jeni ju shkaktarë që nuk zbatuat vendimin e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës» etj. Ata nuk menduan se kishte zgjidhje të tjera, të drejta për mbajtjen e bazës. Veprimi i tyre ishte një komplot, ata kërkonin të gjenin njerëz për të luftuar Partinë, Qeverinë dhe popullin shqiptar.

Ndihmat ushtarake nga ana e BS për ne kanë marrë fund. Dihet se ndihmat ekonomike, ashtu edhe ato ushtarake, pas Mbledhjes së Bukureshtit, bile edhe më përpara, akoma nuk na janë dhënë. Nuk do të flas për frymën e shëndoshë politike e ideologjike si dhe për entuziazmin jashtëzakonisht të madh që ekziston në ushtrinë tonë, këtë ju e dini, por edhe nga ana ekonomike, e armatimeve dhe e gatishmërisë ushtarake i themi Komitetit Qendror se gjendja në ushtri është më e mirë se kurrë ndonjëherë tjetër, se janë marrë të gjitha masat që potenciali ushtarak, armatimet dhe nevojat e tjera të ushtrisë të shumëfishohen. Prandaj edhe në këtë drejtim udhëheqja sovjetike dhe ata që i pasojnë dështuan.

Ata dështuan në qëllimin e tyre të keq për të frikësuar dhe për të tronditur opinionin shqiptar me largimin e nëndetëseve, dështuan në mendimin se ushtria jonë do të mbetej pa furnizime, me gisht në gojë, se do t'i vjetroheshin armatimet, do t'i mbaroheshin veglat e ndërrimit për armët etj. Kështu qëndrojnë punët në çështjet ushtarake.

Në fushën ekonomike ju e dini qëllimin e tyre, t'i prisnin çdo ndihmë Shqipërisë. Ata na prenë kreditë, na hoqën specialistët dhe sa të jetë e mundur përpiqen të zvogëlojnë sferën e marrëdhënieve tregtare me ne. Dhe këta ata e kanë vënë në zbatim në mënyrë dhelparake. Në të gjitha letrat e tyre, veçanërisht në letrën e KQ të PK të BS, të Çekosllovakisë, të Gjermanisë dhe të Hungarisë tani në fund thuhet haptazi se do t'i ndërtojnë marrëdhëniet me Shqipërinë vetëm mbi baza reciproke. Ata nuk kanë guximin dhe kurajën të na thonë

hapur se na i presin kreditë që na kanë akorduar, të cilat në fakt ata na i kanë prerë.

Por edhe presionet e tyre të mëdha ekonomike dështuan. Komiteti Qendror i Partisë sonë e ka të qartë se plani ynë pesëvjeçar është i siguruar financiarisht dhe do të realizohet. Kush dëshiron të mbajë fjalën, le të japë ndihmën që i ka premtuar Shqipërisë në kushtet e mëparshme, në bazë të marrëveshjeve. Por ne mendojmë se një gjë e tillë nuk do të bëhet, nuk duhet pasur asnjë iluzion, sepse është fakt që udhëheqjet e partive të vendeve socialiste të Evropës kanë shkelur çdo normë dhe do të vazhdojnë të ecin në këtë rrugë. Ne kemi ku mbështetemi në realizimin e planeve tona.

Çështja e specialistëve ka qenë akoma më skanda-loze. Duke qenë në dijeni të taktikave dhelparake, poshtuese dhe shpifëse, gjatë gjithë këtyre veprimeve ndaj vendit tonë, neve na është forcuar bindja se kemi të bëjmë me një grup trockistësh nga më të këqijtë që ka parë historia. Këta, nga një anë na thanë se me urdhër të qeverisë sovjetike duhet të hiqeshin specialistët e naftës nga Shqipëria, dhe, nga ana tjetër, i thanë drejtorit të naftës që specialistët e naftës do të largohen nga Shqipëria me urdhër të ministrit të Industrisë. Këto janë poshtërsi të mëdha, po sa të tjera ka të tilla.

Për çështjet tregtare duhet thënë se ata kundër çdo praktike nuk kanë pranuar të nënshkruajnë me ne marrëveshje tregtare me afat të gjatë për vitet 1961-1965, kurse marrëveshje të tilla ata po i zbatojnë edhe me vendet kapitaliste. Pala sovjetike kreditë na i ka bllo-

kuar. Kështu qëndrojnë marrëdhëniet tregtare me këto vende.

Edhe marrëdhëniet kulturore nuk janë në rrugë të mbarë për faj të tyre. Ne asgjë nuk kemi ndryshuar edhe në këtë fushë.

Në çështjet politike ne mbajmë gjithashtu qëndrim të drejtë, i cili i tërbon ata. Shtypi dhe radioja janë vazhdojnë të shkruajnë e të flasin për zhvillimin ekonomik, kulturor etj., të Bashkimit Sovjetik dhe të vendeve të demokracisë popullore, kurse nga ana e tyre janë shkelur të gjitha marrëveshjet. Në Bashkimin Sovjetik kanë ndaluar botimin e revistës «Shqipëria e re» në gjuhë rusisht dhe arabisht, sepse ajo paska materiale «dogmatike» e u bëjmë dëm arabëve me vijën tonë «dogmatike»!

Marrëveshjet kulturore të nënshkruara me ne po shkelen. Mjafton ky fakt për të treguar realitetin. Ata nuk pranuan ansamblin tonë të këngëve dhe të valleve popullore që shkoi në Kinë, në Vietnam dhe në Kore, ku pati suksese të mëdha. Vajtjen e ansamblit tonë edhe në Bashkimin Sovjetik ne e kishim kërkuar në bazë të marrëveshjes së firmosur bashkërisht dhe kërkesa është bërë qysh në fillimin e muajit maj. Por tani pala sovjetike na përgjigjet se nuk e pret, duke u justifikuar se kërkesa u ka shkuar me vonesë. Ky qëndrim kuptohet se ku i ka rrënjët. Pala sovjetike ka frikë se ansambli ynë do të ketë sukses, se nga spektatorët do të duartrokitet për miqësinë e do të protestohet për poshtërsitë që thuhën kundër Shqipërisë. Shumë njerëz sovjetikë e kanë lexuar raportin e Komitetit Qendror mbajtur në Kongresin IV të Partisë dhe në të kanë lexuar që

askush nga ne nuk i ka hedhur baltë Bashkimit Sovjetik.

Pra udhëheqësit sovjetikë kanë shumë frikë edhe nga politika jonë e drejtë kulturore. Edhe udhëheqja bullgare ka dhënë urdhër të hiqen këngët shqiptare nga programi i Radio Sofjes. Në festivalin ndërkombëtar të vendeve tona që u zhvillua në Rumani, në programin e koncertit ishte caktuar për t'u kënduar edhe kënga shqiptare e bilbilit. Në këtë këngë flitet për rrugën që ka ndjekur populli ynë nën udhëheqjen e Partisë etj. Juria dhe artistët e pritën këtë këngë me entuziazëm të madh, mirëpo, kur i erdhi radha koncertit, nuk u dha dhe këtë e justifikuan me sëmundjen e dirigjentit. Siç u muar vesh më vonë, koncerti nuk u dha për shkak të këngës shqiptare që ishte në program. Kështu ngjet në Bashkimin Sovjetik, në Bullgari, në Rumani etj., kurse në Mongoli nuk paskej hotel për të pritur pjesëtarët e ansamblit tonë. Këta njerëz kanë frikë të kenë marrëdhënie me ne se nuk janë në rregull dhe këto na bindin akoma më shumë sa të drejtë e ka rrugën Partia jonë.

Studentët tanë në Bashkimin Sovjetik bëjnë një luftë heroike për të mbrojtur vijën e Partisë. Në universitet, në institutet e Moskës dhe në të gjitha anët e Bashkimit Sovjetik ku studjojnë, ata kanë qartësuar kokën e njerëzve sovjetikë, sepse udhëheqja atje i mban me gënjeshtër njerëzit, prandaj këta vetëm të tanët gjejnë të vërtetën dhe të drejtën dhe kështu arrijnë të bëjnë edhe ndonjë konkluzion. Këtu duhet vënë në dukje se ambasadori ynë në Bashkimin Sovjetik ka ditur t'i mbajë mirë në korent studentët tanë. Kështu

kanë vepruar edhe ambasadorët tanë në vendet e demokracisë popullore. Gati të tërë ambasadorët tanë janë treguar në nivelin e detyrave të rëndësishme që u ka ngarkuar Partia, komunistë të vërtetë, diplomatë revolucionarë.

Veçanërisht kanë bërë një punë të mirë shokët që studjonin në Shkollën e Lartë të PK të BS, të cilët jetonin ditë dhe net në luftë me shtrembërimet e teorisë marksiste-leniniste, me përpjekjet për të futur në atë shkollë teoritë revizioniste dhe trockiste. Ata me vendosmëri, që nga shokët e kursit të parë dhe deri te ata të kursit të tretë, kanë bërë një luftë jashtëzakonisht të madhe për mbrojtjen e Partisë sonë dhe të marksizëm-leninizmit. Kjo ka pasur rëndësi shumë të madhe sepse në Shkollën e Partisë ka kuadro nga të gjitha anët e Bashkimit Sovjetik dhe nga vendet e demokracisë popullore.

Situata atje tani është e tillë, që shumë nga ata që diskutojnë me shokët tanë janë plotësisht me ne. Shokët tanë që jetojnë në Bashkimin Sovjetik, po shikojnë ç'situata ka krijuar për komunistët sovjetikë grupi i Hrushovit. Ju i dini mirë masat që ka marrë udhëheqja sovjetike për të mbuluar dështimet në bujqësi. Edhe këtu dështoi politika narodnike e Hrushovit për shkak të shkeljeve të mësimave leniniste në çështjet e bujqësisë, të shkeljes së parimeve, që nuk i luan as topi, të J. V. Stalinit që pasqyrohen edhe në veprën e tij të fundit «Problemet ekonomike të socializmit në Bashkimin Sovjetik». Lexojeni shokë edhe një herë këtë veper dhe do të shihni se ku të çon politika e Hrushovit që po dështon.

Kjo vijë ka krijuar vështirësi të mëdha ekonomike në Bashkimin Sovjetik. Me javë dhe muaj nuk gjenden me lehtësi mish, sallam dhe produkte të tjera. Ka marrë hov tregu i zi në një kohë që Hrushovi ka hedhur parullën e ndërtimit të shoqërisë komuniste. Të vjen keq me liberalizmat që duken në Bashkimin Sovjetik, të cilat çojnë në shthurjen e moralit, në krijimin e një konfuzioni të madh, në korruptimin e rinisë, në rrugët e mbushura plot me turistë që përpiqen të bëjnë punë spiunazhi etj. Të gjitha këto janë rezultat i politikës oportuniste e revizioniste të klikës hrushoviane. Në Bashkimin Sovjetik po ndodhin gjëra që janë të pabesueshme, por faktet janë fakte.

Si janë marrëdhëniet me vendet e tjera të demokracisë popullore?

Me Poloninë deri sot marrëdhëniet nuk kanë pësuar asnjë ndryshim. Gomulka është Titoja i dytë, shpif sa të duash kundër nesh. Vetëm marrëdhëniet tregtare polakët i mbajnë.

Jashtëzakonisht ulët po sillet udhëheqja çekoslllovakë. Kjo udhëheqje revizioniste është pajisur me një shpirt të theksuar mikroborgjez tregtar që e bën akoma më të rrezikshme. Ata janë matrapazë, luftojnë sa më shumë për para. Këtë shpirt ata e tregojnë edhe në politikë. Ata drejtojnë sharje kundër udhëheqjes së Partisë sonë dhe mbrojnë e pajtohen me Hrushovin kundër vendit tonë.

Edhe përpara miqve të Shqipërisë në Çekosllovaki udhëheqja çekoslllovakë mban qëndrime të poshttra. Ju e dini se para ca kohësh kishte ardhur për të vizituar Shqipërinë gruaja e një komunisti të vjetër çekosll-



vak, bashkëpunëtor dhe shok i afërt i Klement Gotvaldit, një nga themeluesit e PK të Çekosllovakisë. I shoqi i saj ishte mik i Shqipërisë, ka shkruar për Shqipërinë, ka bërë tablo për vendin tonë. Ai ka vdekur, po e shoqja që është një grua e moshuar, komuniste e vjetër, e do Shqipërinë dhe ecën në gjurmët e burrit të saj. Ftesën për të vizituar vendin tonë ajo e priti me një kënaqësi jashtëzakonisht të madhe. E ftuam për drekë unë e shoku Mehmet, u muar vendim të shtypeshin edhe librat e të shoqit mbi Shqipërinë, që në Çekosllovakia nuk ia shtypin. Por këtë grua komuniste, të patriotit të shquar çekoslovak, nuk e priti njeri nga ambasada çekosllovake kur arriti në Tiranë, bile, pas disa ditësh qëndrimi këtu, i hoqën vërejtjen e i bënë presione të largohej sa më parë nga Shqipëria. Kur u kthye në Çekosllovakia, çështjen pse vajti në Shqipëri ia ngritën në organizatën-bazë dhe tani kanë filluar sulmet kundër saj për qëndrimet në favor të vendit dhe të popullit tonë. Edhe kur e thirrën këtu në ambasadën çekosllovake, edhe përpara organizatës-bazë, në Çekosllovakia, i kanë bërë mjaft presione, por ajo ka qëndruar e patundur. Tani marrim vesh se ajo ka shkruar në një uzinë, ka bërë një konferencë për Shqipërinë dhe ka folur me entuziazëm për vendin tonë.

Udhëheqja gjermane, sikurse e dini, vazhdon rrugën e provokacioneve. Përveç provokacionit të hapët në lidhje me botimin e fjalës së Valter Ulbrihtit, të cilit ne iu përgjigjëm me letër korrekte, ata i kanë dhënë urdhër shtypit të tyre që të mos flitet asnjë fjalë për vendin tonë. Të lexosh letrën e një farë Vili Shtof kupton menjëherë se ai është me të vërtetë një fashist. Me

atë letër ai tregon se është bashkëpunëtor i komplotit të Flotës VI Amerikane, në bashkëpunim me revizionistët jugosllavë dhe monarko-fashistët grekë kur na akuzon ne, shqiptarët, që provokojmë Jugosllavinë, Greqinë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të tillë njerëz janë ata.

Udhëheqja hungareze deri para pak kohe mbante disa qëndrime të ndryshme nga të tjerët, gjë që të bënte të mendoje se udhëheqja hungareze kishte nxjerrë mësimë të thella nga e kaluara. Ajo na dha edhe një ndihmë prej 15 milionë rublash. Ne u kërkuam leje për njoftimin në shtyp të këtij akti dhe na u kthye përgjigje pozitive. Mirëpo përpara ndonjë jave nga udhëheqja hungareze na u dërgua një letër e firmosur nga Janosh Kadari<sup>1</sup>, në të cilën akuzohemi si antisovjetikë të tërbuar. Në letër theksohet sikur ne lajmin mbi dhënien e ndihmës nga ana e udhëheqjes hungareze e pas kemi botuar për të futur spica ndërmjet Bashkimit Sovjetik dhe Hungarisë. Kështu ata na detyrojnë të mohojmë ndihmat e tyre. Ne i falenderojmë, siç është e udhës, për këto ndihma, kurse ata duan që ne të heshtim për to me qëllim që pastaj të na sulmojnë si mosmirënjohës.

Kadari na e ka dërguar këtë letër, se udhëheqja sovjetike, me siguri, i ka tërhequr veshin pse na e dha ndihmën, sikurse bëri me udhëheqjen bullgare, së cilës i tha përse u dhatë shqiptarëve si dhuratë bustin e Gjergj Dimitrovit. Kadari dhe Komiteti Qendror i Partisë së Punonjësve të Hungarisë marrin në mbrojtje

<sup>1</sup> Shih letërpërgjigjen në këtë vëllim, f. 405.

tje komplotistët dhe pohojnë se ata janë njerëzit e tyre. Bukur, nuk ka dokument më të mirë për ne që vërteton se Kadari është bashkëpunëtor i komplotistëve, agjentë të imperialistëve. Edhe revizionistët jugosllavë, që kanë qenë bashkëpunëtorë direktë në këtë komplot kundër RPSH, luftojnë për ta mohuar një gjë të tillë, ndërsa Kadari na i quan komplotistët që janë kundërshtarët tanë politikë, se na qenkan marksistë dhe na akuzon se pushkatimi i tyre është i padrejtë!

Udhëheqja bullgare me Zhivkovin në krye është në të njëjtat pozita si të tjerat. Edhe ajo ka vendosur bllokadën kundër vendit tonë. Mirëpo redaksia e gazetës «Trud» shkeli vijën e përgjithshme që mban udhëheqja bullgare ndaj vendit tonë dhe botoi lajmin mbi gjyqin e Tiranës duke e cilësuar vendimin e tij si një vendim të drejtë kundër tradhtarëve të popullit shqiptar, agjentë të revizionistëve jugosllavë. Menjëherë udhëheqjes bullgare i shkoi protesta e Titos dhe po atë ditë Teodor Zhivkovi mblodhi byronë politike të PK të Bullgarisë, e cila vendosi pushimin e presidentit dhe të katër sekretarëve të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Bullgarisë.

Pra kuptohet se të gjitha udhëheqjet e vendeve socialiste të Evropës, me Hrushovin në krye, kanë marrë vendim të përbashkët për qëndrime antisocialiste dhe antishqiptare ndaj Partisë dhe vendit tonë.

Si kemi qëndruar ne përpara këtyre situatave? Ne jemi përpjekur dhe kemi qëndruar gjakftohtë, kemi mbrojtur vijën tonë të drejtë dhe nuk jemi lëkundur. Po edhe ato që na hedhin, ne nuk i hamë, por u japim përgjigjen e merituar. Si na shkruajnë, ashtu u shkru-

ajmë, por në rast se ata shpifin, ne arsyetojmë në rrugën e drejtë marksiste-leniniste dhe në këtë rrugë ua hedhim poshtë shpifjet.

Këtë frymë dhe këtë karakter ka edhe letra që do t'i dërgojmë Komitetit Qendror të PK të BS në përgjigje të letrës së Kosiginit për të gjitha problemet që janë ngritur atje, për sjelljet dhe qëndrimet politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake që kanë mbajtur dhe mbajnë ndaj Partisë dhe popullit shqiptar. Në këtë letër ne shfaqim gjithashtu edhe pikëpamjen tonë se si duhen ndrequr këto çështje.

Gjithashtu është për t'u vënë në dukje edhe qëndrimi i ambasadave të vendeve socialiste të Evropës në vendin tonë. Qëndrimi i punonjësve të këtyre ambasadave pasqyron qëndrimet e udhëheqjeve të tyre. Këto janë kthyer në ambasada vëzhgimi, sulmi dhe diversioni kundër Partisë dhe popullit tonë. Prandaj edhe qëndrimi ynë ndaj tyre duhet të jetë shumë i rezervuar. Takimeve me ta ne nuk u trembemi aspak. Shokët vetëm të jenë vigjilentë, t'u japin përgjigjen e merituar në rast se në këto takime ata provokojnë, t'i demaskojnë provokatorët dhe provokacionet. Kur ata na vinin për takime në kohën e marrëdhënieve me të vërtetë miqësore, ne kemi biseduar me ta si miq, si vëllezër, por tani provokimeve të tyre duhet t'u tregohet vendi. Tani do të sillemi si na sillen ata.

Të jemi vigjilentë ndaj lëvizjeve dhe takimeve të këtyre njerëzve me «nuset» që kanë në vendin tonë. Disa nga shokët tanë janë martuar dhe ne asgjë nuk kemi kundër atyre vajzave sovjetike ose të vendeve të tjera që qëndrojnë në rrugë të drejtë marksiste-lenin-

niste, kurse atyre që mbrojnë Hrushovin t'u tregohet rruga nga erdhën. Prandaj burrave të tyre shqiptarë, me parti ose pa parti, t'u bëhet e qartë se më parë është Partia dhe atdheu pastaj gruaja, kryesorja është të mbrosh Partinë dhe atdheun dhe këto duhet t'i mbrojnë edhe familja edhe fëmijët e secilit, pa përjashtim. Kjo është e qartë. Po të jetë se gruaja e huaj e ndonjë shoku, me parti ose pa parti, mban qëndrim miqësor ndaj popullit dhe Partisë sonë, nëse ajo nuk bën propagandë për vijën e Hrushovit, nëse nuk bën provokime etj., le të ecë përpara bashkë me njerëzit tanë, por në rast se ajo vepron ndryshe, komploton në dëm të Partisë dhe të vendit tonë dhe burri i saj mbyll sytë, atëherë ai le ta marrë përgjegjësinë mbi vete se Partia do të marrë masa karshi asaj dhe atij që mbyll sytë.

Vija jonë e përgjithshme ka qenë dhe është e drejtë. Qëndrimi ynë konsekuent i dhemb Hrushovit me shokë. Por neve aq na bën. Edhe në të ardhshmen ne do të ecim të vendosur në rrugën tonë marksiste-leniniste. Në çështjet e politikës ndërkombëtare ne si kurdoherë do të ecim në bazë të marksizëm-leninizmit, në bazë të vijës së drejtë të Partisë sonë.

Situata kërkon që nga redaktorët e gazetave tona të bëhet një politikë e zgjuar. Në punën e tyre ata duhet të nisen kurdoherë nga pozitat e Partisë sonë. Kryesorja është të mbrohen pikëpamjet e drejta marksiste-leniniste, por në të njëjtën kohë duhet me qenë të ashpër kundër përçarësve dhe deviatorëve. Atyre që hedhin thumba për të na dobësuar t'u biem kokës dhe të jemi vigjilentë për të mbrojtur unitetin, radhët e Partisë dhe të popullit tonë.

Të jesh vigjilent nuk do të thotë të grumbullosh fakte negative për njerëzit dhe në fund pastaj t'ua numërosh një nga një me radhë. Kjo nuk është vigjilencë. Njerëzit që gjatë jetës dhe veprimtarisë së tyre gabojnë ose japin shenja të moskuptimit ideologjik ose politik, t'i ndihmojmë, të bëjmë përpjekje që të kuptojnë drejt ku i kanë gabimet dhe të mobilizohen për të zbatuar vijën dhe direktivat e Partisë. Prandaj duhet menduar mirë për trajtimin e njerëzve që janë tanët por gabojnë, të ndihmohen me kohë që të mos arrijnë gjer atje sa të bien në gabime të rënda e të bëhen të pandreqshëm.

Partia, pra, të punojë me urtësi e vigjilencë dhe të mos harrojë se përveç nesh punon edhe armiku që lufton të futë spica në njerëzit. Në këtë drejtim duhet të jemi të zgjuar. Po është fakt se në përgjithësi trajtimi i njerëzve që gabojnë, nga ana e Partisë, e organeve të drejtësisë dhe të Sigurimit të Shtetit ka qenë në rrugë marksiste-leniniste. Është treguar pjekuri dhe dhembshuri e madhe për njerëzit tanë, frymë e lartë revolucionare dhe e ashpër klasore ndaj njerëzve të pandreqshëm, armiq të Partisë dhe të shtetit, dhe që janë futur në bashkëpunim të fshehtë ose të hapët me imperialistët, revizionistët, monarko-fashistët grekë ose me neofashistët italianë. Këtë qëndrim të drejtë marksist-leninist kanë treguar Partia jonë, organet e Sigurimit të Shtetit dhe populli. Prandaj këtë frymë ta mbajmë gjallë. Të forcojmë në popull dashurinë dhe besimin e madh për njerëzit e Partisë, të ushtrisë, të sigurimit. Kjo dashuri dhe ky besim i madh është krijuar në vendin tonë për këta njerëz.

Mua më vijnë shumë letra nga populli dhe i lexoj ato përditë, çdo mëngjes, para se të filloj nga puna. Ditët e fundit kam lexuar edhe letrën e një qytetari, i cili thotë haptas se ka qenë në kundërshtim politik me Partinë, nuk kishte asnjë besim te ajo, duke e konsideruar si të shitur te të huajt, shërbëtore të verbër të sovjetikëve. «Por, kur mora vesh të gjitha këto gjëra, shkruan ai, dhe pashë qëndrimin heroik marksist-leninist të Partisë, se si ajo mbron me vendosmëri çështjen e drejtë, si mbron atdheun dhe popullin, si dhe çështjen e socializmit, zotohem se do të jem besnik deri në fund ndaj Partisë». Shikoni ç'transformim të madh ka bërë puna e Partisë në kokën e këtij njeriu!

Veçanërisht gjyqi i fundit ka bërë një përshtypje jashtëzakonisht të madhe në popullin tonë. Ai ka ngjallur një urrejti të thellë kundër tradhtarëve dhe spiunëve, kundër imperialistëve dhe revizionistëve dhe një entuziazëm e patriotizëm të pashembullt në masat tona punonjëse. Rreziku i komplotit të zbuluar që dështoi, ka qenë shumë i madh. Me këtë rast duhet vënë në dukje edhe zotësia, vendosmëria, zgjuarsia e shokëve tanë të Ministrisë së Punëve të Brendshme që zbuluan me kohë veprimtarinë armiqësore të këtyre banditëve, hodhën në dorë fakte dhe dokumente shumë të rëndësishme, vepruan me kujdes të madh, pa u ngutur, sipas udhëzimeve të Byrosë Politike të KQ, por edhe pa lënë që të rrezikohej çështja. Kjo punë bëri që edhe t'i shpëtojmë rrezikut të madh e të tronditim edhe planet e imperialistëve dhe veçanërisht të imperializmit amerikan.

Kështu, pra, gjyqi ka pasur një rëndësi të madhe

dhe pse ka pasur këtë rëndësi, sepse janë zbuluar plane të errëta ndaj Partisë dhe popullit tonë, prandaj Hrushovi dhe lakejtë e tij janë tërbuar aq shumë sa bëjnë të tilla absurditete që arrijnë të mbrojnë spiunët dhe tradhtarët. Por le t'i mbrojnë, faktet janë shumë kokëforte. Le të thotë Gomulka se këto gjëra janë të fabrikuara, po të ketë kujdes se mos i dalë edhe atij emri ndonjë ditë në ndonjë gjyq.

Ne do të vazhdojmë dhe kemi besim se do të vazhdojmë me këtë frymë në realizimin e planeve tona. Revizionistët nuk kanë ç'të na bëjnë. Ne jemi të fortë dhe nuk jemi vetëm. Duhet ditur se Partia Komuniste e Kinës qëndron e patundur në parimet e marksizëm-leninizmit. Të gjitha veprimet tona ajo i mbështet qind për qind. Çu En Lai i ka dhënë një përgjigje të ashpër Bashkimit Sovjetik në lidhje me përgjigjen e Kosiginit. Udhëheqja kineze është dakord me të gjitha çështjet me ne, nuk ka asnjë moskuptim midis nesh.

Duhet ditur se ka vende socialiste dhe parti komuniste të tjera që e vlerësojnë qëndrimin tonë të drejtë. Pastaj në këtë rrugë luftojnë me miliona komunistë të vërtetë në të gjithë botën.

Komiteti Qendror do të mbahet vazhdimisht në dijeni për zhvillimin e mëtejshëm të situatave. Ka rëndësi që të vëmë në dijeni edhe gjithë Partinë. Ja tani Byroja Politike ka marrë vendim t'u dërgohet një letër gjithë organizatave-bazë të Partisë ku të shpjegohet situata e zhvilluar pas dërgimit të letrës së parë. Kjo masë ka një rëndësi të madhe, se forca jonë qëndron te Partia. Partia duhet të jetë e qartë në mënyrë që, kur vjen rasti, ajo të jetë në gjendje të sqarojë popullin.



Natyrisht me popullin ne nuk do të bëjmë mitingje, po atij duhet t'i bëhen të ditura këto çështje, me të i qajmë hallet. Populli duhet t'i dijë çështjet në frymën e Partisë sonë. Pastaj këto çështje i di Londra dhe jo të mos i dijë populli ynë. Të gjitha materialet e Mbledhjes së Moskës kanë rënë në duart e anglezëve që mund t'i kenë marrë në Bullgari, në Poloni, në Hungari ose gjetkë. Atje fjalimin që mbajtëm në Moskë po e komentojnë copa-copa nëpër gazeta dhe e lexon publiku.

*Pasi lexohet dhe aprovohet teksti i letrës që Byroja Politike e KQ të PPSH ka pregatitur për KQ të PK të BS, shoku Enver Hoxha përfundoi:*

Meqenëse kjo çështje për pikën e dytë të rendit të ditës të këtij Plenumi bëhet e përbashkët me Qeverinë, propozoj që letra, e cila u lexua e u aprovua këtu, t'i drejtohet jo vetëm KQ të PK të BS, por edhe qeverisë sovjetike dhe për dijeni t'u dërgohet komiteteve qendrore të partive dhe qeverive të të gjitha vendeve socialiste<sup>1</sup>.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

---

<sup>1</sup> Ky propozim u aprovua njëzëri. Shih letrën e botuar në «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 25. Tiranë, 1970.

## **BAKSHISHET NUK PAJTOHEN ME NORMAT E MORALIT KOMUNIST**

*Letër dërguar komiteteve të Partisë të rretheve*

**11 korrik 1961**

### **GJITHË KOMITETEVE TË PARTISË TË RRETHEVE**

Komiteti Qendror i PPSH i ka udhëzuar vazhdimisht organizatat e Partisë që të shtojnë dhe të përmirësojnë më tej punën për edukimin e punonjësve me moralin komunist. Një rëndësi të veçantë ka pasur letra e Komitetit Qendror të PPSH, që flet mbi disa shfaqje të huaja në ndërgjegjen e njerëzve<sup>1</sup>, e cila ka shërbyer si një program i gjerë pune për t'u bërë një luftë më të organizuar dhe më këmbëngulëse këtyre mbeturinave, për t'i bërë më të ndërgjegjshëm njerëzit tanë në punë dhe në shoqëri.

Frytet e punës edukative që kanë bërë organizatat e Partisë janë të mëdha. Të panumërta janë rastet e

---

<sup>1</sup> Shih Enver Hoxha, Vepra, vëll. 18, f. 1.

heroizme dhe të vetëmohimit të punonjësve në punë, të qëndrimeve të ndërgjegjshme që ata mbajnë në zbatimin e detyrave dhe në mbrojtjen e interesave të shtetit dhe të Partisë. Këto tregojnë për formimin e njeriut të ri të shoqërisë sonë socialiste.

Por, pa zvogëluar rezultatet e arritura, organizatat e Partisë duhet ta vazhdojnë më tej punën për të zhdukur mbeturinat borgjeze dhe mikroborgjeze në të gjitha format që ato paraqiten. Një nga këto shfaqje të huaja, që nuk ka asgjë të përbashkët me normat e shoqërisë sonë socialiste, është bakshishi si mbeturinë që prish ndërgjegjen e njerëzve.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, duke shqyrtuar këtë problem, i udhëhequr nga qëllimi për të ruajtur njerëzit, për të edukuar njerëz të ndershëm, me veti të larta dhe me karakter të shëndoshë, e konsideron të nevojshëm organizimin e luftës për të zhdukur bakshishin si një shfaqje të huaj për rendin tonë socialist.

Dhënia dhe marrja e bakshisheve merr një zhvillim të madh dhe forma të shumëllojta në shoqërinë kapitaliste. Borgjezia e nxit përhapjen e bakshisheve kryesisht për të shtuar shfrytëzimin e proletariatit, për të korrë elementët e paqëndrueshëm në radhët e tij. Borgjezia e përdor këtë për t'i siguruar vetes preferenca dhe shërbime të veçanta, ndërsa pronarët e hoteleve, të restoranteve, të ndërmarrjeve komunale etj., duke llogaritur të ardhurat që kanë punonjësit nga bakshishet, u zbresin vazhdimisht rrogat dhe shtojnë kështu shfrytëzimin e tyre.

Edhe në vendin tonë në të kaluarën punonjësit e

tregtisë, të komunikacionit, të shëndetësisë, të ekonomisë komunale dhe të sektorëve të tjerë të shërbimit shfrytëzoheshin egërsisht nga pronarët e mjeteve të prodhimit dhe merrnin rroga shumë të ulëta. Ata, për të përmirësuar sado pak kushtet e vështira të jetesës së tyre, janë mësuar të marrin bakshishe. Me vendosjen e pushtetit popullor gjendja u ndryshua rrënjësisht. Tani punonjësit e shërbimit janë zotër të mjeteve të prodhimit; në këtë mënyrë baza ekonomiko-shoqërore që krijoi bakshishin është zhdukur.

Parimi socialist që krijon të ardhurat e punonjësve është: secili të shpërblehet sipas sasisë dhe cilësisë së punës që bën dhe kjo shprehet në nivelin e rrogave, në masën e realizimit të normave etj. Ky parim është futur thellë në të gjithë jetën tonë ekonomiko-shtetërore. Puna është kthyer në një detyrë, në një çështje nderi e lavdie për çdo njeri të aftë për të punuar. Në këto kushte, pranimi dhe marrja e bakshisheve përbën një burim të ardhurash që punonjësi nuk i realizon nga puna e tij, sepse për atë ai merr rrogën, por i realizon këto nga diferencimet dhe preferencat që bën në shërbimin e popullit, domethënë nga moskryerja mirë e detyrës së ngarkuar. Prandaj te ne pranimi dhe marrja e bakshisheve cilësohet me të drejtë si mbeturinë borgjeze, si një shfaqje e huaj për shoqërinë tonë, pra është në kundërshtim me kërkesat e moralit tonë komunist. Njëlloj e dëmshme është edhe dhënia e bakshisheve, prandaj personat që i japin ato bëjnë një punë të keqe. Dhënia e bakshishit, në çdo formë qoftë, tregon se ai person kërkon t'i bëhen preferenca në shërbime, të tregohet më tepër kujdes për të, në dëm

të shërbimit dhe të kujdesit që duhet të tregohet për të gjithë.

Me gjithë ndryshimet e mëdha ekonomiko-shoqërore që janë bërë në vendin tonë, vërehen akoma raste të dhënies e të marrjes së bakshisheve. Veçanërisht kjo mbeturinë borgjeze është e theksuar në disa punonjës të tregtisë, të shërbimeve, si kamerierë, shoferë, infermierë, berberë, rrobaqepës etj., bile prej tyre janë infektuar dhe punonjës të rinj. Për këtë arsye, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë tërheq vëmendjen e organizatave të Partisë, që të përmirësojnë punën për zhdukjen e bakshishit në tregti dhe në sektorët e tjerë të shërbimit.

Organizatave të Partisë duhet t'i vlerësojnë mirë pasojat që sjell dhënia dhe marrja e bakshishit. Dëmet që vijnë prej tij janë të mëdha, pasi zhvillon te punonjësit ndjenjën për të shtuar të ardhurat pa punuar, nuk i mobilizon në realizimin dhe tejkalimin e planeve, u largon vëmendjen nga puna, ul nivelin e shërbimit, i edukon keq në rrugën e përfitimeve të lehta, i çon drejt degjenerimit moral dhe në disa raste i shtyn në shpërdorimin e pasurisë socialiste. Krahas me këto punonjës të shërbimeve, duke bërë diferencime e preferenca, bëhen shkaktarë për krijimin e pakënaqësive në popull.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë porositi të gjitha organizatat e Partisë që të shtojnë punën edukative për të çrrënjësuar bakshishin, këtë njollë të zezë të së kaluarës. Natyrisht realizimi i kësaj detyre nuk është i lehtë. Kjo kërkon kohë dhe durim. Do të duhet një punë e madhe, e përditshme për t'i bindur punonjësit; duhet të përdoren të gjitha format

edukuese si bisedat, leksionet, diskutimi në mbledhjet e organizatës-bazë të Partisë dhe të kolektivit punonjës, përdorimi i parullave të përshtatshme etj. Por organizatat e Partisë duhet të kuptojnë mirë se duhet të merren përherë me këtë çështje dhe në mënyrë më të organizuar, të jenë më këmbëngulëse, të dinë të kalojnë, si kurdoherë, çdo vështirësi që u del përpara.

Organizatat e Partisë duhet të krijojnë një atmosferë të shëndoshë morale, edukative, që punonjësit e shërbimit të mos marrin bakshishe. Le të jenë të parët komunistët që punojnë si shitës, kamerierë, bufetjerë, shoferë, infermierë etj., ata që të marrin inisiativën për të luftuar këtë mbeturinë në lokalet dhe në qendrat ku punojnë dhe me shembullin e tyre të tërheqin edhe punonjësit e tjerë.

Organizatat e masave, sidomos ajo e bashkimeve profesionale dhe e rinisë, ta vlerësojnë zhdukjen e bakshishit nga punonjësit e shërbimit si një nga detyrat e tyre të përditshme. Ato duhet ta kthejnë këtë në një lëvizje të gjerë të vetë punonjësve, të edukojnë në ta sedrën për të mos e ulur veten para lëmohave dhe të jenë të ndershëm. Rastet e pranimit ose të kërkimit të bakshisheve të diskutohen në mbledhjet e grupeve, të kritikohen në gazetat e murit etj. Krahas me këto, organizatat e masave duhet të edukojnë të gjithë punonjësit që të mos japin bakshishe për shërbimet që u kryhen.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ka besim se organizatat e Partisë do ta marrin në dorë këtë çështje për të çrrënjosur këtë mbeturinë borjeze të së kaluarës nga punonjësit e shërbimit.

Komitetet e Partisë, duke studjuar me vëmendje

këtë çështje, duhet të përcaktojnë masat për punimin e kësaj letre dhe për trajtimin e problemit në organizatat-bazë të Partisë e pastaj me punonjësit. Ky problem nuk zgjidhet përfundimisht me punimin e letrës, sepse likuidimi i mbeturinave të së kaluarës dhe kalitja e ndërgjegjes socialiste është një proces i gjatë, prandaj nga ana e komiteteve të Partisë të ndiqet me kujdes të posaçëm puna për edukimin komunist të punonjësve edhe në këtë drejtim.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## POPULLI YNË KA TRASHËGUAR NJË KULTURË TË MADHE ME TRADITA PËRPARIMTARE

*Fjala në mbledhjen me shkrimtarët dhe artistët*

**11 korrik 1961**

Të dashur shokë e shoqe,

Është një kënaqësi për mua të asistoj në këtë mbledhje dhe mund të them se kam përfituar shumë nga diskutimet tuaja të drejta në përgjithësi, të zjarra, të përshkuara nga një frymë e lartë patriotike dhe një dashuri e pakufishme për popullin dhe Partinë tonë të shtrenjtë të Punës. Me këtë rast, shokë shkrimtarë dhe artistë, dëshiroj t'ju transmetoj përshëndetjet më të përzemërta të Komitetit Qendror të Partisë dhe t'ju siguroj ju se Partia dhe udhëheqja e saj, edhe në të ardhshmen, do të kujdesen për zhvillimin e kulturës në përgjithësi dhe në veçanti për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve në vendin tonë.

Këtë kujdes të natyrshëm, të domosdoshëm të Partisë, ju e keni ndierë në jetë. Ju, shkrimtarët e artistët,



bashkë me Partinë, keni kaluar e keni ndierë të gjitha vuajtjet, sakrificat dhe gëzimet e popullit tonë.

Gjatë gjithë këtyre viteve në veprën tuaj ju jeni ndihmuar nga ana ideopolitike e profesionale me të gjitha forcat dhe mundësitë që kanë ekzistuar. Përsa i përket anës materiale, ndihma ka ardhur duke u shtuar e duke u përmirësuar. Ju, si pjesëtarë të këtij populli, si bashkëluftëtarë të të njëjtit front me klasën punëtore dhe fshatarësinë, keni vënë re se edhe plotësimi i nevojave tuaja materiale ka shkuar gradualisht përpara, krahas përmirësimit të jetës së popullit.

Vendimi i fundit i Komitetit Qendror të Partisë<sup>1</sup> është marrë me qëllim që t'u jepet një hov akoma më i madh zhvillimit të letërsisë dhe të arteve në vendin tonë. Ky vendim, sikundër na kanë raportuar, siç kemi lexuar në shtyp dhe siç po e vëmë re edhe këtu nga diskutimet tuaja, është pritur mirë nga ju. Ju keni qenë dakord me këtë vendim dhe e keni parë të nevojshme që të udhëhiqueni prej tij në punën tuaj krijuese. Kjo është një gjë shumë e mirë, që tregon, përveç provave të tjera të panumërta që keni dhënë, se ju jeni bij të denjë të këtij populli, provon edhe një herë akoma se intelektualët tanë, shkrimtarët dhe artistët, në momente të mira e të vështira, ecin të vendosur në rrugën e marksizëm-leninizmit, u qëndrojnë besnikë Partisë dhe interesave të larta të popullit tonë e të socializmit.

---

<sup>1</sup> «Mbi zhvillimin e mëtejshëm të letërsisë dhe të arteve». 22 maj 1961.

## 1. — Letërsia dhe artet tona janë zhvilluar në rrugë të drejtë

Ç'mendim kanë Partia dhe udhëheqja e saj për zhvillimin e arteve dhe të letërsisë në vendin tonë gjatë këtyre 17 vjetëve të pasçlirimit? Unë mund të them, me pak fjalë, se pikëpamja e Partisë dhe e udhëheqjes së saj është se zhvillimi i letërsisë dhe i arteve në vendin tonë ka qenë i vrullshëm në të gjitha fushat. Ky zhvillim i vrullshëm dhe në rrugë të drejtë, brenda një kohe kaq të shkurtër, pa nxjerrë këtej konkluzione mburrjeje, dëshmon për fuqinë krijuese dhe talentin tuaj, të njerëzve të artit e të letërsisë, si dhe për vitalitetin e talentin krijues të popullit tonë.

Njerëzit tanë të letërsisë dhe të arteve janë të thjeshtë, ashtu siç është vetë populli ynë. Por duhet të themi se veprat tuaja, krijimtaria juaj, qoftë në letërsi, muzikë, pikturë, skulpturë, apo në artin skenik, ju nderojnë ju dhe gjithë popullin, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ky është një sukses i madh, sepse, të mos harrojmë, në Shqipëri, gjatë regjimeve antipopullore, ndryshe nga ç'ka ndodhur në vende të tjera, mundësitë për zhvillimin e letërsisë dhe të arteve kanë qenë shumë të kufizuara, për shkak të qëndrimit negativ dhe prapanik të borgjezisë së vendit ndaj letërsisë e arteve dhe mjeteve jashtëzakonisht të pakta që viheshin në shërbim të tyre. Por megjithëkëtë duke shfrytëzuar traditat e mëdha dhe të shkëlqyera të kulturës sonë, të letërsisë dhe të arteve tona, brenda një periudhe të shkurtër 17-vjeçare të pasçlirimit, u arritën suksese të

tilla që jo vetëm na gëzojnë ne, por, në radhën e sukseseve të tjera, janë një provë e gjallë e forcës jetëdhënëse të socializmit. Zhvillimi i letërsisë dhe i arteve është bërë në një rrugë të drejtë, sepse ka qenë kurdoherë i frymëzuar nga ideologjia marksiste-leniniste e klasës punëtore dhe nga interesat e popullit, është mbështetur në metodën e sprovuar të realizmit socialist, në trashëgimin më të mirë të letërsisë e të artit socialist e botëror.

Letërsia dhe artet në vendin tonë kanë ndjekur hap pas hapi ndërtimin e socializmit, edukimin e njeriut të ri, pa lënë pas dore traditat dhe zakonet e mira të popullit tonë, tradita dhe zakone që populli ynë i mrekullueshëm i ka ruajtur në shekuj. Këto tradita, në saje të rrugës së drejtë të Partisë, të ideologjisë marksiste-leniniste, me punën ndërtimtare të popullit, në të cilën hyn dhe luan një rol të madh edhe puna juaj, veprat tuaja, kanë edukuar, kanë krijuar dhe kanë rritur njerëzit e rinj në vendin tonë.

Kjo, sikurse dihet, është rezultat i vijës së drejtë të Partisë sonë. Një zhvillim i tillë nuk është i rastit. Në Shqipëri, nën udhëheqjen e Partisë, u bë revolucioni popullor, në bazë të ideologjisë së klasës punëtore u udhëhoq populli shqiptar në Luftën e tij Nacionalçlirimtare, si dhe në përpjekjet e mëvonshme për ndërtimin e socializmit. Kështu u arritën këto rezultate të mrekullueshme që shohim sot në vendin tonë.

Një çështje tjetër që ka rëndësi të madhe është fakti se zhvillimi i letërsisë, i muzikës, i arteve figurative etj. në vendin tonë ka një karakter masiv, ka një karakter popullor dhe thellësisht demokratik. Këtu du-

het të gjejmë ne arsyen e vërtetë që letërsia dhe artet tona nuk kanë rënë dhe me siguri nuk do të bien në llumin e dekadentizmit borgjez. Zhvillimi i vendit tonë në rrugën që udhëheq Partia ka bërë që të lulëzojë dhe të shpëtojë nga rreziku i deviacioneve jo vetëm ndërtimi i përgjithshëm i socializmit në Shqipëri, zhvillimi i industrisë, i bujqësisë, i kulturës, por të shpëtojnë edhe letërsia e artet nga rreziku i deviacioneve politike dhe ideologjike. Prandaj mund të themi me plot gojën se letërsia dhe artet tona në përgjithësi janë zhvilluar në rrugë të shëndoshë. Kjo ka rëndësi të madhe.

Kështu, pra, shokë, i konsideron Partia dhe udhëheqja e saj veprat tuaja. Ato kanë luajtur një rol të madh drejtpërdrejt në transformimet e mëdha ekonomike dhe moralo-politike të popullit tonë. Prandaj Partia dhe populli ynë ju janë mirënjohës për përpjekjet tuaja të mëdha në këtë fushë të rëndësishme dhe jetike për popullin tonë.

Por a janë të gjitha veprat tuaja të përsosura? A janë ato pa gabime dhe pa të meta nga ana e përmbajtjes, e stilit, e gjuhës etj.? Natyrisht është e pamundur që veprat tuaja të jenë të përsosura. Perfeksionimi, si në çdo fushë tjetër, edhe në letërsi e në arte vjen me kohë, me përpjekje, me rritjen e kuadrove, me rritjen e pjekurisë së tyre, me ngritjen e vazhdueshme të kulturës së njerëzve.

Ju mbani mend se sa pak kuadro ka pasur vendi ynë para Çlirimit, sidomos në fushën e arsimit e të kulturës. Ndërsa tani ne kemi një numër të konsiderueshëm kuadrosh, që kanë mbaruar shkollat, dhe në saje të punës së këtyre edukatorëve, besnikë të popullit

dhe të Partisë, sot në të katër anët e Shqipërisë është ngritur një rrjet i gjerë institucionesh kulturore dhe shkollash fillore, shtatëvjeçare, të mesme dhe deri te universiteti. Tani ne kemi kuadrot tanë të rinj, që me aq zjarr, vendosmëri dhe talent diskutojnë probleme shumë të rëndësishme dhe shumë të komplikuar, si në çdo fushë ashtu dhe në atë të artit e të letërsisë sonë.

Unë besoj se këta kuadro, që ka farkëtuar Partia, duke ecur në një rrugë të tillë, për të mbrojtur vijën e drejtë të Partisë në çdo sektor, janë në gjendje të maten me cilindo, pa marrë parasysh moshën e tyre. Ata, me pjekurinë e tyre, janë në gjendje, dhe kjo mua më pëlqen shumë në këtë mbledhje, të mbrojnë pikëpamjet e tyre, pavarësisht nëse ato janë apo jo të gjitha të drejta.

Siç dihet, vija e Partisë nuk zbatohet në erë, vetvetiu, atë e zbaton një popull i tërë. Prandaj, në rast se ky popull nuk ka një vitalitet, mprehtësi dhe frymë revolucionare, zhvillimi i tij mund të ngadalësohet. Por, një gjë e tillë te ne nuk ka ndodhur. Kjo i detyrohet vitalitetit të madh të popullit tonë, i cili, edhe pse ka qenë një popull i vogël, ka mundur t'u rezistojë stuhive të mëdha të kohës që kanë kaluar mbi të gjatë shekujve.

## 2. — Populli ynë ka trashëguar një kulturë të madhe me tradita përparimtare

Ju, shokë, jeni punonjës të frontit të kulturës dhe e dini mirë se gjatë historisë shumë popuj, bile edhe të mëdhenj, me qytetërim të lashtë, janë zhdukur, ndër-

sa populli ynë ka rezistuar, nuk është zhdukur. Populli ynë nuk është zhdukur gjatë shekujve, sepse ka qenë një popull trim, një popull që gjatë shekujve ka luftuar për t'u mbrojtur, për të fituar e për të ruajtur lirinë, pavarësinë, gjuhën e kulturën e tij. Pavarësisht se kultura jonë nuk ka pasur një zhvillim të tillë, siç e kanë pasur disa popuj të tjerë, populli ynë, një nga popujt më të vjetër, nuk ka qenë pa kulturë. Është e pamundur që një popull pa kulturë të kapërcejë vështirësi aq të mëdha si ato që ka kapërcyer gjatë shekujve populli ynë, vështirësi që rrezikonin shfarosjen e tij. Populli ynë edhe në të kaluarën ka pasur kulturën e tij, me të cilën ka kontribuar edhe në thesarin e kulturës botërore.

Tani, neve, na duhet të punojmë për të ndërtuar shoqërinë socialiste dhe njëkohësisht të bëjmë përpjekje për të zbuluar edhe traditat e kulturës sonë të lashtë, e cila ka qenë kurdoherë një kulturë përparimtare.

Dihet se kultura e Greqisë së lashtë ka influencuar në kulturën e popullit tonë, por është e pamundur që edhe kultura e lashtë e popullit tonë të mos ketë influencuar në kulturën e popullit grek. Kultura bizantine gjithashtu ka influencuar në kulturën e popullit tonë, por edhe kultura jonë ka influencuar në zhvillimin e kulturës bizantine. Për këtë influencë e gërshetim kulture flasin zbulimet që po bëhen në arkeologji dhe studimet mbi të kaluarën e popullit tonë.

Kishat, megjithëse jo me shkëlqimin e monumenteve të Bizantit, veprat e ikonografisë që ishin lënë në harresë në të kaluarën, përfaqësojnë një pjesë të kul-

turës së kaluar të stërgjyshëve tanë dhe ne këto vepra arti duhet t'i ruajmë, t'i grumbullojmë, pavarësisht se kanë karakter fetar, ato sot për ne kanë vlerën e një thesari të paçmuar artistik.

Tani në vendin tonë bëhen kërkime arkeologjike në shkallë të gjerë, ndër të cilat gjejmë thesarë që tregojnë se populli ynë nuk ka qenë një popull i paditur e pa kulturë, por një popull me kulturë dhe me një shije të lartë artistike. Do të vijë koha kur muzetë tona do të mbushen me vepra të tilla, që do të jenë një trashëgim i pasur dhe i paçmueshëm i kulturës së kaluar të popullit tonë, po për këtë neve na duhet të studjojmë akoma më shumë të kaluarën e shkëlqyer të tij, sepse atje ne gjejmë të shprehur të gjithë jetën, gëzimet, vuajtjet, shijen e tij artistike, luftërat për liri dhe pavarësi, prirjet dhe zakonet që populli ynë ka trashëguar gjenerata pas gjeneratash deri në kohën e sotme.

Ç'tregojnë ky art dhe kjo kulturë e lashtë që ka pasur populli ynë? Ato tregojnë një karakteristikë të veçantë për të, luftën dhe vendosmërinë e tij për çështjen e mbrojtjes së atdheut, të tokës, të jetës dhe të zakoneve të tij. Kjo karakteristikë është trashëguar brez pas brezi dhe ne e kemi zhvilluar dhe e kemi forcuar vazhdimisht atë. Prandaj, shokë, lidhur me të gjitha këto, themi se në fushën e kulturës e të artit ne nuk kemi dalë nga hiçi.

Muzika dhe folklori ynë, kaq të pasur dhe me nuanca të shumta, nuk mund të quhen një thesar i vogël. Përkundrazi ata janë një thesar i madh mbi të cilin janë mbështetur kompozitorët tanë të talentuar, që

në përgjithësi kanë ditur të shfrytëzojnë këngët e vallet e popullit tonë dhe të krijojnë vepra të bukura dhe me vlerë, që pëlqehen jo vetëm në vendin tonë por edhe jashtë atdheut.

Një gjë të tillë vëmë re edhe në fushat e tjera të krijimtarisë artistike. Unë mendoj se edhe në artet figurative ne kemi një trashëgim të pasur. Artet figurative e të aplikuara, megjithëse jo siç i kemi sot, kanë ekzistuar edhe në kohët më të errëta, kur vendi ynë ishte i pushtuar nga Turqia. Gratë e vendit tonë, zanatçinjtë shqiptarë qëndisnin në pëlhura, në filigrane, skalitnin në gur e në dru gjëra aq të bukura artistike sa që ato zënë një vend të shquar në pasurinë e artit tonë popullor. Prandaj edhe në fushën e arteve figurative, që ne e konsiderojmë shumë të re, kemi pasur tradita dhe nuk do të ishte e drejtë të thoshim se traditat në këtë fushë na mungojnë.

Po kështu ne kemi tradita edhe në fushën e arkitekturës, e cila, siç dihet, bën pjesë dhe në sferën e artit. Është e vërtetë se tablotë e skulpturat e piktorëve e të skulptorëve tanë janë vepra të bukura artistike, por edhe një pallat apo një shtëpi kulture, e ndërtuar me shije të lartë artistike, si ato që janë projektuar nga arkitektët tanë të talentuar, si Skënder Luarasi, Anton Lufi, Eqrem Dobi dhe të tjerë, janë vepra arti, edhe atje të duket shija e hollë artistike, edhe te guri qëndron në mënyrë të pashlyeshme shija artistike e një populli. Nga gjiri i popullit tonë ka dalë arkitekt Sinani, njeri i shquar, emri i të cilit përmendet në çdo libër të literaturës botërore mbi historinë e arkitekturës. Shumë e dinë se tunelin e famshëm Semering në mes



të Alpeve e ka projektuar arkitekti i shquar shqiptar Gega. Kujtimi i autorit të kësaj vepre, që ka kërkuar mendje dhe zotësi të madhe, është përjetësuar në një basoreliev të vendosur në hyrje të tunelit.

Si mund të shpjegohet që në këtë thesar kulturor, letrar dhe artistik, në epoka të ndryshme, të gjejmë fare pak vlera jopërparimtare në kulturën e në letërsinë e popullit tonë, kurse në kulturën, në letërsinë dhe në artin e shumë popujve të tjerë ne do të gjejmë një gërshetim dhe një luftë të vazhdueshme të asaj që është përparimtare dhe të asaj reaksionare, do të gjejmë të theksuara influencën retrograde dhe obskurantiste të theksuar të kishës dhe të prapanizmit mesjetar?

Kjo ka ndodhur sepse populli ynë i vogël gjatë shekujve është udhëhequr kurdoherë nga idetë përparimtare të çlirimit, të mbrojtjes së tij, nga idetë e luftërave të drejta kundër shtypësve, kundër ideologjive grabitqare imperialiste të të huajve.

Letërsia, arti dhe kultura e popullit tonë nuk kanë pasur atë zhvillim në çdo kohë që kanë pasur disa popuj të tjerë, por ne shohim që njerëzit e shquar të popullit tonë në shekuj, deri në kohët tona (me përjashtim të disa njerëzve të paktë të kohës së pushtimit fashist, të cilët me shkrimet e tyre u hodhën në sportën e plehrave nga vetë populli), kanë ruajtur dhe kanë luftuar për të renë, për çdo gjë që është përparimtare dhe kanë përfituar e janë influencuar nga kultura botërore, vetëm nga ajo pjesë përparimtare dhe revolucionare.

Zhvillimi i vrullshëm i vendit tonë gjatë këtyre

17 vjetëve të pasçlirimit, nën udhëheqjen e lavdishme të Partisë dhe nën dritën e ideologjisë marksiste-leniniste, është një veprë e madhe e bërë nga një popull i pastër, që nxori nga gjiri i vet edhe një Parti të pastër. Ne kemi trashëguar nga e kaluara tradita fisnike, prandaj edhe Partia jonë u mbryjt dhe trashëgon tradita fisnike. Pikërisht këtu qëndron edhe arsyeja që edhe kultura e artet tona kanë ndjekur gjatë gjithë këtyre viteve një rrugë të drejtë zhvillimi.

Patriotizmi është filli i kuq që përshkon të gjitha aspiratat, përpjekjet dhe krijimtarinë e popullit tonë e të njerëzve të dalluar të tij në çdo lëmë. Shpirti i flaktë i patriotizmit ka udhëhequr rilindasit shqiptarë që kanë bërë vepra aq të bukura dhe aq të frymëzuara. Rilindasit në krijimtarinë e tyre, janë udhëhequr nga patriotizmi i zjarrtë, nga dashuria e madhe për atdheun dhe për popullin. Frymëzimi i madh i rilindasve, patriotizmi i tyre i kulluar, dashuria e flaktë për atdheun dhe perspektivat që i hapnin me veprat e tyre popullit shqiptar, duhet t'i frymëzojnë edhe shkrimtarët e artistët tanë në krijimtarinë e tyre. Pavarësisht se në veprat e rilindasve ka edhe pikëpamje filozofike të ndryshme të atyre kohëve, me të cilat disa herë ne nuk jemi dakord, ata mbetën tanët dhe të rinj përjetë. Naim Frashëri mbetet Naim, poeti ynë më i madh që adhurohet nga të gjithë, sepse ai i ka kënduar me patos të madh bukurisë së atdheut, u shkri si qiri për lirinë, për gjuhën shqipe, çndërroi, punoi e luftoi për të ardhshmen e popullit tonë, të cilën e bënë realitet Partia e Punës e Shqipërisë me pushtetin popullor. Dhe ashtu si Naimi i kanë kënduar popullit dhe atdheut tonë me

dashuri të madhe edhe shumë e shumë të tjerë shkrimtarë e poetë.

Dihet se zakonisht popujt dhe talentet e mëdha krijuese e tregojnë veten më tepër se kurdoherë në momente kthese të rëndësishme. Kështu ka ndodhur edhe te ne. Këto vepra të mrekullueshme të shkrimtarëve dhe të artistëve tanë kanë dalë në momente kthese të jetës së popullit tonë, në periudha revolucionare. Në zjarrin e Luftës Nacionalçlirimtare, në ato momente revolucionare, lindën dhe veprat e bukura e të frymëzuara të shkrimtarëve, të poetëve dhe të artistëve tanë. Edhe në momentet aktuale të vendit tonë, kur populli ndërton socializmin nën udhëheqjen e Partisë, me fenerin e marksizëm-leninizmit përpara, ne kemi një krijimtari të mirë letrare dhe artistike, sepse këto janë momente të rëndësishme të një populli që po ndërton socializmin, që po ndërton një industri të re moderne, që po bën transformime të mëdha në bujqësi, në arsim e në kulturë. Në momente të tilla lindin edhe veprat e mëdha nga mendja dhe nga duart e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë.

Me këtë rast desha të theksoj se studimi i traditave kulturore të popullit tonë, zbulimi e studimi i monumenteve kulturoro-artistike nuk bëhet vetëm me qëllim për të njohur të kaluarën e vendit e të popullit tonë, por në këtë punë ne udhëhiqemi edhe nga qëllimi për të mësuar nga eksperiencia e të parëve tanë, për të pasuruar e për të zhvilluar vlerat kulturore që na i kanë lënë trashëgim, sipas kushteve e kërkesave të reja të shoqërisë sonë socialiste.

Për t'i shërbyer këtij qëllimi duhet të ketë një

bashkëpunim shumë më të ngushtë në mes të shkencëtarëve tanë, njerëzve të krijimtarisë letraro-artistike dhe mjeshtrave ekzistues të artit.

Te ne po bëhen ndërtime me një ritëm të paparë, po zgjerohen e po lindin qytete, fshatarët pothuajse në masë po ndërtojnë shtëpi të reja; po zhvillohet, ose më mirë të themi po krijohet një industri e re e tekstilit, e qilimave, e qeramikës, e qelqit, e drurit etj. Për të gjitha këto tani po mendojnë e punojnë vetëm ato organe shtetërore-shoqërore që interesohen për plotësimin e nevojave të punonjësve. Por ne do të bëhemi «pishman», si i thonë fjalës, dhe brezat e ardhshëm do të na kritikojnë në qoftë se nuk mendojmë dhe nuk punojmë që ato që ndërtojmë e prodhojmë të jenë të tilla jo vetëm sa për të plotësuar nevojat imediate, po të kënaqin dhe shijen jo vetëm të brezave të sotëm, por dhe të atyre të ardhshëm.

Ka ardhur koha që organet e projektimit, për shembull, në planet e tyre të udhëhiqen jo vetëm nga kuotat financiare e normat e caktuara teknike, por duke u mbështetur në to, të organizojnë sa më shumë konsultime në mes tyre si dhe me studjuesit dhe me njerëzit e krijimtarisë, me ekzekutuesit artistikë, bile edhe me vetë punonjësit, intelektualët, gratë, të rinjtë etj., në mënyrë që ndërtimet tona, qytetet, fshatrat, banesat, institucionet shoqërore-kulturore, parqet etj. të jenë sa më të bukura, që të kënaqin e të edukojnë shijen artistike të njerëzit tanë dhe brezat e ardhshëm të shohin në to talentin e punës krijuese të arkitektëve, të inxhinierëve, të mjeshtrave dhe përgjithësisht të njerëzve të krijimtarisë artistike të kohës sonë.

Mua më duket se, në këtë fazë të zhvillimit kulturor të vendit tonë, ka ardhur koha dhe janë krijuar mundësitë që me forca të bashkuara të njerëzve tanë të shkencave, të arteve e të njerëzve të punës, të luftohet më me këmbëngulje për të studjuar karakteristikat kombëtare në drejtime të ndryshme të kulturës dhe të arteve tona dhe për zbatimin e tyre në mënyrë krijuese në veprat e sotme të artit dhe në punën kulturoro-artistike me masat. Dhe kjo duhet të gjejë shprehje jo vetëm në veprat letrare e muzikore, në pikturë e në skulpturë, por, siç thashë, në ndërtime, në punimet e drurit, të gurit, të hekurit, në industrinë tekstile të veshmbathjes, të qeramikës, të qelqit dhe kudo ku duhet të ketë art.

Unë do të shtoja se kolektivet artistike, institutet e larta të teatrit, të arteve figurative dhe ai i muzikës që do të ngrihet, në bashkëpunim me institucionet profesionale të teatrit, të operës e të baletit etj., duhet të mendojnë jo vetëm për të përgatitur kuadro, por edhe për të formuar personalitetin e tyre si shkolla të artit shqiptar, për zhvillimin dhe për pasurimin e karakteristikave kombëtare të artit shqiptar.

Kjo luftë e kombinuar me përpjekjet për të njohur e për të mësuar sa më shumë nga arti përparimtar botëror dhe arti e letërsia sovjetike e realizmit socialist do të ndihmojë që të lulëzojnë arti e letërsia jonë e re me një shkëlqim të ri të denjë si për traditat e lavdishme të së kaluarës së popullit tonë ashtu edhe për brezat e ardhshëm të shoqërisë socialiste e komuniste.

### 3. — Uniteti i shkrimtarëve e i artistëve me çështjen e popullit dhe të Partisë është i pathyeshëm

Shokë, një diskutant tha këtu se kjo është një mbledhje e tillë që, po të ishte një i huaj midis nesh, do të mendonte se është një mbledhje partie. Dhe me të vërtetë ashtu është. Është vështirë të dallosh te ne se kush e ka e kush nuk e ka tesërën e Partisë. Kjo ndodh sepse ne së bashku, Parti e popull, jo vetëm çliruam atdheun dhe po ndërtojmë socializmin, por krijuam edhe një unitet të çeliktë moralo-politik të popullit tonë, që nuk mund të realizohet as me propagandë, as me fjalë, por vetëm me vepra. Janë veprat e mëdha që krijojnë populli, nën udhëheqjen e Partisë dhe në saje të vijës së saj të drejtë, që siguruan këtë unitet të pathyeshëm midis Partisë dhe popullit. Është pjekuria e Partisë sonë, e cila bëri që i madh e i vogël në Shqipëri, sidomos kur shikojnë në horizont ndonjë rrezik, sado i vogël, lënë mënjane çdo mëri, zemërim, pikëpamjet e kundërta dhe, ashtu siç bënin edhe stërgjyshët tanë, bashkohen fort si një grusht. Kjo është një fitore e madhe e popullit dhe e Partisë sonë. Kështu edhe në këtë mbledhje, nga diskutimet është vështirë të dallosh cili është me parti dhe cili është pa parti. Këto nuk janë vetëm fjalë, ky është realiteti. Ashtu sikurse flasin me dashuri për Partinë anëtarët e saj, ashtu flasin edhe njerëzit pa parti në vendin tonë, sepse të gjithë kanë një dashuri të pakufishme për Partinë, për të gjitha ato që ajo ka bërë e bën për popullin. Nuk mund të flasësh në mënyrë të tillë në qoftë se atë që thua nuk e ndien. Ky është re-

zultat i politikës së drejtë të Partisë, që është arritur me punën dhe me qëndrimet që ka mbajtur Partia, jo vetëm me patriotët, por dhe me ata që kanë qenë në kundërshtim me vijën e Partisë sonë.

Durim të madh ka pasur Partia me njerëzit. Pas 30 ose 35 vjetësh unë i dhashë dorën një mikut tim të vjetër, Eqrem Çabejit. Këtë nuk kam pasur rast ta bëja më përpara. Eqremi mori një kulturë gjermane kur ishte i ri dhe mori rrugën e tij në jetë ashtu si e gjykonte ai, rrugë e ndryshme nga ajo jona. Është fakt se ai nuk ka qenë në një radhë me ne, por krime ai nuk ka bërë dhe, kur u çlirua atdheu, nuk e mori baltën e atdheut në thundrën e këpucëve, sikurse bëri Ernest Koliqi; Eqremi nuk tradhtoi si ai. Ishte fare lehtë që ne të merrnim masa kundër tij, por Partia këtë nuk e bëri, përkundrazi, e ndihmoi Eqrem Çabejin të vazhdojë punën e tij shkencore, të ndihmojë shkollën e pregatitjen e kuadrove dhe t'u shërbejë kështu popullit e atdheut. Eqrem Çabej është një shkencëtar, njeri me kulturë të gjerë. Ai po sheh ç'bëhet në vendin tonë, si ia ka ndërruar dhe po ia ndërron Partia vazhdimisht faqen vendit tonë. Unë jam i bindur, duke u bazuar në njohjen që kam për të, se ai është i kënaqur kur sheh që krahas tij janë ngritur njerëz të rinj me vlerë, kuadro të rinj shkencorë në atë fushë për të cilën ka punuar e me të cilët ai mund të diskutojë. Unë jam gjithashtu i bindur se në qoftë se ai i futet edhe më thellë studimit të shkencës së madhe të marksizëm-leninizmit, do ta ketë më lehtë të orientohet edhe në zgjidhjen e problemeve të shkencës së gjuhësisë.

Mund të sjell edhe një shembull tjetër, të një njeriu të një kategorie tjetër, për të treguar drejtësinë e vijës

së Partisë, e cila jo vetëm e bëri popullin një e të pandarë rreth saj, por bëri që edhe mjaft nga kundërshtarët tanë të ndryshojnë pikëpamjet e tyre. Një person me kulturë të gjerë dhe me karakter jo të dobët, për fajet që kishte kryer gjatë pushtimit fashist, ishte dënuar me burgim. Pasi mbaroi dënimin, u lirua, dhe me autobus shëtiti në të katër anët e vendit, ku pa qytete të reja, fabrika, hidrocentrale, rrugë, kanale, fusha e të tjera. Pas kësaj, ai i drejtoi një letër Komitetit Qendror të Partisë, ku i shkruan se «tani që u lirova, shëtita në të katër anët e vendit, pashë të gjitha ato mrekulli që janë bërë nga populli ynë gjatë viteve pas Çlirimit. Te unë ngjau një ndryshim i madh, u bë një transformim në pikëpamjet e mia dhe jam i bindur se, sikur ta kishim pushtetin në dorë ne, nuk do të kishim bërë kurrë vepra të tilla. Për të arritur këto rezultate, duhej një forcë e madhe dhe e zgjuar që ta udhëhiqte popullin». Në letër ai shkruante edhe plot gjëra të tjera dhe, duke përfunduar, i lutet Partisë që letra e tij të botohet. «Do të ketë njerëz, thotë ai, që do të thonë se ja, edhe unë e ula kurrizin, por unë do t'u them atyre se, fundi i fundit, unë i përulem popullit tim, vëllezërve të mi, komunistëve shqiptarë, nën drejtimin e të cilëve u ngritën këto gjëra të mrekullueshme, të cilat ne nuk do t'i bënim dot kurrë».

Ky nuk është një njeri i thjeshtë, por emrin e tij nuk do t'jua tregoj. Edhe letrën e tij nuk e botuam, sepse Partia këtë njeri, që e dënuan drejtësisht ligjet e Partisë dhe të shtetit, e bëri njeri të ri dhe do ta mbrojë, sepse ne duam që askush të mos e fyejë tani që po hyn me të vërtetë në një jetë të re.



Politika që ka ndjekur Partia, deri në ata njerëz që kanë dalë nga burgu, është një politikë e drejtë, që e ka lidhur ngushtë atë me popullin. Kjo politikë ka bërë që populli të aprovojë njëzëri dënimin e të gjithë atyre që tradhtojnë interesat e atdheut, qoftë me parti, qoftë pa parti. Vija e drejtë e Partisë, qëndrueshmëria dhe heroizmi i saj, kanë influencuar dhe influencojnë vazhdimisht edhe në pikëpamjet e atyre njerëzve që nuk e kanë kuptuar dhe nuk e kanë dashur Partinë.

#### 4. — Letërsia dhe artet, duke ecur përpara në rrugë të drejtë, pasurohen çdo ditë e më shumë

Në jetë ka shumë kontradikta, të cilat ju duhet t'i zbuloni dhe të tregoni rrugën e zgjidhjes së tyre. Raporti që mbajti në këtë mbledhje shoku Ramiz Alia, duhet të konsiderohet si diçka që plotëson vendimin e Komitetit Qendror të Partisë mbi letërsinë dhe artet. Shoku Ramiz nuk pretendon që me të do të zgjidhen të gjitha problemet e letërsisë dhe të arteve tona, por aty u jepet rrugë disa çështjeve kryesore që janë problem për ju. Ju mund të keni edhe vërejtjet tuaja, pikëpamjet tuaja për diçka që ndoshta duhet ndrequr akoma më tej; na i bëni ato që t'i ndreqim, sepse Partia mendon se gjëja më e vlefshme është ajo që del nga eksperiencia e popullit. Ju keni edhe organet tuaja ku mund të drejtoheni, por ju mund t'i drejtoheni edhe Komitetit Qendror për një çështje të caktuar. Partia do t'i presë kurdoherë me kënaqësi vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Sikurse u theksua gjatë diskutimeve, jeta jonë është

një burim i madh frymëzimi. Se ç'madhështi po krijohet në vendin tonë, ne po e jetojmë vetë. Kudo ka poezi, kudo ka novatorizëm dhe askush nuk ka të drejtë dhe nuk mund ta pengojë atë. Vetëm se duhet që ky novatorizëm të ecë në rrugë të drejtë, duke respektuar parimet e realizmit socialist; duhet që vepra të jetë e thjeshtë, e qartë, madhështore, mobilizuese, të edukojë e t'i hapë popullit perspektivën. Kjo ka rëndësi të madhe dhe këtë ne e gjejmë kudo. Novatorizmin ta kuptojmë ashtu siç e kupton punëtori novator. Në rast se punëtori apo tekniku novator kërkon të përmirësojë tornon, makinën, aeroplanin dhe nuk bazohet në shkencën, teknikën, në traditat e saj, atëherë nuk mund të ketë përparim tekniko-shkencor. Prandaj asnjë njeri nuk ka të drejtë të pengojë novatorizmin, por njëkohësisht nuk duhet të hidhen poshtë traditat e mira të së kaluarës. Novatorizmi asnjëherë nuk duhet barazuar me mohimin e traditës.

Ju duhet të tregoni kujdes të madh për brendinë. Ka rëndësi të madhe që vepra të dalë e bukur, e qartë, e kuptueshme, por ajo duhet të ketë edhe një brendi të shëndoshë, edukuese, të jetë e qartë dhe e dobishme për masat.

Shoku Andrea Varfi, kur diskutoi, theksoi se atij i pëlqen tetërrokëshi. Edhe mua më pëlqen tetërrokëshi në poezi, edhe dhjetërrokëshi dhe kur dëgjova diskutimin e shokut Andrea i thashë në pushim se unë jam dakord me pikëpamjen e tij. Atëherë Andrea iu kthye shokëve dhe u tha me shaka: «Flitni tani po të doni». Por në fakt ai u gabua dhe e vërteta është se dolën shokë e folën, diskutuan dhe mbrojtën me zjarr pikëpamje të kundërta. Dhe kjo është një gjë shumë e mirë.

Kur dëgjova diskutimet e disa shokëve, të them të drejtën, veç për një gjë nuk më erdhi mirë që doli sikur çështja shtrohet «të rinj» dhe «të vjetër». Në fakt, disa nga ju janë të rinj, disa të tjerë janë të kaluar nga moshja, por unë mendoj se te ne nuk është problem çështja «të rinj» dhe «të vjetër». Të rinjtë me dinamizimin dhe gjallërinë e tyre bëjnë mirë që na shkundin ne më të vjetërve. Për këtë ne duhet t'u jemi mirënjohës atyre. Dinamizmi i shokëve të rinj është një thesar i madh për Partinë dhe për popullin tonë. Ju, shokë të rinj, duhet të dini se edhe shokët e moshuar kanë kaluar në këto faza që jeni duke kaluar ju tani. Prandaj unë nuk besoj kurrë që shkrimtarët dhe artistët më të vjetër duan të pengojnë krijimtarinë e më të rinjve, veçse ata, meqenëse kanë kaluar më parë nëpër këto shtigje, kanë frikë se mos nga hovi i madh ju shkisni nga rruga. Por unë jam i bindur se ju, shokë të rinj, nuk do të ecni kurrë në një rrugë të gabuar, se shkrimtarët dhe artistët tanë të rinj e të vjetër nuk do të shkasin kurrë nga rruga e madhe, metoda e realizmit socialist, mbi bazën e së cilës janë krijuar, në Bashkimin Sovjetik në radhë të parë, dhe në vendet e demokracisë popullore, vepra të tilla letrare e artistike që janë bërë pjesë e pandarë e trashëgimit më të mirë letrar e artistik botëror.

Unë i kam lexuar disa vjersha të Ismail Kadaresë. Kam lexuar, për shembull, atë që ia ka kushtuar Kalasë së Gjirokastrës, «Princesha Argjiro», e cila më ka pëlqyer, mbase sepse jam nga Gjirokastra. Kam lexuar edhe vjersha të tjera të Kadaresë, të cilat më kanë pëlqyer dhe kam përshtypjen se ai është një i ri me talent.

Mua më vjen keq që nuk më kujtohen vjershat e disa shokëve që njoha e dëgjova këtu. Diskutimet tuaja në këtë mbledhje më shtyjnë t'ju siguroj se këtej e tutje do t'i lexoj edhe më me kujdes veprat tuaja, sepse si komunist dua me gjithë shpirt të shoh se si rinia ecën përpara, krijon vepra të bukura për popullin, për atë popull që ajo e do me aq zjarr, patriotizëm dhe shpirt djaloshar që nuk do të plaket kurrë.

Unë mendoj se është një punë e mirë që të diskutoni ndërmjet jush për problemet që ju dalin përpara, sepse nga diskutimet shoqërore del gjithmonë diçka e re, e mirë. Shokët më me eksperiencë kanë një avantazh të madh, ata janë më të moshuar e dihet se në pleqëri «edhe uthulla nuk të duket aq e fortë». Shokët Andrea Varfi, Llazar Siliqi ose të tjerë të kësaj kategorie nuk zemërohen nga diskutimet që u bënë këtu prej disa shokëve. Ata janë komunistë, janë më të vjetër në moshë, janë nga poetët tanë më të mirë, prandaj poetët e rinj mund dhe duhet të diskutojnë gjerësisht me ta.

Por unë desha t'u them edhe të vjetërve edhe të rinjve se, në qoftë se do të bëjnë vjersha që u përngjasin atyre që bëjnë dekadentët borgjezë, kjo do të jetë me të vërtetë e neveritshme, vjersha të tilla janë për t'u hedhur poshtë, sepse ato e pengojnë zhvillimin e poezisë sonë dhe i edukojnë keq masat. Por nga sa di unë dhe nga sa kuptova nga diskutimet tuaja, deri tani në krijimtarinë letrare e artistike nuk ka pasur ndonjë gjë të keqe. Në qoftë se ka disa vjersha jo të mira, ju shokët me një talent më të afirmuar, mos i rezervoni kritikën kundrejt tyre, ndryshe do të bënit një gabim të

madh. Gjithashtu, edhe më të rinjtë do të mbanin një qëndrim të gabuar në rast se nuk do të dëgjonin kritikën e shokëve më të vjetër dhe më me eksperiencë. Veçse kritika duhet të jetë konstruktive, reale, shoqërore.

Disa nga shokët që diskutuan përdorën edhe ca fjalë për të cilat u erdhi hidhur disa të tjerëve. Për shembull, ndonjëri arriti të thotë në diskutimin e tij se në vjershat e disa poetëve të rinj nuk ka asgjë kombëtare. Natyrisht, autori i ri nuk ka si ta mbajë në kurriz këtë kritikë. Prandaj shokët e rinj kërkuan fakte për të argumentuar se ku nuk janë kombëtare vjershat e tyre dhe, duke qenë se faktet nuk dolën, ata futën disa gjilpëra të holla, duke i quajtur shokët e vjetër si konservatorë, që u mbyllin rrugën të rinjve.

Mendimi im personal është se derisa vjershat tuaja të kenë përmbajtje marksiste, me të vërtetë patriotike, mobilizuese, edukative dhe formë të bukur, tërheqëse, të qartë, ato s'ka përse të mos pëlqehen. Mirë e tha shoku Ramiz Alia në referatin e tij: Afirmohuni me vargun tuaj dhe në rast se ju do populli, ai varg është i mirë. Në qoftë se një vepër pranohet nga populli, pëlqehet prej tij, atëherë ajo është në rregull. Nëse e bën poczinë me tetë, me dhjetë apo me dymbëdhjetë rrokje, me vargje të lira apo me rimë, kjo varet nga autori. Mund të ketë shkrimtarë e artistë që, kur krijojnë, mendojnë se si do ta presë krijimin e tyre ky apo ai shkrimtar ose artist. Kjo është një gjë e mirë, sepse tregon që ata kanë respekt për të tjerët, për ata që kanë një eksperiencë të madhe krijuese. Por në të vërtetë, në radhë të parë, ai duhet të mendojë se çfarë do të thotë populli, çfarë do të thotë klasa punëtore

dhe fshatarësia, si do ta presë veprën e tij opiniononi i gjerë. Kjo ka një rëndësi të madhe. Në qoftë, pra, se ka bërë një vepër të mirë edhe kritika letrare ose artistike do t'ia presë patjetër mirë.

### **5. — Jeta e popullit tonë është burim i madh frymëzimi për shkrimtarin dhe për artistin**

Në qoftë se ju dëshironi që veprat tuaja të kenë vlerë dhe t'i shërbejnë me të vërtetë ndërtimit të socializmit në vendin tonë, shkoni në popull, shkruani atë që ndien dhe dëshiron ai, shkruani si e kupton dhe si e ndien populli jetën. Natyrisht, për këtë ju duhet të vini edhe zotësinë tuaj. Kini parasysh që roli juaj si individ, si shkrimtar ose si artist, është shumë i rëndësishëm për krijimin e veprave të bukura. Ana subjektive e artistit luan një rol të madh në sintezën që ai do të bëjë për romanin, kompozimin, muzikën apo pikturën e vet. Kontradikta për të cilën bëhet fjalë në një vepër artistike, duhet të jetë sinteza jo subjektive, por objektive dhe e bazuar në vetë jetën që zhvillohet, që ecën përpara, në luftën e së resë me të vjetrën. Ana subjektive luan një rol të veçantë në nxjerrjen dhe në vënien në dukje si duhet të kontradiktave, me qëllim që ato të mos shihen në sipërfaqe dhe me një ide fikse, të sëmure dhe individuale. Mundet që një shkrimtar ose një artist të shprehë në veprën e vet botën e tij të brendshme individuale, kontradiktat që ai ka në shpirtin e tij, që janë të tijat personale dhe jo të përgjithshme, tipike, dhe ato t'ia veshë pastaj një heroi të veprës

së tij, një fshatari ose një punëtori. Një gjë e tillë mund të ketë një farë vlere në format e paraqitjes, por do të vuajë nga abstraksioni dhe, në përgjithësi, ajo do të shprehë një botëkuptim të veçuar. Shumë keq do të paraqitet, sidomos, në rast se autori që bën këto përpjekje është pa kulturë artistike, i shkëputur nga jeta e gjallë, nga kontakti me njerëzit dhe me mbeturina të theksuara ideopolitike mikroborgjeze. Të vjetrën, flas për të vjetrën pozitive, s'duhet ta vëmë kundër së resë, ajo duhet t'i shërbejë së resë në zhvillim, në afirmim, në ecjen përpara, në krijimin e një shoqërie përparimtare, revolucionare, me tiparet që i përshtaten kohës dhe që trashëgojnë edhe të vjetrën pozitive, edhe ecjen revolucionare përpara, edhe paralajmërimin e së ardhshmes.

Pse u themi njerëzve të artit se duhet të lidhen me jetën që po zhvillohet, duhet jetuar dhe ecur me kohën? Ka rëndësi ana subjektive e artistit dhe formimi i tij. Ky formim mund të marrë shumë rrugë. Artisti, i parë edhe nga korentet e ndryshme letrare dhe artistike përparimtare të huaja, mund të mos jetë në gjendje t'u bëjë atyre një kritikë realiste dhe të shfrytëzojë anët e tyre të mira, në qoftë se nuk lidhet ngushtë me realitetin e vendit dhe të popullit të tij. Ai do të nxjerrë gjëra pa vlerë, do të nxjerrë teori të çala, do të bastardojë dhe atë anë përparimtare të atyre korentëve realiste dhe përparimtare, në rast se nuk lidhet me jetën e popullit të vet.

Prandaj e vetmja rrugë e drejtë për të nxjerrë vepra të denja për popullin, të bukura dhe me përmbajtje, është edukimi juaj i vazhdueshëm marksist-leninist dhe kontakti i ngushtë e i vazhdueshëm me popullin.

Juve nuk ju mungon frymëzimi dhe as mundësia që të nxirrni nga duart vepra të mëdha. Kësaj do t'ia arrini në qoftë se do të mbani të gjallë dhe do ta ngrini gjithnjë më lart atë frymëzim e trashëgim të pavdekshëm patriotik e kulturor të së kaluarës së popullit tonë dhe veçanërisht të periudhës së shkëlqyer të Luftës Nacionalçlirimtare, që u siguroi atdheut e popullit tonë përgjithnjë lirinë, pavarësinë, sovranitetin, jetën e lumtur e të begatshme socialiste, që u siguroi miqësinë me popujt që ndërtojnë socializmin, miqësinë me gjithë popujt që luftojnë për paqen e demokracinë. Ju do të krijoni vepra të mëdha në qoftë se ndiqni me kujdes luftën e madhe që bën klasa punëtore dhe fshatarësia për ndërtimin e socializmit, përpjekjet e mëdha të arsimtarëve tanë, të gruas shqiptare, të rinisë sonë heroike, në qoftë se jetoni me popullin.

Por ka jetë dhe jetë. Në qoftë se shkon dhe bisedon thjesht me një punonjës dhe e pyet si është me shëndet apo sa e ka rrogën, ky është një takim i thatë. Ju duhet të futeni thellë në jetën e punonjësve. Ndiqni jetën e punën heroike të një shoferi, për shembull, dhe do të shihni se ai pa përfillur fare asnjë vështirësi e pengesë punon me ndërgjegje të lartë, me entuziazëm, për të çuar makineritë e mëdha për ndërtimin e hidrocentralit, do të shihni se ç'poezi e madhe vlon në shpirtin e tij. Ai mendon për atë hidrocentral që do të ngrihet dhe do t'i japë popullit dritë, që do të vërë në lëvizje fabrikat e mëdha që po ngremë dhe me këtë ndjenjë besimi dhe optimizmi çan rrugët malore, të mbushura me borë, nga të cilat ai mund edhe të shkëputet dhe të bjerë në hon. Ju do të shihni se si te ai gufon dashuria



e madhe për popullin, për atdheun, për të ardhshmen tonë, socializmin dhe komunizmin. Po të veproni kësh-tu, do t'ju vijë edhe frymëzimi. Kjo që them është diçka shumë e thjeshtë. Ju jeni shkrimtarë, poetë dhe artistë që nuk ju mungon frymëzimi, por, po të jetoni midis masave punonjëse, do të nxirrni nga duart tuaja vepra të mëdha, ashtu siç janë të mëdha edhe vetë veprat dhe heroizmat e punonjësve tanë. Të marrim, për shembull, gjeologët tanë të rinj, që porsa kanë dalë nga bankat e shkollës. Ata me punën e tyre vetëmohuese po zbulojnë për popullin pasuri të mëdha, vetëm me kërkimet gjeologjike në Minierën e Gjegjanit të rrethit të Kukësit, brenda këtij viti, do të realizojnë planin pesëvjeçar të kërkimeve të bakrit. Ata nuk kanë komoditete, kanë plot mungesa e vështirësi, por me sa heroizëm punojnë për t'i dhënë sa më shumë popullit dhe atdheut. Shkoni, shokë shkrimtarë dhe artistë, në gjirin e këtyre njerëzve, shikojini ata kur punojnë, kur shpojnë në thellësitë e tokës se nga ç'ndjenja të larta udhëhiqen për punën që bëjnë. Ose ndiqni gjeologët që i bien malit poshtë e lart në këmbë dhjetë-pesëmbëdhjetë herë në ditë, me çekiç në dorë duke mbledhur mineralin në një thes që mbajnë në krahë. Kjo mund të duket një punë e mërzitshme, kurse ata punojnë plot patos, dashuri dhe patriotizëm të madh për popullin.

Po kështu punojnë edhe punonjësit e sektorëve të tjerë, të naftës, të bujqësisë etj. Në punën e fshatarëve tanë ne do të gjejmë jo vetëm durimin, zgjuarsinë e tyre, por edhe një shije të madhe artistike në punimin e tokave. Kush nga ju nuk e ka parë punimin e bukur të tokave në fushat pjellore të Korçës dhe tani të Lush-

njës e të rretheve të tjera? Disa parcela sidomos janë punuar si qilim. Kush nuk i ka parë dhe nuk është gëzuar me bukurinë e madhe të fushave të mbjella me misër, sikur të ishin radhitur me rigë?! E gjithë puna heroike e fshatarësisë sonë duhet të gjejë shprehje në veprat tuaja. Por një gjë e tillë nuk mund të bëhet nga zyra. Në rast se ju lidhni, jetoni dhe luftoni me të vërtetë me popullin, do të krijoni patjetër vepra me të vërtetë të mëdha.

*Pastaj shoku Enver Hoxha foli mbi disa probleme të gjendjes ndërkombëtare. Ai theksoi veçanërisht luftën e vendosur e parimore që zhvillon Partia jonë kundër imperializmit me atë amerikan në krye dhe veglës së tij, revizionizmit modern.*

*Shoku Enver shtjelloi dhe bëri të qarta qëndrimin dhe vijën e drejtë marksiste-leniniste të Partisë sonë, luftën e vendosur parimore politike e ideologjike të saj kundrejt të gjitha manovrave mashtruese, veprimeve minuese e përçarëse, presioneve e bllokadave të egra të revizionistëve sovjetikë e pasuesve të tyre. Pastaj në përfundim shoku Enver Hoxha tha:*

Duke analizuar planin e gjashtëmujorit të parë të këtij viti, ne vëmë re se ai është tejkaluar në të gjithë sektorët. Kjo nuk ka ndodhur asnjëherë si këtë vit. Natyrisht, këtë e bëri vija e drejtë e Partisë, patriotizmi i madh i klasës sonë punëtore dhe i fshatarësisë punonjëse, përqaftimi dhe zbatimi me besnikëri i vijës së Partisë, dashuria dhe besnikëria e punonjësve tanë ndaj Partisë, guximi dhe heroizmi i tyre i madh përpara vështirësive, të cilat do t'i kapërcejmë me sukses dhe planet tona do t'i realizojmë patjetër. Të gjitha këto

tregojnë se sa shumë e mbështetin masat tona punonjëse Partinë. Partia është pjella më besnike e popullit, ajo kurdoherë i ka ndarë dhe i ndan të mirat dhe hallet me popullin. Kështu do të veprojë ajo edhe në të ardhshmen.

Në çështjen e ndërtimit të socializmit në vendin tonë, një detyrë shumë të madhe keni edhe ju, shokë shkrimtarë dhe artistë të të gjitha gjinive, duke filluar që nga poetët e gjer te rapsodët popullorë, që nga kompozitorët e gjer te valltarët e gjithë artistët e skenës. Vini të gjitha forcat dhe talentet tuaja që ta bëjmë jetën e popullit sa më të lumtur dhe të gëzuar. Ne kemi një popull të mrekullueshëm, të cilit edhe sakrifica jonë më e madhe është e pamjaftueshme për t'ia shpërblyer. I tillë është populli ynë heroik, i vendosur, punëtor, i zgjuar dhe besnik ndaj Partisë. Prandaj ne, bijtë dhe bijat e tij, duhet të vëmë të gjitha forcat që t'ia bëjmë jetën të lumtur e ta zbukurojmë akoma më shumë. Dhe në këtë mes një rol të madh keni dhe ju.

Puna juaj mund të mos duket si një punë konkrete, por veprat tuaja, romanet, poemat, pikturat dhe skulpturat, këngët dhe shfaqjet tuaja frymëzojnë në jetë dhe në punë punëtorët, fshatarët, gratë, rininë tonë heroike, nxënësit dhe mësuesit e tyre. E pallogaritshme është kjo forcë që u jepni atyre nëpërmjet veprave tuaja. Ndihma juaj ka bërë që edhe në fshat, në kooperativat bujqësore, të krijohen sot ansamble koresh, vallesh, me 40-50 e më shumë djem e vajza, burra e gra. Si u bë e mundur kjo? Kjo u bë e mundur, përveç të tjerave, nga përpjekjet tuaja për t'i shërbyer popullit, për ta bërë artin të masave, siç na mëson Lenini i madh.

Në veprat tuaja, natyrisht ka edhe të meta, por është fakt që masat e gjera punonjëse i ka rrëmbyer jo vetëm entuziazmi për punë, por edhe dëshira e zjarhtë për kulturë, arsim; fshatarët tani kërkojnë filma, shfaqje të ndryshme, lexojnë me interesim librat tuaj, dëgjojnë me endje koncertet e artistëve tanë në radio. S'po u përgjigjemi dot kërkesave të mëdha nga ana e kooperativave për elektrik, radio, vegla muzikore, ilustracione, pllakata e të tjera. I tillë revolucion i thellë kulturor është bërë në vendin tonë dhe të tillë punë të madhe e shërbim fisnik keni bërë ju.

Prandaj, shokë, punoni dhe krijoni sa më shumë vepra, me përmbajtje sa më të mirë për popullin tonë. Në këtë drejtim do të keni vazhdimisht të gjithë ndihmën e Partisë. Partia nuk e kupton veprimtarinë e saj pa ju dhënë ndihmën e vet në punën tuaj, që ka të bëjë me një sektor shumë të rëndësishëm të zhvillimit të popullit tonë, për t'i dhënë atij kulturë, për ta edukuar atë nëpërmjet punës dhe shkrimeve tuaja. Kini parasysh se çdo vepër juaja ka një rëndësi të madhe për edukimin e njerëzve të rinj të Shqipërisë sonë socialiste, të punëtorëve, të fshatarëve, të mësuesve dhe të gjithë inteligjencës sonë, për t'i bërë këta të aftë që t'i japin atdheut dhe popullit më shumë dhe më mirë.

Partia dhe Komiteti Qendror janë plotësisht të bindur se ju do ta kryeni me nder detyrën, ashtu sikurse keni vepruar gjer tani. Partia ka besim të plotë te ju. Ju jeni intelektualë të popullit, intelektualë të një brumi tjetër, nuk ka te ju sëmundje apo deviacione, por ka patriotizëm, dashuri dhe besnikëri të pakufishme ndaj Partisë dhe popullit që ju ka lindur dhe ju ka rritur.

Prandaj këtë dashuri, këtë besnikëri dhe patriotizëm që ushqeni për popullin dhe atdheun, Partia do t'jua shpërblejë dhjetë dhe njëqind herë më shumë me kujdesin e saj.

Edhe një herë më lejoni t'ju përgëzoj për sukseset tuaja, t'ju falënderoj për besimin e madh dhe dashurinë që ju ushqeni për Partinë dhe, në emër të Komitetit Qendror, t'ju uroj nga zemra suksese sa më të mëdha në punën tuaj fisnike!

*Botuar për herë të parë  
me shkurtime, në revistën  
«Nëntori», Nr. 8, f. 3. Tiranë,  
1961*

*Botohet me shkurtime, sipas  
originalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## **ÇDO GJË KA VLERË TË MADHE KUR BËHET NGA DUART E ARTA DIJE MENDJA E KTIJELLËT E BIJVE TË POPULLIT TONË**

*Nga biseda me një grup të rinjsh pjesëmarrës  
në takimin kombëtar të rinisë së minierave  
dhe të gjeologjisë<sup>1</sup>*

**12 korrik 1961**

Jam shumë i gëzuar që takohem sot me ju, të rinj të dalluar të sektorit shumë të rëndësishëm të minierave dhe të gjeologjisë. Ju bëni një punë të madhe për popullin e për atdheun dhe Partia ka besim të madh te ju, sepse punoni me ndërgjegje dhe pa u lodhur për shfrytëzimin e pasurive të nëntokës sonë. Shfrytëzimi i pasurive të nëntokës i ka sjellë shumë të mira vendit tonë dhe ka kontribuar fuqimisht për ndërtimin e socializmit te ne, për zhvillimin e ekonomisë, për rritjen e nivelit kulturor dhe të jetesës së popullit shqiptar. Me punën tuaj ju i keni hapur popullit një perspektivë të

---

<sup>1</sup> Takimi kombëtar i rinisë së minierave dhe të gjeologjisë, u zhvillua në Tiranë më 11 korrik 1961.

shkëlqyer. Çdo gjë ka vlerë të madhe kur bëhet nga duart e arta dhe nga mendja e kthjellët e bijve të popullit tonë.

Përpara ne ishim me të vërtetë në vështirësi përsa i përket shfrytëzimit të pasurive të nëntokës. Por në këtë fushë ne kemi pasur edhe ndihmën e Bashkimit Sovjetik dhe të disa vendeve të tjera të demokracisë popullore. Këtë ndihmë ne nuk e kemi mohuar dhe nuk e mohojmë, pavarësisht nga shpifjet që bën në këtë drejtim udhëheqja e sotme sovjetike.

Udhëheqja revizioniste sovjetike ka gabuar rëndë duke tërhequr specialistët, ashtu sikurse ka gabuar edhe në shumë drejtime të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me RP të Shqipërisë.

Me këtë masë udhëheqja sovjetike ka menduar t'u bëjë presion Partisë dhe shtetit tonë që ne t'u përmbahemi pikëpamjeve të tyre antimarksiste. Por këtë nuk mund ta pranoni dhe kurrë nuk do ta pranojnë as komunistët as populli shqiptar.

Parimet e marksizëm-leninizmit nuk duhet të shkelen. Partia jonë nuk lejon të devijohet nga marksizëm-leninizmi. Kush devijon prej tij ai ka rrezikuar jetën e popullit, lirinë dhe pavarësinë e tij.

Ju e dini se populli shqiptar ka luftuar vazhdimisht për këto ideale të larta dhe ai fitoi vetëm se në udhëheqje kishte Partinë e klasës punëtore, të ndriçuar nga ideologjia e saj, marksizëm-leninizmi. Të gjitha fitoret që kemi arritur dhe që përfaqësojnë luftën, gjakun dhe djersën e popullit, u bënë realitet, se populli ynë u udhëhoq nga marksizëm-leninizmi. Ta shkelësh këtë ideologji, të ecësh në rrugë qorre do të thotë t'i rrezikosh

këto fitore, t'i humbasësh ato. Partia jonë nuk e ka bërë dhe nuk do ta bëjë kurrë një gjë të tillë, pavarësisht se të tjerët na hedhin gurë, na luftojnë, mbajnë ndaj nesh qëndrime të palejueshme në kundërshtim me marksizëm-leninizmin, me internacionalizmin proletar dhe me miqësinë luftarake që ka ekzistuar midis nesh.

Por ne jemi në rrugë të drejtë, prandaj asgjë nuk mund të na pengojë në rrugën tonë. Të mos shkojmë më larg, të shikojmë vetëm në sektorin e naftës ç'po ndodh. Prodhimi i naftës, me largimin e specialistëve sovjetikë, u rrit akoma më tepër, sepse atje me një patriotizëm të zjarrtë dhe mobilizim të madh, punoni ju, shokë punëtorë, mjeshtër dhe inxhinierë, që, të frymëzuar dhe të udhëhequr nga Partia, luftoni dhe kapërceni vështirësitë me një frymë të lartë vendosmërie, me zotësinë që keni fituar në shkolla, në punë, por edhe me eksperiencën që keni marrë, duke pasur kurdoherë afër punëtorët tanë të vjetër të naftës.

Marksizëm-leninizmi nuk mund të mposhtet, nuk ka forca në botë që ta bëjnë këtë, sado të mëdhenj të jenë kundërshtarët e tij. Shumë e madhe ka qenë forca e kapitalizmit në kohën e Marksit dhe të Engelsit. Në ato situata lëvizja komuniste në botë ishte shumë e dobët, por kapitalizmi nuk mundi ta pengonte dot triumfin e çështjes së klasës punëtore, nuk mundi ta pengonte më vonë edhe Revolucionin e madh të Tetorit dhe vendosjen e diktaturës së proletariatit në një të gjashtën e botës. Bashkimi Sovjetik, i udhëhequr nga Partia e madhe e Leninit dhe e Stalinit, u bë një shtet i fuqishëm socialist me një autoritet të madh në botë. U deshën dhjetëra e dhjetëra vjet pune dhe lufte vetëmohuese të



punonjësve sovjetikë për të bërë transformime të thella revolucionare në jetën e popullit sovjetik. Ata që mohojnë luftën e madhe, të vendosur, parimore, marksiste-leniniste të Partisë Bolshevike e të Josif Stalinit që ishte në udhëheqje të saj, ata janë revizionistë.

Që në kohën e Stalinit dhe nën udhëheqjen e tij kanë luftuar e kanë punuar për triumfin e kauzës së socializmit dhe të paqes një plejadë e tërë shkencëtarësh sovjetikë që shpikën këto gjëra të mrekullueshme, me të cilat Hrushovi tani mburret dhe hiqet si «luftëtari» më i madh i paqes në botë. Po të lexoni fjalimet e Stalinit, të Molotovit e të Vishinskit në mbledhjet ndërkombëtare do të shikoni luftën plot zjarr që bënin ata për t'i siguruar paqen njerëzimit, përpjekjet e vendosura për bashkekzistencën e shteteve me sisteme të ndryshme shoqërore.

Teorinë marksiste-leniniste mbi bashkekzistencën paqësore e ka formuluar e zbatuar me lavdi Lenini i madh dhe më vonë nxënësi i tij besnik Stalini e jo Nikita Hrushovi, që hiqet sikur e ka nxjerrë ai këtë teori të cilën në fakt e ka shtrembëruar. Lenini dhe Stalini kanë thënë se gjersa ekziston imperializmi ekziston edhe rreziku i luftës. Prandaj vetëm kur të zhduket imperializmi, zhduket rreziku i luftës.

Paqja nuk sigurohet me fjalë. Ajo sigurohet duke qëndruar vigjilentë dhe të pregatitur kundër çdo rreziku. Paqja nuk sigurohet vetëm me bisedime. Pse pak ka biseduar Stalini me udhëheqësit perëndimorë për këtë çështje? Ai nuk bridhte andej-këtej si Hrushovi, por kur ishte puna dinte ai si të bisedonte me përfaqësuesit e shteteve borgjeze. Hrushovi hiqet si «politikani» më i

madh që di t'ua marrë zemrën kapitalistëve! Por ai shkon te ata «për lesh dhe kthehet i qethur».

Në taktikën, metodën dhe në mjetet se si duhet siguruar paqja dhe si duhet evituar lufta, qëndron një nga kontradiktat e mëdha parimore të Partisë sonë me udhëheqësit sovjetikë. Partia jonë ka qenë dhe lufton për paqen. Ne kurrë nuk e duam luftën, se populli ynë i ka pësuar në truallin e vet tmerret e luftës për vite me radhë. Por rrezikun e luftës nga imperializmi ne e shohim me syrin e marksistit.

Ne nuk trembemi nga imperialistët. Nuk kemi pasur frikë as nga fashizmi italian, as nga nazizmi gjerman në kohën e pushtimit, kur ishim fare të paarmatosur, sepse populli i vendosur luftonte për një çështje të drejtë, për çlirimin e vendit, për lirinë dhe pavarësinë e atdheut, për vendosjen e regjimit të demokracisë popullore, për ndërtimin e socializmit. Tani që fituam luftën, që kemi ndërtuar atdheun e shkatërruar dhe kemi hedhur bazat ekonomike të socializmit, shikoni ç'forcë e madhe jemi bërë, ç'potencial ekonomik dhe ushtarak ka Shqipëria. Te ne i tërë populli është i armatosur, gjë që nuk e kanë popuj të tjerë. Dhe për këtë disa udhëheqës revizionistë na qortojnë pse i japim armë popullit. Ne u jemi përgjigjur atyre se populli ynë është i lidhur ngushtë me Partinë, prandaj e armatosim dhe ai armët që i ka dhënë Partia i ruan si sytë e ballit për t'i përdorur kundër çdo rreziku. Tani jemi shumë të fortë si politikisht dhe ushtarakisht. Ju dëgjuat në këtë takim rezultatet e arritura në gjeologji e në naftë. Rezultate të mëdha kemi edhe në sektorë të tjerë të cilat tregojnë sa të fortë jemi tani. Në këto kushte

përballë forcës së socializmit imperializmi është prap-sur dhe dobësuar.

Por me gjithë disfatat imperializmi me shpirt ndër dhëmbë vazhdon të armatoset. Pse e bën këtë? Që të sulmojë të tjerë, t'u rrëmbejë popujve lirinë dhe pavarësinë siç e ka zakon. N. Hrushovi ka ngritur problemin e çarmatimit të përgjithshëm dhe të plotë. Kjo do të bëhet kur të çarmatosen të gjithë dhe jo vetëm një pjesë. Ndërsa imperialistët amerikanë dhe partnerët e tyre armatosen gjer në dhëmbë, ne nuk duhet të çarmatosemi e t'i lëmë kufijtë të hapur, të mos kemi topa e avionë, të prishim flotën dhe nëndetëset tona. Për çarmatimin Partia dhe Qeveria janë kanë qenë dhe janë kurdoherë, por në rrugë të drejtë.

Ndryshimi i pikëpamjeve tona me udhëheqjen sovjetike qëndron në atë se si duhet arritur në rezultate konkrete për këto probleme. Rruga që ndjek Hrushovi në këto çështje nuk është e drejtë. Ai mendon e vepron se me bisedime, me lëvdata e lëshime ndaj imperialistëve sigurohet paqja, arrihet çarmatimi. Ka shumë vjet që bëhen diskutime për çarmatimin, por asnjë rezultat nuk është arritur, përkundrazi imperialistët amerikanë kërkojnë të fitojnë sa më shumë kohë për t'u armatosur. Partia jonë thotë se imperialistëve amerikanë nuk duhet t'u bëjmë asnjë lëshim, t'u qëndrojmë dhëmb për dhëmb krerëve imperialistë. Jeta vërteton atë që thotë Partia jonë se të gjithë armiqtë një qëllim kanë, se si Ajzenhaueri ashtu edhe Kenedi njëllon janë, përfaqësues të monopoleve amerikane që mbrojnë interesat e tyre në kurriz të popullit amerikan.

Qëndrimet tona parimore ndaj çështjeve të mëdha

ndërkombëtare nuk u kanë pëlqyer Nikita Hrushovit me shokë, prandaj ata kanë ndërmarrë akte kriminale ndaj nesh. Hrushovi që e mendon dhe e kupton ndryshe marksizëm-leninizmin, vepron ndaj nesh si elefanti ndaj mizës, nga pozitativat e shtetit të madh ndaj shtetit të vogël. Por marksizëm-leninizmi nuk njeh të vogël apo të madh, të fortë apo të dobët, para tij të gjithë janë të barabartë, prandaj qëndrimet që Hrushovi mban ndaj Partisë sonë janë të huaja për marksizëm-leninizmin dhe e demaskojnë atë dhe ata që e pasojnë.

Qëndrimet antimarksiste që mbahen ndaj Shqipërisë janë qëndrime të disa grupeve dhe jo të popujve e të komunistëve në masë. Prandaj ne jemi shumë të fortë e të bindur se do t'i kapërcejmë këto vështirësi të përkohshme. As që u trembet syri Partisë dhe popullit tonë, përkundrazi ju shokë punëtorë si e tërë klasa jonë punëtoreshë po punoni me forca të dhjetëfishuara dhe po i realizoni detyrat para afatit edhe në këto situata, të cilat ju i keni kuptuar shumë mirë.

Kjo tregon se, megjithëqë ju jeni të rinj, jeni të pjekur dhe me rezultatet që keni arritur, u keni dhënë një grusht dërrmues të gjithë armiqtë të Partisë dhe të popullit tonë. Kjo që po bëjmë është një luftë e madhe, bile më e madhe se Lufta Nacionalçlirimtare. Shumë prej jush kanë qenë të vegjël në atë kohë, nuk e kanë parë luftën, por megjithatë ju nuk mbeteni prapa nga brezi ynë më i vjetër për heroizmat dhe luftën që bëni për të mirën e popullit shqiptar, sepse edhe kjo që bëjmë tani është një luftë e madhe, e ashpër, plot pengesa e sakrifica, por një epokë e lavdishme që brezat e ardhshëm do të na kujtojnë me mburrje e mirënjohje.

Rrethimi armiqësor, në kushtet e të cilit ne jemi të detyruar të luftojmë, të punojmë e të mbrohemi, nuk do të thotë se Shqipëria është e vetme, e izoluar. Jo, sot është vështirë të preket ajo, sepse ka miq të shumtë dhe të fuqishëm. Por gjatë këtyre 17 vjetëve, nuk ka kaluar jo vit, po muaj dhe ditë që të mos jenë bërë kundër vendit tonë veprime armiqësore me anë diversantësh, spiunësh dhe kurdisje komplotesh të njëpasnjëshme. Ne kurdoherë kemi fituar, se Partia na ka mësuar që të mbajmë fort në njërën dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën. Kazma përfaqëson gjithçka që ndërtojmë, ndërsa pushka përfaqëson luftën për të mbrojtur e për të ruajtur fitoret tona, sepse në këto kushte e ndërtojmë ne socializmin. Kjo vijë e drejtë e Partisë ka bërë që të gjitha komplotet ne i kemi likuiduar dhe kështu do të likuidojmë çdo orvatje të armiqve, të cilët kurdoherë do të dështojnë, prandaj e mbajmë kurdoherë gati dyfekun dhe nuk na mposht dot askush. Armiqtë e vendit tonë kanë të bëjnë me një popull heroik dhe me një Parti të çeliktë, sot këtë e pranojnë edhe ata që kanë qenë kundërshtarët tanë.

Një unitet i çeliktë është krijuar midis Partisë dhe popullit, prandaj armiqtë tanë këtu synojnë, të përçajnë këtë unitet që është krijuar nga vija e drejtë e Partisë, vepra e madhe që ka bërë ajo, se veprat i bindin njerëzit, popullin.

Partia ju ka porositur dhe ju ka vënë detyrën që brenda pesëvjeçarit të realizoni një nivel të caktuar prodhimi. Por drejtësia e vijës së Partisë, forca e saj ju shtyn ju t'i tejkalonit këto shifra. Sikurse më kanë thënë shokët e Partisë, minatorët e Gjegjanit në rre-

thin e Kukësit, me rastin e 20-vjetorit të themelimit të Partisë, do ta realizojnë pesëvjeçarin në ditën e këtij jubileu. Ju lumtë atyre për këtë hov të madh revolucionar në punë për të mirën e popullit dhe të atdheut!

Edhe naftëtarët po i tejkalojnë planet. Por ata duhet t'i futen akoma më mirë punës së naftës. Specialistët sovjetikë, që kanë punuar në naftë, në bazë të urdhrave që morën nga udhëheqja e tyre, kanë zhvilluar veprimtari sabotuese. Perspektivën e naftës në vendin tonë e kanë theksuar specialistët sovjetikë, por në të vërtetë nën drejtimin e tyre janë shpuar shumë puse dhe gati asnjë prej tyre nuk na ka dhënë gjë deri tani. Është e pamundur të jetë kështu. Tani varet shumë nga ju, nga zotësia dhe kujdesi juaj që të rishikoni një nga një të gjitha të dhënat, ashtu siç na këshilloi Partia në Kongres, të organizoni punën dhe kohën tuaj dhe t'i rifuteni punës për të studjuar se ku duhen ribombarduar shtresat e naftës ose ku duhen bërë punime të këtij lloji dhe Partia është e bindur se atje nafta do të shpërthejë.

Kështu mund të themi edhe për çështjen e qymyrit, të kromit, të hekur-nikelit etj., që janë një pasuri e madhe për vendin tonë. Kudo po realizohen rezervat e parashikuara në plan.

Krahas minierave ne do të ndërtojmë edhe degë të tjera të industrisë sonë të rëndë. Për këtë qëllim objekte shumë të rëndësishme do të ngremë edhe me ndihmën internacionaliste të Republikës Popullore të Kinës.

Zhvillimi ekonomik i vendit tonë në të ardhshmen

ka perspektiva të mira në të gjithë sektorët. Do të shtohet sidomos prodhimi i bakrit, i kromit, i naftës e të tjera. Byroja Politike e Komitetit Qendror i ka dhënë direktivë Ministrisë së Minierave dhe të Gjeologjisë që brenda këtyre dy vjetëve të parë të pesëvjeçarit të kemi të qartë gjendjen e rezervave, të kemi të qartë ç'mineralet të tjera të reja mund të ketë në vendin tonë, cilat mund të përpunohen në vend, ç'leverdi ka përpunimi i tyre në vend ose jashtë etj.

Është një kënaqësi e madhe për popullin dhe për Partinë tonë që në saje të punës heroike të klasës punëtore dhe të vrullit revolucionar të rinisë sonë, me punën dhe djersën e tyre jo vetëm po realizohen vepra të mëdha në vendin tonë, por ato populli e sidomos rinia jonë i ruajnë me kujdes të madh, sepse i kanë ndërtuar vetë dhe kur i ndërton vetë të dhimbshen më shumë. Kjo vërtetohet edhe nga jeta, kur njeriu e nxjerr me djersë e mund bukën, e harxhon atë me rregull dhe nikoqirllëk. Kështu edhe rinia, punon e ndërton për vete, për lumturinë dhe për begatinë e atdheut e të popullit të vet, prandaj asaj i dhimbset çdo gjë. Kjo luan një rol të rëndësishëm jo vetëm për shtimin e pasurisë së popullit në çdo sektor, por edhe për ruajtjen e përdorimin me nikoqirllëk të saj.

Rinia kudo që punon është një mbështetje e madhe për zhvillimin tonë, ajo hidhet me vrull në të gjitha frontet e punës. Unë besoj se edhe angazhimin që morët ju, për ta realizuar pesëvjeçarin në katër vjet e gjysmë, do ta mbani.

Duhet të keni parasysh se të gjitha veprat e mëdha që do të bëhen këtë pesëvjeçar në vendin tonë, do të

kërkojnë punë e përpjekje, luftë e sakrifica, djersë e mund. Por këto nuk na trembin dhe në fakt nuk na kanë trembur se vetëm me punë, me përpjekje dhe me një organizim të shëndoshë ne do t'i kalojmë me sukses të gjitha vështirësitë.

Një çështje tjetër që dua të theksoj është ajo e mësimit, e edukimit dhe e specializimit tuaj. Në ç'situatë do të ishim ndodhur ne pas largimit të specialistëve sovjetikë në qoftë se nuk do t'ju kishim ju, në qoftë se nuk do të kishim këtë klasë punëtore, këta mjeshtra dhe inxhinierë që i rriti dhe i edukoi Partia, që i përgatiti nëpër shkolla? Po të mos ishte punuar me kohë për përgatitjen tuaj, tani do ta kishim shumë vështirë. Kur u larguan specialistët sovjetikë, ne, të themi të drejtën, u shqetësuam pak në fillim, prandaj menduam të shkurtonim pak planin. Mirëpo nga qendrat e punës na bombarduan me letra duke kërkuar që plani në asnjë mënyrë të mos shkurtohej. Atëherë përpara hovit të madh të klasës punëtore dhe të rinisë sonë ne «ngritëm» duart, nuk bëmë shkurtime, sepse ju na dhatë zemër dhe forcë dhe tani jemi plotësisht të bindur se do t'i realizoni planet, sepse shohim me sytë tanë mobilizimin në punë, vrullin, vendosmërinë dhe zotësinë tuaj.

Neve na vijnë çdo ditë informata jo vetëm për rezultatet e mira që arrini në punë, por edhe për vendosmërinë, për durimin dhe për aftësinë tuaj për t'i përballuar vështirësitë. Në qendrat e punës sigurisht ju jeni nga njerëzit më të dalluar, por si ju ka dhe plot të tjerë që punojnë me po atë vendosmëri, me po atë patriotizëm. Ajo që ka rëndësi është që shkollat të vazh-



dohen nga të gjithë. Edhe ata që kanë bërë shkolla përsëri të mësojnë më shumë, edhe ata që nuk kanë bërë shkolla të bëjnë përpjekje të specializohen, njëkohësisht të punojnë të ndjekin edhe shkollën. Tani mundësitë i kemi si brenda dhe jashtë vendit. Prandaj dikasteret përkatëse bashkë me Ministrinë e Arsimit e të Kulturës të organizojnë mirë punën që planet dhe detyrat për edukimin dhe specializimin tuaj të kryhen plotësisht.

Ju kuadrot e vjetër inxhinierë ose mjeshtra me stazh, bëni shumë kujdes për kuadrot e rinj, kujdes të shumanshëm, si shokë dhe si njerëz më me eksperiencë e më të regjur në jetë. Sigurisht midis jush ka minatorë dhe mjeshtra të profesioneve të ndryshme me disa vjet eksperiencë pune në miniera të ndryshme të vendit tonë. Duhet të bëni kujdes kur ju vijnë kuadro të rinj nga universiteti, sepse ata janë mësuar pa shumë shqetësime, me një jetë ku çdo gjë e kanë gjetur të gatshme në familje, kurse në minierë puna është ndryshe. Nuk them se të rinjtë që vijnë te ju kanë frikë nga puna dhe jeta që bëni ju atje, por kur largohet tjetri nga ambienti i shtëpisë dhe i Tiranës e ka pak të vështirë të futet menjëherë në minierë. Prandaj ju duhet të jeni pranë kuadrove të rinj dhe t'i ndihmoni që t'i kalojnë vështirësitë e kohës së parë. Natyrisht ka gjithfarë metodash për t'i kapërcyer ato. Ata janë njerëz të ngritur politikisht, që e duan popullin dhe Partinë, por të keni parasysh se ata vijnë për herë të parë në një punë të re. Prandaj, po të dini t'i trajtoni si duhet këta njerëz atëherë do t'i keni ushtarë të fortë. Nga ana tjetër, këta njerëz që kanë në shpirtin e tyre vrullin e rinisë, do të

shërbejnë për të gjallëruar në punë edhe të vjetrit, se i vjetri ka sedër. Kur ai e sheh të riun që çan tunelin ose i qëndron në kokë sondës me orë të zgjatura, me mendjen e tij thotë: si mund të ma kalojë mua ky djalë i ri? Edhe i riu, me gjithë vrullin djaloshar, përpiqet t'i marrë zanatin të vjetrit, por edhe ky duhet të gjejë mënyrën si t'ia japë. Prandaj këto gjëra të shikohen me kujdes edhe i vjetri të mësojë nga hovi i të riut, edhe ky të bëjë përpjekje që të përfitojë nga eksperiencia dhe pjekuria e më të vjetrit.

Prandaj në mes të rinjve dhe mjeshtreve të ketë një bashkëpunim të ngushtë për shkëmbimin e eksperiencës dhe të vrullit në punë, në mënyrë që kudo të krijohet një unitet graniti. Kështu planet jo vetëm do të realizohen, por edhe do të tejkalohen, bile me më pak lodhje e vështirësi. Këto dy çështje duhet t'i keni parasysh dhe veçanërisht ju, të bëheni shembull për të gjithë; rinia punëtore të frymëzojë me vrullin e saj, me punën dhe me rezultatet e saj gjithë klasën punëtore, fshatarësinë punonjëse dhe inteligjencën tonë.

Partia është shumë e kënaqur nga realizimi i planeve në industri dhe në miniera, pavarësisht se ka edhe të meta, ndaj të cilave ju nuk duhet të mbyllni sytë, por të merrni masa për t'i luftuar e zhdukur ato gradualisht. Plani i gjashtëmujorit të parë në industri e në miniera jo vetëm është realizuar por edhe është tejkaluar. Pra ky është një vit i mbarë dhe mobilizimi i punonjësve në të gjithë sektorët është i plotë.

Edhe fshatarësia punonjëse i ka realizuar mirë detyrat në bujqësi. Këtë vit ne do të kemi të korrura

të mira, do të kemi grurë, misër, pambuk, panxhar, fruta dhe perime shumë, plani i qumshtit është realizuar, sepse blegtoria ka ecur mirë. Pra, në saje të udhëheqjes së drejtë të Partisë dhe të punës plot vetëmohim të klasës punëtore, të fshatarësisë dhe të inteligjencës sonë planet po realizohen mirë në të gjithë sektorët.

Dje isha në mbledhjen e shkrimtarëve dhe të artistëve. Pjesëmarrësit atje diskutuan me dashuri të zjarrtë për Partinë e klasën punëtore dhe bënë autokritikë se nuk janë të lidhur sa duhet me klasën punëtore dhe fshatarësinë, prandaj morën zotime se do ta përmirësojnë punën e tyre në këtë drejtim. Kështu edhe ju do të kënaqeni me veprat e tyre ashtu sikurse kënaqen edhe ata me realizimin e planeve tuaja. Domethënë në të gjitha shtresat e popullit tonë ka një frymëzim të madh, një patriotizëm të paparë dhe besnikëri të pakufishme ndaj Partisë dhe marksizëm-leninizmit.

Prandaj, shokë të rinj, me këtë besim të madh, me këtë frymëzim shkoni në miniera, organizoni mirë punën, kohën e studimit dhe jetën tuaj sa të jetë e mundur më mirë. Mos lini pas dore edhe dëfrimin. Tani mjetet tona në këtë drejtim nuk janë të varfëra si përpara. Sigurisht të meta ka, por përparimet janë më të mëdha dhe Partia do të bëjë përpjekje që në të gjitha qendrat e punës të përmirësohet edhe më shumë jeta, çlodhja dhe dëfrimi i klasës punëtore.

Edhe një këshillë para se të ndahemi. Të gjithë ju bëni pjesë në organizatën e rinisë. Ta doni organizatën tuaj dhe ta forconi, ta bëni atë një levë të fuqishme të Partisë, të fortë, kompakte dhe përçuese të denjë të

vijës së Partisë në masat e rinisë; sa më mirë të punojë organizata juaj, aq më tepër elementë të shëndoshë dhe më besnikë do të vijnë në radhët e Partisë. Partia ka nevojë për ju, ajo duhet të përtërihet me gjak të ri dhe kur ju të kaliteni politikisht dhe ideologjikisht, në Parti do të vijnë njerëz të përgatitur dhe të çeliktë dhe kudhra e Partisë do t'i çelikosë akoma më shumë. Kështu Shqipëria do të ecë më shpejt në rrugën e socializmit dhe të komunizmit. Organizata e BRPSH ka një rëndësi të madhe për të ardhshmen e popullit dhe për forcimin e Partisë. Prandaj ta doni organizatën tuaj dhe të punoni për forcimin e saj.

Të grumbulloni në organizatën tuaj sa të jetë e mundur të rinj dhe të reja nga rinia punëtore. Organizata juaj tani është zgjeruar mjaft. Sidoqoftë përpiquni të punoni dhe t'i edukoni të rinjtë dhe të rejat.

Veçanërisht mos harroni të rejat. Në radhët tuaja nuk ka pikëpamje prapanike, por, sado që kemi bërë hapa përpara në këtë drejtim, prapë nuk kemi arritur atje ku duhet. Prandaj organizata të bëjë përpjekje për shtimin e radhëve të saj me më shumë të reja. Në radhët tuaja të forcohet morali i lartë proletar, ndershmeria, guximi, besnikëria, thjeshtësia, solidariteti etj., që janë karakteristika të popullit e të Partisë sonë. Varet nga ju, nga rinia në radhë të parë, që virtytet e larta të Partisë e të popullit tonë të ruhen dhe të çelikosen. Në punë ju do të lidhni miqësinë e dashurinë. Kjo është e natyrshme, por njihuni mirë me njëri-tjetrin dhe pastaj, kur të lidheni si duhet, jeta juaj do të bëhet më e lumtur.

Në emër të Komitetit Qendror ju falënderoj shumë

për këtë takim dhe ju uroj me gjithë zemër shëndet, të jeni kurdoherë në ballë të punës dhe të luftës për mbrojtjen e atdheut, të popullit dhe të Partisë, për realizimin e planeve tona!

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

# TE PËRILAPIM PËRVOJËN E MIRË TË SHKOLLAVE EKSPERIMENTALE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

15 korrik 1961

Në konferencën kombëtare të arsimit që u zhvillua dje foli gjerë e gjatë shoku Mehmet, i cili trajtoi jo vetëm probleme të shkollës sonë, por shpjegoi mirë edhe situatën politike që po kalon vendi ynë. Ai u foli hapur arsimtarëve, sepse Partia i konsideron ata nga njerëzit më të mirë e patriotë. Partia ka besim të madh te mësuesit e pedagogët, sepse këta merren me edukimin e brezit të ri, që është e ardhshmjia e vendit tonë. Nga ata varet në një shkallë të madhe ndërtimi i socializmit dhe përmirësimi çdo ditë e më shumë i jetës së popullit.

Reforma shkollore që kemi vendosur të bëjmë është një gjë shumë e mirë. Si nga informacioni që kemi

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua një informacion mbi punën e shkollave eksperimentale.

lexuar, ashtu dhe nga diskutimet e shokëve drejtorë të shkollave eksperimentale<sup>1</sup> si dhe të përfaqësuesve të ndërmarrjeve ekonomike ku nxënësit bëjnë praktikën, kuptohet se sa rezultate të mira janë arritur e sa të tjera do të arrihen në të ardhshmen. Kjo tregon se shkolla jonë do të korrë suksese më të mëdha.

Nuk di ç'botime do të bëhen pas konferencës që u zhvillua. Mendoj se duhet të dalë në dritë eksperiencia e mirë e shkollave eksperimentale. Ndërsa çështjen që shqyrtojmë në këtë mbledhje të Sekretariatit të Komitetit Qendror mendoj t'ia komunikojmë Partisë me anë të një vendimi, me qëllim që ajo të mobilizohet për realizimin e kësaj reforme shkollore. Përveç vendimit, duke marrë shkas nga kjo mbledhje e Sekretariatit të Komitetit Qendror, mund të botohet në shtyp edhe një shkrim, i cili të mos jetë i shkurtër, një kolonë, por të jetë i gjerë, me qëllim që të japë eksperiencë, sidomos eksperiencën që kanë fituar gjatë këtij viti këto tri shkolla eksperimentale, të cilat na informuan së bashku me ndërmarrjet ku bëjnë praktikë.

Shoku Kristaq Dollaku<sup>2</sup> shtroi këtu një sërë problemesh, zgjidhja e të cilave do të ndihmojë dhe shkollat e tjera. Këto probleme duhet t'i bëjnë të mendojnë edhe dikasteret, sidomos Ministrinë e Arsimit e të Kulturës, e cila, për mjaft çështje që u propozuan, është e

---

<sup>1</sup> Në Sekretariat u dëgjua eksperiencia e shkollës 11-vjeçare eksperimentale të Shkodrës, e asaj me profil bujqësor të Fierit dhe e shkollës 11-vjeçare «Qemal Stafa» me profil industrial të Tiranës.

<sup>2</sup> Në atë kohë kryeinxhinier i kombinatit të tekstileve «Stalin».

domosdoshme të përcaktojë masat që duhet të zbatohen. Eksperienca që dëgjuam në këtë mbledhje të Sekretariatit, t'u shërbejë edhe shkollave të tjera. Prandaj në artikull të dalin edhe emrat e këtyre tri shkollave si dhe ato të qendrave të punës ku nxënësit bëjnë praktikën, të cilat i përgëzojmë për punën e mirë që kanë bërë.

Për shkollat eksperimentale të Fierit dhe të Shkodrës shokët sekretarë të këtyre rretheve të bisedojnë veçanërisht me drejtorët e ndërmarrjeve për të plotësuar nevojat materiale që kanë këto shkolla, duke u shpërblyer kështu puna e mirë që kanë bërë gjatë këtij viti. Po të lindë nevoja për fonde, t'i paraqitet studimi ose propozimi Komitetit Qendror.

Ju faleminderit shokë të shkollave eksperimentale për ndihmën që na dhatë dhe ju urojmë suksese më të mëdha në vitin e ardhshëm shkollor!

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*



**ZËRI I FUQISHËM I SË VERTETËS  
MARKSISTE-LENINISTE DO TË MBYTË ZËRIN E  
ÇJERRË TË KORIT SHPIFARAK REVIZIONIST**

*Letërpërgjigje drejtuar KQ të PSP të Hungarisë<sup>1</sup>*

**12 gusht 1961**

**KOMITETIT QENDROR  
TË PARTISË SOCIALISTE TË PUNONJËSVE TË HUNGARISË**

*Budapest*

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë ju njofton se ka marrë dhe ka lexuar letrën e 21 qershorit 1961 që Komiteti Qendror i Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë i drejtonte Komitetit Qendror të Partisë sonë.

Me keqardhje ne konstatojmë se letra juaj është formuluar me një frymë ofenduese ndaj popullit shqip-

---

<sup>1</sup> Kopja e kësaj letrë u dërgohet edhe komiteteve qendrore të partive komuniste e punëtore të vendeve të tjera socialiste.

tar, ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj. Ajo, duke u bazuar në informata krejt pa baza, përfundon në konkluzione fund e krye të gabuara, me sulme dhe shpifje kundër Partisë dhe popullit tonë. Neve na vjen keq që udhëheqja e Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, duke qenë e keqinformuar, është vënë në pozita jomiqësore ndaj popullit shqiptar, ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë. Por faktet mbeten fakte. Letra juaj ekziston, ajo është firmosur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, J. Kadar, prandaj ne, me gjithë respektin që kemi ndaj Partisë motër të Hungarisë, jemi të detyruar t'i përgjigjemi udhëheqjes suaj.

Në letrën tuaj, në mënyrë tendencioze, përpiqeni të akuzoni Partinë e Punës të Shqipërisë për gjoja dizinformacion dhe për iluzione lidhur me qëndrimin dhe pikëpamjen e Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë. Por ne qysh në fillim do ta themi hapur mendimin tonë: letra juaj e 21 qershorit 1961 është e çuditshme, ajo, siç duket, më tepër synon të sqarojë e të kënaqë të tjerët për pozitën e partisë suaj, sesa Partinë tonë, e cila kurdoherë i ka pasur shumë të qarta qëndrimin dhe pikëpamjen tuaj dhe asnjëherë nuk ka pasur as iluzionin më të vogël.

Duke u bazuar në informata false udhëheqja juaj akuzon Partinë e Punës të Shqipërisë për antisovjetizëm. Ne mund t'ju themi se gjithë jeta e Partisë sonë, që nga themelimi i saj e deri sot, vërteton se Partia e Punës e Shqipërisë, populli shqiptar dhe udhëheqësit e tij, kurdoherë i kanë qëndruar besnikë Partisë Komu-

niste Bolshevike të Bashkimit Sovjetik, miqësisë me popujt sovjetikë dhe me të gjithë popujt e kampit socialist. Kështu ka qenë në të kaluarën, kështu është edhe sot.

Faktet tregojnë se populli shqiptar, gjatë gjithë historisë së tij shekullore, kurrë nuk është ndodhur në luftë me popullin rus, por kurdoherë në miqësi me të, në luftë kundër armiqve të përbashkët. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Bashkimi Sovjetik luftonte me heroizëm për shkatërrimin e fashizmit dhe për shpëtimin e popujve të ndryshëm nga murtaja fashiste, populli shqiptar, i udhëhequr nga komunistët, rrëmbeu armët dhe u radhit përkrah Bashkimit Sovjetik, përkrah ushtrisë së tij të lavdishme dhe me gjakun e dhjetëra mijëra dëshmorëve dha kontributin e tij modest në fitoren e përbashkët. Armiqtë e Bashkimit Sovjetik dhe të Shqipërisë, imperialistët dhe revizionistët, shpeshherë janë përpjekur, veçanërisht pas Çlirimit të vendit, të minojnë miqësinë shqiptaro-sovjetike, të armiçësojnë popujt tanë, por ata kurdoherë kanë dështuar me turp. Kurrë ndonjëherë populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqja e saj nuk janë gjetur e as do të gjenden në anën e armiqve të Bashkimit Sovjetik. Miqësia dhe dashuria që lidh popujt, partitë dhe udhëheqësit e vendeve të ndryshme me popullin sovjetik dhe me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik ka edhe të kaluarën e vet historike. Kjo e kaluar historike nuk duhet harruar, sepse ajo hedh dritë të qartë mbi atë se kush është mik i vërtetë, konsekuent e me besë i Bashkimit Sovjetik e kush jo.

Eksperiencia historike ka treguar dhe tregon se kundër Bashkimit Sovjetik luftohet me dy mënyra: ose

me armë në dorë, pra hapur, ose duke u përpjekur për ta izoluar Bashkimin Sovjetik nga miqtë e vërtetë, pra në mënyrë të tërthortë e të maskuar. Kushdo që pretendon se është mik i Bashkimit Sovjetik do të bënte mirë të reflektonte mbi këtë çështje. Partia dhe populli ynë, siç e provon vetë eksperiencia historike, vetë jeta, e kanë ndërgjegjen të pastër si për rastin e parë ashtu edhe për të dytin.

Në letrën tuaj bëhet fjalë për çështjen e bazës ushtarako-detare të Vlorës. Ne mendojmë se nuk është nevoja të zgjatemi për këtë çështje, duke qenë se ky problem është trajtuar me hollësi në letrën tonë të datës 6 korrik 1961 drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, e cila ju është dorëzuar edhe juve për dijen. Tashmë është fare e qartë se kush është fajtor për likuidimin e bazës ushtarako-detare të Vlorës dhe kush duhet të përgjigjet për këtë krim që është bërë kundër popullit shqiptar dhe kundër kampit të socializmit, se kush duhet të përgjigjet për konsekuencat që mund të rrjedhin nga likuidimi i bazës së vetme ushtarako-detare të kampit socialist në Mesdhe.

Në letrën tuaj të 21 qershorit 1961 ju i kushtoni një vend të madh gjyqit që u zhvillua në Tiranë gjatë muajit maj 1961 kundër një grupi tradhtarësh dhe spiunësh, të cilët ishin në shërbim të shteteve kapitaliste. Letra juaj e 21 qershorit 1961 merr një rëndësi shumë të madhe për ne, sepse ajo hedh dritë mbi një çështje që neve nuk na kishte shkuar ndër mend: në një dokument zyrtar drejtuar Komitetit Qendror të Partisë sonë, ju, pa kurrfarë hezitimi, merrni nën

mbrojtje spiunët dhe agjentët e imperializmit! Për fat të keq ne detyrohemi të mbajmë shënim për një gjë të tillë. Por, meqë ju interesoheni për fatin e kundërshtarëve dhe të armiqve të popullit e të Partisë sonë; jemi të detyruar t'ju themi se vlerësimi i fajit të tyre, dënimi ose mosdënimi i tyre, u përket vetëm Partisë së Punës të Shqipërisë, Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Ne nga ana jonë as jemi interesuar dhe as do të interesohemi kurrë se ç'bëni ju me kundërshtarët dhe armiqtë e partisë suaj dhe të popullit hungarez: i arrestoni apo i lini të lirë, i mbani në udhëheqje apo i internoni, i dëboni nga vendi juaj apo i rehabilitoni — kjo është krejtësisht puna juaj dhe përgjegjësia juaj.

Në letrën tuaj të 21 qershorit 1961 ju ankoheni pse Ambasada e Republikës Popullore të Shqipërisë në Hungari shpërndau nëpër qytetarët hungarezë buletin informativ mbi procesin gjyqësor që u zhvillua në Tiranë dhe më poshtë konkludoni: «Ne kemi dy mundësi: ose nuk do të lejojmë botimin e një informacioni të tillë, ose do ta lejojmë, por në këtë rast do të na duhet gjithashtu të botojmë mendimin tonë rreth procesit». Pra ju direkt na kërcënoni me publikimin në shtyp të pikëpamjes suaj lidhur me gjyqin që u zhvillua në Tiranë. Është e tepërt të theksojmë se një kërcënim i tillë bëhet në adresë të gabuar. Ne nuk frikësohemi nga kërcënimet. Dihet se kundër këtij gjyqi publikisht u ngritën edhe imperialistët edhe revizionistët jugosllavë, të cilët bënë bile edhe kërcënime. Por kjo nuk na pengoi që komplotistët t'i nxirrnim përpara gjyqit dhe mbasi gjyqi i dënoi edhe t'i ekzekutonim.

Në qoftë se ju dëshironi të shkruani publikisht për këtë çështje, të jeni të sigurt se do të merrni përgjigjen e merituar botërisht. Ne do të dimë të mbrohemi, si kurdoherë, ndaj cilitdo që do të sulmojë e do të shpifë kundër popullit e Partisë sonë. Dhe këtë do ta bëjmë ashtu si duhet, të plotë dhe me fakte e dokumente konkrete. Ne kemi marrë masat që ambasada jonë në Hungari të mos shpërndajë më asnjë material lidhur me gjyqin që u zhvillua në Tiranë. Këtë e bëjmë vetëm sepse duam të respektojmë rregullat e një vendi mik e aleat, siç është Hungaria, megjithëse rregullat e vëna nga ju, posaçërisht kundër nesh, janë jomiqësore dhe aspak normale në marrëdhëniet midis vendeve socialiste.

Ne duam të theksojmë se për gjyqin e Tiranës kemi lexuar mjaft deklarata të ndryshme. Midis të tjerave edhe deklaratën e mëposhtme të gazetës jugosllave «Borba», të datës 31 maj 1961, në të cilën thuhet: «Fakti se sot, në vitin 1961, Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu, mbas gjithë palavdisë, organizuan një proces gjyqësor të tillë, i cili i shërbeu opinionit botëror si ilustrim i paligjshmërisë së Qeverisë në Shqipëri dhe i padrejtësisë që jeton populli liridashës i Shqipërisë, tregoi se qëllimi ka qenë që nëpërmjet këtij procesi moralisht dhe politikisht të diskreditojë lavdinë e luftëtarëve të Luftës Nacionalçlirimtare Shqiptare, kuadro të aktivë të Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilët kanë shfaqur pakënaqësinë për politikën e brendshme e të jashtme të Enver Hoxhës dhe të ndihmësve të tij dhe që kanë kërkuar që ajo të shndërrohet». Ne nuk kemi asnjë kundërshtim në qoftë se ndokush publi-

kisht dëshiron të bashkohet me një pikëpamje të tillë. Siç shihet një precedent ekziston.

Në letrën tuaj shumë vend i kushtoni çështjes së marrëdhënieve shqiptaro-hungareze. Ne nuk e kuptojmë se për ç'arsye ju vjen keq që në shtypin tonë u botua lajmi mbi ndihmën prej 15 milion rublash që populli dhe qeveria hungareze u dhanë popullit dhe Qeverisë Shqiptare. Së pari, botimi në shtyp i njoftimit mbi këtë gjest internacionalist u bë pasi u muar aprovimi verbal i delegacionit tregtar hungarez që në atë kohë gjendej në Tiranë, megjithëqë kjo nuk ishte absolutisht e domosdoshme; pra në atë kohë ju vetë ishit dakord për një gjë të tillë. Së dyti, përse kërkonti që ne t'i fshehim popullit shqiptar ndihmën që atij i jep një popull mik e vëlla siç është populli hungarez? Kjo mund të shpjegohet vetëm kështu: ose qeveria juaj dhe Komiteti Qendror i Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, për arsyet që i dinë ata vetë, janë pënduar që i akorduan popullit shqiptar një ndihmë të tillë, ose ata do të dëshironin që ne të mos shkruanim fare për këtë ndihmë, për të pasur një «argument» për të akuzuar më vonë Partinë e Punës të Shqipërisë për «mosmirënjohëse», apo për «largim» nga ndjenjat e internacionalizmit proletar etj., etj. Në qoftë se është rasti i parë, ne nuk e konceptojmë dot përse nevojitej një letër e tillë dhe një thurje e tillë legjendash, kurse çështja do të ishte më e thjeshtë: të anulohet kjo ndihmë nën çfarëdo preteksti (tani gjetja e preteksteve për çfarëdo lloj veprimi kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë së Punës të Shqipërisë është bërë një gjë e zakonshme). Në qoftë se është rasti i

dytë, atëherë gaboheni rëndë, se kurrë ndonjëherë Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria Shqiptare, populli shqiptar nuk e kanë fshehur dhe as do ta fshehin nga askush ndihmën e sinqertë të vëllezërve dhe të alcatëve. Ai ka folur me zë të lartë për këtë dhe do të flasë edhe në të ardhshmen, pavarësisht nëse kjo ju pëlqen apo jo.

Në letrën tuaj të mësipërme, ju akuzoni pa të drejtë Partinë tonë lidhur me interpretimin e ngjarjeve të kundërrevolucionit të tetorit 1956 në Hungari. Pikëpamjet e Partisë sonë mbi ngjarjet e këtij kundërrevolucionit janë bërë të njohura botërisht prej kohësh, ato shprehen në dokumente zyrtare të Partisë sonë. Por nga ju vetëm tash dëgjojmë kritika për këto pikëpamje. Ne jemi thellësisht të bindur se pikëpamjet tona mbi ngjarjet e kundërrevolucionit në Hungari janë të drejta.

Përsa i përket deklaratës së prokurorit në gjyqin që u zhvillua në Tiranë, për të cilën bëhet fjalë në letrën tuaj, mendojmë se nuk është nevoja të zgjatemi. Në këtë gjyq nuk shtrohej çështja që të analizoheshin shkaqet që sollën kundërrevolucionin në Hungari. Atje bëhej fjalë për veprimtarinë komplotiste të imperialistëve amerikanë dhe të revizionistëve jugosllavë kundër vendeve socialiste, atje demaskohej fytyra armiqësore e imperialistëve dhe e shërbëtorëve të tyre. Ne jemi të mendimit se prokurori në gjyqin që u zhvillua në Tiranë ka vepruar drejt dhe ka bërë shumë mirë që ka përdorur fakte konkrete, midis të cilave edhe ngjarjet tragjike të kundërrevolucionit në Hungari, apo ato të agresionit kundër Kubës, për të treguar rrezikshmërinë dhe agresivitetin e imperialistëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre. Në qoftë se ju keni ndryshuar



mendim dhe kërkoni të mohoni rolin armiqësor që kanë luajtur në kundërrevolucionin në Hungari imperialistët amerikanë dhe revizionistët jugosllavë, kjo është puna juaj.

Në përgjithësi përmbajtja dhe toni i letrës suaj të 21 qershorit ka për qëllim të shtrembërojë të vërtetën, të akuzojë Partinë e Punës të Shqipërisë për faje që nuk i ka, të mashtrojë opinionin e partive motra, të cilave u keni dërguar letrën e lartpërmendur. Por është e qartë se ju gaboni rëndë. Duke vepruar në këtë mënyrë, duke përdorur metoda e «fakte» të tilla, ju nuk do të bindni asnjëri, por nxirrni në shesh atë që përpiqeni të fshihni: qëllimet e errëta që ju shtyjnë për të sulmuar Partinë e Punës të Shqipërisë dhe popullin shqiptar.

Në qoftë se ju mendoni se duke vepruar në një mënyrë të tillë do të frikësoni Partinë dhe popullin tonë, ne mund t'ju themi se as letra juaj, as provokacionet e hapëta e të botuara në shtyp që disa udhëheqës të disa partive kanë bërë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë, as kërcënimet e turpshme dhe bllokada ekonomike, ushtarake dhe politike që është organizuar me kujdes dhe pasion nga udhëheqjet e partive të disa vendeve socialiste, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, nuk i trembin Partinë, Qeverinë dhe popullin tonë. Përkundrazi nga veprime të tilla ne akoma më shumë bindemi se jemi në rrugë të drejtë, se ata që akuzojnë e sulmojnë Partinë dhe popullin tonë, i cili ndërton socializmin në kushte shumë të vështira të rrethimit kapitalist, gabojnë rëndë dhe marrin mbi vete një përgjegjësi të madhe përpara historisë dhe lëvizjes

komuniste e punëtore ndërkombëtare. «Argumentet» tuaja janë pa baza dhe shpifjet që përdoren sot në kor kundër Shqipërisë socialiste dhe Partisë së saj marksiste-leniniste mund të gënjejnë përkohësisht vetëm disa njerëz. Por çdo gjë do të sqarohet, zëri i fuqishëm i së drejtës leniniste patjetër do ta mbytë zërin e çjerrë të korit shpifararak dhe antimarksist. Atëherë do të jetë më e vështirë që të gjenden argumente për shfajësim.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë shpreson se ju, shokë të Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, do të rishikoni me gjakftohtësi të gjitha faktet dhe se do të ndryshoni rrugë në lidhje me qëndrimin tuaj ndaj Partisë dhe popullit tonë, shpreson se do të hiqni dorë nga sulmet dhe qëndrimet e padrejta ndaj Partisë dhe popullit tonë.

Kurrë ndonjëherë Partia e Punës e Shqipërisë nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim që sado pak do të dëmtonte interesat e Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë apo të popullit vëlla hungarez. Përkundrazi, ju vetë e dini, dhe për këtë faktet janë të panumërta, se gjithnjë Partia e Punës dhe populli shqiptar janë gjendur pranë partisë dhe popullit hungarez, në kohë të mira dhe të këqija. Ne edhe në të ardhshmen këtë qëndrim do të kemi, sepse këtë na e dikton ndjenja e miqësisë së sinqertë, respekti për popullin vëlla hungarez dhe detyra jonë internacionaliste. Asnjëherë në marrëdhëniet midis dy partive dhe dy vendeve tona nuk ka pasur asnjë mosmarrëveshje dhe në qoftë se tani, me letrën tuaj, ju përpigëni të krijoni artificialisht një situatë jonormale, e kuptoni se për këtë nuk jemi ne fajtorë! Ne as nuk e kemi dashur, as nuk e duam

një gjë të tillë, sepse kjo nuk është as në interesin e Partisë dhe të popullit tonë, as në interesin e partisë dhe të popullit hungarez, as në atë të unitetit të kampit socialist. Për këtë janë të interesuar vetëm armiqtë e partive dhe të popujve tanë, armiqtë e vendeve socialiste, armiqtë e socializmit dhe të komunizmit. Ne shpresojmë se edhe Komiteti Qendror i Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë do të jetë i të njëjtit mendim me ne.

Përshëndetje komuniste

Me autorizim të Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim, sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*

# **NJË AKT ANTIMARKSIST E ANTISHQIPTAR I GRUPIT REVIZIONIST TË HRUSHOVIT**

*Letër dërguar të gjitha organizatave të Partisë*

**16 gusht 1961**

## **TË GJITHA ORGANIZATAVE TË PARTISË**

Shokë,

Sikurse jeni vënë në dijeni me anën e shtypit, prej datës 3 deri më 5 gusht 1961 u mbajt në Moskë një mbledhje e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtorë të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës për çështjen e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë. Komiteti Qendror i Partisë sonë caktoi, për të marrë pjesë në këtë mbledhje, delegacionin e tij, të kryesuar nga shoku Ramiz Alia, me kompetenca të plota, për të shpënë atje pikëpamjen e Partisë dhe të Qeverisë sonë mbi rregullimin e problemit gjerman. Për këtë vendim u njoftua zyrtarisht nga ana e Komitetit Qendror të Partisë, qysh më 22 korrik, inisiatori i mbledhjes, V. Ulbrihti.

Në datën 1 gusht delegacioni ynë arriti në Moskë.

Mbledhja filloi në datën 3 gusht. Merrnin pjesë, përveç përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve të Traktatit të Varshavës, edhe përfaqësues të partive komuniste e punëtoresh të vendeve socialiste të Azisë. Sapo filloi mbledhja, të cilën e kryesonte N. Hrushovi, e mori fjalën Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë Socialiste të Bashkuar Gjermane, V. Ulbrihti, i cili, pasi bëri një varg akuzash dhe shpifjesh të ulëta kundër Partisë sonë dhe udhëheqësve të saj, sikur gjoja Partia jonë «ka frikë të marrë përgjegjësi për një çështje të tillë të ndërlikuar sikurse është çështja gjermane», sikur gjoja ajo «pregatit terrenin për t'u afruar me ata që kundërshtojnë rregullimin paqësor të problemit gjerman» dhe se «është vënë në opozitë me Traktatin e Varshavës» etj., etj., kërkoi që delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë të mos pranohej në mbledhje, nën pretekstin se atë nuk e kryesonte Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, ndërsa delegacionet e tjera të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës kryesoheshin nga sekretarët e parë. Është fare e qartë se përsëri, si në mbledhjet e mëparshme, ne ndodheshim përpara një provokacioni të ulët, i cili kishte për qëllim të poshtëronte Partinë tonë, t'i mohonte asaj të drejtën e padiskutueshme që, si pjesëtare e Traktatit të Varshavës, të thoshte fjalën e saj për një problem kaq të rëndësishëm siç është problemi gjerman.

Ky komplot i ri ishte organizuar në mënyrë të tillë që delegacionit tonë të mos i jepej fare mundësia që të fliste dhe të hidhte poshtë shpifjet e akuzat që u bënë në adresë të Partisë sonë, të denonconte këtë akt

antimarksist të paparë ndonjëherë në marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtoze. Megjithëkëtë, edhe pse u ndërpre pas çdo fjale nga N. Hrushovi, delegacioni ynë e dënoi këtë veprim si armiqësor e antimarksist, theksoi se Partia jonë kurrë dhe nga askush nuk ka pasur dhe nuk ka frikë, ajo zbaton me besnikëri angazhimet e saj ndaj Traktatit të Varshavës, se Partia e Punës e Shqipërisë ka qenë dhe është e vendosur që çështja e traktatit të paqes me Gjermaninë të përfundohet sa më parë, se propozimi i Ulbrihtit është në kundërshtim me çdo rregull marksist, sepse në Partinë tonë vepron parimi i udhëheqjes kolegjiale, sipas të cilit çdo i deleguar i Komitetit Qendror është i autorizuar nga ai për çdo veprim edhe është në gjendje të marrë përgjegjësi të plotë në çdo situatë. Por organizatorët e këtij veprimi armiqësor ndaj Partisë sonë bënë punën e tyre. Të gjithë sekretarët e parë të partive komuniste e punëtoze të vendeve të Traktatit të Varshavës, që folën pas Ulbrihtit, aprovuan propozimin e tij duke i mohuar Partisë sonë të drejtën e pjesëmarrjes në mbledhje.

Në këto kushte delegacioni ynë menjëherë i drejtoi një letër N. Hrushovit, si kryetar i mbledhjes, me të cilën protestoi për këtë veprim antimarksist që u krye kundër Partisë sonë, i dërgoi tekstin e fjalimit që do të mbante delegacioni ynë në mbledhje, me kërkesën që të lexohej në mbledhje dhe të futej në protokollet e saj. (Përmbajtja e fjalimit në formën e një deklarate<sup>1</sup>, ku përcaktohet pikëpamja e Partisë sonë për

---

<sup>1</sup> Shih «Dokumente kryesore të PPSH», vëll. IV, f. 62. Tiranë, 1970.

problemin gjerman, u botua në gazetën «Zëri i popullit» të datës 8 gusht 1961). Kopja e letrës drejtuar Hrushovit dhe kopja e fjalimit iu dërguan gjithashtu edhe të gjithë kryetarëve të delegacioneve të partive që merrnin pjesë në mbledhje.

Duket qartë se N. Hrushovi dhe udhëheqësit e tjerë kryesorë të vendeve socialiste të Evropës, që ndjekin kursin e tij, me qëllime të paracaktuara dhe armiqësore mbajtën ndaj Partisë sonë të Punës, që mbron me besnikëri marksizëm-leninizmin, një qëndrim antimarksist dhe armiqësor, duke shkelur edhe një herë, në mënyrën më brutale, normat më elementare organizative dhe parimet marksiste-leniniste të konsultimit dhe të barazisë që duhet të zbatohen në marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtore motra; ndërhyjnë haptazi në kompetencat dhe në punët e brendshme të një partie tjetër, e cila ka të drejtë të plotë që, në mënyrë të pavarur, të caktojë vetë delegacionin që ajo mendon ta përfaqësojë në këtë apo në atë mbledhje partie, të shfaqë lirisht pikëpamjet e saj, pavarësisht nëse këto i pëlqejnë apo nuk i pëlqejnë dikujt. Ky qëndrim i tyre armiqësor dhe në kundërshtim flagrant me parimet dhe rregullat e përcaktuara në Deklaratën e përbashkët të partive komuniste e punëtore, të nënshkruar në Moskë, në nëntor të vitit 1960, është vetëm një hallkë në zinxhirin e gjatë të veprimtarisë antimarksiste, antisocialiste dhe antishqiptare që zhvillojnë grupi i Hrushovit dhe ata që e ndjekin pas. Qëndrimi armiqësor pa precedent që mbajtën sekretarët e parë të komiteteve qendrore të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës është një goditje tjetër e rëndë që

u bëhet unitetit të kampit socialist, marksizëm-leninizmit dhe gëzon vetëm armiqtë e socializmit e të paqes, imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, revizionistët jugosllavë në radhë të parë. Në këtë mulli çon ujë trajtimi antimarksist që iu bë delegacionit të Partisë sonë të Punës në mbledhjen e Moskës të 3 gushtit.

Duhet theksuar se përfaqësuesi i Partisë Komuniste të Kinës, që asistonte në mbledhje me cilësinë e vëzhguesit, lexoi një deklaratë proteste në emër të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, me anën e së cilës udhëheqja e Partisë Komuniste të Kinës dënonte qëndrimin armiqësor që u mbajt ndaj delegacionit të Partisë sonë, duke e konsideruar atë në kundërshtim me Deklaratën e Moskës të nëntorit 1960, dhe aspak bindëse arsyetimet mbi të cilat u bë propozimi për mospranimin e delegacionit tonë në mbledhje. Në këtë protestë theksohej se çdo parti ka të drejtë të caktojë vetë delegacionin e saj, të cilit ajo i jep kompetenca për të vepruar në emër të saj dhe se asnjë parti nuk ka të drejtë të largojë nga një mbledhje e përbashkët delegacionin e caktuar nga Komiteti Qendror i një partie tjetër. Qëndrimi që u mbajt ndaj delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë, thekson deklarata e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Kinës, dëmton hapur kompaktësinë e kampit socialist, ai do të pritet me hidhërim nga të gjithë ata që luftojnë për unitetin dhe do të gëzojë imperialistët e armiqtë e socializmit. Me anë të deklaratës së tij Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Kinës kërkoi që të anulohet vendimi për largimin e delegacionit tonë nga mbledhja.



Por pjesëmarrësit e mbledhjes së Moskës nuk e morën parasysh as këtë protestë. Ata zhvilluan mbledhjen pa delegacionin tonë dhe në fund të punimeve, duke dashur që të mbulojnë krimin që bënë ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, botuan një komunikatë ku, në mënyrë të paturpshme e falsifikuese, thuhej se në mbledhje morën pjesë gjithë sekretarët e parë të komiteteve qendrore të partive komuniste e punëtore të vendeve të Traktatit të Varshavës. Duke marrë parasysh se një afirmim i tillë është fals dhe nuk i përgjigjet së vërtetës, Komiteti Qendror i Partisë sonë vendosi të mos e botojë këtë komunikatë. Nga ana tjetër, me qëllim që të shprehim pikëpamjen tonë lidhur me problemin gjerman, që të hedhim poshtë shpifjet dhe akuzat false që u bënë kundër Partisë sonë lidhur me këtë çështje, Komiteti Qendror i Partisë vendosi të botojë në shtyp deklaratën e Komitetit Qendror të Partisë lidhur me çështjen gjermane, të cilën do ta mbante në mbledhjen e Moskës delegacioni ynë dhe që iu dërgua që në Moskë gjithë kryetarëve të delegacioneve që merrnin pjesë në atë mbledhje. Deklarata, siç u tha më lart, u botua më 8 gusht 1961 në gazetën «Zëri i popullit». Por, duke e botuar këtë deklaratë, Komiteti Qendror i Partisë kishte parasysh që të mos u jepte armë as imperialistëve, as revizionistëve jugosllavë, prandaj nuk u theksua se delegacioni ynë nuk u pranua në mbledhje. Në shtyp ne shënuam vetëm se delegacioni ynë shkoi në Moskë dhe u dërgoi kryetarëve të delegacioneve të partive, që merrnin pjesë në mbledhje, deklaratën e Komitetit Qendror të PPSH mbi çështjen e përfundimit të traktatit të paqes me Gjermaninë. Ko-

miteti Qendror i Partisë mendon se kaq ishte e mjaftueshme. Në qoftë se grupi i Hrushovit e të gjithë ata që e pasojnë duan t'i japin armë reaksionit, le ta thonë në shtyp vetë arsyen pse delegacioni ynë nuk foli në mbledhje, por dërgoi këtë deklaratë.

Siç shihet, mbledhja e Moskës e sekretarëve të parë të partive komuniste e punëtoresh të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, u shndërrua edhe një herë nga Hrushovi dhe nga ata që i mbajnë iso në arenë sulmesh, provokacionesh e ofendimesh të ndyra, kundër Partisë, popullit e atdheut tonë. Kjo mbledhje nxori në shesh fytyrën e tyre prej antimarksistësh e antishqiptarësh, fytyrën e tyre prej revizionistësh e oportunistësh. Por, nga ana tjetër, kjo mbledhje, ashtu si edhe mbledhjet e Bukureshtit e të Moskës të vitit 1960, do të përmenden në historinë e lëvizjes komuniste e punëtoresh ndërkombëtare, në historinë e kampit socialist, jo vetëm për qëndrimet antimarksiste dhe revizioniste të Hrushovit me shokë, por edhe për qëndrimin e vendosur, parimor, marksist-leninist, që mbajti një parti e vogël, Partia e Punës e Shqipërisë, për mbrojtjen e parimeve të marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen dhe për forcimin e unitetit të kampit socialist, për mbrojtjen e nderit e të dinjitetit të popullit e të atdheut të saj.

Presionet e provokacionet, shantazhet dhe kërcënimet që u bëhen Partisë dhe Qeverisë sonë, popullit tonë, tregojnë se Hrushovi me grupin e tij notojnë në llumin e revizionizmit e të oportunitizmit, tregojnë se Partia jonë është në rrugë të drejtë.

Mobilizimi në punë, i paparë ndonjëherë, dhe rea-

lizimet e mrekullueshme që po arrin populli ynë, i udhëhequr nga Partia e vet, besnike deri në vdekje e interesave të popullit, në sektorin e industrisë e të bujqësisë, të ndërtimeve e të kulturës etj., janë përgjigjja më e mirë që u jepet armiqve të Partisë. Këto dëshmojnë për drejtësinë e vijës së Partisë, e cila është vija dhe politika e vetë masave punonjëse të qytetit e të fshatit, këto dëshmojnë edhe një herë për unitetin e çeliktë revolucionar e luftarak që bashkon Partinë me popullin, për unitetin e pathyeshëm marksist-leninist të radhëve të komunistëve shqiptarë, të cilët, në këto momente, janë të bashkuar si një trup i vetëm rreth Komitetit Qendror të Partisë, këtij shtabi luftarak që me trimëri e zgjuarsi, me besnikëri të pakufishme ndaj interesave të atdheut, udhëheq popullin në rrugën e socializmit.

Përpara një uniteti të tillë bolshevik, unitet interesash e qëllimesh të përbashkëta të Partisë e të popullit, kanë thyer dhe do të thyejnë gjithmonë kokën armiqtë e Partisë e të popullit, sepse në anën tonë është forca e së drejtës, e cila është një forcë e pamposhtur.

Sa më tepër e sulmojnë dhe e kërcënojnë armiqtë Partinë tonë, aq më fort komunistët shtrëngojnë radhët e tyre, aq më ngushtë lidhet populli me Partinë e tij që e nxori nga errësira në dritë. Historia e luftërave dhe e përpjekjeve të Partisë e të popullit kundër imperialistëve dhe shërbëtorëve të tyre, revizionistëve jugosllavë, monarko-fashistëve grekë, neofashistëve italianë si edhe revizionistëve e oportunistëve të çdo kallëpi, na ka mësuar se uniteti është garancia vendimtare

e fitoreve tona dhe e disfatave për armiqtë tanë, se uniteti është burimi i forcës sonë të pashtershme, është arma jonë gjithmonë fitimtare. Prandaj, të dashur shokë, le ta ruajmë si thesarin më të shtrenjtë, si sytë e ballit unitetin tonë që ka në bazën e vet mësime të marksizëm-leninizmit, interesat e përbashkëta të Partisë, të popullit e të atdheut për mbrojtjen e fitoreve të revolucionit tonë popullor dhe të ndërtimit socialist të vendit.

Le ta mbajmë gjithmonë lart vrullin revolucionar të popullit e të Partisë sonë për ndërtimin e socializmit dhe vigjilencën e tyre të mprehtë!

Le ta mbajmë lart, me guxim, si deri sot, flamurin e marksizëm-leninizmit, flamurin e miqësisë me popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik, të Kinës e të vendeve të tjera të demokracisë popullore! Kështu ne do të kapërcejmë çdo vështirësi dhe pengesë, kështu ne do të thyejmë çdo armik që do të tentojë të prekë Partinë e popullin, lirinë, pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin tokësor të atdheut tonë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*



Kjo letër të lexohet në të gjitha organizatat-bazë të Partisë me qëllim që të gjithë komunistët të jenë në

dijeni të këtij akti të pashembullt antimarksist që Hrushovi dhe njerëzit që e pasojnë bënë kundër Partisë dhe vendit tonë.

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**TELEGRAM NGUSHULLIMI PËR VDEKJEN  
E MILITANTIT TË PALODHUR KOMUNIST,  
UILLIAM FOSTER**

**4 shtator 1961**

**KOMITETIT EKZEKUTIV KOMBËTAR TË PARTISË  
KOMUNISTE TË SHTETEVE TË BASHKUARA  
TË AMERIKËS**

Të dashur shokë,

Me hidhërim të madh mësuam për vdekjen e udhëheqësit të shquar të Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, luftëtarit të paepur për mbrojtjen e interesave të klasës punëtore dhe të masave punonjëse, personalitetit të shquar të lëvizjes komuniste e punëtore amerikane dhe ndërkombëtare, birit besnik të popullit amerikan, shokut Uiliam Foster.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë i dërgon ngushullimet e thella Partisë Komuniste të Shteteve të Bashkuara për këtë humbje të rëndë.

Jeta dhe vepra revolucionare e militantit të palodhur komunist, shokut Uiliam Foster, do të mbeten të paharruara dhe do të frymëzojnë mijëra e mijëra mili-

tantë komunistë të rinj në luftë për unitetin dhe kompaktësinë e radhëve të partisë, kundër armiqve të klasës punëtore e të marksizëm-leninizmit, kundër imperializmit amerikan, kokës së reaksionit ndërkom-bëtar, dhe agjentëve të tij, oportunistëve dhe revizionistëve modernë, për triumfin e çështjes së klasës punëtore, të socializmit dhe të komunizmit, në shërbim të të cilave shoku Uiliam Foster shkriu gjithë energjitë dhe jetën e tij.

Për Komitetin Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
Nr. 214 (4057), 5 shtator 1961*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë .*

## MBI DISA PROBLEME TË GJENDJES NDERKOMBETARE

*Fjala në Plenumin III të KQ të PPSH*

5 shtator 1961

Byroja Politike mendoj të thërresë mbledhjen e këtij Plenumi për të diskutuar dhe për të aprovuar projektletren<sup>1</sup> që do t'u dërgojmë komiteteve qendrore të partive komuniste e punëtore të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës, në përgjigje të letrës së tyre të 3 gushtit të këtij viti, për të cilën ju keni dijeni. Njëkohësisht në mbledhjen e sotme të Plenumit mendojmë t'ju vëmë në dijeni edhe për një letër provokuese e plot shpifje që i është dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë nga ana e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë. Fryma e kësaj letre është e njëjtë me ato të letrave të tjera që na janë dërguar nga Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe komitetet qendrore të partive të tjera të vendeve socialiste të Evropës. Kjo letër nuk na ka ar-

---

<sup>1</sup> Shih në këtë vëllim f. 457.



dhur akoma, por jemi njoftuar me një radiogram përmbledhës nga ambasadori ynë në Bullgari. Sidoqoftë nga leximi i këtij radiogrami Plenumi ynë do të ketë një ide të qartë mbi përmbajtjen e letrës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë.

Para se të flasim konkretisht për këto letra dhe për përgjigjet që mendojmë t'u japim, dëshiroj të bëj një përmbledhje si po zhvillohen tani ngjarjet në arenën ndërkombëtare.

Ju e ndiqni me kujdes shtypin e Partisë dhe jeni në korent si po zhvillohen ngjarjet në botë. Situata aktuale ndërkombëtare është e vështirë, e rëndë, për shkak se imperialistët dhe kryesisht ata amerikanë po kurdisin konflikte dhe kanë qëllime luftënxitëse. Këto situata të acaruar nuk janë të papritura jo vetëm për ne si Plenum, por as për gjithë Partinë dhe popullin tonë, për arsye se Komiteti Qendror i Partisë sonë e ka parashikuar me kohë zhvillimin e tyre, ai nuk shkon kurrë me hamendje, por fenomenet e ndryshme i gjykon dhe i analizon në dritën e shkencës marksiste-leniniste, prandaj koha ka vërtetuar se sa të drejta kanë qenë dhe janë parashikimet e tij. Si rrjedhim, Komiteti ynë Qendror ka ditur të sqarojë e të mobilizojë në rrugë të drejtë gjithë komunistët dhe punonjësit e vendit tonë, duke krijuar situata të tilla të forta që Partia dhe populli të mundin të përballojnë pa lëkundje çdo të papritur.

Çështja se imperializmi e veçanërisht ai amerikan dhe aleatët e tij anglezë, gjermanë e të tjerë janë luftënxitës, për ne as ka qenë dhe as është e re. Gati në çdo mbledhje të Komitetit Qendror kjo çështje është

shtruar drejt e me forcë dhe jo vetëm si është zhvilluar situata, por janë përcaktuar edhe masat që duhej të merrte në çdo moment Partia për të përballuar çdo situatë të krijuar dhe për të demaskuar përpara opinionit shqiptar e botëror rrezikshmërinë e imperializmit amerikan dhe të bashkëpunëtorëve të tij si dhe përgatitjet e tyre për luftë.

Për ne është e qartë se imperializmi amerikan është xhandar ndërkombëtar dhe udhëheqës i botës kapitaliste. Nuk është nevoja të zgjatemi rreth përgatitjeve të mëdha për luftë që bëjnë imperialistët amerikanë me aleatët e tyre. Është fakt se tani janë krijuar prej tyre dy vatra shumë të rrezikshme lufte.

Gjermania e Bonit është fashistizuar, atje mbretëron fashizmi nën maskën e «demokracisë» kristiane. Në Gjermaninë e Bonit janë në fuqi revanshistët, i gjithë llumi i hitlerianëve që i shpëtuan dënimit. Këta revanshistë, të ndihmuar nga imperialistët amerikanë, anglezë dhe francezë, kanë kohë që po organizojnë një forcë të madhe ushtarako-fashiste, për ta përdorur përsëri si forcë sulmi në Evropë kundër vendeve socialiste e për të krijuar unitetin e Gjermanisë në interes të politikës së tyre fashiste. Kjo ka qenë e qartë për të gjitha partitë komuniste dhe punëtoje, veçanërisht për Partinë tonë, e cila e ka demaskuar kurdoherë rrezikun e revanshizmit gjerman. Për ta demaskuar dhe për t'i vënë fre këtij revanshizmi, politika e Partisë sonë ka qenë e palëkundshme dhe në përputhje me interesat e revolucionit, të socializmit dhe të paqes në botë.

Krahas me Republikën Federale Gjermane, fashizmi orvatet të vendoset edhe në vende të tjera perëndi-

more. Kështu për shembull, qysh para Luftës së Dytë Botërore, në Francë, grupet e La Rokut, ato të kryqeve të zjarra të Charl Morasit e të tjerë, u përpoqën të merrnin pushtetin dhe të vendosnin diktaturën e tyre fashiste. Por kjo nuk ishte aq e lehtë, sepse partitë e tjera, që kishin akoma influencë në popull, si partia radikalsocialiste, partia socialiste e të tjera, veçanërisht Partia Komuniste e Francës, e cila ka qenë një nga partitë më të rëndësishme dhe të fuqishme, nuk i lejuan grupimet fashiste në Francë të merrnin pushtetin si në Itali dhe në Gjermani. Megjithëkëtë rruga që ndoqën këto parti në Francë, me përjashtim të Partisë Komuniste, ishte e tillë që hitlerianët e përulanë Francën brenda një kohe fare të shkurtër.

Edhe tani orvatjet për fashistizimin e Francës nuk mungojnë. Kjo duket jo vetëm në luftën që bëjnë elementët fashistë për të ardhur në fuqi, por edhe në faktin se vazhdon lufta në Algjeri e gjetkë. Një gjë e tillë tregon se në Francë ekzistojnë e veprojnë edhe organizata fashiste të ultrave, të fshehta dhe të hapura. Në këtë situatë Partia Komuniste e Francës nuk është më ajo që ka qenë para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, sepse, sikurse dihet, ajo dhe sidomos udhëheqja e saj nuk janë në pozita revolucionare marksiste-leniniste. Në udhëheqjen e tanishme të Partisë Komuniste të Francës duken tendenca të theksuara oportuniste, revizioniste jo vetëm në politikën ndërkombëtare, por ajo mbyll sytë edhe përpara fashizmit që po ngre kokë në Francë.

Në Itali situata për reaksionin e brendshëm, për partitë borgjeze profashiste paraqitet edhe më e favor-

shme, sepse Partia Komuniste e Italisë gjendet në pozita krejtësisht oportuniste revizioniste. Pra fashistizimi në Itali po zhvillohet me hapa të shpejtë.

Në këto situata, forca kryesore goditëse është imperializmi amerikan, i cili vë në lëvizje edhe Gjermaninë fashiste të Bonit, Anglinë etj. Në këto vende ne shikojmë tendenca që rriten e zhvillohen dhe po realizohen qëllimet e imperialistëve dhe të fashistëve. Tregu i Përbashkët dominohet nga Gjermania e Bonit që është bërë një fuqi e madhe politike, ekonomike dhe ushtarake. Ky treg është një pregatitje e terrenit për luftë, që imperialistët amerikanë dhe të tjerët, kur të shpërthejnë luftën, të mos gjenden në ato pozita që u ndodh Hitleri para Luftës së Dytë Botërore, i cili u detyrua të godasë Francën, megjithëse atë e likuidoi shpejt, si dhe më vonë Anglinë, duke i pasur këto vende kundërshtarë në Luftën e Dytë Botërore. Imperialistët përpigën që, kur të futen në luftë kundër vendeve socialiste, në radhët e tyre të ekzistojë një bllok pak a shumë homogjen. Prandaj nga shtetet imperialiste përrëndimore tani po bëhen pregatitje edhe ushtarake, edhe ekonomike që anomalitë që ndodhën në Luftën e Dytë Botërore të mos përsëriten. Anglia, me formimin e Tregut të Përbashkët, tentoi të mos merrte pjesë dhe nuk mori. Por tani ne shohim se Makmilani dhe qeveria angleze kanë thënë se do të marrin pjesë në këtë organizatë, që ka për qëllim të zgjidhë problemet ekonomike në interes të trusteve dhe të monopoleve kapitaliste dhe në luftë kundër vendeve socialiste.

Natyrisht, çështja e Berlinit dhe e Gjermanisë Përrëndimore tani është shumë e mprehtë, që i ka vënë

si kampin socialist, ashtu edhe imperializmin amerikan me gjithë aleatët e tij të Bonit, të Londrës, të Parisit etj., përpara një gjendjeje që duhet kapërcyer me dëmtim. Traktati i paqes me Gjermaninë duhet nënshkruar dhe të likuidohet edhe situata jonormale e Berlinit Perëndimor, i cili është e domosdoshme të kthehet në një qytet të lirë dhe të çmilitarizuar. Sigurisht, zgjidhja e këtij problemi duhet bërë në momente të favorshme për ne, dhe në përgjithësi situata është në favorin tonë në çdo pikëpamje. Ne jemi marksistë, duhet t'i gjujkojmë çështjet objektivisht, situatën ta analizojmë konkretisht duke u nisur nga pozitat e marksizëm-leninizmit.

Rreziku i luftës është shtuar edhe më tepër me propagandën antimarksiste të paqes dhe të çarmatimit të përgjithshëm e të plotë që bëhet si pasojë e politikës oportuniste revizioniste të grupit të N. Hrushovit. Përveç të tjerave, politika e Nikita Hrushovit ka bërë që midis vendeve të kampit socialist të mos ekzistojë unitet, i cili është i domosdoshëm sidomos përpara rrezikut në rritje të imperializmit me atë amerikan në krye. Të gjithë popujt, të gjithë komunistët dhe partitë komuniste e punëtore të vendeve socialiste duhet të jenë të gatshme të derdhin gjakun, që të shpëtojnë popujt, vendet e tyre dhe botën nga rreziku i imperializmit amerikan dhe i aleatëve të tij. Mirëpo shtetet socialiste në vend që të jenë të bashkuara si një trup i vetëm përpara kësaj force barbare, të egër dhe shkatërruese, janë të përcara.

Shkaku i kësaj përcarjeje është politika revizioniste e tradhtarëve të grupit të N. Hrushovit, veprimtaria e të

cilit ka filluar që kur N. Hrushovi dhe pasuesit e tij erdhën në fuqi në Bashkimin Sovjetik. Sa ishte gjallë Stalini në të gjitha partitë komuniste dhe punëtoze zbatohesh një vijë e drejtë marksiste-leniniste dhe midis tyre ekzistonte një miqësi e ngushtë internacionaliste e vërtetë. Rryma oportuniste kanë ekzistuar në këto parti edhe atëherë, por ato ishin të pafuqishme. Fakti është se farën e grindjes dhe të përçarjes në kampin socialist dhe në lëvizjen komuniste ndërkombëtare e solli ky grup me N. Hrushovin në krye, me politikën e tij revizioniste dhe likuidatore të marksizëm-leninizmit. Si rrjedhim, situata sot është në dëm të prestigjit, të autoritetit dhe të dashurisë së madhe që kanë pasur dhe kanë popujt për Bashkimin Sovjetik, shtetin e parë të proletariatit në botë. Grupi i N. Hrushovit në fakt po i likuidon këto merita të Bashkimit Sovjetik.

Politika e N. Hrushovit dhe e grupit të tij është një politikë e zbutjes dhe e nënvleftësimit të rrezikut imperialist, është një politikë «bombastike», sipas së cilës «në çdo moment jemi të gatshëm dhe aq të fuqishëm sa brenda ditës mund t'i zhdukim të gjitha forcat e imperializmit». Kjo është një propagandë e nënvleftësimit të forcës së kundërshtarëve tanë. Të gjitha pikat kyçe të politikës së N. Hrushovit vërtetojnë një vijë të tillë revizioniste.

Nën maskën e bashkekzistencës paqësore dhe të mbrojtjes së paqes, në masat e gjera të popullit Hrushovi ka krijuar një iluzion të dënueshëm, kriminal dhe nga ana tjetër i ka dhënë kohë të vlefshme imperializmit për t'u armatosur dhe për të kërcënuar vendet socialiste dhe popujt të vendeve të tjera.

Le të marrim çështjen e vendeve të shtypura koloniale e gjysmëkoloniale, ku ziente, zien dhe do të ziejë revolucioni. N. Hrushovi me politikën e tij revizioniste e ka tradhtuar lëvizjen nacionalçlirimtare në këto vende. Në shtyp e në radio shkruhet dhe flitet për to, por kjo është vetëm një re tymi, sepse, po të mos shkruhej e flitej, do të ishte demaskim i plotë për të.

Hrushovi dhe ata që e pasojnë nganjëherë janë të detyruar të thonë ndonjë fjalë kundër imperializmit dhe kolonializmit, por le t'i hyjmë më në detaje kësaj çështjeje. Vendet që janë akoma nën sundimin kolonial dhe ato që porsa janë çliruar nga zgjedha e huaj duhen ndihmuar në luftën e tyre kundër imperializmit dhe reaksionit. Popujt e këtyre vendeve duhen mbështetur medoemos politikisht, ekonomikisht dhe, kur kërkojnë ndihmë, u duhen dhënë edhe armë për t'u çliruar nga kolonizatorët ose për t'u mbrojtur prej tyre. Kush mendon ndryshe nuk është në rrugën marksiste-leniniste. Çështja e përkrahjes internacionaliste të popujve është një detyrë e madhe e të gjitha partive komuniste dhe punëtore të vendeve socialiste. Mirëpo sot, Bashkimi Sovjetik, që ka një peshë të madhe politike, ekonomike dhe ushtarake nuk po e ndihmon lëvizjen nacionalçlirimtare të asnjë vendi dhe kjo fshihet nën maskën e bashkekzistencës paqësore me fuqitë që vazhdojnë politikën e shtypjes e të shfrytëzimit kolonial.

Çlirimi i shumë popujve të Azisë dhe të Afrikës nga zgjedha e imperializmit amerikan ose më direkt nga imperializmi anglez dhe francez është një çështje me rëndësi të madhe dhe pozitive që ndihmon në ecjen përpara të revolucionit me etapa.

Komiteti Qendror i Partisë sonë në shumë dokumente e ka theksuar se ne nuk jemi kundër ndihmës që u duhet dhënë vendeve të porsaçliruara, por t'u japësh kredi atyre që bëjnë një politikë antipopullore, atyre që vrasin e burgosin komunistët, që shpallin botërisht programin e tyre antikomunist dhe që janë të lidhur me një mijë e një fije me imperializmin, këtë ne e quajmë t'u krchësh bishtin këtyre klikave reaksionare të imperializmit.

Politika reaksionare që ndjekin qeveritë e disa vendeve të Azisë e të Afrikës i ka detyruar partitë komuniste që të hidhen në ilegalitet. Megjithëkëtë, Hrushovi vazhdon të tregohet bujar dhe zemërgjerë ndaj qeverive të këtyre vendeve. Kjo ka një qëllim. Hrushovi dhe grupi i tij mendojnë se me politikën që ndjekin do të kenë rreth Bashkimit Sovjetik një numër gjithnjë e më të madh simpatizantësh. Por kjo vijë që zbatohet nga Hrushovi dhe pasuesit e tij nuk e forcon influencën e Bashkimit Sovjetik në këto vende, përkundrazi politika që ndjek Hrushovi u jep mundësi klikave borgjeze reaksionare në disa vende të Azisë e të Afrikës t'i forcojnë më shumë pozitat e tyre në kurriz të popujve, të partive komuniste e punëtoresh e të lëvizjeve revolucionare.

Ka shumë vende në Afrikë e në Azi që kanë fituar një farë pavarësie. Në përgjithësi, udhëheqjet e këtyre vendeve tregojnë një farë urrejtje kundër imperializmit dhe kolonializmit, veçanërisht kundër imperializmit anglez, francez dhe amerikan. Por ata janë udhëheqës të borgjezisë së vendit të tyre, që është në atë nivel force dhe organizimi siç ka qenë para çlirimit borgjezia



në vendin tonë. Megjithatë kjo borgjezi duhet ndihmuar, sepse në situatën e tanishme partitë komuniste në këto vende s'kanë kushte të vijnë në fuqi, dhe në disa prej tyre nuk ka fare parti komuniste, bile nuk ka as krah përparimtar të borgjezisë, sepse ato lirinë e kanë marrë nga imperialistët kolonizatorë, të cilët, në situata të caktuara, kanë qenë të detyruar, nga presioni i kampit socialist dhe i lëvizjeve nacionalçlirimtare të popujve të shtypur, t'ua jepnin këtë farë pavarësie këtyre popujve.

Ja, çfarë ndihme iu dha Kongos? Shumë zhurmë u bë rreth ngjarjeve në këtë vend, por atje vepron dora e imperializmit amerikan dhe e agjentëve të tij. U mbrojt nga ana jonë Patris Lumumba, po atë e vranë e pas tij u vu Gizenga, i cili u bashkua me Kasavubunë e të tjerë. Këta u bashkuan se të tillë janë, ne nuk kemi pasur asnjë iluzion për ta, por duhet vënë në dukje se ndihma, në radhë të parë e Bashkimit Sovjetik për Kongon nuk ka qenë një ndihmë revolucionare, por oportuniste e revizioniste për të fituar tregje, për të shtrirë zonat e influencës të një fuqie të madhe. Qëndrimet sovjetike në këtë çështje synonin për të mos prishur politikën që kishte vendosur Hrushovi me imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, pra politika e Hrushovit është paqe për hir të paqes.

Po me Indinë? Nehru i është një përfaqësues i borgjezisë së madhe reaksionare. Në formë ai tregohet pacifist dhe mik i N. Hrushovit dhe në fakt kështu është, mik i ngushtë i tij. Po ne e dimë kush është Nehru. Ai lufton e përçan Partinë Komuniste të Indisë. Ligjërisht kjo parti nuk është e ndarë, por në fakt

ndodh e kundërta, nga një anë janë elementët e shëndoshë marksistë dhe nga ana tjetër qëndrojnë revizionistët që përkrahen nga N. Hrushovi. Nehru i shfarosi komunistët në Kerala, ai po i arreston dhe po i vret ata. Megjithëkëtë borgjezia indianë merr ndihma të mëdha nga Bashkimi Sovjetik, dhe përpara popullit të vet e komunistëve indianë ajo del me parullën e miqësisë me Bashkimin Sovjetik. Ajo mburr N. Hrushovin duke e quajtur «politikan të madh të botës komuniste» etj.

Shikoni, shokë, ç'politikë djallëzore po bëhet në kurriz të komunizmit ndërkombëtar, shikoni si po shtrembërohen mësimet e Leninit për t'u dhënë ndihmë popujve të porsaçliruar, sidomos atëherë kur Bashkimi Sovjetik t'i ketë forcuar pozitat e tij ekonomike. Kjo është e domosdoshme të bëhet, por ka ndihmë e ndihmë dhe duhet të shikohet qëllimi i kësaj ndihme. India po e përdor ndihmën për qëllime të këqija dhe këtë e thonë vetë imperialistët, të cilët nuk janë budallenj. Ata thonë se N. Hrushovi po krijon një «kordon sanitar» rreth Kinës dhe në fakt ai po e bën këtë. Nehru është një antikinez i tërbuar dhe në këtë rrugë ai po ndihmohet nga grupi revizionist i Hrushovit jo vetëm fshehtazi, po edhe haptazi, politikisht, ekonomikisht dhe ushtarakisht.

Kjo po ndodh edhe në Laos. Ndërhyrjet e Hrushovit në këtë vend rënduan gjendjen e nuk u ndreq asgjë, atje nuk ka paqe, po luftë dhe bëhen muhabetë për të fituar kohë imperializmi, i cili e shfrytëzon këtë situatë për t'u armatosur dhe për të forcuar pozitat e tij në Laos.

Nga ana tjetër, Hrushovi popullarizon planin e

SENTO-s si një fitore të madhe të kampit socialist që demaskoka imperializmin. Në të vërtetë ky plan është një zbulim dhe vërtetim i padiskutueshëm i rrezikshmërisë së imperializmit, me të cilin Hrushovi është përpjekur dhe përpiqet të krijojë një «modus vivendi» dhe të vërë kështu botën në gjumë.

Në Iran, në Pakistan e në Afganistan, politika e Hrushovit krijon dhe ushqen në fakt pikëpamje të rrezikshme në vend që socializmi të ketë një influencë me të vërtetë të shëndoshë. Nga ana tjetër, imperializmi lufton me armë të kundërta nga tonat. Ai po bën ndryshime përsa i përket dhënies së ndihmave për vendet e porsaçliruara. Tani ai nuk u jep atyre vetëm ndihmë në armatime, por u jep edhe ndihma ekonomike. Përveç kësaj, imperializmi amerikan ka si aleat në këto vende borgjezinë reaksionare kombëtare, bashkë me dollarin dhe mjetet e propagandës së vet, me të cilat i kundërvihet influencës së vendeve socialiste dhe ideologjisë së marksizëm-leninizmit. Në këtë drejtim vepronë me djallëzi edhe revizionistët jugosllavë, të cilët organizuan konferencën e Beogradit.

Kjo konferencë kishte për qëllim krijimin e të ashtuquajturës forcë e të paangazhuarve. Po si duhet kuptuar e ashtuquajtura forcë e të paangazhuarve? Mundet që kjo të jetë një forcë monolite? Kjo është e pamundur, për shkak se disa nga këto vende kanë kontradikta të mëdha me njëra-tjetrën, disa kanë kontradikta me vende socialiste, disa i kanë këto kontradikta me imperialistët. U fol shumë në këtë konferencë për paqen, por në fakt mjaft nga pjesëmarrësit nuk thanë asnjë fjalë kundër imperializmit amerikan dhe bllokut

të NATO-s që kërcënojnë botën me luftë. Disa nga pjesëmarrësit e Konferencës së Beogradit nuk folën hapur kundër imperializmit luftënxitës, jo se janë «neutralë», po e kanë hallin te kreditë. Ata duan të marrin kredi edhe andej edhe këtej dhe kështu të quhen «të paangazhuar». Kjo është një taktikë e vjetër e revizionistëve të Beogradit që ua kanë mësuar shumë bukur edhe të tjerëve se kështu duhet të ecin dhe në këtë mënyrë po ecin.

Të jesh me të vërtetë «i paangazhuar» nuk mjafton të mos bësh pjesë në një nga blloqet ushtarake, të NATO-s ose të Traktatit të Varshavës, por të jesh i pavarur politikisht dhe të mos lejosh që ndihmat ekonomike të bëhen shkas për presione e shantazhe që shpien në humbjen e sovranitetit shtetëror dhe të lirisë së popullit tënd.

Kjo situatë, shokë, nuk është shkaktuar vetëm nga politika e forcës dhe e dollarit, që ndjekin imperialistët e sidomos ata amerikanë, po edhe nga politika revizioniste e N. Hrushovit. Revizionizmi ka për qëllim të minojë unitetin e kampit socialist, ta dobësojë atë dhe lëvizjen komuniste ndërkombëtare, të forcojë imperializmin.

Imperializmi amerikan do të përpiqet të izolojë nga vendet socialiste popujt e ish-vendeve koloniale, gjysmëkoloniale dhe të porsaçliruara, kurse detyra jonë, e vendeve socialiste, është t'i mbështetim këta popuj në aspiratat e tyre të drejta, për liri, pavarësi, për një jetë më të mirë, duke hedhur njëkohësisht dritë në kurthet që u ngrenë imperialistët e revizionistët modernë, në radhë të parë revizionistët titistë.

Në Amerikën e Jugut shohim një situatë të ndryshme nga ajo e vendeve të Afrikës dhe të Azisë. Në Kubë revolucionit u krye dhe mbahet qëndrim revolucionar përballë Imperializmit amerikan. Partitë marksiste në Amerikën Latine janë gati në ilegalitet dhe në pozita të mira revolucionare. Me sa dimë ne hidhen edhe në aksione kundër borgjezisë në fuqi, bëjnë greva e demonstrata, përleshjen dhe gjakosen me armiq të klasës.

Shokë, gjendja aktuale ndërkombëtare është e acruar. Kujtoni momentet e rënda të kohës së fashizmit, mbledhjen e KomInternit, fjalët e Stalinit dhe të Dimitrovit. Hrushovi vetëm me fjalë thotë se re të zeza të luftës po i turren Bashkimit Sovjetik, po pikërisht në këto momente të rrezikshme ai bërtet për paqen, bashkekzistencën paqësore, miqësinë dhe nuk flet se nga vijnë këto re të zeza e kush i shkakton ato. Ai nuk flet me emra konkretisht, sepse janë ata të cilëve u ka fërkuar krahët vite me radhë, ndërsa ne, që tregojmë qartë se nga vjen rreziku, vazhdon të na luftojë.

Situata e sotme e shtyu N. Hrushovin që të detyrohet të bëjë deklaratën e fundit mbi rifillimin e provave të armëve atomike. Ky qëndrim i Hrushovit është jashtë bindjeve të tij revizioniste trockiste, në kundërshtim me gjithë politikën që ai ka ndjekur deri tani. Ai u detyrua të vinte në këtë vijë, por ne dimë se Hrushovi dhe grupi i tij nuk janë konsekuentë. Ai është i detyruar të bëjë ndonjë ndryshim në politikën e tij sa herë sheh që dështon në këtë ose atë drejtim. Hrushovi nuk ka turp të bëjë deklaratatë të bujshme, pa çka se këto janë në kundërshtim me ç'ka thënë më parë. Është tjetër çështje se të gjithë revizionistët si

Zhivkovi, Novotni e të tjerë, e duartrokasit Hrushovin në çdo hap të tij. Këtë taktikë ai e ndjek. sa të kapërcejë edhe Kongresin XXII, pas të cilit me siguri do të merren masa për spastrimin e partisë nga njerëzit e shëndoshë dhe do të sillen në udhëheqje të saj njerëzit e tij. Pastaj të demaskojë edhe Partinë e Punës të Shqipërisë dhe direkt ose indirekt t'i japë një grusht edhe Partisë Komuniste të Kinës si dhe të rregullojë përsëri çështjen e bisedimeve me Kenedin.

Manovrat që kërkon të bëjë Hrushovi janë minuse për të. Natyrisht ato janë një dëm edhe për rrugën tonë, por e drejta është me ne, pra edhe fitorja është jona. Situata që kalojmë është e vështirë për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare; sigurisht edhe për vendin tonë, po ne do ta përballojmë se jemi të fortë, jemi në të drejtën tonë dhe nuk ndodhemi vetëm, me ne është Partia Komuniste e Kinës dhe miliona komunistë në të gjithë botën që nuk janë dakord me vijën revizioniste të Hrushovit.

Tani të vijmë konkretisht në marrëdhëniet me ne. N. Hrushovi dhe grupi i tij vazhdojnë punën armiqësore ndaj vendit tonë. Qëndrimi i tyre jo vetëm nuk ka ndryshim, po përkundrazi ata nuk lënë rast pa na sulmuar, sa mbaron një letër me sulme, vjen tjetra. Ne mendojmë se mbledhja e fundit e 3 gushtit në Moskë nuk kishte për qëllim shqyrtimin e problemit gjerman dhe të Berlinit. Qëllimi i saj kryesor ishte për të na sulmuar ne dhe për të na nxjerrë nga Traktati i Varshavës, sepse çështja gjermane është biseduar kushedi sa herë midis tyre dhe për këtë vendiml është marrë

pa ne. Një gjë të tillë e vërteton fakti që edhe pasi nuk u lejua delegacioni ynë të merrte pjesë në këtë mbledhje, nuk u muar ndonjë vendim.

Ju e kuptoni përse nuk shkuam unë e Mehmeti në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Komiteti Qendror i Partisë sonë dërgoi atje një delegacion me atë udhëheqje që ai e gjeti të arsyeshme. Po të kisha shkuar unë atje do të bëhej luftë diskutimesh dhe pastaj do të merrnin vendim që të na përjashtonin nga Traktati i Varshavës. Mund të themi se kjo u evitua hëpërhë, por ata janë njerëz të tillë që shkelin jo vetëm parimet, por edhe format. Pra, duke parë se në mbledhje shkoi shoku Ramiz [Alia] revizionistët vendosën që delegacionit tonë t'i mohojë drejta për të diskutuar e për të marrë pjesë në këtë mbledhje dhe një vendim i tillë ishte një gabim i madh parimor e politik jo vetëm nga përmbajtja, por edhe nga forma.

Partia Komuniste e Kinës na mbrojti në këtë mbledhje. Ambasadori kinez atje ka shfaqur pikëpamjen e Komitetit Qendror të Partisë së tij duke e cilësuar vendimin që u muar kundër nesh si shkelje të së drejtës të një partie, si shkelje të parimit të barazisë dhe të internacionalizmit dhe propozoi që delegacioni ynë të kthehej dhe të merrte pjesë në mbledhje nga e cila të dilte një vendim i përbashkët. Po ata e kishin marrë vendimin ndaj nesh e nuk mund të ktheheshin se në këtë rrugë ishin të vendosur deri në fund.

Nga kjo lindi çështja e qëndrimit tonë që kenë parë në gazetë ku u botua deklarata e Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe jo komunikata e mbledhjes, e cila nuk

përfaqësonte realitetin. Në komunikatë ata e paraqitën çështjen sikur në mbledhje kishin shkuar gjithë sekretarët e parë. Dhe ne që të mos kuptohej se kush nuk ishte në këtë mbledhje botuam deklaratën tonë dhe theksuam se ajo lu dërgua të gjitha delegacioneve. Qëndrimi ynë ishte i drejtë. Edhe pikëpamja e Partisë sonë për çështjen gjermane dhe të Berlinit ishte e qartë, parimore dhe e vendosur.

Në këtë mbledhje u muar edhe vendimi për t'i dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë një letër të poshtër me anën e së cilës ngarkohen me përgjegjësi Partia jonë dhe udhëheqja e saj për mosvajtjen e Sekretarit të Parë të PPSH. Tani ne po përgatitim përgjigjen, të cilën do ta lexojmë këtu, ta diskutojmë dhe pasi ta aprovojmë, ta dërgojmë.

Pas mbledhjes që u bë në Moskë për problemin gjerman dhe të Berlinit, na kanë njoftuar se nuk do të na pranojnë as studentët me bursë. Prandaj duke marrë parasysh situatën e krijuar, ne bëmë një shkurtim të numrit të studentëve që dërgohen në BS dhe në vendet e demokracisë popullore. Kurse ata kanë hapur fjalë se shqiptarët i tërhoqën studentët dhe nuk i dërgojnë më, sepse nuk duan eksperiencën sovjetike. Mirëpo në prag të shtatorit studentët tanë filluan të shkojnë, atëherë polakët të parët na njoftuan se nuk na i pranojnë, duke shkelur kështu marrëveshjen. Sovjetikët na kanë bërë 2-3 nota për këtë çështje me të cilat njoftojnë se qeveria sovjetike nuk jep më bursa, prandaj po të duam t'i dërgojmë me shpenzimet tona.

Ka ardhur edhe një letër e Ministrisë së Jashtme të BS, gjoja konfidenciale, në të cilën thuhet se stu-



dentët shqiptarë në BS kanë mbajtur gjoja qëndrime antisovjetike, kanë sulmuar BS dhe PK të Bashkimit Sovjetik dhe na paralajmërojnë që në rast se ndonjëri prej tyre nuk zbaton ligjet sovjetike, nuk u përgjigjet mësimëve e rregullave të shkollës, sulmon BS etj., ai do të nxirret menjëherë jashtë BS. Për fjalën më të vogël që mund të thotë një student shqiptar dhe që do ta provokojnë ata, menjëherë do të merret masë. Shumë nga studentët tanë nuk pranuan të mbrojnë diplomën mbi tezat që u thoshin ata. Kështu jeta e studentëve tanë tani në BS është bërë e pamundur. Por ne i kemi këshilluar studentët që të qëndrojnë korrektë dhe në rast se dëgjojnë të flitet një fjalë e keqe kundër Partisë sonë, ose një pikëpamje në kundërshtim me marksizëm-leninizmin, ata duhet të flasin dhe për këtë le t'i ndjekin, ata duhet të mbrojnë marksizëm-leninizmin dhe Partinë nga kushdo qoftë. Kështu janë porositur edhe ata që u dërguan në Bullgari, në Çekosllovakia etj.

Përsa u përket çështjeve politike dhe ekonomike nga BS na është bërë bllokadë e plotë. Asnjë fjalë nuk flitet për Shqipërinë në shtypin sovjetik, kurse nuk lënë pa shkruar edhe për gjënë më të vogël të një farë fermeri amerikan. Kuptohet, ata e bëjnë këtë se po të shkruajnë për vendin tonë, opinioni sovjetik do ta kuptojë si qëndron e vërteta. Kjo tregon sa shumë frikë kanë ata nga e vërteta marksiste-leniniste. Do të vijë koha dhe të gjitha këto do të dalin në shesh e do të sqarohen. Ne kemi shumë fakte që flasin për qëndrimet tona të drejta, që sqarojnë popujt e Bashkimit Sovjetik dhe opinionin ndërkombëtar.

Hrushovi dhe grupi i tij shkojnë edhe më tutje.

Ata nuk duan të bëjnë me ne tregti me klering që zhvillojnë edhe me vendet kapitaliste. Tregtinë po e dobësojnë dhe po e ngadalësojnë me qëllim që ne të mos e realizojmë planin e vitit 1961. Bile na kanë dërguar edhe një letër ku na kërkohet të paguajmë ratat e kredive që na kanë dhënë, për të cilat në një letër të dërguar para një viti nga Hrushovi njoftoheshim se na i shtynë për 10-15 vjet. Përsa i përket eksportit tonë, ai nuk është realizuar asnjëherë si këtë vit. Në këtë anë ata nuk kanë ku të na kapin, bile jemi më mirë nga ata, po eksportet tona na i pengojnë duke i justifikuar me shlyerjen e ratave. Këtë çështje na e nxorën tani në mes të vitit, me qëllim që të mos na vijnë makineritë dhe mallrat që na nevojiten për të realizuar planin. Pra edhe me kleringun kërkojnë të na sabotojnë, por nuk do të arrijnë gjë.

Me shtetet e tjera socialiste të Evropës tregtia jonë mund të themi ecën normalisht. U japim, na japin. Kreditë edhe ata deri tani na i kanë pezulluar. Disa vende nuk na kanë njoftuar akoma, po ka mundësi të mos na i japin. Në mbledhjen e ardhshme Byroja Politike do të studjojë masat për rregullimin e planit 1962-1965, të fiksohen definitivisht cilat objekte do të bëhen me kredi nga RP e Kinës, cilat me kleringun tonë dhe cilat nuk do të bëhen fare, po shumica e veprave të planit të pesëvjeçarit të tretë do të ngrihen. Sidoqoftë plani ynë si prodhim nuk do të ulet, atë ne do ta plotësojmë patjetër.

Në mes të gjitha këtyre gjërave pati edhe ndonjë udhëheqës partie, që u përpoq të na pajtojë me revizionistët sovjetikë, për të cilin ju jeni në dijeni...

Midis udhëheqjeve të vendeve socialiste të Evropës dhe të Bashkimit Sovjetik duket sikur ka unitet, por nuk është kështu. Ata kanë mosmarrëveshje. Kështu, për shembull, pas deklaratës së qeverisë sovjetike lidhur me provat e armëve bërthamore, Polonia, Rumania dhe Hungaria nuk kanë bërë deklaratë zyrtare për ta mbështetur këtë masë. Në shtyp ata kanë mbajtur qëndrime dhe kanë folur për këtë çështje po deklarata nuk kanë bërë. Ne besojmë se shkaqet që këto tri vende nuk kanë bërë deklarata në favor të vendimit të qeverisë sovjetike duhen kërkuar në gjendjen e brendshme dhe të jashtme. Gomulka, për shembull, po bën përgatitje për të marrë kredi nga SHBA-ja, përveç atyre që ka marrë gjer tani. Po ka edhe kontradikta të tjera. Gjermania Lindore tani është në situatë të vështirë dhe duhet të ndihmohet. Hrushovi me shokë në mbledhjen e Moskës të 3 gushtit kanë marrë vendim ta ndihmojnë ekonomikisht RD Gjermane. Mirëpo marrim vesh se udhëheqësit polakë nuk kanë njoftuar fare Komitetin Qendror të tyre për sa u vendos në mbledhjen e 3 gushtit për Gjermaninë dhe Gomulka me shokë në këtë situatë kanë shkuar shëtitje në Venecia të Italisë. Polakët as politikisht nuk po e mbrojnë RD Gjermane, pa lëre ekonomikisht.

Ka edhe parti e udhëheqës të tyre që janë dakord me qëndrimet tona dhe nuk aprovojnë veprimet e N. Hrushovit, por tremben të flasin, prandaj s'bëjnë gëk...

Tani Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik ndodhet përpara Kongresit XXII të saj. Është përgatitur dhe është shpallur projektprogrami i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik. Nga studimi i parë që i kemi

bërë, del se ky projektprogram karakterizohet nga pikëpamje të theksuara revizioniste në shumë çështje të rëndësishme. Këto pikëpamje revizioniste janë mbuluar me fraza e parime të njohura marksiste-leniniste. Byroja Politike mendon të mos i bëhet asnjë popullarizim këtij dokumenti. Kur projekti të bëhet program, pasi të aprovohet nga kongresi, atëherë Byroja Politike mendon të mbahet dhe qëndrim nga ne, sepse tjetër është projekti dhe tjetër është kur ai bëhet program. Qëndrim do të mbajmë sidomos për çështjet politike, ideologjike dhe organizative, natyrisht pasi t'i studjojmë si duhet këto dhe pasi të marrim edhe aprovimin e Komitetit Qendror, sepse ato janë çështje të një rëndësie shumë të madhe, sidomos në këtë situatë kaq të vështirë që është krijuar jo vetëm për Partinë tonë, por për gjithë lëvizjen komuniste ndërkombëtare.

Kurse të gjithë ata që ndjekin vijën e grupit të Hrushovit kanë ngritur bajrakun e revizionizmit. Ka prej tyre që po shkruajnë artikuj duke bërë vlerësime pozitive të projektprogramit, por duhet thënë se nuk ka artikuj bazë dhe seriozë nga pikëpamja teorike e politike mbi këtë dokument. Ai që tregohet më i zellshëm «për të kurdisur akrepet», sipas orës së N. Hrushovit, është Zhivkovi, i cili tani po kurdis dhe artikuj, duke i bërë jehonë projektprogramit revizionist sovjetik.

Të shohim nëse do të guxojnë të na sulmojnë revizionistët sovjetikë në Kongresin XXII të tyre, do t'i hapin këto çështje apo do të qëndrojnë të maskuar. Sidoqoftë kohë kemi dhe këtu jemi. Pastaj Hrushovi, siç e ka zakon, do të organizojë edhe ndonjë mbledhje

me përfaqësuesit e partive që do të shkojnë në Kongresin XXII dhe me siguri do të mbajë ndonjë fjalim, ku të kërkojë, direkt ose indirekt, aprovimin e gjithë punës së kongresit. Edhe për këtë do të shohim dhe do të dëgjojmë. Sido që të zhvillohen ngjarjet ne jemi dhe do të jemi gati për të mbrojtur interesat e larta të Partisë sonë dhe marksizëm-leninizmin.

Kjo është situata. Përpara kësaj gjendjeje aktuale ndërkombëtare, si dhe qëndrimeve armiqësore ndaj nesh të revizionistëve sovjetikë dhe të vendeve socialiste të Evropës, ne duhet të jemi në këmbë, asgjë të mos na gjejë në befasi. Armiku do të punojë kundër Partisë sonë, prandaj të jemi vigjilentë dhe të përgatitur. Ta ruajmë Partinë nga armiku, i cili përpiqet të depërtojë në radhët e saj. Të jemi vigjilentë kundrejt parullave të Imperialistëve dhe të trockistëve, të cilët përdorin për qëllimet e tyre njerëzit që kanë gabuar, ose ata që punojnë të fusin spica në Parti. Kini parasysh se lufta kundër revizionizmit do të ashpërsohet.

Përsa i përket çështjes së mbrojtjes së atdheut, këtë duhet ta konsiderojmë si një detyrë të dorës së parë dhe urgjente. Mbrojtja e atdheut nga e gjithë Partia dhe populli lyp një vigjilencë të lartë, për të përballuar rreziqet që kërcënojnë socializmin dhe veçanërisht vendin tonë nga ana e imperializmit amerikan. Prandaj Partia ta ketë parasysh vazhdimisht që jo vetëm vigjilencia në ushtri, në organet e Sigurimit të Shtetit dhe të kufirit të jetë në nivel të lartë, por duhet të jetë e plotë edhe gatishmëria e popullit. Për mbrojtjen e atdheut duhet të mendojmë e të veprojmë të gjithë.

Ju e dini se ne nga ana ekonomike kemi vështirësi.

Në këto situata të vështira sigurimi i rezervave ka rëndësi të madhe. Po edhe rezervat duhet të dish t'i administrosh, sepse mund të kesh shumë e të mos dish t'i shfrytëzosh e mund të kesh edhe pak dhe t'i ekonomizosh mirë. Prandaj të bëjmë kujdes që rezervat t'i administrojmë mirë dhe të mos krijohet panik në popull. Populli ynë nuk është i tillë që kapet nga paniku. Përkundrazi është një popull heroik, trim dhe sado fjalë të mëdha të themi nuk i vlerësojmë dot cilësitë e tij të larta, gatishmërinë dhe lidhjet e tij të ngushta me Partinë. Duke e mbajtur popullin në dijeni të ngjarjeve që po zhvillohen, do të rritim te ai vigjilencën dhe gatishmërinë. Por rëndësi kanë edhe problemet ekonomike, sidomos tani, që përveç rrethimit titist, grek dhe italian na janë shtuar edhe vende të tjera, të cilat na kanë krijuar vështirësi të reja. Pezullimi i kredive dhe i marrëveshjeve nga vendet socialiste të Evropës na vë para një detyre të madhe, të bëjmë ekonomizime. Shokët e Partisë dhe të pushtetit në rreth duhet të bëjnë shumë kujdes në lidhje me kursimet, sidomos për bukën. Buka të ekonomizohet sa të jetë e mundur më shumë.

Puna e bërë nga organizatat e Partisë dhe nga organet e pushtetit në sektorin e bujqësisë këtë vit ka qenë mjaft e mirë. Ky do të ishte një vit bujqësor shumë i mbarë po të mos na kishte dëmtuar thatësira. Megjithatë, në krahasim me vitin e kaluar, bujqësia këtë vit është shumë më mirë. Populli është furnizuar në rregull e me çmime më të ulëta nga viti i kaluar dhe ka vënë ushqime rezerva për dimër. Një punë e mirë për dimër po bëhet dhe nga ndërmarrjet e përpunimit të frutave e

të zarzavateve. Për dimër kemi edhe rezerva të mira gjalpi, mishi etj. Rezervat janë në sasi më të kënaqshme nga viti i kaluar. Tani jemi përpara fushatës së ullinjve, të cilët paraqiten të mbarë. T'u bëhen shërbimet e duhura dhe kur të piqen, të mblidhen edhe kokrrat e fundit. Ullinjtë të grumbullohen, të përpunohen e të konservohen mirë, sepse popullit duhet t'i plotësojmë kërkesat për yndyrna.

Objektet kryesore të eksportit tonë janë mineralet. Prandaj ju shokë drejtues të ndërmarrjeve minerare dhe të gjeologjisë, që nga ministri e gjer në bazë t'u vini rëndësinë më të madhe realizimit të planit të prodhimit të mineraleve dhe zhdukjes së firove. Në mbledhjen e ardhshme të Byrosë Politike do të kemi një raport mbi gjendjen dhe perspektivat e mineraleve. Sukseset tona në këtë sektor janë të mëdha, por kemi pasur edhe humbje në minierat, duke mos treguar interes dhe kujdes për shfrytëzimin racional të tyre. Këto kanë një vlerë të madhe, prandaj duhet luftuar për të mos humbur as thërrimet e mineralit.

Të luftojmë gjithashtu për shtimin e duhanit, që zë një vend të rëndësishëm në eksportin tonë. Këtë vit ne patëm fatkeqësi në duhan, sidomos në Shkodër, për shkak të sëmundjes që ra, por në ato fusha që nuk u dëmtuan duhet që duhani të vilet gjer në gjethen e fundit dhe të manipulohet sa më mirë, gjë që do të ngrejë kualitetin dhe do të zëvendësojmë deri diku prodhimin e humbur.

Prandaj t'i vihemi me të gjitha forcat realizimit të planit, në industri, në bujqësi dhe në të gjithë sektorët e tjerë. Kudo të punojmë sa të jetë e mundur për të

evituar firof dhe dëmtimet, qofshin ato në korrje, në grumbullim, në mbledhjen e pambukut, në transportimin e mineraleve etj. Çështja nuk është vetëm që të realizojmë planet në përgjithësi, por në të gjithë zërat dhe llojet e në çdo sektor, sepse në shumë ndërmarrje kemi mjaft boshllëqe dhe humbje, kundër të cilave duhet të bëjmë kujdes të madh.

Në bazë të orientimit që dha Kongresi IV i Partisë kemi menduar edhe për një ulje të re çmimesh, gjë që konsiderohet një ulje mjaft e ndjeshme. Kjo ulje bëhet sidomos për mallrat industriale, po çështja do të shihet edhe për disa mallra ushqimore. Ulja e re e çmimeve do të jetë jo vetëm një zbatim i vendimeve të Kongresit IV të Partisë, por edhe një grusht politik kundër atyre që donin të na mbysin me anën e bllokadës ekonomike dhe për t'u thënë atyre realisht që ne po ecim përpara, po zbatojmë në rregull edhe planin e furnizimit të popullit, bile ulim edhe çmimet dhe po ndërtojmë me sukses objektet e parashikuara në planin pesëvjeçar. Ulja e çmimeve do të jetë njëkohësisht edhe një ndihmë ekonomike për masat tona punonjëse.

Të luftojmë, shokë, për ruajtjen e unitetit të Partisë, si dhe të unitetit të saj me popullin, të punojmë për të sqaruar edhe popullin, që të jetë i qartë për situatën e të ketë besim në forcat tona, të socializmit dhe të komunizmit, kundër Imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve modernë.

Të lidhemi sa më ngushtë me popullin, karakteristike kjo aq e shëndoshë e Partisë sonë që nuk ka forcë ta prishë. Kjo nuk do të thotë se nuk ka njerëz të pakënaqur që përpiqen të krijojnë mjegull në masat.



Njerëzit tanë kudo që punojnë, në fabrika e uzina, në kooperativa bujqësore e shkolla, nëpër dyqane, në çerdhe, në kopshte etj., zbatojnë si duhet politikën e drejtë të Partisë, se ndryshe po të mos vendosin kudo drejtësinë, po të mos i vënë veshin zërit të masës e po të mos luftojnë për të likuiduar hatëret etj. te njerëzit mund të lindin pakënaqësi. Gjëra të tilla ka, po ato nuk përbëjnë një sëmundje të madhe që vë në rrezik unitetin e Partisë me popullin. Megjithatë këto janë çështje që duhet të na preokupojnë. Prandaj duhet bërë shumë kujdes që populli të jetë sa më i lidhur me Partinë, në mënyrë që ai t'i zbatojë si duhet në jetë direktivat e Partisë për mbrojtjen e lirisë dhe të pavarësisë së atdheut, për realizimin e planeve tona ekonomike. Të kemi parasysh që në situatat e sotme këto janë detyrat tona kryesore dhe do të vijë koha që edhe partitë e tjera do të gjejnë se ne kemi të drejtë. Koha dhe marksizëm-leninizmi na japin neve të drejtë.

Mbi të gjitha këto çështje le të diskutojnë shokët. Tani propozoj të lexohet projektlettra që kemi menduar t'u drejtohet komiteteve qendrore të partive komuniste e punëtorë të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës në përgjigje të letrës së tyre të aprovuar në mbledhjen e Moskës, më 3 gusht të këtij viti, dhe t'ju vëmë në dijeni edhe për përmbajtjen e letrës së Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bullgarisë, përgjigjen e së cilës nuk e kemi hartuar akoma. Në rast se Komiteti Qendror jep aprovimin, ne atyre do t'u përgjigjemi më vonë. Ne do t'u përgjigjemi udhëheqësve bullgarë kur të marrim tekstin e plotë zyrtar, vetëm them se nuk ka letër më të poshtër, letër të tipit fashist. Unë

jam i bindur se kjo letër është përpiluar nga Zhivkovi dhe grupi i tij, se nuk mund të jetë në këtë rrugë i gjithë Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bullgarisë, prandaj besoj se këto gjëra bëhen pa dijeninë e Komitetit Qendror. Sigurisht, po t'i marrë vesh këto veprime Komiteti Qendror i Partisë Komuniste të Bullgarisë do të indinjohet, sepse ato që thuhën janë krejt shpifje. Zhivkovi është një shërbëtor besnik i Hrushovit.

Nga letra duket qartë se na akuzojnë për trubullues të paqes në Ballkan, se ne për udhëheqësit bullgarë qenkemi bërë më të këqij nga klika tradhtare e Beogradit, dhe meqenëse nuk pajtohemi me këta, qenkemi prishës të paqes në Ballkan! Pse ne nuk lejojmë që plani antishqiptar i Hrushovit, sipas të cilit Shqipëria e Jugut t'i jepet Greqisë në formë «autonomie», pse ne nuk përulemi dhe i luftojmë me vendosmëri revizionistët e Beogradit, për këto jemi ne trubulluesit e Ballkanit?! Për këto arsye ne nuk qenkeshim për çarmatimin e Ballkanit! Po kur Zhivkovi na qenka kaq i mirë, pse nuk e bëri çarmatimin dhe pastaj le të vazhdonte të na injoronte ne?!

Këto arsyetime tregojnë jo vetëm sa pa baza janë, por vërtetojnë se kemi të bëjmë me trillime renegatësh që kanë ardhur në fuqi në krye të një partie dhe një populli heroik. Çfarë shpifjesh! Ne paskemi atakuar Bullgarinë në procesin e gjyqit që u zhvillua në Tiranë kundër komplotit të organizuar nga revizionistët jugosllavë, monarko-fashistët grekë, në koordinim me NATO-n dhe me Flotën VI Amerikane në Mesdhe. Ata që merren me hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale e dinë se krimineli, pasi kryen krimin, instinkt-

visht kthehet në vendin ku e ka bërë atë. Pra këta njerëz që insistojnë kaq shumë për këtë gjyq, tregojnë se diçka u djeg. Prandaj me siguri nesër do të dalë se ata kanë qenë të implikuar, komplotistë, që kjo veprimtari armiqësore ndaj RP të Shqipërisë është kurdisur edhe nga ata që po insistojnë shumë se e dinë këtë çështje, kurse ne tani nuk e dimë atë që dinë ata, po me siguri do të mësojmë çdo gjë, do të zbulohet se si dhe përse këta «marksistë» mbrojnë agjentët e imperializmit amerikan. Sa kanë marrë pjesë dhe në ç'formë kanë marrë pjesë në këtë komplot, këtë sot për sot nuk e dimë, po koha do ta sqarojë. Është e çuditshme që udhëheqësit e partive komuniste dhe punëtorë të disa vendeve socialiste të arrijnë sa të mbrojnë kriminelët.

Letra e Kadarit ishte provokuese e skandaloze, po kjo e udhëheqjes bullgare është akoma më e keqe. Qëllimi i grupit të Zhivkovit, përveç të tjerave, është që me anën e kësaj letre të na kërcënojë se do të prishet Traktati i miqësisë, i bashkëpunimit dhe i ndihmës reciproke që kemi me Bullgarinë. Ky pra është një komplot i tërë i koordinuar. Prandaj t'u bëjmë shqiptarëve një letër që të vënë mend, kanë menduar ata, sepse po të mos përulen, atëherë Traktati i miqësisë me ta do të prishet. Këto janë shantazhe. Ne nuk dëshirojmë që ky traktat të prishet, por në qoftë se Zhivkovi do të ecë në një rrugë të tillë, ne do të mbrohemi edhe pa këtë traktat. Ne do të luftojmë për mbrojtjen e atdheut po të sulmohemi, bile po t'i ndodhë gjë popullit bullgar, edhe pa traktatin ne do të luftojmë kundër armiqve të tij dhe do ta mbrojmë atë. Prandaj t'i qëndisim një përgjigje udhëheqjes bullgare.

*Pastaj lexohet teksti i projektlettrës që është pre-gatitur për t'iu dërguar komiteteve qendrore të partive komuniste e punëto-re të vendeve pjesëtare të Traktatit të Varshavës në përgjigje të letrës së tyre të aprovuar në mbledhjen e Moskës të 3 gushtit 1961. Shokët e Plenumit, pasi diskutuan, e miratuan atë njëzëri. Duke mbyllur mbledhjen shoku Enver Hoxha tha:*

*Shokë, ne mendojmë të thërresim së shpejti edhe një mbledhje tjetër të rregullt të Plenumit të Komitetit Qendror për problemin e rinisë. Byroja Politike në mbledhjen që do të bëjë pas disa ditësh do ta marrë në shqyrtim raportin që do t'i paraqitet Plenumit, brenda këtij muaji. Problemi i rinisë është me shumë rëndësi dhe shqyrtimi i tij në Plenum do t'i japë një hov edhe më të madh rinisë për ta mobilizuar në një nivel akoma më të lartë në punë e në shkollë si dhe për mbrojtjen e atdheut.*

*Botohet për herë të parë me disa shkurtime, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbajtur në këtë Plenum që gjendet në AQP*

**LETËR DREJTUAR KOMITETEVE QENDRORE  
TË PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE  
TË VENDEVE PJESEMARRËSE TË  
TRAKTATIT TË VARSHAVËS<sup>1</sup>**

**6 shtator 1961**

Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më 5-6 shtator 1961, pasi shqyrtoi me kujdes letrën që sekretarët e parë të Komiteteve Qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, të Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, Partisë Punëtore të Rumanisë, i dërguan Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë më 3 gusht 1961 nga

---

<sup>1</sup> Kjo letër u është drejtuar komiteteve qendrore: të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë, Partisë Punëtore të Rumanisë dhe për dijeni komiteteve qendrore: të Partisë Komuniste të Kinës, Partisë së Punës të Koresë dhe Partisë së Punonjësve të Vjetnamit.

mbledhja e përfaqësuesve të partive komuniste e punëtoresh të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, nëpërmjet sekretariatit të kësaj mbledhjeje, ju drejton përgjigjen e mëposhtme:

Nga letra e sipërpërmendur, si dhe nga delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë që shkoi në Moskë për të marrë pjesë në këtë mbledhje, mësuam me indinjatë për qëndrimin e palejueshëm, thellësisht jomiqësor e pa precedent në historinë e lëvizjes komuniste ndërkombëtare, që u mbajt atje nga autorët e letrës në fjalë kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë. Kohët e fundit, duke filluar qysh nga Mbledhja e Bukureshtit e qershorit 1960, nga ana e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, N. S. Hrushovit, dhe e sekretarëve të parë të disa partive komuniste e punëtoresh të vendeve socialiste pjesëtare të Traktatit të Varshavës, është bërë rrugë praktike antimarksiste për ta vënë Partinë e Punës të Shqipërisë në pozita pabarazie, diskreditimi e diskriminacioni. Kjo praktikë e rrezikshme arriti kulmin në mbledhjen e 3 gushtit 1961, ku, me pretekstin se në mbledhje nuk merrte pjesë personalisht Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, u shkelën brutalisht edhe normat më elementare të marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtoresh dhe delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë, me anën e një vendimi arbitrar, u nxuar jashtë mbledhjes. Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e konsideron këtë akt, të padëgjuar ndonjëherë në marrëdhëniet midis partive marksiste-leniniste motra, si një ndërhyrje brutale në

punët e brendshme të Partisë sonë, si një shkelje të hapët të parimeve të konsultimit, të barazisë e të pavarësisë së partive komuniste e punëtore, të cilat janë përcaktuar qartë në Deklaratën e Moskës të 81 partive komuniste e punëtore. Ndërmarrja e një veprimi të tillë ndaj një partie motër, siç është Partia e Punës e Shqipërisë, tregon qartë se autorët e saj po ecin gjithnjë më tej me ndërgjegje në rrugën e acarimit të marrëdhënieve me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe me Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, se ata kanë hyrë në një rrugë pa krye, që dëmton rëndë interesat e larta të unitetit të kampit socialist e të lëvizjes komuniste ndërkombëtare, interesat e Traktatit të Varshavës, në një rrugë që mund të gëzojë vetëm armiq të tanë të përbashkët.

Qysh në letrën e datës 22 korrik 1961, drejtuar V. Ulbrihtit, Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë e ka sqaruar se Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shoku Enver Hoxha, nuk kishte mundësi të merrte pjesë personalisht në mbledhjen e 3 gushtit 1961. Është krejt pa baza e në kundërshtim me rregullat organizative leniniste preteksti që përmbahet në letrën e 3 gushtit, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë se gjoja delegacioni i caktuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë për atë mbledhje, i cili kryesohej nga një anëtar i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror, me atë përbërje, nuk ishte «kompetent» të merrte pjesë në diskutimin e problemeve lidhur me përgatitjet për përfundimin e traktatit të paqes me Gjermaninë. Në partitë komuniste e punë-

tore ekziston parimi leninist i udhëheqjes kolegjinale. Dhe Partia jonë e Punës e respekton me rigorozitet këtë parim. Si rrjedhim, Komiteti Qendror i cilëso parti komuniste e punëtore, pra edhe Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, në çdo rast dhe në çdo mbledhje, në pamundësi që të dërgojë Sekretarin e tij të Parë, ka plotësisht të drejtë të caktojë një përfaqësues tjetër të plotfuqishëm, i cili të jetë i autorizuar të paraqitë pikëpamjen e Partisë së tij dhe të marrë në emër të saj detyrime e përgjegjësi të plota për vendimet e marra bashkërisht si rezultat i konsultimeve të barabarta e shoqërore. Po për të njëjtën arsye duhet theksuar se as N. S. Hrushovi, as V. Ulbrihti dhe as ndonjë tjetër nuk është në gjendje dhe as që i përket të përcaktojë nëse ishte ose jo «kompetent» delegacioni i caktuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë që të përfaqësonte Partinë tonë në mbledhjen e 3 gushtit. Kjo është një çështje e brendshme e Partisë sonë dhe, në përputhje me parimet e njohura të pavarësisë së çdo partie komuniste e punëtore, vetëm Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, si organi udhëheqës kolegjal më i lartë i Partisë, ka të drejtë të vendosë se cili delegacion ose drejtues i Partisë do ta përfaqësojë atë në këtë apo në atë mbledhje të partive motra.

Në letrën e tij të 22 korrikut 1961 Komiteti Qendror i Partisë sonë ka deklaruar me qartësinë më të madhe se delegacioni i tij, i kryesuar nga shoku Ramiz Alia, ishte i plotfuqishëm dhe i autorizuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë të përfaqësonte me kompetencën më të plotë Partinë e Punës të Shqi-



përisë në mbledhjen e 3 gushtit 1961 lidhur me problemin gjerman që qëndronte në rendin e ditës. Prandaj vendimin e sekretarëve të parë të komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë dhe Partisë Punëtore të Rumanisë, për të mos lejuar delegacionin e Partisë së Punës të Shqipërisë që të merrte pjesë në mbledhjen në fjalë, e konsiderojmë si të paligjshëm, si një ndërhyrje të pashembullt në punët e brendshme të Partisë së Punës të Shqipërisë. Po kështu, një ndërhyrje në punët tona të brendshme janë edhe akuzat që i bëhen Partisë së Punës të Shqipërisë lidhur me mospjesëmarrjen e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në mars të këtij viti.

Ne hedhim poshtë gjithashtu akuzën e pathemeltë që bëhet në letrën e 3 gushtit, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, sipas së cilës udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë nuk përfill mendimin kolektiv të partive komuniste e punëtore motra dhe se gjoja për këtë arsye në nëntor të vitit 1960 shokët Enver Hoxha e Mehmet Shehu «u larguan në mënyrë demonstrative» nga Mbledhja e përfaqësuesve të 81 partive komuniste e punëtore. Dihet fare mirë se Partia e Punës e Shqipërisë, po ashtu si dhe të gjitha partitë e tjera motra pjesëmarrëse në Mbledhjen e nëntorit të vitit 1960, e nënshkroi Deklaratën e përbashkët që u adoptua atje. Partia e Punës e Shqipërisë ka zba-

tuar e zbaton në mënyrë konsekuente Deklaratën e 81 partive komuniste e punëtore të vitit 1960, ashtu siç ka zbatuar e zbaton Deklaratën e vitit 1957 të Mbledhjes së Moskës. Ku qëndron, pra, «mospërfillja e mendimit kolektiv të partive motra»? Mendimin kolektiv të partive motra nuk e përfillin ata që kanë shkëlur e po shkelin brutalisht parimet e Deklaratës lidhur me marrëdhëniet midis partive komuniste e punëtore dhe midis vendeve socialiste, nuk e përfillin sekretarët e parë të komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë dhe Partisë Punëtore të Rumanisë, të cilët mbajnë qëndrime arrogante e jomiqësore ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, siç e vërteton edhe qëndrimi që ata mbajtën ndaj delegacionit të Partisë së Punës të Shqipërisë në mbledhjen e 3 gushtit 1961. Përsa i përket largimit të shokëve Enver Hoxha e Mehmet Shehu nga seancat e fundit të Mbledhjes së nëntorit 1960, dihet mirë se kjo u bë për arsye se ata duhej të ndodheshin në atdhe për festat kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit. Për më tepër, ata u larguan kur diskutimi i përgjithshëm në Mbledhjen e Moskës kishte marrë fund, kur puna vazhdohej vetëm me komisionin për përgatitjen e tekstit të Deklaratës, në të cilin shumica dërrmuese e partive pjesëmarrëse, duke përfshirë edhe Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, Partinë Komuniste të Çekosllovakisë, Partinë Socialiste të Bashkuar të Gjer-

manisë, Partinë Punëtore të Bashkuar të Polonisë etj., nuk përfaqësoheshin nga kryetarët e delegacioneve. Veç asaj, mjaft parti motra në Mbledhjen e nëntorit 1960 nuk përfaqësoheshin nga udhëheqësit e tyre kryesorë, kurse, disa ditë përpara largimit të shokëve Enver Hoxha e Mehmet Shehu, nga kjo mbledhje u largua shoku A. Novotni, por megjithatë askujt nuk i ka shkuar as ndër mend t'i akuzojë këto parti dhe veçanërisht shokun Novotni për këtë gjë, dhe kjo është e drejtë. Përse pra, në rastin e Partisë së Punës të Shqipërisë mbahet një qëndrim i ndryshëm? A nuk është kjo një shkelje e trashë e parimit të barazisë, një qëndrim hapët diskriminues ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë?

Nga këto del qartë se të gjitha ato që përmbahen në letrën drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, dhe që u thanë në mbledhjen e 3 gushtit 1961 kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj, s'janë gjë tjetër veçse pretekste të trilluara për të justifikuar qëndrimet e palejueshme diskriminuese kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë, për t'i mohuar asaj të drejtën të merrte pjesë në mbledhje dhe të paraqiste atje pikëpamjen e saj të drejtë lidhur me çështjen gjermane. Me vendimin e tyre të padrejtë sekretarët e parë të komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Çekosllovakisë, Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë dhe Partisë Punëtore të Rumanisë, kryen një krim të pashembullt: ata i mo-

huan Partisë së Punës të Shqipërisë, që kurdoherë ka mbrojtur e mbrohet me besnikëri parimet e marksizëm-leninizmit e të internacionalizmit proletar, dhe popullit aleat e vëlla shqiptar, pjesëtar i Traktatit të Varshavës, të drejtën e tyre të ligjshme të thonë fjalën lidhur me zgjidhjen e drejtë të problemit gjerman; ata morën nëpër këmbë çdo ligj e parim leninist që rregullon marrëdhëniet midis partive motra dhe vendeve socialiste.

Duket se për të fshehur përpara botës këtë krim, për të mbuluar padrejtësinë që u bë ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, në fund të punimeve të mbledhjes së 3 gushtit 1961 u dha për shtyp një njoftim në të cilin falsifikohet realiteti, duke lënë të kuptohet sikur në këtë mbledhje merrte pjesë edhe delegacioni i Partisë së Punës të Shqipërisë. Por sido që të justifikohen dhe të fshihen këto veprime, mbetet një fakt i hidhur e i pamohueshëm se ato po dëmtojnë seriozisht unitetin e kampit socialist dhe të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe autorët e tyre po marrin kështu mbi vete një përgjegjësi të rëndë përpara popujve dhe historisë.

Dhe jo vetëm kaq. Në vazhden e veprimeve të tyre të dënueshme kundrejt Partisë së Punës të Shqipërisë, ata shkelën pa skrupul çdo normë leniniste të marrëdhënieve midis partive komuniste e punëtoresh motra: as që e vunë fare në dijeni Komitetin Qendror të Partisë sonë mbi zhvillimin e punimeve të mbledhjes së 3-5 gushtit 1961 dhe masat që u morën atje. Deri më sot Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë nuk i janë dërguar as vendimet e marra në këtë mbledhje dhe as protokollat e saj. Një veprim i tillë

ndaj një partie motër s'mund të cilësohet ndryshe, veçse si një orvatje e pandershme dhe krejt e pajustificueshme për ta përjashtuar në fakt Partinë e Punës të Shqipërisë nga pjesëmarrja efektive në diskutimin dhe në zgjidhjen e problemeve të mëdha që preokupojnë sot lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare, kampin socialist dhe Traktatin e Varshavës, siç është për shembull problemi gjerman.

Por ata shkuan edhe më tej. Siç del nga vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës Demokratike Gjermane i datës 12 gusht 1961 lidhur me masat për forcimin e kontrollit në kufirin me Berlinin Perëndimor, përveç mbledhjes së 3 gushtit 1961 të përfaqësuesve të partive komuniste e punëtore të vendeve pjesëmarrëse të Traktatit të Varshavës, ku Partisë së Punës të Shqipërisë iu ndalua në mënyrë të paligjshme pjesëmarrja, është bërë dhe mbledhja e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës. Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë jo vetëm nuk u thirrën për të marrë pjesë në këtë mbledhje, por as që u vunë fare në dijeni për mbajtjen e një mbledhjeje të tillë. Komiteti Qendror i Partisë sonë e konsideron këtë si një shkelje të hapët të të drejtave të ligjshme të Republikës Popullore të Shqipërisë, që është pjesëtare e denjë dhe e barabartë e Traktatit të Varshavës. Organizatorët e këtij akti të pashembullt, i cili ka për qëllim ta vërë efektivisht Republikën Popullore të Shqipërisë jashtë Traktatit të Varshavës, morën mbi vete një përgjegjësi të rëndë si minues të unitetit të Traktatit të Varshavës dhe të kampit socialist. Ne detyrohemi të

konstatojmë me keqardhje të thellë se nuk është hera e parë që disa udhëheqës të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me N. S. Hrushovin në krye, dhe disa udhëheqës të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës në marrëdhëniet me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë shkelin në mënyrë flagrante marrëveshjet që ekzistojnë midis partive dhe vendeve tona. Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë proteston në mënyrën më të vendosur për këto veprime të paligjshme thellësisht antimarksiste, të cilat i sjellin një dëm shumë të madh çështjes sonë të përbashkët.

Letra, që sekretarët e parë të komiteteve qendrore të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, të Partisë Komuniste të Çekoslovakisë, Partisë Socialiste të Bashkuar të Gjermanisë, Partisë Punëtore të Bashkuar të Polonisë, Partisë Komuniste të Bullgarisë, Partisë Socialiste të Punonjësve të Hungarisë dhe Partisë Punëtore të Rumanisë i drejtuan Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, përmban një sërë sulmesh, argumentesh false dhe trillimesh nga më të ulëtat kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqësve të saj, që nuk mund të lihen pa përgjigjen e merituar nga ana e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë.

Udhëheqësit e Partisë së Punës të Shqipërisë akuzohen se gjoja kanë frikë të marrin përsipër përgjegjësinë për zgjidhjen e një çështjeje kaq të ndërlikuar, siç është çështja gjermane. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare, udhëheqësit shqiptarë, nuk i janë trembur dhe as nuk i tremben kurrë e në asnjë

situatë përgjegjësisë së tyre si aleatë dhe pjesëtarë të Traktatit të Varshavës. Megjithatë një vend i vogël, i rrethuar nga të katër anët nga armiq të egër, pa kufi të përbashkët me vendet e tjera socialiste, Republika Popullore e Shqipërisë ka qëndruar si shkëmb graniti në brigjet e Adriatikut, u ka bërë ballë me sukses kompleteve, provokacioneve e shantazheve të panumërta të imperialistëve e të veglave të tyre, ka kryer me përpikëri detyrimet e saj si vend socialist dhe anëtarë i Traktatit të Varshavës.

Qëndrimi i Partisë dhe i Qeverisë sonë për çështjen gjermane njihet nga gjithë bota, ai përmbahet në shumë dokumente zyrtare që janë të botuara në shtyp. Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë kanë përkrahur kurdoherë dhe me vendosmëri përpjekjet e Bashkimit Sovjetik dhe të Republikës Demokratike Gjermane për zgjidhjen paqësore të çështjes gjermane. Pikëpamja e Partisë dhe e Qeverisë sonë ka qenë dhe mbetet se përfundimi i traktatit të paqes me Gjermaninë dhe zgjidhja mbi këtë bazë edhe e problemit të Berlinit Perëndimor janë masa të domosdoshme, të pjekura prej kohësh dhe në interes të Republikës Popullore të Shqipërisë, të Republikës Demokratike Gjermane, të vendeve të tjera socialiste, në interes të paqes dhe të sigurimit në Evropë. Ne kemi qenë dhe jemi për zgjidhjen sa më parë të këtyre problemeve, sepse çdo zvarritje e tyre është vetëm në dobi të armiqve tanë. Ju të gjithë e keni fjalimin që do të mbante në mbledhjen e 3 gushtit delegacioni i Partisë sonë, të cilin ai ua dërgoi më 3 gusht delegacioneve të të gjitha partive komuniste e

punëtore pjesëmarrëse në këtë mbledhje. Ai dëshmon se delegacioni ynë ishte i autorizuar të deklaronte, në emër të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, se «në çdo gjendje dhe në çdo çast të rrezikshëm ne do të luftojmë deri në fund përkrah Bashkimit Sovjetik dhe vendeve të tjera vëllezër, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, në çdo rast dhe si kurdoherë do të jemi solidarë deri në fund dhe do të kryejmë me nder detyrën tonë». Kjo ka qenë dhe është pikëpamja e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe e Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, pavarësisht nga mosmarrëveshjet ideologjike që ekzistojnë midis partive tona.

Kush i trembet në të vërtetë përgjegjësisë për zgjidhjen e çështjes gjermane, ne që kemi qenë dhe jemi për zgjidhjen e saj sa më shpejt, apo ata që në këtë çështje janë tërhequr dhe e kanë zvarritur deri më sot? Vetë N. S. Hrushovi, në nëntor të vitit 1958, deklaroi botërisht se pas gjashtë muajsh do të fillonte realizimi i masave për likuidimin e regjimit të okupacionit në Berlinin Perëndimor dhe për shndërrimin e tij në një qytet të lirë, të çmilitarizuar. Por kaluan gjashtë muaj, kaluan edhe dy vjet të tjerë dhe gjendja në Berlinin Perëndimor ka mbetur ajo që ishte. Nuk mund të mos përmendim këtu edhe një fakt tjetër. Vetëm disa muaj më parë, në mbledhjen e marsit 1961 të Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës, Nikita S. Hrushovi qortoi Partinë e Punës të Shqipërisë se gjoja ndjek një politikë të pamatur e të ashpër në lidhje me çështjen gjermane, kurse pas ka-



tër muajsh Partia e Punës e Shqipërisë akuzohet se ka frikë, se kërkon t'u shmangët përgjegjësi ve që rrjedhin nga zgjidhja e çështjes gjermane etj., etj. A nuk janë të paktën të çuditshme këto deklarata? A nuk është e qartë se disa udhëheqës të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik dhe disa udhëheqës të partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës që i përkrahin në përpjekjet e tyre për të njollosur Partinë e Punës të Shqipërisë, për të shtrembëruar politikën e saj të drejtë, përdorin çfarëdo lloj argumentesh, qofshin këto të trilluara apo të huajtura nga arsenali i armiqve të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të kampit socialist, qofshin këto edhe kontradiktore me njëra-tjetrën? Por dielli me shoshë nuk mund të mbulohet. Qëndrimi i Partisë së Punës dhe i Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë është i qartë për të gjithë. Shpifjet dhe akuzat e ndryshme, ngado që të vijnë, nuk mund të gënjejnë njeri, përveçse naivët dhe ata që duan të gënjen.

Për ne është e çuditshme dhe monstruoze se si mund të nxirren nga goja e udhëheqësve të disa vendeve socialiste e të partive komuniste shpifje të tilla kundër një vendi tjetër socialist siç është Shqipëria, dhe një partie marksiste-leniniste siç është Partia e Punës e Shqipërisë, se gjoja ato «përpiqen të përgatitin terrenin për t'u afruar me ata që kundërshtojnë rregullimin paqësor të problemit gjerman». Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë e hedh poshtë me vendosmëri dhe indinjatë këtë insinuatë të ulët dhe e konsideron atë një fyerje të rëndë për Partinë dhe popullin tonë, që kanë luftuar me heroizëm

kundër fashizmit dhe nazizmit, që kanë dhënë prova të shumta në luftën kundër imperializmit dhe veglave të tij, që kanë qëndruar të papërkulur ndaj çdo kërcënimi e provokacioni të armiqtve të socializmit, që kanë demaskuar pa mëshirë të gjithë ata që, duke u larguar nga pozitat e klasës, kanë rënë në llumin e oportunitizmit dhe kanë predikuar pajtimin me armiqtë tanë. Siç duket, pasi akuzat e tyre false kundër Partisë së Punës të Shqipërisë për sektarizëm dhe ekstremizëm nuk zunë vend dhe nuk mundën të mashtronin njeri, tani ata përpiqen të përhapin gjithfarë trillimesh se Partia e Punës e Shqipërisë po afrohet me armiqtë e paqes e të socializmit. Por, përpara qëndrimit të drejtë marksist-leninist dhe konsekuent të Partisë sonë, qëndrim që njihet botërisht kaq sa nuk marrim as mundimin ta dokumentojmë në këtë letër, edhe këto akuza të reja do të pësojnë fatin e akuzave të mëparshme; ato do të dështojnë me turp. Ata që akuzojnë e shpifin kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe udhëheqjes së saj nuk janë në gjendje të sjellin qoftë edhe një fakt të vetëm që do të mund të provonte thëniet e tyre, kurse ne jemi në gjendje të sjellim shumë fakte të dokumentuara që tregojnë qartë lëkundjet e tyre nga pozitat e marksizëm-leninizmit dhe të luftës kundër imperializmit. Ne nuk kemi pasur kurrë iluzione për armiqtë tanë, nuk jemi përçafuar e puthur me ta, nuk u kemi bërë kurrë lajka dhe nuk u kemi fërkuar krahët, s'jemi përkulur kurrë përpara tyre. Partia dhe Qeveria jonë kanë mbajtur gjithnjë një qëndrim të vendosur e parimor marksist-leninist ndaj armiqtve të paqes e të socializmit, ato kanë demaskuar ashpër e vazhdimisht impe-

rializmin dhe politikën e tij të luftës dhe të agresionit, ato kanë qenë të papajtueshme me armiqtë e klasës. Përpyekjet për të hedhur baltë mbi Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Qeverinë e Republikës Popullore të Shqipërisë, mbi gjithë popullin shqiptar, janë orvatje të turpshme që nuk kanë për të pasur kurrë sukses. Atë hidhen poshtë si nga gjithë historia e Partisë së Punës të Shqipërisë, ashtu dhe nga vetë jeta e realiteti i ditëve të sotme.

Autorët e letrës së lartpërmendur të 3 gushtit 1961 përpiqen me të gjitha mënyrat e bëjnë çmos për të gjetur çfarëdo lloj pretekstesh për veprime të mëtejshme antimarksiste dhe aspak miqësore kundër popullit shqiptar, Partisë dhe Qeverisë së tij. Janë fund e krye trillime akuzat që na bëhen se gjoja Republika Popullore e Shqipërisë nuk zbaton angazhimet e saj si pjesëtare e Traktatit të Varshavës, se ajo nuk informon Komandën e Bashkuar mbi gjendjen e Ushtrisë Shqiptare, se ndjek një vijë që është në kundërshtim me interesat e vendeve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe me parimet e internacionalizmit proletar. Në të vërtetë, ne kemi zbatuar me përpikëri të gjitha marrëveshjet ekzistuese, të gjitha detyrat që na janë ngarkuar nga Komanda e Bashkuar e Forcave të Armatosura të Traktatit të Varshavës, kemi zbatuar të gjitha urdhrat e udhëzimet e saj për stërvitjet ushtarake dhe të gjitha masat që parashikoheshin në planë të përbashkëta të ushtrive të Traktatit të Varshavës. Ne kemi njoftuar rregullisht çdo vit e çdo gjashtë muaj, në afatet e caktuara dhe me të gjitha hollësitë, Komandën e Bashkuar të Traktatit të Varshavës për gjendjen mo-

ralo-politike e materialo-teknike, gatishmërinë luftarake e tekniko-operative të ushtrisë sonë. Të tilla janë, për shembull, raportet e fundit që i janë dhënë me gojë e me shkrim komandantit të përgjithshëm të Forcave të Bashkuara të Traktatit të Varshavës, mareshalit A. A. Greçko, në tetor 1960 dhe më 27 mars 1961. Nuk jemi ne, por janë pikërisht Komanda e Bashkuar dhe qeveria sovjetike ato që nuk kanë kryer detyrimet e tyre ndaj ushtrisë së një vendi anëtar të Traktatit të Varshavës, siç është Republika Popullore e Shqipërisë. Menjëherë pas Mbledhjes së Bukureshtit qeveria sovjetike ndërpreu të gjitha furnizimet ushtarake në ushqim e veshmbathje, pajisje teknike, armatime e mjete të tjera për Ushtrinë Shqiptare, duke shkelur kështu në mënyrë të njëanshme dhe pa asnjë paralajmërim të gjitha marrëveshjet e nënshkruara më parë, siç janë për shembull marrëveshja e përfunduar midis Qeverisë së BS dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë më 28 shtator 1949, protokollit i 26 shkurtit 1959, protokollit i 3 shkurtit 1960 e të tjera, duke përfshirë edhe shkeljet flagrante nga pala sovjetike të marrëveshjeve të viteve 1957 dhe 1959 lidhur me bazën ushtarako-detare të Vlorës. Në kundërshtim të plotë me interesat e përbashkëta të mbrojtjes së kampit socialist, udhëheqësit sovjetikë dhe të gjithë ata udhëheqës të partive komuniste e punëtorë të vendeve socialiste të Evropës, që aprovuan propozimin e tyre, likuiduan bazën ushtarako-detare të Vlorës, duke marrë kështu përsipër një përgjegjësi të rëndë historike jo vetëm përpara popullit shqiptar, por edhe përpara gjithë popujve të tjerë të kampit socialist. Plani i masave kryesore të Komandës së Bashkuar të Traktatit

të Varshavës, mbi përgatitjen operative dhe luftarake të Ushtrisë Shqiptare për vitin mësimor 1961, nuk është zbatuar. Ai është shkëlur pa asnjë arsye e paralajmërim. Komanda e Bashkuar ka ndërprerë kategorikisht dërgimin e literaturës ushtarake në Shqipëri dhe nuk i jep Komandës së Ushtrisë Shqiptare asnjë informacion se ç'bëhet në ushtritë e vendeve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës. Me gjithë kërkesat e përsëritura të autoriteteve shqiptare, të bëra në raportin drejtuar mareshalit Greçko, më 27 mars 1961, në mbledhjen e Komitetit Politik Konsultativ të Traktatit të Varshavës në mars të këtij viti dhe në raste të tjera, që Komanda e Ushtrisë Shqiptare të dijë cilat janë detyrat e saj dhe ushtritë me të cilat do të bashkëvepronte ushtria jonë në rast lufte, të paktën në etapën e parë të fillimit të saj, deri tani nuk është dhënë asnjë përgjigje dhe nuk është marrë asnjë masë, kështu që Ushtria Shqiptare vazhdon të mos dijë akoma detyrat e saj në kuadrin e planit të përbashkët strategjik dhe operativ të ushtrive të Traktatit të Varshavës. Pa përgjigje ka mbetur gjithashtu kërkesa e palës shqiptare, e paraqitur në raportin e lartpërmendur të 27 marsit 1961, që, në kuadrin e shkëmbimit reciprok të eksperiencës, të marrë pjesë në stërvitje të përbashkëta edhe Ushtria Shqiptare në masën dhe në përbërjen që do të shihet e arsyeshme.

Nga sa u tha më lart, del qartë se Partia e Punës e Shqipërisë dhe Republika Popullore e Shqipërisë kanë plotësuar kurdoherë në mënyrë korrekte detyrimet e tyre, si ndaj vendeve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës, ashtu edhe ndaj Komandës së Bashkuar.

Kurse, në të kundërtën, udhëheqësit e vendeve të tjera pjesëtare të Traktatit të Varshavës dhe Komanda e Bashkuar nuk i kanë plotësuar detyrat e tyre ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Ushtrisë Shqiptare, ndaj një vendi socialist pjesëtar i Traktatit të Varshavës.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe përsa i përket veprimtarisë politike të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë. Në gjithë praktikën e saj Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ka informuar rregullisht për të gjitha çështjet e rëndësishme të politikës së jashtme vendet e tjera të Traktatit të Varshavës, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre diplomatikë në Tiranë, të cilëve u ka krijuar të gjitha kushtet e favorshme për ushtrimin e veprimtarisë së tyre. Akuzat që u bëhen udhëheqjes së Partisë dhe Qeverisë sonë edhe në këtë drejtim janë fund e krye trillime që bëhen me qëllim për të keqësuar akoma më shumë marrëdhëniet tona.

Por të gjitha këto veprime të padrejta, akuza të pamthemelta e shpifje që bëhen kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, nuk do t'ia arrijnë kurrë qëllimit, ato nuk do të mund ta largojnë kurrë Republikën Popullore të Shqipërisë nga zbatimi rigoroz e konsekuent i detyrave të saj internacionaliste si shtet socialist dhe si pjesëtar i denjë i Traktatit të Varshavës. Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë deklaroi edhe një herë se, me gjithë pengesat e vështirësitë që po na krijohen çdo ditë, me mjetet dhe mundësitë tona do të mbajmë në

gatishmëri të plotë Forcat tona të Armatosura për të kryer me nder e saktësi detyrën tonë prej aleati për mbrojtjen e interesave të kampit socialist në këtë rajon dhe, me sa na takon, do të mbajmë në dijeni Komandën e Bashkuar të Traktatit të Varshavës dhe të gjitha vendet socialiste. Në të njëjtën kohë, ne kërkojmë dhe do të kërkojmë që edhe Komanda e Bashkuar dhe qeveritë e vendeve socialiste pjesëtare të Traktatit të Varshavës të plotësojnë në mënyrë të përpiktë detyrimet e tyre ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe ushtrisë së saj, si pjesëtare e barabartë e Traktatit të Varshavës. Partia e Punës e Shqipërisë mendon se detyrimet reciproke të të gjithë pjesëtarëve të Traktatit të Varshavës duhen zbatuar me përpikëri dhe nga të gjithë, pa asnjë dallim.

Në letërën e 3 gushtit, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, thuhet se Partia e Punës e Shqipërisë «e konsideron një barrë të rëndë zbatimin e detyrave të veta që rrjedhin nga Traktati i Varshavës» etj. Është me të vërtetë për të ardhur keq për pozitën qesharake, në të cilën e kanë vënë veten autorët e këtyre deklaratave. Si mund t'i rëndohet qenia në Traktatin e Varshavës një vendi të vogël si Shqipëria, që ndërton socializmin në kushtet e rrethimit gjeografik kapitalist, nën presionin e vazhdueshëm të kompleteve, provokacioneve e të kërcënimeve të imperialistëve, të monarko-fashistëve grekë dhe të revizionistëve jugosllavë? E kush mund të jetë më tepër i interesuar për Traktatin e Varshavës sesa populli i vogël shqiptar, që rron e punon në gojën e ujkut? Prandaj Plenumi i Komitetit Qendror i Partisë së Punës të

Shqipërisë hedh poshtë me indinjatë si konkluzionin që përmban letra e 3 gushtit, sipas të cilit gjoja udhëheqësit shqiptarë «e konsiderojnë barrë të rëndë zbatimin e detyrave që rrjedhin nga Traktati i Varshavës», si dhe formulën që përsëritet në mjaft dokumente në adresë të Komitetit Qendror të PPSH se gjoja «Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria Shqiptare e kanë vënë veten jashtë Traktatit të Varshavës». Qëllimi ku synojnë autorët e shpifjeve të këtilla është më se i qartë, por pavarësisht nga kjo Plenumi i Komitetit Qendror të PPSH deklaroi se Republika Popullore e Shqipërisë ka qenë dhe është e denjë për të qenë anëtare e Traktatit të Varshavës, ajo ka mbajtur dhe mban me nder të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga kjo anëtarësi.

Akuzat, se gjoja Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësit e saj me veprimet e tyre po përçajjnë unitetin e vendeve të Traktatit të Varshavës dhe të kampit socialist, janë gënjeshtër dhe bëhen me qëllime të errëta, për të mbuluar veprimtarinë jomiqësore që po zhvillohet prej disa kohësh kundër Partisë dhe popullit tonë nga udhëheqësit e disa partive komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës. Është pikërisht kjo veprimtari dhe jo qëndrimet e Partisë së Punës të Shqipërisë, ajo që po minon unitetin e kompaktësinë e vendeve të Traktatit të Varshavës dhe të kampit socialist. Me gjithë veprimet e padrejta që u bëhen, me gjithë shpifjet, presionet e shumëllojshme dhe vështirësitë që po u krijohen, Partia e Punës e Shqipërisë dhe udhëheqësit e saj asnjëherë nuk kanë dhënë asnjë shkak që uniteti ynë të dobësohet, përLundrazi ata kanë luf-



tuar e luftojnë për forcimin e tij, ata nuk i kanë dhënë e nuk u japin asnjë armë armiqve që të godasin unitetin tonë. Janë pikërisht disa udhëheqës të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, me N. S. Hrushovin në krye, dhe të partive të tjera komuniste e punëtore të vendeve socialiste të Evropës, me në krye A. Novotniñ, V. Ulbrihtin, V. Gomulkën, T. Zhivkovin, J. Kadarin e G. Georgiu Dezhin ata që me veprimet e tyre kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, veprime që po bëhen përditë e më të njohura botërisht, po u japin armiqve të përbashkët armë për të sulmuar si unitetin tonë në përgjithësi, ashtu edhe Republikën Popullore të Shqipërisë. Janë ata që mosmarrëveshjet ideologjike midis partive tona i kaluan me ndërgjegje edhe në fushën e marrëdhënieve midis shteteve tona socialiste, duke vendosur bllokadën ekonomike, politike dhe ushtarake ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë. Janë ata që nga diskutimi në rrugë partie i këtyre problemeve u hodhën në diskutimin e tyre publik, siç bëri V. Ulbrihti në deklaratën e tij të njohur pas Mbledhjes së Moskës të 81 partive komuniste e punëtore, ose siç ka bërë në partinë e saj udhëheqja e Partisë Komuniste të Bullgarisë. Janë ata që në vend që, sipas Deklaratës së Moskës, të punonin për të zhdukur gradualisht mosmarrëveshjet që ekzistonin dhe fenomenet negative që ishin vënë re në marrëdhëniet midis partive tona, preferuan një rrugë tjetër: rrugën e acarimit të mëtejshëm, rrugën e presioneve njëri më i madh se tjetri, rrugën e sulmeve të paprincipita dhe të provokacioneve të panumërta kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë. Janë pikërisht

ata që e dobësojnë dhe e minojnë unitetin e kompaktësinë e kampit socialist dhe të Traktatit të Varshavës, me vendimin pa precedent që morën në mbledhjen e 3 gushtit për t'i hequr delegacionit të plotfuqishëm të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë të drejtën e ligjshme të merrte pjesë në mbledhje dhe të shfaqte pikëpamjen e Partisë sonë për një problem kaq të rëndësishëm, siç është problemi gjerman, dhe pikërisht në një moment shumë delikat të gjendjes ndërkombëtare, kur kërkohet më shumë se kurrë që të jemi të bashkuar si një trup i vetëm përballë imperialistëve amerikanë e të tjerë që na kërcënojnë me luftë. Pra, nuk është Partia e Punës e Shqipërisë, por janë disa udhëheqës sovjetikë, me N. S. Hrushovin në krye, dhe udhëheqës të vendeve të tjera socialiste të Evropës, ata që, me veprimet e veta antimarksiste dhe aspak miqësore, po dobësojnë e po minojnë unitetin e kampit socialist, të lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe të vendeve të Traktatit të Varshavës, duke u bërë qejfin kështu vetëm armiqve të paqes e të socializmit. . .

Përse atëherë shpifet me aq zell kundër udhëheqjes së Partisë sonë? Çfarë qëllimesh synojnë të arrijnë autorët e akuzave dhe të sulmeve monstruoze kundër saj? Qëllimi është i maskuar keq, sepse çdo gjë është më se e qartë: atyre nuk u pëlqen udhëheqja e sotme e Partisë së Punës të Shqipërisë dhe përpiqen me të gjitha mënyrat ta rrëzojnë atë. Por le të jenë të sigurt se nuk do t'ia arrijnë dot këtij qëllimi, ashtu siç nuk ia kanë arritur e nuk do t'ia arrijnë as imperialistët, as revizionistët jugosllavë.

Komiteti Qendror i Partisë së Punës-të Shqipërisë e ka deklaruar më se një herë dhe po e përsëritim edhe në këtë letër, se ne na shqetëson e na hidhëron shumë fakti që udhëheqësit sovjetikë dhe ata të vendeve të tjera socialiste të Evropës po ndjekin një kurs krejt të gabuar politik në marrëdhëniet me Partinë e Punës të Shqipërisë dhe Republikën Popullore të Shqipërisë, kurs që i sjell dëm jo vetëm popullit shqiptar dhe ndërtimit të socializmit në Shqipëri, por edhe vetë intereseve të kampit socialist dhe të Traktatit të Varshavës, unitetit tonë, i cili është më se i domosdoshëm, veçanërisht tani. Ata kanë marrë rrugën e rrezikshme të acarimit dhe të ndërlimit me ndërgjegje të mosmarrëveshjeve tona dhe në këtë rrugë po shkojnë gjithnjë e më thellë. Partia jonë e Punës e ka thënë dhe po e përsëritim që në qoftë se disa mendojnë se kështu, me presione e veprime të padrejta, me bllokada e restriksione ekonomike, politike apo ushtarake, mund të mposhtet Partia jonë, mund t'i imponohen asaj pikëpamje, me të cilat ajo nuk është dakord, ata gabojnë rëndë. Prandaj Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë përsërit edhe një herë thirrjen e bërë në letrën e tij të 6 korrikut 1961, drejtuar Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, që të hiqet dorë nga veprimet jomiqësore, nga presionet ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, nga acarimi me ndërgjegje i marrëdhënieve tona, nga çdo gjë që krijon vetëm pengesa artificiale për forcimin e unitetit dhe të miqësisë sonë. Kjo dhe vetëm kjo është rruga e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe e forcimit të unitetit tonë.

Por ne konstatojmë me keqardhje të thellë se gjak-nxehtësia dhe qëndrimi arrogant ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat nuk përputhen aspak me parimet e internacionalizmit proletar, i pengojnë N. S. Hrushovin dhe udhëheqësit e vendeve të tjera socialiste të Evropës që t'i peshojnë në mënyrë të matur propozimet tona të letrës së 6 korrikut, të cilat tregojnë të vetmen rrugë të drejtë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve tona. Në vend që të korrigojnë qëndrimet e tyre të gabuara ndaj Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të ndërmarrin hapa realë për përmirësimin e marrëdhënieve dhe për forcimin e unitetit tonë, ata i tregojnë forcën një populli të vogël vëlla, siç është populli shqiptar, me anë bllokadash, shantazhesh e presionesh ekonomike, politike e ushtarake. Por dihet se argumenti i forcës është një shenjë dobësie, ai nuk mund ta shndërrtojë gënjeshtrenë në të vërtetë dhe as të zëvendësojë parimet. Ne qëndrojmë të patundur, sepse kemi një forcë të pathyeshme, forcën e së vërtetës, forcën e parimit, forcën e marksizëm-leninizmit. Duke u nisur nga pozitat e tyre të shtrembra, udhëheqësit sovjetikë dhe ata të vendeve të tjera socialiste të Evropës që i përkrahin në luftën e tyre të paprincipitë kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe popullit shqiptar, mund të marrin çdo vendim kundër Partisë së Punës të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Shqipërisë, kundër popullit shqiptar, por çdo vendim i tillë do të jetë i gabuar dhe nuk do t'ia arrijë qëllimit.

Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë ashtu si deri tani,

edhe në të ardhshmen do të kryejnë me nder detyrat si Parti marksiste-leniniste dhe si vend socialist. Kjo ka qenë vija jonë. Kjo do të jetë edhe në të ardhshmen.

Për Komitetin Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Sekretari i Parë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **TË KAPIM MIRË KYÇET PËR EDUKIMIN E NJERËZVE**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH*

**11 shtator 1961**

Sipas mendimit tim, çështja që shqyrtojmë<sup>1</sup> është serioze dhe e përhershme për të gjithë Partinë. Jam plotësisht dakord me shokun Rita [Marko] që çështjet e forcimit të Partisë të mos i konsiderojmë një fushatë, por problem të madh shoqëror.

Grindjet dhe tarafet që ndihen në fshatra e që reflektohen dhe në organizatat-bazë të Partisë i kanë rrënjët te mbeturinat e vjetra të së kaluarës, prandaj për t'i zhdukur ato duhet luftuar kundër mbeturinave të vjetra. Mirëpo askush të mos ushqejë iluzione se mbeturinat e ideologjisë së vjetër zhduken me dekret. Për zhdukjen e tyre kërkohet një punë e dendur dhe e vazhdueshme edukative. Njerëzit edukohen gradualisht,

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti mbi zbatimin e detyrave që shtroi Kongresi IV i PPSH për forcimin e jetës së brendshme në organizatat-bazë.

nga puna e Partisë do të dalë njeriu i ri, i pastër e i ndërgjegjshëm. Por edhe kur të arrihet kjo në shkallë kombëtare, do të ketë përsëri njerëz të pandërgjegjshëm, që do të thyejnë normat e moralit të Partisë.

Partia jonë ka baza të shëndosha. Këto baza qëndrojnë në karakterin e lartë të popullit tonë, i cili i ka ruajtur të paprekura virtytet e tij të rralla. Megjithatë edhe në vendin tonë ekzistojnë akoma shumë mbeturina mikroborgjeze, të cilat vijnë duke u pakësuar por nuk janë zhdukur. Sot ato nuk shfaqen si në të kaluarën, me hakmarrje e vrasje, por kanë tjetër karakter dhe marrin forma të ndryshme. Po të shihen me kujdes, në shumicën e tyre, grindjet që vihen re sot te ne janë për çështje ekonomike, si për shembull përpjekjet që bëhen nga disa për të zënë vende ku mund të sigurojnë më tepër të ardhura etj. Natyrisht ka dhe mbeturina të tjera, kundër të cilave luftohet sipas mësimeve të Partisë. Të marrim një shembull: Më parë në vendin tonë bëheshin vjedhje. Atëherë prona ishte private. Tani prona është shoqërore, pra e popullit, njerëzit punojnë dhe jetojnë. Por a do të thotë kjo se sot nuk ka më njerëz që vjedhin? Edhe tani ka të tillë, që vjedhin në mënyrë të stërholluar, ndaj të cilëve ne duhet të jemi vigjilentë. Partia punon në këtë drejtim për edukimin e punonjësve. Bazë për këtë kemi karakterin e panjollësuar të shumicës dërrmuese të popullit, ndershmërinë e tij. Ky karakter është forcuar e është pasuruar akoma më shumë nën udhëheqjen e Partisë, e cila ua ka bërë njerëzve të qartë se prona shoqërore është ndërtuar me duart e tyre dhe për veten e tyre, prandaj ajo duhet të ruhet dhe të zhvillohet në

interes të të gjithë popullit. Nga ana e Partisë është edukuar gjithashtu edhe ndjenja e lartë e fisnike e punës. Kështu, pra, virtytet e larta që ka trashëguar populli ynë brez pas brezi, po i zhvillon Partia edhe më tej në rrugën marksiste-leniniste.

Zhdukja e grindjeve dhe e tarafeve kërkon një kujdes të madh për edukimin e punonjësve me virtytet e larta të popullit tonë, në radhë të parë që secili të punojë ndershmërisht. Kjo ka rëndësi të madhe. Njeriu që dërsin e punon, largohet nga veset e këqija, ndërsa ai që në shoqërinë tonë të re i bën bisht punës, gjen kohë të grindet, të bëjë dallavere, të merret me thashetheme etj. Prandaj zënia e njerëzve me punë duhet të jetë një nga preokupacionet kryesore të Partisë. Puna është nder, ajo është jo vetëm burim i mirëqenies, por edhe faktor me rëndësi për edukimin e njeriut që nuk i lë shteg zhvillimit të mbeturinave mikroborgjeze.

Një nga problemet më kryesore për Partinë sot është çështja e mbrojtjes së atdheut nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm, nga imperialistët, revizionistët hrushovianë, titistë etj. Kjo ka qenë në qendër të vëmendjes së Partisë gjatë gjithë jetës së saj. Në rast se gjithë anëtarët e Partisë, krahas punës, mobilizohen mirë edhe për kuptimin e drejtë të gjendjes së brendshme e ndërkombëtare dhe edukohen me frymë revolucionare, atëherë edhe grindjet më të vogla, thyerjet e disiplinës etj., do të zhduken përpara çështjes së madhe të mbrojtjes së atdheut, të fitoreve të socializmit dhe të marksizëm-leninizmit.

Kur themi që në këtë situatë të rëndë Partia jonë,



megjithëse është e vogël, qëndron në ballë të luftës, kjo na ngarkon me përgjegjësi të madhe para popullit dhe lëvizjes komuniste ndërkombëtare. Nuk do të ndodhë kurrë që ne të ndalemi në rrugën tonë, sepse luftojmë për çështjen e madhe të marksizëm-leninizmit, kundër imperializmit dhe udhëheqjes revizioniste sovjetike me Hrushovin në krye, që kanë për qëllim të zhdukin kampin socialist dhe socializmin. Ne flasim me thjeshtësinë që na karakterizon, por me mendjen top se veprimtaria përçarëse e imperialistëve dhe e revizionistëve po bëhet çdo ditë e më e qartë. Një Parti e vogël, një shtet i vogël, lufton me vendosmëri kundër armiqve të mëdhenj e të organizuar. Por të gjithë duhet të mbajnë parasysh se Partinë e dëmton qoftë edhe një gabim i vogël që bën një anëtar i thjeshtë i saj sot, në këto situata që po kalon lëvizja komuniste ndërkombëtare. Partia e Punës e Shqipërisë kërkon nga çdo njeri, nga çdo komunist e patriot, ta kuptojë mirë situatën dhe të luftojë çdo shfaqje të huaj sado e vogël që të jetë. Në qoftë se çdo komunist do të jetojë me situatën në kompleks, do t'i pritët rruga veprimtarisë armiqësore që po zhvillohet me intensitet më të madh nga ana e armiqve tanë të jashtëm dhe të brendshëm, të cilët përpiqen të përfitojnë edhe nga dobësitë e vëgla që kemi në punën tonë, për të na dëmtuar. Armiku bën përpjekje që edhe një pakënaqësi të vogël që mund të ketë një komunist ose patriot, ta shfrytëzojë, duke synuar që ta kthejë atë në një sabotator të luftës për ndërtimin e socializmit në vendin tonë. Prandaj lufta për të zhdukur mbeturinat e vjetra nuk duhet neglizhuar, sepse këto janë të rrezikshme.

Unë jam dakord me pikëpamjen e shokëve që thanë se në përgjithësi grindjet e tarafet nuk janë të karakterit politik. Por ne nuk duhet ta flemë mendjen e të mbyllim sytë. Ne shikojmë se gjithë populli dhe komunistët janë ngritur në këmbë dhe punojnë për realizimin e vijës së Partisë. Megjithatë, mbeturinat e vjetra dhe shfaqjet e huaja, në çdo formë që të paraqiten, nuk duhet t'i nënvleftësojmë, natyrisht as t'i mbivlerësojmë, por t'i vlerësojmë drejt, sidomos në situatat politike që zhvillohen sot. Prandaj të kapim mirë kyçet për edukimin e njerëzve, për t'i shpëtuar ata nga rreziqet.

Të shikojmë se ç'bëjnë revizionistët. Ata i kanë vënë detyrë vetes të likudojnë komunizmin dhe socializmin. Veprimtarinë e tyre armiqësore e kanë filluar nga degjenerimi i Partisë dhe i popullit, jo vetëm nga pikëpamja e korrupsionit dhe e komprometimit agjencurial, por e gjithë propaganda, ideologjia, kultura, teatri, kinemaja etj., po zhvillohen në një mënyrë të tillë të heshtur dhe të bujshme që u japin mundësi revizionistëve të degjenerojnë një brez të tërë njerëzish për të mbështetur punën e tyre armiqësore kundër komunizmit, pro imperializmit, pro ideologjisë borgjeze. Nga kjo tragjedi ne nxjerrim shumë mësim, një nga të cilët është edhe ky: grindjet, tarafet etj., që ekzistojnë te ne, megjithëse nuk kanë karakter politik, sepse fakti është që predominon dashuria për Partinë, për pushtetin popullor etj., po të mos u vëmë kujdes të madh për t'i luftuar në rrugë partie dhe administrative, atëherë ato mund të marrin edhe karakter politik. Këtë çështje duhet ta gjejkojmë thellë. Ta zëmë se në një

kooperativë bujqësore kemi një sekretar të mirë të organizatës-bazë ose një kryetar kooperative punëtor partie, të cilët i lejojnë vetes disa gabime, atëherë ç'do të ndodhë? Në organizatën-bazë ose në kooperativën bujqësore do të krijohet një taraf kundër tyre, ky taraf mund të kthehet edhe në një sëmundje politike. Në fillim çështja nuk arrin sa të hidhen njerëzit kundër organizatës së Partisë, por, në qoftë se gjendja do të keqësohet, gabimet do të trashen, armiku me siguri do t'i shfrytëzojë situatat e sëmura. Prandaj çështje të tilla duhen parë në dinamikën e tyre, ato nuk duhen konsideruar vetëm si çështje të thjeshta.

Unë, për shembull, kam marrë vesh që një kryetar kooperative po bën disa favorizime për njerëzit e tij. Ky veprim tani mund të mos jetë politik, por në qoftë se ky kryetar nuk ndihmohet të korrigojë, atëherë mikrobi mbetet, favorizimet do të zhvillohen në atë shkallë sa do të dëmtohet puna e Partisë. Në këtë kooperativë ka zëra që thonë se nuk merren masa kundër favorizimeve, sepse puna është qelbur nga koka, duke bërë aluzione për kryetarin. Ja, pra, çështjet nuk duhen parë vetëm nga ana ekonomike, por në radhë të parë nga pikëpamja politike. Kur kryetari i kooperativës favorizon dy-tre nga njerëzit e tij, kjo është një çështje politike, sepse atij i ka besuar populli një funksion me rëndësi, ai përfaqëson pushtetin, nuk është vetëm një ekonomist ose agronom, por një njeri politik, një punëtor partie. Duke bërë favore ky shok a nuk ka shkelur vijën e Partisë? Mendoj se kështu duhen parë gjërat dhe kështu duhen edukuar njerëzit.

Grindjet në një organizatë-bazë partie nuk duhen

lënë pas dore. Askush nuk duhet të mendojë: e ç'rëndësi ka një organizatë-bazë përpara 80 ose 100 të tjerave që ka rrethi? Jo, edhe një organizatë ka rëndësi të madhe. Prandaj në gjirin e saj nuk duhet të ketë grindje, por unitet të shëndoshë. Zbatimi i drejtë i mësimëve të Partisë në organizatën-bazë ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për forcimin e Partisë dhe të shtetit, për sigurimin e pavarësisë së atdheut dhe të fitoreve të socializmit.

Këto çështje, pra, duhet të merren me seriozitetin më të madh, të vlerësohen me kujdes, të zgjidhen drejt dhe ndaj atij që mbush kupën të merren masa administrative, bile të rrepta. Po të jetë nevoja ndonjë që kryen faj të rëndë, të demaskohet, me qëllim që të mësojnë dhe të tjerët e, kur është rasti, ndonjëri që kryen krim t'i jepet edhe gjyqit.

Të mendoni mirë sidomos ju, shokë të Shkodrës<sup>1</sup>. Nuk mund të pranohet mendimi se në këtë ose në atë zonë s'ka elementë për t'u pranuar në Parti. Edhe atje ka elementë të shëndoshë për të hyrë në Parti, prandaj të mos jeni as oportunistë, po as sektarë. Organizatat-bazë të Partisë kanë nevojë për gjak të ri. Prandaj njohja e terrenit, e njerëzve, e çdo problemi në zonat e rrethit tuaj duhet të preokupojë jo vetëm sekretarin e parë, por gjithë komitetin e Partisë. Instruktorët mund të venë, por mos u mjaftoni me këtë, merrni më shumë takim me njerëzit duke shkuar në vend ose duke

---

<sup>1</sup> I drejtohet sekretarit të parë të Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës që morri pjesë në mbledhjen e Byrosë Politike.

thirrur në byronë e rrethit jo vetëm sekretarë organizatash-bazë ose komunistë, po edhe nga populli. Receta për këtë punë nuk ka, mbështetuni në Statutin e Partisë, nenet e tij duhen zbatuar në jetë duke punuar gjallërisht me njerëzit. Nëse një djalë i mirë ka ndonjë të dënuar nga rrethi i tij, por vetë është hero, përse të mos e pranojmë në Parti? Kemi edhe të tillë në radhët e Partisë, që mund të kenë ndonjë të afërt të dënuar nga pushteti popullor, por ata janë nga shokët tanë besnikë, kanë dhënë prova e kanë mbajtur qëndrime të mira si gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ashtu edhe sot në ndërtimin e socializmit duke luftuar sinqerisht për Partinë dhe popullin. A nuk duhet marrë parasysh, për shembull, lufta 10-12-vjeçare e një malësori, që ka luftuar për mbrojtjen dhe propagandimin e vijës së Partisë, që sakrifikon nëpër male kundër armiqve, që kap edhe diversantë? Ata që qëndrojnë në këto dallgë duhen konsideruar sikur kanë marrë pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare. Në qoftë se nuk mbahen parasysh këto kritere, çdo punë tjetër është në dëm të forcimit të organizatave-bazë të Partisë në këto zona.

Është shumë mirë që Partia jonë nuk është infektuar nga ideologjia borgjeze e revizioniste, siç ka ngjarë në vende të tjera. Ky është një plus i madh për ne. Ç'po ndodh në Bashkimin Sovjetik dhe në vende të tjera socialiste? Ka një shturje të madhe morale, degjenerim ideologjik, politik dhe ekonomik të njerëzve. Kjo nuk ngjet në vendin tonë, për arsyet që dihen dhe për shkak të vigjilencës së mprehtë të Partisë. Organizatat-bazë dhe komitetet e Partisë, organet e pushtetit, organizatat e masave dhe kryesitë e kooperativave

bujqësore janë mobilizuar mirë jo vetëm për problemet ekonomike, po edhe për çështjet politike dhe të mbrojtjes së atdheut. Këto janë probleme kyçe, prandaj Partia dhe populli janë ngritur në këmbë për zgjidhjen e tyre. Gjatë këtij viti të vështirë ka një mobilizim të masave të popullit për realizimin e planeve ekonomike si dhe për zbatimin e detyrave politike, gjë që nuk është parë kurrë. Kjo ka ndodhur se udhëheqja e Partisë në bazë dhe e gjithë Partia në vendin tonë e kanë kuptuar drejt situatën dhe kanë punuar mirë për të arritur rezultate gjithnjë e më të mëdha.

Analizat që janë bërë për grindjet dhe tarafet nga komitetet e Partisë, duke shkuar në organizatat-bazë, kanë qenë të efektshme, sepse kanë shërbyer për të përmirësuar gjendjen. Por këto probleme duhet t'i kemi parasysh vazhdimisht, sepse ka raste që grindjet përsëriten. Prandaj t'i mbajmë sytë hapur, t'u dalim të këqijave përpara dhe të jemi kurdoherë në sulm për të zbatuar detyrat ekonomike, politike, ideologjike dhe ushtarake.

Unë jam dakord që për këto çështje t'u bëhet një letër të gjitha organizatave-bazë të Partisë. Letra, sa të jetë e mundur, të mos jetë e gjatë, të jetë konkrete, e kuptueshme dhe optimiste, sepse situata zhvillohet në favorin tonë.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstilt të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **NË GJENDJEN E KRIJUAR NE NUK DO TË SHKOJMË NË MBLEDHJEN E KNER-IT**

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**11 shtator 1961**

Në gjendjen që është krijuar në Këshillin e Ndhimës Ekonomike Reciproke (KNER) është njësoj si të shkojmë dhe të mos shkojmë. Unë mendoj që ne të mos marrim pjesë në mbledhjen e ardhshme të KNER-it, ku sundojnë revizionistët, të cilët duan të lënë pas dere përfaqësuesit e vendit tonë. Prandaj propozoj t'u bëhet një letër jo nga ana e Qeverisë, po nga ana e ndonjë shoku të ngarkuar prej Këshillit të Ministrave.

Në këtë letër mund të thuhet se me keqardhje të madhe nuk mund të vijmë në mbledhjen e 15 shtatorit, megjithëse ishim të gatshëm të diskutonim mbi

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua, jashtë rendit të ditës, problemi i pjesëmarrjes ose jo të vendit tonë në mbledhjen e Këshillit të Ndhimës Ekonomike Reciproke (KNER) që do të zhvillohej në Moskë më 15 shtator 1961.

çështjet e rendit të ditës, për shkak se është krijuar një situatë armiqësore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë në të gjitha fushat dhe veçanërisht në fushën ekonomike. Konkretisht, në mos janë fshirë fare, neve na janë pezulluar të gjitha kreditë e akorduara për pesëvjeçarin e tretë. Bashkimi Sovjetik e ka konsideruar Shqipërinë një vend armik dhe prandaj ai nuk po e ndihmon. Duke e konsideruar vendin tonë armik, Bashkimi Sovjetik ka marrë edhe masa për prerjen e kredive, nuk ka dashur të koordinojë planet me vendin tonë, marrëveshjen e kleringut për pesëvjeçarin etj., në një kohë që një marrëveshje të tillë ka përfunduar me vende kapitaliste. Në këto kushte, na është bërë e pamundur ardhja për të marrë pjesë në mbledhje, derisa vendet anëtare të KNER-it të ndryshojnë qëndrimin e tyre ndaj Shqipërisë.

Në letër të vihet në dukje gjithashtu se në pamundësi të marrim pjesë në këtë mbledhje, për shkak të vendimeve që janë marrë kundër nesh, vendi ynë do t'i vazhdojë marrëdhëniet me klering, por Këshilli i Ndhmës Ekonomike Reciproke do të jetë përgjegjës për situatën e krijuar. Këtë duhet t'ua theksojmë që nesër të mos na thonë dot që ju s'doni të keni marrëdhënie me ne as me klering.

Ka rëndësi që në letër të vihen në dukje edhe shkaqet e kësaj shtate, pse janë shkëlur marrëveshjet ndaj nesh, pse janë pezulluar ose prerë kreditë ndaj Shqipërisë. Të thuhet shkaqet dhe shkaktarët, dhe kjo konkretisht, duke e argumentuar me fjalët e Hrushovit, me shprehjet e tij, të cilat të citohen në letër. Të theksohet që në këtë rrugë udhëheqësit e Bashkimit



Sovjetik i kanë pasuar edhe ata të Çekosllovakisë, të Bullgarisë etj., të cilët na kanë njoftuar se «me ne do të mbani vetëm marrëdhënie tregtare me interes reciprok».

Kjo është, shokë, situata e krijuar ndaj nesh. Ne, si vend i socializmit dhe besnik i marksizëm-leninizmit, do të jemi kurdoherë të gatshëm të marrim pjesë në mbledhjet e ardhshme, në rast se na heqin pengesat e tanishme. Me anë të kësaj letre t'u japim të kuptojnë që ne, sot për sot, nuk largohemi nga KNER-i, po, në situatat e krijuara, nuk marrim pjesë në këtë mbledhje dhe për këtë ata mbajnë përgjegjësi.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Byrosë  
Politike të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË PRANOJME NË PARTI MË SHUME NJERËZ NGA KLASA PUNËTORE**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**16 shtator 1961**

Në përgjithësi ne kemi përmirësime në forcimin e përbërjes së Partisë. Por, ndërsa punëtorët e fshatarët zënë rreth 30 për qind të efektivit të Partisë, nëpunësit zënë 42 për qind, pra këta të fundit vazhdojnë të dominojnë. Dihet se këta nëpunës janë kuadro të Partisë e të pushtetit si dhe ushtarakë. Por sidoqoftë, ne përsëri duhet të na preokupojë problemi i pranimit akoma më shumë nga radhët e punëtorëve. Por edhe në këtë drejtim të kemi parasysh specifikën e punëtorëve, sepse ka punëtorë e punëtorë.

Orientimi që ka dhënë Komiteti Qendror është i

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u muar në shqyrtim raporti «Mbl zbatimin e detyrave të Plenumit XVIII të KQ të PPSH mbl disa çështje të punës organizative të Partisë dhe të Kongresit IV, për forcimin e përbërjes së Partisë».

drejtë. Ai synon të forcojë organizatat-bazë të Partisë me komunistë të rinj në ato ndërmarrje ku ka më tepër dobësi. Por ne duhet t'i drejtojmë sytë ndaj ndërmarrjeve që kanë numër të madh punëtorësh, puna e të cilëve është shumë e vështirë, në vend të disa ndërmarrjeve të tjera, që edhe ato kanë punëtorë shumë, por që puna e tyre është më e lehtë, veç nuk duhet dobësuar vëmendja në këto të dytat. Pra, për pranimet në Parti të na preokupojë më shumë cilësia.

Le të marrim si shembull uzinën «Enver». Atje ka një organizatë-bazë partie të fortë. Megjithatë, mendimi im është që ne duhet të punojmë më shumë për të pranuar akoma më tepër punëtorë në Parti nga kjo uzinë, jo për t'i bërë anëtarë partie të gjithë punëtorët, por të pranojmë ata që i kanë të gjitha kushtet për të qenë në Parti. Nuk është e thënë që të gjithë këta anëtarë partie që do të kemi aty, do t'i lëmë në këtë uzinë. Do të ndërtojmë uzina e ndërmarrje të reja, prandaj do të kemi nevojë të dërgojmë komunistë në to. Për shembull, në këtë pesëvjeçar do të ngremë uzina mekanike në Shkodër e në Qytetin «Stalin». Vetvetiu atje do të na duhet të transferojmë disa nga komunistët e uzinës «Enver» për të forcuar punën e Partisë.

Ose le të marrim çështjen me perspektivë të madhe të minierave në vendin tonë. Sot kemi Minierën e Pishkashit si qendër me rëndësi për nxjerrjen e mineralit të hekurit, po nesër do të kemi 2-3 qendra të tjera të këtij lloji. Sot kemi Minierën e rëndësishme të Qymyrgurit në Memaliaj, po nesër do të kemi edhe Mëzezin e Alarupin. Kur të kemi punëtorë me stazh në punë të rënda, krijojmë një bazament të shëndoshë të klasës sonë

punëtore. Pra të synojmë për të pranuar në Parti së pari nga këta pastaj nga punonjësit e tregtisë ose nga punëtorët që punojnë në sektorë ushqimorë, ku puna është më e lehtë. Në radhë të parë, të synojmë te ata që punojnë ditë e natë në punë të rënda. Qendra me punë të tilla janë në zhvillim e sipër në vendin tonë, prandaj të mos e marrim të shkëputur atë që them për pranimet në Parti nga radhët e punëtorëve të uzinës «Enver» e të themi ç'na duhen gjithë këta. Të njëjtin kujdes duhet të tregojmë gjithashtu edhe në kombinatin e tekstileve «Stalin», sepse si ky do të ndërtojmë edhe kombine të tjera tekstilesh në të ardhshmen. Po të punojmë këtu qysh tani me mend, për pak kohë ne do të kemi një grup të mirë anëtarësh partie që mund t'i dërgojmë pastaj në Berat. Kështu mund të themi edhe për minierat e qymyrgurit, të bakrit etj.

Ka rëndësi, pra, puna që bëhet nga komitetet e Partisë në bazë të orientimit të Komitetit Qendror lidhur me pranimet. Është e drejtë praktika e Komitetit të Partisë të Tiranës për këtë problem, ku sekretarët e organizatave-bazë kanë bërë një studim për pranimet në Parti, duke e parë problemin nga të gjitha anët. Përqindjet të shihen jo vetëm brendapërbrenda ndër-marrjeve, po edhe në perspektivë, sipas nevojave kombëtare. Prandaj, sa të jetë e mundur, në punëtorët që pranohen, shumicën ta zënë ata që e kanë punën të rëndë, megjithëse disa prej këtyre nuk i plotësojnë të gjitha kushtet, si për shembull shkollën. Punëtori i industrisë ushqimore mund të shkojë më lehtë për të mësuar në shkollë sesa punëtori i minierës, po komitetet e Partisë të tregojnë kujdes të veçantë më shumë për

punëtorët e kësaj kategorie, edhe pse nuk e kanë arsimin e duhur. Këtyre punëtorëve t'u jepen më shumë mundësi dhe të lehtësohen për të plotësuar kushtet që të hyjnë në Parti, sesa punëtorëve të sektorit të ushqimores, të cilët mund të vazhdojnë edhe shkollën, por mund të mos kenë kushtet e tjera kryesore.

Jam dakord që të mos bëjmë pranime pa pasur shkollën përkatëse. Përjashtim në këtë çështje të bëjmë vetëm për punëtorë. Kur një punëtor me stazh të vjetër është i kualifikuar në punë, i zoti, i vendosur, edhe pse nuk e ka arsimin e duhur, të mos e lëmë jashtë Partisë. Ndryshe është për një punëtor të ri, këtij do t'ia kërkojmë patjetër 7-vjeçaren. Edhe kur një i ri ka garancitë, por nuk ka shkollën, të mos pranohet, të shkojë ta bëjë edhe shkollën e pastaj të shihet çështja e pranimit të tij në Parti.

Përqindjeve duhet t'u përmbahemi. Partia ka besim te ata që punojnë, prandaj dhe i pranon në radhët e saj, por jo pse disa punojnë në organet e punëve të brendshme ose në ushtri dhe nga ata të pranojmë më shumë në Parti. Proporcionet duhet të ruhen, por përsa u përket elementëve të klasës punëtore të kemi parasysh ato që theksuam, sepse në qoftë se kemi një punëtor me stazh, politikisht të formuar dhe që bën një punë tërëndë në ndonjë uzinë, pasi ta pranojmë në Parti, ne mund ta marrim atë më lehtë dhe t'ua japim organeve të sigurimit ose ushtrisë, në vend të një tjetri që mund të jetë djalë i mirë, të jetë edhe bir dëshmorë, por që vazhdimisht ka ardhur rrotull zyrave. Është ndryshe kur në vend të tij ke një komunist që vjen nga një uzinë ose kombinat, të cilit i janë argasur duart, është

I rrahur me punë dhe me vështirësi, prandaj edhe punën e sigurimit e bën shumë më mirë dhe garancitë i ka më të mëdha. Këtë çështje duhet ta shohim me kujdes, sepse në shkollën e oficerëve shkon më me lehtësi djali i atij që është oficer, sesa i biri i minatorit të Kërrabës. Prandaj t'i shikojmë mirë këto çështje, se po të kemi organizatë-bazë të Partisë të fortë në qendrat më të mira industriale, atje do të përgatitim edhe kuadro të mirë për sektorët e tjerë, edhe për Ministrinë e Punëve të Brendshme apo për ushtrinë.

Pra, megjithëse pranimi i nëpunësve në Parti ka ardhur duke u ulur, duhet të kemi kujdes që të pranojmë akoma më shumë punëtorë se nëpunës. Veç të pranojmë jo punëtorë për punëtorë, por punëtorë të vërtetë, që ta meritojnë emrin e komunistit. Ata punëtorë që plotësojnë kushtet sipas Statutit, të studjohen për t'u pranuar në Parti. Ne nuk e kemi kryer si duhet detyrën ndaj atyre që kanë 10-12 vjet punëtorë.

Të gjitha këto gjëra duhen parë me kujdes, me qëllim që Partia të forcohet me elementë të klasës punëtore dhe në radhë të parë me ata që punojnë në sektorët e vështirë të industrisë, natyrisht pa lënë në harresë sektorët e tjerë. Konsideratat e tjera dhe orientimi i dhënë të kihen parasysh, po të theksohet edhe kjo gjë: nga administrata sa të jetë e mundur më pak pranime në Parti. Ndaj njerëzve të zyrave duhet të jemi shumë të kursyer në aprovimin e kërkesave për pranime.

Komitetet e Partisë të kenë parasysh edhe çështjen se po të shtojmë përqindjen e punëtorëve në Parti, do të kemi më pak dënime e përjashtime. Vjedhjet e abuzimet, qëndrimet oportuniste dhe mashtrimet nuk bëhen

nga ata që punojnë në torno ose në qymyr, por nga ata që vërtiten dyqaneve dhe thyejnë disiplinën, cenojnë nderin dhe moralin e Partisë. Duke e forcuar Partinë me elementë të klasës, do të kemi edhe më pak shturje në jetën e komunistëve. Pra, le të qëndrojmë në orientimin që është dhënë, por të kemi kujdes në zërthimin dhe në zbatimin e tij praktik.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH  
që gjendet në AQP*

## **TË GJITHA FORCAT PËR PËRMIRËSIMIN E METODËS SË PUNËS**

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**16 shtator 1961**

Kisha edhe unë për të shtuar diçka. Ne jemi të sigurt se ju, shokë drejtues të Partisë në Gjirokastrë, nuk keni lidhur duart, përkundrazi e dimë që keni punuar dhe punoni, vetëm se duhet ta përmirësoni më tej metodën e punës, prandaj në këtë çështje jam plotësisht dakord me raportin dhe me vërejtjet e shokëve. Raporti në përgjithësi i ka paraqitur mirë çështjet dhe janë parë drejt të metat në metodën e punës të sekretarit të parë të komitetit të Partisë dhe të drejtuesve të tjerë të rrethit. Është e nevojshme që këto vërejtje shokët drejtues të Gjirokastrës t'i kuptojnë drejt dhe të vënë të gjitha forcat për përmirësimin e metodës së punës.

Kur thirren shokë para Sekretariatit ose Byrosë

---

<sup>1</sup> Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti «Mbl disa probleme të punës së Partisë në rrethin e Gjirokastrës», paraqitur nga ekipi i Komitetit Qendror të PPSH.



Politike të KQ duhet të kenë parasysh se nuk vijnë për të pranuar ose jo vërejtjet që u bëhen nga ekipi apo të dërguarit për ndihmë e kontroll, por për të raportuar se si shkojnë punët e Partisë në të gjithë sektorët, cila është gjendja politike, morale, ekonomike dhe organizative dhe të dalin me konkluzione. Më në fund të shprehin edhe pikëpamjen e tyre se me cilat konkluzione të ekipit janë dakord e cilat gjëra ekipi nuk i ka drejt. Po kështu të dilet edhe me zotime e të tregohen masat që janë marrë e do të merren për realizimin e detyrave.

Ju, shokë të Komitetit të Partisë të Gjirokastrës, të keni parasysh se ai rreth ka rëndësi të madhe politike dhe ekonomike. Rëndësia politike e Gjirokastrës qëndron në faktin se ajo ndodhet në Jug dhe afër me Greqinë monarko-fashiste, e cila zhvillon një propagandë të dendur dhe të organizuar kundër nesh. Nga ana ekonomike Gjirokastra ka rëndësi se ka një popullsi relativisht të madhe me një nivel kulturor të ngritur, pra atje jeton një popull me kërkesa të shumanshme. Por zhvillimi ekonomik në Gjirokastër nuk ka ecur paralel me ekzigjencat e popullit. Sa më të kulturuar të jenë njerëzit, aq më tepër kërkesa do të kenë, prandaj kur nuk shfrytëzohen të gjitha mundësitë e rrethit për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit, atëherë në masat do të ketë edhe pëshpëritje, edhe pakënaqësi. Prandaj duke marrë parasysh rëndësinë ekonomike dhe politike të rrethit të Gjirokastrës, ju që punoni në krye të kësaj krahine duhet ta organizoni punën më mirë.

Gjirokastra është një krahinë e cila edhe tani ka mjaft karakteristika që ju duhet t'i keni parasysh. Këto karakteristika nuk qëndrojnë vetëm në faktin se në

këtë rreth ndodhet minoriteti grek. Veçoritë janë për shembull edhe midis qytetarëve, kurveleshasve etj. Të tjera karakteristika ka Lunxhëria, të tjera Zagoria. Prandaj këto veçori ju duhet t'i mbani parasysh dhe të ndërtoni punën në përputhje me to.

Dikur, qyteti i Gjirokastrës rronte me nëpunësi, popullsia e saj nuk e përfillte zanatin dhe aq më pak bujqësinë. Por edhe para pushtetit tonë popullor ky mentalitet kishte filluar të ndryshonte. Ky ndryshim pikëpamjesh është bërë këtu e 40-50 vjet përpara, kur edhe myslimanët e qytetit filluan dalngadalë të punojnë. Më përpara punonin vetëm të krishterët. Por gjirokastritët, jo vetëm ata që kishin ara, po edhe të tjerë e familjet e tyre përpiqeshin të punonin sa më pak, sepse tendenca ishte t'i dërgonin fëmijët e tyre në shkollë për të mësuar. Tani ky mentalitet ka ndryshuar për shkak të krijimit të marrëdhënieve socialiste në prodhim, sepse ai që s'punon s'ha. Pra tani, në Gjirokastrë, krahas traditave për mësim ka edhe një terren të favorshëm për punë.

Përbuzja nacionale në Gjirokastrë kundrejt minoritetit grek ka qenë e gërshctuar me shtypjen klasore nga ana e regjimeve antipopullore. Por në këtë rreth ka zotëruar kurdoherë qëndrimi patriotik i popullit, dashuria për atdheun, për Shqipërinë, dhe urrejtja ndaj monarko-fashizmit grek, armik i vendit tonë. Mirëpo, duke urryer Greqinë monarko-fashiste, disa qytetarë në kohët e kaluara, e kanë parë minoritetin me një sy tjetër, sikur banorët e tij janë me Greqinë. E vërteta është se kombësia e banorëve të minoritetit është greke, por nënshtetësia e tyre është shqiptare.

Çështjen e të drejtave të minoritetit grek, që të ruajë gjuhën e tij, duhet ta kemi të qartë. Kur shkoj ndonjëherë në Gjirokastrë, disa pleq, që i kam të afërt, më thonë: «More Enver, këtu në qytet, në zyrat që vemi si shumë dropullitë ka, sikur nuk ka djem e vajza nga qyteti». Këto fjalë të një ose të disa pleqve nuk kanë ndonjë rëndësi, po fakti është se ekziston problemi, në një rreth njerëzish ka një koncept jo shumë të drejtë mbi minoritarët, nuk kuptohen mirë nga të gjithë të drejtat që ka minoriteti grek, të drejta këto që rrjedhin nga politika marksiste e Partisë sonë për çështjet nacionale. Ata që thonë: përse të jenë nëpër zyrat e pushtetit kaq shumë nga Dropulli, nuk e kanë kuptuar vijën e Partisë e politikën e shtetit tonë socialist. Në qoftë se këto çështje nuk sqarohen nga Partia, ka rrezik që të ringjallen ndjenjat e dikurshme nacionaliste. S'është e drejtë pikëpamja që në qytet të mos ketë njeri fare nga Dropulli. Natyrisht, njerëzit nga fshati tërhiqen me kritere të caktuara, me plan. Në bazë të vijës së Partisë e të Kushtetutës së Republikës minoriteti grek trajtohet njësoj me popullin shqiptar. Po ta shohim edhe gjuhën në këtë prizëm, minoriteti ka të drejtë të flasë greqisht, sepse ajo është gjuha amtare, po duhet mbajtur parasysh që në bazë të ligjeve të shtetit në zyra duhet të flitet shqip, sepse kjo është gjuha zyrtare. Ka të drejtë ai që është nga Gjirokastra, Lunxhëria apo nga Kurveleshi të revoltohet, kur sheh që shokë nga minoriteti, me funksione në zyrat e pushtetit tonë popullor, nuk flasin shqip. Në këto raste, mund t'i thuhet atij që flet greqisht: Ti je qytetar i Republikës Popullore të Shqipërisë, je anëtar

partie, prandaj këtu në zyrat e pushtetit fol shqip, sepse njerëzve të popullit nuk u vjen mirë që ti flet greqisht. Dhe jam i bindur se minoritarët, si patriotë e revolucionarë, këtë vërejtje do ta kuptojnë drejt.

Minoriteti grek në rrethin e Gjirokastrës, Dropulli dhe Pogoni, ka edhe probleme të veçanta. Për këtë arsye nuk mund të bëhet në këtë zonë një punë shabllone, duke vepruar njëllor si dhe në krahinat e tjera ose në qytet. Fshatrat e minoritetit grek janë të qytetëruara. Prandaj në këtë krahinë udhëheqja e rrethit të bëjë një punë të organizuar mirë, të kualifikuar.

Në fshatrat e Dropullit ne kemi plot suksese, janë bërë përmirësime kolosale. Forcimi i gjendjes ekonomike si kudo në vendin tonë dhe puna ideopolitike që ka zhvilluar Partia në këtë zonë, kanë ndikuar jashtëzakonisht në zhdukjen e shumë paragjykimeve fetare ose shoviniste. Po puna nuk mbaron me kaq. Pakica kombëtare greke duhet çdo ditë e më shumë të shohë gjëra të mira nga Partia, të shohë në radhë të parë ngrohtësinë e organeve e të kuadrove drejtues në rreth, prandaj t'u qëndrohet afër dhe të bëhet një punë politike me masat e gjera. Por në minoritet kërkohet të zhvillohet një punë politike e veçantë. Duhet mbajtur mirë parasysh se propaganda monarko-fashiste greke synon të zhvillojë shovinizmin grek. Prandaj është e domosdoshme që të luftohet si duhet kundër kësaj propagande armiqësore, për të shpëtuar njerëzit nga helmi i saj.

Në Gjirokastrë ka shokë që kanë mbaruar shkolla të larta partie, midis të cilëve edhe shoku Kristo Sharra, i cili është kandidat i KQ të Partisë sonë dhe duke qenë vetë minoritar ka mundësi që bashkë me shokë të ndih-

mojë më shumë në zhvillimin e një pune politike më të gjerë në minoritet. Përveç kësaj, në rrethin e Gjirokastrës janë tërë ata kuadro të vjetër, që kanë një praktikë të gjatë drejtimi. Prandaj ju, shokë sekretarë të komitetit të Partisë të rrethit, keni përgjegjësi për dobësitë dhe të metat që janë konstatuar në Gjirokastrë. Për një punë më të gjerë politike në fshatrat e minoritetit grek, mund të veprohet më me efektivitet edhe nëpërmjet gazetës «Laiko Vima», seminareve me sekretarët e organizatave-bazë të Partisë etj. Po të udhëzohen mirë sekretarët e organizatave-bazë si ta bëjnë propagandën e Partisë në popull, po të sinjalizohen e të orientohen ata se ku rreh propaganda e armikut dhe ç'qëndrim duhet të mbajnë, si t'ia shpjegojnë popullit realitetin e vendit tonë etj., atëherë do të kemi rezultate të mira në kundërpropagandën tonë.

Përsa u përket çështjeve politike në krahina të tjera të rrethit, puna ndryshon. Për shembull, në Kurvelesh nuk ekziston më problemi «turq e kaurrë». Thirrjeve të Partisë populli u përgjigjet menjëherë, kurveleshasi e ka kurdoherë në krah dyfekun. Kurveleshi, Lunxhëria dhe Zagoria kanë qenë tri krahina shumë të varfëra, atje njerëzit, për të siguruar bukën, kanë luftuar e kanë punuar në gur dhe në strall.

Tjetër problem me rëndësi në Gjirokastrë janë çështjet ekonomike. Ne e dimë gjendjen e Gjirokastrës, po kur ju, shokë të rretheve, vini përpara Sekretariatit të Komitetit Qendror, duhet të na bëni një pasqyrë nëse ka apo jo njerëz që s'janë në marrëdhënie pune në qytet, ç'u bë me kooperativën bujqësore të qytetit, e cila u prish, ç'u bë me ata qindra njerëz, ku punojnë,

si rojnë, jeni interesuar për t'i sistemuar në punë etj. Ky është një problem ekonomik i rëndësishëm që duhet ta kishit parasysh, se shumë nga këta njerëz atje nuk kanë edhe ku punojnë. Në përgjithësi në Gjirokastrë ka pak njerëz që s'janë në marrëdhënie pune dhe ky qytet nuk bën ndonjë përjashtim nga qytetet e tjera.

Ju duhet të përfitoni nga përvoja e gjirokastritëve në çështjet ekonomike. Ata kanë tradita të mira nikoqirllëku. Kur familja gjirokastrite ka në punë edhe një njeri të vetëm, di ta rregullojë jetën e vet. Megjithatë ju duhet të mendoni ku mund të hapen fronte të reja pune, se kurdoherë do të ketë njerëz, sidomos të rinj, të cilët kanë prirje për të ndjekur shkolla dhe për t'u larguar edhe nga rrethi. Gjirokastritët largohen lehtë nga rrethi dhe kjo është bërë traditë e keqe, për shkak se në të kaluarën «nuk i mbante vendi» të gjithë. Pra edhe tani, megjithëse janë krijuar disa mundësi, të rinjtë gjirokastritë mund të venë të punojnë jashtë qytetit, në radhë të parë në fshatrat e rrethit, si teknikë bujqësorë e agronomë, si punonjës të shëndetësisë, të arsimit etj. Prandaj plani i kurseve e i shkollave të plotësohet me elementë nga fshatrat, po edhe nga qyteti, se ata që dërgohen në universitet, shumica janë gjimnazistë, pra qytetarë. Është e vërtetë se në shkolla të mesme e të larta venë edhe nga fshati, po ne nuk duhet të bazohemi vetëm te fshatarët për plotësimin e nevojave të fshatit. Fshatin duhet t'ua bëjmë të dashur të gjithëve, edhe qytetarëve. Në qytete ka shumë djem e vajza dhe të gjithë nuk pregatiten për qytetin. Prandaj t'u futet dëshira të rinjve për të vajtur në fshat. Kjo është një punë e tërë edukative që duhet të zhvillohet

nga Partia, nga rinia, nga shkolla, në mënyrë që njerëzit të shkojnë të punojnë edhe në fshat, se edhe atje populli ka nevojë të zhvillohen bujqësia, arsimiti, kultura, shëndetësia etj.

Një kujdes i veçantë të tregohet edhe për zonat e malësisë së Gjirokastrës, për zhvillimin e tyre ekonomik si të atyre degëve tradicionale, që sigurojnë të ardhura për këto zona, ashtu edhe për të gjetur burime të reja ekonomike, që ndihmojnë për zhvillimin e një bujqësie intensive.

Në përgjithësi organizata e Partisë në Gjirokastrë është e fortë. Kryesorja është që njerëzit të lidhen me punën, komunistët të jenë në ballë, në radhë të parë të punojë më mirë udhëheqja në rreth, e cila të organizojë si duhet punën në të gjitha fushat: ekonomike, politike, ideologjike, shoqërore etj. Puna konkrete do të ndihmojë për të gjykuar më mirë mbi njerëzit dhe nuk do të ketë vend për thashetheme. Këto i zhduk puna, ndryshe, një njeri që qëndron pa punë, zhvillon parazitizmin, thashethemet, kuriozitetin e sëmurë etj.

Forcimi i punës së Partisë në atë rreth kërkon përmirësimin e drejtimit nga ana e sekretarëve të komitetit të Partisë. Në radhë të parë, ti, shoku Seit, si sekretar i parë, që je një shok i mirë, i vjetër, duhet të jesh më i shkathët. Ndodh që javashllëku ka të mirën e tij, sepse problemet duhen menduar pak dhe nuk duhet të gjykohen me rrëmujë. Mirëpo kur javashllëku teprohet, atëherë puna dëmtohet. Natyrisht, ju duhet të mbështeteni shumë në organizatat-bazë të Partisë, po nuk ka asnjë arsye që të mos shkoni në organizatat

profesionale, të cilat kanë një rëndësi të madhe, prandaj i bëni këto mbështetje të fuqishme të punës së Partisë, i bëni ato organizata të gjalla masash. Kështu duhet të jenë edhe organizatat e gruas e të rinisë. S'është aspak e drejtë që ju të mos shkoni atje asnjëherë, njerëzit duan t'ju shohin e t'ju dëgjojnë.

Pra, rishikojeni metodën e punës suaj, mos jini sektarë. Le të marrim shembullin e atij komunistit në Polican, që bëri pyetjen: «Doli gjë vendi ynë nga Traktati i Varshavës?». Po të isha unë në vendin tuaj nuk do ta dënoja këtë komunist për një pyetje të tillë. Nuk mendoj se ai e ka bërë pyetjen me qëllim të keq. Ai, para se të pyeste, mund të jetë nisur nga mendimi që çështjen e qenies ose të largimit tonë nga Traktati i Varshavës, ndoshta, nuk është momenti të na e thotë Partia, prandaj vendosi të pyesë dhe pyetjen e bëri në Parti. Por kjo nuk do të thotë që armiqtë të lejohen të livadhisin. Armiqve u duhet rënë në kokë, të mbrohet Partia, por njerëzit e popullit të sqarohen. Çdo gjë ne e kemi të hapur. Edhe çështjen e marrëdhënieve me udhëheqjen sovjetike, që është shumë delikate, ne ia thamë Partisë, direkt dhe indirekt kemi vënë në dijeni edhe popullin dhe mendoj se nuk kemi bërë keq, bile kemi bërë shumë mirë. E meritonte grupi i Hrushovit dhe ata që e pasojnë këtë demaskim, sepse veprimtaria e tyre është shumë e rrezikshme për komunizmin ndërkombëtar, veçanërisht për vendin tonë. Ata i kanë vënë vetes detyrën që të shkatërrojnë Republikën Popullore të Shqipërisë dhe udhëheqjen e saj. Prandaj ne vepruam me ta ashtu si e meritonin.



Seiti vetë nuk është nga Gjirokastra, po shokët e tjerë të udhëheqjes së rrethit që janë vendës, të kenë kujdes që të luftojnë në çdo rast akraballëqet dhe kushërillëqet.

*Botohet për herë të parë me  
ndonjë shkurtim, sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverballi i  
mbledhjes së Sekretariatit të  
KQ të PPSH që gjendet  
në AQP*

**PARTI E RINI, SI KURDOIERË, TË PUNOJMË,  
TË MËSOJMË E TË VIGJËLOJMË NË UNITET TË  
ÇELIKTË, NË SOLIDARITET DHE BESNIKËRI  
TË PATUNDUR**

*Fjala e mbylljes në Plenumin IV të përbashkët  
të KQ të PPSH dhe të KQ të BRPSH<sup>1</sup>*

**26 shtator 1961**

Të dashur shokë,

Të gjithë jemi shumë të gëzuar që marrim pjesë në këtë mbledhje të përbashkët për shqyrtimin e problemit të rinisë dhe për të marrë masa që të arrijmë rezultate

---

<sup>1</sup> Plenumi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH «Kongresi IV i PPSH dhe detyrat për edukimin komunist e mobilizimin e mëtejshëm të rinisë për ndërtimin e plotë të socializmit në vendin tonë», mbajtur nga shoku Rita Marko, anëtar i Byrosë Politike dhe në atë kohë sekretar i KQ të PPSH. Ishin të ftuar sekretarët e parë të komiteteve të Partisë dhe sekretarët e parë të komiteteve të BRPSH të rretheve, si dhe punonjës të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë dhe të Komitetit Qendror të BRPSH.

edhe më të mëdha në forcimin e organizatës së BRPSH, në interes të popullit dhe të rinisë sonë heroike.

Sikurse u shprehët edhe ju, kjo mbledhje ka rëndësi të madhe. Byroja Politike e Komitetit Qendror mendon se u bë mirë që Komiteti Qendror i Partisë dhe ai i BRPSH diskutojnë së bashku për këtë problem me rëndësi që preokupon Partinë. Këtu morën pjesë mjaft shokë e shoqe që punojnë me rininë, në vend që të vinin vetëm 2-3 përfaqësues nga Komiteti Qendror i BRPSH. Natyrisht, të tilla mbledhje të përbashkëta për probleme të caktuara nuk duhet të jenë të shpeshta, sepse Plenumi i Komitetit Qendror të BRPSH ka inisiativën e vet. Organizata e BRPSH duhet të bëhet gjithnjë e më e aftë për të zgjidhur problemet e mëdha politike, ekonomike e kulturore që i dalin përpara. Ne kemi besim se ajo, nën udhëheqjen e Partisë, ashtu siç e ka kryer deri tani, do ta kryejë më së miri edhe në të ardhshmen këtë detyrë.

Sivjet kemi njëzetvjetorin e themelimit të Partisë sonë të lavdishme, e cila ngriti dhe mobilizoi popullin tonë në luftë kundër pushtuesve dhe tradhtarëve të vendit. Edhe organizata e rinisë sonë të lavdishme është moshatare me Partinë, sepse ajo u themelua pothuajse menjëherë pas krijimit të Partisë.

Më kujtohen vitet e para pas Çlirimit, kur na shtroheshin detyra të mëdha për ndërtimin e vendit të shkatërruar, për ngritjen e industrisë, të bujqësisë dhe të shkollave. Të gjithë atëherë ishim të rinj dhe veçanërisht shokët e rinisë thoshin se e kishin të vështirë t'u imponoheshin atyre që ishin në moshë më të madhe. Përsa i përket «gishtit», domethënë trimërisë gjatë

Luftës Nacionalçlirimtare të rinjtë ishin në lartësinë e duhur. Me luftën e tyre heroike, ata treguan sa shumë genë të lidhur me Partinë dhe me popullin, ç'sakrificatë mëdha bënë për t'i dhënë popullit fitoren. Nën udhëheqjen e Partisë, të rinjtë luftuan në mënyrë të tillë që edhe ata të moshuar që s'kishin besim, t'u ngrinin atyre kapelen. Pas Çlirimit shtrohej çështja e rindërtimit të vendit dhe e ndërtimit të bazave ekonomike të socializmit dhe kjo nuk ishte një punë e lehtë. Por Partia kishte besim të madh te rinia dhe i thoshte asaj se njerëzit e moshuar do të kuptojnë se ç'forcë e madhe qëndron te Partia dhe te të rinjtë tanë edhe në periudhën e rindërtimit dhe të ndërtimit socialist të atdheut. Pas Çlirimit Partia thoshte se duhet të mësojmë ne vetë, komunistët, e pastaj ne do të mësojmë edhe rininë si të punojë e të ndërtojë dhe nuk do të jetë e largët koha kur njerëzit e moshuar, jo vetëm do t'i dëgjojnë më me vëmendje të rinjtë, por do të pranojnë edhe të udhëhiqen prej tyre në punët e ndryshme të shtetit, të ekonomisë dhe të shkollave. Dhe kështu ngjau.

Pas Çlirimit, organizata e BRPSH, nën udhëheqjen e Partisë, ka dhënë prova të shumta zotësie, pjekurie dhe guximi në ndërtimin socialist të atdheut. Këtë ajo e ka bërë se i ka pasur sytë dhe zemrën vazhdimisht te Partia, ka ndjekur dhe ka zbatuar me besnikëri mësimet e Partisë, prandaj ka kryer me sukses çdo detyrë që i ka ngarkuar ajo. Partia ka te organizata e BRPSH një nga organizatat më të forta e më të lavdishme, prandaj është krenare, ashtu si janë krenarë për fëmijët e tyre ata prindër që i kanë rritur, i kanë edukuar dhe i kanë bërë të vlefshëm për popullin. Kështu, kur fëmijët

arrijnë moshën 20-25-vjeçare prindërit e tyre ndiejnë një gëzim të veçantë për ta, sepse tani u janë bërë shokë, u janë bërë mbështetje kryesore në gëzime e hidhërime, në halle dhe në çaste të lumtura. Këtë gëzim ndien tani edhe Partia për organizatën e Bashkimit të Rinisë. Dhe pikërisht për këtë, në çdo punë që ndërmerr Partia bashkë me këtë levë të saj, ndihet uniteti i çelikut, solidariteti gjer në fund, dashuria e madhe për njëra-tjetrën, besnikëria e pafund e rinisë për Partinë dhe kujdesi i madh i Partisë për rininë. Pikërisht kjo forcë e madhe shihet edhe në këtë Plenum të përbashkët.

Ne, shokë, po ndërtojmë socializmin. Në këtë etapë të jetës së vendit tonë Partia nuk e ka hedhur kot parullën: «Në njërin dorë kazmën dhe në tjetrën pushkën». Brezit tonë i duhet ta vazhdojë, në forma të ndryshme, luftën për mbrojtjen e interesave të popullit, për mbrojtjen e socializmit dhe të marksizëm-leninizmit, sepse ekziston akoma armiku i betuar i popujve, i socializmit dhe i marksizëm-leninizmit, imperializmi, me atë amerikan në krye, si dhe veglat e aleatët e tij, revizionistët modernë, të cilët i kanë vënë detyrë vetes të shkatërrojnë socializmin dhe lëvizjen komuniste e punëtorë. Prandaj jo vetëm ne komunistëve shqiptarë, po të gjithë komunistëve të botës u duhet ta vazhdojnë me vendosmëri luftën kundër këtyre armiqve të betuar të marksizëm-leninizmit.

Ne mund të themi se tani jemi në fazën e një lufte të re të madhe sa edhe Lufta Nacionalçlirimtare. Populli shqiptar dhe Partia e Punës e Shqipërisë bënë Luftën Nacionalçlirimtare, gjatë së cilës shumë nga shokët tanë,

bij të këtij populli, u vranë, armiku dogji me zjarr e hekur atdheun tonë, por ne fituam dhe menjëherë ia filluam ndërtimit të jetës së re. Edhe pas Çlirimit na u desh të luftonim përsëri dhe me të gjitha forcat tona kundër imperialistëve, shteteve kapitaliste dhe kundër armiqtë të rinj që na dolën, revizionistëve jugosllavë. Edhe kjo luftë e dytë ishte një luftë e ashpër. Por, në këtë kohë ekzistonte një forcë e madhe e vendosur kundër armiqtë të socializmit, Bashkimi Sovjetik dhe Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, e udhëhequr nga Komiteti Qendror me Josif V. Stalinin në krye, me atë burrë të lavdishëm për të cilin Anri Barbysi, autor i njohur i veprës «Zjarri», në një nga librat e tij shkruan se në Kremlin jeton një njeri i madh, një kokë e shquar dijetari, me fytyrë punëtori dhe rroba ushtaraku të thjeshta, që e do shumë njerëzimin dhe që edhe njerëzimi e do shumë dhe ka besim të madh te ai. Kur e ka shkruar këtë vepër Anri Barbysi ishte një luftëtar i vendosur kundër luftës, jopacifist si Hrushovi. Vepra kryesore e tij, «Zjarri», shpreh urrejtjen e thellë kundër luftërave imperialiste, zbulon shkaqet dhe tregon rrugën si duhet luftuar kundër tyre.

Kur Anri Barbysi shkroi veprën e tij «Zjarri» nuk ishte komunist, por ai u bë komunist në kohën më të vështirë për Partinë Komuniste të Francës, atëherë kur borgjezia reaksionare arrestoi udhëheqësit e saj dhe ajo ishte e detyruar të hidhej në ilegalitet. Pikërisht në këtë kohë të vështirë Barbysi deklaroi se ishte anëtar i Partisë Komuniste të Francës. I tillë ishte ai, njeri që luftonte për njerëzimin, për paqen, për progresin shoqëror. Barbysi kishte besim të madh te J. V. Stalini, për

arsye se Stalini luftonte me konsekuencë në rrugën e Leninit, për triumfin e revolucionit e të socializmit në Bashkimin Sovjetik. Stalini luftoi me të gjitha forcat e mendjes e të shpirtit të tij për të shkatërruar brenda në Bashkimin Sovjetik armiqtë e revolucionit dhe të socializmit, të cilët ishin agjenturë e vërtetë e imperializmit dhe e intervencionistëve. Ai luftoi me vendosmëri të pashoqe kundër trockistëve, buharinistëve, zinovievistëve dhe bandave të tjera që kishin për qëllim të likuidonin Bashkimin Sovjetik, atdheun e parë të socializmit në botë. Njerëzit përparimtarë e donin Stalinin, sepse ai udhëhoqi luftën e madhe antifashiste, kundër nazizmit gjerman. Lufta e popujve sovjetikë, të udhëhequr nga Partia e Leninit, me Stalinin në krye, ndihmoi në çlirimin e popujve nga robëria fashiste dhe te ne e në vende të tjera të Evropës dhe të Azisë u vendos rendi i demokracisë popullore. Për këtë arsye e donin, e duan dhe do ta duan popujt J. V. Stalinin, nxënësin besnik të V. I. Leninit.

Lufta që është bërë nga Partia jonë dhe nga gjithë komunistët e botës kundër titistëve kishte mbështetjen e madhe të PK të BS. Ju, shokë të Partisë dhe të rinisë, e dini me sa urtësi të madhe e njëkohësisht me sa mprehtësi të pagabueshme marksiste-leniniste J. V. Stalini dhe KQ i PK të BS ndërmorën zgjidhjen në rrugë të drejtë të çështjes jugosllave. Udhëheqësve jugosllavë në fillim iu dha dora, ata u kritikuan në rrugë marksiste. PK e BS dhe partitë e tjera që qëndronin në pozita të drejta marksiste-leniniste u përpoqën që grupi revizionist i Beogradit të ndryshonte rrugën që kishte nisur. Por gabimet e këtij grupi i kishin rrënjët e

thella, prandaj ai vazhdoi të ecte në rrugën e tradhtisë, jashtë binarëve të marksizëm-leninizmit.

Aktualisht ne ndodhemi përsëri në një luftë tjetër kundër imperializmit dhe revizionizmit modern. Askush nuk duhet të mendojë se në këtë luftë jemi vetëm, të izoluar. Jo, ne nuk jemi vetëm. Por tani veç një gjë ndryshon. Në udhëheqjen e PK të BS nuk është më J. V. Stalini, nuk janë më shokët e tij marksistë që kishin dhënë prova në luftën e madhe për triumfin e socializmit, në luftën e madhe kundër pushtuesve fashistë. Tani në udhëheqje të PK të BS ka ardhur një grup i egër revizionist. Janë me miliona komunistë në botë që e shohin qartë se popullit sovjetik i kanë hedhur duart në grykë një klikë tradhtarësh, renegatë të marksizëm-leninizmit, të cilët, ashtu si paraardhësit e tyre — Bernshtajni, Trocki, Kautski e të tjerë luftojnë kundër komunizmit të maskuar me flamurin e marksizmit.

Ç'ka bërë Hrushovi dhe si erdhi në fuqi? Ky është një fakt i hidhur. Ne e kemi të qartë si erdhi ai në krye të PK të BS. Është e padiskutueshme se Hrushovi erdhi në fuqi me intriga e dallavere prej trockisti. Ai diti ta shfrytëzojë çdo dobësi që mund të ketë ekzistuar në udhëheqjen e PK të BS, pas vdekjes së Stalinit, çdo kontradiktë që ka ekzistuar midis tyre dhe i ka vënë kështu njërin kundër tjetrit, duke shpifur, për të krijuar një situatë të paqëndrueshme në Komitetin Qendror. Dihet që sa ishte gjallë J. V. Stalini, Hrushovi, ky renegat i marksizmit, bërtiste më shumë se kushdo tjetër për gjenialitetin dhe zotësinë e Stalinit. Merrni fjalimin e fundit të Hrushovit në Kongresin XIX të PK të BS dhe do të shihni se ai dhe shokët e tij si



Mikojani etj. më shumë se kushdo i thurin lëvdata Stalinit, pikërisht lëvdata të tilla me të cilat sot ata akuzojnë komunistët e vërtetë se gjoja po zhvillojnë kultin e Stalinit.

Qëllimi kryesor i Hrushovit dhe i atyre që e pasojnë ishte të diskreditonin J. V. Stalinin dhe të shkurorëzonin veprën e tij, se kështu do të shkurorëzonin veprën e madhe të Leninit, veprën e madhe të PK (b) të BS, që, për një periudhë të gjatë, kur ishte në krye Stalini, është e mbushur me sakrifica, luftëra e fitore të panumërta kundër imperializmit dhe agjenturave të tij të shumta.

Këtij qëllimi Hrushovi ia arriti në rrugë agjenturale dhe me intriga. Po të lexoni me kujdes goditjen që i bëhet Stalinit, do të shihni se ai nuk ka guxuar të atakonte veprën e tij të gjallë. Me akuzat në raportin «sekret» kundër Stalinit, mbajtur në Kongresin XX, Hrushovi dhe shokët e tij i dhanë një armë imperializmit, me qëllim që ky të kuptonte se këta që kanë ardhur tani në fuqi në BS nuk janë si Stalini, por njerëz me të cilët mund të bisedohet dhe ndonjë ditë të arrihet në ujdi.

Hrushovi në këtë raport e nxjerr J. V. Stalinin si kriminel. Por Stalini nuk ka bërë krime gjatë jetës së tij, kurse sipas Hrushovit dhe atyre që e pasojnë, Stalini tërë jetën, s'paska bërë gjë tjetër veçse ka vrarë dhe ka prerë njerëz të pafajshëm, paska akuzuar njerëz si agjentë të imperializmit dhe tradhtarë të marksizëm-leninizmit dhe pastaj i paska pushkatuar! I gjithë raporti në këtë frymë është ndërtuar.

Para se të mbahej ky raport u bë gjyqi kundër

Berias, të cilin Hrushovi e akuzoi dhe e pushkatoi si agjent të imperializmit. Se ç'ka qenë Beria neve kjo s'na intereson, sepse është një çështje e brendshme e Partisë Komuniste dhe e shtetit të Bashkimit Sovjetik, por ajo që duam të themi është se raporti «sekret» që u mbajt në Kongresin XX e akuzonte Stalinin se nuk ishte gjë tjetër veçse një njeri të cilin Beria e hiqte për hunde!

Hrushovi dhe njerëzit e tij kanë shkuar edhe më tutje. Ata kanë thënë me gojën e tyre se Stalini, duke mos u përgatitur kundër Hitlerit, i paska shërbyer fashizmit, se nënshkrimi i traktatit të vitit 1939 me Gjermaninë qenkej një ndihmë e madhe për fashizmin! Akuza të tilla krejtësisht pa baza, Hrushovi dhe grupi i tij nuk i bëjnë vetëm kundër Stalinit, ata veprojnë me të njëjtën mënyrë edhe kundër të gjithë atyre që po godasin tradhtinë e tyre të madhe. Të tilla metoda trockiste duken çdo ditë e më shumë në punën e Hrushovit.

Raporti «sekret» i mbajtur në Kongresin XX ishte shumë tronditës për gjithë komunistët e vërtetë të botës, të cilët u revoltuan kur dëgjuan përmbajtjen e tij plot shpifje e trillime kundër Stalinit, sepse me emrin e Stalinit në gojë kemi luftuar ne, komunistët shqiptarë dhe miliona komunistë revolucionarë në mbarë botën. Stalini nuk ishte vetëm udhëheqës i Bashkimit Sovjetik, por udhëheqës i proletariatit ndërkombëtar, prandaj si merren këto vendime kundër tij pa pyetur? Po Hrushovi e bëri këtë gjë *fetakompli*.

Hrushovi thurte plane edhe për masa të tjera kundër Stalinit, por nuk guxonte ta atakonte politi-

kisht dhe ideologjikisht atë dhe kurrë nuk do të arrijë ta rrëzojë veprën e tij, prandaj u kap vetëm nga njëra anë, nga ana e gjyqeve që u zhvilluan në kohën e Stalinit kundër armiqve të BS dhe që me siguri vendimet e tyre ishin të drejta. Merrni me mend sikur te ne të vijnë në fuqi tradhtarët e Partisë, trockistët, ata do të marrin dosjet e armiqve të Partisë e të popullit që kanë bërë krime dhe poshtërsi të mëdha kundër popullit, që kanë dashur të shesin atdheun dhe Partinë dhe me siguri do të thonë: «Ja këta njerëz të mirë i ka vrrarë kot udhëheqja shqiptare»! Kështu ka vepruar dhe N. Hrushovi me trockistët dhe kriminelët e Bashkimit Sovjetik, për të cilët hapi dosjet e gjyqeve të tyre, i mori në mbrojtje dhe i rehabilitoi. Kjo është e turpshme, po Hrushovi nuk kishte si bënte ndryshe. Këtij tradhtari të marksizëm-leninizmit i duheshin armiqtë dhe tradhtarët e tjerë, sepse do të gjente në ta mbështetjen kryesore për të qenë në fuqi.

Hrushovi nuk mori në mbrojtje vetëm tradhtarët e PK të BS, trockistët, buharinistët, zinovievistët e të tjerë, por edhe të gjithë kundërrevolucionarët në botë. Shpejt e shpejt, pas Kongresit XX të PK të BS, ai bëri, siç e ka zakon, disa mbledhje, në të cilat, duke shfrytëzuar faktin se disa udhëheqës partish akoma nuk i dinin qëllimet e vërteta të Hrushovit, deklaroi se Kominterni paskej gabuar me vendimin që kishte marrë kundër partisë polake. Bieruti, pa u thelluar, pranoi dhe menjëherë kjo çështje u botua edhe në gazeta. Pastaj u tha se Bela Kumi gjoja ishte pushkatuar kot, edhe kjo u botua në gazetë. Më vonë këto u pasuan nga gjëra të tjera.

Është fakt se në letrat që Hrushovi i ka dërguar Komitetit Qendror të Partisë sonë provohet se ai ka marrë nën sjetull jo vetëm miqtë e tij Liri Belishovën dhe Koço Tashkon, po gjithë kundërrevolucionarët që janë dënuar nga Partia jonë. Dhe tani së fundi për këtë punë ai ka lëshuar kundër nesh lakeun e njohur të tij Teodor Zhivkovin dhe të përkëdhelurin Janosh Kadarin, të cilët, në frymën e tij, akuzojnë Partinë tonë se ka dërguar në gjyq dhe ka pushkatuar njerëz «të lavdishëm», «komunistë shqiptarë», sigurisht e kanë fjalën jo vetëm për grupin e Teme Sejkos, po edhe për armiq-të e tjerë.

Grupi revizionist i Hrushovit ka goditur gjithashtu edhe të gjithë udhëheqësit e vjetër sovjetikë që kishin mbetur pas Stalinit, si Molotovin me shokë. Që Hrushovi t'i kishte duart të lira duhej të pastroheshin këta nga rruga e tij. Në fillim ai thoshte se në Komitetin Qendror ka mjaft nuanca në pikëpamjet e udhëheqësve dhe kuptohet se atëherë ai përgatiste likuidimin e këtyre udhëheqësve. Nuk mendohej që këta shokë bolshevikë më tradita dhe eksperiencë të madhe revolucionare dhe që gëzonin respektin dhe përkrahjen e gjithë partive dhe të popullit sovjetik, të tregoheshin kaq naivë ndaj veprimeve të N. Hrushovit, pavarësisht se ndonjëri mund të kishte bërë ndonjë gabim. Ata gjersa e lejuan këtë grup revizionistësh dhe armiqsh të vinte në fuqi dhe të shkurorëzonin veprën e madhe të Leninit dhe të Stalinit, u treguan miopë dhe jovigjilentë për të parandaluar këtë të keqe, prandaj, me gjithë respektin që kemi, ata mbajnë përgjegjësi të madhe përpara popullit sovjetik dhe komunizmit ndërkombëtar, sepse sot

ky grup armiqsh që ka ardhur në fuqi në Bashkimin Sovjetik, po përgatit një komplot të tmerrshëm kundër revolucionit proletar dhe komunizmit. Grupi i Hrushovit, pra, likuidoi edhe shokët e vjetër të Stalinit duke l akuzuar si elementë antiparti që donin të rrëzonin Hrushovin jashtë «rregullave demokratike» të Partisë. Partia jonë i njeh mirë këto metoda, ajo ka një eksperiencë të madhe në luftën kundër revizionizmit, sepse, që kur është krijuar, ka zhvilluar dhe po zhvillon një luftë të ashpër kundër tij. Këto çështje Partia jonë i analizon kurdoherë me kujdes dhe në dritën e fakteve.

Por ka njerëz që thonë: ç'i duhet Partisë së Punës të Shqipërisë, që është një parti e vogël, t'i hyjë kësaj pune? Këta njerëz janë naivë dhe një pikëpamje e tillë nuk është aspak marksiste. Marksizmi nuk njeh të madh e të vogël. Për Komitetin tonë Qendror kanë rëndësi të madhe çështja e popullit, e Partisë, e marksizëm-leninizmit, çështje të cilat Partia do t'i mbrojë me konsekuencë deri në fund. I madh ose i vogël qofsh, në rast se nuk i mbron, atëherë bën krim edhe ndaj popullit, edhe ndaj Partisë, edhe ndaj marksizëm-leninizmit. Marksizëm-leninizmi nuk është monopol i një partie të madhe, po një armë e fuqishme e proletariatit, e partive komuniste, e të gjithë komunistëve të botës dhe e njerëzve përparimtarë që luftojnë për çlirimin e punonjësve nga zgjedha e kapitalit dhe e borgjezisë, për zhdukjen e klasave shfrytëzuese, për ndërtimin e socializmit dhe të komunizmit. Marksizëm-leninizmi është libër i hapur, prandaj le ta studjojmë e ta zbatojmë në praktikë, me frymë revolucionare, në kushtet e secilit vend, cilado parti, e vogël apo e madhe qoftë.

Domosdo, një parti e madhe, në qoftë se zbaton me konsekuencë marksizëm-leninizmin, ka një eksperiencë më të madhe. Po edhe partia e vogël ka eksperiencën e vet e të gjitha së bashku kontribuojnë në zhvillimin e marksizëm-leninizmit. Kurse N. Hrushovi mohon kontributin e partive tona për marksizëm-leninizmin dhe sipas tij del se askush përveç tij nuk paska ndihmuar për pasurimin e marksizmit! Ne themi se eksperiencia e një partie të madhe i shërben edhe një partie të vogël. Por themi se edhe eksperiencia e një partie të vogël i vlen një partie të madhe. Ne kemi thënë dhe do të vazhdojmë të themi se kemi mësuar nga eksperiencia e Partisë së madhe të Lenin-Stalinit dhe nga eksperiencia e partive të tjera, por kemi mësuar shumë edhe nga lufta dhe jeta e Partisë dhe e popullit tonë.

Njerëzit e lëkundshëm dhe kapitullantët thonë: «Po ç'na duhen neve qëndrime të tilla?». Po ne përgjigjemi: i mbajmë këto qëndrime se jemi marksistë, sepse marksizmi e shpëtoi dhe do ta shpëtojë popullin tonë, prandaj edhe në qoftë se jemi një Parti e vogël kemi të drejtë të themi pikëpamjen dhe fjalën tonë në rrugë partie, në rrugë marksiste. Dhe këtë fjalë ne e kemi thënë dhe do ta themi, pa marrë parasysh se jemi të vegjël ose të mëdhenj. Ata që duan të ecin drejt me siguri e bindje për të mirën e interesat e popullit të vet, qofshin të vegjël ose të mëdhenj, duhet të ecin kurdoherë në rrugën e caktuar nga Marksi, Engelsi, Lenini dhe Stalin.

Hrushovi, duke atakuar Stalinin, trumbeton vijën e re, kursin e ri të tij. Në këtë kurs të ri, jo vetëm personit të Stalinit, po gjithë jetës dhe sukseseve të BS

iu hodh një cipë e zezë. Në projektprogramin që është përgatitur për Kongresin XXII të PK të BS epoka e lavdishme e luftëtarëve heroikë që ndërtuan socializmin kalohet vetëm me një frazë. Hrushovi me këtë kërkon të na mbushë mendjen se BS ka ecur përpara vetëm pasi erdhi ai në fuqi. Realiteti i sotëm nuk e vërteton këtë. Bujqësia në BS tani nuk po realizon as rendimentet e 1939-s, domethënë të periudhës së paraluftës, kur populli sovjetik luftonte me vështirësi jashtëzakonisht të mëdha.

Po kush e ka fajin për këtë situatë? Sigurisht grupi revizionist i Hrushovit, i cili me rrugën e tij antimarksishte po e shpie Bashkimin Sovjetik në greminë. Për vështirësitë e mëdha që ka sot në Bashkimin Sovjetik, Hrushovi akuzon si fajtorë një numër kuadrosh, ndaj të cilëve merr masat më të rrepta deri në shkarkimin e tyre nga detyra. Taktika e tij është përgatitja e terrenit për të sjellë në postet kyçe njerëz të tij revizionistë, servilë, karrieristë. Ky proces është duke u zhvilluar tani në BS.

Hrushovi likuidoi gjithashtu edhe gjithë ata mareshalë dhe gjeneralë të shquar sovjetikë në Luftën e Dytë Botërore. Le të marrim shembullin e Rokosovskit, të cilin e shkarkoi nga funksionet. Ose mareshali Konjev, që u hoq nga posti i komandantit të Forcave të Armatosura Ushtarake të Bashkuara të Traktatit të Varshavës, gjoja si i sëmurë. Për këtë Hrushovi na njoftoi me një letër, me të cilën thoshte se ai hiqej nga detyra për arsye shëndetësore, duke treguar se në vend të tij caktohet mareshali Greçko. (Thonë se ky Greçkoja është kunati i Hrushovit). Më pas pamë se mareshali

Konjev nuk qënkej i sëmurë, sepse tani që u keqësua gjendja në Berlin, ai menjëherë «na u shërua» dhe u emërua atje komandant i forcave sovjetike. Po edhe kjo masë është një blufë e Hrushovit, që e përdor vetëm për interesat e tij.

N. Hrushovi vazhdon të ecë më tej në rrugën e tij antimarksiste, por do të dështojë. Natyrisht, ai nuk do t'i dorëzojë armët aq lehtë, armiku lufton gjer në fund. Por të jemi të sigurt se në BS do të ketë dhe revoltim kundër vijës antimarksiste të N. Hrushovit. Këtë e bazojmë në takimet e pakta që kanë pasur njerëzit tanë me njerëz sovjetikë, të cilët aprovojnë plotësisht vijën e Partisë sonë dhe manifestojnë disaprovimin, fshëhtazi ose heshtazi, të vijës së grupit të Hrushovit.

Hrushovi dhe ata që e pasojnë luftojnë ta shuajnë me një mijë e një dallavere, gënjeshtër dhe parulla pacifiste rezistencën kundër vijës së tij. Midis të tjerash, ai kërkon të frikësojë popullin sovjetik dhe popujt e botës me tezën e tij «ose paqe me lëshime imperializmit, ose luftë bërthamore që çon në likuidimin e njerëzimit». Hrushovi përgatit terrenin me mënyra nga më të ulëtat, duke shfrytëzuar faktin që popullit sovjetik gjatë Luftës së madhe Patriotike iu vranë rreth 20 milion bij të tij.

Gjatë kohës që Hrushovi ka ardhur në fuqi, në sajë të politikës revizioniste pacifiste të tij, imperializmi amerikan ka bërë hapa të mëdhenj në rrugën e armatimeve. Ju e dini se Gjermania e Bonit po bëhet një forcë e rrezikshme agresive. Imperializmi amerikan krahas me Gjermaninë Perëndimore ka armatosur dhe ka forcuar lidhjet edhe me të gjitha shtetet e tjera imperialiste. Kurse Hrushovi na akuzon ne si luftënxitës, sikur ne



gjoja duam luftën, se ne shqiptarët trubullojmë ujërat në Ballkan, pengojmë çarmatosjen e Greqisë, siç thotë Teodor Zhivkovi, se jemi ata që kemi prishur konferencën e paqes në Ballkan! Ne nuk dimë fare ç'është kjo konferencë. Por, siç duket, Hrushovi dhe Zhivkovi kanë ndër mend të organizojnë një konferencë të vendeve ballkanike që të vendosin së bashku një «paqe» dhe të krijojnë «Ballkanin e lulëzuar». Por politika që ata trumbetojnë demaskohet me forcë nga qëndrimi marksist-leninist i Partisë sonë.

Një ndërmarrje tjetër e Hrushovit është rehabilitimi i grupit revizionist të Beogradit. Nuk flasim për gabimet dhe devijimet në çështjet e tjera, vetëm fakti që Titon e quan shok e marksist, kjo sqaron pozitën se kush është Hrushovi. Menjëherë pas vdekjes së Stalinit, iu vu punës për rehabilitimin e Titos dhe grupit të tij. Në këtë çështje kundërshtoi vetëm Partia e Punës e Shqipërisë. Këtë hap Hrushovi nuk e bëri për sytë e bukur të Titos, po për faktin se të dy i bashkon e njëjta ideologji, të dy janë për miqësi me imperializmin. Politika e Titos është demaskuar haptazi, por edhe politika që ndjek Hrushovi po demaskohet gradualisht dhe do të vijë koha që edhe atij do t'i hiqet maska dhe do të duket se nuk është veçse një revizionist i ndyrë që bashkëpunon ngushtë me imperializmin.

Për rehabilitimin e revizionistëve jugosllavë Hrushovi mori edhe aprovimin e partive komuniste dhe punëtore të Evropës, për arsye se vitet e fundit në krye të tyre kanë ardhur revizionistë, pasues të Hrushovit. Në partitë e vendeve socialiste të Evropës, si në Bullgari, Hungari, RD Gjermane, Poloni, Rumani e në Çekoslllo-

vaki, në udhëheqje sot janë në krye njerëz të një pikëpamjeje me Hrushovin. Këta jo vetëm mbajnë një qëndrim armiqësor ndaj nesh, por në gjithë politikën e jashtme ndjekin qorrazi vijën tradhtare të Hrushovit. Tëodor Zhivkovi na këshillon të jemi me Bashkimin Sovjetik qoftë edhe sikur Hrushovi të jetë në rrugë të gabuar. Një pikëpamje e tillë, shokë, nuk është marksiste, përkundrazi ky qëndrim është armiqësor ndaj Bashkimit Sovjetik. Gjersa pranon ta ndjekësh Hrushovin edhe kur ai ecën gabim, atëherë i ke vënë kazmën Bashkimit Sovjetik dhe marksizëm-leninizmit.

Me anën e njerëzve të tillë Hrushovi ka rehabilituar edhe agjentët e revizionistëve jugosllavë, të cilët me forma agjenturale u përpoqën të rrëzonin pushtetin në vendet e demokracisë popullore. Dihet se pas Kongresit XX të PK të BS në mjaft parti filluan të rehabilitohen armiq, si për shembull, në Bullgari Trajçe Kostovi, për të cilin vetë udhëheqësit bullgarë kanë pohuar se është tradhtar. Si mund të rehabilitohet ky njeri, fajësia e të cilit është provuar? Po kështu në Hungari u rehabilitua Laslo Rajku. Në Poloni pas vdekjes së Bierutit e pas shumë makinacionesh revizionistët sollën në fuqi Gomulkën. Hrushovi që ndihmoi në këtë çështje kujtonte se Gomulkën do ta kishte qind për qind pas vetes si Zhivkovin, kurse ai si revizionist i regjur pati momente fërkimi me Hrushovin. Megjithëkëtë Gomulka me Hrushovin tani janë bërë miq të ngushtë. Kur kam qenë një herë në Moskë, vetë Hrushovi na ka thënë se Gomulka është një fashist, mirëpo ca kohë më vonë, kur në Moskë ishte shoku Mehmet dhe në një bisedim i tha Mikojanit se Gomulka është revizionist, Miko-

jani kërceu dhe e mbrojti duke pohuar se Gomulka është një nga marksistët më të shquar! Të tillë sharlatanë janë njerëzit që udhëheqin sot Bashkimin Sovjetik dhe pretendojnë të udhëheqin lëvizjen komuniste e punëtore ndërkombëtare.

Hrushovi nuk rehabilitoi vetëm këta tradhtarë, por të gjitha klikat revizioniste, kudo që ishin, gjersa u arrit në kundërrevolucion në Hungari, gjatë të cilit bashkëpunoi shumë ngushtë me Titon. Ne kemi në dorë dokumente që flasin se gjatë ditëve të rënda të kundërrevolucionit në Hungari të dy bashkë kanë biseduar se në krye të partisë dhe të shtetit hungarez të vihej Kadari. Përse të bisedonte Hrushovi me Titon për një çështje me kaq rëndësi siç ishte problemi kush të ishte në udhëheqje në Hungari? Pse të bisedohej për probleme të udhëheqjes së një partie ose të një vendi tjetër, nga udhëheqës të vendeve të tjera? Por tani të gjitha këto pikëpyetje bëhen të qarta. Titoja me Hrushovin bashkëpunojnë ngushtë me njëri-tjetrin. Mirëpo, botimi i programit antimarksist të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë i acaroi punët, sa edhe partitë, udhëheqësit e të cilave pasojnë Hrushovin, për të mos demaskuar veten, u detyruan të thonë ndonjë fjalë kundër këtij dokumenti revizionist. Partia jonë e hodhi poshtë me argumente këtë program antimarksist. Ky program vërtetoi edhe një herë sa të drejtë kishte Stalini kur i cilësoi udhëheqësit jugosllavë tradhtarë, revizionistë. Me gjendjen që u krijua tani kundër programit titist indirekt i themi Hrushovit: «Je ti që ke gabuar me jugosllavët dhe jo Stalini». Për shkak të presionit të madh nga poshtë Hrushovi u detyrua atëherë të hedhë

edhe ai ndonjë fjalë me gjysmë zëri kundër Titos sig ishte parulla «kalë i Trojës» etj.

Kjo qe thjesht për demagogji, se politikën e afrimit me revizionistët jugosllavë ai e çoi përpara me zell të madh, po kështu vazhdoi presionet kundër nesh, që ne të zbusnim luftën kundër këtyre armiqve të marksizëm-leninizmit, me qëllim që të krijonte një situatë që të bashkoheshim edhe ne me rrugën e tij tradhtare.

Revizionistët jugosllavë aktualisht janë në marrëdhënie jashtëzakonisht të mira me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet e tjera të demokracisë popullore të Evropës. Ne mund të themi se revizionistët jugosllavë ia arritën të ushtrojnë influencën e tyre në vendet socialiste të Evropës, të cilat tani janë futur në llumin e revizionizmit, në luftë kundër marksizëm-leninizmit e veçanërisht kundër PK të Kinës dhe Partisë së Punës të Shqipërisë. Ja një shembull. Një përfaqësues nga BRPSH shkoi në Bullgari për të marrë pjesë në një mbledhje të përfaqësuesve të fshatarësisë ballkanike. Ashtu si folën të gjithë, foli në këtë mbledhje edhe përfaqësuesi i rinisë shqiptare, në atë frymë që folët ju shokë të rinisë në këtë Plenum. Kur erdhi puna te rezolucioni i mbledhjes, përfaqësuesi i rinisë jugosllave deklaroi se në qoftë se në këtë dokument do të flitej për luftën kundër imperializmit, kundër kolonializmit, për njohjen e Republikës Demokratike Gjermane, për nënshkrimin e traktatit të paqes me Gjermaninë, ai nuk do ta firmoste. Pas kësaj delegati bullgar i tha përfaqësuesit të rinisë sonë se ç'mendonte për pikëpamjet e jugosllavit, sepse KQ i partisë së tij kishte dhënë udhëzime që të pranoheshin këto pikëpamje. Shoku ynë u përgjigj se në qoftë se në

rezolucion problemet nuk vihen si themi ne, ai si përfaqësues i rinisë shqiptare nuk do ta firmoste rezolucionin. Atëherë delegati bullgar shkoi përsëri në KQ të partisë, ku i thanë «fundja të bëhen dy rezolucione», domethënë njëri ujë, pa kripë, kurse tjetri ashtu siç thamë ne.

Politika e jashtme që ndjek Hrushovi është një politikë krejtësisht antimarksiste, një politikë pajtimi me imperializmin amerikan. Ajo është politika për paqen me çdo kusht. Por fjalët e bukura dhe parullat e Hrushovit për paqen, për çarmatimin, s'janë gjë tjetër veçse demagogji. Deklarata e Mbledhjes së Moskës për të nuk ekziston. Pa u tharë akoma boja e firmës që vuri atje, ai e shkeli atë. Dhe që nga nëntori i vitit 1960 e deri tani, Deklaratën e Mbledhjes së Moskës N. Hrushovi as që e peshon fare, por ndjek rrugën e tij antimarksiste dhe proimperialiste. E gjithë politika e Hrushovit është një varg dallaveresh dhe intrigash me krerët e imperializmit. Ai u bën atyre lëshime ditë-ditës. Lëshime ka bërë dhe po bën Hrushovi edhe në çështjen e çarmatimit, lëshime ka bërë edhe në çështjen gjermane dhe do të shohim nëse do të nënshkruhet traktati i paqes me Gjermaninë. Në një letër që i kemi dërguar kohët e fundit i themi se na akuzoi ne, shqiptarët, që nuk marrim përgjegjësi për zgjidhjen e problemit gjerman, kurse Partia jonë qysh në fillim ka deklaruar se duhet nënshkruar traktati i paqes me Gjermaninë po ka qenë ai vetë që e ka shtyrë këtë gjë disa herë, bile para disa kohësh ka thënë që e ka gati edhe penën, se puna ka mbetur vetëm për një firmë.

Megjithatë përsëri Hrushovi ka shpallur tani se

brenda këtij viti do të përfundojë kjo çështje! Po ja që del Pol Rejno<sup>1</sup>, ky agjent i vjetër i imperializmit, i cili ka shkuar në Moskë dhe ka biseduar me orë të tëra me Hrushovin. Edhe ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s ka deklaruar se është takuar me Hrushovin dhe ky i ka thënë se mund të shtyhet përsëri edhe për ca kohë firmosja e traktatit të paqes me Gjermaninë me qëllim që «të bisedohet» mbi këtë çështje. Kur e morën vesh këtë udhëheqësit e Republikës Demokratike Gjermane u alarmuan. Thuhet se tani Ulbrihti, në krye të një delegacioni të madh, na paska shkuar në Moskë për ta bindur Hrushovin të mos kthejë fjalën e thënë për të firmosur traktatin. Por revizionistët nuk kanë cipë. Në qoftë se shtyhet edhe një herë nënshkrimi i traktatit të paqes me Gjermaninë, kjo do të jetë një disfatë për Hrushovin me shokë, një demaskim i madh për të dhe për ata që e pasojnë.

Duket qartë se më shumë zhurmë dhe reklamë po bëhet për këtë çështje sesa punë e veprime konkrete. Në fund të fundit Republika Demokratike Gjermane është një shtet i njohur nga të gjitha vendet e kampit socialist me të cilat ajo ka lidhje ekonomike, politike, diplomatike dhe ushtarake, prandaj kush prek atë ka luftë me këto vende. Për të firmosur traktatin e paqes me Gjermaninë rëndësi ka që këtë duhet ta bëjnë edhe miqtë e Hrushovit... Thuhet se me nënshkrimin e trak-

---

<sup>1</sup> Udhëheqës politik borgjez francez (1878-1966). Deri më 1938 ka qenë një nga drejtuesit e partisë reaksionare «Aleanca demokratike». Kundërshtar i vendosur i Frontit Popullor. Deri më 1954 ka pasur poste të rëndësishme në të gjitha qeveritë franceze.

tatit të paqes me Gjermaninë do të zgjidhet edhe problemi i Berlinit. Kjo është një parullë e hedhur prej kohësh, po tani Hrushovi, si i lëkundur që është, del me parulla të tjera, si për shembull: «Kush ka thënë se ne nuk do të njohim të drejtat e aleatëve në Berlin, ose të drejtat e popullsisë së Berlinit Perëndimor për të komunikuar me botën e jashtme? Vetëm duhet të merret leja nga autoritetet e Republikës Demokratike Gjermane për këtë çështje». Përsa i përket kësaj Kenedi është shprehur se «ne nuk na intereson ç'bëni ju, nëse e firmosni apo jo traktatin e paqes me qeverinë e një vendi që keni okupuar dhe ku në fuqi janë agjentët tuaj, vetëm mos na prekni të drejtat tona në Berlinin Perëndimor». Dhe Hrushovi e siguron se këto të drejta nuk do t'ia prekë njeri. Kjo është e gjithë buja që bëhet.

Në lidhje me këtë ju keni dëgjuar për masa ushtarake që janë marrë nga vendet e Traktatit të Varshavës, si mbledhja e shtabeve të këtyre vendeve, deklaratat e njëpasnjëshme të mareshalëve sovjetikë etj. Ju mbani mend se një vit mbeti ura ajrore në Berlin<sup>1</sup> në kohën e Stalinit dhe u zgjidh pa lëshime ndaj imperiaлизmit, ndërsa tani me Berlinin Hrushovi u bën lëshime pas lëshimesh imperialistëve. Me sa duket çështjen e Berlinit ai e ka lënë në plan të dytë, tani kryesore për të është çështja e bashkekzistencës paqësore.

Parulla për çarmatimin zë vendin e parë në politikën e jashtme sovjetike. Hrushovi i dërgoi Kenedit programin e tij për çarmatimin dhe i thekson se përsa

---

<sup>1</sup> Bëhet fjalë për urën ajrore lidhur me «krizën e Berlinit» të vitit 1948.

i përket Berlinit mund të merren vesh. Prandaj kërkon që problemi i çarmatimit të bisedohet midis Bashkimit Sovjetik dhe Shteteve të Bashkuara. Ai kërkon që të bien në një farë ujdje mbi këtë çështje. Grupi i Hrushovit tani pra është rikthyer me parullat e vjetra kundër të cilave u luftua në Mbledhjen e Moskës, me parullat «e botës pa luftë», «e botës pa armë», «e botës pa ushtri», për zgjidhjen e problemeve ndërkombëtare me imperializmin në rrugën e bisedimeve. Këto janë vetëm një bluf.

Përpara këtyre situatave, shokë, duhet mbrojtur pa u përkulur marksizëm-leninizmi, duhen mbrojtur interesat e popujve të vendeve socialiste dhe komunizmi. Këto duhen mbrojtur me të gjitha forcat, se kur kemi mbrojtur këto ne kemi mbrojtur atdheun, popullin dhe Partinë tonë.

Hrushovi ka krijuar një situatë frike dhe druajtjeje në Bashkimin Sovjetik. Atje tani nuk guxon njeri të flasë për të kaluarën dhe sidomos të zihet në gojë Stalini. Çdo gjë bëhet për të ngritur sa më lart Hrushovin, atë që gjoja luftoi kundër kultit të individit. Lufta kundër kultit të individit në parim dhe në praktikë është e drejtë. Por çështja e «kultit të individit» të Stalinit që ngriti Hrushovi ishte një pjesë e planit të tij për të shkurorëzuar leninizmin. Nuk kanë kaluar pesë vjet që Hrushovi është në fuqi dhe në çdo gazetë e revistë sovjetike do të gjesh vazhdimisht fotografinë e tij, në çdo artikull do të gjesh disa herë emrin dhe citatet e tij. Në BS është krijuar një atmosferë mbytëse për çdo njeri që mund të pëshpëritë kundër politikës së tij tradhtare.



Mosmarrëveshjet politike dhe ideologjike me Partinë tonë Hrushovi kërkon t'i mbulojë. Ai thotë se nuk ka asnjë mosmarrëveshje të tillë, po ka vetëm punë përçarëse nga udhëheqja e Partisë së Punës të Shqipërisë. Ai ka arritur gjer atje saqë në një letër të na shkruajë se nuk është e vërtetë ajo që themi ne shqiptarët se në Mbledhjen e Bukureshtit u atakua Partia Komuniste e Kinës, prandaj nuk ka pasur vend për Partinë tonë të Punës ta mbronte Partinë Komuniste të Kinës, pra, sipas tij, sa thuhet për këtë çështje janë shpifje. Hrushovi nuk ka as respektin më të vogël ndaj përfaqësuesve të komunizmit ndërkombëtar që i dëgjuan ato që tha ai kundër Partisë Komuniste të Kinës në Bukuresht dhe më vonë në Moskë, sulmet e ulëta që bëri kundër saj, me qëllim që të likuidonte një kundërshtar të fortë për të pasur pastaj rrugë të lirë në veprën e tij tradhtare dhe revizioniste. Bukureshti ishte fillimi i një faze të luftës së hapur kundër Partisë Komuniste të Kinës dhe Partisë sonë, të cilat, që nga fillimi i veprimtarisë së N. Hrushovit deri tani, kanë parë kurdoherë qartë se çfarë fshihej nën lëkurën e këtij pseudomarksisti.

Për Partinë tonë ai ka shkuar me mendimin se është një parti e vogël, një parti që nuk ka asnjë rëndësi në lëvizjen komuniste, se Shqipëria, duke qenë e rrethuar nga Jugosllavia, Greqia dhe Italia e që në çdo moment është në rrezik të sulmohet prej tyre, do të nënshtrohet menjëherë. Përveç këtyre, ka menduar ai, në Shqipëri populli ka një dashuri të zjarrtë për Bashkimin Sovjetik, prandaj sikur gabimin më të vogël të bëjnë udhëheqësit shqiptarë në drejtim të udhëheqjes

sovjetike, ata likuidohen menjëherë; pastaj në Shqipëri ne kemi me qindra kuadro që kanë mësuar në BS dhe që e duan BS, prandaj ata i kemi me vete. Mjafton t'u falim kreditë që ata të ëmbëlsohen dhe nuk do të na kundërshtojnë në rrugën tonë. Në qoftë se ne arrijmë ta nënshtrojmë dhe ta vëmë në gjunjë udhëheqjen e Partisë dhe të Qeverisë Shqiptare me këto mjete, ka menduar Hrushovi, mirë, ndryshe do të përgatitim edhe plane të tjera. Dhe Hrushovi filloi të kurdiste plane nga më të ulëtat kundër Shqipërisë. Për këtë qëllim Hrushovi e pasuesit e tij u orvatën të përcanin udhëheqjen e Partisë sonë me anë të njerëzve frikacakë e provokatorë si Liri Belishova e Koço Tashko dhe t'i sillnin këta në krye të udhëheqjes në Shqipëri. Mirëpo të gjitha këto plane plasën si fluska sapuni.

Për shkak të qëndrimit tonë parimor, qysh pas Mbledhjes së Bukureshtit, Hrushovi dhe grupi i tij filluan bllokadat ekonomike, komplotet politike dhe ushtarake kundër Partisë e vendit tonë. Sa false tingëllojnë shkrimet e shtypit sovjetik të mbushura me fraza plot demagogji kundër imperializmit amerikan që i bënë bllokadë ekonomike dhe politike Kubës. Me të vërtetë të vjen ndot kur i lexon, sepse bllokada që grupi revizionist sovjetik i ka bërë vendit tonë, një vendi socialist, është shumë më e egër se ato që imperialistët amerikanë kanë bërë kundër Kubës dhe vendeve të tjera përparimtare. Me bllokadën kundër RPSII Hrushovi ka menduar se ne do të falimentojmë dhe Partia do të ngrihet kështu kundër udhëheqjes së saj. Ekonomikisht shqiptarët janë të varur nga ne, mendon ai, prandaj me të vënë bllokadën, brenda një muaji do të kapitu-

llojnë se nuk kanë bukë të hanë dhe udhëheqja nuk ka çfarë t'u thotë popullit dhe Partisë. Po Hrushovi me shokë janë revizionistë, prandaj edhe mendojnë kështu. Pasi e panë se në Partinë dhe në popullin tonë jo vetëm nuk pati tronditje nga veprimet e tyre armiqësore, por situata e krijuar e bëri akoma më të çeliktë unitetin e Partisë me popullin, revizionistët sovjetikë kaluan në veprime agjenturale dhe komplotiste për të përmbysur diktaturën e proletariatit në vendin tonë. Koha do të vërtetojë se në këto komplete ka gisht edhe Hrushovi.

Porsa dëgjuan për zbulimin e komplotit që u shpall në Kongresin IV të Partisë sonë, Hrushovit me shokë u dogji si zjarr ky lajm. Prandaj ata morën menjëherë nën mbrojtje Liri Belishovën dhe Koço Tashkon, se mos emrat e tyre dilnin në procesin gjyqësor. Përse u dogji ata e dinë vetë, por edhe ne e dimë. Ne dimë fare mirë edhe që Panajot Plaku i ka dërguar një letër të gjatë N. Hrushovit, ku, përveç të tjerash, i kërkon që të likuillojë udhëheqjen e Partisë sonë, e cila qenka «antimarksiste», «staliniste». Ne dimë gjithashtu që Hrushovi ka folur edhe me Sofokli Venizellosin për kufijtë e Shqipërisë<sup>1</sup>. Këtë të fundit nuk e kemi lexuar në gazetatat reaksionare greke, por në informacionin që na ka dërguar Hrushovi dhe që e kemi në dorë.

Imperializmi përgatitet për luftë kundër vendeve socialiste, ai synon të sulmojë vendet socialiste të Ballkanit, konkretisht Shqipërinë, duke menduar se është shtet i vogël dhe mund të shfrytëzohet për këtë punë

---

<sup>1</sup> Shih Enver Hoxha. Vepra, vëll. 19, f. 54-55.

ekzistenca gjoja e gjendjes së luftës midis Greqisë dhe Shqipërisë që reaksioni e mban me qëllim prej shumë vjetësh me radhë. Pikërisht në këto rrethana dhe kur armiqtë rreth nesh dërgojnë spiunë dhe diversantë, instalojnë raketa në drejtim të vendit tonë, Hrushovi para 15 ditësh i dha një intervistë një gazetari anglez, ku e njoftoi, midis të tjerash, se Greqia ka drejtuar raketa kundër aleates sonë Bullgarisë, e cila nuk duhet të preket, ndryshe do të konsiderohet sikur preket Bashkimi Sovjetik. Për aleaten tjetër të BS në Ballkan, Shqipërinë, ai indirekt, duke mos e zënë në gojë, u thotë armiqve: «Bëni si të doni me të se ne nuk interesohemi fare për Shqipërinë». Me një fjalë Hrushovi u thotë imperialistëve se duart i kenë të lira në drejtim të Shqipërisë, prandaj mund të vepronë si të doni me të. Ky njeri që na akuzon se po prishim unitetin e vendeve të kampit socialist, i orienton, pra, armiqtë e atdheut tonë të bëjnë ç'të duan me ne.

Ju, shokë, jeni në dijeni për shumë çështje të tjera mbi marrëdhëniet tona me udhëheqjen e sotme sovjetike. Por vetëm nga këto që thashë mund të gjykosh fare lehtë se cilët janë këta njerëz. Prandaj ka të drejtë Partia jonë kur thotë se këta janë një grup i rrezikshëm revizionistësh e tradhtarësh të marksizëm-leninizmit. Grupi i N. Hrushovit e di fare mirë se as bllokadat, as shantazhet, as shpifjet nuk e lëkundin Partinë tonë dhe unitetin e saj të çeliktë me popullin.

Shqipëria e re socialiste nuk do të mposhtet nga bllokada ekonomike që i bëjnë Hrushovi dhe udhëheqësit revizionistë të vendeve të tjera socialiste të Evropës. Përkundrazi, në situatën e krijuar është rri-

tur një entuziazëm i paparë dhe mobilizim i jashtëzakonshëm i masave tona punonjëse për realizimin e planeve më mirë se çdo vit tjetër. Pastaj Partia ka punuar që të zbulohen pasuri të mëdha në vendin tonë, që të kapërcehen vështirësitë e bllokadës. Lidhjet me vendet socialiste të Azisë i kemi shumë të mira. Me Republikën Popullore të Kinës dhe PK të Kinës jemi në marrëdhënie të përzemërta politike e ideologjike. Ju të gjithë jeni në dijeni për ndihmën e madhe ekonomike që na dha Republika Popullore e Kinës duke zëvendësuar të gjitha kreditë që na kishin akorduar vendet socialiste të Evropës, të cilat na i ndërprejnë për të na dëmtuar e për të sabotuar planin tonë pesëvjeçar. Kina e madhe Popullore, e cila është në gjendje të ndërtojë me sukses socializmin në vendin e vet, do të ndihmojë edhe Shqipërinë e vende të tjera që meritojnë të ndihmohen. Pavarësisht se N. Hrushovi ka në dorë një forcë të madhe ekonomike dhe politike, ai po e shkatërron socializmin, po e kthen Bashkimin Sovjetik prapa, në kapitalizëm. Socializmi ndërtohet me vendosmëri në vendin tonë, dikur i shtypur e i varfër, ku njerëzit s'kanë pasur këpucë në këmbë dhe nuk mbushnin dot barkun me bukë. Socializmin nuk mund ta ndërtojnë kapitalistët, as ata komunistë që janë borgjezuar dhe s'çajnë kokën për revolucionin, për popullin.

Edhe në fushën ekonomike Hrushovi me shokët e tij nuk kanë ç'të bëjnë, ndërtimi i socializmit në vendin tonë do të ecë gjithnjë përpara pa u ndalur, dhe çdo ditë na vijnë vazhdimisht lajme të mira. Tani porsa u njoftuam se janë bërë zbulime të rëndësishme të mineralit të bakrit e të zinkut, si dhe të dy-tri mineraleve

të tjera të rralla bashkë me bakrin, me përmbajtje të mirë industriale. Këto pasuri i zbuluan «birçet» tanë. Hrushovi me shokë, duke na prerë kreditë, kujtuan se ne do të mbeteshim si peshku pa ujë. Ata na hoqën specialistët sovjetikë dhe kujtuan se do të mbarojmë. Por kjo nuk ndodhi, as do të ndodhë, përkundrazi ne përparojmë çdo ditë më shumë. Fakti është që Partia rriti e kaliti klasën tonë heroike punëtore nga gjiri i së cilës dhe i tërë popullit tonë dolën kuadro të shëndoshë, të devotshëm dhe të zotë për ta shpënë përpara ndërtimin e socializmit, njerëz modestë që nuk u rritet mendja, që mbështeten kurdoherë në vijën e Partisë dhe në forcën krijuese të masave punonjëse. Vendet socialiste të Evropës, na i prenë ndihmat, por kjo nuk na pengon ne të ecim përpara. Pra edhe në këtë drejtim Hrushovi e pasuesit e tij dështuan.

Blokada politike ka arritur gjer në mosrespektimin e marrëveshjeve kulturore, bile edhe në mosbotimin në shtyp të ndonjë urimi që është dërguar nga ana jonë. Kështu, për shembull, ne dërguam si zakonisht përshëndetje për festën e çlirimit të popullit bullgar, 9 shtatorit, por udhëheqja bullgare për t'i fshehur popullit dhe partisë ndjenjat e miqësisë që ushqejnë për to Partia, Qeveria dhe populli ynë nuk e botoi përshëndetjen tonë për një javë rresht. Kur studentët bullgarë e mësuan këtë, bënë zhurmë, gjë që e detyroi udhëheqjen bullgare ta botonte përshëndetjen tonë pas disa ditësh. Hrushovi me shokë kanë frikë nga vija e Partisë sonë, sidomos nga kontaktet me njerëzit tanë, sepse kështu bëhet demaskimi i tyre. Ata nuk flasin fare që ne jemi kundër Hrushovit dhe pasuesve të tij,

por shpifin sikur ne gjoja shajmë dhe diskreditojmë Bashkimin Sovjetik. E gjithë propaganda e tij bërtet se kush orvatet të ndajë Bashkimin Sovjetik nga Hrushovi ai është kundër Bashkimit Sovjetik. Po në qoftë se është kështu, atëherë kundër BS është vetë Hrushovi që ka sharë dhe i ka hedhur baltë J.V. Stalinit. Ata që e kanë ndarë Stalinin nga vepra e tij e madhe janë kundër Bashkimit Sovjetik.

Hrushovi përpiqet me çdo kusht t'u mbushë mendjen njerëzve që ky konflikt politik dhe ideologjik është kundër gjithë BS dhe PK të BS dhe jo kundër grupit të tij. Ai paska të drejtë t'i drejtojë letra poshtë-ruese e shpifëse KQ të Partisë sonë dhe të thotë gjëra të paqena për udhëheqjen e Partisë dhe të Qeverisë sonë, kurse ne nuk paskemi të drejtë ta demaskojmë këtë revizionist të rrezikshëm me fakte dhe me dokumente të shumta. Është e kuptueshme se këto letra ai nuk i ka dërguar për konsumin tonë, sepse e di që te ne Partia me popullin janë të lidhur ngushtë rreth udhëheqjes së tyre, Komitetit Qendror. Po ata shpifin sa mundin kundër nesh për konsum të jashtëm. Shumë nga ju e kanë dëgjuar shprehjen «shpif e shpif se diçka do të mbetet». Edhe Hrushovi kështu mendon, me shpifjet e tij ai do të formojë opinionin jashtë kundër nesh.

Por shpejt a vonë partitë komuniste e punëtore do të kuptojnë se «ku fle lepuri». Qysh tani shumë parti kanë filluar të thonë se Partia e Punës e Shqipërisë e ka drejt. Një parti komuniste në ilegalitet ka dërguar te ne sekretarin e KQ, i cili na tha se që nga sekretari i parë e deri te anëtari i thjeshtë i partisë së tyre janë

dakord me Partinë e Punës të Shqipërisë. Por, na kuptoni, tha ai, këtë nuk mund ta shprehim publikisht se Hrushovi do të merrte masa të ashpra kundër nesh, kështu do të likuidohej puna e partisë sonë në ilegalitet. Me letrën që na ka bërë, Hrushovi u thotë indirekt edhe partive të tjera që po të vepronin edhe ju si shqiptarët, «do ta pësoni» si ata, kurse kundërrevolucionarëve në partitë e tjera u jep të kuptojnë se i mbron.

Por Hrushovi edhe në këtë rast mendon e vepron si revizionist. Deri dje të gjitha partitë komuniste të vendeve socialiste e kanë ndjekur Hrushovin në letrat që i ka dërguar Partisë sonë, kurse në letrën e fundit atë e mbështetnin vetëm revizionistët me damkë, si Teodor Zhivkovi dhe Janosh Kadari, sepse të tjerët e shohin që akuzon pa fakte dhe dokumente.

Por për një gjë ne duhet të jemi të bindur, që Hrushovi me taktikën e tij i ka komprometuar udhëheqësit e vendeve të demokracisë popullore të Evropës, dhe si intrigant i madh që është i ka lidhur ata pas qerres së tij. Prandaj të kemi kurdoherë të qartë detyrën e demaskimit pa lëkundje të këtij grupi tradhtar dhe renegat të PK të BS dhe të komunizmit ndërkombëtar. Kështu na mëson vija e drejtë e Partisë sonë.

Të kemi parasysh se Hrushovi përpiqet të krijojë përshtypjen në opinionin publik ndërkombëtar sikur mosmarrëveshjet ekzistojnë vetëm midis Partisë sonë dhe PK të BS. Ai ka tendencë ta lokalizojë konfliktin, sepse kështu i intereson. Është fakt se kundër Partisë sonë janë lëshuar të gjitha shigjetat, mbi Partinë tonë



është lëshuar i gjithë zjarri i goditjes së grupit të Hrushovit, po Partia jonë e mban gjoksin hapur dhe në këtë luftë të drejtë parimore ajo nuk është e vetme.

Mosmarrëveshje me grupin e Hrushovit kanë të gjitha partitë marksiste-leniniste. Të gjithë komunistët e vërtetë janë kundër vijës revizioniste të Hrushovit. Por në vijën e parë të kësaj lufte përveç Partisë sonë është edhe PK e Kinës, e cila mban një qëndrim të vendosur marksist-leninist kundër vijës tradhtare të Hrushovit.

Po ka edhe parti të tjera që, gjysmë fshehtazi dhe gjysmë haptazi, e mbrojnë vijën e Partisë sonë, na japin të drejtë dhe kritikojnë Hrushovin. Por qëndrimet e tyre do të kristalizohen çdo ditë e më shumë. Sidoqoftë të gjitha bateritë tani për tani janë derdhur kundër nesh. Kjo nuk na tremb, lufta nuk na ka trembur kurrë. Ne nuk jemi luftënxitës, siç na akuzon Hrushovi, por, duke pasur të qartë se imperialistët dhe revizionistët nuk flenë, ne jemi nga të parët që atyre u qëndrojmë me trimëri, ballë për ballë.

Hrushovi dhe ata që e pasojnë mund të shkojnë edhe më tutje, përse i përket anëtarësisë sonë në Traktatin e Varshavës. Në këtë situatë rëndësi për ne ka çështja që të jemi të fortë, vigjilentë, të gatshëm për çdo gjë, sepse e dimë që popujt e BS, të Kinës dhe të gjithë botës janë me ne. Fakti është se Hrushovi me shokë e kanë shkelur Traktatin e Varshavës, ata na kanë mënjeluar, vetëm kanë frikë të na përjashtojnë, sepse kjo gjë do të ishte në dëm të tyre.

Gjithashtu në qoftë se Hrushovi në Kongresin XXII të PK të BS do të sulmojë publikisht Partinë

tonë ky do të ishte fillimi i çjerrjes së maskës revizioniste tradhtare të tij. Tani të shohim si do t'i bëjë llogaritë, se ne nga ana jonë llogaritë i kemi bërë. Fakt është që ne nuk kemi marrë ftesë për të dërguar delegacion në Kongresin XXII të PK të BS. Ata do të përpiqen të justifikohen përpara partive të tjera se Partinë tonë nuk e ftuan se është «sektare», «dogmatike» dhe në «pozita armiqësore ndaj BS». Hrushovi mendon se do të na dëmtojë me këtë qëndrim, por llogaritë ai i bën gabim, sepse më shumë do të shtohen dyshimet për të dhe interesimi për Partinë tonë, për mbrojtjen e saj.

Në rast se Hrushovi do të flasë në kongres dhe do të akuzojë udhëheqjen shqiptare se është në pozita «antisovjetike», «sektare», «dogmatike» etj., atëherë ai do të marrë menjëherë përgjigjen e merituar nga Partia jonë, një përgjigje të qëndisur mirë dhe jemi të sigurt se do të kemi përkrahjen e hapët të partive që janë në pararojë të luftës kundër revizionizmit dhe Hrushovit me shokë. Komiteti Qendror i Partisë sonë llogaritë i ka bërë shumë mirë: luftë gjer në fund kësaj bande që po i bën varrin komunizmit, unitetit të kampit socialist në dobi të imperializmit. Hrushovi me shokë përpiqen t'u bëjnë varrin edhe popullit e Partisë së Punës të Shqipërisë. Prandaj ne do të luftojmë deri në fund kundër këtyre renegatëve. Këtë luftë Partia jonë e bën në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe me urtësi që të diskreditohet Hrushovi, i cili është në krye të PK dhe të shtetit sovjetik. Prandaj ne do ta demaskojmë në popull Hrushovin dhe grupin e tij, do të demaskojmë sa më shumë veprimet e tyre antimarksiste,

antishqiptare. Kjo është një detyrë internacionaliste. Asnjë hezitim të mos ketë në këtë çështje.

Është fatkeqësi e madhe për të gjithë lëvizjen komuniste, por sidomos për Bashkimin Sovjetik që në krye të shtetit të madh të parë socialist, i cili tani duhet të ecte drejt komunizmit, ka ardhur një tradhtar i marksizmit si Hrushovi. Prandaj të luftojmë për t'i hequr maskën këtij renegati të marksizmit, tradhtari të komunizmit.

Situata jonë e brendshme është jashtëzakonisht e fortë. Këtë nuk e themi për të gënjer veten, ndryshe do të bënim gabim, por ky është realitet. Një patriotizëm i flaktë dhe një besnikëri e madhe e popullit ndaj Partisë duket kudo në vendin tonë. Kjo vjen se populli ynë e shikon se rruga e Partisë është e drejtë dhe këtë ai e vëren jo në frymë nacionaliste, po internacionaliste, në frymë të drejtë marksiste-leniniste, jo siç thotë Hrushovi, i cili kërkon të akuzojë Partinë tonë për nacionalizëm. Po kjo është taktika e tij. Sipas tij, ne paskemi tendenca nacionaliste borgjeze dhe shoviniste. Është e çuditshme që të gjitha këto akuza i bën pa asnjë fakt. Letra me të cilën Hrushovi bën të tilla akuza, nuk ka fakte, ai vetëm ka kopjuar të gjitha të ashtuquajturat «fakte» që kanë përdorur kundër Partisë dhe udhëheqjes sonë revizionistët jugosllavë, të cilët ju të gjithë i keni dëgjuar për shumë vite me radhë. Pra ata na akuzojnë sikur gjoja në Partinë tonë është zhdukur demokracia, se në Komitetin Qendror paska familjaritet! Këtë tezë e kanë përdorur shumë revizionistët jugosllavë dhe radioja «Shqipëria socialiste», ku flet tradhtari Panajot Plaku. Por e vërteta është krejt ndry-

she. Ne të gjithë e dimë se çdo anëtar që është zgjedhur në Komitetin Qendror të Partisë sonë, qoftë shok ose shoqe, e ka merituar këtë besim dhe nder të madh në saje të luftës konsekuente dhe të punës së palodhur që ka bërë qysh nga themelimi i Partisë dhe gjatë gjithë jetës së saj.

Akuza tjetër e tyre është çështja e «kultit» të Enver Hoxhës. Ky kult, sipas tyre, është zmadhuar shumë kohët e fundit dhe për këtë «dikush është i interesuar». Këtë e thonë se duan të mos flitet fare për Enver Hoxhën, as për ndonjë tjetër, sepse kanë qëllime djallëzore ndaj udhëheqjes sonë. Në këtë frymë ata ngrenë në letër edhe shumë çështje të tjera që i kanë huajtur nga revizionistët e Beogradit. Akuzat e tyre në këtë letër janë të përbindshme. Ata shkojnë edhe më tej duke thënë se Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu janë njerëz të dyshimtë, se ata kanë lejuar dyfishimin e personelit të legatave franceze dhe italiane, se njëri nga ne ka studjuar në Francë dhe tjetri në Itali. Sipas tyre të gjithë ata që kanë studjuar jashtë janë agjentë.

Çështja është, shokë, që përpara kësaj shtate të jemi të armatosur në të gjitha drejtimet. Partia dhe rinia t'i përvishen si duhet punës, duke pasur parasysh kurdoherë parullën: «Në njërin dorë kazmën, në tjetrën pushkën». Kjo parullë do të thotë që për asnjë moment të mos harrojmë rrezikun që kërcënon Partinë dhe atdheun tonë. Rreziku ekziston jo vetëm nga ana e imperializmit, por edhe nga ana e revizionizmit. Në planin e përgjithshëm botëror mund të mos ndodhë gjë, po kundër vendit tonë mund të ndodhë. Ne e dimë mirë natyrën e imperializmit, ne dimë gjithashtu edhe

qëllimet e monarko-fashistëve grekë, të revizionistëve jugosllavë dhe të neofashistëve italianë, që punojnë për të likuiduar situatën e mrekullueshme që është krijuar në Shqipëri. Prandaj ata mund të na bëjnë edhe provokime për të arritur qëllimet e tyre. Kjo gjendje kërkon që ne të jemi kurdoherë shumë vigjilentë.

Pra të mbajmë gjallë vazhdimisht frymën e Luftës Nacionalçlirimtare që populli të jetë i përgatitur nga çdo pikëpamje, ushtarakisht po e po, po ai duhet të jetë i përgatitur plotësisht edhe nga pikëpamja psikologjike. Kjo kërkon që të mos lihet pas dore puna për përgatitjen ushtarake të të gjithë popullsisë. Këtë detyrë duhet ta kryejmë mirë, sepse sa më të fortë të jemi aq më pak rreziqe do të kemi, se po të të gjejë të dobët armiku, të dëmton shumë. Por, me masat që ka marrë Partia, armiqtë nuk do të na gjejnë kurrë të papërgatitur.

Që të dalim fitimtarë në këtë luftë ne duhet të mobilizohemi me të gjitha forcat për të realizuar me përpikëri të gjitha detyrat që na ka ngarkuar Partia.

Planet e këtij viti janë realizuar në mënyrë të kënaqshme, gjë që i detyrohet rrugës së drejtë të Partisë, mobilizimit të plotë të komunistëve, të rinisë dhe të gjithë popullit. Në këto kushte të vështira ekonomike e politike që na kanë krijuar imperializmi, revizionistët jugosllavë dhe Hrushovi me shokë, ne duhet t'i japim më shumë dhe më mirë popullit, t'u tregojmë imperialistëve dhe revizionistëve se populli shqiptar jo vetëm nuk përkulet, po realizon me sukses edhe planet e tij ekonomike. Pra rinia nën udhëheqjen e Partisë t'i futet mirë çështjes së realizimit të planeve.

Në sektorin e industrisë kemi korrur suksese të mëdha. Këtu po zbatohen drejt të gjitha vendimet e Partisë. Sigurisht vërehen edhe dobësi e të meta, prandaj të vëmë të gjitha forcat që këto t'i zhdukim dhe të kemi sa më pak mungesa, humbje, të kemi sa më shumë prodhime e të një cilësie sa më të mirë, që kësaj situate t'i përgjigjemi me realizimin e plotë të planeve ekonomike.

Edhe në sektorin e bujqësisë është punuar gjithashtu mirë, prandaj rezultatet këtë vit janë shumë më të mira nga viti i kaluar, sado që kushtet atmosferike edhe sivjet na kanë dëmtuar. Tani ne duhet t'i përvishemi punës për mbjelljet e vjeshtës. Në fshat, i madh e i vogël, të mobilizohen për punët e stinës, të përfitojnë sa më shumë nga koha e mirë, të shfrytëzohen në maksimum traktorët, kanalet e çdo gjë tjetër.

Të kemi mirë parasysh se luftojmë në kushte të vështira, të rrethuar nga imperialistë e revizionistë. Prandaj çdo punë që ndërmerret Partia, rinia ose çdo njeri veç e veç të vlejë që ta kapërcejmë këtë situatë, të dalim faqebardhë përpara popullit, t'i japim atij paktjetër ato që kemi planifikuar.

Rinia të mësojë sa më mirë në shkolla, se kemi nevojë për njerëz të mësuar e të kualifikuar. Bllokadën revizioniste edhe në këtë drejtim do ta përballojmë. Tani Partia ka krijuar mjetet dhe mundësitë që rinia jonë të mësojë në vend. Të gjithë të rinjtë dhe të rejat ta kenë parasysh këtë situatë që është krijuar dhe jam i bindur se ata e kuptojnë mirë atë. Ata duhet të jenë në dijeni aq sa edhe anëtarët e Partisë, të vihen në korent për presionet e shantazhet e armiqtë kundër

vendit tonë, se kjo do t'i bëjë të jenë akoma më vigjilentë. Zemra e rinisë është e fortë dhe kur t'i thuash asaj si të mirat ashtu edhe rreziqet asgjë nuk e ndal vrullin e saj për të ecur përpara.

Rininë duhet ta kemi të qartë në radhë të parë politikisht. Përveç detyrës së mësimit që ajo duhet ta kryejë mirë, rinia të edukohet politikisht me frymën revolucionare të Partisë se brumin e kemi të mrekullueshëm, të pastër. Mos shikoni një ose pesë të rinj jo të mirë, nuk e përbëjnë ata rininë. Natyrisht duhet t'i shikojmë e të kujdesemi edhe për ta, t'ua zhdukim të metat që kanë, t'i korrigjojmë me qëllim që gjithë rininë tonë ta mbajmë të pastër. Po kryesisht të kemi parasysh masën dërrmuese të rinisë, t'i krijojmë asaj kushtet për mësim dhe edukim, se Partia ka te rinia një forcë të madhe. Prandaj Partia ta ndihmojë rininë për ta mbajtur atë kurdoherë në një nivel të lartë ideopolitik.

Ky Plenum nuk zhvillohet vetëm për rininë. Tema vërtet ka të bëjë me problemin e rinisë, por detyrat që shtrohen duhet të kihen parasysh si nga Komiteti Qendror i BRPSH, ashtu edhe nga ai i Partisë. Prandaj në qoftë se deri sot ka pasur disa të meta dhe neglizhenca në punë nga disa komitete partie, si dhe nga aparatet e Komitetit Qendror të Partisë dhe të Rinisë, të luftohet për zhdukjen e tyre dhe të forcohet bashkëpunimi me organizatat dhe me komitetet e rinisë, jo vetëm nga ana e komiteteve të Partisë në rrethe, por edhe nga organizatat-bazë në ndërmarrjet ekonomike, në kooperativat bujqësore, në shkolla etj. Ky bashkëpunim të jetë i vazhdueshëm dhe luftarak.

Komiteti Qendror vëren me kënaqësi të madhe se ç'kuadro të shumtë e të zotë janë krijuar nga Partia nëpërmjet veprimtarisë revolucionare të organizatës së Bashkimit të Rinisë. Tani me mijëra kuadro të rinj drejtojnë të ne në Parti, në pushtet, në ushtri, në ekonomi, në arsim etj. Metoda e punës që ndjek Komiteti Qendror i BRPSH dhe komitetet e rinisë në rrethe me të rinjtë është e drejtë. Tani ne vëmë re se është zhdukur disi sektarizmi që ekzistonte përpara, vetëm shikojmë se ka një farë formalizmi. Na thonë se në përbërjen e Komitetit Qendror të BRPSH ka vetëm anëtarë partitë. Në bazë të Statutit të organizatës, në KQ të BRPSH mund të ketë edhe të rinj pa parti, por kurdoherë ata duhet të jenë të tillë që ta meritojnë.

Të kemi kujdes që të mbushim radhët e organizatës së Bashkimit të Rinisë edhe me të reja. Përparime ka në këtë drejtim, po akoma vihen re ngurrime. Të rejat përbëjnë një forcë të madhe si për rininë, ashtu edhe për Partinë, prandaj më të mirat t'i pranojmë në organizatë.

Mbi të gjitha duhet ruajtur Partia, pastërtia e radhëve të saj. Në këto situata të vështira ne duhet të shtrëngojmë radhët e Partisë e të jemi vigjilentë. Kjo nuk do të thotë që një njeri që gabon ta hedhim menjëherë jashtë. Jo, ta shikojmë mirë punën e tij, gabon me qëllim të keq apo pa dashje. Në këtë drejtim rëndësi të madhe ka gjykimi i komunistëve. Prandaj të mbajmë gjakftohtësinë me cilindo, sepse armiku do të përdorë një mijë e një mënyra për të na futur në qorr-sokak. Aftësia e çdo komunisti në çdo situatë është të ruajë gjakftohtësinë, durimin dhe zemrën ta ketë me



të vërjetë prej komunisti, njerëzit t'i gjykojë sipas fajeve që kanë bërë, sipas rrethanave dhe situatave, të mos harrojnë të kaluarën dhe të tashmen e njeriut që gjykon, ta gjykojë atë drejt dhe po që armik atëherë të dënohet pa mëshirë, po që i gabuar të bëhen përpjekje që të ndreqet. Roli i Partisë dhe i rinisë në këtë drejtim është i madh.

Në këto situata nuk na falet të jemi as liberalë dhe as sektarë. Të mos tregohemi liberalë ndaj njerëzve që nuk i kanë garancitë e duhura për t'u zgjedhur ose për t'u emëruar në këtë ose në atë organ. Nga ana tjetër, të mos tregohemi sektarë e të braktisim ata që, në këto situata të vështira, armiku përpiqet t'i bëjë për vete, pa zhvilluar luftë dhe përpjekje për t'i sjellë në rrugën e drejtë të Partisë. Prandaj çështja e gjykimit të drejtë të veprimeve të njerëzve luan një rol të madh në favor të Partisë.

Me kaq, në emër të KQ të Partisë i uroj gjithë rinisë dhe organizatës së saj luftarake suksese në punën e lavdishme për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e fitoreve të mëdha të popullit dhe të Partisë sonë. Partia jonë ka besim të plotë e të patundur te rinia dhe është e sigurt se ajo, ashtu siç ka qenë kurdoherë pranë Partisë në momentet më të vështira nga ku ka kaluar populli, duke luftuar bashkë dhe krah për krah me komunistët, ashtu do të qëndrojë sypatrembur edhe në të ardhshmen. Në saje të luftës së drejtë që ka bërë rinia, nën udhëheqjen e Partisë, ne jemi të bindur se Partia do të bëhet akoma më e fortë. Ashtu siç i ka ardhur Partisë deri tani gjaku i ri dhe i pastër i rinisë sonë heroike, ashtu do të shtohen edhe paskëtaj radhët

e Partisë me të rinj e të reja heroike, punëtorë, fshatarë, intelektualë, të cilët mbajnë lart të pastër vetëm një flamur, flamurin e Partisë.

Shokë, nuk ka gjë më të shtrenjtë se populli, Partia, marksizëm-leninizmi. Me këtë flamur, pra, të bashkuar grusht, nën udhëheqjen e Partisë, të ecim përpara me besim të patundur, sepse ashtu siç kemi korrur gjer tani fitore kolosale me flamurin e Partisë, ashtu do të korrim edhe në të ardhshmen fitore të reja akoma më të mëdha dhe armiqtë do t'i mposhtim. Armiqtë e brendshëm do t'i shpartallojmë, po të nxjerrin veshët, dhe orvatjet e armiqtve të jashtëm do t'i bëjmë të dështojnë me çfarëdo koalicioni që të na luftojnë. Ne me siguri do të fitojmë edhe kundër klikës tradhtarë të Hrushovit që sot paraqitet gjoja e fuqishme, po ajo do të demaskohet dhe do të shkatërrohet nga forca e pamposhtur e marksizëm-leninizmit dhe e revolucionarëve të vërtetë në botë.

*Në fund mbledhja e përbashkët e Komitetit Qendror të PPSH dhe e Komitetit Qendror të BRPSH aprovoi vendimin që është botuar në «Dokumente kryesore të PPSH», vëllimi IV, f. 73. Tiranë, 1970.*

*Botohet për herë të parë me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## **KINA POPULLORE LUAN SOT NJË ROL GJITHNJË E MË TË MADH NË ARENËN NDERKOMBËTARE**

*Fjala në pritjen e dhënë nga Ambasada e RP të Kinës  
në Tiranë me rastin e 12-vjetorit të shpalljes  
së RP të Kinës*

**30 shtator 1961**

I dashur shoku ambasador,

Shokë dhe zotërinj,

U mbushën plot 12 vjet që populli i madh vëlla kinez shpalli Republikën e tij Popullore. 1 tetori është bërë tani në Kinë ditë e madhe gëzimi për masat punonjëse, të cilat me krenari të ligjshme bëjnë bilancin e fitoreve të shkëlqyera që korrin nga viti në vit, duke dhënë një shembull të lartë të punës krijuese paqësore. Tok me Kinën e madhe gëzojnë popujt e vendeve socialiste dhe gjithë njerëzimi përparimtar. Shpallja e Republikës Popullore të Kinës është gjithashtu ditë gëzimi edhe për popullin shqiptar dhe Partinë e Punës të Shqipërisë, miq të singertë dhe besnikë të popullit vëlla kinez. Më lejoni, shoku ambasador, që në emër të

Komitetit Qendror të Partisë së Punës, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të gjithë popullit shqiptar t'ju shpreh Juve dhe nëpërmjet Jush mbarë popullit kinez, Partisë Komuniste dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës përshëndetjet më të nxehta vëllazërore me rastin e festës suaj të madhe!

Shpallja e Republikës Popullore të Kinës dhe vendosja e diktaturës së proletariatit në një vend me territor të madh dhe me një popullsi që përfshin një të katërtën e njerëzimit, shënojnë një hap vendimtar përpara në raportin e forcave në botë në favor të socializmit dhe në dëm të imperializmit, shënojnë shpejtimin e procesit të kalbëzimit të mëtejshëm dhe të shembjes së sistemit shoqëror kapitalist. Çlirimi i popullit të madh kinez i dha një hov të paparë luftës së drejtë çlirimtare të popujve të Azisë, të Afrikës dhe të Amerikës Latine.

I udhëhequr me urtësi nga Partia e tij e lavdishme Komuniste me birin e tij të madh në krye, shokun Mao Ce Dun, populli heroik kinez, gjatë këtyre pak vjetëve, që nga shpallja e Republikës, ka arritur fitore të shkëlqyera historike në ndërtimin socialist. Duke zbatuar në mënyrë krijuese marksizëm-leninizmin, Partia e lavdishme Komuniste e Kinës po e bën Republikën Popullore të Kinës një vend të fuqishëm socialist. Populli kinez, duke zbatuar me sukses tre flamurët e kuq: të vijës së përgjithshme të partisë për ndërtimin e socializmit, të hopit të madh përpara dhe të komuneve popullore, ka treguar një inisiativë krijuese në një nivel shumë të lartë në të gjitha fushat e ndërtimit socia-

list. Kështu, në Kinë, gjatë tre vjetëve të hopit të madh, në sektorin e industrisë u realizuan përpara afatit treguesit kryesorë të planit të dytë pesëvjeçar, u krijua një bazë industriale moderne mjaft e madhe, duke bërë që të rritet disa herë më shumë kapaciteti i prodhimit në degët kryesore të industrisë. Në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar në përpjesëtime të mëdha ndërtimet e bonifikimit të tokave dhe një sërë punimesh të tjera, duke krijuar kushte të favorshme për një zhvillim të mëtejshëm të prodhimeve bujqësore, ndërsa arsimi dhe kultura gjatë kësaj periudhe kanë ecur me shpejtësi përpara. Nuk ka dyshim se sukseset e shkëlqyera, të arritura deri sot, përbëjnë një bazë shumë të fuqishme për të ecur akoma më shumë dhe më me vrull përpara.

Këto suksese të shkëlqyera janë fryt i përpjekjeve vigane të këtij populli të madh e të talentuar dhe i unitetit të tij të pathyeshëm me Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës. Këto suksese frymëzojnë në luftën e tyre për liri, pavarësi dhe përparim shoqëror të gjithë popujt e tjerë që vuajnë akoma nën zgjedhën e egër të kapitalit.

Republika Popullore e Kinës, duke ndjekur me konsekuencë politikën e urtë marksiste-leniniste të forcimit të miqësisë dhe të unitetit me të gjitha vendet socialiste, përkrah me të gjitha forcat e veta përpjekjet revolucionare të popujve të shtypur që luftojnë kundër imperializmit dhe kolonializmit, lufton më vendosmëri kundër politikës imperialiste të agresionit dhe të luftës.

Si vend i fuqishëm socialist, Kina luan sot një rol

gjithnjë e më të madh në arenën ndërkombëtare, jep një kontribut të rëndësishëm në triumfin e parimeve të bashkekzistencës paqësore midis shteteve me sisteme të ndryshme politike dhe shoqërore dhe qëndron e patundur në radhët e para të luftës kundër imperializmit për forcimin e miqësisë midis popujve, për uljen e tensionit ndërkombëtar dhe për sigurimin e paqes në botë.

Politika e urtë paqësore marksiste-leniniste e Republikës Popullore të Kinës çmohet shumë nga të gjithë popujt paqedashës, të cilët shohin te ajo një mbrojtëse të vendosur e konsekuente të lirisë dhe të pavarësisë së popujve, një luftëtare të papërkulur kundër çdo lloj shtypjeje, shfrytëzimi dhe padrejtësie. Prandaj kjo politikë e drejtë e Republikës Popullore të Kinës nuk mund të errësohet nga akuzat dhe shpifjet e ulëta të imperialistëve dhe të aleatëve të tyre, si dhe të revizionistëve modernë.

Qeveria e Kenedit dhe partnerët e saj perëndimorë, ndërsa flasin me hipokrizi për paqe sa për të gënjer popujt, vazhdojnë politikën e vjetër kundër paqes, shpejtojnë me përpjesëtime të padëgjuaara deri tani garën e armatimeve dhe përgatitjet historike për luftë, duke krijuar një situatë shumë të nderë ndërkombëtare. Shtetet imperialiste, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në krye, i kanë sabotuar vazhdimisht bisedimet për çarmatimin dhe ato për ndalimin e provave të armëve bërthamore. Imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, sidomos qeveria revanshiste e Bonit, kohët e fundit kanë shpërthyer një fushatë të madhe luftënxitëse, kanë shtuar së tepërmi veprimet dhe provoka-

cionet agresive, si dhe përpjekjet për të ngjallur psiko-  
zën e luftës.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria dhe populli ynë, kanë kërkuar dhe kërkojnë nënshkrimin e traktatit të paqes me Gjermaninë dhe normalizimin e gjendjes në Berlinin Perëndimor si një qytet i lirë dhe i çmilitarizuar.

Ngjarjet vërtetojnë çdo ditë e më qartë karakterin agresiv të imperializmit, prandaj në situatën e sotme ndërkombëtare më tepër se kurrë kërkohet të rritet vigjilenca e popujve dhe bashkimi i të gjitha forcave paqedashëse për të frenuar planet agresive të përgatitjes dhe të shpërthimit të luftës së imperialistëve e veçanërisht të imperialistëve amerikanë, këtyre atentatorëve të egër të paqes, armiq të betuar të njerëzimit. Duhet luftuar e duhet goditur pa mëshirë planet dhe veprimet luftënxitëse e agresive të imperialistëve, duhen demaskuar pa lëkundje orvatjet demagogjike të imperialistëve dhe të agjenturave të tyre revizioniste. Partitë marksiste-leniniste kanë zhvilluar dhe zhvillojnë një luftë parimore të vendosur kundër revizionizmit të sotëm, që përbën rrezikun kryesor në lëvizjen komuniste. Në këtë luftë midis marksizëm-leninizmit dhe revizionizmit fitorja do të jetë e marksizëm-leninizmit, ndërsa revizionizmi në mënyrë të pashmangshme është i destinuar të falimentojë e të shpartallohet. Revizionistët mund të arrijnë të mashtrojnë disa të ashtuquajtur marksistë, por kurrë marksistët e vërtetë; revizionistët mund të të gënjejnë për një kohë, por jo gjithmonë. Ndërgjegjja e komunistëve s'është plaçkë tregu që blihet e shitet në pazar. Mendja e kthjellët e marksistëve

nuk errësohet lehtë nga dredhitë e akrobatëve dhe të sharlatanëve të panairëve. Marksizëm-leninizmi është i pamëshirshëm ndaj renegatëve, prandaj revizionistët me çfarëdo maske që ta mbulojnë fytyrën, kanë një frikë të tmerrshme në bark, sepse e dinë ç'fat i pret.

Imperialistët amerikanë dhe aleatët e tyre, duke ndjekur një politikë luftënxitëse dhe të tmerruar nga rritja e vazhdueshme e autoritetit të Republikës Popullore të Kinës në botë, shkolin në mënyrë flagrante normat më elementare të së drejtës ndërkombëtare dhe parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Ata janë munduar me të gjitha mënyrat t'i mohojnë, për 12 vjet me radhë, Republikës Popullore të Kinës rivendosjen e të drejtave të saj të ligjshme në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, shpikin të ashtuquajturën politikë të «dy Kinave» si taktikë djallëzore për të përjetësuar pushtimin e ishullit të Tajvanit, për të mbajtur me çdo kusht në këmbë kufomën politike të Çan Kai Shisë, që populli kinez e shporri nga atdheu i vet me luftën e tij heroike. Por duan apo nuk duan imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre, sot ekziston vetëm një Kinë, një dhe e pandarë — Republika e madhe Popullore e Kinës, shtet i fuqishëm socialist, që përparon dhe lulëzon çdo vit e më shumë, pa pjesëmarrjen e të cilit nuk mund të zgjidhet asnjë problem i rëndësishëm ndërkombëtar.

Populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria jonë i dënojnë me vendosmërinë më të madhe manovrat dhelparake të imperialistëve amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre për të mohuar të drejtat e ligjshme të Republikës Popullore të Kinës në Organizatën



e Kombeve të Bashkuara dhe përkrahin pa rezerva çështjen që Republikës Popullore të Kinës t'i jepet sa më parë vendi që i përket në këtë organizatë ndërkombëtare. Tajvanin dhe ishujt e tjerë rreth tij ne i konsiderojmë si pjesë përbërëse dhe të pandarë të Republikës Popullore të Kinës, prandaj e kemi mbështetur plotësisht dhe do ta mbështetim edhe në të ardhshmen çështjen e çlirimit të plotë të tyre.

Të dashur shokë dhe zotërinj,

Populli shqiptar dhe populli kinez janë lidhur me një miqësi të përjetshme vëllazërore, të bazuar në parimet e marksizëm-leninizmit dhe të internacionalizmit proletar. Kjo miqësi e madhe që rritet, forcohet dhe lulëzon çdo ditë e më shumë është kalitur në luftën tonë të përbashkët për mbrojtjen e pastërtisë së marksizëm-leninizmit, për demaskimin me vendosmëri deri në fund të imperialistëve luftënxitës amerikanë dhe të shërbëtorëve të tyre, revizionistëve modernë, për qëllimet dhe idealet tona të përbashkëta — ndërtimin e socializmit dhe ruajtjen e paqes në botë. Farkëtuese të kësaj miqësie të pathyeshme janë partitë tona marksiste-leniniste, të cilat luftojnë me vendosmëri dhe pa u përkulur përpara çdo pengese e vështirësie për zbatimin e marksizëm-leninizmit, për forcimin e unitetit të vendeve socialiste dhe të unitetit të lëvizjes komuniste e punëtore ndërkombëtare, të cilin më kot orvaten ta dëmtojnë mercenarët e imperializmit dhe revizionistët modernë.

Frytet e miqësisë së madhe të të dy vendeve tona pasqyrohen më së miri në zgjerimin dhe në forcimin e

gjithanshëm të marrëdhënieve dhe të bashkëpunimit vëllazëror midis të dy popujve dhe vendeve tona socialiste. Ne me kënaqësi të madhe konstatojmë se gjatë viteve të fundit, sidomos gjatë vitit 1961, bashkëpunimi në të gjitha fushat midis Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Republikës Popullore të Kinës ka marrë një zhvillim akoma më të madh në interes të të dy popujve tanë dhe të socializmit. Republika Popullore e Kinës i ka dhënë dhe vazhdon t'i japë popullit shqiptar një ndihmë të madhe bujare, internacionaliste, për ndërtimin e socializmit në Shqipëri. Partia e Punës, Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dhe populli shqiptar kanë qenë dhe do t'u jenë kurdoherë mirënjohës popullit të madh kinez, Partisë Komuniste të lavdishme dhe Qeverisë së Republikës Popullore të Kinës për këtë ndihmë vëllazërore pa interes.

Shokë dhe zotërinj,

Populli shqiptar, i udhëhequr me urtësi e guxim nga Partia e Punës e Shqipërisë, me patriotizmin e flaktë që e karakterizon, me punën e tij vetëmohuese, çan përpara i vendosur dhe ka arritur suksese të mëdha në ndërtimin e socializmit, në forcimin e pozitës ndërkombëtare të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe të fuqisë së saj mbrojtëse, pa iu trembur syri nga rrethimi kapitalist e revizionist dhe nga orvatjet e pandërprera armiqësore të imperialistëve e të veglave të tyre.

Imperializmi, revizionistët e Beogradit dhe gjithë armiqtë e Partisë e të popullit tonë janë përpjekur me zjarr e me hekur, me komplete e me bllokada të shumë-

llojshme ta mbytin Partinë tonë, të robërojnë popullin. Armiqtë mendojnë se Shqipërinë, meqë është e vogël, mund ta likuidojnë lehtë. Por ata, duke gabuar në llogaritë e tyre, kanë dështuar dhe do të dështojnë me turp, sepse përpara kanë gjetur dhe do të gjejnë kurdoherë një kala të çeliktë që nuk jepet, e cila mbrohet me heroizëm e me guxim nga një popull e një Parti trime. Ata që janë përpjekur t'i bëjnë varrin Shqipërisë kanë rënë vetë brenda. Shqipëria e re socialiste ecën përpara si trimëreshë, siç i ka hije një vendi socialist që rron dhe lufton në shekullin e madh të leninizmit. Trupi i kësaj trimëreshe ka shenjat e plagëve nga thikat e plumbat e armiqve, por balli i saj është i pastër e i ndritur, pa njolla, syrin e ka si shqiponjë mali dhe zemrën e ka të pastër e të zjarrtë si revolucioni. Është për këtë arsye që Shqipërinë dhe Partinë e saj heroike i duan, i respektojnë dhe i mbrojnë gjithë njerëzit përparimtarë e gjithë komunistët në botë. Është për këtë arsye që kush ngre dorën kundër Shqipërisë, do të hajë grushtin e rëndë jo vetëm të kësaj trimëreshe, por dhe të të gjithë komunistëve të botës, të popujve të vendeve socialiste, të gjithë njerëzve të ndershëm dhe përparimtarë. Armiqve të popullit dhe të Partisë sonë të mos u shkojë ndër mend se do të na gjejnë në befasi. Ne jemi të pregatitur për çdo situatë dhe të gatshëm të përballojmë me sukses çdo ngjarje. Ne ua njohim dhe ua kuptojmë dredhitë, kompletet, kombinacionet e tyre kundër popullit dhe Partisë sonë dhe këtu qëndrojnë forca dhe pjekuria e popullit dhe e Partisë sonë. Ne s'jemi njerëz të iluzionëve dhe të ëndrrave, ne e dimë se vështirësitë e pen-

gesat e njerëzimit dhe të popullit tonë s'mbarojnë pa u shfarosur imperializmi dhe agjentura e tij — revizionizmi. Dhe duke mos pasur frikë t'i përballojmë dhe t'i zhdukim këto vështirësi përgjithmonë, ne korrin vazhdimisht suksese, kurse armiqtë tanë disfata.

Me entuziazëm të papërshkruar, si kurrë ndonjëherë, punonjësit e vendit tonë janë mobilizuar tani me të gjitha forcat për realizimin dhe tejkalimin e detyrave të planit të tretë pesëvjeçar. Këtë e dëshmojnë më së miri rezultatet e shkëlqyera të realizimit të planit nëntëmujor të këtij viti.

Vendimet historike të Kongresit IV të Partisë sonë pasqyrojnë më së miri politikën e drejtë konsekuente, marksiste-leniniste të Partisë së Punës të Shqipërisë. I frymëzuar nga këto vendime populli shqiptar, si një popull që ndërton me sukses socializmin, edhe paskëtaj do të punojë akoma më i vendosur për ndërtimin e socializmit në atdheun e tij të lirë e sovran.

Populli ynë ecën i sigurt përpara në rrugën e socializmit, sepse kudo në botë ka miq dhe vëllezër të sinqertë e besnikë që e përkrahin, si popujt vëllezër të Bashkimit Sovjetik, të Kinës Popullore dhe të vendeve të tjera socialiste.

Një miqësi e flaktë, e pastër, e sinqertë, është kalitur në zemrat e Partisë dhe të popullit tonë për popujt e Bashkimit Sovjetik dhe për Partinë e Leninit dhe të Stalinit. Kjo s'u pëlqen dhe u prish planet revizionistëve modernë, të cilët na quajnë antisovjetikë, farisej. Partia i thotë popullit, qentë le të lehin, ti shiko punën tënde të lavdishme se e ke drejt. Partia dhe populli ynë, si kurdoherë, do të luftojnë për forcimin e miqësisë

vëllazërore me popujt e Bashkimit Sovjetik, të Republikës Popullore të Kinës dhe me të gjithë popujt e vendeve të tjera socialiste, për forcimin e mëtejshëm të unitetit dhe të solidaritetit internacjonalist, për mbrojtjen e interesave të larta të atdheut dhe të socializmit, në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.

Në këtë ditë feste të madhe dhe gëzimi të papërshkruar për popullin vëlla kinez, më lejoni të ngre këtë doli:

Për popullin e madh heroik dhe të talentuar kinez!

Për Partinë e lavdishme Komuniste të Kinës, me udhëheqësin e dashur shokun Mao Ce Dun në krye!

Për miqësinë e pathyeshme midis dy popujve tanë vëllezër!

Për paqen dhe miqësinë midis popujve!

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», Nr. 237 (4080), 1 tetor 1961*

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## L E N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 21-të. .... V—VIII

1961

- TË MËSOJMË PËRDITË DHE DIJEN TA VËMË NË SHËRBIM TË POPULLIT — Fjala para nxënësve dhe mësuesve të shkollës pedagogjike «Luigj Gurakuqi» të Elbasanit (3 maj 1961) ..... 1—10
- PËRSE RANKOVIÇI SHKON NË ATHINË? (2 maj 1961) 11—17
- KOMUNISTËT SHQIPTARË I PËRULEN VETËM MARKSIZËM-LENINIZMIT DHE POPULLIT TONË — Nga biseda me kuadrot e Partisë të qytetit të Elbasanit (4 maj 1961) ..... 18—37
- KUADËR I MIRË ËSHTË AI QË DËGJON ZËRIN E MASËS — Nga biseda me kuadrot e kooperativës bujqësore të bashkuar të Zervaskës në rrethin e Pogradecit (6 maj 1961) ..... 38—46
- RRËNJËT E PARTISË SONË JANË NË ZEMRËN E POPULLIT SHQIPTAR — Nga fjala në mitingun para popullit të Pogradecit (6 maj 1961) ..... 47—59
- USHTRIA JONË ËSHTË NJË GARANCI PËR TË MBROJTUR FITORET E ARRITURA — Fjala në një repart ushtarak të qytetit të Korçës (8 maj 1961) .. 60—72
- UNITETI PARTI-POPULL E BËN RPSH NJË KËSH-TJELLË TË PAMPOSHTUR — Fjala me kuadrot e repartit ushtarak të kufirit dhe të Sigurimit të Shtetit të rrethit të Korçës (9 maj 1961) ..... 73—83

NË ÇDO PUNË TË NA KARAKTERIZOJË FRYMA E LARTË REVOLUCIONARE DHE MPREHTËSIA POLITIKE — Nga biseda në kryesinë e kooperativës bujqësore të bashkuar të Pojanit në rrethin e Korçës (9 maj 1961) .....	84—90
KOHA E REGJIMIT TË SKLLAVËRISË, E SHTYPJES SË POPULLIT DHE E URISË S'KA PËR TË KTHYER KURRË NË SHQIPËRI — Nga biseda me fshatarët e kooperativës bujqësore të bashkuar të Lumalasit në rrethin e Korçës (9 maj 1961) .....	91—98
KUSH PËRPIQET T'I BËJË VARRIN SHQIPËRISË, DO TË BJERË VETË BRENDA — Fjala para kua-drove të Partisë, të pushtetit dhe të ushtrisë në rrethin e Korçës (9 maj 1961) .....	99—115
TË PËRBALLOJMË SITUATAT E VËSHTIRA QË NA IMPONOHEN — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 maj 1961) .....	116—119
POPULLI KËRKON QË SHKRIMTARËT DHE ARTISTËT TË KRIJOJNË SA MË SHUMË VEPRA ME VLERË — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (22 maj 1961) .....	120—129
SITUATA KËRKON SQARIM POLITIK, UNITET TË FORTË DHE MOBILIZIM TË MADH TË MASAVE — Fjala me sekretarët e parë të komiteteve të Partisë të rretheve dhe me disa kuadro kryesorë të aparatit të KQ të PPSH (30 maj 1961) .....	130—158
TELEGRAM URIMI ME RASTIN E 60-VJETORIT TË DITËLINDJES (31 maj 1961) .....	159—160
MBROJTJA E KUFIJVE ËSHTË DETYRA MË E LARTË PATRIOTIKE — Fjala në aktivin e Partisë të forcave të kufirit (2 qershor 1961) .....	161—193
TA BËJMË LUGINËN E BUKUR TË PEZËS QË TË LULËZOJË KURDOHERË — Fjala në mitingun me	



kooperativistët e lokalitetit të Ndroqit në rrethin e Tiranës (14 qershor 1961) .....	194—211
DUKE PRODHUAR SA MË SHUMË DO TË RROJMË EDHE MË MIRË — Fjala me kooperativistët e Petrelës në rrethin e Tiranës (14 qershor 1961). .....	212—226
TË PËRHAPIM NË FSHAT TË GJITHA TË MIRAT E KLASËS PUNËTORE — Nga biseda me kuadrot drejtues të kooperativës së bashkuar të Vaqarrit «Rruga e Leninit» të rrethit të Tiranës (14 qershor 1961)	227—232
TË LUFTOJMË E TË PUNOJMË DUKE VËNË KURDOHERË IDEALIN E PARTISË MBI GJITHÇKA, ATDHEUN MBI ÇDO GJË — Nga biseda me kuadrot drejtues të kooperativës së bashkuar Bërzhitë-Dobresh të rrethit të Tiranës (14 qershor 1961) .....	233—240
KËTO DITË TË LUMTURA POPULLI YNË I KA ËNDËRRUAR ME SHEKUJ — Fjala në mitingun e organizuar me popullin e lokalitetit të Zall-Herrit të rrethit të Tiranës (15 qershor 1961) .....	241—255
AVIATORËT QË RRTI, KALITI DHE EDUKOËI PARTIA JANË BIJ BESNIKË TË SAJ DHE TË POPULLIT — Fjala me oficerët e repartit të aviacionit të Rinastit (15 qershor 1961) .....	256—264
PARTIA NA KËSHILLON TË QËNDROJMË MË PAK NË ZYRË DHE MË SHUMË MIDIS POPULLIT — Fjala në mitingun e organizuar me kooperativistët e lokalitetit të Vorës e të Prezës (15 qershor 1961) ....	265—280
SPECIALISTËT E BUJQËSISË TË MERREN MË SHUMË ME PUNËN E GJALLË NË TERREN — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 qershor 1961) .....	281—286
PROBLEMET E ORGANIZATËS SË GRUAS NUK MUND TË ZGJIDHEN SI DUHET NË RAST SE NUK BËHEN PROBLEME TË PARTISË — Diskutim në	

mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (23 qershor 1961) .....	287—294
KURSIMI — METODË PUNE SOCIALISTE, DETYRË E MADHE POLITIKE, EKONOMIKE, E PËRHERSHME PËR TË GJITHË — Fjala në Plenumin II të KQ të PPSH (1 korrik 1961) .....	295—323
MBI GJENDJEN NDËRKOMBËTARE DHE MBI MARRËDHËNIET E PPSH ME PK TË BS DHE PARTITË KOMUNISTE E PUNËTORE TË VENDEVE SOCIALISTE TË EVROPËS — Informacion në Plenumin II të KQ të PPSH (1 korrik 1961) .....	324—349
BAKSHISHET NUK PAJTOHEN ME NORMAT E MORALIT KOMUNIST — Letër dërguar komiteteve të Partisë të rretheve (11 korrik 1961) .....	350—355
POPULLI YNË KA TRASHËGUAR NJË KULTURË TË MADHE ME TRADITA PËRPARIMTARE — Fjala në mbledhjen me shkrimtarët dhe artistët (11 korrik 1961) .....	356—385
ÇDO GJË KA VLERË TË MADHE KUR BËHET NGA DUART E ARTA DHE MENDJA E KTHJELLËT E BIJVE TË POPULLIT TONË — Nga biseda me një grup të rinjsh pjesëmarrës në takimin kombëtar të rinisë së minierave dhe të gjeologjisë (12 korrik 1961) .....	386—401
TË PËRHAPIM PËRVOJËN E MIRË TË SHKOLLAVE EKSPERIMENTALE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (15 korrik 1961) .....	402—404
ZËRI I FUQISHËM I SË VËRTETËS MARKSISTE-LENINISTE DO TË MBYTË ZËRIN E ÇJERRË TË KORIT SHIPFARAK REVIZIONIST — Letërpërgjigje drejtuar KQ të PSP të Hungarisë (12 gusht 1961) ....	405—415
NJË AKT ANTIMARKSIST E ANTISHQIPTAR I GRUPIT REVIZIONIST TË HRUSHOVIT — Letër dërguar të gjitha organizatave të Partisë (16 gusht 1961) .....	416—425

TELEGRAM NGUSHULLIMI PËR VDEKJEN E MILITANTIT TË PALODHUR KOMUNIST, UILIAM FOSTER (4 shtator 1961) .....	426—427
MBI DISA PROBLEME TË GJENDJES NDËRKOMBËTARE — Fjala në Plenumin III të KQ të PPSH (5 shtator 1961). .....	428—456
LETËR DREJTUAR KOMITETEVE QENDRORE TË PARTIVE KOMUNISTE E PUNËTORE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË TRAKTATIT TË VARSHAVËS (6 shtator 1961). .....	457—481
TË KAPIM MIRË KYÇET PËR EDUKIMIN E NJERËZVE — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (11 shtator 1961) .....	482—490
NË GJENDJEN E KRIJUAR NE NUK DO TË SHKOJME NË MBLEDHJEN E KNER-IT — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (11 shtator 1961) .....	491—493
TË PRANOJMË NË PARTI MË SHUMË NJERËZ NGA KLASA PUNËTORE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shtator 1961) ....	494—499
TË GJITHA FORCAT PËR PËRMIRËSIMIN E METODËS SË PUNËS — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (16 shtator 1961) .....	500—509
PARTI E RINI, SI KURDOHERË, TË PUNOJMË, TË MËSOJMË E TË VIGJËLOJMË NË UNITET TË ÇELIKTË, NË SOLIDARITET DHE BESNIKËRI TË PATUNDUR — Fjala e mbylljes në Plenumin IV të përbashkët të Komitetit Qendror të PPSH dhe të Komitetit Qendror të BRPSH (26 shtator 1961) .....	510—550
KINA POPULLORE LUAN SOT NJË ROL GJITHNJË E MË TË MADH NË ARENËN NDËRKOMBËTARE — Fjala në pritjen e dhënë nga Ambasada e RP të Kinës në Tiranë me rastin e 12-vjetorit të shpalljes së RP të Kinës (30 shtator 1961) .....	551—561